



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
INSTITUTI I STUDIMEVE EVROPIANE**

**Disertacion i paraqitur nga:
Vilma Hasneziri**

**Në kërkim të gradës shkencore:
“DOKTOR”**

Në

“Studime Evropiane dhe Integrim Evropian”

**Tema: ROLI I GJYKATËS EVROPIANE TË DREJTËSISË
NË TË DREJTËN E BASHKIMIT EVROPIAN**

Drejtimi: Legjislacioni dhe institucione evropiane

Kandidate

Msc. Vilma HASNEZIRI

Udhëheqës Shkencor

Prof. Dr. Ardian NUNI

Tiranë, 2016



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
INSTITUTI I STUDIMEVE EVROPIANE**



Disertacion i paraqitur nga:
Vilma Hasneziri

Në kërkim të gradës shkencore:
“DOKTOR”

Në

“Studime Evropiane dhe Integrim Evropian”

**Tema: ROLI I GJYKATËS EVROPIANE TË DREJTËSISË
NË TË DREJTËN E BASHKIMIT EVROPIAN**

Drejtimi: Legjislacioni dhe institucione evropiane

**Udhëheqës Shkencor
Prof.Dr. Ardian Nuni**

Mbrohet më, dt. /2016

1. **Kryetar**
2. **Anëtar (oponent)**
3. **Anëtar (oponent)**
4. **Anëtar**
5. **Anëtar**

TIRANË, 2016

Përmbajtja

Parathënie.....	III
Hyrje.....	1

KAPITULLI I PARË

Evoluimi historik i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe parimet bazë të veprimtarisë së saj.....	8
--	----------

1.1. Gjykata Evropiane e Drejtësisë, si një institucion i një lloji të veçantë, “sui generis”.....	8
1.2. Evoluimi historik i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.....	11
1.3. Parimet bazë të veprimtarisë së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.....	14

KAPITULLI DYTË

Organizimi dhe funksionimi i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.....	29
---	-----------

2.1. Përbërja e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe statusi i gjyqtarëve të sa.....	29
2.2. Gjykata e Përgjithshme, evoluimi historik, organizimi dhe juridiksioni i saj.....	40
2.3. Gjykata e Shërbimit Civil, veçoritë dhe juridiksioni i saj.....	48
2.4. Procedura e gjykimit para Gjykatës së Drejtësisë.....	55

KAPITULLI I TRETË

Mbrojtja e të drejtave të njeriut nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë.....	69
--	-----------

3.1. Paditë e ngritura nga personat fizikë ose juridikë privatë me objekt anulimin e akteve të institucioneve të Bashkimit Evropian.....	69
3.2. Paditë e ngritura nga personat fizikë ose juridikë privat, me objekt mosveprimin e institucioneve të Bashkimit Evropian.....	90
3.3. Paditë e ngritura nga personat fizikë ose juridikë privat, me objekt paligjshmërinë e akteve të institucioneve të Bashkimit Evropian.....	98
3.4. Paditë e ngritura nga personat fizikë ose juridikë privat, ndaj institucioneve të Bashkimit Evropian me objekt dëmshpërblimin kontraktor dhe jashtëkontraktor.....	103

KAPITULLI I KATËRT

Gjykata Evropiane e Drejtësisë si roje e traktateve.....	124
---	------------

4.1. Procedurat ligjore të ndjekura nga Komisioni Evropian, në rastet e mospërbushjes së detyrimeve nga një Shtet Anëtar.....	124
4.2. Rastet tipike kur Komisioni mund të fillojë procedurat ligjore, për mospërbushje të detyrimeve nga Shtetet Anëtare.....	135
4.3. Paditë e ngritura nga një Shtet Anëtar, kundër një Shteti tjetër	

Anëtar për mospërbushje të detyrimeve.....	150
4.4.Rregullat ligjore për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, për mospërbushje të detyrimeve nga ana e Shteteve Anëtare.....	159
Konkluzione.....	171
Bibliografia.....	196

Parathënie

Bashkimi Evropian është çështja kryesore si dhe kryefjala e çdo vendi që pret të bëhet pjesë e tij. Ky organizëm është nderuar për përkrahjen e demokracisë, të drejtat e njeriut si dhe përhapjen e paqes dhe stabilitetit në kontinent. Çuarja përpara e të drejtave të njeriut kërkon që Bashkimi Evropian të krijojë aleanca të gjera me qeveri të tjera, organizata ndërkombëtare, me sektorin privat dhe sidomos me shoqërinë civile. Pikerisht, ky zgjerim në pjesëmarrje si dhe bashkëpunim me organizma të tjerë, janë premisa edhe për lindjen e mosmarrëveshjeve mes qytetarëve evropianë dhe organeve mes tyre, si dhe më e rëndësishmja, lind nevoja e interpretimit të traktateve me anën e të cilave këto shtete janë bërë palë e Evropës së Bashkuar.

Ky moment ka qënë shtysë e cila më ka orientuar tek Roli i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, e cila është një nga instituconet më të rëndësishme të Bashkimit Evropian, misioni dhe funksioni qëndror i së cilës është: “garantimi i zbatimit të ligjit në interpretimin dhe zbatimin e Traktateve”. Me anë të saj, garantohen dhe sigurohen të drejtat e qytetarit, të shteteve si dhe interpreton normat të cilat derivojnë nga korpusi ligjor i të Drejtës Komunitare.

Derisa Komuniteti Ekonomik Evropian, i krijuar më 1957, fillimisht gjatë viteve '80, nuk merrej me çështje politike, siç janë të drejtat e njeriut, me integrimin politik të Evropës drejtë Bashkimit Evropian, të drejtat e njeriut dhe demokracia u bënë koncepte kryesore të rendit të përgjithshëm juridik Evropian.

Rolin kryesor e ka luajtur Gjykata Evropiane e Drejtësisë e cila ka zhvilluar juridiksionin për të drejtat e njeriut, që rrjedh si nga “traditat e përbashkëta kushtetuese të shteteve anëtare”, ashtu edhe nga traktatet ndërkombëtare, siç janë Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, palë të të cilave janë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të marrësh në analizë Bashkimin Evropian hasesh me një sërë problematikash të cilat janë produkt i bashkimit të një sër shtetesh me zhvillime të ndryshme, mentalitete dhe politika të ndryshme të cilat hera herës interferojnë tek njëra tjetra. Pikerisht ky studim i detajuar është fokusuar tek Gjykata Evropiane e Drejtësisë, duke analizuar rolin e saj pozitiv në ndërthurjen e normave juridike të ndryshme për shtete të ndryshme si dhe harmonizimi i tyre në funksion të së mirës së përbashkët drejt një unifikimi normash dhe parimesh, bazë për vazhdimësinë dhe zbatimin e të drejtës Evropiane të përbashkët.

Me anën e këtij punimi është analizuar, organizimi dhe struktura e Gjykatës Evropiane, rëndësia e këtij organi në Bashkimin Evropian si dhe sfidat e saj në garantimin e të drejtave të Shteteve Anëtare, individëve dhe organeve të këtij organizmi ndërkombëtarë.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka një rëndësi të dukshme në lidhje me interpretimin por edhe për evoluimin e të drejtës komunitare, madje dhe për vetë konceptin e Komunitetit. Gjykata Evropiane ka luajtur një rol të madh të “Plotësimit Normativ”, analog me rolin e ushtruar ndaj Parlamentit të brendëshëm të shteteve anëtare nga Gjykata Kushtetuese me vendimet e saj. Më konkretisht ky dizertacion, është i strukturuar në 4 kapituj ku secili prej tyre trajton natyrën, funksionin dhe rolin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, tek shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe qytetarët e Bashkimit.

Hyrje

Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian ka mbi 50 vjet që ekziston si një nga organet më të rëndësishme të këtij Bashkimi. Nevoja për krijimin e saj lindi nga fakti se, çdo sistem ligjor mund të jetë i vazhdueshëm vetëm në qoftë se, rregullat e tij kontrollohen nga një autoritet i pavarur. Duke qenë se, Bashkimi Evropian i krijuar nga këto tre Traktate Themeluese, përbëntë një bashkim shtetesh të pavarur, rregullat e përbashkta të bashkimit, nëse do t'i nënshtroheshin kontrollit të gjykatave të shteteve të anëtare, kjo do të çonte në një interpretim dhe zbatim të ndryshëm të këtyre rregullave, nga shtete të ndryshme anëtare.¹ Pikërisht, sigurimi i zbatimit uniform të së drejtës së Bashkimit Evropian, si dhe sigurimi i vazhdimësisë së vetë kësaj organizate, përbën edhe arsyen kryesore të lindjes së Gjykatës Komunitare të Drejtësisë, sot Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Një tjetër arsye për krijimin e kësaj Gjykate, është se, që në Traktatet Themeluese,² por edhe në traktatet që janë në fuqi, Traktati për Bashkimin Evropian dhe Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, të cilët kanë zëvendësuar Traktatet Themeluese, institucionet e Bashkimit Evropian, janë parashikuar që të organizohen dhe të funksionojnë në bazë të parimit të bashkëpunimit, respektit dhe kontrollit reciprok ndaj njëri-tjetrit. Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian, duke u nisur nga juridiksioni dhe kompetencat që ka, është një nga institucionet më të rëndësishme, që shërben për realizimin e kontrollit dhe balancës ndërmjet institucioneve.

Aspekti kontrollues i kësaj Gjykate, duket në disa drejtime, të cilat përbëjnë edhe pjesë të rëndësishme të juridiksionit të saj. Kështu, për shembull, kur kjo Gjykatë merr për shqyrtim dhe vendos për paditë që kanë të bëjnë me vlefshmërinë ligjore të akteve që nxjerrin institucionet e ndryshme të Bashkimit Evropian, si Komisioni Evropian, Këshilli, apo Parlamenti Evropian, sigurisht, në këto raste, ajo ushtron kompetenca të rëndësishme kontrolli dhe balance, ndërmjet institucioneve. Po ashtu, në rastet kur kjo Gjykatë shqyrton padi me objekt mosveprimin e institucioneve të ndryshme të Bashkimit, edhe në këto raste, ajo ushtron kompetenca kontrolli, mbi mënyrën sesi duhet të veprojnë institucionet e ndryshme të Bashkimit Evropian.

Përsa i përket kontrollit të akteve të institucioneve të Bashkimit Evropian, nga ana e Gjykatës së Drejtësisë, duhet të kemi parasysh se, ajo e ushtron këtë funksion, në përputhje me normat ligjore të parashikuara nga vetë Traktatet e Bashkimit Evropian, si dhe brenda kompetencave që asaj i janë dhënë dhe për pasojë nuk mund ta bëjë një gjë të tillë, në mënyrë arbitrare, apo subjektive. Kjo do të thotë që, edhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë, i nënshtrohet parimeve që iu nënshtrohen të gjithë institucionet e tjera të Bashkimit Evropian, parime që kanë të bëjnë me bashkëpunimin, respektin dhe kontrollin reciprok ndaj njëri-tjetrit.

Për funksionet kontrolluese të kësaj gjykate, ashtu siç do ta shohim edhe më poshtë, duhet të mbajmë parasysh edhe një fakt tjetër të rëndësishëm, i cili lidhet me rendin

¹ Shih për më tepër: "ABC-ja e së drejtës së Bashkimit Evropian", botim i Ministrisë së Integrimit Evropian, Tiranë 1011, faqe 70.

² Është fjala për Traktatin Themelues të Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut, nënshkruar në Paris, me 18 prill 1951, nga gjashtë shtetet themeluese, Franca, Gjermania, Italia, Holanda, Belgjika dhe Luksemburgu, i cili ka hyrë në fuqi me datë 23 korrik 1952, si dhe për Traktatet Themeluese të Komunitetit Ekonomik Evropian dhe të Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, nënshkruar në Romë, po nga këto gjashtë shtete, me 25 mars 1957, të cilët hynë në fuqi me 1 janar 1958.

juridik të Bashkimit Evropian. Parë në këtë këndvështrim, rendi juridik i Bashkimit përbëhet nga dy kategori të rëndësishme normash juridike:

Së pari: Normat juridike të promulguara apo të sanksionuara nga Traktatet Kushtetuese, të cilat njihen edhe si burime primare ose origjinale të së drejtës evropiane dhe

Së dyti: Normat juridike të nxjerra nga institucionet apo organizmat e Bashkimit Evropian, të cilat njihen edhe si burime sekondare ose derivative të së drejtës, ku përfshihen Rregulloret, Direktivat dhe Vendimet.

Duke iu referuar Traktateve Kushtetuese, konstatohet se, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, ka kompetenca kontrolli, pra, ka kompetencë apo juridiksion për të shqyrtuar dhe për pasojë edhe për të shfuqizuar ose ndryshuar, vetëm aktet juridike që përbëjnë burim sekondar të së drejtës evropiane. Ndërsa, për ndryshimin dhe/ose shfuqizimin e normave juridike që përbëjnë burim primar të së drejtës, kjo Gjykatë nuk ka juridiksion, por, një e drejtë e tillë iu është lënë Shteteve Anëtare, çka përbën edhe një nga veçoritë më interesante të Bashkimit Evropian, si një organizatë ndërkombëtare, e llojit të veçantë apo “siu generis”.

Pavarsisht faktit të rolit kontrollues që ka Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në lidhje me aktet dhe normat juridike që nxjerrin institucionet e Bashkimit Evropian, apo edhe në lidhje me të gjithë veprimtarinë juridike të këtyre institucioneve, duhet theksuar se, sipas Traktateve Kushtetuese, ky nuk është roli kryesor që i është njohur, në mënyrë të shprehur, këtij institucioni. Përkundrazi, që në Traktatet Kushtetuese, si rol kryesor i kësaj Gjykate është parashikuar, garantimi i respektimit të ligjit në interpretimin dhe zbatimin e Traktateve. Një rol i tillë i është dhënë Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në mënyrë të shprehur, në Traktatin për Bashkimin Evropian, në të cilin janë përcaktuar edhe organet që përbëjnë këtë institucion.³

Duke u nisur nga përmbajtja e kësaj norme juridike konstatohet se, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, është e përbërë nga tre organe:

a) Gjykata e Drejtësisë;

b) Gjykata e Përgjithshme dhe

c) Gjykatat e specializuara, të cilat mund të krijohen me propozimin e Gjykatës së Drejtësisë nga ana e Këshillit dhe që deri tani, është krijuar dhe funksion vetëm Gjykata e Shërbimit Civil.

Në lidhje me këto organe që përbëjnë Gjykatën Evropiane të Drejtësisë, duhet thënë se, secili nga këto organe, nuk është institucion i posaçëm i Bashkimit Evropian, siç janë për shembull, Parlamenti Evropian apo Komisioni Evropian, por, ato janë organizma përbërës brenda një institucioni të vetëm që është Gjykata Evropiane e Drejtësisë. Po ashtu, në lidhje me pozitën e këtyre organeve, duhet theksuar se, në përputhje me normat ligjore të parashikuara nga Traktatet, këto organe nuk ndodhen në pozita hierarkie me njëri-tjetrin, por, në pikëpamje të kompetencës funksionale vendimet e marra nga një gjykatë më e ulët, mund të ndryshohen ose prishen nga gjykata më e lartë.

Në përputhje me kompetencën funksionale, vendimet që merr Gjykata e Shërbimit Civil, mund të bëhen objekt ankimi në Gjykatën e Përgjithshme, vetëm për

³ Pika 1 e nenit 19 të Traktatit për Bashkimin Evropian parashikon:

“Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian, përfshin Gjykatën e Drejtësisë, Gjykatën e Përgjithshme dhe gjykatat e specializuara. Ajo garanton respektimin e ligjit në interpretimin dhe zbatimin e Traktateve”.

shkaqe ligjore dhe po kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Drejtësisë, vetëm në raste përjashtimore, kur rrezikohet uniformiteti dhe koherenca e të drejtës së Bashkimit Evropian. Pra, Gjykata Evropiane e Drejtësisë funksionon mbi bazën e tre organeve të i ngjashëm me çdo sistem ligjor të Shteteve Anëtare; Gjykata e Drejtësisë, si gjykata më e lartë, Gjykata e Përgjithshme dhe gjykatat e specializuara.

Nga ana tjetër, fakti që Gjykata Evropiane e Drejtësisë është e përbërë nga tre organe të veçanta, që kanë kompetenca funksionale të ndryshme, ku gjykatat më të larta kanë të drejtë që të ndryshojnë ose prishin vendimet e gjykatave më të ulta, nuk do të thotë që, secili nga organet që e përbëjnë atë, nuk është i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij. Përkundrazi, Traktatet Kushtetuese përcaktojnë në mënyrë të qartë se, çdo gjykatë, në ushtrimin e funksionit të saj është e pavarur, dhe asnjë gjykatë më e lartë apo asnjë institucion tjetër i Bashkimit Evropian, nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e veprimtarisë së saj të ligjshme. Raporti që ekziston mes tre gjykatave të niveleve të ndryshme, gjykatave të specializuara, Gjykatës së Përgjithshme dhe Gjykatës së Drejtësisë, është i njëjtë me raportin që ekziston në sitemet juridike të brendshme të çdo Shteti Anëtar, ku, vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë, shqyrtohen nga Gjykata e Apelit dhe vendimet e kësaj të fundit shqyrtohen nga Gjykata e Lartë ose Gjykata e Kasacionit.

Ky raport nuk çënon pavarësinë e gjykatave të ndryshme më të ulta, jo vetëm për faktin se, shqyrtimi i vendimeve të tyre bëhet në përputhje me normat juridike të përcaktuara nga Traktatet Kushtetuese, por, edhe për faktin se, ai është i domosdoshëm në respektim të të drejtës universale për t'u ankuar kundër një vendimi të dhënë nga një gjykatë më e ulët, në një gjykatë më të lartë. Një gjë e tillë është siguruar me anë të një sistemi drejtësie, me të paktën dy shkallë gjykimi, sistem ky i përqaftuar nga të gjitha Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, dhe që është përpjekur që ta bëjë edhe vetë Bashkimi Evropian, për aq sa ka qenë e mundur. Përveç raporteve të kompetencës funksionale që ekziston ndërmjet niveleve të ndryshme të gjykimin, duhet theksuar se, Gjykata e Drejtësisë, si gjykata më e lartë e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në disa raste gjykon vetë si instancë e parë dhe e fundit, çka do të thotë se, ajo ka edhe juridiksion fillestar edhe juridiksion rishikues.

Nga sa u përmend më sipër në lidhje me rolin që Traktatet i kanë njohur, në mënyrë të shprehur, Gjykatës Evropiane e Drejtësisë, mund të themi se, funksioni kryesor i kësaj Gjykate përbëhet nga dy elementë të rëndësishëm:

- a) Garantimi i respektimit të ligjit me anë të interpretimit të Traktateve dhe
- b) Garantimi i respektimit të ligjit me anë të zbatimit të Traktateve.

Interpretimi i Traktateve është një nga funksionet më të rëndësishme që ka Gjykata Evropiane e Drejtësisë. Interpretimi i Traktateve do të thotë nxjerra e kuptimit dhe përmbajtjes së tyre për një çështje konkrete. Interpretimi i traktateve përbën një kompetencë ekskluzive të kësaj Gjykate, ç'ka do të thotë se, një normë e caktuar e Traktateve apo edhe një Traktat i caktuar, në tërësinë e tij, duhet të interpretohet ashtu siç e kupton Gjykata Evropiane e Drejtësisë dhe të gjitha institucionet e tjera të Bashkimit Evropian, si dhe të gjitha shtetet anëtare, janë të detyruar që të respektojnë vendimin e Gjykatës që ka bërë interpretimin përkatës.

Fakti që Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka kompetencë ekskluzive interpretimin e Traktateve, nuk do të thotë që institucionet e tjera të Bashkimit, nuk e kanë një të drejtë të tillë. Përkundrazi, të drejtën për të interpretuar Traktatet dhe normat e tjera juridike e ka çdo institucion tjetër, siç është Parlamenti Evropian, Këshilli apo Komisioni Evropian, pasi veprimtaria e tyre, në një pjesë të madhe, ushtrohet

pikërisht, me anë të interpretimit që ato i bëjnë normave juridike. Kompetenca ekskluzive e Gjykatës për të interpretuar Traktatet do të thotë se, fjalën e fundit në lidhje me interpretimin e tyre e ka në çdo rast Gjykata, dhe asnjë institucion tjetër, të cilët duhet t'i bindet vendimit të gjykatës në rastet kur ajo interpreton një normë të caktuar.

Përsa i përket interpretimit të Traktateteve dhe normave të tjera juridike të Bashkimit Evropian që bën Gjykata Evropiane e Drejtësisë, duhet thënë se, ky funksion i Gjykatës, nuk përbën qëllim në vetvete. Këtë interpretim Gjykata e bën me qëllim që të garantojë respektimin e ligjit brenda Bashkimit Evropian, në mënyrë që, e gjithë veprimtaria e institucioneve të Bashkimit dhe e shteteve anëtare të Bashkimit, të ushtrohet në përputhje me parimin e ligjshmërisë apo me parimin e sundimit të ligjit apo të së drejtës (rule of Law).

Funksioni i dytë i rëndësishëm i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë është sigurimi i zbatimit të ligjit me anë të zbatimit të Traktateteve. Funksioni i zbatimit të Traktateteve nga kjo gjykatë, do të thotë që në ushtrimin e kompetencave të saj, ajo duhet të bazohet vetëm në normat juridike që janë përcaktuar në vetë Traktatet apo në aktet e tjera të Bashkimit Evropian dhe duhet t'i marrë vendimet e saj, në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian.

Ky funksion i zbatimit të traktateteve nga ana e Gjykatës, përbën një aspekt tjetër të parimit të sundimit të ligjit, pasi kjo Gjykatë, ashtu si edhe çdo institucion tjetër i Bashkimit, duhet t'i nënshtrohet normave juridike që janë sanksionuar nga Traktatet Kushtetuese dhe aktet e tjera juridike. Çdo vendim i Gjykatës i cili, nuk është bazuar në një normë juridike të Bashkimit Evropian, apo që nuk është i bazuar në parimet e përgjithshme të drejtësisë, apo në marrëveshjet ndërkombëtare, apo nuk është i bazuar në moralin dhe zakonet e mira, është pa vlerë juridike.

Duhet theksuar se, funksioni i interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga ana gjykatës, nuk duhen parë si funksione të ndara nga njëri-tjetri. Përkundrazi, ato janë të lidhur në mënyrë të ngushtë me njëri-tjetrin, sa, nuk mund të zbatohet njëri pa u zbatuar, në të njëjtën kohë edhe tjetri. Kjo për faktin se, në zgjidhjen e çdo çështjeje konkrete Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në të njëjtën kohë, respekton Traktatet dhe aktet e tjera juridike të Bashkimit Evropian, sepse, është e detyruar që ta bazojë vendimin, në një nga këto akte dhe po ashtu, interpreton Traktatet dhe aktet e tjera juridike, duke nxjerrë kuptimin dhe përmbajtjen e tyre në çdo rast konkret.

Më sipër theksuam se, një nga funksionet kryesore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, është funksioni i kontrollit të veprimtarisë së institucioneve të tjera të Bashkimit Evropian, në zbatim të parimit të bashkëpunimit dhe respektit ndërmjet institucioneve, si dhe të balancës ndërmjet tyre. Ky funksion kontrolli, është në përputhje të plotë me misionin kryesor që ka kjo Gjykatë, që është garantimi i ligjshmërisë, nëpërmjet interpretimit dhe zbatimit të Traktateteve, për faktin se, ushtrimi i këtij funksioni kontrollues bëhet nga ana e Gjykatës, me anë të garantimit të ligjshmërisë së funksionimit të të gjitha institucioneve të Bashkimit Evropian, si dhe të shteteve anëtare.

Ky punim doktror trajton problematikat e sipërpërmendura duke u strukturuar në 4 kapitull ku fillohet që me trajtimin e evoluimit historik të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe deri tek menyra se si funksionon dhe vepron ky institucion. Dhe konkretisht :

Në kapitullin e parë, është trajtuar, Evoluimi historik i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë kompetencat që i janë shtuar kësaj gjykate nga njëri traktat në tjetrin duke filluar që me mënyrën e kompozimit të saj dhe me gjerë. Vijon trajtimi në këtë

kapitull me natyrën e veçantë “sui generis” e këtij institucioni kjo për faktin se, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, ka elementet e një Gjykate Kushtetuese, në rastet kur ajo shqyrton mosmarrëveshjet ndërmjet institucioneve të ndryshme të Bashkimit Evropian ose kur jep mendim, nëse një marrëveshje ndërkombëtare që do të nënshkruajë në të ardhmen Bashkimi Evropian, është apo jo në përputhje me të drejtën evropiane apo rendin juridik evropian. Nga ana tjetër, kjo Gjykatë paraqet elementët e një gjykate ndërkombëtare në rastet kur, ajo shqyrton paditë kundër shteteve anëtare për shkak të mospërmbushjes prej tyre të detyrimeve që burojnë nga Traktatet. Po ashtu, ajo paraqet elementet e një gjykate administrative kur shqyrton paditë që kanë të bëjnë me aktet e nxjerra nga institucionet e tjera të Bashkimit Evropian, nëse ato janë apo jo në përputhje me të drejtën evropiane.

Kjo Gjykatë, ka elementet e një gjykate civile, në rastet kur shqyrton paditë e ndryshme për dëmshpërblim që mund të ngrihen ndaj institucioneve të Bashkimit apo ndaj shteteve anëtare, si dhe kur interpreton Konventën e Brukselit “*Mbi zbatimin e vendimeve gjyqësore në fushën civile dhe tregtare*” ose shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me qarkullimin e lirë të personave dhe mundësive të barabarta. Ajo paraqet elementë të një gjykate penale, kur shqyrton vendimet e Komisionit që vendosin gjoba, kundër Shteteve Anëtare për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve që burojnë nga Traktatet. Panvarsisht ngjashmërive që paraqet me secilën prej gjykatave të mësipërme, Gjykata Evropiane e Drejtësisë mbetet unike në llojin e saj pasi ajo , është një gjykatë e një lloji të veçantë “sui generis”. Ajo përbën organin gjyqësor të Bashkimit Evropian, juridiksioni i së cilës është të garantojë respektimin e ligjit me anë të interpretimit të Traktatave, ose thënë ndryshe, të sigurojë rendin juridik evropian dhe të interpretojë të drejtën evropiane.

Në kapitullin e parë trajtohen gjithashtu edhe parimet bazë të veprimtarisë së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, mes të cilave trajtohet Parimi i Ligjshmërisë, delegimit të kompetencave, proporcionalitetit, subsidiaritetit etj.

Në kapitullin e dytë, është trajtuar organizimi dhe funksionimi i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, duke filluar që me përbërjen e saj, statusi i gjyqtarëve të kësaj Gjykate. Për të vijuar me tej me Gjykatën e Përgjithshme, Gjykata e Shërbimit Civil, evoluimi historik, organizimi dhe juridiksioni i tyre si dhe Procedura e gjykimit para Gjykatës së Drejtësisë duke u trajtuar nën evolucionin historik që këto gjykata kanë patur si rrjedhojë e traktateve të Bashkimit. Përveç Gjyqtarëve, të cilat janë funksionarë publikë të ngarkuar nga ligji për dhënien e drejtësisë në kuadër të Bashkimit Evropian, një vend të rëndësishëm në Gjykatën e Drejtësisë zënë edhe *Avokatët e Përgjithshëm*. Në Traktatet Themeluese është përcaktuar se, Avokatët e Përgjithshëm kanë si detyrë që të mbështesin Gjykatën e Drejtësisë gjatë ushtrimit të funksioneve të saj. Aktualisht, numri i Avokatëve të Përgjithshëm është nëntë, por, është parashikuar mundësia që ky numër të rritet, me kërkesë të Gjykatës së Drejtësisë dhe me vendim të Këshillit Evropian.⁴

Avokatët e Përgjithshëm përbëjnë një organ “sui generis” ose të llojit të veçantë, brenda organizimit të përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë, i cili, nuk gjendet në asnjë prej organeve gjyqësore, qoftë të Shteteve Anëtare, qoftë edhe të homologëve të tjerë, në të drejtën ndërkombëtare. Avokatët e Përgjithshëm, si një organ i pavarur dhe i paanshëm, nuk marrin pjesë në çdo çështje që shqyrtohet nga

⁴ Paragrafi i parë i nenit 252 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Gjykata e Drejtësisë mbështetet nga nëntë Avokatë të Përgjithshëm. Këshilli, me unanimitet, mund ta rrisë numrin e Avokatëve të Përgjithshëm, nëse këtë e kërkon Gjykata e Drejtësisë”.

ana e Gjykatës së Drejtësisë, por, vetëm në ato çështje, në të cilat sipas Statutit të kësaj Gjykate, kërkohet pjesëmarrja e tyre në gjykim. Në çështjet në të cilat ato marrin pjesë, Avokatët e Përgjithshëm, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, paraqesin parashtrimet e tyre të arsyetuara, me shkrim, në seancë gjyqësore publike.

Detyra e Avokatëve të Përgjithshëm është që të paraqesin opinione me shkrim para Gjykatës, në formën e propozimeve jo të detyrueshme për zgjidhjen e çështjes, opinione këto të bazuara në një studim, tërësisht të pavarur dhe jo politik të çështjeve ligjore të ngritura për shqyrtim. Opinionet e Avokatëve të Përgjithshëm janë pjesë e pavarur e procedurës së zhvillohet para Gjykatës së Drejtësisë dhe botohen në Raportet e Gjykatës, së bashku me vendimet përfundimtare. Me anë të opinioneve të tyre, Avokatët e Përgjithshëm, vetëm mund të ndikojnë tek vendimi përfundimtar i Gjykatës me anë të forcës së argumenteve, por, ato nuk kanë fuqi vendim marrëse, pasi nuk përfshihen në diskutime dhe as nuk marrin pjesë në votim, në marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e Gjykatës së Drejtësisë.

Për të vijuar më tej me Kapitullin e tretë, me anën e të cilit njihemi me mirë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë. Paditë e ngritura nga personat fizikë ose juridikë privatë me objekt anulimin e akteve të institucioneve të Bashkimit Evropian, duke specifikuar edhe rastet e tjera të rolit aktiv të qytetarëve ndaj institucioneve të Bashkimit, në rastet e akteve të nxjerra prej tyre apo dhe në rastet e mosveprimeve të këtyre insitucioneve kur janë të detyruara të veprojnë. Në këtë kapitull trajtohen më hollësisht mbrojtja e të drejtave të individëve si dhe rastet se kur këto subjekte mund të iniciojnë një proces gjyqësor në mbrojtje të të drejtave të tyre të cënuara nga veprimet apo mosveprimet e organeve të Bashkimit Evropian. Nuk ka munguar në këtë kapitull edhe konkretizimi i çështjeve të trajtuara me raste praktike të gjykuara nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë si duke u njojtur me hollësisht me arsyetimin e Gjykatës për probleme specifike.

Kapitulli i katërt, sjell në vëmendje rolin më kryesor të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë si roje e traktateve. Në këtë kapitull trajtohet përgjegjësia e Shteteve anëtare përballë detyrimeve të Bashkimit Evropian, si dhe interferenca e organeve të tjera, siç është Komisioni Evropian në Gjykatën e Drejtësisë në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve nga një Shtet Anëtar. Në këtë kapitull jam përpjekur të trajtoj rastet tipike kur komisioni mund të fillojë procedurat ligjore, për mospërmbushje të detyrimeve nga shtetet anëtare, paditë e ngritura nga një shtet anëtar, kundër një shteti tjetër anëtar për mospërmbushje të detyrimeve si dhe rregullat ligjore për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, për mospërmbushje të detyrimeve nga ana e Shteteve Anëtare.

Nga sa është trajtuar në këtë dizertacion, mund të konkludojë se ky institucion ka një rëndësi thelbësore për Bashkimin Evropian pasi me anë të tij sigurohet zbatimit uniform i së drejtës së Bashkimit Evropian, si dhe sigurohet vazhdimësia e vetë kësaj organizate.

Përgatitja dhe finalizimi i këtij punimi do të ishte i mangët pa mbështetjen, përkrahjen dhe dashamirësinë e shumë personave të rëndësishëm të jetës time, të cilët gjej rastin t'i falenderoj për zemërsisht dhe t'iu jem mirnjohës për gjithë jetën.

Shpreh mirënjohjen për udheheqësin tim Shkencor Prof. Dr. Ardian Nuni për ndihmën dhe përkrahjen që me ka kushtuar gjatë gjithë ciklit të studimit për strukturimin dhe punimin e temës.

Një falenderim të veçantë i'a dedikoj stafit të Institutit të Studimeve Evropiane, të cilët më kanë mbështetur dhe më kanë ndihmuar pa u kursyer duke mu gjendur pranë që në hartimin dhe përfundimin e këtij cikli studimi.

Dashuri, mirënjohje dhe një falenderim të veçantë i dedikoj familjes time, veçanërisht bashkëshortit tim, për mbështetjen psikologjike, shpirtërore si dhe inkurajimin e pa kursyer deri në finalizimin e kësaj pune disa vjeçare.

KAPITULLI I PARË

EVOLUIMI HISTORIK I GJYKATËS EVROPIANE TË DREJTËSISË DHE PARIMET BAZË TË VEPRIMTARISË SË SAJ

1.1. Gjykata Evropiane e Drejtësisë, si një institucion i një lloji të veçantë, “sui generis”.

Përpara se të sqaroj evolumin historik të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, është e nevojshme që të sqarohet natyra juridike e kësaj Gjykate, apo karakteristikat që ajo paraqet si një nga institucionet e Bashkimit Evropian. Kuptimi i natyrës së saj, si një nga institucionet e Bashkimit, është e vështirë, sepse, duke u nisur nga juridiksioni dhe kompetencat që ajo ka, ajo paraqet elemente të një gjykate të një lloji të ndryshëm, në varësi të çështjes konkrete që ajo shqyrton.

Kështu, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, ka elementet e një Gjykate Kushtetuese, në rastet kur ajo shqyrton mosmarrëveshjet ndërmjet institucioneve të ndryshme të Bashkimit Evropian ose kur jep mendim, nëse një marrëveshje ndërkombëtare që do të nënshkruajë në të ardhmen Bashkimi Evropian, është apo jo në përputhje me të drejtën evropiane apo rendin juridik evropian. Nga ana tjetër, kjo Gjykatë paraqet elementët e një gjykate ndërkombëtare në rastet kur, ajo shqyrton paditë kundër shteteve anëtare për shkak të mospërmbushjes prej tyre të detyrimeve që burojnë nga Traktatet. Po ashtu, ajo paraqet elementet e një gjykate administrative kur shqyrton paditë që kanë të bëjnë me aktet e nxjerra nga institucionet e tjera të Bashkimit Evropian, nëse ato janë apo jo në përputhje me të drejtën evropiane.

Kjo Gjykatë, ka elementet e një gjykate civile, në rastet kur shqyrton paditë e ndryshme për dëmshpërblim që mund të ngrihen ndaj institucioneve të Bashkimit apo ndaj shteteve anëtare, si dhe kur interpreton Konventën e Brukselit “*Mbi zbatimin e vendimeve gjyqësore në fushën civile dhe tregtare*” ose shqyrton çështjet që kanë të bëjnë me qarkullimin e lirë të personave dhe mundësive të barabarta. Ajo paraqet elementë të një gjykate penale, kur shqyrton vendimet e Komisionit që vendosin gjyba, kundër Shteteve Anëtare për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve që burojnë nga Traktatet.

Pavarsisht nga fakti se, Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka, në të njëjtën kohë, elementet e disa gjykatave, si ato të Gjykatës Kushtetuese, administrative, civile dhe penale, ajo për nga natyra e saj, nuk mund të konsiderohet, se përmbush në mënyrë të plotë, elementët e secilës gjykatë në kuptimin klasik të fjalës. Kështu, kjo Gjykatë nuk mund të konsiderohet si Gjykatë Kushtetuese e Bashkimit Evropian, jo vetëm për faktin se, një status të tillë nuk ia kanë dhënë Traktatet Kushtetuese dhe sistemi juridik evropian, por, edhe për faktin tjetër se, kompetenca dhe procedura që ajo zbaton, kanë ndryshime thelbësore me kompetencat dhe procedurën që ndjek, secila prej Gjykatave Kushtetuese të shteteve anëtare të Bashkimit. Kjo Gjykatë nuk mund të konsiderohet Gjykatë Kushtetuese e Bashkimit, edhe për një arsye shumë themelore; për faktin se, vetë Bashkimi Evropian, nuk përbën një shtet as federal dhe aq më pak unitar dhe për pasojë, duke mos qenë një shtet, në kuptimin e së drejtës ndërkombëtare, ai nuk mund të ketë as Gjykatën Kushtetuese të tij.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë nuk mund të konsiderohet as si një gjykatë ndërkombëtare, pavarsisht nga disa elementë që ajo ka, për faktin se, ajo vepron në

kuadër të një organizate të veçantë siç është Bashkimi Evropian, i cili vepron vetëm brenda një numri të caktuar shtetesh evropiane, aktualisht 28 shtete dhe brenda një rendi juridik të caktuar siç është e drejta evropiane. Në këtë drejtim kjo Gjykatë, ka dallime thelbësore me gjykatat ndërkombëtare, siç është Gjykata Ndërkombëtare Penale apo edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Në të njëjtën kohë, ajo nuk mund të përmbushë të gjitha veçoritë që paraqet një gjykatë administrative, në mënyrë që të konsiderohet si e tillë, për faktin se, subjektet që paraqiten prej saj, janë të ndryshme nga subjektet që paraqiten para një gjykatë administrative, ku, një palë në çdo rast është shteti, ndërsa, para saj si subjekte paraqiten jo vetëm shtetet anëtare, por, edhe institucionet e ndryshme të Bashkimit Evropian, si dhe vetë qytetarët e Bashkimit. Po ashtu, kjo Gjykatë nuk përmbush të gjitha cilësitë që të quhet si gjykatë civile apo penale, në kuptimin klasik, duke u nisur nga juridiksioni krejt i ndryshëm, që ka ajo në këtë rast, krahasuar me gjykatat penale apo civile të Shteteve Anëtare. Një gjykatë penale, në rendin e brendshëm ka si juridiksion gjykimin e veprave penale me qëllim deklarimin e pafajshëm ose fajtor të personit dhe caktimin e masës dhe llojit të dënimit, në rastet kur personi deklarohet fajtor, ndërsa, juridiksioni i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, kur vepron si gjykatë penale, ka të bëjë me gjykimin e ankesave të Shteteve që ato paraqesin ndaj Komisionit Evropian, në lidhje me gjokat që ai ka vendosur ndërmjet tyre.

Të njëjtën gjë mund të themi edhe për rastet kur kjo Gjykatë vepron si një gjykatë civile, ajo nuk përmbush të gjitha elementët që të konsiderohet si e tillë, në kuptimin klasik të fjalës. Kjo sepse, juridiksioni i një gjykatë civile në rendin e brendshëm të çdo Shteti Anëtar, është shqyrtimi i mosmarrëveshjeve civile dhe mosmarrëveshjeve të tjera, që lindin ndërmjet subjekteve të ndryshme të së drejtës, ndërsa juridiksioni i kësaj Gjykate, është të shqyrtojë vetëm një pjesë të mosmarrëveshjeve civile, që i janë deleguar Bashkimit Evropian nga Traktatet Kushtetuese, si dhe procedura dhe efektet e vendimit, janë krejt të ndryshme, me procedurën dhe efektet e vendimeve civile që jepen nga gjykatat e brendshme.

Nisur nga sa u tha më lart, mund të konkludojmë se, *Gjykata Evropiane e Drejtësisë, është një gjykatë e një lloji të veçantë "siu generis". Ajo përbën organin gjyqësor të Bashkimit Evropian, juridiksioni i së cilës është të garantojë respektimin e ligjit me anë të interpretimit të Traktatave, ose thënë ndryshe, të sigurojë rendin juridik evropian dhe të interpretojë të drejtën evropiane.*

Në lidhje me natyrën juridike të kësaj Gjykate, nga autorë të ndryshëm janë dhënë mendime sipas të cilave, kjo gjykatë përveçse si një nga institucionet e Bashkimit Evropian, mund të konsiderohet edhe si gjykatë ndërkombëtare, në rastet kur ajo zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet Shteteve Anëtare apo ndërmjet Bashkimit dhe Shteteve Anëtare.⁵ Ky vlerësim mendoj se, nuk është i saktë, pasi siç e sqarova më lart, mendoj se, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, nuk i përmbushë të gjitha cilësitë për t'u konsideruar si gjykatë ndërkombëtare, sepse, ajo vepron në kuadër të një organizate të veçantë, siç është Bashkimi Evropian, si dhe brenda një rendi juridik të caktuar, siç është e drejta evropiane.

Një tjetër veçori që ka të bëjë me natyrën e kësaj Gjykate është fakti se, në Traktatet Kushtetuese dhe në normat e tjera juridike që përbëjnë rendin juridik evropian, nuk janë parashikuar organe të posaçme, brenda Bashkimit Evropian, që të bëjnë ekzekutimin e vendimeve që ajo jep. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës, i

⁵ Shih për më tepër: Pocar; Fausto; "E Drejta e Komuniteteve Evropiane", Shtëpia Botuese "Logoreci", Tiranë 1995, faqe 117.

është lënë kompetencë organeve të brendshme të Shteteve Anëtare, të cilat duhet të marrin masa konkrete për ekzekutimin e tyre.

Është i vertetë fakti se, ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, i cili bëhet nga organet e brendshme të Shteteve Anëtare, nuk është lënë në vullnetin e lirë të Shtetit kundër të cilit është marrë vendimi. Në rast se, Shteti të cilit i drejtohet vendimi, nuk e ekzekuton atë, Komisioni Evropian, merr masa ndaj këtij Shteti, duke i propozuarr vendosjen e gjobës, deri në ekzekutimin e vendimit prej tij. Por, mosparashikimi i organeve ekzekutuese, brenda Bashkimit Evropian, të vendimeve të Gjykatës, si institucione të posaçme, mund të sjellë vonesa në ekzekutimin e vendimeve të saj dhe përbën një nga veçoritë që ka kjo Gjykatë, në raport me gjykatat e rendit të brendshëm.⁶

Një çështje tjetër që lidhet me natyrën juridike të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, është *çështja e të drejtës që ajo është e detyruar që të zbatojë*. Duke iu referuar dispozitatave të Traktateve Kushtetuese dhe normave të tjera juridike në fuqi, nuk ekziston një dispozitë konkrete që, të tregojë të drejtën apo ligjin që do të zbatohet nga Gjykatësit e kësaj Gjykate, në rastet kur ato zgjidhin një mosmarrëveshje konkrete.⁷ Neni 19 i Traktatit për Bashkimin Evropian vetëm pëckatin se, Gjykata garanton respektimin e ligjit në interpretimin dhe zbatimin e Traktateve.

Pavarsisht nga fakti se, në Traktatet Themeluese, nuk ka një dispozitë konkrete që të përcaktojë të drejtën ku, duhet t'i bazojë vendimet e saj Gjykata Evropiane e Drejtësisë, *mund të konkludojmë se, burimet e së drejtës, apo normat juridike, ku kjo Gjykatë duhet t'i bazojë vendimet e saj janë si më poshtë:*

a) *dispozitat e Traktateve Kushtetuese, të cilat, pas Traktatit të Lisbonës që ka hyrë në fuqi me 1 dhjetor 2009 janë tre; Traktati i Bashkimit Evropian, Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian dhe Traktati Evropian për Energjinë Atomike (EUROATOM);*

b) *parimet e përgjithshme të së drejtës të përbashkëta për ligjet e Shteteve Anëtare;*

c) *Protokollet e ndryshme, të cilat u bashkëngjiten Traktateve Kushtetuese, të cilat kanë të njëjtën vlerë, si dhe vetë Traktatet pasi janë pjesë përbërës e tyre;*

ç) *marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Bashkimi Evropian me shtetet e treta;*

d) *aktet normative të nxjerra nga institucionet e Bashkimit Evropian;*

⁶ Duhet theksuar se, mosparashikimi i organeve të brendshme të Bashkimit Evropian, që do të merren me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, nuk është një çështje e thjeshtë dhe nuk ka të bëjë me një mungesë legjislative apo me një pakujdesi të rendit juridik evropian. Parashikimi i organeve të veçanta brenda Bashkimit, që do të merren me ekzekutimin e vendimeve të kësaj Gjykate, është mbi të gjitha çështje e vullnetit politik të Shteteve Anëtare dhe ka të bëjë me heqjen dorë nga kjo pjesë e Sovranitetit të tyre, që lidhet me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Deri tani, Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, nuk janë treguar të gatshme që të heqin dorë nga kjo pjesë e Sovranitetit të tyre dhe për këtë arsye, në Traktatet Kushtetuese dhe as në normat e tjera juridike të Bashkimit Evropian, nuk janë parashikuar organe të posaçme të Bashkimit, të cilët, të kenë si kompetencë ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (Shënim i autores).

⁷ Shih për më tepër: Pocar; Fausto; "E Drejta e Komuniteteve Evropiane", Shtëpia Botuese "Logoreci", Tiranë 1995, faqe 119.

1.2. Evoluimi historik i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, si një nga institucionet e Bashkimit Evropian, i është nënshtruar një evoluimi të vazhdueshëm, si nga pikëpamja e organizimit dhe funksionit, ashtu edhe për nga pikëpamja e kompetencave, që nga data e krijimit të saj dhe deri në ditët tona. Ky evoluim apo zhvillim historik i kësaj Gjykate, është i lidhur me vetë zhvillimin historik të Bashkimit Evropian. Në kushtet kur, vetë Bashkimi, nëpër vite dhe dekada, i është nënshtruar një procesi të vazhdueshëm ndryshimesh dhe reformash edhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë, si një nga institucionet e tij, ka ndjekur të njëjtin fat të ndryshimeve dhe reformave.

Si datë e krijimit të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, konsiderohet data 18 prill 1951, e cila është data e nënshkrimit të Traktatit të Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut nga gjashtë shtete Franca, Gjermania, Italia, Holanda, Belgjika dhe Luksemburgu dhe ishte i hapur për nënshkrim për të gjitha shtetet e tjera të Evropës, traktat i cili hyri në fuqi, me datë 25 korrik 1952. Ky Traktat, i cili kishte si qëllim krijimin e një tregu të përbashkët evropian të qymyrit dhe çelikut si dhe krijimin e institucioneve të përbashkëta me qëllim garantimin e zbatimit të detyrimeve që buronin nga Traktati, krahas organeve të tjera, krijoi edhe Gjykatën e Drejtësisë.⁸

Traktati Themelues i Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut përcaktonte se, respektimi i drejtësisë në interpretimin dhe zbatimin e Traktatit dhe të akteve dhe institucioneve komunitare, garantohej nga Gjykata e Drejtësisë. Kjo Gjykatë përbëhej nga Gjykatës të emëruar nga qeveritë e Shteteve Anëtare dhe kishte si kompetencë që të gjykonte mbi ankesat e paraqitura nga secili Shtet Anëtar, nga Këshilli i Ministrave ose Autoriteti i Lartë, kundër shkeljeve të Traktatit të bëra nga Shtetet e tjera Anëtare ose institucionet e Komunitetit. Po ashtu, kjo Gjykatë kishte si kompetencë që të shqyrtonte edhe ankesat për anullimin e akteve jo të ligjshme të Autoritetit të Lartë, të Këshillit, si dhe në raste të caktuara edhe aktet e nxjerra nga ndërmarrjet dhe grupet e ndërmarrjeve.

Traktati i mësipërm i jepte Gjykatës së Drejtësisë një kompetencë ekskluzive për zgjidhjen e çështjeve, që nuk ishin në juridiksionin e gjykatave të brendshme të Shteteve Anëtare. Një gjë e tillë ishte parashikuar me synim që të shmangej krijimi i interpretimeve të ndryshme nga gjykatat e ndryshme të Shteteve Anëtare, për çështje që kanë të bëjnë me funksionim e Traktatit të Përbashkët.⁹ Në funksion të arritjes së këtij qëllimi, Traktati i mësipërm parashikonte shprehimisht që, vetëm Gjykata e Drejtësisë ishte kompetente që të gjykonte, mbi vlefshmërinë e akteve të Autoritetit të

⁸ Institucionet që u krijuan me anë të Traktatit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut, përveç Gjykatës së Drejtësisë, ishin:

- **Autoriteti i Lartë**, i cili ishte organ kolegjal dhe institucioni më i rëndësishëm që kishte si kompetencë nxjerrjen e akteve juridike detyruese ose jo, të cilat i drejtoheshin si Shteteve Anëtare, ashtu edhe vetë Komunitetit dhe me anë të të cilave, realizohej Politika e Përbashkët e Komunitetit;
- **Këshilli i Ministrave**, i cili përbëhej nga përfaqësuesit e secilit Shtet Anëtar dhe që ishte “organ këshillimor” që jepte mendime të detyrueshme, në lidhje me propozimet që bënte Autoriteti i Lartë;
- **Asambleja e Përbashkët**, e cila përbëhej nga parlamentarët e secilit Shtet Anëtar të emëruar sipas një procedure të caktuar dhe e cila kishte pushtetin ekskluziv të kontrollit politik të Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut.

⁹ Shih për më tepër: Pocar; Fausto; “E Drejta e Komuniteteve Evropiane”, Shtëpia Botuese “Logoreci”, Tiranë 1995, faqe 17.

Lartë ose Këshillit, në çdo rast që një çështje e parashtruar para një gjykate të brendshme, kishte të bënte me vlefshmërinë e këtyre akteve.¹⁰

Ndryshimi i parë që i ndodhi në organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, përgjatë kohëvazhdimet të saj, *lidhet me Traktatet e Romës*, konkretisht me Traktatin Themelues të Komunitetit Ekonomik Evropian dhe Traktatin Themelues të Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, të cilat çuan në krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike (Euroatom). Këto Traktate u nënshkruan, po nga 6 Shtetet Themeluese, Franca, Gjermania, Italia, Holanda, Belgjika dhe Luksemburgu, më datë 25 mars 1957 dhe hynë në fuqi, më 1 janar 1958.

Përveç dy Traktateve të mësipërme, po në këtë datë, u nënshkrua edhe *një Konventë “Mbi institucionet e përbashkëta të Komuniteteve Evropiane”*, e cila parashikonte ekzistencën e një Gjykate të vetme që do t’u shërbente të tre Komuniteteve. Mbi bazën e kësaj Konvente, Gjykata e Drejtësisë e Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut, u quajt *Gjykata e Drejtësisë së Komuniteteve Evropiane* dhe ishte organi i vetëm gjyqësor për të tre Komunitetet, ndërsa funksionet dhe kompetencat e saj ishin të parashikuara, në mënyrë të ndarë, në secilin prej tre Traktateve Themeluese.

Në lidhje me kompetencat dhe juridiksion konkret të Gjykatës së Drejtësisë së Komuniteteve Evropiane, secili nga tre Traktatet Themeluese, përcaktonte kompetencat e saj, me qëllim garantimin e zbatimit të së drejtës brenda bashkësisë së Komuniteteve Evropiane. Ashtu si edhe Traktati Themelues i Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut edhe Traktatet Themeluese të Komunitetit Ekonomik Evropian dhe të Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, parashikojnë që Gjykata e Drejtësisë së Komuniteteve Evropiane, kishte si kompetencë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ndërmjet Shteteve Anëtare, si dhe atyre ndërmjet Shteteve Anëtare dhe Komuniteteve Evropiane, për secilën nga fushat ku vepronin këto Traktate. Po ashtu, një kompetencë e rëndësishme e kësaj Gjykate, ishte edhe shqyrtimi i vlefshmërisë së akteve të secilit prej institucioneve të Komuniteteve Evropiane dhe dhënia e vendimeve në lidhje me interpretimin e dispozitave të Traktateve dhe në lidhje me vlefshmërinë e tyre, në rastet kur një gjë e tillë e kërkonin gjykatat e brendshme të shteteve anëtare, që përbënin të ashtëquajturat “Gjykime paragjykimore”.

Një evoluim të mëtejshëm pësoi Gjykata Evropiane e Drejtësisë me anë të nënshkrimit të Aktit Unik Evropian, i cili u nënshkrua në Luksemburg, me datë 17 shkurt 1986 dhe në Hagë me 28 shkurt 1986 dhe që hyri në fuqi, me datë 1 korrik 1987. Ky Akt bashkon në një dokument të vetëm dispozitat që kanë të bëjnë me institucionalizimin e bashkëpunimit politik evropian, si dhe ndryshon Traktatet Komunitare ekzistuese. Qëllimi i këtij Akti shprehet qartë që në nenin 1 të tij, në të cilin përcaktohet se: “Komunitetet Evropiane dhe bashkëpunimi politik ndjekin objektivin që të kontribuojnë së bashku për përparimin konkret të bashkimit evropian”.¹¹

Përveç risive dhe ndryshimeve që solli në Traktatet Themeluese ekzistuese, *Akti Unik Evropian*, solli ndryshime të rëndësishme edhe për Gjykatën Evropiane të

¹⁰ Shih për më tepër: Nenin 41 të Traktatit Themelues të Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut, nënshkruar me datë 18 prill 1951 dhe hyrë në fuqi me datë 25 korrik 1952.

¹¹ Shih për më tepër: Nenin 1 të Aktit Unik Evropian, nënshkruar në Luksemburg me datë 17 shkurt 1986 dhe në Hagë me 28 shkurt 1986 dhe hyrë në fuqi me datë 1 korrik 1987.

Drejtësisë. Këto ndryshime sollën krijimin e një organi të veçantë gjyqësor, brenda Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, e cila ishte *Gjykata e Shkallës së Parë*, sot Gjykata e Përgjithshme, e cila filloi aktivitetin e saj në vitin 1989. Nevoja për krijimin e kësaj Gjykate lindi për shkak se, Gjykata e Drejtësisë, ishte shumë e ngarkuar me çështje dhe me qëllim lehtësimin e ngarkesës së saj u pa e arsyeshme krijimi i kësaj Gjykate. Ky ndryshim bëri të mundur shtimin e një organi të ri, i cili kishte kompetenca gjyqësore dhe i cili, funksiononte krahas Gjykatës së Drejtësisë së Komuniteteve Evropiane. Duhet theksuar se, Gjykata e Shkallës së Parë, nuk përbënte dhe as sot nuk përbën një institucion të ri dhe të veçantë të Komuniteteve Evropiane, por, ishte një organ që funksiononte brenda Gjykatës së Drejtësisë.

Në lidhje me kompetencat që kishte Gjykata e Shkallës së Parë, Akti Unik Evropian, me anë të ndryshimeve që bëri, në secilin prej tre Trakateve Themeluese, parashikonte si kompetenca kryesore të saj, gjykimin e çështjeve që ngriheshin nga personat fizikë ose juridik me objekt anulimin e akteve të Komuniteteve Evropiane, për shkak të paligjshmërisë së tyre. Po ashtu, në kompetencë të kësaj Gjykate ishin edhe paditë që ngriheshin nga personat fizikë dhe juridikë ndaj institucioneve të Bashkimit Evropian, me objekt dëmshpërblimin për arsye të përgjegjësisë kontraktore ose jashtëkontraktore.

Traktati i Masihtit, i njohur edhe si "*Traktati mbi Bashkimin Evropian*", i nënshkruar me datë 7 shkurt 1992, shënon një moment tjetër të rëndësishëm në evoluimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Në këtë Traktat, qëllimi i të cilit ishte krijimi i një Evrope, sa më të bashkuar në të gjitha fushat e mundshme, ku, mund të pranohej ky bashkim nga Shtetet Anëtare, u bë ndryshimi i një numri dispozitash të Traktateve Themeluese.

Për Gjykatën Evropiane të Drejtësisë, ky Traktat paraqet rëndësi të madhe, për faktin se, ai parashikoi *zgjerimin e kompetencave të kësaj Gjykate, të cilës iu dha juridiksioni që të vendoste gjopa mbi shtetet anëtare*, të cilat shkelnin detyrimet që buronin nga e drejta komunitare ose *acquis communautaire*. Një gjë e tillë, përbënte një risi dhe një hap pozitiv përpara, në drejtim të realizimit të vetë qëllimeve të Traktatit, krijimin e një Evrope të Bashkuar, e cila realisht ishte më shumë një ideal sesa, një objektiv konkret.

Në procesin e evolimit të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, një vend më rëndësi paraqet edhe *Traktati i Amsterdimit*, i nënshkruar më datë 2 tetor 1997, i cili, ka bërë një sërë ndryshimesh në Traktatin e Bashkimit Evropian dhe në Traktatin e Komunitetit Evropian, si dhe refoma në institucionet e Komunitetit. Në bazë të këtij Traktati, *Gjykatës së Drejtësisë, iu zgjerua juridiksioni në lidhje me çështjet paragjykimore*, që kanë të bëjnë me vlefshmërinë dhe interpretimin e akteve të Komunitetit.

Po ashtu, në bazë të Traktatit të Amsterdimit, Gjykata e Drejtësisë, mori, për herë të parë, një numër kompetencash që kanë të bëjnë me *bashkëpunimin më të ngushtë, ndërmjet Shteteve dhe bashkëpunimin policor dhe gjyqësor në çështjet penale*. Megjithatë, kësaj Gjykate, nuk iu njoh juridiksioni që të vendosë, në lidhje me masat e marra nga Këshilli dhe që kanë të bëjnë me ruajtjen e rendit publik dhe sigurinë e brendshme.

Një nga aktet më të rëndësishme që ka sjellë ndryshime të mëdha në organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, i cili, është edhe ndryshimi i fundit në kuadrin e evoluimit historik të kësaj gjykate, është *Traktati i Nisës, i cili hyri në fuqi më 1 shkurt të vitit 2003*. Ndryshimet e bëra nga ky Traktat, përsa i përket Gjykatës së Drejtësisë, mund të përmbledhen si më poshtë:

- ndryshimin e juridiksionit dhe statusin e Gjykatës së Shkallës së Parë, e cila, nuk konsiderohet më si pjesë përbërëse e Gjykatës së Drejtësisë, por, ka një status të pavarur, por gjithmonë, brenda institucionit të Gjykatës së Drejtësisë;

- përfshirjen e dispozitave që i lejojnë mundësinë Këshillit, që me unanimitet të krijojë Panele Gjyqësore, të cilat i bashkëngjiten Gjykatës së Shkallës së Parë, sot Gjykata e Përgjithshme;

- parashikimin e dispozitave për t'i dhënë juridiksion Gjykatës së Drejtësisë, për të zgjidhur mosmarrëveshjet, në lidhje me zbatimin e akteve të miratuara, të cilat krijojnë të drejtat e pronësisë industriale të Komunitetit;

- ndryshime në organizimin dhe organizimin e brendshëm të Gjykatës së Drejtësisë, ku, ndër të tjera veçojmë:

- Dhoma e Madhe përbëhet, sipas këtij Traktati nga 13 gjyqtarë, e cila ka kompetencë që të gjykojë çështjet më të rëndësishme, ndërsa gjykata e plotë, përbëhet nga 25 anëtarë, për shkak se ky ishte numri i Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian në kohën e miratimit të Traktatit të Nisës;

- zgjedhja e Presidentëve të Dhomave për pesë gjyqtarësh, për një periudhë 3 vjeçare dhe marrje pjesë e tyre në gjykimet e Dhomës së Madhe;

- Gjykata e Drejtësisë mund t'i marrë vendimet edhe pa mendimin e Avokatit të Përgjithshëm, kur ato nuk ngrejnë çështje të reja ligjore.¹²

Nisur nga sa u trajtua më lart, në lidhje me evoluimin historik të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, konstatojmë se, që nga krijimi i saj më datë 18 prill të vitit 1951, me emrin Gjykata e Drejtësisë dhe deri në ditët tona, kjo Gjykatë, ka pësuar një ndryshim të vazhdueshëm, si përsa i përket organizimit dhe funksionimit të saj, ashtu edhe përsa i përket juridiksionit të saj. Sot Gjykata Evropiane e Drejtësisë, është e organizuar dhe funksionon në tre organe të ndryshme, të cilat, kanë secili prej tyre juridiksion të ndarë dhe të pavarur, nga njëri-tjetri. Këto organe janë:

a) *Gjykata e Drejtësisë*, e cila është organi më i lartë gjyqësor i Bashkimit Evropian dhe konsiderohet si “roja e Traktateve” dhe ka si funksion kryesor interpretimin e të drejtës evropiane ose *acquis communautaire*;

b) *Gjykata e Përgjithshme*, e cila ka si funksion kryesor shqyrtimin e padive që paraqesin personat fizikë ose juridikë privat, kundër akteve të institucioneve të Bashkimit Evropian dhe

c) *Gjykatat e specializuara*, ku, përfshihet *Gjykata e Shërbimit Civil*, e cila shqyrtton paditë që rrjedhin nga mardhëniet e punës, ndërmjet nënpunësve publike dhe institucioneve të Bashkimit Evropian.

1.3. Parimet bazë të veprimtarisë së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, ku përfshihen të tre organet përbërëse, Gjykata e Drejtësisë, Gjykata e Përgjithshme (ish Gjykata e Shkallës së Parë) dhe Gjykata e Shërbimit Civil, gjatë veprimtarisë së saj, ka përcaktuar disa rregulla të përgjithshme, të cilat zbatohen nga ajo, në të gjitha rastet e gjykimit çështjeve. Këto rregulla të përgjithshme, të cilat janë konsideruar nga ana ime si “Parime bazë të veprimtarisë së Gjykatës”, janë të parashikuara, si në dispozitat e Traktateve

¹² Shih për më tepër: Celami, E; “*Gjykata Evropiane e Drejtësisë. Juridiksioni. Efekti i vendimeve të saj në gjykatat e shteteve anëtare. Raporti i saj me GJEDNJ*”, Shkolla e Magjstraturës, viti 2006, faqe 3-4.

Themeluese, ashtu edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, të cilat ajo i ka sanksionuar përgjatë ushtrimit të funksioneve të saj.

Këto parime burojnë nga nenin 2 i Traktatit të Bashkimit Evropian, në të cilat janë parashikuar *vlerat themelore*, ku bazohet ky Bashkim dhe të cilat janë të përbashkëta, për të gjitha Shtetet Anëtare. Kjo dispozitë përcakton se: “*Bashkimi ka në themel vlerat e respektimit të dinjitetit të njeriut, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës, dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat që i përkasin pakicave. Këto vlera janë të përbashkëta për shtetet anëtare në një shoqëri ku mbisundon pluralizmi, mosdiskriminim, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia midis grave dhe burrave*”.¹³

Duke u nisur nga përmbajtja e kësaj dipsozite, konstohet se, *vlerat themelore, të cilat janë të përbashkëta për të gjitha shtetet anëtare dhe mbi të cilat bazohet Bashkimi Evropian, janë si më poshtë:*

- *respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut*, e cila përbën edhe vlerën kryesore të Bashkimit Evropian, mbi bazën e të cilës, vetë Bashkimi, institucionet e tij, si dhe Shtetet Anëtare, gjatë veprimtarisë së tyre, duhet që, në çdo rast, të mos shkelin të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe duhet të marrin veprime konkrete aktive, për realizimin e tyre nga çdo qytetar i Bashkimit;

- *respektimi i parimit të lirisë*, e cila, përbën një nga të drejtat më themelore të njeriut dhe në bazë të të cilës çdo person është i lirë, që të vendosë vetë për fatin e tij, si dhe të bëjë çdo zgjedhje që ai dëshiron, gjithmonë, pa dëmtuar interesat e ligjshme të tretëve, në përputhje me normën morale: “*liria ime mbaron, aty ky fillon liria e tjetrit*”;

- *respektimi i parimit të demokracisë*, i cili, nënkupton që pushteti shtetëror, tek çdo Shtet Anëtar dhe vetë Bashkimi Evropian, buron nga zgjedhje të lira, demokratike, të barabarta dhe periodike, në bazë të parimit që pushteti shtetëror, buron nga populli, i përket popullit dhe ushtrohet për popullin;

- *respektimi i parimit të barazisë*, sipas të cilit, të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit dhe duhet të trajtohen në mënyrë të njëjtë nga shteti, për situata të njëjta ose të ngjashme;

- *respektimi i parimit të shtetit të së drejtës*, i cili, nënkupton se, si qytetarët ashtu edhe organet shtetërore si dhe vetë Shteti, gjatë veprimtarisë së tyre, duhet të sillen në përputhje me ligjin dhe të drejtën dhe se, asnjë person ose organ shtetëror, nuk qëndron mbi ligjin dhe të drejtën;

- *respektimi i të drejtave të pakicave*, në bazë të të cilit, qytetarët që i përkasin pakicave të ndryshme, kombëtare, etnike, fetare, gjuhësore, etj, në një Shtet të caktuar, por dhe brenda Bashkimit Evropian, kanë të njëjtat të drejta si dhe qytetarët e shumicës, si dhe qytetarët e pakicave, kanë të drejtë që të ushtrojnë lirisht gjuhën, fenë apo të shprehin hapur kombësinë, mendimet dhe idetë e tyre;

- *sundimi i pluralizimit*, mbi bazën e të cilit, në çdo Shtet Anëtar por, edhe në vetë Bashkimin Evropian, duhet të ekzistojnë parti të ndryshme politike, të cilat formojnë vullnetin politik të qeverisjes, mbi bazën e të cilit, qytetarët duhet të kenë të drejtën e zgjedhjes, në çdo rast, ndërmjet dy ose më shumë alternativave qeverisëse;

- *sundimi i mosdiskriminimit*, i cili, nënkupton se, asnjë shtetas nuk mund të diskriminohet nga Shteti, në qoftë se, nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive;

¹³ Shih për më tepër: Nenin 2 të Traktatit të Bashkimit Evropian, version i konsoliduar.

- *sundimi i tolerancës*, që do të thotë se, çdo mosmarrëveshje apo konflikt që mund të ekzistojë ndërmjet shtetasve të ndryshëm, apo ndërmjet tyre dhe Shteteve Anëtare apo ndërmjet Shteteve Anëtare dhe ndërmjet tyre dhe institucionet të Bashkimit Evropian, duhet të trajtohet me anë të bisedimeve, respektit dhe mirëkuptimit;

- *sundimi i drejtësisë*, i cili nënkupton se, të gjithë qytetarët evropianë, Shtetet Anëtare, institucionet e Bashkimit Evropian, si dhe vetë Bashkimi Evropian, duhet që të veprojnë në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian ose *acquis communautaire*;

- *sundimi i solidaritetit*, në bazë të të cilit, raportet ndërmjet çdo Shteti Anëtar, ndërmjet Shteteve Anëtare dhe Bashkimit Evropian, si dhe ndërmjet qytetarëve të Bashkimit Evropian dhe Shteteve Anëtare, duhet të funksionojnë, në bazë të ndihmës dhe mbështetjes reciproke, që ato duhet t'i japin njëri-tjetrit;

- *sundimi i barazisë ndërmjet grave dhe burrave*, i cili nënkupton që, brenda Bashkimit Evropian, nuk lejohet asnjë lloj diskriminimi për shkak të gjinisë, në çdo fushë të jetës, si në fushën politike, ekonomike, sociale, të karrierës, profesionit, etj. Bazuar në këto Vlera Themelore të Bashkimit Evropian, si dhe bazuar në të gjithë të drejtën e Bashkimit Evropian, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, ka sanksionuar disa parime të veprimtarisë së saj, të cilat janë:

a) Parimi i ligjshmërisë

Ky parim përbën parimin më të rëndësishëm, mbi të cilin është e bazuar e gjithë veprimtaria e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Parimi i ligjshmërisë, është i lidhur me vetë funksionin që ka kjo Gjykatë, si një nga institucionet e Bashkimit, funksion ky i përcaktuar në nenin 19 të Traktatit të Bashkimit Evropian. Në këtë dispozitë është parashikuar, në mënyrë të shprehur se, *Gjykata Evropiane e Drejtësisë garanton respektimin e ligjit në interpretimin dhe zbatimin e Traktateve*.

Parimi i ligjshmërisë, duhet parë në dy aspekte kryesore:

Së pari: Si një detyrim për të gjithë Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, për të gjithë qytetarët e këtij Bashkimi, si dhe për vetë institucionet e Bashkimit Evropian që të sillen dhe veprojnë, në përputhje me normat juridike evropiane ose të së drejtës së Bashkimit Evropian;

Së dyti: Si një detyrim edhe për vetë Gjykatën Evropiane të Drejtësisë, e cila, kur shqyrton dhe gjykon mosmarrëveshjet që janë brenda juridiksionit të saj, t'i bazojë vendimet e marra, në normat juridike evropiane dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Duke u nisur nga fakti se, parimi i ligjshmërisë, zbatohet nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë në çdo rast, trajtimi më i plotë i këtij parimi, do të bëhet nga ana ime, kur do të trajtohet çdo çështje që është në kompetencë të kësaj Gjykate. Në këtë pjesë të punimit, e rëndësishme është të theksohet fakti, se, ky parim, përbën parimin bazë të veprimtarisë së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, parim i cili, jo vetëm që është i sanksionuar nga vendimet e dhëna prej saj, por, është i shprehur edhe në dispozita të veçanta të Traktateve Kushtetuese.

b) Parimi i delegimit të kompetencave

Ky parim përbën një ndër parimet e tjera themelore ku, e bazon veprimtarinë e saj Gjykata Evropiane e Drejtësisë. Parimi i mësipërm është i lidhur me vetë natyrën juridike të Bashkimit Evropian, si subjekt i së drejtës dhe për këtë arsye, duhet që të merret parasysh nga Gjykata gjatë veprimtarisë së saj.

Në lidhje me këtë fakt, duhet theksuar se, për të sqaruar natyrën juridike të Bashkimit Evropian, nuk është një çështje e lehtë dhe do të duheshin shumë faqe, gjë që nuk është objekt i kësaj teme. Megjithatë, në lidhje me natyrën juridike të tij, duhet thënë se, ai nuk përbën një shtet federativ, në kuptimin e plotë të fjalës. Përkundrazi, nga mënyrë sesi është organizuar dhe funksionon, Bashkimi Evropian, është një organizatë ndërkombëtare, me elementë të një shteti federal, sidomos kur flitet për fushën ekonomike dhe monetare.

Një nga aspektet ku duket më qartë karakteri i tij si organizatë ndërkombëtare, është *parimi i delegimit të kompetencave*. Ky parim është përcaktuar, në mënyrë të shprehur, në pikën 1 të nenin 5 të Traktatit të Bashkimit Evropian, në të cilën thuhet: *“Kufijtë e kompetencave të Bashkimit rregullohen përmes parimit të delegimit”*.¹⁴

Parimi i delegimit të kompetencave është shumë i rëndësishëm dhe duhet të merret në çdo rast, në konsideratë nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë, sepse, pikërisht në bazë të këtij parimi, përcaktohet edhe juridiksioni ose fusha e veprimtarisë së saj, ashtu si edhe për të gjitha institucionet e tjera të Bashkimit Evropian. Çdo vendim që merr kjo Gjykatë, duhet të merret brenda kufirit të kompetencave që i janë deleguar asaj nga ana e Traktateve Kushtetuese dhe brenda fushës së veprimtarisë së saj, në të kundërt, vendimi i saj nuk ka vlerë dhe nuk është i detyrueshëm.

Duke qenë se, parimi i delegimit të kompetencave paraqet një rëndësi shumë të madhe, vetë Traktatet Themeluese, e kanë përcaktuar kuptimin e këtij parimi. Traktati i Bashkimit Evropian, përcakton se, *sipas parimit të delegimit, Bashkimi Evropian vepron vetëm brenda kufijve të kompetencave që i kanë deleguar atij Shtetet Anëtare, përmes Traktateve dhe vetëm për arritjen e objektivave të parashikuara nga Traktatet, ndërsa, kompetencat që Traktatet nuk ia ka dhënë Bashkimit, u mbeten Shteteve Anëtare.*

Në bazë të parimit të delegimit të kompetencave, duke iu referuar Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, dallojmë tre kategori kompetencash të Bashkimit Evropian:

- i. kompetenca ekskluzive;
- ii. kompetenca të përbashkëta
- iii. kompetenca të ndara.

*i. Me kompetenca ekskluzive kuptojmë ato fusha apo çështje, në të cilat vetëm Bashkimi Evropian ka të drejtë që të nxjerrë akte juridike me fuqi detyruese të përgjithshme, ndërsa, Shtetet Anëtare mund ta bëjnë një gjë të tillë, vetëm nëse një të drejtë të tillë ua jep Bashkimi Evropian ose për zbatimin e akteve që nxjerrë ai.*¹⁵

Sipas Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, kompetencat ekskluzive të Bashkimit përfshijnë fushat e mëposhtme:

- bashkimin doganor;
- vendosja e rregullave të konkurrencës që nevojiten për funksionimin e tregut të brendshëm të Bashkimit Evropian;

¹⁴ Shih për më tepër nenin 5 të Traktatit të Bashkimit Evropian.

¹⁵ Pika 1 e nenit 2 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Kur Traktatet i japin Bashkimit kompetencë ekskluzive në një fushë të caktuar, vetëm Bashkimi mund të miratojë legjislacion dhe akte me fuqi detyruese, ndërsa Shtetet Anëtare mund ta bëjnë një gjë të tillë vetëm nëse këtë të drejtë ua jep Bashkimi ose për zbatimin e akteve të Bashkimit”.

- politika monetare për Shtetet Anëtare, monedha e të cilës është Euro;
- ruajtja e burimeve biologjike detare, në kuadër të politikës së përbashkët për peshkimin;

- politika e përbashkët tregtare.¹⁶

Përveç fushave të mësipërme, Bashkimi Evropian ka kompetenca ekskluzive edhe për lidhjen e një marrëveshjeje ndërkombëtare, me një ose disa shtete jashtë Bashkimit Evropian ose me një ose disa organizata të tjera ndërkombëtare, në rast se, plotësohen një ose disa nga këto kushte:

- lidhja e marrëveshjes ndërkombëtare parashikohet në një akt legjislativ i Bashkimit Evropian ose

- lidhja e marrëveshjes ndërkombëtare është e nevojshme, për t'i dhënë mundësi Bashkimit Evropian që të ushtrojë kompetencat e tij të brendshme ose

- lidhja e marrëveshjes ndërkombëtare mund të prekë ose të ndryshojë normat e brendshme të Bashkimit.¹⁷

ii. *Me kompetenca të përbashkëta kuptojmë ato fusha apo çështje, për të cilat akte juridike me fuqi detyruese, kanë të drejtë që të nxjerrin si Bashkimi Evropian ashtu edhe Shtetet Anëtare, por, që aktet juridike nxirren nga Shtetet Anëtare, vetëm në masën që Bashkimi nuk i ka nxjerrë këto akte ose në rastet kur ai nuk i ushtron kompetencat e tij.* Si kompetenca të përbashkëta, mund të konsiderohen edhe ato fusha ku Bashkimi Evropian ka kompetencë për të kryer veprime të caktuara me qëllim mbështetjen, bashkërendimin dhe plotësimin e veprimeve të Shteteve Anëtare.

Sipas Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, Bashkimi mund të kryejë veprime mbështetëse, koordinuese dhe plotësuese me Shtetet Anëtare, në një ose disa nga këto fusha:

- mbrojtja dhe përmirësimi i shëndetit të njeriut;
- industria;
- kultura;
- turizmi;
- arsimi, formimi profesional, rinia dhe sporti;
- mbrojtja civile;
- bashkëpunimi administrativ.¹⁸

iii. *Me kompetenca të ndara, kuptojmë atë fusha apo çështje, ku, akte juridike me fuqi detyruese, mund të nxjerrin si Shtetet Anëtare, ashtu edhe Bashkimi Evropian, por, nxjerrja e tyre bëhet e ndarë, në përputhje me të drejtën që i është dhënë secilit prej tyre, në Traktatet Kushtetuese për Bashkimin Evropian dhe në rendin juridik të brendshëm të secilit Shtet Anëtar, për Shtetet Anëtare.* Sipas Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, kompetenca e ndarë, ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shteteve Anëtare, zbatohet në fushat e mëposhtme:

- tregu i brendshëm;
- politika sociale për aspektet e përcaktuara në Traktatet Themeluese;
- kohezioni ekonomik, social dhe territorial;

¹⁶ Shih për më tepër: Pikën 1 të nenit 3 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian.

¹⁷ Pika 2 e nenit 3 e Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Bashkimi ka gjithashtu kompetencë ekskluzive për lidhjen e një marrëveshjeje ndërkombëtare, kur lidhja e saj parashikohet në një akt legjislativ të Bashkimit ose nevojitet për t'i dhënë mundësi Bashkimit që të ushtrojë kompetencën e tij të brendshme ose për atë që lidhja e saj mund të prekë normat e brendshme ose mund të ndryshojë objektin e tyre

¹⁸ Shih për më tepër: Nenin 6 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian.

• bujqësia dhe peshkimi, pa përfshirë ruajtjen e burimeve biologjike detare, e cila është kompetencë ekskluzive e Bashkimit;

- mjedisi;
- mbrojtja e konsumatorit;
- transporti;
- rrjetet Trans-Evropiane;
- energjitika;
- zona e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë;
- shqetësimet e përbashkëta për sigurinë në çështjet e shëndetit publik.¹⁹

Bazuar në parimin e delegimit të kompetencave Gjykata Evropiane e Drejtësisë, ka juridiksion dhe mund të vendosë vetëm për çështje, të cilat përfshijnë kompetencat ekskluzive të Bashkimit Evropian, kompetencat e përbashkëta dhe kompetencat e ndara, por, në rastin e kompetencave të ndara, vetëm për ato fusha, ku Traktatet Themeluese i njohin të drejtë Bashkimit që të nxjerrë norma juridike me fuqi detyruese. Ndërsa, për kompetencat e ndara, të cilat sipas Traktateve Themeluese dhe të drejtës së brendshme të Shteteve Anëtare, të drejtën për të nxjerrë norma juridike detyruese, e kanë vetëm Shtetet Anëtare, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, nuk ka juridiksion dhe kompetencë për të vendosur në lidhje me këto fusha, por, një të drejtë të tillë e kanë gjykatat e brendshme të shteteve anëtare.

c) Parimi i proporcionalitetit

Ky përbën një tjetër parim të rëndësishëm, mbi të cilin e bazon veprimtarinë e saj Gjykata Evropiane e Drejtësisë. Për vetë rëndësinë që paraqet ky parim është parashikuar, në mënyrë të shprehur, në Traktatet Themeluese, ku është përcaktuar se, *çdo akt dhe veprim i Bashkimit Evropian dhe institucioneve të tij, nuk duhet të tejkalojë kufijtë që janë të nevojshëm për arritjen e objektivave të Bashkimit*. Pra, në bazë të parimit të proporcionalitetit, duhet të ketë një përputhje, ndërmjet mjeteve që përdoren për arritjen e qëllimeve të caktuara dhe vetë këtyre qëllimeve që duhet të arrihen.²⁰

Parimi i proporcionalitetit nënkupton se, çdo veprim i vetë Bashkimit Evropian, si dhe i institucioneve të tij, si përsa i përket formës ose përmbajtjes, duhet të merret brenda kufijve që janë të nevojshëm për arritjen e objektivave, për të cilat ndërmerret ai veprim. Në këtë rast, paraqet rëndësi, jo vetëm përmbajtja e veprimit, me anë të të cilit mund të çënohen të drejtat e subjekteve të caktuar, por edhe forma e tij, sepse, në disa raste, të drejtat mund të çënohen, jo vetëm nga përmbajtja e veprimit por, edhe nga forma e tij.

Parimi i proporcionalitetit paraqet specifika të veçanta në zbatimin e tij dhe për këtë arsye nuk ekziston një rregull i përgjithshëm që të përcaktojë, nëse është respektuar apo jo ky parim. Verifikimi i faktit të zbatimit të këtij parimi, bëhet nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë, rast pas rasti, në varësi të çështjes konkrete.

Duke u nisur nga specifikat që paraqet ky parim, është parashikuar një Protokoll i veçantë për zbatimin e tij, ku, në vetë Traktatet Kushtetuese është përcaktuar se, institucionet e Bashkimit Evropian e zbatojnë parimin e proporcionalitetit, siç parashikohet në Protokollin për zbatimin e parimeve të

¹⁹ Shih për më tepër: Pikën 2 të nenit 4 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian.

²⁰ Pika 4 e nenit 5 të Traktatit të Bashkimit Evropian parashikon:

“Sipas parimit të proporcionalitetit, përmbajtja dhe forma e veprimit të Bashkimit nuk duhet të tejkalojë kufijtë e asaj që është e nevojshme për arritjen e objektivave të Traktateve”.

subsidiaritetit dhe të proporcionalitetit. Në bazë të këtij Protokolli, të gjitha projektaktet legjislative, duhet të arsyetohen, nëse, janë në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe subsidiaritetit. Për këtë qëllim, çdo projekt-akt duhet të përmbajë një *Deklaratë* të hollësishme, që mundëson vlerësimin e përputhshmërisë me këto parime.

Ky Protokoll, po ashtu përcakton se, Deklarata e mësipërme duhet të përmbajë vlerësime edhe në lidhje me efektet financiare të propozimit, si dhe në rastin e një Direktive, duhet të përmbajë rrethimet e saj, lidhur me miratimin e normave juridike nga ana e Shteteve Anëtare, duke përfshirë kur është e nevojshme edhe legjislacionin rajonal. *Në përputhje dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit, arsyetimi që të çon në përfundimin se, një objektiv i caktuar mund të arrihet më mirë, me një akt legjislativ të Bashkimit Evropian, sesa me legjislacionin e Shteteve Anëtare, duhet të mbështet në tregues cilësor dhe sasiorë. Po ashtu, projektaktet legjislative duhet që të marrin parasysh, nevojën për të minimizuar dhe mbajtur në përpjestim me objektivin, çdo barrë financiare ose administrative, që bie, qoftë mbi Bashkimin Evropian, qoftë mbi Shtetet Anëtare, qoftë mbi autoritetet rajonale e vendore, qoftë mbi operatorët ekonomike, si dhe qoftë mbi qytetarët e Bashkimit Evropian.*²¹

Parimi i proporcionalitetit, si një nga parimet bazë mbi të cilin bazohet veprimtaria e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në rastet kur ajo shqyrton çështje që përfshihen në juridiksionin e saj, përveç se është parashikuar në Traktatet Kushtetuese dhe në një Protokoll të veçantë, është sanksionuar edhe në praktikën gjyqësore të saj, në vendimet që ajo ka marrë për shqyrtimin e çështjeve konkrete. Nga këto vendime vlen të përmendim *çështjen nr. 114/76 Bela-Muhle vs Groës Farm (1997) ECR 1211*, ku, kjo Gjykatë në lidhje me këtë parim, ndër të tjera ka arsyetuar: “...Duhet të jetë e sigurtë nëse mjetet që përdoren janë të përshtatshme për qëllimin e arritjes së objektivit të dëshiruar dhe nëse ato nuk shkojnë përtej asaj që është e nevojshme për të arritur atë. Për më tej, ...nëse një masë është haptazi e papërshtatshme për objektin që institucioni kompetent kërkon të ndjekë, kjo mund të prekë ligjshmërinë e saj....”²²

ç) Parimi i subsidiaritetit.

Një tjetër parim i rëndësishëm që duhet të marrë parasysh Gjykata Evropiane e Drejtësisë gjatë veprimtarisë së saj, është parimi i subsidiaritetit. Kuptimi i këtij parimi është dhënë në vetë Traktatet Kushtetuese, sipas të cilëve, *në bazë të parimit të subsidiaritetit në qoftë se, një çështje nuk hyn në fushën ekskluzive të Bashkimit Evropian, ky i fundit vepron vetëm nëse objektivat e veprimit të propozuar, nuk mund të arrihen njaftueshëm nga Shtetet Anëtare ose kur këto objektiva mund të arrihen më*

²¹ Neni 5 i Protokollit (nr. 2) “Për zbatimin e parimeve të subsidiaritetit dhe të proporcionalitetit”, parashikon: “Projektaktet legjislative duhet të arsyetohen kundrejt parimeve të subsidiaritetit dhe të proporcionalitetit. Çdo projektakt legjislativ duhet të përmbajë një Deklaratë të hollësishme që mundëson vlerësimin e përputhshmërisë me parimet e subsidiaritetit dhe proporcionalitetit. Kjo Deklaratë duhet të përmbajë disa vlerësime mbi efektet financiare të propozimit dhe, në rastin e një Direktive, Deklarata duhet të përmbajë rrethimet e saj, lidhur me miratimin e normave nga Shtetet Anëtare, duke përfshirë, kur është e nevojshme, legjislacionin rajonal. Arsyetimi që të çon në përfundimin se, një objektiv i Bashkimit mund të arrihet më mirë në nivel të Bashkimit, duhet të mbështet në tregues cilësor, dhe kur është e mundur edhe në tregues sasiorë. Projektaktet legjislative duhet të marrin parasysh nevojën për të minimizuar dhe mbajtur në përpjestim me objektivin çdo barrë, qoftë financiare apo administrative, që bie mbi Bashkimin, qeveritë kombetare, autoritetet rajonale e vendore, apo operatorët ekonomik dhe qytetarëve”.

²² Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen çështjen nr. 114/76 Bela-Muhle kundër Grous Farm (1997) ECR 1211.

*mirë, në nivelin e Bashkimit Evropian, duke marrë në konsideratë shkallën apo pasojat e veprimit të propozuar.*²³

Duke iu referuar kuptimit që Traktati i Bashkimit Evropian i ka dhënë parimit të subsidiaritetit, konstatohet se, në mënyrë që të zbatohet ky parim, duhet të plotësohen disa kushte:

Së pari: nuk duhet që çështja konkrete të bëjë pjesë në fushën ekskluzive të Bashkimit Evropian, pasi në qoftë se, një çështje e caktuar hyn në fushën ekskluzive të Bashkimit, nuk zbatohet ky parim, pasi çështja, rregullohet, plotësisht me akte legislative të Bashkimit Evropian, duke u përjashtuar aktet ligjore të Shteteve Anëtare, në nivel qendror ose vendor;

Së dyti: Bashkimi Evropian vepron me një veprim konkret, vetëm në qoftë se, objektivat e veprimit të propozuar, nuk mund të arrihen mjaftueshëm me veprimet e Shteteve Anëtare;

Së treti: Bashkimi vepron, vetëm në qoftë se, objektivat e veprimit të propozuar, mund të arrihen më mirë në nivelin e Bashkimit Evropian, sesa në nivelin e Shteteve Anëtare, duke marrë në konsideratë shkallën apo pasojat e veprimit të propozuar.

Parimi i subsidiaritetit, nënkupton një bashkëpunim të detyrueshëm, ndërmjet institucioneve të Bashkimit Evropian dhe Shteteve Anëtare të tij, në rastet kur Bashkimi Evropian, do të nxjerrë akte të ndryshme ligjore që përfshihen në zbatimin e këtij parimi. Mënyra e zbatimit të Parimit të Subsidiaritetit është përcaktuar në një Protokoll të veçantë, i cili është përmendur nga ana ime më lart dhe që është konkretisht, Protokoll (nr. 2) *“Për zbatimin e parimeve të subsidiaritetit dhe të proporcionalitetit”*.

Sipas këtij Protokoll, përpara propozimit dhe ndryshimit të akteve legislative, Komisioni duhet të konsultohet gjerësisht, si dhe duhet t’ua dërgojë propozimin parlamenteve kombëtare të Shteteve Anëtare, në të njëjtën kohë që ia kalon edhe Parlamentit Evropian. Po ashtu edhe Parlamenti Evropian dhe Këshilli, duhet që t’ua dërgojnë parlamenteve kombëtare projektaktet e tyre legislative dhe ndryshimet e tyre.

Çdo parlament kombëtar, brenda tetë javëve nga data e dërgimit të një projektakti legjislativ, mund t’i dërgojë Presidentit të Parlamentit Evropian, Presidentit të Këshillit dhe Komisionit, një mendim të arsyetuar, në të cilin shprehen arsyet se pse, projektakti në fjalë, nuk është në përputhje me parimin e subsidiaritetit. Nëse projektakti legjislativ, është propozuar nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë, nga Banka Qendrore Evropiane dhe nga Banka Evropiane e Investimeve, Presidenti i Këshillit, ua dërgon mendimin e arsyetuar të parlamenteve kombëtare edhe këtyre institucioneve.

Parlamenti Evropian, Këshilli dhe Komisioni, duhet që të marrin parasysh mendimet e arsyetuara të dhëna nga parlamentet kombëtare. Në qoftë se, mendimet e arsyetuara të parlamenteve kombëtare, ku, çdo parlament kombëtar përfaqësohet me 2 vota, mbi mos përputhjen e një akti legjislativ të Bashkimit Evropian, me Parimin e Subsidiaritetit, përfaqësojnë të paktën një të tretën e të gjithë votave që u janë caktuar parlamenteve kombëtare, atëherë, projektakti legjislativ rrëzohet, pra, nuk

²³ Pika 3 e Traktatit të Bashkimit Evropian parashikon:

“Sipas parimit të subsidiaritetit, për fushat që nuk bien në kompetencën ekskluzive të tij, Bashkimi vepron vetëm nëse dhe për atë që objektivat e veprimit të propozuar nuk mund të arrihen mjaftueshëm nga Shtetet Anëtare në nivel qendror ose në nivel rajonal dhe vendor, por mund të arrihen më mirë në nivel Bashkimi duke pasur parasysh shkallën apo efektin e veprimit të propozuar”.

mund të miratohet nga Parlamenti Evropian. Kufiri minimal i cili rrëzon një akt legjislativ të Bashkimit Evropian, është një e katërta e votave të parlamenteve kombëtare, në qoftë se, projektakti bën fjalë për fushat e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Zbatimi i parimit të subsidiaritetit nga ana e institucioneve të Bashkimit Evropian, në rastin e nxjerrjes së akteve legjislative, paraqet një rëndësi të madhe. Kjo për faktin se, në qoftë se, nga ana e tyre, nuk është zbatuar parimi i subsidiaritetit, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, ka të drejtë që ta shfuqizojë këtë akt legjislativ për mos respektim të procedurës së nxjerrjes së tij dhe për pasojë akti të mbesë pa vlerë juridike.²⁴

d) Parimi i mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Ky është një nga parimet më të rëndësishme, mbi të cilën e bazon veprimtarinë e saj Gjykata Evropiane e Drejtësisë. Ky parim gjendet i shprehur që në nenin 2 të Traktatit të Bashkimit Evropian, i cili përcakton se, *Bashkimi ka në themel të tij respektimin e dinjetit të njeriut dhe të të drejtave dhe lirive themelore*. Po ashtu, edhe në pikën 5 të nenit 3 të këtij Traktati, është përcaktuar se, Bashkimi Evropian, në mardhënie me Shtetet e tjera jo Anëtare dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, mbron dhe nxit respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, sidomos të të drejtave të fëmijëve.

Mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të njeriut, është një parim që ka udhëhequr Bashkimin Evropian, që në fillimet e krijimit të tij, kur ai ishte i ndarë në tre organizata ndërkombëtare. Madje, duhet thënë se, një nga arsyet kryesore që ka shtyrë Shtetet Anëtare për krijimin e tij, përveç sigurimit të paqes dhe bashkëpunimit ndërmjet tyre, ka qenë edhe njohja dhe garantimi i të drejtave dhe lirive themelore.

Por, në kuadër të Bashkimit Evropian, parimi i respektimit të të drejtave të njeriut, u ngrit në një nivel kushtetues, me miratimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, në 7 dhjetor 2000, e cila është përshtatur në Strasburg, me 12 dhjetor 2007. Në këtë akt ndërkombëtar, me vlerë për të gjitha Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, individi, pra, njeriu si qenie sociale, vendoset në qendër të veprimtarisë së tij, si dhe sanksionohet detyrimi i shteteve për njohjen dhe garantimin e të drejtave të individit.

Rëndësia e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, përveç përmbajtjes së saj, qëndron edhe në faktin se, Traktatet Kushtetuese të Bashkimit i kanë dhënë asaj, të njëjtën fuqi ligjore siç kanë edhe ato vetë. Po ashtu, në këto Traktate është përcaktuar, detyrimi që ka Bashkimi Evropian për të respektuar të drejtat e njeriut, ashtu siç ato janë parashikuar në Kartën Themelore.²⁵

Një vlerë akoma më të madhe i jep parimit të respektimit të të drejtave të njeriut, në kuadër të Bashkimit Evropian, fakti i anëtarësimit të Bashkimit, në

²⁴ Paragrafi i parë i nenit 8 të Protokollit (nr. 2) "Për zbatimin e parimeve të subsidiaritetit dhe të proporcionalitetit", parashikon:

"Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian ka juridiksion për paditë me objekt shkeljen e parimit të subsidiaritetit nëpërmjet një akti legjislativ, të cilat janë paraqitur nga shtetet anëtare në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 263 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian ose të cilat janë bërë të ditura sipas rendit të tyre juridik, në emër të parlamentit të tyre kombëtar ose të një dhome të tij"

²⁵ Neni 6, pika 1 e Traktatit të Bashkimit Evropian parashikon:

"Bashkimi njeh të drejtat, liritë dhe parimet e parashikuara në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, datë 7 dhjetor 2000, siç u përshtat në Strasburg, me datë 12 dhjetor 2007, e cila ka të njëjtën fuqi ligjore me Traktatet".

Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, nënshkruar në Romë më 4 nëntor 1950 dhe hyrë në fuqi, me datë 3 shtator 1953. Kjo Konventë, e cila është nënshkruar në kuadër të një organizate tjetër ndërkombëtare evropiane, që është Këshilli i Evropës, është akti i parë ndërkombëtar evropian, ku, janë shpallur, në mënyrë solemne, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe ku është parashikuar detyrimi i Shteteve Anëtare që, të respektojnë të drejtat e njeriut, për çdo person që ndodhet në juridiksionin e tyre.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka një vlerë dalluese nga të gjitha aktet e tjera ndërkombëtare që trajtojnë çështjen e të drejtave dhe lirive themelore, sepse, kjo Konventë, për herë të parë, në ndryshim nga të gjitha aktet e tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, ka parashikuar një organ të posaçëm, që është Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila ka për mision, mbrojtjen e këtyre të drejtave nga çdo cënim që mund të bëjnë Shtetet Anëtare ose organet e tyre. Në bazë të kësaj Konvente dhe Protokolleve Shtesë të saj, të cilat janë pjesë e Konventës, çdo shtetas i një shteti që ka nënshkruar Konventën, ka të drejtë që t'i drejtohet Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pasi të ketë shteruar mjetet e brendshme të ankimit, për cënimin e të drejtave dhe lirive themelore që parashikohen nga Konventa, nga Shteti përkatës ose organet e tij.

Vendimi që merr Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në rastet kur, ajo konstaton se një Shtet Anëtar i Konventës ka cënuar një nga të drejtat dhe liritë që parashikohen në Konventë, është i detyrueshëm për zbatim nga organet e brendshme të Shteteve Anëtare. Gjatë veprimtarisë së saj kjo Gjykatë, ka marrë disa vendime edhe ndaj Shqipërisë, e cila e ka nënshkruar këtë Konventë, në vitin 1996, ku, në vendimet e saj, Shqipëria është ndëshkuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, mbi bazën e paraqitjes së ankimit nga ana e personave fizikë dhe juridikë shqiptarë për cënimin e të drejtave dhe lirive themelore të ndryshme, si e drejta e pronës, e drejta lirisë dhe sigurisë, parimi i prezumimit të pafajsisë, etj.

Anëtarësimi që Bashkimi Evropian ka bërë në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, do të thotë se, anëtarë të kësaj Konvente, aktualisht, janë jo vetëm shtetet evropiane, rreth 50 të tillë, por edhe një organizatë ndërkombëtare siç është Bashkimi Evropian. Në të njëjtën kohë, anëtarësimi që Bashkimi Evropian ka bërë në këtë Konventë, i jep të drejtën çdo qytetari të Bashkimit Evropian që, si qytetar i Bashkimit, t'i drejtohet Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, pasi të ketë shteruar mjetet e brendshme juridike brenda Bashkimit, për shkeljen ose cënimin e të drejtave dhe lirive themelore të tij, nga ana e Bashkimit Evropian dhe institucioneve të tij.

Duke e parë çështjen e zbatimit të parimit të të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, brenda Bashkimit Evropian në aspektin historik, mund të thuhet se, para miratimit të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, në vitin 2000, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në fillimet e veprimtarisë së saj, ka hezituuar për të shfuqizuar një akt të Komunitetit Evropian, në rastet kur pretendohet se, ai cënonte të drejtat dhe liritë themelore. Një hezitim i tillë i Gjykatës vinte, jo vetëm për faktin se, në atë kohë mungonte një Kartë e të Drejtave Themelore, e cila, aktualisht ekziston, por, edhe për fatkin se, Traktatet Kushtetuese, nuk ia njihnin, në mënyrë të shprehur, të drejtën Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, që të rishikonte një akt të Komunitetit, i cili, shkelte të drejtat e njeriut.

Megjithatë, pavarësisht nga fakti se, në atë kohë mungonte një Kartë Themelore e të Drejtave të Njeriut, si dhe pavarësisht se Traktatet Themeluese nuk ia njihnin, në mënyrë të shprehur, Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, të drejtën që të

shfuqizonte një akt të Komunitetit që cënonte të drejtat e njeriut, Gjykata, duke interpretuar frymën e përgjithshme të Traktateve Kushtetuese, i konsideroi të drejtat e njeriut si një parim të përgjithshëm të së drejtës komunitare. Një gjë të tillë kjo Gjykatë e bëri për herë të parë në një çështje paragjykimore, të ngritur nga një gjyqtar gjerman, e njohur si çështja *Stauder vs Ulm*.

Në këtë çështje, Gjykata Evropiane e Drejtësisë u shpreh se, “të drejtat themelore janë të mëshiruara në parimet e përgjithshme të së drejtës komunitare dhe për pasojë janë të mbrojtura nga gjykata”.²⁶ Në një çështje tjetër të njohur si çështja *Nold vs European Commission*, kjo Gjykatë avancoi më tej, duke pranuar influencën e traktateve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, duke u shprehur, ndër të tjera se: “...Siç është shprehur më parë Gjykata, të drejtat themelore formojnë një pjesë integrale të parimeve të përgjithshme të së drejtës, respektimin e të cilës ajo siguron. Në ruajtjen e këtyre të drejtave, Gjykata bazohet tek frymëzimi i traditave të përbashkëta të Shteteve Anëtare dhe nuk mund të mbështesë në këtë mënyrë, masa që janë të papajtueshme me të drejtat themelore të njohura dhe të mbrojtura nga Kushtetutat e këtyre Shteteve.

Në mënyrë të ngjashme edhe instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, tek të cilat Shtetet Anëtare, kanë marrë pjesë ose kanë aderuar, mund të sigurojnë udhëzime, të cilat duhet të ndiqen brenda kuadrit të së drejtës komunitare. ...”²⁷

e) Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit.

Parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, pa shkaqe objektive, është tjetër parimi i rëndësishëm që gjen zbatim në veprimtarinë e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Ky parim ka qenë i sanksionuar që në Traktatet e para Themeluese dhe është i parashikuar edhe aktualisht në Traktatin për Bashkimin Evropian dhe në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian. Kështu, konkretisht, në Traktatin e Komunitetit Evropian parashikohej se, Këshilli, duke vepruar me unanimitet, mbi bazën e propozimeve të Komisionit Evropian dhe pas këshillimeve me Parlamentin Evropian, ka të drejtë që të ndërmarrë veprime konkrete të cilat kanë si qëllim parandalimin dhe shmangien e çdo diskriminimi, i cili, është i bazuar në racën, seksin, etninë, moshën, fenë, orientimin seksual dhe gjendjen shëndetësore.²⁸

Po ashtu, Traktati i Komunitetit Evropian, parashikonte një numër dispozitash me anë të të cilave, ndalohej diskriminimi në fusha të ndryshme, si:

- ndalohej diskriminimi mbi baza shtetësie, e cila parashikohej në nenin 12 të këtij Traktati;
- ndalohej diskriminimi ndërmjet prodhuesve dhe konsumatorëve, sipas nenit 34 të këtij Traktati;

²⁶ Shih për më tepër: Vendmin nr. 26/69, (1960), ECR 423, të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen *Stauder kundër Ulm*.

²⁷ Shih për më tepër: Vendmin nr. 4/73, (1974), ECR 491, të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen *Nold kundër Komisionit Evropian*.

²⁸ Neni 13 i Traktatit të Komunitetit Evropian, parashikonte:

“Pa paragjykuar dispozitat e tjera të këtij Traktati dhe brenda kufijve të kompetencave që i janë dhënë nga ky Komitet, Këshilli, duke vepruar me unanimitet mbi bazën e një propozimi nga Komisioni dhe pas këshillimit me Parlamentin, mund të marrë veprime të përshtatshme për të luftuar diskriminimin mbi bazë seksi, origjine raciale ose etnike, feje ose besimi, aftësive të kufizuara, moshe ose orientimi seksual”.

• vendoset barazia në shpërblimin e punës ose pagës, ndërjet burrave dhe grave, duke u ndaluar diskriminimi mbi bazë seksi, sipas nenit 141 të tij.

Aktualisht, parimi i barazisë dhe të mos diskriminimit e gjejmë më disa dispozita të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, ku një theks i veçantë i jepet çështjes së barazisë, ndërmjet burrit dhe gruas. Kështu, në nenin 8 të tij, është përcaktuar se, Bashkimi Evropian në të gjitha aktivitetet e tij, ka si qëllim eliminimin e pabarazive dhe nxitjen e barazisë ndërmjet burrave dhe grave. Po ashtu, në një dispozitë të veçantë të këtij Traktati, është përcaktuar se, gjatë gjithë veprimtarisë së tij dhe në të gjitha fushat, Bashkimi Evropian, ka si qëllim që të luftojë diskriminimin, i cili mund të jetë i bazuar në seks, racë, origjinë etnike, fe, moshë, orientim seksual apo gjendje shendetësore.²⁹

Një vëmendje e veçantë i kushtohet ndalimit të diskriminimit mbi baza shtetësie, duke qenë se, Bashkimi Evropian, aktualisht përbëhet nga 28 shtete, pra, nga qytetarë të 28 shtetësisë të ndryshme. Për këtë qëllim në Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, është parashikuar në mënyrë të shprehur se, ndalohet çdo lloj diskriminimi për shkak të shtetësisë, duke i dhënë të drejtë Parlamentit Evropian dhe Këshillit që të marrin çdo masë të nevojshme me qëllim ndalimin e këtij diskriminimi.

Përsa i përket parimit të mosdiskriminimit, ky Traktat, ashtu si edhe Traktati i Komunitetit Evropian, ka parashikuar një dispozitë të përgjithshme, me anë të të cilës i jep të drejtë Këshillit që të marrë masat e nevojshme për luftuar çdo lloj diskriminimi. Konkretisht, në nenin 19 të këtij Traktati, parashikon se, Këshilli duke vendosur me unanimitet, sipas një procedure të posaçme legjislative dhe pasi merr pëlqimin e Parlamentit Evropian, mund të marrë masat e nevojshme për të luftuar diskriminimin për shkak të gjinisë, racës, etnisë, fesë, aftësive të kufizuara, moshës ose orientimit seksual.

Përveç parashikimit në Traktatet Themeluese, parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit është elaboruar edhe nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë në jurisprudencën ose në vendimet e saj. Kështu në një vendim të saj të vitit 1978, në çështjen *Royal Scholten-Honing kundër IBAP*, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, është shprehur se, parimi i barazisë është një nga parimet e përgjithshme të së drejtës komunitare. Ky parim sipas kësaj gjykate, kërkon që situata të ngjashme nuk duhet të trajtohen në mënyra të ndryshme, përveç kur trajtimi i ndryshëm është objektivisht i justifikueshëm.³⁰

Në një çështje tjetër, konkretisht, në çështjen *Ueiser vs Caise Nationale des Barreaux Français*, kjo Gjykatë i dha një kuptim akoma më të gjerë parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit. Në këtë çështje ajo u shpreh, ndër të tjera se, parimi i barazisë së trajtimit përbën një të drejtë themelore të njeriut, e cila është e detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë autoritetet e Komunitetit.³¹

f) Parimi i sigurisë juridike.

²⁹ Neni 10 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, parashikon:

“Gjatë vendosjes dhe zbatimit të politikave të veta, Bashkimi ka si qëllim luftën kundër diskriminimit për shkak të gjinisë, racës ose origjinës etnike, fesë ose besimit, aftësive të kufizuara, moshës ose orientimit seksual”.

³⁰ Shih për më tepër: Vendmin nr. 145/77, (1978) ECR 2027 të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen *Royal Scholten-Honing kundër IBAP*.

³¹ Shih për më tepër: Vendmin nr. 37/89, (1990) ECR 2395 të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen *Ueiser kundër Caise Nationale des Barreaux Français*

Siguria juridike përbën një nga elementët më të rëndësishëm të shtetit të së drejtës. Ajo është pjesë përbërëse e parimit të ligjshmërisë dhe paraqet një rëndësi shumë të madhe, pasi moszbatimi i sigurisë juridike, çënon nga themelet, parimet e shtetit të së drejtës, të demokracisë dhe të lirisë. Parimi i sigurisë juridike, është në të njëjtën kohë, një nga parimet bazë, ku Gjykata Evropiane e Drejtësisë e bazon veprimtarinë e saj.

Ky parim përbëhet nga disa elementë kryesore:

i. që normat juridike me fuqi detyruese të përgjithshme, duhet që të nxirren vetëm nga një organ i përcaktuar, që zakonisht është organi legjislativ;

ii. që normat juridike funksionojnë mbi bazën e parimit të hierarkisë, ku normat e nivelet më të ulët duhet të jenë në përputhje me përmbajtjen dhe qëllimin e normave të nivelit më të lartë, në të kundërt ato janë të pavlefshme;

iii. që normat juridike duhet të jenë të qarta dhe të sakta;

iv. që normat juridike me fuqi detyruese të përgjithshme, nuk duhet të ndryshojnë në mënyrë të shpeshtë dhe pa arsye, pra, duhet të krijojnë parashikueshmëri dhe siguri tek qytetarët;

v. që normat juridike nuk duhet të kenë fuqi prapavepruese.

Secili nga këto pesë elementë të parimit të sigurisë juridike, mund të përbënte një çështje më vete për t'u trajtuar, por, kjo nuk do të bëhet nga ana ime, sepse del jashtë qëllimit të kësaj teme. Këtu në këtë çështje, unë do të ndalemi në trajtimin, shumë të shkurtër, të secilit për tyre, duke i parë ato në kuadër të së drejtës evropiane. *Elementi i parë i parimit të sigurisë juridike, kërkon që normat juridike me fuqi detyruese të përgjithshme, të nxirren nga një organ i përcaktuar, që zakonisht është organi legjislativ.* Duke iu referuar Traktateve Kushtetuese, konkretisht, Traktatit për Bashkimin Evropian dhe Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, rezulton se, norma juridike me fuqi detyruese të përgjithshme, ka të drejtë që të nxjerrë, vetëm Parlamenti Evropian dhe Këshilli, të cilat janë dy institucione të Bashkimit, të cilët së bashku, ushtrojnë pushtetin legjislativ të Bashkimit Evropian.³² Në bazë të parimit të sigurisë juridike, vetëm Parlamenti Evropian dhe/ose Këshilli, kanë të drejtë që të nxjerrin norma juridike, me fuqi detyruese të përgjithshme dhe asnjë institucion tjetër i Bashkimit, nuk e ka një të drejtë të tillë dhe në qoftë se, ato veprojnë ndryshe, pra, institucionet e tjera të Bashkimit, nxjerrin norma detyruese të përgjithshme, ato nuk kanë asnjë vlerë, pasi nxjerrja e tyre vjen në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike.

Elementi i dytë i parimit të sigurisë juridike, është hierarkia e normave, sipas të cilit normat e nivelit më të ulët, duhet të nxirren nga dhe në bazë të normave të nivelit më të lartë dhe duhet të jenë në përputhje me përmbajtjen dhe qëllimin e tyre. Ky element i sigurisë juridike rezulton më i qartë, në rendin juridik të brendshëm të Shteteve Anëtare, ku, Kushtetuta e vendit, përbën ligjin më të lartë dhe të gjitha normat e tjera juridike, duhet të dalin nga dhe në bazë të Kushtetutës, si dhe duhet të jenë në përputhje, me përmbajtjen dhe qëllimin e saj.

Por, parimi i hierarkisë së normave juridike, si pjesë e parimit të sigurisë juridike, gjen zbatim edhe në rendin juridik të Bashkimit Evropian. Sipas këtij parimi, të gjitha normat e tjera juridike që dalin nga institucionet e ndryshme të Bashkimit, duhet të jenë në përputhje me përmbajtjen dhe qëllimin e normave juridike që nxjerrin Parlamenti Evropian dhe Këshilli, të cilat janë normat juridike me fuqi detyruese më

³² Pika 1 e nenit 14 të Traktatit për Bashkimin Evropian parashikon:

“Parlamenti Evropian ushtron bashkarisht me Këshillin funksione legjislative dhe buxhetore”.

të larta, në kuadër të Bashkimit. Ky parim i hierarkisë së normave në të drejtën evropiane, gjen zbatim edhe në një aspekt tjetër, sipas të cilit, të gjitha aktet që nxjerrin Parlamenti Evropian dhe Këshilli, si dhe institucionet e tjera të Bashkimit, duhet të jenë në përputhje me përmbajtjen dhe qëllimet e Traktateve Kushtetuese të Bashkimit Evropian, të cilat përbëjnë “Kushtetutën” e Bashkimit Evropian.

Duke e përmbledhur atë që thamë më sipër, në lidhje me hierarkinë e normave juridike si pjesë e parimit të sigurisë juridike, në kuadër të së drejtës evropiane, mund të themi se, në Bashkimin Evropian, veprojnë këto norma juridike me fuqi detyruese të përgjithshme dhe sipas kësaj hierarkie:

1. Traktatet Kushtetuese të Bashkimit Evropian, që aktualisht janë, Traktati për Bashkimin Evropian dhe Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, si dhe Traktati Evropian i Energjisë Atimike dhe që përbëjnë normat juridike më të larta në kuadër të Bashkimit;

2. Normat juridike që nxjerrin Parlamenti Evropian dhe Këshilli, të cilat dalin në bazë dhe për zbatim të Traktateve Themeluese, si dhe duhet të jenë në përputhje me përmbajtjen dhe qëllimin e Traktatave Themeluese;

3. Normat juridike që nxjerrin organet e specializuara dhe institucionet e ndryshme të Bashkimit Evropian, të cilat duhet të dalin në bazë të autorizimit që i ka dhënë Parlamenti Evropian ose Këshilli dhe duhet të jenë në përputhje me përmbajtjen dhe qëllimet si të normave juridike të nxjerra nga Parlamenti dhe Këshilli, ashtu edhe me përmbajtjen dhe qëllimin e Traktateve Themeluese.

Elementi i tretë i parimit të sigurisë juridike kërkon që, normat juridike të jenë të qarta dhe të sakta.

Ky element nënkupton se, çdo normë juridike me fuqi detyruese të përgjithshme, duke qenë se, iu drejtohet qytetareve të zakonshëm, ajo duhet që të jetë e tillë që, të kuptohet nga një qytetar që ka një zhvillim intelektual mesatar. Në qoftë se, një normë juridike është e paqartë, apo është e errët dhe lën hapësirë për interpretime të ndryshme, atëherë, kjo vjen në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe për pasojë mund të kundërshtohet, si pa fuqi ligjore, në kuadër të parimit të sigurisë juridike.

Elementi i katërt i parimit të sigurisë juridike është parashikueshmëria e normave juridike.

Kjo do të thotë se, ligjvënësi, nuk ka të drejtë që të bëjë një ndryshim të shpeshtë dhe pa arsye, të normave juridike. Një ndryshim i tillë do të krijonte një konfuzion dhe paqartësi tek qytetarët, se cila normë juridike është në fuqi dhe për pasojë, cilën normë janë të detyruar që të zbatojnë. Ky element i sigurisë juridike shtrihet më me forcë, sidomos në ligjet financiare dhe tatimore, të cilat në praktikë, ndryshohen edhe më shpesh, ku ligjvënësi duhet të ketë parasysh, në këtë rast, se çdo ndryshim i shpeshtë dhe i pamotivuar i këtyre ligjeve, vjen në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike.

Ky element i parimit të sigurisë juridike është trajtuar edhe nga Gjykata Evropiane në çështjen Komisioni Evropian kundër Francës, ku ajo është shprehur ndër të tjera se, “siguria dhe parashikueshmëria juridike janë kërkesa që duhet të respektohen, në mënyrë strikte, në çështjet e normave juridike që sjellin pasojë financiare”.³³

³³ Shih për më tepër: Vendmin nr. 30/89, (1990) ECR 691 të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen Komisioni Evropian kundër Francës.

Elementi i fundit i parimit të sigurisë juridike ka të bëjë me, mos pasjen fuqi prapavepruese të normave juridike.

Normat juridike që vendosin rregulla të detyrueshme me karakter të përgjithshëm dhe që iu drejtohen një numri të pakufizuar personash, si rregull, kanë fuqi juridike, vetëm që nga momenti i miratimit të tyre dhe për të ardhmen, pra, efekti juridik i normave juridike, është për fakte dhe ngjarje juridike që, ndodhin pas miratimit dhe hyrjes së tyre në fuqi, efekt që njihet me emrin *ex nunc*.

Ky përcaktim sipas të cilit normat juridike veprojnë vetëm për të ardhmen, përbën parimin e mospasjes fuqi prapavepruese të tyre, si një element i parimit të sigurisë juridike.

Çështja e mos pasjes fuqi prapavepruese të normave juridike, është një problem shumë i mprehtë, sidomos në fushën penale, ku, në mënyrë kategorike, është e ndaluar që ligji penal të ketë fuqi prapavepruese, me përjashtim të rasteve kur ai është në favor të të pandehurit. Mospasja fuqi prapavepruese e normave juridike, përbën një problem më rëndësi edhe në rastet e ligjeve financiare dhe tatimore, të cilat në çdo rast, duhet të veprojnë për të ardhmen.

Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, një normë juridike mund të ketë fuqi prapavepruese, ose efekte *ex tung*, në qoftë se, ndodhemi para njëres prej këtyre situatave:

- kur ndodhemi para një ligji me natyrë konfirmuese, e cila është në ato raste kur, ligji miratohet me qëllim që të rregullojë me norma juridike, një situatë që ishte e paligjshme deri në atë kohë;

- kur ndodhemi para një ligji interpretues, e cila është në rastet kur, miratimi i ligjit bëhet me qëllim që të zgjidhë mosmarrëveshjet, lidhur me anët e errëta dhe të paqarta të një ligji të mëparshëm;

- kur jemi para një ligji penal, i cili mund të ketë fuqi prapavepruese, vetëm kur ai shfuqizon një vepër penale të caktuar ose parashikon një dënim më të butë;

- kur jemi para një ligji me natyrë procedurale, qoftë procedurale civile ose penale, i cili, zbatohet edhe për rastet e lindura para hyrjes së tij në fuqi.³⁴

³⁴ Shih për më tepër: Nuni, A, "E drejta Civile, Pjesa e Përgjithshme", Tiranë 2012, faqe 34.

KAPITULLI I DYTË

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I GJYKATËS EVROPIANE TË DREJTËSISË

2.1. Përbërja e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe statusi i gjyqtarëve të saj.

Më sipër kur kemi folur për Gjykatën Evropiane të Drejtësisë, si organi gjyqësor i Bashkimit Evropian, kemi sqaruar se, ajo përbëhet nga tre organe të ndryshme, Gjykatën e Drejtësisë, Gjykatën e Përgjithshme dhe Gjykatën e Shërbimit Civil, si gjykatë e specializuar. Në këtë çështje, kur do të flasim për Gjykatën Evropiane të Drejtësisë, do të kemi parasysh vetëm njërin organ të saj dhe konkretisht, Gjykatën e Drejtësisë, i cili është edhe organi kryesor i saj dhe nënkupton këtë institucion, sa herë që flitet për organin gjyqësor të Bashkimit Evropian.

Në Traktatet Themeluese është përcaktuar se, *Gjykata e Drejtësisë përbëhet nga një gjyqtar për çdo Shtet Anëtar*.³⁵ Për pasojë, duke qenë se, aktualisht Bashkimi Evropian, me pranimin së fundmi edhe të Kroacisë në këtë organizatë, përbëhet nga 28 anëtarë, edhe Gjykata e Drejtësisë, përbëhet nga 28 anëtarë.

Përgjatë procesit të evoluimit të Bashkimit Evropian edhe përbërja e Gjykatës së Drejtësisë ka pësuar ndryshime, në varësi të ndryshimeve që pësonte vetë kjo organizatë ndërkombëtare. Kështu, në fillimet e saj, në Komunitetin Ekonomik Evropian të përbërë nga 6 anëtarë, Gjykata e Drejtësisë përbëhej nga 7 anëtarë, nga një gjyqtar për çdo Shtet, ndërsa, gjyqtari i shtatë, zgjidhej me rotacion, ndërmjet shteteve të mëdha Gjermanisë, Francës dhe Italisë. Me zgjerimin e mëtejshëm të Komunitetit Evropian, në 12 anëtarë, Gjykata e Drejtësisë përbëhej nga 13 anëtarë, nga një gjyqtar për çdo Shtet Anëtar, ndërsa gjyqtari i trembëdhjetë zgjidhej me rotacion, ndërmjet 5 shteteve të mëdha, Gjermanisë, Francës, Spanjës, Britanisë së Madhe dhe Italisë.

Në vitin 1995, me zgjerimin tjetër të Bashkimit Evropian, numri i Shteteve Anëtare të të cilit shkoi në 15, Gjykata e Drejtësisë përbëhej nga 15 anëtarë, nga një gjyqtar për çdo Shtet Anëtar. Në këtë periudhë u bënë përpjekje që numri i anëtarëve të Gjykatës së Drejtësisë, të mbetej, në çdo rast, të mbetej 15 anëtarë, pavarësisht nga zgjerimet e mëvonshme që mund t'i ndodhnin Komunitetit Evropian dhe pavarësisht nga numri i Shteteve Anëtare që ai mund të kishte në të ardhmen.

Megjithatë, këto përpjekje për ta mbajtur numrin e anëtarëve të Gjykatës së Drejtësisë në 15, pavarësisht nga numri i Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, nuk rezultuan të suksesshme, për shkak të presionit të Shteteve Anëtare, të cilët kërkonin që të kishin, detyrimisht, përfaqësuesin e tyre në Gjykatën e Drejtësisë. Në këto kushte, me Traktatin e Nisës, u vendos, përfundimisht, që Gjykata e Drejtësisë do të përbëhej, në çdo rast, nga një gjyqtar për çdo Shtet Anëtar, çka do të thotë se, me shtimin e Bashkimit Evropian, me një ose disa Shtete Anëtare të rinj edhe Gjykata e Drejtësisë do të shtohet, po ashtu me anëtarë të rinj, fakt i cili u konfirmua me pranimin së

³⁵ Pika 2 e nenit 19 të Traktatit për Bashkimin Evropian parashikon:

“2. Gjykata e Drejtësisë përbëhet nga një gjyqtar nga secili Shtet Anëtar. Ajo mbështetet nga Avokatët e Përgjithshëm”.

fundmi të Kroacisë në Bashkimin Evropian, ku, numri i Shteteve Anëtare shkoi nga 27 në 28 anëtarë dhe numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Drejtësisë shkoi nga 27, në 28 Gjyqtarë.

Përveç Gjyqtarëve, të cilat janë funksionarë publikë të ngarkuar nga ligji për dhënien e drejtësisë në kuadër të Bashkimin Evropian, një vend të rëndësishëm në Gjykatën e Drejtësisë zënë edhe *Avokatët e Përgjithshëm*. Në Traktetet Themeluese është përcaktuar se, *Avokatët e Përgjithshëm kanë si detyrë që të mbështesin Gjykatën e Drejtësisë gjatë ushtrimit të funksioneve të saj*. Aktualisht, numri i Avokatëve të Përgjithshëm është nëntë, por, është parashikuar mundësia që ky numër të rritet, me kërkesë të Gjykatës së Drejtësisë dhe me vendim të Këshillit Evropian.³⁶

Avokatët e Përgjithshëm përbëjnë një organ “sui generis” ose të llojit të veçantë, brenda organizimit të përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë, i cili, nuk gjendet në asnjë prej organeve gjyqësore, qoftë të Shteteve Anëtare, qoftë edhe të homologëve të tjerë, në të drejtën ndërkombëtare. Se cili është roli i Avokatëve të Përgjithshëm në organizimin e brendshëm të Gjykatës së Drejtësisë, kjo është e përcaktuar qartë në Traktetet Themeluese. Ato kanë si detyrë që të mbështesin Gjykatën e Drejtësisë dhe ku më tej, në Traktate është përcaktuar edhe roli konkret i tyre. Por, cila ka qenë arsyeja pse është parashikuar ky organ i veçantë, si dhe ku është marrë modeli për parashikimin e tij, një gjë e tillë nuk rezulton e shprehur në Traktetet Themeluese dhe as në ndonjë normë tjetër juridike të Bashkimit Evropian.

Avokatët e Përgjithshëm, si një organ i pavarur dhe i paanshëm, nuk marrin pjesë në çdo çështje që shqyrtohet nga ana e Gjykatës së Drejtësisë, por, vetëm në ato çështje, në të cilat sipas Statutit të kësaj Gjykate, kërkohet pjesëmarrja e tyre në gjykim. Në çështjet në të cilat ato marrin pjesë, *Avokatët e Përgjithshëm, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, paraqesin parashtrimet e tyre të arsyetuara, me shkrim, në seancë gjyqësore publike*.³⁷

Duhet theksuar se, parashtrimet me shkrim që paraqesin Avokatët e Përgjithshëm, nuk janë të detyrueshme për Gjykatën e Drejtësisë, ato, mund të merren ose jo parasysh nga ana e gjyqtarëve të çështjes, në varësi të bindjes së tyre të brendshme dhe provave të shqyrtuara. Megjithatë, kjo nuk e zbeh aspak rolin që kanë Avokatët e Përgjithshëm në kuadër të gjykimit të mosmarrëveshjeve nga ana e Gjykatës së Drejtësisë. Kjo jo vetëm për faktin se, mendimet e tyre me shkrim, kanë vlerën e tyre në zgjidhjen e çështjes konkrete, pasi ato janë paraqitur nga persona të pavarur dhe të paanshëm si dhe të kualifikuar, me njohuri të posaçme në fushën e ligjit, e posaçërisht të së drejtës ndërkombëtare, por edhe për faktin tjetër se, praktika e Gjykatës së Drejtësisë ka treguar se, opinionet ose mendimet e Avokatëve të Përgjithshëm, janë marrë parasysh nga kjo Gjykatë, në një masë të madhe, në rreth 60-70% të çështjeve të shqyrtuara.

Për t'i dhënë përgjigje pyetjes se cila ishte arsyeja e përfshirjes së Avokatëve të Përgjithshëm, si një organ i veçantë “sui generis”, që nuk gjendet në asnjë prej organeve të tjera gjyqësore kombëtare dhe ndërkombëtare, do të na duhet të kthehemi

³⁶ Paragrafi i parë i nenit 252 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Gjykata e Drejtësisë mbështetet nga nëntë Avokatë të Përgjithshëm. Këshilli, me unanimitet, mund ta rrisë numrin e Avokatëve të Përgjithshëm, nëse këtë e kërkon Gjykata e Drejtësisë”.

³⁷ Paragrafi i dytë i nenit 252 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Avokati i Përgjithshëm ka për detyrë që, me paanshmëri dhe pavarësi të plotë, të bëjë parashtrime të arsyetuara në seancë të hapur gjyqësore, për çështje të cilat, sipas Statutit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, kërkohet përfshirjen e tij”.

tek origjina e krijimit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Ashtu siç është sqaruar kur kemi trajtuar evoluimin historik të kësaj Gjykate, *ky institucion, në momentet e para të krijimit të tij, ishte parashikuar me një nivel të vetëm, pra, si shkallë e parë dhe e fundit e gjyqimit*. Kjo do të thotë se, vendimet e Gjykatës së Drejtësisë, që gjykonin çdo lloj çështje, pavarisist nga natyra, objekti apo rëndësia e saj, ishin të formës së prerë dhe ndaj tyre nuk lejohej ankimi, kjo për faktin se, në Traktatet Themeluese, nuk ishte parashikuar një institucion tjetër gjyqësor, tek i cili, mund të paraqitej ankimi, kundër vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë.

Avokatët e Përgjithshëm u përfshinë si një organ i veçantë për të mbështetur Gjykatën e Drejtësisë, pikërisht me qëllimin e vendosjes së një ekuilibri, ndërmjet gjykimeve me një nivel të procesve gjyqësore, në të cilat mungonin procedurat e apelit dhe nevojës së palëve për të patur të drejtë ankimi ndaj vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë. Në këtë mënyrë, Avokatët e Përgjithshëm, në çështjet ku ata marrin pjesë dhe që sigurisht janë edhe çështjet më të rëndësishme, me opinionet e tyre të specializuara, të pavarura dhe të paanshme, shtrojnë para Gjykatës çështje dhe probleme të cilat ajo duhet t'i marrë parasysh, të cilat janë të atilla, që po të ekzistojë një gjykatë apeli, do të merren parasysh nga ana e gjykatës së apelit.

Kështu, disa nga çështjet që shtrohen për diskutim nga ana e Avokatëve të Përgjithshëm, në mendimet apo opinionet e tyre të pavarura, janë në radhë të parë çështje të procedurës së rregullt ligjore që duhet të ndjekë Gjykata e Drejtësisë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, çështje që kanë të bëjnë me kompetencën e gjykatës, me legjitimitimin e palëve, me zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm etj.

Po ashtu, përse i përket themelit të çështjes, *detyra e Avokatëve të Përgjithshëm është që të paraqesin opinione me shkrim para Gjykatës, në formën e propozimeve jo të detyrueshme për zgjidhjen e çështjes, opinione këto të bazuara në një studim, tërësisht të pavarur dhe jo politik të çështjeve ligjore të ngritura për shqyrtim.* Opinionet e Avokatëve të Përgjithshëm janë pjesë e pavarur e procedurës së zhvillohet para Gjykatës së Drejtësisë dhe botohen në Raportet e Gjykatës, së bashku me vendimet përfundimtare. Me anë të opinioneve të tyre, Avokatët e Përgjithshëm, vetëm mund të ndikojnë tek vendimi përfundimtar i Gjykatës me anë të forcës së argumenteve, por, ato nuk kanë fuqi vendim marrëse, pasi nuk përfshihen në diskutime dhe as nuk marrin pjesë në votim, në marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e Gjykatës së Drejtësisë.³⁸

Një tjetër arsye se pse, janë parashikuar Avokatët e Përgjithshëm si një organ që mbështet Gjykatën e Drejtësisë, mund të themi që, është fakti se, *në opinionet e tyre, ata ngrajnë çështje të së drejtës së Bashkimit Evropian.* Në këtë drejtim, vlera e këtyre opinioneve qëndron në garancinë që çështje të së drejtës komunitare të njihen dhe të diskutohen nga ana e Gjykatës së Drejtësisë, para se, ajo të marrë vendimin përfundimtar. Kjo sepse, ekziston mundësia që, në disa raste, edhe pse në çështjet konkrete, mund të ketë probleme që i përkasin të drejtës së Bashkimit, palët të mos i grejnë këto çështje gjatë argumenteve të tyre, boshllëk i cili plotësohet nga ana e Avokatëve të Përgjithshëm, të cilët kërkojnë që, në çdo rast, kur ato ekzistojnë, çështjet e së drejtës komunitare të përfshihen në gjykim.³⁹

³⁸ Shih për më tepër: Borhardt, K, D, "ABC-ja e së Drejtës së Bashkimit Evropian", botim i Ministrisë së Integrimit të Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2010.

³⁹ Shih për më tepër: Celami, E; "Gjykata Evropiane e Drejtësisë. Juridiksioni. Efekti i vendimeve të saj në gjykatat e shteteve anëtare. Raporti i saj me GJEDNJ", Shkolla e Magjstraturës, viti 2006, faqe 12.

Nga sa u tha më sipër, mund të konkludojmë se, një nga arsyet se, pse janë parashikuar Avokatët e Përgjithshëm, si një organ mbështetës pranë Gjykatës së Drejtësisë, është uniformizimi i të drejtës së Bashkimit Evropian. Avokatët e Përgjithshëm, duke ngritur në opinionet e tyre të pavarura dhe të specializuara, çështje të së drejtës së Bashkimit Evropian, në mënyrë të natyrshme, kontribuojnë në uniformizimin kësaj të drejte ose “*acqius communitare*”, i cili, përbën realisht një nga kontributet më të vlerë dhe një nga arsyet me të qenësishme që legjitimon ekzistencën e tyre. Kjo për faktin se, zbatimi në mënyrë të njëjtë ose uniforme ose të barabartë të ligjit, në zgjidhjen e çështjen të njëjta ose të ngjashme, përbën një nga sfidat më të rëndësishme që ka çdo shoqëri, në kuadrin e organizimit të saj të brendshëm, në funksion të garantimit të parimit të barazisë para ligjit dhe të ekzistencës së shtetit të së drejtës, sfidë nga e cila, nuk mund të përjashtohet as Bashkimi Evropian, i cili, është nga ana e tij një organizëm i ndërmjetëm, i llojit të veçantë “*sui generis*”, midis shtetit dhe organizatës ndërkombëtare.

Duke u nisur nga struktura organizative që ka sot Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian, e cila, për shkak të evoluimit historik të saj, sot përbehet nga tre organizma të pavarur, Gjykata e Drejtësisë, Gjykata e Përgjithshme dhe Gjykata e Nëpunësve Civil, pra, aktualisht kemi një pushtet gjyqësor brenda Bashkimit, pothuajse me tre nivele gjykimi, e ngjashme me atë të Shteteve Anëtare, si dhe duke u nisur nga fakti se, arsyeja kryesore e parashikimit të Avokatëve të Përgjithshëm, ishte për të shmangur të metën që kishte Gjykata e Drejtësisë, në fillimet e saj, e cila ishte parashikuar si një organ gjyqësor me një nivel, mund të lindë pyetja, nëse është e nevojshme që Avokatët e Përgjithshëm të ekzistojnë si organe mbështetëse të Gjykatës së Drejtësisë, në të ardhmen?

Në lidhje me këtë pyetje, mendoj se, përgjigja është pozitive, po, Avokatët e Përgjithshëm janë të nevojshëm dhe duhet që të ekzistojnë si një organ mbështetës për Gjykatën e Drejtësisë edhe për të ardhmen. Shkaqet se, pse Avokatët e Përgjithshëm, janë të nevojshëm që të ekzistojnë si organ mbështetës i Gjykatës së Drejtësisë, edhe në të ardhmen, mund të përmbledhen si më poshtë:

Së pari: Traktatet Themeluese iu kanë siguruar Avokatëve të Përgjithshëm një status dhe pozitë të njëjtë me Gjyqtarët e Gjykatës së Drejtësisë, përse i përket mënyrës së emërimit dhe shkarkimit të tyre. Avokatët e Përgjithshëm, po ashtu si edhe Gjyqtarët, emërohen me marrëveshje ndërmjet Shteteve Anëtare, për një mandat gjashtë veçar dhe zgjidhen në mes personave për pavarësinë e të cilëve nuk ka dyshime, të cilët përmbushin kushtet e nevojshme për të mbajtur postet më të larta gjyqësore në vendet përkatëse. Duke i barazuar Avokatët e Përgjithshëm me Gjyqtarët, për nga statusi i tyre, Traktatet Themeluese kanë pasur si qëllim që, ata të jenë një organ i rëndësishëm brenda Gjykatës së Drejtësisë, dhe për këtë arsye, heqja e tyre, do të vinte në kundërshtim me qëllimin dhe vullnetin e ligjvënësit.

Së dyti: Pavarsisht nga fakti se, aktualisht, Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian, mund të konsiderohet se, përbëhet nga tre nivele, ku vendimet e Gjykatës së Shërbimit Civil, mund të ankimohen, për çështje të ligjit në Gjykatën e Përgjithshme dhe kundër vendimeve të saj, në raste të jashtëzakonshme, mund të bëhet ankim në Gjykatën e Drejtësisë, përsëri, ekzistenca e Avokatëve të Përgjithshëm është e nevojshme, për faktin se, në opinionet e tyre, ata ngrejnë çështje që kanë të bëjnë me procesin e rregullt ligjor dhe me respektimin e ligjit, çështje të cilat, për një arsye ose tjetër, mund të mos ngrihen nga palët në gjykim. Mosekzistenca e Avokatëve të Përgjithshëm, në këtë rast, do të çonte në zvarritje të pajustificuar në dhënien e drejtësisë, pasi vendimet e marra nga gjykatat më të ulta, duke mos respektuar

procesin e rregullt ligjor, do të prisheshin nga gjykatat më të larta dhe çështja do të kthehej edhe njëherë për rigjykim nga e para, çka do të vinte dyshime të forta, mbi efikasitetin dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë, brenda Bashkimit Evropian.

Së treti: Një arsye tjetër e rëndësishme që tregon nevojën për ekzistencën e Avokatëve të Përgjithshëm në të ardhmen, ka të bëjë me faktin se, përveç të tjerash, në opinionet e tyre, ata ngrejnë çështje të së drejtës së Bashkimit Evropian, që mund të mos jenë ngritur nga palët. Ngritja e këtyre çështjeve përbën një moment me rëndësi, për të gjithë rendin juridik të Bashkimit, pasi siç u tha më lart, zbatimi në mënyrë uniforme dhe padiskriminim i ligjit, përbën një nga elementët më të rëndësishëm të venies në jetë të parimit të madh të barazisë para ligjit dhe të shtetit të së drejtës.

Së katërti: Opinionet me shkrim të paraqitura nga Avokatët e Përgjithshëm, kanë një rëndësi të madhe, jo vetëm për Gjykatën që zgjidh çështjen, por, edhe për të drejtën komunitare, pasi faktet kanë treguar se, mbi 60% e tyre, janë marrë parasysh nga Gjykata në dhënien e vendimeve prej saj, si dhe për shkak të rëndësisë që ata paraqesin, vetë Traktatet Themeluese kanë parashikuar që opinionet e Avokatëve të Përgjithshëm, duhet të botohen në Buletinin e Gjykatës, së bashku me vendimet e saj. Më sipër u dhanë arsyet kryesore që kanë çuar në parashikimin e Avokatëve të Përgjithshëm si një organ mbështetës i Gjykatës së Drejtësisë, si dhe arsyet se, pse ky organ është i nevojshëm që të ekzistojë edhe në të ardhmen, tani do të sqaroj shkurtimisht se, cili ka qenë modeli nga ku është marrë ky organ, i cili ka për detyrë që të mbështesë në punën e saj, Gjykatën e Drejtësisë. Duke iu referuar sistemit ligjor francez, i cili është jo pak i njohur edhe nga juristët në Shqipëri, pasi vendi ynë, një pjesë të ligjeve i ka marrë nga sistemi ligjor francez, konstojmë se, *Avokati i Përgjithshëm, është një organ i ngjashëm me Komisararin e Qeverisë, i cili ekziston në Francë, pranë Këshillit të Shtetit dhe gjykatave administrative.* Megjithatë, ndërmjet Avokatit të Përgjithshëm, si organ pranë Gjykatës së Drejtësisë dhe Komisararit të Qeverisë, në sistemin ligjor francez, mund të konstatohet një dallim i rëndësishëm. Avokati i Përgjithshëm ka një pozitë më të dobët juridike se Komisari i Qeverisë, pasi Avokati i Përgjithshëm, nuk merr pjesë në Dhomën e Këshillimit, kur merret vendimi nga Gjykata, ndërsa, Komisari i Qeverisë, merr pjesë në Dhomën e Këshillimit, në marrjen e vendimit përfundimtar, edhe pse mendimi i tij nuk është detyrues, por, ka karakter këshillimor.

Përsa i përket statusit të Gjyqtarëve të Gjykatës së Drejtësisë, e cila, në këtë rast, përfshin edhe statusin e Avokatëve të Përgjithshëm, në përcaktimin e statusit të tyre, duhet të kemi parasysh disa elementë si, emërimi, kohëzgjatja në detyrë, patundshmëria nga detyra, paga dhe privilegjet. Për emërimin e Gjyqtarëve dhe Avokatëve të Përgjithshëm, Traktatet Themeluese parashikojnë si mënyrën e emërimit të tyre, ashtu edhe cilësitë që duhet që të ketë një person që të emërohet në një funksion të tillë. Konkretisht, në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian është përcaktuar që, *Gjyqtarët emërohen me miratimin e përbashkët të qeverive të Shteteve Anëtare, për një periudhë gjashtë vjeçare, me të drejtë riemërimi.*

Po ashtu, në këtë Traktat janë përcaktuar edhe cilësitë që duhet të gëzojë një person që të emërohet gjyqtar, ku, është parashikuar se, si gjyqtar mund të emërohen vetëm personat të cilët përmbushin kushtet e nevojshme për të mbajtur postet më të larta gjyqësore në vendet e tyre përkatëse ose që janë juristë me aftësi profesionale të shquara. Një tjetër kriter që duhet të plotësojë një person, që të emërohet gjyqtar në Gjykatën e Drejtësisë, është edhe pavarësia e tij ndaj pushtetit politik apo ndaj pushtetit shtetëror të Shteteve Anëtare ose për të përdorur gjuhën e Traktatit, si

gjyqtar mund të emërohen vetëm personat për pavarsinë e të cilëve, nuk mund të ketë dyshime.⁴⁰

Duke u nisur nga sa u trajtua më lart, konstatohet se, që një person të emërohet si gjyqtar ose Avokat i Përgjithshëm i Gjykatës së Drejtësisë, duhet të plotësojë dy kategori cilësish:

Së pari: Integritetin profesional, pasi si të tillë mund të emërohen vetëm personat të cilët përmbushin kushtet e nevojshme për të mbajtur postet më të larta gjyqësore në vendet e tyre përkatëse ose që janë juristë me aftësi profesionale të shquara dhe

Së dyti: Integritetin personal, në lidhje me pavarsinë e tyre, pasi si të tillë mund të emërohen vetëm personat për pavarsinë e të cilëve nuk mund të ketë dyshime.

Për mënyrën e emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës së Drejtësisë, po ashtu, konstatohet se, Shtetet Anëtare, nuk kanë pranuar që të heqin dorë nga Sovraniteti i tyre dhe t'ia delegojnë emërimin e tyre një institucioni të brendshëm të Bashkimit Evropian, siç mund të ishte Parlamenti apo Këshilli i Bashkimit Evropian, por, kanë parashikuar që emërimi i tyre, të bëhet me marrëveshje të përbashkët me qeveritë e Shteteve Anëtare, pra, në mënyrë të njëjtë, siç janë miratuar edhe Traktatet Themeluese. Mos cedimi i Sovranitetit nga ana e Shteteve Anëtare për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Drejtësisë, tregon për rëndësinë e madhe që kanë këto funksionarë publikë, si për Shtetet Anëtare, ashtu edhe për vetë Bashkimin Evropian. Po ashtu, ky mos cedim i kompetencës së emërimit nga ana e Shteteve Anëtare, institucioneve të brendshme të Bashkimit Evropian, shpreh edhe “frikën” ose mungesën e vullnetit të Shteteve Anëtare që të gjykohen nga “persona të jashtëm”, të cilët nuk janë emëruar prej tyre apo që këto Shtete, nuk kanë dhënë të paktën pëlqimin për emërimin e tyre.

Nga ana tjetër, duke u nisur nga fakti se, kompetenca e emërimit të gjyqtarëve nuk i është deleguar Bashkimit Evropian, me qëllim gjetjen e një ekuilibri, ndërmjet “xhelozisë dhe frikës” së Shteteve Anëtare për t’u gjykuar nga persona, të cilët nuk janë emëruar ose propozuar prej tyre dhe integritetit personal dhe profesional që duhet të kenë këta persona, para se të emërohen si gjyqtarë, në Traktatet Themeluese është parashikuar që, emërimi i tyre, duhet të bëhet pasi të jetë dhënë mendimi nga një Panel i përbërë nga profesionistë të shquar, në lidhje me plotësimin e kriterëve nga çdo kandidat. Ky Panel i përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët zgjidhen ndërmjet ish anëtarëve të Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme, si dhe ndërmjet anëtarëve të Gjykatave të Larta kombëtare, ku, njëri prej këtyre anëtarëve, propozohet nga ana e Parlamentit Evropian.

Në Traktatet Themeluese është përcaktuar se, anëtarët e Panelit emërohen nga ana e Këshillit të Bashkimit Evropian me vendim, i cili, po me anë të një vendim tjetër të veçantë, përcakton edhe rregullat e punës së Panelit. Paneli për shqyrtimin e kandidaturave për gjyqtarë dhe Avokat të Përgjithshëm, mbledhet me nismën e Kryetarit të Gjykatës së Drejtësisë dhe detyra e tij është që të japë mendim, nëse

⁴⁰ Pika 1 e nenit 253 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Gjyqtarët dhe Avokatët e Përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë zgjidhen mes personave për pavarsinë e të cilëve nuk ka dyshime, të cilët përmbushin kushtet e nevojshme për t’u emëruar në postet më të larta gjyqësore në vendet përkatëse të tyre ose janë juristë me aftësi profesionale të njohura. Ata emërohen me miratimin e përbashkët të qeverive të Shteteve Anëtare për një mandat gjashtë vjeçar, pasi konsultohen me panelin e parashikuar në nenin 255”.

kandidatura e paraqitur plotëson kriteret për t'u emëruar si Gjyqtar apo Avokat i Përgjithshëm.⁴¹

Në lidhje me mendimin që jepet nga ana e Panelit, shtrohet pyetja: Cila është natyra e këtij mendimi, a është ky detyrues për qeveritë e Shteteve Anëtare, apo ky mendim i Panelit është me karakter këshillues? Duke iu referuar përmbajtjes së nenit 255 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, vlerësoj se, mendimi i Panelit në lidhje me përshtatshmërinë e kandidatëve për kryerjen e detyrave të Gjyqtarit dhe të Avokatit të Përgjithshëm, është me natyrë këshilluese dhe jo detyruese për qeveritë e Shteteve Anëtare. Kjo do të thotë se, teorikisht, qeveria e një Shteti Anëtar, mund t'i propozojë qeverive të tjera të Shteteve Anëtare, emërimin e një personi si Gjyqtar ose Avokat i Përgjithshëm edhe pse Paneli ka dhënë mendim negativ, duke u shprehur që, kandidati përkatës, nuk i plotëson kriteret për kryerjen e detyrës së Gjyqtarit apo Avokatit të Përgjithshëm.

Por, fakti që mendimi i Panelit lidhur me përshtatshmërinë e kandidatëve për kryerjen e detyrës së Gjyqtarit apo Avokatit të Përgjithshëm, është me natyrë këshilluese, nuk do të thotë se, ky mendim nuk ka vlerë dhe nuk ka rëndësi. Përkundrazi, praktikisht, ky mendim paraqet një fazë paraprake, në gjithë procedurën e emërimit të Gjyqtarit ose të Avokatit të Përgjithshëm dhe kjo procedurë e emërimit, nuk ka vazhduar më tej, në qoftë se, Paneli ka dhënë mendim negativ në lidhje me cilësitë e kandidatit, pasi qeveria e Shtetit Anëtar, është tërhequr, duke propozuar një kandidat tjetër, edhe pse rastet të tilla, kanë ndodhur rrallë.

E lidhur ngushtë me çështjen e emërimit të Gjyqtarëve, është edhe momenti i fillimit të detyrës së detyrës, pas emërimit që ata marrin me marrëveshje, ndërmjet qeverive të Shteteve Anëtare, moment i cili, ka karakter ceremonial dhe publik, çka tregon për rëndësinë që paraqet funksioni i gjyqtarit, në kuadër të organizimit të institucioneve të Bashkimit Evropian. Sipas Statutit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, i cili, është pjesë përbërëse e Traktateve Themeluese, përpara fillimit të detyrës, çdo Gjyqtar betohet para Gjykatës së Drejtësisë, të mbledhur në seancë publike se do të kryejë detyrën, "në mënyrë të paanshme dhe parimore si dhe do të ruajë fshehtësinë e debatit të zhvilluar përgjatë marrjes së vendimeve".⁴²

Në lidhje me statusin e Gjyqtarëve të Gjykatës së Drejtësisë dhe Avokatëve të Përgjithshëm, Statuti parashikon se, ata gëzojnë imunitet ndaj çdo procedimi ligjor penal. Kjo do të thotë se, ata nuk mund të ndiqen penalisht, të akuzohen osë të dërgohen para organeve të drejtësisë, pa lejen paraprake të vetë Gjykatës së Drejtësisë. Pajisja e Gjyqtarëve dhe Avokatëve të Përgjithshëm me imunitet, nuk duhet të shikohet si një privilegj apo si një favor personal që iu bëhet atyre.

⁴¹ Neni 255 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

"Krijohet një panel për të dhënë mendimin e tij lidhur me përshtatshmërinë e kandidatëve për kryerjen e detyrave të Gjyqtarit dhe Avokatit të Përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme, përpara se qeveritë e Shteteve Anëtare të bëjnë emërimet e përmendura në nenet 253 dhe 254.

Paneli përbëhet nga shtatë anëtarë të zgjedhur mes ish anëtarëve të Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme, anëtarëve të gjykatave të larta kombëtare dhe juristëve që njihen për aftësitë profesionale, njërin prej të cilëve e propozon Parlamenti Evropian. Këshilli miraton një vendim për rregullat e punës së panelit dhe një vendim për emërimin e anëtarëve të panelit. Ai vepron me nismën e Kryetarit të Gjykatës së Drejtësisë"

⁴² Neni 2 i Statutit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian parashikon:

"Përpara se të marrë detyrën, çdo gjyqtar betohet përpara Gjykatës së Drejtësisë të mbledhur në seancë me dyer të hapura, për kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të paanshme dhe parimore dhe për ruajtjen e fshehtësisë së debatit gjyqësor të Gjykatës".

Përkundrazi, imuniteti i Gjyqtarëve të Gjykatës së Drejtësisë, përbën një garanci të fortë, me qëllim që ata të ushtrojnë funksionin e tyre të dhënies së drejtësisë, larg çdo lloj presioni politik apo shtetëror, qoftë nga Shtetet Anëtare, qoftë nga institucionet e Bashkimit Evropian.

Duke u nisur nga rëndësia që paraqet imuniteti i Gjyqtarëve në Statut është parashikuar se, ata gëzojnë imunitet, jo vetëm gjatë kohës që kanë qenë në detyrë, por edhe edhe pas përfundimit të detyrës. Por, imuniteti që Gjyqtarët gëzojnë pas përfundimit të detyrës, është më i kufizuar se, imuniteti që ata kanë gjatë ushtrimit të detyrës. Në qoftë se, gjatë ushtrimit të detyrës, Gjyqtarët kanë imunitet ndaj çdo procedimi ligjor, pas përfundimit të detyrës, ata gëzojnë imunitet vetëm “në lidhje me veprimet e kryera prej tyre për shkak të detyrës, duke përfshirë çdo mendim të dhënë ose çdo vendim të marrë gjatë ushtrimit të funksionit të tyre.”⁴³

Më sipër sqaruam se, Gjyqtarët e Gjykatës së Drejtësisë dhe Avokatët e Përgjithshëm, gëzojnë imunitet nga procesi penal, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit nga ana e tyre. *Por, mund të ndodhë që për një Gjyqtar ose Avokat të Përgjithshëm, që është në detyrë, të lindë nevoja që fillojë procedimi penal kundër tij, për shkaqe të përligjura, në këtë rast, shtrohet pyetja: Si do të bëhet e mundur procedimi penal ndaj këtij Gjyqtari? Në lidhje me këtë pyetje, Statuti parashikon që, para se të fillojë procedimi penal ndaj Gjyqtarit, Gjykata e Drejtësisë duhet t’i heqë imunitetin dhe vetëm pas heqjes së imunitetit, mund të fillojë procedimi penal kundër tij.*

Heqja e imunitetit të Gjyqtarit ose Avokatit të Përgjithshëm bëhet nga Gjykata e Drejtësisë, në mbledhje, në Seancë Plenare, që do të thotë se, heqja e imunitetit bëhet me pjesëmarrjen e të gjithë Gjyqtarëve të Gjykatës së Drejtësisë, të cilët aktualisht janë, gjithsej 28 gjyqtarë. Parashikimi që ka bërë Statuti, sipas të cilit për heqjen e imunitetit të Gjyqtarit, duhet të shprehet Gjykata e Drejtësisë, në seancë plenare, me pjesëmarrjen e të gjithë Gjyqtarëve, tregon për rëndësinë e jashtëzakonshme që ka kjo çështje, pasi siç do ta shohim më poshtë, Gjykata e Drejtësisë i ushtron funksionet e saj, e organizuar në Dhoma me tre ose pesë gjyqtarë ose në Dhomë të Madhe me 13 gjyqtarë dhe vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe për çështje me shumë rëndësi, funksionon e mbledhur në Seancë Plenare, në të cilën marrë pjesë të gjithë gjyqtarët e kësaj Gjykate.

Kur kemi folur për evoluimin historik të Gjykatës së Drejtësisë, kemi thënë se, aktualisht ajo përbëhet nga tre organe të ndryshme, të pavarura; Gjykata e Drejtësisë, Gjykata e Përgjithshme, ose Gjykata e Shkallës së Parë, siç njëjtoj deri vonë dhe gjykatat e specializuara, ku, kemi përmendur Gjykatën ose Tribunalin e Shërbimit Civil. Nevoja për heqjen e imunitetit mund të lindë, jo vetëm për Gjyqtarët e Gjykatës së Drejtësisë, por, edhe për Gjyqtarët e Gjykatës së Përgjithshme ose për Gjykatën e Shërbimit Civil. Në një rast të tillë, Statuti ka parashikuar që për heqjen e imunitetit të Gjyqtarëve të Gjykatës së Përgjithshme dhe të Gjykatës së Shërbimit Civil, vendos, po Gjykata e Drejtësisë, në seancë plenare, por, një vendim të tillë ajo e merr pasi të jetë konsultuar me Gjykatën, ku ndodhet gjyqtari të cilit do t’i hiqet imuniteti.

Në Statut nuk është përcaktuar se çfarë duhet të kuptojmë me termin “konsultim”, të cilin duhet që të bëjë Gjykata e Drejtësisë, me Gjykatën e Përgjithshme dhe Gjykatën

⁴³ Paragrafi i parë i nenit 3 të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian parashikon: “Gjyqtarët janë imunë nga procedimi ligjor. Pas përfundimit të detyrës, ata vazhdojnë të gëzojnë imunitet në lidhje me veprimet e kryera prej tyre për shkak të detyrës, duke përfshirë fjalët e thëna apo të shkruara”.

e Shërbimit Civil, para se ajo të vendosë për heqjen e imunitetit të Gjyqtarëve të njërëz prej këtyre Gjykatave. Mendoj se termi “konsultim”, në këtë rast, nënkupton që, për heqjen e imunitetit të këtij Gjyqtari, duhet të jetë marrë vendim dhe të ketë qenë dakort edhe Gjykata ku ai bën pjesë dhe më pas për heqjen e imunitetit të tij, vendos, përfundimisht Gjykata e Drejtësisë. Për shembull, në qoftë se, personi A, është gjyqtar i Gjykatës së Përgjithshme dhe ndaj tij, nga organi kompetent është paraqitur kërkesë për heqjen e imunitetit, në këtë rast, për heqjen e imunitetit të tij, duhet të ketë votuar në seancë plenare dhe të ketë rënë dakort Gjykata e Përgjithshme dhe më pas, duhet që të merret vendim edhe nga Gjykata e Drejtësisë, në seancë plenare, për heqjen e imunitetit të këtij gjyqtari.

Në qoftë se, një Gjyqtari ose Avokati të Përgjithshëm i hiqet imuniteti, atëherë ndaj tij mund të nisë procedimi penal nga Shteti Anëtar, i cili e ka emëruar atë. Gjykimi i këtij Gjyqtari në Shtetin Anëtar duhet të bëhet, vetëm nga gjykata që është kompetente për të gjykuar anëtarët e organeve gjyqësore më të larta në atë vend. Gjykimi i Gjyqtarit të Gjykatës së Drejtësisë nga organet më të larta gjyqësore të shtetit përkatës, tregon për rëndësinë që Traktatet Kushtetuese dhe Statuti i Gjykatës së Drejtësisë, i japin funksionit të Gjyqtarit, si një nga postet më të larta publike, në kuadrin e zyrtarëve të lartë të Bashkimit Evropian.

Një element tjetër i rëndësishëm që ka të bëjë me statusin e Gjyqtarëve, është edhe çështja e patundshmërisë ose palëvizshmërisë së tyre nga detyra ose funksioni, i cili përbën një nga faktorët më të rëndësishëm për ushtrimin e detyrës në pavarësi të plotë, nga çdo Gjyqtar në çdo lloj sistemi, ku, nuk bëjnë përjashtim as Gjyqtarët e Gjykatës së Drejtësisë. Statuti në dispozitat e tij, e ka garantuar në mënyrë të shprehur patundshmërinë e Gjyqtarëve nga detyra e tyre, duke përcaktuar konkretisht, rastet kur merr fund ose mbaron funksioni i gjyqtarit. Sipas Statutit, funksioni i Gjyqtarit të Gjykatës së Drejtësisë (ku përfshihen edhe Gjyqtarët e Gjykatës së Përgjithshme dhe Gjyqtarët e Gjykatës së Shërbimit Civil), mbaron në një nga këto raste:

a) Kur zëvendësohet sipas procedurave të parashikuara në Traktate Kushtetuese ose në Statut. Sipas Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, çdo tre vjet bëhet zëvendësimi i pjesshëm i Gjyqtarëve dhe Avokatëve të Përgjithshëm, sipas kushteve të përcaktuara në Statutin e Gjykatës së Drejtësisë. Nga ana e tij, Statuti parashikon se, në rastet e zëvendësimit të Gjyqtarëve çdo tre vjet pjesërisht, 14 dhe 13 gjyqtarë zëvendësohen në mënyrë të alternuar, ndërsa në rastet e zëvendësimit pjesërisht çdo tre vjet, të Avokatëve të Përgjithshëm, katër prej tyre zëvendësohen në çdo rast. Me qëllim që të mos krijohet boshllëk dhe të mos shkaktohen probleme në veprimtarinë e punës së Gjykatës së Drejtësisë, në Statut është përcaktuar se, në rastet e zëvendësimit të Gjyqtarit ose në rastet kur ai jep dorëheqjen, Gjyqtari i zëvendësuar ose që ka dhënë dorëheqjen, vazhdon që të kryerje funksionet e tij, deri në marrjen e detyrës nga ana e Gjyqtarit që do ta zëvendësojë.

b) Kur Gjyqtari jep dorëheqjen. Dorëheqja e Gjyqtarit nga detyra përbën një nga rastet e mbarimit të funksionit të tij, dhe për të drejtën nuk kanë rëndësi shkaqet që e çojnë gjyqtarin që të japë dorëheqjen, ai mund ta japë dorëheqjen për shkaqe personale, shëndetësore, familjare, e rëndësishme është që dorëheqja e tij të jetë shprehje e lirë dhe e plotë e vullnetit të tij, për të mos vazhduar më funksionet e gjyqtarit. Në Statut është parashikuar se, në rastet kur një Gjyqtar jep dorëheqjen, ai duhet t’ia paraqesë kërkesën e dorëheqjes nga funksioni i gjyqtarit, Kryetarit të Gjykatës së Drejtësisë, i cili, ia dërgon këtë kërkesë Presidentit të Këshillit të Bashkimit të Evropian. Me paraqitjen e kërkesës së dorëheqjes së Gjyqtarit dhe me

depozitimin e saj tek Presidenti i Këshillit, krijohet një vend vakand për këtë funksion dhe nisin procedurat nga Shteti përkatës për zëvendësimin e Gjyqtarit të dorëhequr.

c) *Kur Gjyqtari shkarkohet nga detyra ose për të përdorur gjuhën e Statutit, kur Gjyqtari privohet nga funksioni.* Sipas Statutit një Gjyqtar mund të privohet nga funksioni vetëm me vendim unanim të Gjyqtarëve dhe të Avokatëve të Përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë, ku gjyqtari për të cilin është paraqitur kërkesa për shkarkim, nuk merr pjesë në votim. Për shkarkimin e një Gjyqtari nga detyra ose për privimin e tij nga funksioni i Gjyqtarit, konstatohet se, Statuti i ka bërë një mbrojtje të jashtëzakonshme. Ai mund të shkarkohet nga detyra, vetëm në qoftë se, për një gjë të tillë kanë votuar, në mënyrë unanime, të gjithë Gjyqtarët dhe të gjithë Avokatët e Përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë.⁴⁴ Në rastet e shkarkimit të një Gjyqtari nga detyra, edhe sikur një Gjyqtar i vetëm ose qoftë edhe një Avokat i Përgjithshëm i vetëm, të mos jetë dakort me shkarkimin, atëherë, ai Gjyqtar nuk mund të shkarkohet. Në rastet kur, shtrohet për diskutim çështja e shkarkimit të një Gjyqtari të Gjykatës së Përgjithshme ose të Gjykatës së Shërbimit Civil, Statuti përcakton se, para marrjes së vendimit nga ana e Gjykatës së Drejtësisë, ajo duhet të “konsultohet” me Gjykatën në të cilën Gjyqtari bën pjesë. Termi “konsultim”, në këtë rast, nënkupton se, për shkarkimin e Gjyqtarit të Gjykatës së Përgjithshme ose të Gjykatës së Shërbimit Civil, duhet të votojnë, në mënyrë unanime, të gjithë Gjyqtarët e Gjykatës respektive, ku ai bën pjesë, si dhe të gjithë Gjyqtarët dhe Avokatët e Përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë.

Shkaqet të cilat mund të çojnë në shkarkimin e një Gjyqtari ose Avokati të Përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë, Statuti nuk i ka të parashikuar, në mënyrë konkrete. Statuti ka përdorur një term të përgjithshëm, sipas të cilit Gjyqtari mund të shkarkohet në qoftë se, Gjykata e Drejtësisë, në mënyrë unanime vlerëson se: “*nuk i plotëson kushtet apo detyrimet që i rrjedhin nga funksioni*”.

Bazuar në këtë term të përgjithshëm, i takon Gjykatës së Drejtësisë për të gjykuar dhe vendosur, rast pas rasti, se, cilët janë ato shkaqe apo rrethana konkrete, të cilat bëjnë që një gjyqtar i caktuar, *nuk i plotëson kushtet apo detyrimet që i rrjedhin nga funksioni*. Por, duke iu referuar praktikës gjyqësore dhe kornizës kushtetuese të Shteteve Anëtare, nuk është e vështirë për të përcaktuar se, cilat do të jenë ato shkaqe apo rrethana që tregojnë se, gjyqtari në fjalë, nuk i përmbush kushtet dhe detyrimet e tij si gjyqtar, ku si shkaqe të tilla mund të konsiderohen për shembull, shkelja nga ana e gjyqtarit e parimeve të pavarësisë dhe të paanësisë, nxjerrja prej tij e sekreteve të Dhomës së Këshillimit, etj.

Po ashtu, do të konsiderohen si shkaqe, të cilat mund të çojnë në shkeljen e kushteve dhe detyrimeve të funksionit të gjyqtarit, dhe veprimet e paligjshme të tij të cilat përbëjnë vepër penale, siç mund të jetë, shpërdorimi i detyrës, korrupsioni, etj. E rëndësishme është që të kuptohet fakti se, *një Gjyqtar ose Avokat i Përgjithshëm i Gjykatës së Drejtësisë, mund të shkarkohet vetëm për shkaqe objektive dhe për shkelje të rënda gjatë ushtrimit të detyrës së tij, sjellja të cilat janë të atilla që, e deskreditojnë rëndë pozicionin dhe figurën e Gjyqtarit dhe të cilat bëjnë që, Gjyqtari të mos i plotësojë më kushtet dhe detyrimet që rrjedhin nga funksioni tij si gjyqtar.*

⁴⁴ Paragrafi i parë i nenit 6 të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian parashikon: “Gjyqtari mund të privohet nga funksioni, e drejta për pension apo përfitime të tjera në vend të tij, vetëm nëse sipas opinionit unanim të Gjyqtarëve dhe Avokatëve të Përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë nuk plotëson më kushtet apo detyrimet që rrjedhin nga funksioni. Gjyqtari në fjalë nuk merr pjesë në këto debate. Nëse personi në fjalë është anëtar i Gjykatës së Përgjithshme ose i një gjykate të specializuar, Gjykata vendos pas konsultimit me gjykatën në fjalë”.

Mbrojtja e jashtëzakonshme që i bën Statuti shkarkimit të një Gjyqtari ose Avokati të Përgjithshëm, ku për shkarkimin e tij, duhet të votojnë në mënyrë unanime, të gjithë Gjyqtarët dhe Avokatët e Përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë, tregon për rëndësinë e madhe që i kushton e drejta e Bashkimit Evropian, çështjes së patundshmërisë së Gjyqtarëve nga detyra, si një nga elementët më të rëndësishëm të statusit të tyre. Me rastin e shkarkimit të një Gjyqtari nga detyra, Kancelari i Gjykatës ia komunikon vendimin përkatës Presidentit të Parlamentit Evropian, Presidentit të Komisionit dhe ia njofton këtë vendim Presidentit të Këshillit, pasi në këtë rast krijohet një vend vakand dhe fillon procedura për emërimin e Gjyqtarit të shkarkuar nga ana e Shtetit Anëtar, i cili e kishte emëruar atë.

Përveç shkarkimit të tij si Gjyqtar, Statuti parashikon se, Gjykata e Drejtësisë, në mënyrë unanime, mund të vendosë edhe heqjen e përfitimeve të tjera që ka patur në vendin e tij, Gjyqtari i shkarkuar, për shkak të funksionit të tij. Si përfitime të tjera mund të jenë e drejta e pensionit, ose drejta për të përfituar vende pune të caktuara në Shtetin Anëtar, për shkak të funksionit si Gjyqtar i Gjykatës së Drejtësisë, të cilat mund të hiqen nga ana e Gjykatës së Drejtësisë, duke mos i gëzuar këto të drejta në vendin e tij.

Megjithatë, sa i përket heqjes së të drejtave të tjera, duhet të kemi parasysh se, për heqjen e këtyre të drejtave, kërkohet një vendim tjetër, i marrë në mënyrë unanime nga Gjykata e Drejtësisë, i ndryshëm nga vendimi që është marrë për shkarkimin e tij. Po ashtu, duhet të kemi parasysh se, jo në çdo rast që një Gjyqtar shkarkohet, atij i hiqen edhe të drejtat apo përfitimet e tjera që ka në vendin e tij, pasi mund të ndodhë që Gjyqtari të shkarkohet, por, Gjykata e Drejtësisë të vendosë që atij të mos i hiqen të drejtat dhe përfitimet që ai ka në vendin e tij, për shkak të funksionit të tij si gjyqtar, kjo varet në çdo rast, nga lloji i shkeljes ligjore që ka kryer ai dhe nga shkalla e saj, si dhe nga qëndrimi që ai ka mbajtur gjatë dhe pas kryerjes së shkeljes ligjore. Me qëllim që Gjyqtari ta ushtrojë detyrën e tij, në mënyrë sa më të pavarur dhe të paanshme, si pjesë e statusit të tij, Statuti ka parashikuar se, ai nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër politik apo administrativ, qoftë në Shtetin Anëtar, qoftë në institucionet e Bashkimit Evropian. Po ashtu, Gjyqtari nuk mund të angazhohet në asnjë lloj veprimtarie tjetër, fitimprurëse ose jo fitimprurëse, përveç rasteve kur Këshilli i Bashkimit Evropian, e lejon që ta bëjë një gjë të tillë. Me rastin e marrjes së detyrës së tij, Gjyqtari angazhohet, solemnisht se, si gjatë ushtrimit të detyrës, ashtu edhe pas mbarimit të mandatit të tij, do të përmbushë të gjitha detytrimet që rrjedhin nga funksioni i tij si gjyqtar, veçanërisht, angazhohet për t'u sjellë me integritet dhe me maturi për sa i përket pranimit të emërimeve ose përfitimeve të caktuara pas mbarimit të detyrës.

Si pjesë e statusit të Gjyqtarit të Gjykatës së Drejtësisë dhe në plotësim të tij, vlen të përmendim, së fundmi edhe faktin se, ai gëzon edhe një sërë përfitimesh të tjera, të cilat rrjedhin nga Protokolli për Privilegjet dhe Imunitetet e Bashkimit Evropian. Si përfitime të tilla mund të përmendim:

- gjyqtarët e Gjykatës së Drejtësisë, janë imunë ndaj proceseve civile për aktet e ligjshme të kryera prej tyre, në cilësinë e tyre zyrtare, imunitet të cilin e gëzojnë dhe pas mbarimit të detyrës;

- së bashku me familjet e tyre, nuk u nënshtrohen kufizimeve të imigracionit ose formaliteteve për regjistrimin e të huajve;

- atyre iu ofrohen lehtësitë e nevojshme për rregullat valutore, në mënyrë të njëjtë, siç u ofrohen këto lehtësira, punonjësve të organizatave ndërkombëtare;

- kanë të drejtë që të importojnë pa doganë një automjet personal, si dhe mobiljet dhe sendet e nevojshme për banim, si dhe të drejtën që t'i riekportojnë ato, pa doganë, në vendin e origjinës;
- përjashtohen nga tatimet kombëtare mbi pagat, dhe shpërblimet që paguhen nga Bashkimi Evropian;
- përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore, sipas pëcaktimeve të bëra nga institucionet e Bashkimit.

2.2. Gjykata e Përgjithshme, evoluimi historik, organizimi dhe juridiksioni i saj.

Gjykata e Përgjithshme është një organ i pavarur që funksionon brenda kuadrit të sistemit gjyqësor të Bashkimit Evropian. *Fillimisht kjo Gjykatë, u krijua si një trupë gjyqësore që i bashkëngjitej Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, por, me Traktatin e Nisës, ajo u parashikua si një institucion më vete, i pavarur nga Gjykata e Drejtësisë, si dhe me kompetenca dhe juridiksion të përcaktuar qartë.* Aktualisht, Gjykata e Përgjithshme, është një institucion i pavarur i drejtësisë, në kuadër të sistemit gjyqësor të Bashkimit Evropian dhe organizimi dhe mënyra e funksionimit të saj, janë parashikuar, si në Traktatet Themeluese, ashtu edhe në dispozitat e Statutit të Gjykatës së Drejtësisë.

Një veçori e Gjykatës së Përgjithshme është fakti se, ky organ nuk ka ekzistuar që në momentet e para të krijimit të Komuniteteve Evropiane, por, është krijuar shumë më vonë dhe për këtë arsye edhe evoluimi historik i kësaj Gjykate, është i ndryshëm nga ai i Gjykatës së Drejtësisë. *Si datë e krijimit të Gjykatës së Përgjithshme, konsiderohet data 31 tetor 1989, që është edhe data kur ajo ka filluar veprimtarinë e saj kjo Gjykatë, e cila kishte në juridiksonin e saj për të gjykuar çështje të caktuara, por, që në momentin e krijimit nuk konsiderohej si Gjykatë e veçantë, por, si një trupë gjyqësore që mbështeste Gjykatën e Drejtësisë.*

Krijimi i Gjykatës së Përgjithshme, çoi në një ndryshim rrënjësor në sistemin e drejtësisë së Bashkimit Evropian. Kjo sepse, pas krijimit të kësaj Gjykate, sistemi gjyqësor i Bashkimit, nga një sistem me një nivel gjykimi, e cila ishte Gjykata e Drejtësisë, vendimet e të cilës ishin të formës së prerë dhe palët nuk kishin të drejtë ankimi, u shndërrua në një sistem me dy nivele gjykimi; Gjykata e Përgjithshme, ose siç njihet në aktet kohë, Gjykata e Shkallës së parë dhe Gjykata e Drejtësisë, si gjykatë e shkallës së dytë, tek e cila mund të paraqiteshin ankimet, për çështje ligjore, kundër vendimeve të Gjykatës së Përgjithshme.

Arsyet që çuan në krijimin e Gjykatës së Përgjithshme, mund të përmbledhen si më poshtë:

Së pari: Rritja e numrit të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, në vitet 1970-1980, nga gjashtë, në dymbëdhjetë, sigurisht që solli rritjen e volumit të çështjeve që paraqiteshin para Gjykatës së Drejtësisë, e cila, për shkak të numrit të vogël të Gjyqtarëve, e kishte të pamundur që të gjykonte ato, brenda një afati të arsyeshëm;

Së dyti: Rritja e kompleksitetit dhe vështirësisë së çështjeve që paraqiteshin para Gjykatës së Drejtësisë, i cili kërkonte Gjyqtarë të specializuar në fusha të veçanta të ligjit, si dhe kërkonte kohë të mjaftueshme për gjykimin e këtyre çështjeve;

Së treti: Tendanca që kishte vetë Gjykata e Drejtësisë për të rritur juridiksionin e saj, duke i dhënë efekte të drejtpërdrejta të drejtës komunitare, por që solli dhe rritjen e ngarkesës së punës së kësaj Gjykate.

Nisur nga këto shkaqe, në vitin 1974 Presidenti i Gjykatës së Drejtësisë, sugjeroi që të krijohet një gjykatë e specializuar që të kishte në juridiksionin e saj gjykimin e çështjeve që kishin të bënin me mosmarrëveshjet që kishin institucionet e Bashkimit Evropian me njëri-tjetrin, si dhe mosmarrëveshjet që kishin nëpunësit e institucioneve të Bashkimit me institucionet e Bashkimit Evropian. Në vijim të këtyre përpjekjeve në vitin 1985, Presidenti i Gjykatës së Drejtësisë, në konferencën ndërkombëtare të këtij viti, paraqiti disa projekte, për të shtuar disa nene në Traktatet Kushtetuese, të cilat do t'i jepnin të drejtë Këshillit të Bashkimit Evropian që të krijonte një Gjykatë të re. *Propozimet e mësipërme, u miratuan në korrik të vitit 1987, në Aktin Unik Evropian dhe u shtuan me të njëjtën përmbajtje në të tre Traktatet Kushtetuese.*

Baza ligjore që lejoi krijimin e Gjykatës së Përgjithshme, gjendet në nenin 168/a të Traktatit të Komunitetit Evropian, me gjithë ndryshimet e pësuar, në dhjetor 1991, me Traktatin e Mastrihtit. Sipas kësaj dispozite, parashikohej që, Këshilli i Bashkimit Evropian, duke vepruar unanimisht, mbi kërkesën e Gjykatës së Drejtësisë dhe pasi të këshillohej me Parlamentin dhe Komisionin Evropian, mund t'i transferonte Gjykatës së Shkallës së Parë, sot Gjykata e Përgjithshme, çdo çështje që përfshihej në juridiksionin e Gjykatës së Drejtësisë, me përjashtim të çështjeve paragjykimore. Po ashtu, kjo dispozitë ligjore, përcaktonte se, Gjykata e Shkallës së Parë, ishte një trupë gjyqësore, që i bashkëngjitej Gjykatës së Drejtësisë dhe kishte kompetencë të shqyrtonte dhe të vendoste në shkallë të parë për disa kategori çështjesh.⁴⁵

Një veçori tjetër e Gjykatës së Përgjithshme, është fakti se, jo vetëm statusi i saj, por, edhe juridiksioni i saj, nga momenti i krijimit deri më sot, ka ndryshuar, duke u shndërruar kjo Gjykatë, në një institucion të veçantë dhe të pavarur, në kuadrin e sistemit gjyqësor të Bashkimit Evropian. Për statusin e kësaj Gjykate mund të themi se, ai ka ndryshuar në mënyrë rrënjësore, pasi kjo Gjykatë, në momentin e krijimit ishte konceptuar si një trupë gjyqësore që mbështeste Gjykatën e Drejtësisë, ndërsa, sot, ajo është një organ gjyqësor i pavarur, që funksion brenda sistemit gjyqësor të Bashkimit Evropian, krahas Gjykatës së Drejtësisë.

Për juridiksionin e kësaj Gjykate, konstohet se, juridiksioni i saj, nga momenti i krijimit e deri më sot, ka ardhur duke u zgjeruar, kjo sepse, në momentin e krijimit Gjykata e Përgjithshme, e njohur atë kohë si Gjykata e Shkallës së Parë, kishte si kompetencë që të shqyrtonte, vetëm mosmarrëveshjet që lindin, ndërmjet nëpunësve të Bashkimit Evropian dhe institucioneve të Bashkimit, si dhe mosmarrëveshjet që lindin ndërmjet vetë institucioneve të Bashkimit, ndërsa, aktualisht, kjo Gjykatë, gjykon një numër të madh mosmarrëveshjes, të cilat do të përmenden nga ana ime më poshtë në këtë çështje.

Në lidhje me emërimin dhe statusin e Gjyqtarëve të Gjykatës së Përgjithshme, në Traktatet Kushtetuese, është përcaktuar se, mënyra e emërimit dhe statusi i këtyre Gjyqtarëve është e njëjtë me emërimin dhe statusin e Gjyqtarëve të Gjykatës së

⁴⁵ Paragrari i parë i nenit 168/a i Traktatit të Komunitetit Evropian, pas ndryshimeve të bëra me Traktatin e Mastrihtit parashikonte:

“Një Gjykatë e Shkallës së Parë i bashkëngjitet Gjykatës së Drejtësisë dhe ka kompetencë të shqyrtojë dhe të vendosë në shkallë të parë për disa kategori ankimesh”.

Drejtësisë, të cilat janë trajtuar nga ana ime më lart, prandaj nuk do të trajtohen edhe në këtë çështje. Fakti që, Traktatet Kushtetuese, por edhe Statuti i Gjykatës së Drejtësisë, kanë përcaktuar të njëjtën mënyrë emërimi dhe të njëjtën status për Gjyqtarët e Gjykatës së Përgjithshme, ashtu si edhe Gjyqtarët e Gjykatës së Drejtësisë, tregon për rëndësinë shumë të madhe që ka kjo Gjykatë, në kuadër të sistemit të drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Në pikëpamje të organizimit, i vetmi dallim që qëndron ndërmjet Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme, është fakti se, tek Gjykata e Përgjithshme, nuk ekzistojnë Avokatët e Përgjithshëm, si një organ mbështetës për Gjykatën e Përgjithshme, ashtu siç i ka Gjykata e Drejtësisë. Megjithatë, edhe ky është më shumë një dallim formal sesa real, pasi, nga ana procedurale, në çështjet që gjykohen nga Gjykata e Përgjithshme, kur në Statut është parashikuar, merr pjesë edhe një Avokat i Përgjithshëm, i cili është një person që nuk është emëruar posaçërisht për këtë funksion, por, si i tillë caktohet një nga Gjyqtarët e Gjykatës së Përgjithshme.

Për shqyrtimin e çështjeve që hyjnë në juridiksionin e saj, Gjykata e Përgjithshme mbledhet në dhoma të përbëra nga tre ose pesë gjyqtarë. Gjyqtarët zgjedhin Kryetarët e dhomave në secilën prej dhomave, ku ata bëjnë pjesë. Në statut është parashikuar se, Kryetarët e dhomave me pesë gjyqtarë zgjidhen për tre vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm njëherë. Përveç gjyqimeve në dhoma me tre ose pesë gjyqtarë, Rregullorja e Brendshme e Gjykatës së Përgjithshme, mund të parashikojë që kjo Gjykatë në gjykojë edhe në Dhomë të Madhe, në rastet dhe kushtet e parashikuara nga vetë kjo Rregullore.⁴⁶

Në Statut, po ashtu, është përcaktuar se përbërja e dhomave të Gjykatës së Përgjithshme dhe caktimi i çështjeve për secilën dhomë, përcaktohet me Rregulloren e Brendshme të Gjykatës, e cila miratohet nga ana e Këshillit, pasi të jetë konsultuar më parë edhe me Gjykatën e Drejtësisë. Në Rregulloren e Brendshme parashikohen edhe rastet kur Gjykata e Përgjithshme, mund të gjykojë në Seancë Plenare, pra, me pjesëmarrjen e të gjithë gjyqtarëve të saj, si dhe kur ajo mund të gjykojë me një gjyqtar të vetëm.

Përsa i përket juridiksionit që ka Gjykata e Përgjithshme, ose rrethit të çështjeve që ajo ka të drejtë për të shqyrtuar dhe vendosur, konstatohet se, kjo Gjykatë ka juridiksion fillestar dhe rishikues.⁴⁷ Juridiksioni më i rëndësishëm i Gjykatës së Përgjithshme, është juridiksioni fillestar i saj, i cili përbën edhe volumnin më të madh të punës të kësaj gjykate dhe rastet e shqyrtuara sipas këtij funksioni, përbëjnë edhe çështjet më të rëndësishme të gjykuara prej saj.

Për juridiksionin rishikues të Gjykatës së Përgjithshme, mund të themi se, ajo ka të drejtë që të shqyrtojë dhe vendosë për ankimet që bëhen kundër vendimeve të gjykatave të specializuara, siç është Gjykata e Shërbimit Civil e Bashkimit Evropian. Sipas Traktateve Themeluese dhe Statutit të Gjykatës së Drejtësisë, kundër vendimit përfundimtar të marrë nga Gjykata e Shërbimit Civil, palët kanë të drejtë që të bëjnë

⁴⁶ Paragrafi parë i nenit 50 të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian parashikon:

“Gjykata e Përgjithshme mbledhet në dhoma me tre ose pesë gjyqtarë. Gjyqtarët zgjedhin Kryetarët e dhomave mes radhëve të tyre. Kryetarët e dhomave me pesë gjyqtarë zgjidhen për tre vjet. Ata mund të rizgjidhen vetëm njëherë”.

⁴⁷ Si juridiksion fillestar për një gjykatë konsiderohet e drejta që ka ajo për të shqyrtuar dhe vendosur për mosmarrëveshje, të cilat janë paraqitur për herë të parë para saj, dhe nuk janë paraqitur më parë, para asnjë organi tjetër gjyqësor të atij Shteti. Si juridiksion rishikues për një gjykatë, konsiderohet e drejta që ka ajo për të gjykuar ankimet ose apelet që paraqiten nga palët, kundër një vendimi gjyqësor të dhënë nga një gjykatë e një niveli më të ulët.

ankim në Gjykatën e Përgjithshme. *Ankimi kundër vendimit të Gjykatës së Shërbimit Civil, mund të bëhet nga palët, si rregull, për çështje të zbatimit të ligjit, pra, për mos zbatim ose zbatim të gabuar të ligjit nga ana e Gjykatës dhe jo edhe për çështje të vlerësimit të fakteve. Megjithatë, në rastet kur Rregullorja e Brendshme e Gjykatës e parashikon dhe e lejon, ankimi nga palët mund të bëhet edhe për çështje që kanë të bëjnë me vlerësimin e fakteve.*⁴⁸

Në lidhje me juridiksionin fillestar të Gjykatës së Përgjithshme, konstojmë se, ky juridiksion është parashikuar, në mënyrë të përgjithshme nga paragrafi i parë i nenit 256 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, si dhe nga neni 51 i Statutit të Gjykatës së Drejtësisë. Duke iu referuar këtyre dispozitave ligjore, konkludojmë se në juridiksionin fillestar të Gjykatës së Përgjithshme përfshihen këto çështje:

a) ankimet ose paditë që ngrihen nga personat fizikë ose juridikë privatë që ndodhen brenda Bashkimit Evropian dhe që kanë për objekt kundërshtimin e akteve të paligjshme legislative të Parlamentit Evropian, të akteve të paligjshme të Këshillit, të Komisionit dhe të Bankës Qendrore Evropiane, të cilat janë të detyrueshme për zbatim të drejtpërdrejtë, në territorin e Shteteve Anëtare. Në mënyrë që të paraqitet ankimi ose padia para Gjykatës së Drejtësisë në këtë rast kërkohen që të plotësohen, në të njëjtën kohë, tre kushte:

Së pari: Duhet që padia të ngrihet nga një person fizik ose juridik privat dhe jo nga një Shtet Anëtar, pasi në rastet kur një padi e tillë ngrihet nga një Shtet Anëtar, kompetente për gjykimin e çështjes është Gjykata e Drejtësisë dhe jo Gjykata e Përgjithshme;

Së dyti: Duhet që padia të ngrihet ndaj një akti juridik me fuqi detyruese, të drejtpërdrejtë, në Shtetet Anëtare, pra, duhet që të jemi ose para një Akti Legjislativ ose para një Direktive të Komisionit apo para Vendimeve të Parlamentit Evropian, të Këshillit, të Komisionit dhe të Bankës Qendrore Evropiane që, kanë fuqi të detyrueshme dhe zbatim të drejtpërdrejtë në territorin e Shteteve Anëtare dhe nuk duhet të jemi para Rekomandimeve ose Opinioneve të institucioneve të Bashkimit Evropian, të cilat, nuk kanë fuqi detyruese dhe nuk zbatohen, drejtpërdrejt, në territorin e Shteteve Anëtare;

Së treti: Duhet që akti t'i drejtohet personit që ka paraqitur padinë ose që prek, në mënyrë të drejtpërdrejtë, interesat e tij, përfshirë edhe rastet kur akti ka karakter të përgjithshëm, mjafton që personi të pretendojë që prek, në mënyrë të drejtpërdrejtë, interesat e tij.

Padia e ngritur kundër akteve të mësipërme, duhet që të ngrihet nga personi fizik ose juridik, brenda dy muajve nga nxjerrja e aktit ose botimi i masës me karakter të përgjithshëm. Kur akti që goditet është me natyrë individuale, padia duhet të ngrihet brenda dy muajve nga njoftimi i aktit ose masës paditësit ose nga dita që ai ka marrë dijeni për nxjerrjen e aktit.

b) Paditë e ngritura nga personat fizikë dhe juridikë kundër akteve të paligjshme të organeve, zyrave ose agjensive të Bashkimit Evropian, të ndryshme nga institucionet kryesore të tij, siç janë Parlamenti, Këshilli, Këshilli i Bashkimit Evropian, Komisioni dhe Banka Qendrore Evropiane. Për ngritjen e padive të

⁴⁸ Paragrafi i tretë i nenit 257 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, parashikon:

“Kundër vendimeve që nxjerrin gjykatat e specializuara mund të apelohe vetëm për çështje të interpretimit ligjor ose kur e parashikon rregullorja përmes së cilës krijohet gjykata e specializuar, mund të apelohe edhe për faktet e parashtruara, përpara Gjykatës së Përgjithshme”.

mësipërme, paditësi, duhet të plotësojë të njëjtat kushte, si në rastet kur ai e ngren padinë kundër akteve të paligjshme të Parlamentit, Këshillit, Komisionit Evropian, etj, pra, duhet që akti të ketë efekt detyrues të drejtpërdrejtë, duhet që t'i drejtohet paditësit ose të prekë interesat e tij, si dhe padia duhet të ngrihet brenda dy muajve nga nxjerrja, botimi ose njoftimi i aktit. I vetmi dallim që qëndron në këtë rast, është fakti se, akti që kundërshtohet si i paligjshëm, nuk është nxjerrë nga organet kushtetuese të Bashkimit Evropian, siç janë Parlamenti, Komisioni, Këshilli etj, por, është nxjerrë nga një organ ose zyrë ose agjensi e Bashkimit Evropian, e cila, është e krijuar dhe funksionon mbi bazën e një vendimi ose akti, që ka marrë një nga institucionet kushtetuese të Bashkimit.

Sa i përket akteve me anë të të cilave krijohen organe, zyra apo agjensi, në Traktatet Themeluese është parashikuar se, këto akte duhet të pëcaktjnë kushte dhe masa organizative të caktuara, lidhur me paditë që mund të ngrihen kundër tyre, nga personat fizikë ose juridikë kundër akteve të këtyre organeve, zyrave apo agjensive, të cilat prekin, në mënyrë të drejtpërdrejtë, interesat e tyre ose prodhojnë pasojë ligjore kundër tyre.⁴⁹ Duhet të kemi parasysh se, këto kushte ose masa organizative që mund të përcaktohen për paditë që ngrihen kundër akteve të këtyre organeve, zyrave apo agjensive, duhet të jenë të tilla që, të mos pengojnë të drejtën e personave fizikë ose juridikë për të ngritur padi kundër tyre, por, përkundrazi, duhet të synojnë në krijimin e kushteve dhe lehtësirave të nevojshme që personat fizikë ose juridikë, të kenë mundësi reale që t'i kundërshtojnë ato.

c) Paditë e ngritura nga personat fizikë ose juridikë kundër organeve kushtetuese të Bashkimit, siç janë Parlamenti, Këshilli, Komisioni dhe Banka Qendrore Evropiane, në rastet kur këto organe, në bazë të Traktatave Themeluese, kanë detyrimin për të vepruar, për të nxjerrë akte ose për të kryer veprime të caktuara, dhe nuk veprojnë, në kundërshtim me parashikimet ligjore të Traktateve Themeluese. Për ngritjen e padisë, në këtë rast, nga ana e subjektit duhet të plotësohen tre kushte:

Së pari: Duhet që të jetë parashikuar, në mënyrë të shprehur, në Traktatet Themeluese që një organ kushtetues i Bashkimit të veprojë duke nxjerrë një akt ose duke kryer një veprim të caktuar;

Së dyti: Duhet që organi konkret, në kundërshtim me parashikimin e shprehur në Traktatet Themeluese, të mos ketë vepruar;

Së treti: Duhet që më parë, t'i jetë bërë thirrje organit konkret për të vepruar dhe duhet të kenë kaluar dy muaj që, ky organ edhe pas kësaj thirrjeje, nuk ka vepruar.

Me plotësimin e këtyre tre kushteve personi fizik ose juridik, mund t'i drejtohet Gjykatës së Përgjithshme me padi, brenda dy muajve nga skadimi i afatit dy mujor i thirrjes që i është bërë organit për të vepruar. Me anë të kësaj padie, në rastet kur ajo pranohet si e bazuar, Gjykata e detyron organin kushtetues të Bashkimit Evropian, për shembull, Komisionin që të veprojë, duke i përcaktuar edhe se cilin akt konkret do të nxjerrë apo cilin veprim do të kryejë.

⁴⁹ Paragrafi i pestë i nenit 263 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Aktet përmes të cilave krijohen organe, zyra dhe agjensi të Bashkimit mund të pëcaktjnë kushte dhe masa organizative të caktuara lidhur me paditë e ngritura nga personat fizikë ose juridikë kundër akteve të këtyre organeve, zyrave dhe agjensive, të cilët kanë për qëllim prodhimin e pasojave kundrejt tyre”.

c) *Paditë e ngritura nga personat fizikë ose juridikë në rastet kur organet, zyrat ose agjensitë e Bashkimit Evropian, të ndryshme nga organet kushtetuese, nuk i janë drejtuar personit me një akt, edhe pse sipas kushteve dhe rrethanave konkrete, pra, sipas gjendjes së faktit dhe sipas normave ligjore, ato duhej ta kishin nxjerrë aktin, përveç rasteve kur ky akt është një rekomandim ose opinion.*⁵⁰ Padia, në këtë rast, ngrihet për mosveprim të organeve, zyra ose agjensive të Bashkimit, të cilat edhe pse kanë detyrimin ligjor për të vepruar, nuk veprojnë, duke cënuar kështu, në mënyrë të paligjshme, interesat e personave fizikë ose juridikë privatë. Edhe për ngritjen e kësaj padie, duhet të ekzistojnë të njëjtat kushte, si në rastet kur ngrihet për mosveprimin e organeve kushtetuese të Bashkimit Evropian, pra, duhet të ekzistojë një detyrim ligjor për të vepruar dhe këto organe ose zyra ose agjensi, nuk veprojnë, si dhe duhet t'iu jetë bërë thirrje atyre për të vepruar dhe të ketë kaluar afati dy mujor, nga dita e bërjes së thirrjes dhe ato, përsëri, nuk kanë vepruar.

d) *Paditë e ngritura nga personat fizikë dhe juridikë në rastet kur, një institucion i Bashkimit Evropian ose nëpunësit e tyre, përfshirë edhe Bankën Qëndrore Evropiane dhe nëpunësit e saj, shkaktojnë një dëm jashtëkontraktor ndaj tyre.* Gjatë veprimtarisë së tyre institucionet e Bashkimit Evropian, si dhe nëpunësit e tyre, mund të shkaktojnë dëme jashtë kontraktor, personave të tretë dhe në këto raste, ata janë të detyruar që të shpërblejnë dëmin e shkaktuar. Para se të paraqes kushtet që duhet të plotësohen për ngritjen e padisë sipas kësaj pike, do të duhet të sqarojmë fillimisht se ç'duhet të kuptojmë me konceptin “dëm jashtëkontraktor” dhe cilët janë kushtet për ngritjes e padisë në një rast të tillë?

Dëmi jashtëkontraktor nënkupton dëmtimin e jetës, shëndetit ose pasurisë së personit të tretë, si pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme dhe me faj, të kryera nga shkaktuesi i dëmit. Në rastin e dëmit jashtëkontraktor, nuk ekziston asnjë lidhje juridike, ndërmjet shkaktuesit të dëmit dhe personit të tretë të dëmtuar, i cili pëson dëmin në shëndetin ose pasurinë e tij, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të kryera me faj, nga ana e shkaktuesit të dëmit. Ky është edhe dallimi kryesor, ndërmjet dëmit kontraktor dhe dëmit jashtëkontraktor, ku në rastin e dëmit kontraktor, ekziston një kontratë ose një marrëdhënie juridike ndërmjet palëve, dhe njëra prej tyre, në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shakton dëm palës tjetër kontraktore.

Në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen që, shkaktuesi i dëmit të përgjigjet për dëmin e shkaktuar, në parimet e përgjithshme të të drejtës civile, por, edhe në Kodet Civile të Shteteve Anëtare, përcaktohet se, duhet të ekzistojnë, në të njëjtën kohë, katër kushte:

Së pari: Duhet të jetë shkaktuar dëmi, në shëndetin ose pasurinë e personit të tretë;

Së dyti: Duhet që dëmi të ketë ardhur si rrjedhojë e veprimit ose mosveprimit të paligjshëm të shkaktuesit të dëmit;

Së treti: Duhet që dëmi të jetë shkaktuar me faj nga ana shkaktuesit të dëmit;

Së katërti: Duhet që të ekzistojë lidhja shkakësore, e menjëhershme dhe e drejtpërdrejtë, ndërmjet veprimit dhe mosveprimit dhe pasojës së ardhur.

⁵⁰ Paragrafi i dytë i nenit 265 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Çdo person fizik ose juridik mund të ankohet përpara Gjykatës sipas kushteve të përcaktuara në paragrafët e mësipërm, se një institucion, organ, zyrë ose agjensi e Bashkimit nuk i është drejtuar personit me një akt, përveç një rekomandimi ose opinionit”.

Trajtimi me hollësi i secilit prej këtyre kushteve të domosdoshme, të cilat duhet të ekzistojnë me qëllim që të ekzistojë përgjegjësia për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, i përket të drejtës civile dhe nuk është qëllim i kësaj teme dizertacioni. E rëndësishme është të kuptohet se, që një person të mbajë përgjegjësi për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, duhet që të plotësohen, në të njëjtën kohë, të gjitha kushtet e mësipërme, pasi mungesa e qoftë njërit prej tyre, bën që personi të përjashtohet nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor. Ekzistenca e të gjitha kushteve të mësipërme për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, kërkohet, jo vetëm nga parimet e përgjithshme të së drejtës civile, por edhe nga vetë Traktatet Kushtetuese, të cilët kanë përcaktuar se, në rastin e dëmit jashtëkontraktor, shpërblimi nga ana e Bashkimit Evropian, jepet në përputhje me parimet e përgjithshme që janë të përbashkëta për ligjet e Shteteve Anëtarë të Bashkimit.⁵¹ Duke qenë se, secili nga ligjet e përbashkëta të Shteteve Anëtare, si parime të përgjithshme për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, parashikojnë ekzistencën e katër kushteve të mësipërme, atëherë, konkludojmë se, që Bashkimi Evropian, të japë dëmshpërblim për dëmin jashtëkontraktor, duhet të ekzistojnë të gjitha këto kushte.

Për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor nga ana e Bashkimit Evropian, duhet që të kemi parasysh, gjithashtu që, përveç kushteve të mësipërme, *duhet që dëmi jashtëkontraktor të jetë shkaktuar nga ana e institucionit ose nëpunësit, gjatë kryerjes së detyrave të tyre funksionale*. Pra, duhet që dëmi jashtëkontraktor të jetë shkaktuar, gjatë kryerjes së funksionit ose detyrës ose për shkak të saj dhe jo për shkaqe që nuk lidhen me detyrën. *Në qoftë se, dëmi është shkaktuar nga ana e institucionit të Bashkimit Evropian ose nga nëpunësi i këtij institucioni, për shkaqe që nuk lidhen me detyrën ose funksionin e tyre, përgjegjësinë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor e mban, personalisht, vetë institucioni ose nëpunësi që ka shkaktuar dëmin dhe jo Bashkimi Evropian*.

Përsa i përket juridiksionit të Gjykatës së Përgjithshme, duke i bërë një interpretim të kundërt ose a contrario, nenit 51 të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, si dhe duke i bërë një interpretim sistematik dispozitave të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, *mendoj se, në juridiksionin e Gjykatës së Përgjithshme, përfshihen edhe këto kategori çështjesh:*

i. paditë e ngritura nga një Shtet Anëtar, kundër vendimeve të marra nga ana e Këshillit Evropian, vendim i cili e ka konsideruar ndihmën ekonomike të dhënë nga ky Shtet, si të papajtueshëm me tregun e brendshëm të Bashkimit Evropian;

ii. paditë e ngritura kundër akteve të Këshillit Evropian, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e tregtisë së përbashkët të Bashkimit;

*iii. paditë e ngritura kundër akteve të Këshillit Evropian, me anë të të cilave Këshilli ushtron kompetenca zbatuese që kanë për qëllim detyrimin e Shteteve Anëtare që të miratojnë të gjitha masat e nevojshme legislative kombëtare, për vënien në zbatim të akteve të Bashkimit Evropian, me fuqi ligjore detyruese.*⁵²

⁵¹ Paragrafi i dytë i nenit 340 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Në rastin e përgjegjësisë jashtëkontraktore, Bashkimi mund të japë dëmshpërblim, në përputhje me parimet e përgjithshme që janë të përbashkëta për ligjet e Shteteve Anëtare, për çdo dëm që shkaktojnë institucionet ose nëpunësit e tij gjatë kryerjes së detyrave të tyre”

⁵² Paragrafi i parë i nenit 51 të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, parashikon:

“Duke u shmangur nga rregulli i përcaktuar nga neni 256(1) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, Gjykatës së Drejtësisë i rezervohet juridiksioni për paditë e përmendura në nenin 263 dhe 265 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian kur ato ngrihen nga një Shtet Anëtar kundër:

Për paditë që ngrihen nga një Shtet Anëtar, kundër vendimeve të Këshillit Evropian sipas germës (i) të mësipërme, kjo çështje rregullohet në nenin 107 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian. Kjo dispozitë parashikon se, ndalohej çdo lloj ndihme që mund të japë një Shtet Anëtar, përmes burimeve të tij shtetërore ose me çdo lloj forme tjetër, e cila shtrembëron ose rrezikon që të shtrembërojë konkurrencën e ndershme, duke favorizuar ndërmarrje të caktuara ose prodhimin e mallrave të caktuar. Në dispozitën e mësipërme janë përcaktuar edhe disa raste përjashtimore, sipas të cilave ndihma e dhënë nga një Shtet Anëtar, është e lejueshme dhe për pasojë është e pajtueshme me tregun e brendshëm të Bashkimit Evropian, siç mund të jetë ndihma e dhënë në rastet e fatkeqësive natyrore, ndihma e dhënë për nxitjen ekonomike të zonave ku standarti i jetesës është i ulët, në mënyrë jo normale dhe ku papunësia është shumë e lartë, ndihma për nxitjen e projekteve me interes të përbashkët për Bashkimin Evropian, etj.

Në qoftë se, një Shtet Anëtar jep një ndihmë shtetërore ose të çfarë do lloj forme, e cila cënon ose rrezikon të cënojë konkurrencën e ndershme dhe që është për pasojë në kundërtim me tregun e brendshëm të Bashkimit, Këshilli Evropian, me unanimitet, mund të vendosë që kjo ndihmë është e papajtueshme me tregun e brendshëm dhe për pasojë, urdhëron ndërprerjen e menjëhershme të saj. *Pikërisht, në lidhje me padinë që mund të ngrejë Shteti Anëtar, kundër vendimit të mësipërm të Këshillit, ka juridiksion Gjykata e Përgjithshme, për të vendosur, nëse, vendimi i marrë nga Këshilli është i bazuar apo jo.*

Për ngritjen e padisë së mësipërme Shteti Anëtar, duhet që të provojë që ka dhënë një ndihmë ekonomike ose financiare, e cila nuk ka cënuar konkurrencën e ndershme ose që nuk ka rrezikuar që ta cënojë atë dhe vendimi i marrë nga Këshilli, është në kundërshtim me parashikimet ligjore të Traktateve Kushtetuese. Barra e provës për të provuar që vendimi i marrë nga Këshilli është i pabazuar, në këtë rast, bie mbi Shtetin Anëtar dhe jo mbi Këshillin, i cili, duhet të provojë që vendimi i marrë nga Këshilli, nuk është marrë në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe se ndihma ekonomike e dhënë prej tij, është në përputhje me tregun e përbashkët të Bashkimit.

Paditë e ngritura sipas germës (ii) si më sipër, kanë lidhje me ato që u trajtuan me germën (i) më lart, sepse në këtë rast, bëhet fjalë për mbrojtjen e politikës së përbashkët tregtare të Bashkimit Evropian. Dispozitat e Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian përcaktojnë se, politika e përbashkët tregtare bazohet në parime të njëjta, sidomos sa u takon ndryshimeve të normave tarifore, lidhjes së marrëveshjeve për tarifatat dhe tregtinë e mallrave dhe shërbimeve, investimeve të huaja të drejtpërdrejta, arritjes së njëtrajshmërisë në masat e liberalizimit, eksporteve dhe të masave për të mbrojtur tregtinë. Po ashtu, në këto dispozita parashikohen rregullat dhe procedurat konkrete, si dhe institucionet përkatëse që, janë të autorizuar për negocimin dhe lidhjen e marrëveshjeve tregtare, me vendet e treta ose organizatat ndërkombëtare.

(a) një veprimi ose mosveprimi të Parlamentit Evropian ose Këshillit, ose atyre institucioneve që veprojnë bashkarisht, përveç:

- vendimeve që merren nga Këshilli sipas nënparagrafit të tretë të nenit 108(2) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian;
- akteve të Këshillit të miratuara sipas një rregullorje të Këshillit në lidhje me masat për të mbrojtur tregtinë sipas kuptimit të nenit 207 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian;
- akteve të Këshillit me të cilat Këshilli ushtron kompetenca zbatuese në përputhje me paragrafin e dytë të nenit 291 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian”.

Në rastet kur, një Shtet Anëtar kryen një veprim ose mosveprim, me anë të të cilit çenohet ose rrezikon të çenohet tregu i përbashkët i Bashkimit Evropian, Këshilli, me unanimitet, mund të vendosë që ky veprim ose mosveprim i Shtetit Anëtar, është në kundërshtim me politikën e përbashkët tregtare të Bashkimit, duke urdhëruar marrjen e masave për rivendosjen e gjendjes së mëparshme. *Nga ana tije, nëse Shteti Anëtar çmon se, vendimi i marrë nga Këshilli është i pabazuar, ai ka të drejtë që të ngrejë padi, kundër vendimit të mësipërm të Këshillit, për shqyrtimin e të cilës ka juridiksion dhe vendos Gjykata e Përgjithshme.* Me ngritjen e padisë edhe në këtë rast, Shteti Anëtar, ka detyrimin për të provuar se, veprimi ose mosveprimi i tij, nuk ka cenuar dhe nuk ka rrezik që të cenohet tregun e brendshëm evropian dhe se vendimi i Këshillit, nuk është bazuar në dispozitat ligjore që rregullojnë këtë çështje.

Paditë e ngritura sipas germës (iii) si më sipër, u referohen akteve të Këshillit, me të cilat ai ushtron kompetenca zbatuese për detyrimin e Shteteve Anëtare që të miratojnë masat e duhura legjislative kombëtare, për të vënë në jetë aktet ligjore të Bashkimit Evropian, që kanë fuqi detyruese, të drejtpërdrejtë. Në kapitullin I të këtij punimi është cekur se, aktet e Bashkimit me fuqi detyruese, të drejtpërdrejtë, janë Rregulloret dhe Vendimet. Mund të ndodhë që, institucionet e Bashkimit të nxjerrin një Rregullore ose Vendim, që iu drejtohet një ose disa Shteteve Anëtare dhe që në bazë të këtyre akteve, Shtetet Anëtare janë të detyruara që të marrin masa të brendshme legjislative për zbatimin e tyre. Në qoftë se, Shteti Anëtar, nuk merr masat e nevojshme legjislative të kërkuara nga Rregullorja ose Vendimi përkatës, atëherë, Këshilli Evropian, me unanimitet, merr një vendim me anë të të cilit e detyron Shtetin Anëtar, që të marrë masat konkrete të brendshme legjislative.

Kundër këtij vendimi të Këshillit mund të paraqesë padi Shteti Anëtar, padi e cila shqyrtohet nga ana e Gjykatës së Përgjithshme, në bazë të rregullave dhe procedurës së përcaktuar nga Statuti për këtë Gjykatë. Shteti Anëtar që ngren një padi të tillë duhet që të provojë se, i ka marrë të gjitha masat e brendshme legjislative që i kërkohej nga Rregullorja ose Vendimi dhe që për pasojë, vendimi i marrë nga Këshilli është i pabazuar. Në këtë rast, duhet të kemi parasysh se, Shteti Anëtar, nuk mund të pretendojë që, nuk i ka marrë masat e nevojshme legjislative për zbatimin e aktit të detyrueshëm të nxjerrë nga institucionet e Bashkimit Evropian, për shkak të pengesave që ai mund të ketë në lidhje me organizimin e brendshëm administrativ të tij, siç mund të jetë ndarja në rajone apo lande, ose dhe autonomi të veçanta që mund të gëzojnë pjesë të caktuara të territorit apo popullsisë së tij.

2.3. Gjykata e Shërbimit Civil, veçoritë dhe juridiksioni i saj.

Gjykata e Shërbimit Civil, është një organ gjyqësor i pavarur që funksionon brenda sistemit gjyqësor të Bashkimit Evropian. Organizimi, përbërja dhe kompetencat e kësaj Gjykate, janë përcaktuar në 257 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, si dhe në Statutin e Gjykatës së Drejtësisë. Gjykata e Shërbimit Civil, paraqet disa veçori specifike, në krahasim me organet e tjera gjyqësore të Bashkimit, si në pikëpamje të kohës së fillimit të veprimtarisë së saj, ashtu edhe në pikëpamje të mënyrës së emërimit të gjyqtarëve të kësaj Gjykate, si dhe të objektit të veprimtarisë së saj dhe për këtë arsye, është vendosur që të trajtohet në një çështje të veçantë nga ana ime.

Në lidhje me kohën e fillimit të veprimtarisë së kësaj Gjykate, si datë e fillimit të veprimtarisë së saj konsiderohet data 22 korrik 2005, datë në të cilën Këshilli Evropian mori vendimin për emërimin e gjyqtarëve të kësaj Gjykate. Megjithatë,

pavarisht nga fakti se, juridikisht, si datë e fillimit të veprimtarisë së kësaj Gjykate, konsiderohet data 22 korrik 2005, si datë e krijimit të saj, është data 2 nëntor 2004, datë në të cilën Këshilli mori një vendim për krijimin e Gjykatës së Shërbimit Civil. Si bazë ligjore për krijimin e kësaj Gjykate, shërbeu neni 225a i Traktatit të Komuniteteve Evropiane, aktualisht, neni 257 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian.

Në këtë dispozitë ligjore përcaktohet se, *Parlamenti Evropian dhe Këshilli, me propozim të Komisionit ose të Gjykatës së Drejtësisë, duke respektuar procedurën e zakonshme legislative, mund të krijojnë gjykata të specializuara, për të shqyrtuara dhe vendosur, në shkallë të parë, për disa kategori çështjesh dhe procedurash që u takojnë fushave të caktuara.*⁵³ Gjykatat e specializuara vendosen pranë Gjykatës së Përgjithshme, çka do të thotë se, aktualisht, ato nuk përfaqësojnë institucione juridike më vete të drejtësisë, në kuadër të Bashkimit Evropian, siç janë Gjykata e Drejtësisë dhe Gjykata e Përgjithshme. Por, kjo nuk do të thotë, nga ana tjetër, që këto gjykata të specializuara, nuk janë organe gjyqësore të pavarura për zgjidhjen, në mënyrë të plotë dhe përfundimtare, të çështjeve që përfshihen në juridiksionin e tyre.

Një mënyrë tjetër për krijimin e gjykatave të specializuara, sipas dispozitës së mësipërme, është që Parlamenti Evropian dhe Këshilli, të veprojnë përmes Rregulloreve të caktuara për krijimin e gjykatave të specializuara, mënyrë e cila nuk është përdorur ende, deri tani, nga këto institucione. Siç u tha më lart, Gjykata e Shërbimit Civil, deri tani është gjykata e vetme e specializuar që funksionon në kuadër të pushtetit gjyqësor të Bashkimit Evropian, megjithatë, gjasat janë që ajo të mos jetë e vetme edhe për shumë kohë. Kjo për faktin se, edhe gjykata të tjera të specializuara, pritet që të krijohen shumë shpejt në të ardhmen, madje për njërin prej tyre, përpjekjet për krijimin e saj, kanë filluar që në vitin 2003. *Është fjala për krijimin e Gjykatës së Patentave, për të cilën Komisioni Evropian me datë 23 dhjetor 2003, ka miratuar një vendim, i cili përmban dy propozime për krijimin e kësaj Gjykate:*

a) Sipas propozimit të parë, Komisioni kërkon që t'i jepet juridiksion Gjykatës së Drejtësisë, për të vendosur në lidhje me këto çështje:

- me shkeljet ose vlefshmërinë e Patentave të Komunitetit Evropian dhe të certifikatës së mbrojtjes suplementare të Komunitetit;
- me të drejtat që kanë të bëjnë me përdorimin e shpikjes pas publikimit të aplikimit të Patentës së Komunitetit;
- me të drejtën bazuar në përdorimin prioritar të shpikjes, masave provizore dhe masave mbrojtëse;
- me mbrojtjen e të dhënave në lidhje me patentat, përcaktimi i dëmeve dhe kompensimeve në situatat kur është e nevojshme një gjë e tillë;
- me urdhërat e pagimit të gjobave në çështjet e mospajtimit me një vendim ose urdhër që përbën një detyrim për të vepruar ose për t'iu përmbajtur aktit.

⁵³ Paragrafi i parë i nenit 257 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, parashikon: *“Parlamenti Evropian dhe Këshilli, sipas procedurës së zakonshme legislative, mund të krijojnë gjykata të specializuara, të cilat vendosen pranë Gjykatës së Përgjithshme për të dëgjuar dhe vendosur në shkallë të parë për disa kategori të caktuara çështjesh dhe procedurash që u takojnë fushave të caktuara. Parlamenti Evropian dhe Këshilli veprojnë përmes rregulloreve ose me propozim të Komisionit pasi konsultohen me Gjykatën e Drejtësisë ose me kërkesë të Gjykatës së Drejtësisë pasi konsultohen me Komisionin”.*

b) Sipas propozimit të dytë, Komisioni propozon që të krijohet një trupë gjyqësore e veçantë e quajtur Tribunali i Patentave të Komunitetit, i cili do të gjykonte në shkallë të parë, të gjitha çështjet e përmendura më sipër, që kishin lidhje me patentat e Komunitetit Evropian, brenda organizimit të Gjykatës së Drejtësisë. Ky propozim i dytë përmban edhe dispozita të tjera sipas të cilave, Gjykata e Përgjithshme, do të gjykojë si instancë e dytë dhe e fundit, ankimet kundër vendimeve të dhëna nga Tribunali i Patentave. Kundër vendimet të dhëna nga Gjykata e Përgjithshme, e cila kishte shqyrtuar një çështje, mbi bazën e ankimit të bërë ndaj vendimeve të Tribunalit të Patentave, mund të lejohet që të bëhet ankim, vetëm për raste përjashtimore dhe vetëm nga ana e Avokatit të Përgjithshëm, kur ekziston rrezik serioz, për cënimin e uniformitetit të së drejtës së Bashkimit Evropian.

Përsa i përket juridiksionit të Gjykatës së Shërbimit Civil, ai është përcaktuar në Shtojcën nr. 1, të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë, Shtojcë, e cila është pjesë përbërëse e Statutit, si dhe ka të njëjtën vlerë juridike, po ashtu, si Statuti dhe Traktatet Themeluese. Në këtë Shtojcë të Statutit, e cila përbëhet gjithësej nga 13 dispozita, është rregulluar, jo vetëm çështja e juridiksionit të kësaj Gjykate, por, edhe statusi i Gjyqtarëve të saj, i cili përfshin, mënyrën e emërimit dhe të largimit nga detyra, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të saj.

Sipas dispozitave të mësipërme, Gjykata e Shërbimit Civil, ka si juridiksion që të shqyrtojë dhe të vendosë për të gjitha mosmarrëveshjet që lindin, ndërmjet Bashkimit Evropian dhe nëpunësve të tij, ku, përfshihen edhe mosmarrëveshjet e lindura ndërmjet të gjitha organeve dhe agjensive të Bashkimit Evropian nga njëra anë dhe nëpunësve të këtyre organeve ose axhensive nga ana tjetër.⁵⁴ Nisur nga juridiksioni që ka kjo Gjykatë, mund të konkludojmë se, Gjykata e Shërbimit Civil, është një “gjykatë që ka për kompetencë për të zgjidhur dhe vendosur, për të gjitha mosmarrëveshjet e punës që lindin ndërmjet punëdhënësit që është Bashkimi Evropian dhe organet ose agjensitë e këtij Bashkimi, nga njëra anë dhe punëmarrësve që janë të gjithë nëpunësit ose punonjësit që punojnë pranë Bashkimit Evropian dhe organeve ose agjensive të tij, nga ana tjetër”.

Kur themi se, Gjykata e Shërbimit Civil ka juridiksion për të shqyrtuar dhe vendosur për të gjitha mosmarrëveshjet e punës që lindin ndërmjet Bashkimit Evropian dhe organeve dhe agjensive të tij, me cilësinë e punëdhënësit dhe personave që ofrojnë aftësitë e tyre fizike dhe mendore, pra ofrojnë punën e tyre pranë Bashkimit dhe institucioneve të tij, në cilësinë e punëmarrësit, mosmarrëveshjet më të rëndësishme, janë mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë më largimin nga puna ose me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës të këtyre nëpunësve ose punonjësve të Bashkimit Evropian. Megjithatë, edhe pse është i vertetë fakti se, mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës së nëpunësve të Bashkimit dhe të organeve ose agjensive të tij, përbëjnë pjesën më të madhe të volumit të punës së Gjykatës së Shërbimit Civil, kjo nuk do të thotë se, kjo Gjykatë në punën e saj, shqyrton vetëm këtë kategori mosmarrëveshjesh.

⁵⁴ Neni 1 i Shtojcës 1 të Statutit të Gjykatës së Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian parashikon:

“Gjykata e Shërbimit Civil e Bashkimit Evropian (në vijim Gjykata e Shërbimit Civil) ka juridiksion fillestar për mosmarrëveshjet ndërmjet Bashkimit dhe nëpunësve të tij të përmendur në nenin 270 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, duke përfshirë mosmarrëveshjet ndërmjet të gjithë organeve ose agjensive dhe nëpunësve të tyre, në lidhje me të cilat kompetenca i është dhënë Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian”.

Përkundrazi, koncepti që Gjykata e Shërbimit Civil shqyrton dhe vendos për të gjitha mosmarrëveshjet e punës, që lindin ndërmjet Bashkimit Evropian dhe nëpunësve të tij, është një koncept më i gjerë dhe përfshin edhe çështje të tjera, përveç çështjes së ndërprerjes së marrëdhënieve të punës. Disa nga çështjet për të cilat ka juridiksion kjo Gjykatë, që janë të lidhur me marrëdhëniet e punës, përveç çështjes së ndërprerjes së këtyre marrëdhënieve, mund të përmendim:

- çështjet që kanë të bëjnë me kushtet e punës dhe pushimit të punëmarrësve;
- çështjet që kanë të bëjnë me pagën dhe shpërblimet e punës;
- çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë dhe mbrojtjen në punë;
- çështjet që lidhen me formimin dhe kualifikimin profesional të nëpunësve;
- çështjet që kanë të bëjnë me liritë sindikale dhe të drejtën e grevës.

Në lidhje me përbërjen e Gjykatës së Shërbimit Civil, duhet theksuar se, aktualisht ajo përbëhet nga shtatë gjyqtarë. Megjithatë, është parashikuar mundësia që, ky numër të shtohet, me kërkesë të Gjykatës së Drejtësisë. Vendimi për shtimin e numrit të gjyqtarëve të kësaj Gjykate, merret nga Këshilli i Bashkimit Evropian, mbi bazën e propozimit të bërë nga Gjykata e Drejtësisë.

Gjyqtarët e Gjykatës së Shërbimit Civil, po ashtu si gjyqtarët e Gjykatës së Përgjithshme dhe të Gjykatës së Drejtësisë, emërohen për një periudhë gjashtëvjeçare. Me mbarimin e mandatit gjashtëvjeçar, ata kanë të drejtë që të riemërohen në të njëjtën detyrë, sipas procedurës së emërimit të mëparshëm të tyre. Në qoftë se, posti i një gjyqtari të kësaj Gjykate mbetet vakand, për çfarëdo arsye, ky vend vakand plotësohet, me emërimin e një gjyqtari të ri për një periudhë gjashtëvjeçare.

Statusi i gjyqtarëve të Gjykatës së Shërbimit Civil, i cili përfshin garancitë e nevojshme për ushtrimin e funksionit të tyre, si imuniteti nga procesi penal, patundshmëria nga detyra, si dhe shkarkimi i tyre, është i njëjtë me statusin e gjyqtarëve të Gjykatës së Përgjithshme dhe të Gjykatës së Drejtësisë. Një gjë e tillë është e përcaktuar, në mënyrë të shprehur, në nenin 5 të Shtojcës 1 të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë ku thuhet se, dipozitat e Statutit që parashikojnë statusin e Gjyqtarëve të Gjykatës së Drejtësisë dhe të Gjykatës së Përgjithshme, zbatohen edhe për gjyqtarët e Gjykatës së Shërbimit Civil.

Një nga veçoritë me të rëndësishme që lidhet me pozitën e Gjykatës së Shërbimit Civil, në kuadrin e organeve gjyqësore të Bashkimit Evropian dhe që e dallon atë nga Gjykata e Drejtësisë dhe Gjykata e Përgjithshme, është fakti se, procedura e emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës së Shërbimit Civil, është krejt e ndryshme nga procedura që zbatohet për emërimin e Gjyqtarëve të Gjykatës së Përgjithshme dhe të Gjykatës së Drejtësisë. Më sipër kemi sqaruar se, Gjyqtarët e Gjykatës së Përgjithshme dhe të Gjykatës së Drejtësisë emërohen me marrëveshje të përbashkët të Shteteve Anëtare. Në ndryshim nga kjo procedurë, gjyqtarët e Gjykatës së Shërbimit Civil emërohen nga Këshilli i Bashkimit Evropian, me unanimitet, pas konsultimit që ky Këshill bën me Komitetin e krijuar posaçërisht për këtë qëllim. Në emërimin e gjyqtarëve të mësipërm, Këshilli mban parasysh, për aq sa është e mundur, një shpërndarje gjeografike sa më të gjerë, me qëllim që në këtë Gjykatë, të përfaqësohen sa më shumë Shtete Anëtare, si dhe sa më shumë sisteme juridike të Shteteve Anëtare të ndryshme.⁵⁵

⁵⁵ Neni 3, pika 1 e Shtojcës 1 të Statutit të Gjykatës së Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian parashikon:

Në dispozitat e Statutit të Gjykatës së Drejtësisë janë përcaktuar edhe kushtet ligjore që duhet të plotësojë që të emërohet gjyqtar i Gjykatës së Shërbimit Civil, kushte të cilat janë:

- personi duhet të jetë qytetar i Bashkimit Evropian;
- personi duhet që të ketë aftësitë e nevojshme që kërkohen për t'u emëruar si gjyqtar në gjykatat e brendshme të Shteteve Anëtare;
- personi duhet që të ketë treguar cilësitë e duhura se është i pavarur në kryerjen e funksionit të tij si gjyqtar ose personi duhet të ketë cilësi të tilla që, për pavarësinë e tij, nuk mund të ketë asnjë dyshim.⁵⁶

Emërimi i një personi si gjyqtar i Gjykatës së Shërbimit Civil, zhvillohet sipas një procedure të caktuar, para se të bëhet emërimi i tij përfundimtar nga Këshilli. Kjo procedurë fillon me shpalljen e vendit vakand si gjyqtar pranë kësaj Gjykate, shpallje e cila iu njoftohet të gjithë personave të interesuar. Më pas, Këshilli, bazuar në një rekomandim të Gjykatës së Drejtësisë, përcakton kushtet dhe masat organizative për shqyrtimin e kërkesave të paraqitura ose për shqyrtimin e kandidatave për gjyqtar të kësaj Gjykate.

Kandidaturat e paraqitura, pas verifikohen se plotësojnë kriteret formale-ligjore, i kalojnë për shqyrtim një Komiteti të posaçëm për emërimet e gjyqtarëve të Gjykatës së Shërbimit Civil. Ky Komitet përbëhet nga shtatë persona, të cilët zgjidhen mes ish anëtarëve të Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme dhe juristëve me aftësi të njohura profesionale. Procedura e emërimit të anëtarëve të këtij Komiteti, si dhe rregullat për funksionimin e tij, përcaktohen nga Këshilli i Bashkimit Evropian, mbi bazën e një rekomandimi të paraqitur nga Kryetari i Gjykatës së Drejtësisë.

Detyra kryesore e Komitetit të posaçëm për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Shërbimit Civil, është që të japë mendimin mbi përshtatshmërinë e kandidatëve për të kryer detyrën e gjyqtarit pranë kësaj Gjykate. Ky Komitet, mendimit të tij duhet t'i bashkëngjisë edhe listën e emrave të kandidatëve të cilët sipas tij, kanë eksperiencën më të përshtatshme dhe cilësitë më të larta për t'u emëruar si gjyqtar. Numri i kandidatëve me emrat që përmban kjo listë, duhet të jetë, të paktën, dy herë më i madh se numri i gjyqtarëve që do të emërojnë Këshilli.

Mendimi që jep Komiteti i posaçëm për përshtatshmërinë e kandidatit për t'u emëruar si gjyqtar i Gjykatës së Shërbimit Civil, kuptohet se, duke qenë një mendim, nuk është i detyrueshëm për Këshillin, i cili është organi kompetent që bën emërimin e gjyqtarit. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se, mendim i këtij Komiteti, nuk ka vlerë apo është i parëndësishëm. Përkundrazi, praktika e emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës së Shërbimit Civil ka treguar se, dhënia e mendimit pozitiv nga ana e Komitetit për emërimet, është një kusht i nevojshëm, që një person të emërohet si gjyqtar pranë kësaj gjykate.

"Gjyqtarët emërohen nga Këshilli, në përputhje me paragrafin e katërt të nenit 257 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, pas konsultimit me komitetin e parashikuar në këtë nen. Këshilli kur emëron gjyqtarët, siguron përbërje të drejtpeshuar të Gjykatës së Shërbimit Civil me përhapjen me të gjerë të mundshme gjeografike nga radhët e Shteteve Anëtare dhe duke pasur parasysh sistemet juridike kombëtare të përfaqësuara".

⁵⁶ Paragrafi i katërt i nenit 257 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

"Anëtarët e gjykatave të specializuara zgjidhen mes personave për pavarësinë e të cilëve nuk ka dyshime dhe të cilët kanë aftësitë që kërkohen për t'u emëruar në detyra gjyqësore. Ata emërohen nga Këshilli, i cili vendos me unanimitet".

Me sipër shpjeguar se, gjyqtarët e Gjykatës së Shërbimit Civil, ndryshe nga gjyqtarët e Gjykatës së Drejtësisë dhe të Gjykatës së Përgjithshme, emërohen nga ana e Këshillit të Bashkimit Evropian, ndërsa këta të fundit (gjyqtarët e Gjykatës së Drejtësisë dhe të Gjykatës së Përgjithshme) emërohen me marrëveshje të Shteteve Anëtare, sipas parimit një Shtet Anëtar, një Gjyqtar. Në kushtet kur, gjyqtarët e Gjykatës së Shërbimit Civil emërohen nga Këshilli që është një nga institucionet e Bashkimit Evropian dhe jo me marrëveshje të Shteteve Anëtare, mund të shtrohet pyetja, që për gjyqtarët e kësaj Gjykate, Shtetet Anëtare, a kanë hequr dorë nga Sovraniteti i tyre, duke lejuar që këta gjyqtarë të mos emërohen me marrëveshje ndërmjet tyre, por të emërohen nga vetë institucionet e Bashkimit Evropian?

Në lidhje me këtë pyetje, përgjigja është se, pavarësisht nga fakti se gjyqtarët e Gjykatës së Shërbimit Civil, emërohen nga vetë Bashkimi Evropian dhe jo me marrëveshje ndërmjet Shteteve Anëtare, këta të fundit nuk kanë hequr dorë nga Sovraniteti i tyre në çështjen e emërimit të këtyre gjyqtarëve, pasi, duke u nisur nga juridiksioni që ka kjo Gjykatë, ajo shqyrton dhe vendos vetëm për çështje që kanë të bëjnë me mardhëniet e punës, ku punëdhënës janë institucionet e Bashkimit Evropian dhe *ajo nuk ka juridiksion për të vendosur për çështje që mund të prekë, drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, intersat e Shteteve Anëtare*. Pëderisa, në juridiksionin e Gjykatës së Shërbimit Civil, janë vetëm çështje që nuk lidhen me interesat e Shteteve Anëtare, atëherë, në këtë rast, nuk shtrohet, fare për diskutim problemi heqjes dorë nga Sovraniteti kombëtar prej këtyre Shteteve, sepse, ata nuk kanë interes për emërimin e gjyqtarëve të mësipërm, në kushtet kur, këta gjyqtarë nuk kanë juridiksion që të marrin vendime që prekin Sovranitetin e këtyre Shteteve.

Gjyqtarët e Gjykatës së Shërbimit Civil, zgjedhin Kryetarin e Gjykatës mes anëtarëve të kësaj Gjykate, për një mandat tre vjeçar, me të drejtë rizgjedhje. *Në pikëpamje të organizimit dhe funksionimit të saj, kjo Gjykatë mblidhet, si rregull, në dhoma të përbëra nga tre gjyqtarë. Në raste të caktuara, të përcaktuar në Rregulloren e saj të Brendshme, Gjykata e mësipërme, mund të mblidhet në seancë plenare, me pjesëmarrjen e të gjithë gjyqtarëve ose në një dhomë me pesë gjyqtarë ose edhe me një gjyqtar të vetëm.*

Rregulla më të hollësishme për mënyrën e funksionimit të Gjykatës së Shërbimit Civil, përcaktohen me anë të *Rregullores së Brendshme* të kësaj Gjykate. Në Rregulloren e saj përcaktohen, po ashtu, rregullat në lidhje me juridiksionin dhe si dhe kuorumin për seancën plenare. Në këtë Rregullore përcaktohen edhe rregullat që përcaktojnë përbërjen e dhomave dhe caktimin e çështjeve për to.⁵⁷

Në Statut është përcaktuar se, Kryetari i Gjykatës së Shërbimit Civil, kryeson seancën plenare si dhe dhomën me pesë gjyqtarë. Nga ana e tyre, dhomat me tre gjyqtarë kanë të drejtë që të zgjedhin kryetarët e tyre, të cilët kryesojnë çështjet në dhomat respektive. Në qoftë se, Kryetari i Gjykatës së Shërbimit Civil, caktohet si gjyqtar në një dhomë me tre gjyqtarë, ai kryeson çështjen në atë dhomë.

Për realizimin e veprimtarisë së përditshme, Gjykata e Shërbimit Civil, duke mos patur një strukturë organike të veten, mbështetet nga departamentet e Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme. Kryetari i Gjykatës së Drejtësisë ose respektivisht Kryetari i Gjykatës së Përgjithshme, me marrëveshje të përbashkët me

⁵⁷ Pika 4 e nenit 4 të Shtojcës 1 të Statutit të Gjykatës së Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian parashikon:

“Juridiksioni dhe kuorumi për seancën plenare si dhe përbërja e dhomave dhe caktimi i çështjeve në të rregullohet me rregulloren e brendshme”.

Kryetarin e Gjykatës së Shërbimit Civil, vendosin kushtet sipas të cilave, zyrtarë dhe nëpunës të tjerë të Gjykatës së Drejtësisë ose të Gjykatës së Përgjithshme, ofrojnë shërbime të ndryshme, me qëllim që Gjykata e Shërbimit Civil të realizojë funksionin e saj.

Pavarsisht nga fakti se, Gjykata e Shërbimit Civil nuk ka organikë me vete, të veçantë, me nëpunës dhe zyrtarë, që të mundësojnë realizimin e funksioneve të saj, por ajo ndihmohet nga nëpunësit dhe zyrtarët e Gjykatës së Drejtësisë ose të Gjykatës së Përgjithshme, *Gjykata e Shërbimit Civil, ka të drejtë që të emërojë Kancelarin e saj*, si dhe të përcaktojë rregullat e punës për veprimtarinë e tij. Disa nëpunës ose zyrtarë të Gjykatës së Drejtësisë ose të Gjykatës së Përgjithshme, përgjigjen para Kancelarit të Gjykatës së Shërbimit Civil, nën autoritetin e Kryetarit të kësaj Gjykate. Në dispozitat e Statutit të Gjykatës së Drejtësisë është përcaktuar se, *vendimet përfundimtare të Gjykatës së Shërbimit Civil me të cilën ajo ka zgjidhur, në themel, një çështje që është brenda juridiksionit të saj, ose që ka zgjidhur një çështje lëndore ose një çështje procedurale, në lidhje me kompetencën dhe/ose papranueshmërinë e çështjes për gjykim, mund të apelohe përpara Gjykatës së Përgjithshme, brenda dy muajve, duke filluar ky afat nga data e njoftimit të vendimit objekt apelimi.*⁵⁸

Kundër vendimit përfundimtar të Gjykatës së Shërbimit Civil, mund të paraqesin ankim ose apel, palët ndërgjyqëse, si dhe Shtetet Anëtare dhe institucionet e Bashkimit Evropian, pavarsisht nga fakti, nëse, kanë qenë apo jo palë të gjykimit për të cilin është marrë vendimi përfundimtar. Duke u nisur nga rregullimi ligjor që i ka bërë Statuti i Gjykatës së Drejtësisë çështjes së apelimit kundër vendimeve përfundimtare të Gjykatës së Shërbimit Civil, konstatojmë se, kemi dy kategori subjektësh të cilët kanë të drejtë që të bëjnë apel, kundër vendimeve të Gjykatës së Shërbimit Civil:

Së pari: Palët ndërgjyqëse, të cilët kur janë të ndryshme nga Shtetet Anëtare ose institucionet e Bashkimit Evropian, mund të paraqesin apel, vetëm nëse preken, drejtpërdrejt nga vendimi i Gjykatës së Shërbimit Civil;

Së dyti: Shtetet Anëtare ose institucionet e Bashkimit Evropian, të cilët kanë të drejtë që të paraqesin, në çdo rast apel, pavarsisht nga fakti, nëse, ata janë apo jo palë ndërgjyqëse, si dhe pavarsisht nga fakti nëse preken apo jo, drejtpërdrejt nga vendimi i Gjykatës.

Përveç çështjes së afatit, si dhe të palëve që kanë të drejtë që të paraqesin apel kundër vendimeve të Gjykatës së Shërbimit Civil, në Statut janë parashikuar edhe *shkaqet e apelit ndaj vendimeve të kësaj Gjykate, shkaqe të cilat, në mënyrë të përmbledhur janë:*

i. apelimi mund të bëhet, vetëm për çështje të interpretimit të ligjit material ose procedural;

ii. apelimi mund të bëhet për mungesë të kompetencës së Gjykatës së Shërbimit Civil;

iii. apelimi mund të bëhet për shkelje të procedurës nga ana e Gjykatës, e cila ka prekur interesat e apeluesit;

iv. apelimi mund të bëhet për shkelje të së drejtës së Bashkimit Evropian;

⁵⁸ Paragrafi i parë i nenit 9 të Shtojcës 1 të Statutit të Gjykatës së Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian parashikon:

“Vendimet e formës së prerë të Gjykatës së Shërbimit Civil dhe vendimet e kësaj Gjykate që zgjidhin pjesërisht çështje lëndore ose që zgjidhin një çështje procedurale në lidhje me një kërkesë për mungesë kompetence ose papranueshmëri mund të apelohe para Gjykatës së Përgjithshme, brenda dy muajve nga njoftimi i vendimit që apelohe”.

v. *apelimi nuk lejohet në lidhje me shumën e shpenzimeve gjyqësore, si dhe në lidhje me palën që është urdhëruar që t'i paguajë ato.*⁵⁹

Vendimi marrë nga Gjykata e Përgjithshme për çështjet e gjykuara nga Gjykata e Shërbimit Civil, për të cilat është paraqitur apel, janë të formës së prerë. Kjo do të thotë se, ata bëhen të ekzekutueshme nga organet kompetente, si dhe ndaj këtyre vendimeve nuk mund të lejohet ankim. Megjithatë, si përjashtim nga rregulli i mësipërm, Traktatet Themeluese përcaktojnë se, *kundër vendimve të Gjykatës së Përgjithshme, me të cilat është shqyrtuara apeli i paraqitur për vendimet e marra nga Gjykata e Shërbimit Civil, mund të ushtrohet ankim në Gjykatën e Drejtësisë, vetëm në raste të jashtëzakonshme, kur ka rrezik serioz, që vendimi i marrë nga Gjykata e Përgjithshme, të çënojë rëndë unifikimin e të drejtës së Bashkimit Evropian.*

Duke iu referuar parashikimit ligjor të mësipërm, rezulton se, që të lejohet ankim kundër vendimeve të Gjykatës së Përgjithshme, me të cilin është shqyrtuar një vendim i Gjykatës së Shërbimit Civil, duhet të plotësohen, në të njëjtën kohë, tre kushte:

- a) çështja duhet të paraqesë një rëndësi të veçantë;
- b) Statuti i Gjykatës së Drejtësisë duhet të lejojë që ndaj këtij vendimi, të bëhet ankim në Gjykatën e Drejtësisë;
- c) duhet që vendimi i marrë nga Gjykata e Përgjithshme, të vendosë, në rrezik serioz pajtueshmërinë dhe unifikimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian.⁶⁰

2.4. Procedura e gjykimit para Gjykatës së Drejtësisë.

Përpara se të trajtoj rolin që ka Gjykata e Drejtësisë në kuadrin e rendit juridik evropian, mendoj se është e rëndësishme të sqarohet se, cila është procedura e gjykimit që zhvillohet nga kjo Gjykatë. Kur flasim për procedurë të gjykimit që zhvillohet para Gjykatës së Drejtësisë, do të kemi parasysh të tre organet e kësaj Gjykate, pra, si Gjykatën e Drejtësisë, ashtu edhe Gjykatën e Përgjithshme, si dhe Gjykatën e Shërbimit Civil. Kjo për faktin se, duke iu referuar dispozitave të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë, rezulton se, në vija të përgjithshme, procedura e gjykimit është e ngjashme, si për Gjykatën e Drejtësisë, ashtu edhe për Gjykatën e Përgjithshme, dhe për Gjykatën e Shërbimit Civil.

Prandaj, në këtë çështje, sa herë që do të flasim për procedurë të gjykimit para gjykatës së Drejtësisë, do të kemi parasysh jo vetëm procedurën që zhvillohet para kësaj Gjykate, por edhe procedurën që zhvillohet para Gjykatës së Përgjithshme dhe Gjykatës së Shërbimit Civil. Megjithatë, pavarësisht se procedurat që zhvillohen para këtyre Gjykatave, në thelb, janë të ngjashme, secila prej këtyre procedurave paraqet edhe specifikat e veta, që e dallon nga procedura që zhvillohet nga një Gjykatë tjetër.

⁵⁹ Neni 11 i Shtojcës 1 të Statutit të Gjykatës së Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian parashikon:

"1. Apeli në Gjykatën e Përgjithshme përfshin vetëm çështje të interpretimit ligjor. Apeli bëhet për mungesë kompetence të Gjykatës së Shërbimit Civil, për shkelje të procedurës përpara saj që prek interesat e apellesit, si dhe për shkeljen e të drejtës së Bashkimit nga Gjykata.

2. Nuk bëhet ankim në lidhje me shumën e shpenzimeve apo palën që është urdhëruar t'i paguajë ato".

⁶⁰ Paragrafi i dytë i pikës 2 të nenit 256 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian parashikon: *"Vendimet që nxjerrë Gjykata e Përgjithshme sipas këtij paragrafi mund të shqyrtohen, në mënyrë të jashtëzakonshme nga Gjykata e Drejtësisë, sipas kushteve dhe brenda kufijve që përcakton Statuti, kur ka rrezik serioz për unifikimin ose pajtueshmërinë e legjislacionit të Bashkimit që preket".*

Kështu, në përgjithësi, duke u nisur nga rëndësia më e madhe e çështjeve që shqyrton, procedura që zhvillohet para Gjykatës së Drejtësisë, është më formale dhe më solemne, se procedura që zhvillohet para Gjykatës së Përgjithshme dhe sidomos se procedura që zhvillohet para Gjykatës së Shërbimit Civil. Po ashtu, duhet shtuar edhe fakti se, procedura që zhvillohet para Gjykatës së Drejtësisë, përmban edhe të gjithë elementët e nevojshëm që përbëjnë këtë procedurë, siç është mendimi i Avokatit të Përgjithshëm dhe për këtë arsye, nga ana studimore, është edhe procedura që është më e plotë për t'u pasqyruar në një punim shkencor.

Rregullat e hollësishme mbi procedurën e gjykimit para Gjykatës së Drejtësisë, janë parashikuar në Statutin e kësaj Gjykate, si dhe në Rregulloren e Procedurës. Duke u nisur nga përmbajtja e dispozitave të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë, konstatohet se, procedura e gjykimit para Gjykatës së Drejtësisë, është e ndryshme, në varësi të faktit nëse jemi para një Padie të paraqitur nga ana e një Shteti Anëtar, e një institucioni të Bashkimit Evropian ose nga një person fizik ose juridik privat, apo jemi para një Gjykimi Paraprak, ose Procedura Paragjykimore, e cila zbatohet në rastet kur një gjykatë kombëtare e pezullon gjykimin, sepse mendon se një dispozitë ligjore e Shtetit Anëtar, ose një normë apo akt i institucioneve ose organeve të Bashkimit Evropian, bie në kundërshtim me të drejtën e Bashkimit Evropian.

Në këtë çështje, fillimisht, do të trajtoj procedurën që zhvillohet para Gjykatës së Drejtësisë në rastet e Padive që paraqiten para saj dhe më pas, do të trajtoj procedurën që zhvillohet për Çështjet Paragjykimore. *Që të fillojë procedura për gjykimin e një çështjeje në rastin e Padive, Statuti i Gjykatës së Drejtësisë parashikon se, subjekti, i cili mund të jetë një Shtet Anëtar, një institucion i Bashkimit Evropian ose një person fizik ose juridik privat, duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim, drejtuar Kancelarit të Gjykatës së Drejtësisë.* Kjo kërkesë me shkrim, e cila në thelb, por edhe për arsye studimore, njihet me emrin *Padi*, që të jetë e rregullt, nga ana procedurale, duhet të përmbajë këto elementë:

- emrin, mbiemrin, gjeneralitete e plotë, si dhe adresën e saktë të kërkuarit;
- emrin, mbiemrin, gjeneralitete e plotë, si dhe adresën e saktë të palës ose palëve kundër të cilëve paraqitet kërkesa;
- objektin e mosmarrëveshjes;
- formën e urdhërit që kërkohet të lëshohet nga Gjykata e Drejtësisë, në përfundim të gjykimit, kur ajo vendos zgjidhjen në themel të çështjes;
- një deklaratë të shkurtër mbi bazën ligjore ku bazohet kërkesa;
- përcaktimin e masës konkrete ligjore që kërkohet të shfuqizohet në rastet kur kërkesa paraqitet për shfuqizimin e masës ligjore;
- provat shkruese që tregojnë datën kur institucioni i Bashkimit Evropian nuk ka vepruar, në rastet kur kërkesa ngrihet për mosveprim të institucionit;
- nënshkrimin e palës që ka paraqitur kërkesën.⁶¹

Kërkesa me shkrim që paraqitet para Kancelarit të Gjykatës së Drejtësisë, përveç elementeve të mësipërm procedural, duhet të shoqërohet edhe me të gjitha

⁶¹ Paragrafi i parë i nenit 21 të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian parashikon: *"Një çështje i paraqitet Gjykatës së Drejtësisë me anë të një kërkesë me shkrim drejtuar Kancelarit. Kërkesa përmban emrin e kërkuarit, adresën e banimit të përhershëm dhe përshkrimin e palës nënshkruese, emrin e palës ose emrat e palëve kundër të cilave është bërë kërkesa, objektin e mosmarrëveshjes, formën e urdhërit që kërkohet dhe një deklaratë të shkurtër të bazës ligjore ku bazohet kërkesa".*

dokumentet provuese, në atë kopje sa janë palët ndërgjyqëse. Në qoftë se, kërkesa e paraqitur është me të meta, pra, nuk përmban një ose disa nga elementët e treguar më sipër, ose nuk është e shoqëruar me dokumentet e nevojshme, Kancelari merr vendim me shkrim, për kthimin e kërkesës për të meta, duke i kërkuar në vendim palës që ka paraqitur kërkesën, plotësimin e të metave ose paraqitjen e dokumenteve, brenda një afati të arsyeshëm.

Me plotësimin e të metave ose paraqitjen e dokumenteve të nevojshme, brenda afatit të caktuar, kërkesa konsiderohet si e paraqitur në datën e fillimit, por të drejtat e palës nuk parashkruhen edhe sikur këto dokumente të sigurohen pas afatit kohor, që është përcaktuar për paraqitjen e kërkesës. Në rast të kundërt, nëse pala nuk i plotëson të metat e kërkesës brenda afatit të caktuar, atëherë, kërkesa e paraqitur kthehet pas, pa veprime dhe konsiderohet se nuk është paraqitur ndonjëherë për gjykim, para Gjykatës së Drejtësisë.

Pas paraqitjes së kërkesës me shkrim nga ana e palës kërkuuese, kjo kërkesë së bashku me dokumentet provuese, i njoftohet palës së paditur, si dhe palëve të tjera ndërgjyqëse, nëse ka të tilla nga ana e Kancelarit të Gjykatës. Rregulla të hollësishme, të metjeshme, për zhvillimin e procedurës para Gjykatës së Drejtësisë, janë përcaktuar në Rregulloren e Procedurës së Gjykimit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, e njohur shkurtimisht si Rregullorja e Procedurës.

Duke iu referuar dispozitave të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë dhe Rregullores së Procedurës, konstatohet se, *procedura e gjykimit para Gjykatës së Drejtësisë, përbëhet nga dy faza ose pjesë; pjesa me shkrim dhe pjesa me gojë ose orale. Pjesa me shkrim fillon që pas momentit të paraqitjes së kërkesës me shkrim nga ana e palës, e cila, në rastet kur është e rregullt nga pikpamja procedurale dhe e shoqëruar me dokumentet e nevojshme, i njoftohet palës së paditur si dhe palëve të tjera ndërgjyqëse, kur ka të tilla, nga ana e Kancelarit të Gjykatës, së bashku me dokumentet provuese që e shoqërojnë kërkesën. Pas bërjes së këtij njoftimi, pala e paditur si dhe palët e tjera ndërgjyqëse, kanë të drejtë që të depozitojnë mbrojtjen e tyre, brenda një muaji nga marrja e njoftimit.*

Përveç depozitimit të mbrojtjes nga ana e palës së paditur ose e palëve të tjera, procedura me shkrim përfshin edhe komunikimet me palët dhe institucionet e Bashkimit Evropian, vendimet e të cilit janë në diskutim, përfshin, po ashtu edhe kërkesat, parashtrimin e argumenteve, mbrojtjen konstatimet dhe përgjigjet, si dhe të gjitha shkresat dhe dokumentet mbështetëse, që palët ndërgjyqëse paraqesin në funksion të mbrojtjes së interesave të tyre.⁶² Komunikimi ndërmjet palëve bëhet me anë të Kancelarit të Gjykatës, sipas radhës dhe brenda kohës së caktuar nga Rregullorja e Procedurës. Po ashtu, palëve iu lejohej që, brenda afateve të caktuara nga Kryetari i Gjykatës së Drejtësisë, të paraqesin përgjigje dhe kundërpërgjigje, në lidhje me çështjen objekt gjykimi.

Pasi palët kryejnë një ose disa nga komunikimet me shkrim ndërmjet njëra-tjetrës dhe gjykatës, që ato i çmojnë të rëndësishme, në varësi të çështjes konkrete, përfundin pjesa më shkrim e procedurës dhe kalohet në pjesën me gojë të saj. *Përpara*

⁶² Paragrafi i dytë i nenit 20 të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian parashikon: *“Procedura me shkrim përfshin komunikimin me palët dhe institucionet e Bashkimit vendimet e të cilit janë në diskutim, përfshin kërkesat, parashtrimin e argumenteve, mbrojtjen, konstatimet dhe përgjigjet, nëse ka, si dhe të gjitha shkresat dhe dokumentet mbështetëse ose kopje të noterizuara të tyre”.*

se palët të paraqiten në pjesën me gojë ose verbale të procedurës, sipas nenit 44 të Rregullores së Procedurës, Kryetari i Gjykatës së Drejtësisë, cakton një Gjyqtar Relator, i cili, ka për detyrë që të përgatisë një Raport Paraprak.

Ky Raport duhet të përmbajë:

- rekomandime për marrjen e masave paraprake nga Gjykata, nëse një gjë e tillë është e nevojshme;
- propozimin, nëse, çështja do të gjykohet me trup gjykues të përbërë nga tre apo pesë gjyqtare ose nga Dhoma e Madhe;
- propozimin, nëse është e nevojshme që të mos zhvillohet pjesa me gojë ose orale e procedurës;
- propozimin nëse për çështjen konkrete, duhet marrë apo jo mendimi i Avokatit të Përgjithshëm.

Raporti paraprak i Gjyqtarit Relator i paraqitet Mbledhjes së Përgjithshme të Gjykatës së Drejtësisë, e cila vendos në lidhje me veprimet konkrete që do të ndërmerren për zgjidhjen e çështjes konkrete. Mbledhja e Përgjithshme për veprimet që do të ndërmerren, vendos pasi të ketë dëgjuar Avokatin e Përgjithshëm.

Në Rregulloren e Procedurës përcaktohet se, caktimi i Gjyqtarit Relator për hartimin e Raportit Paraprak, bëhet nga ana e Kryetarit të Gjykatës, vetëm pasi të ketë kaluar afati i vendosur për palët për depozitimin e kundërpërgjigjeve me shkrim. Kryetari i Gjykatës cakton Gjyqtarin Relator edhe në rastet kur palët deklarojnë me shkrim se heqin dorë nga depozitimi i kundërpërgjigjeve me shkrim, si dhe kur është kërkuar procedura e përshpejtuar, ku, në këtë rast Kryetari i Gjykatës, përveç caktimit të Gjyqtarit Relator, cakton edhe datën për zhvillimin e pjesës me gojë të procedurës.

Më sipër përmendëm se, në Raportin Paraprak të gjyqtarit relator, një nga pjesët më të rëndësishme të tij, ishte dhënia e rekomandimeve për marrjen e masave paraprake nga Gjykata. Këto *Masa Paraprake, të cilat njihen edhe me emrin Hetimet Paraprake të Gjykatës*, përfshijnë në vetvete, një ose disa nga veprimet e mëposhtme:

- i. paraqitjen personale të palëve;
- ii. kërkesë për informacion;
- iii. kërkesë për paraqitjen e dokumenteve;
- iv. dëshmitë gojore para Gjykatës;
- v. kryerjen e një akti ekspertimi;
- vi. kqyerjen e vendeve apo sendeve.

Procedura e kryerjes së secilit prej këtyre veprimeve përcaktohet në Rregulloren e Procedurës, por edhe në dispozitat e Statutit të Gjykatës së Drejtësisë. *Kështu në lidhje me shqyrtimin e dokumenteve ose të provave shkresore, Statuti parashikon që Gjykata e Drejtësisë, ka të drejtë që t'u kërkojë palëve ndërgjyqëse, që të paraqesin të gjitha dokumentet si dhe të japin çdo informacion, me shkrim që Gjykata e konsideron të nevojshëm për zgjidhjen e çështjes.*

Kjo e drejtë e Gjykatës për të kërkuar nga palët dokumentet dhe informacionin e nevojshëm që lidhet me çështjen, nuk nënkupton që, pala është e detyruar, forcërisht që të paraqesë ato. Përkundrazi, në këtë proces gjyqësor, ashtu si dhe në çdo lloj procesi tjetër civil, pala vepron ashtu si ajo e çmon të arsyeshme për mbrojtjen e interesave të saj në gjykim, çka do të thotë se, pala, në funksion të mbrojtjes së interesave të saj, mund të mos i dorëzojë Gjykatës dokumentet që ajo kërkon, ose mund të mos i japë informacionin e duhur në lidhje me çështjen. Megjithatë, mos dhënia Gjykatës e dokumenteve dhe informacionit të nevojshëm nga ana e palës, mbahet shënim, në mënyrë formale nga Gjykata dhe mund të sjellë efekte negative

për palën që ka refuzuar. Kjo për faktin se, *Gjykata refuzimin e palës për të dhënë dokumentet ose/dhe informacionin e nevojshëm, së bashku me aktet dhe sjelljet e tjera, mund ta vlerësojë si pranim të palës që ka refuzuar të faktit, për të cilin flasin dokumentet ose informacioni i kërkuar.*

Në funksion të zgjidhjes së çështjes Gjykata e Drejtësisë ka të drejtë që t'u kërkojë dokumente dhe informacionin e nevojshëm jo vetëm palëve, por edhe Shteteve Anëtare, institucioneve organeve, zyrave dhe agjensive të Bashkimit Evropian, të cilat nuk janë palë në çështje. Shtetet Anëtare dhe institucionet dhe organet e Bashkimit, në ndryshim nga palët ndërgjyqëse, janë të detyruara që t'i japin informacionin e nevojshëm ose t'i dorëzojnë Gjykatës së Drejtësisë, dokumentet që ajo mendon se janë të nevojshme për zgjidhjen e çështjes.

Përveç informacioneve me shkrim dhe dokumenteve të ndryshme, për zgjidhjen e një çështje konkrete, Gjykata e Drejtësisë mund të ketë nevojë që të marrë mendime të specializuara nga fusha të ndryshme të shkencës, artit dhe teknikës, mendime të cilat jepen vetëm nga ana e ekspertëve përkatës. Për këtë arsye, në Statut është parashikuar që, Gjykata, ka të drejtë, që në çdo fazë të procedurës, të kërkojë opinionin e një eksperti, i cili mund të jetë një institucion, organ, komitet, organizatë apo individ i caktuar prej saj.⁶³

Eksperti i caktuar prej Gjykatës së Drejtësisë, qoftë ai individ apo institucion ose organizatë, është i detyruar që të kryejë detyrën e caktuar dhe nuk mund ta refuzojë kryerjen e detyrës, pa patur shkaqe të përligjura. Për realizimin e detyrës së ekspertit, individit ose organizatës, sigurisht që do të marrë shpërblimin përkatës, në përputhje me punën ose shërbimin e kryer. Individit ose organizatës e caktuar me detyrën e ekspertit, po ashtu, ka detyrimin që të bëjë ekspertim të drejtë, me qëllim nxjerrjen e së vertetës, si dhe duhet që të ruajë sekretin për faktet dhe të dhënat e mësuara, për shkak të detyrës si ekspert. Eksperti, qoftë ai individ ose organizatë, mendimin e tij mbi çështjen e jep, zakonisht me shkrim, konkretisht me Aktin e Ekspertimit. Megjithatë, në varësi nga natyra dhe lloji i çështjes, mund të pranohet që, mendimin e tij, eksperti ta japë edhe me gojë para gjykatës dhe në prani të palëve. Në këtë rast, mendimi i ekspertit regjistrohet në procesverbal dhe ka të njëjtën vlerë, ashtu si dhe akti i ekspertimit.

Pas paraqitjes së aktit të ekspertimit me shkrim, para Gjykatës së Drejtësisë, mund që të lind nevoja që eksperti të dëgjohet në seancë gjyqësore, me kërkesë të paleve ose edhe kryesisht nga Gjykata. Për këtë qëllim, eksperti ftohet që të paraqitet para Gjykatës, për të dhënë shpjegime në lidhje me aktin e ekspertimit, si dhe për t'i përgjigjur pyetjeve të palëve ose/dhe Gjykatës. Për thirrjen dhe pyetjen e ekspertit, zbatohen të njëtat rregulla si edhe për thirrjen dhe pyetjen e dëshmitarëve. Kjo do të thotë se, eksperti pasi jep shpjegimet që ai i çmon të nevojshme për aktin e ekspertimit, ai fillimisht pyetet nga pala që e ka kërkuar aktin e ekspertimit, më pas nga pala kundërshtarë dhe së fundi nga Gjykata. Çdo pyetje e bërë nga palët ose/dhe Gjykata, në lidhje me aktin e ekspertimit, si dhe çdo përgjigje e dhënë nga eksperti, regjistrohet në procesverbal dhe konsiderohet si pjesë e aktit të ekspertimit.

Gjatë çështjeve të ndryshme mund të lind nevoja që të kryhet një akt ekspertimi ose të pyetet një dëshmitar, i cili, ndodhet shumë larg ose e ka të pamundur që të paraqitet para Gjykatës. Në një rast të tillë, Gjykata e Drejtësisë, mund të

⁶³ Neni 25 i Statutit të Gjykatës së Drejtësisë parashikon:

"Gjykata e Drejtësisë mundet që, në çdo kohë, t'i besojë detyrën për t'i dhënë opinionin prej eksperti çdo individit, institucioni, organi, autoriteti, komiteti ose organizate tjetër që zgjedh".

urdhërojë që ekserti ose dëshmitari të mos paraqitet para saj, por të dëgjohet para gjykatës së vendit ku ai ka vendbanimin e tij të përhershëm. Pyetje e ekspertit ose dëshmitarit sipas kësaj procedure, bëhet në bazë të Letërporosisë që Gjykata e Drejtësisë i dërgon organit gjyqësor të shtetit ku ka vendbanimin ekspertit ose dëshmitari. Kushtet konkrete që duhet të plotësohen për dërgimin e Letërporosisë, janë të përcaktuara në Rregulloren e Procedurës. *Eksperti ose dëshmitari do të pyetet në bazë të ligjit dhe procedurës ligjore të parashikuara nga e drejta e brendshme e shtetit ku ka vendbanimin ekspertit ose dëshmitari.* Të gjitha aktet dhe dokumentet të përfuara nga pyetja e ekspertit ose dëshmitarit, i kthehen Gjykatës së Drejtësisë, po me anë të një Letërporosie, në përputhje me procedurën ligjore të parashikuar nga Rregullorja e Procedurës.

Përveç eksperteve, një nga provat e tjera me rëndësi që shqyrtohen nga Gjykata e Drejtësisë, është edhe pyetja e dëshmitarëve. Rregullat e hollësishme për mënyrën e pyetjes së dëshmitarëve janë të përcaktuara në Rregullorën e Procedurës. Dëshmitari para se të pyetet i nënshtrohet formulës së betimit dhe më pas fillon pyetja e tij, fillimisht nga pala që e ka kërkuar, pastaj nga palët e tjera dhe së fundi nga gjykata. Dëshmitarët dhe ekspertët mund ta bëjnë betimin e tyre, sipas formës së përcaktuar në rregullorën e brendshme ose sipas mënyrës së përcaktuar nga legjislacioni i shtetit të vendbanimit të dëshmitarit ose ekspertit.

Në qoftë se, një dëshmitar ose ekspert është thirrur, rregullisht nga Gjykata e Drejtësisë dhe ai nuk është paraqitur, pa shkaqe të arsyeshme, Gjykata e Drejtësisë ka të njëjtat kompetenca ashtu si dhe gjykatat e brendshme të Shteteve Anëtare dhe mund të vendosë ndaj tyre gjoba monetare, sipas kushteve të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme. Kur një dëshmitar ose ekspert, bën, respektivisht, dëshmi ose ekspertim të rremë, çdo Shtet Anëtar, e trajton këtë shkelje ligjore, në të njëjtën mënyrë, sikur ajo të ishte kryer para gjykatave të tij, me juridiksion në çështjet civile.

Për zgjidhjen e drejtë të çështjes, Gjykata e Drejtësisë, mund të urdhërojë paraqitjen personalisht të palëve, që ato të japin shpjegimet e duhura dhe të mbajnë qëndrimin e tyre, në lidhje me mosmarrëveshjen objekt gjykimi. Paraqitja personalisht e palëve para Gjykatës kërkohet prej saj, jo në çdo çështje, pasi ato, si rregull përfaqësohen në gjykim nga avokatët ose mbrojtësit/agentët e tyre, por, vetëm në rastet kur, shpjegimet e palëve dhe qëndrimi personal i tyre, është i nevojshëm për të kuptuar natyrën e konfliktit si dhe zgjidhjen e drejtë të tij.

Gjykata e Drejtësisë, mund të urdhërojë paraqitjen personalisht të një pale dhe kjo palë, megjithëse, ka dijeni rregullisht, nuk paraqitet, pa shkaqe të arsyeshme. Në këtë rast shtrohet pyetja: A ka të drejtë Gjykata e Drejtësisë që të urdhërojë sjelljen forcërisht të kësaj pale para Gjykatës? Në lidhje me këtë pyetje, përgjigja është negative, Gjykata nuk ka të drejtë që të urdhërojë sjelljen me forcë të palës, e cila, pa shkaqe të arsyeshme nuk paraqitet. Por, këtë qëndrim të palës, Gjykata do ta vlerësojë në harmoni me të gjitha aktet dhe provat e tjera, dhe mundet që mos paraqitja personalisht e palës të shkojë në dëm të saj, pasi, Gjykata, mund të kosiderojë si të provuara faktet, për të cilat ajo ka kërkuar paraqitjen personalisht palës, me qëllim pyetjen e saj për këto fakte.

Gjatë gjykimit të një çështje nga ana e Gjykatës së Drejtësisë, megjithëse, në raste të rralla, mund të lind nevoja që ajo të bëjë edhe kqyerjen në vend të sendeve ose personave. Rregullat me të hollësishme për procedurën e kqyerjes së sendeve ose personave, janë të përcaktuara në Rregulloren e Procedurës. Megjithatë, në këtë temë doktrature, mund të përmend disa rregulla të përgjithshme, përsa i përket marrjes së kësaj prove. Kur është fjala për kqyerjen e personave, duhet të kemi parasysh se, se

procedura e kqyerjes duhet të bëhet, pa cënuar dinjitetin dhe personalitetin e personit. Zakonisht, këtë procedurë të kqyerjes Gjykata ia beson një eksperti të fushës.

Kur bëhet kqyerja e sendeve, duhet të jetë i pranishëm, kur është e mundur, pronari sendit ose personi që gëzon të drejta reale ose gëzimi mbi këtë send. Kqyerja si rregull, bëhet në prani të një eksperti të fushës, ku, në varësi të sendit që do të kqyret, përcaktohet të gjitha karakteristikat e tij. Për kqyerjen në vend të sendeve ose personave, mbahet, në çdo rast, procesverbal, në të cilin, shënohen, data dhe ora e fillimit dhe mbarimit të kqyerjes, vendi i kqyerjes, personat që kanë marrë pjesë në kqyerje, veprimet konkrete dhe procedura e realizimit të kqyerjes, si dhe përfundimet e përfutuara nga kqyerja, pretendimet e palëve, nëse ka, si dhe në fund, procesverbali nënshkruhet nga të gjithë personat e pranishëm.

Pasi nga ana e Gjykatës së Drejtësisë është miratuar Raporti Paraprak i hartuar nga ana e Gjyqtarit Relator, gjykimi kalon në pjesën me gojë të procedurës. Pjesa me gojë e procedurës, është një fazë e gjykimit e cila ndodh, zakonisht, në të gjitha gjykimet e zhvilluara nga Gjykata e Drejtësisë. Në pjesën me gojë të procedurës, çështja e parë që shtrohet për zgjidhje, është çështja e përfaqësimit të palëve para Gjykatës, pasi në këtë fazë para Gjykatës së Drejtësisë, palët nuk mund të mbrohen personalisht, por, ata mbrohen nga përfaqësuesit e tyre.

Sipas Statutit, Shtetet Anëtare dhe institucionet e Bashkimit Evropian, përfaqësohen përpara Gjykatës së Drejtësisë, nga një agjent i emëruar për çdo çështje. Agjenti i caktuar mund të ndihmohet nga një këshilltar ose avokat i caktuar me pëlqimin e tij, si dhe të Shtetit Anëtar ose institucionit të Bashkimit.

Në të njëjtën mënyrë, përfaqësohen edhe Shtetet jo Anëtare të cilat janë palë në Marrëveshjen për Zonën Ekonomike Evropiane dhe janë gjithashtu në Autoritetin Mbikqyrës të përmendur në atë Marrëveshje.⁶⁴

Palët e tjera, siç mund të jenë individët, personat juridikë privatë, shoqatat dhe organizatat e së drejtës private, përfaqësohen para Gjykatës së Drejtësisë, nga një avokat. Që një avokat të mund të përfaqësojë një palë para kësaj Gjykate, duhet që të jetë i autorizuar për të vepruar, domethënë, të gëzojë cilësitë e avokatit përpara një gjykatë të një Shteti Anëtar ose të një Shteti, i cili është palë në Marrëveshjen për Zonën Ekonomike Evropiane. Përveç këtyre, për palët private, si avokatë dhe përfaqësues të palëve, mund të jenë dhe pedagogët e universitetit, që janë shtetas të një Shteti Anëtar, në rastet kur, legjislacioni i brendshëm i atij Shteti, iu jep të drejtën e përfaqësimit në gjykatë.

Përveç rregullave të përfaqësimit, Statuti iu ka dhënë përfaqësuesve të palëve edhe imunitetin dhe të drejtat e nevojshme që iu nevojiten atyre, për ta realizuar detyrën e tyre në mënyrë normale dhe të pavarur nga çdo ndikim i paligjshëm ose i parregullt. Çdo agjent, këshilltar ose avokat që paraqitet para Gjykatës së Drejtësisë, për të mbrojtur një çështje të caktuar, gëzon të gjitha të drejtat dhe imunitetin e nevojshëm për ushtrimin e pavarur të detyrës së tij. Rregulla më të hollësishme në lidhje me të drejtat dhe imunitetin që ka një përfaqësues ligjor i palëve para Gjykatës së Drejtësisë, gjenden të pasqyruara në Rregulloren e Procedurës.

⁶⁴ Tre paragrafët e parë të nenit 19 të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian parashikojnë:

“Shtetet Anëtare dhe institucionet e Bashkimit përfaqësohet përpara Gjykatës së Drejtësisë nga një agjent i emëruar për çdo çështje; agjenti mund të mëshitet nga një këshilltar ose avokat.

Shtetet jo Anëtare, të cilat janë palë në Marrëveshjen për Zonën Ekonomike Evropiane dhe gjithashtu në Autoritetin Mbikqyrës të SHETL-së të përmendur në atë marrëveshje, përfaqësohen në të njëjtën mënyrë. Palët e tjera duhet të përfaqësohen nga një avokat”.

Përfaqësuesit e palëve, qofshin këta agjentë, këshilltarë apo avokatë, krahas të drejtave dhe imunitetit të tyre për ushtrimin si duhet të detyrës së tyre, kanë edhe detyrime përpara Gjykatës së Drejtësisë. Këto detyrime kanë të bëjnë me dhënien e kontributit të tyre për garantimin e një procesi të rregullt ligjor dhe gjykimin e çështjes nga ana e Gjykatës, brenda një afati të arsyeshëm. Në këtë drejtim, Gjykata e Drejtësisë, ka të njëjtat kompetenca për të disiplinuar sjelljen e përfaqësueve të palëve, ashtu siç e kanë edhe gjykatat e brendshme, të secilit prej Shteteve Anëtare.

Gjatë pjesës me gojë të procedurës së gjyimit para Gjykatës së Drejtësisë, seanca gjyqësore, si rregull, zhvillohet me dyer të hapura ose në mënyrë publike. Megjithatë, si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, seanca gjyqësore mund të zhvillohet edhe me dyer të mbyllura, kur për arsye serioze, Gjykata vendos, kryesisht me nisëm e saj ose me kërkesë të palëve, që gjykimi do të jetë me dyer të mbyllura, por vendimi jepet, në çdo rast publikisht.

Seanca gjyqësore fillon me leximin e Raportit Paraprak të hartuar nga Gjyqtari Relator. Më pas dëgjohen agjentët, këshilltarët dhe avokatët, sipas radhës së tyre, ku në fillim e merr fjalën përfaqësuesi i paditësit, më pas i të paditurit dhe më pas bën parashtrimet e tij, përfaqësuesi i personit të tretë ose i palëve të tjera pjesëmarrëse, nëse ka të tilla. Në çështjet kur sipas Statutit të Gjykatës së Drejtësisë dhe Rregullores së Procedurës, është e domosdoshme prania e Avokatit të Përgjithshëm, ky i fundit e marr fjalën për të paraqitur Mendimin e tij, në përfundim të pjesës me gojë të procesit ose në përfundim të gjyimit, pra, para se Gjykata të tërhiqet për të marrë vendimin përfundimtar.

Gjatë seancës gjyqësore mund të marrin pjesë personalisht edhe palët, qofshin këta persona fizikë ose juridikë, por, ata kanë të drejtë që t'i drejtohen Gjykatës, vetëm me anë të përfaqësuesve të tyre. Pasi përfaqësuesit e palëve bëjnë parashtrimet e tyre para Gjykatës, kjo e fundit, kur është e nevojshme kalon në marrjen e provave që ajo çmon se duhen për zgjidhjen e drejtë të çështjes. Në pjesën me gojë të procesit, mund të shqyrtohen prova të ndryshme, si provat me dëshmitarë, ekspertë, dokumentet shkresore, kqyerja në vend e personave dhe sendeve, rregullat për marrjen e të cilave janë trajtuar më lart. Për çdo seancë gjyqësore të zhvilluar, mbahet procesverbal nga ana e sekretarit gjyqësor, i cili, nënshkruhet në përfundim të seancës, nga personi që e ka hartuar, nga Krytari i Gjykatës së Drejtësisë dhe Kancelari.

Më sipër thamë se, në një gjykim nga ana e Gjykatës së Drejtësisë, si rregull, çështjet kalojnë në dy pjesë ose faza, në pjesën me shkrim dhe në pjesën me gojë, si dhe trajtuam procedurat që ndiqen për secilën fazë. *Megjithatë, në raste të veçanta, sipas nenit 44.a të Rregullores së Procedurës, Gjykata e Drejtësisë, mund të vendosë që të përjashtohet pjesa me gojë e procedurës.* Në marrjen e një vendimi të tillë gjykata mban parasysh Rportin Paraprak të paraqitur nga Gjyqtari Relator, mendimin e Avokatit të Përgjithshëm, si dhe faktin, nëse palët kanë paraqitur në kërkesën e tyre arsyet konkrete, se pse, duhet të dëgjohen nga Gjykata, në pjesën me gojë të procedurës së gjyimit.

Gjatë një gjykimi që po zhvillohet para Gjykatës së Drejtësisë, qoftë kur gjykimi është në pjesën me shkrim, qoftë kur është në pjesën me gojë të procesit, Shtetet Anëtare dhe institucionet e Bashkimit Evropian, kanë të drejtë që të ndërhyjnë në gjykimin e filluar. Një të drejtë të tillë e gëzojnë edhe organet, zyrat dhe agjensitë e Bashkimit, si dhe çdo person tjetër fizik ose juridik, i cili është i interesuar dhe interesat e të cilit preken, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga gjykimi. Po ashtu, të drejtën për të ndërhyrë në gjykim e kanë edhe Shtetet, që nuk janë Shtete

Anëtare të Bashkimit, por, janë palë e Marrëveshjes për Zonën Ekonomike Evropiane dhe gjithashtu në Autoritetin e Mbikqyerjes të SHELIT-së, të përnendur në atë marrëveshje, nëse bëhet fjalë për një nga fushat e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Pavarsisht nga e drejta që kanë personat fizikë ose juridikë, për të ndërhyrë në një gjykim të filluar para Gjykatës së Drejtësisë, ata nuk mund të ndërhyjnë në një gjykim, në të cilin janë palë vetëm Shtetet Anëtare ose në një gjykim ku janë palë, vetëm institucionet e Bashkimit apo në një gjykim në të cilin janë palë, vetëm Shtetet Anëtare dhe institucionet e Bashkimit. Që një Shtet Anëtar, një institucion i Bashkimit ose person fizik/juridik, të ndërhyjë në një gjykim të filluar para Gjykatës së Drejtësisë, ai duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim, si dhe duhet të tregojë, me argumente dhe prova konkrete, se gjykimi që po zhvillohet prek, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, interesat e tij.

Pas marrjes së provave dhe paraqitjes së diskutimit përfundimtar nga palët, si dhe dëgjimit të Mendimit të Avokatit të Përgjithshëm, në rastet kur ai merr pjesë në gjykim sipas Statutit, pjesa me gojë ose faza me gojë e procesit përfundon dhe Gjykata e Drejtësisë deklaron të mbyllur shqyrtimin gjyqësor dhe tërhiqet në Dhomën e Këshillimit për të marrë vendimin përfundimtar që e zgjidh çështjen në themel. Në Dhomën e Këshillimit, ku diskutohet dhe vendoset për zgjidhjen përfundimtare të çështjes, marrin pjesë vetëm Gjyqtarët që kanë gjykuar çështjen dhe asnjë person tjetër. Nuk lejohet që të marrë pjesë në Dhomën e Këshillimit, as Kryetari i Gjykatës së Drejtësisë, as Avokati i Përgjithshëm, as sekretari gjyqësor, dhe asnjë person tjetër, përveç Gjyqtarëve të çështjes.

Në Dhomën e Këshillimit paraqesin mendimet e tyre për zgjidhjen e çështjes, secili nga Gjyqtarët që ka marrë pjesë në fazën me gojë të gjykimit, duke filluar nga Gjyqtari më i ri në profesion, ndërsa i fundit voton Kryetari i trupit gjykues. *Gjyqtarët diskutojnë në lidhje me marrjen e vendimit përfundimtar, mbi bazën e një Proket-vendimi të paraqitur nga Gjyqtari Relator, megjithatë, secili nga Gjyqtarët ka të drejtë që të paraqesë propozime për ndryshime për vendimin përfundimtar. Gjykata e Drejtësisë i merr vendimet në mënyrë unanime ose me shumicë votash, megjithatë, vendimi i marrë prej saj konsiderohet se, është marrë, në çdo rast në mënyrë unanime dhe nuk lejohet Mendimi i Pakicës.*

Nga interpretimi që mund t'i bëjmë Statutit të Gjykatës së Drejtësisë, rezulton se, çdo gjë që diskutohet në Dhomën e Këshillimit nga Gjyqtarët për marrjen e vendimit përfundimtar, është sekret dhe nuk mund të nxirret nga askush, në të kundërt, nxjerrja e sekretit të Dhomës së Këshillimit, përbën një shkelje të rëndë për Gjyqtarin që e bën një veprim të tillë. Duke u nisur nga fakti se, debatet që zhvillohen në Dhomën e Këshillimit janë sekret, është parashikuar që, edhe pse vendimi përfundimtar mund të jetë marrë, jo në mënyrë unanime, por, me shumicë votash, ky vendim për palët konsiderohet se është marrë në mënyrë unanime, duke mos u lejuar, në këtë mënyrë, Mendimi i Pakicës.

Duke iu referuar Rregullores së Procedurës mund të themi se, rastet kur vendimi përfundimtar i Gjykatës së Drejtësisë është i pavlefshëm, janë:

- kur në gjykim nuk kanë marrë pjesë një numër tek gjyqtarësh;
- vendimi nuk është marrë, në mënyrë unanime, nga të tre gjyqtarët, kur në gjykim kanë marrë pjesë tre gjyqtarë;
- nuk kanë votuar në favor të vendimit, të paktën tre gjyqtarë, kur në gjykim kanë marrë pjesë pesë gjyqtarë;
- nuk kanë votuar në favor të vendimit, të paktën nëntë gjyqtarë, kur çështja është gjykuar në Dhomën e Lartë;

- nuk kanë votuar në favor të vendimit të marrë, të paktën pesëmbëdhjetë gjyqtarë, kur çështja është gjykuar në Seancë Plenare.

Vendimi i përfundimtar i marrë nga ana e Gjykatës së Drejtësisë është i formës së prerë, domethënë, ai mund të vihet në ekzekutim, në rast se, pala që ka humbur gjyqin, nuk e zbaton atë në mënyrë vullnetare. Duke qenë se, Gjykata e Drejtësisë është organi më i lartë gjyqësor i Bashkimit Evropian, kundër vendimeve të marra prej saj, nuk lejohet ankim dhe për pasojë, ky vendim është i detyrueshëm për palët që nga data që ai është marrë. Nisur nga fakti se, vendimet përfundimtare të dhëna nga Gjykata e Drejtësisë janë të formës së prerë, atëherë shtrohet çështja: *cili organ do t'i ekzekutojë këto vendime dhe cila është procedura e ekzekutimit të vendimeve?*

Në lidhje me këtë çështje, neni 280 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian përcakton se, vendimet e Gjykatës së Drejtësisë janë të ekzekutueshme sipas procedurës së përcaktuar nga neni 299 i këtij Traktati. *Nga ana e saj kjo dispozitë parashikon që, ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë bëhet sipas normave të procedurës civile në fuqi, në territorin e Shtetit Anëtar të të cilit do të kryhet ky ekzekutim.* Kështu, në qoftë se, vendimi i Gjykatës do të ekzekutohet në Holandë, atëherë, procedura e ekzekutimit të këtij vendimi do të bëhet, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile të shtetit holandez.

Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Drejtësisë lëshohet urdhëri i ekzekutimit, i cili, i bashkëlidhet vendimit përfundimtar, pa asnjë lloj formaliteti tjetër, përveç verifikimit të vertetësisë së vendimit të bërë nga autoriteti kombëtar, të cilin Qeveria e çdo Shteti Anëtar e ka caktuar për këtë qëllim dhe i njoftohet Gjykatës së Drejtësisë dhe Komisionit Evropian. Në funksion të realizimit të një ekzekutimi sa më të shpejtë të vendimit të Gjykatës, është parashikuar që, në qoftë se, formalitetet e lëshimit të urdhërit të ekzekutimit dhe të dorëzimit të vendimit, janë përfunduar me kërkesë të palës gjyqësuese, ajo ka të drejtë që të paraqesë kërkesë, drejtpërdrejt, përpara autoritetit kompetent, me qëllim që të realizojë ekzekutimin e vendimit në përputhje me legjislacionin e tij kombëtar.⁶⁵

Më sipër thamë se, vendimet e Gjykatës së Drejtësisë, janë të formës së prerë dhe të ekzekutueshme, forcërisht, sipas procedurës civile të Shtetit ku do të bëhet ekzekutimi i vendimit. Megjithatë, për arsye të përligjura, mund që të lindë nevoja që të bëhet pezullimi i ekzekutimit të vendimit të Gjykatës, duke ndërprerë ekzekutimin e tij, në mënyrë të përkohshme. *Organi kompetent për pezullimin e përkohshëm të vendimit të Gjykatës së Drejtësisë, është Kryetari i kësaj Gjykate. Në bazë të Statutit, Kryetari i Gjykatës së Drejtësisë, me anë të një procedure të shkurtuar, mund të vendosë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës, ose për marrjen e masave të tjera të përkohshme. Por, duhet të kemi parasysh faktin se, vendimi i Kryetarit të Gjykatës për pezullimin e vendimit përfundimtar, është me karakter të përkohshëm dhe nuk çënon, në asnjë mënyrë, vendimin e Gjykatës së Drejtësisë për themelin e çështjes.*

Një nga kategoritë më të rëndësishme të çështjeve që gjykohen nga Gjykata e Drejtësisë janë edhe *Kërkesat për Mendime Paraprake* që gjykatat kombëtare i

⁶⁵ Paragrafi i dytë i nenit 299 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon: *"Ekzekutimi i tyre rregullohet nga normat e procedurës civile në fuqi në Shtetin në territorin e të cilit realizohet ky ekzekutim. Urdhëri i ekzekutimit i bashkëlidhet vendimit, pa formalitete të tjera, përveç verifikimit të vertetësisë së vendimit, e bërë nga autoriteti kombëtar të cilin qeveria e çdo Shteti Anëtar e ka caktuar për këtë qëllim dhe i njoftohet Komisionit dhe Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian".*

drejtojnë Gjykatës së Drejtësisë, të cilat njihen ndryshe edhe si *Referime për Vendime të Ndërmjetme ose Vendime Paragjyqësore*. Këto Kërkesa për Mendime Paraprake, në fakt, janë vendime që marrin gjykatat kombëtare të Shteteve Anëtare, në rastet kur janë të bindura se një normë juridike e rendit të brendshëm të Shtetit Anëtar, ose një normë juridike e institucioneve të Bashkimit Evropian, bie në kundërshtim me Traktatet Kushtetuese ose me rendin juridik evropian, dhe luajnë rolin e Padive që paraqiten para Gjykatës së Drejtësisë. Në një rast të tillë, gjykatat kombëtare pezullojnë gjykimin e çështjes dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës së Drejtësisë, për të dhënë një Mendim Paraprak ose një Vendim të Ndërmjetëm, me të cilin përcaktohet, nëse, norma juridike e rendit të brendshëm kombëtar, apo norma juridike apo akti i institucioneve të Bashkimit Evropian, është apo jo në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian.

Procedura e gjykimit nga Gjykata e Drejtësisë të Kërkesave për Mendime paraprake, është e ndryshme nga ajo për gjykimin e Padive, e cila u paraqit më lart, dhe për këtë arsye, kjo procedurë do të trajtohet, në mënyrë të veçantë, shkurtimisht, nga ana ime. Fillimisht, duhet thënë se, edhe procesi gjyqësor që ka të bëjë me Vendimet Paraprake të Gjykatës së Drejtësisë, zhvillohet në dy pjesë ose faza, faza me shkrim dhe faza me gojë. Po ashtu, duhet thënë se, e gjithë procedura e gjykimit për këto lloje vendimesh që merr Gjykata, është e rregulluar, në mënyrë të përmbledhur, në nenin 23 të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë. Sipas kësaj dispozite, *procesi gjyqësor fillon me pjesën me shkrim të tij, dhe më pas kalon në pjesën me gojë, ku nga ana e Gjykatës dëgjohen pretendimet dhe prapsimet e palëve, si dhe mund të merren edhe prova të ndryshme, nëse është e nevojshme, për zgjidhjen e drejtë të çështjes*.

Në pjesën me shkrim të procesit, vendimi i gjykatës kombëtare, me të cilin është pezulluar gjykimi dhe i është dërguar çështja për një Vendim Paraprak Gjykatës së Drejtësisë, i njoftohet kësaj Gjykate, nga ana e gjykatës së Shtetit Anëtar, e cila e ka marrë këtë vendim. Pas njoftimit të vendimit nga ana e gjykatës së Shtetit Anëtar, Gjykatës së Drejtësisë, kjo e fundit, me anë të Kancelarit, ia njofton këtë vendim, subjekteve që kanë qenë palë në atë vendim, Shteteve Anëtare, Komisionit dhe institucionit, zyrës ose agjensisë së Bashkimit Evropian që ka miratuar aktin, vlefshmëria apo interpretimi i të cilit është objekt shqyrtimi gjyqësor. *Me marrjen e kësaj njoftimi, palët në gjykim, Shtetet Anëtare, Komisioni ose institucioni, zyra apo agjensia që ka nxjerrë aktin që është objekt shqyrtimi gjyqësor, brenda dy muajve, kanë të drejtë që të paraqesin në Gjykatë, argumentet e tyre mbi çështjen ose parashtrimet e tyre me shkrim*. Në këto argumente ose parashtrime me shkrim, palët, Shtetet Anëtare si dhe institucionet, zyrat apo agjensitë që kanë nxjerrë aktin objekt shqyrtimi, paraqesin qëndrimin e tyre ligjor dhe faktik, nëse, akti apo norma juridike që po diskutohet, është apo jo në përputhje me rendin juridik evropian dhe me të drejtën evropiane ose *acquis communautaire*.⁶⁶

⁶⁶ Paragrafi i parë dhe i dytë i nenit 23 të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian parashikojnë:

“Në çështjet që rregullohen nga neni 267 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, vendimi i gjykatës së një Shteti Anëtar, i cili pezullon procedimet e saj dhe e dërgon çështjen në Gjykatën e Drejtësisë, i njoftohet Gjykatës nga gjykata e përfshirë. Vendimi më pas u njoftohet nga Kancelari i Gjykatës, palëve, Shteteve Anëtare, Komisionit dhe institucionit, organit, zyrës ose agjensisë të Bashkimit që ka miratuar aktin, vlefshmëria apo interpretimi i të cilit është në diskutim.

Në pjesën me shkrim të procesit, e njëjta procedurë parashikohet, edhe në rastet kur Vendimi Paraprak që kërkohet të merret nga ana e Gjykatës së Drejtësisë, i referohet Shteteve jo Anëtare të Bashkimit Evropian, por, që kanë nënshkruar Marrëveshjen e Zonës Ekonomike Evropiane dhe janë në Autoritetin Mbikqyrës së SHETL-së, të përmendur në atë Marrëveshje, me kusht që vendimi të ketë të bëjë me çështje që janë rregulluar, në mënyrë të shprehur në atë Marrëveshje. Edhe në një rast të tillë, Shtetet jo Anëtare, palët, Komisioni, ose institucionet, organet ose zyrat e Bashkimit Evropian, kanë të drejtë që të paraqesin argumentet dhe parashtrimin e tyre me shkrim, në lidhje me çështjen.

E drejta për të nxjerrë një Vendim Paraprak në një çështje paragjykimore, i njihet Gjykatës së Drejtësisë, jo vetëm kur një gjë të tillë e kërkojnë gjykatat e Shteteve Anëtare ose gjykatat e Shteteve jo Anëtare, që kanë nënshkruar Marrëveshjen e Zonës Ekonomike Evropiane, por edhe në rastet kur, këtë e kërkojnë gjykatat e një Shteti jo Anëtar, i cili, nuk është as pjesë e Marrëveshjes së Zonës Ekonomike Evropiane. Që Gjykata e Drejtësisë të nxjerrë një Vendim të Ndërmjetëm në një rast të tillë, është e nevojshme që nga ana e Këshillit të Bashkimit Evropian, të jetë lidhur një marrëveshje me një objekt specifik, me kusht që çështja e ngritur të jetë brenda fushës së veprimit të marrëveshjes. *Në këto raste, Shtetet jo Anëtare, kanë të drejtë që të paraqesin aragumentet e tyre dhe parashtrimet e tyre me shkrim, në lidhje me çështjen, brenda dy muajve nga njoftimi i vendimit të gjykatës kombëtare, me kusht që kjo e drejtë t'u jetë njohur, në mënyrë të shprehur, këtyre Shteteve nga marrëveshja specifike e nënshkruar.*⁶⁷

Me paraqitjen nga ana e palëve, të Shteteve Anëtare, Komisionit, institucioneve ose organeve apo zyrave të Bashkimit të parashtrimeve të tyre me shkrim, në lidhje me objektin e mosmarrëveshjes, ose me kalimin e afatit dy mujor dhe këto subjekte nuk paraqesin argumentet e tyre me shkrim, Gjykata e Drejtësisë, kalon në pjesën e dytë të procesit, e cila është pjesa me gojë e tij. *Pjesa me gojë të procesit, fillon me fjalën e Gjyqtarit Relator, i cili u parashtron palëve të pranishëm në gjykim, vendimin e gjykatës së Shtetit Anëtar, duke u ndalur tek argumentet që ka paraqitur ajo gjykatë se, pse norma juridike e Shtetit Anëtar ose norma juridike dhe/apo akti i institucioneve të Bashkimit Evropian, është në kundërshtim me të drejtën e Bashkimit Evropian.*

Më pas fjalën e merr, secila prej palëve në gjykim, duke filluar me përfaqësuesin e paditësit, atë të të paditurit, për të vazhduar me argumentet që paraqet përfaqësuesi i Komisionit Evropian, si dhe përfaqësuesi i institucionit, organit, zyrës apo agjensisë, akti i të cilit po diskutohet. *Në pjesën me gojë të procesit, Gjykata e Drejtësisë, mund të marrë edhe prova të ndryshme, siç mund të jenë dokumentet,*

Brenda dy muajve nga ky njoftim, palët, Shtetet Anëtare, Komisioni dhe, kur duhet, institucioni, organi, zyra ose agjensia që ka miratuar aktin, vlefshmëria apo interpretimi i të cilit është në diskutim, kanë të drejtë që të paraqesin në gjykatë argumente mbi çështjen ose konstatime me shkrim".

⁶⁷ Paragrafi i katërt i nenit 23 të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian parashikon: *"Kur një marrëveshje në lidhje me një objekt specifik, e lidhur mes Këshillit dhe një ose më shumë Shteteve jo Anëtare, parashikon që këto Shtete të kenë të drejtë që të paraqesin pohimin e fakteve ose konstatime me shkrim, kur një gjykatë e një Shteti Anëtar i drejtohet Gjykatës së Drejtësisë për t'u shprehur me vendim paragjyqësor për një çështje që është brenda fushës së veprimit të marrëveshjes, vendimi i gjykatës kombëtare në lidhje me atë çështje u njoftohet edhe jo Shteteve Anëtare të interesuara. Këto Shtete brenda dy muajve nga ky njoftim, mund të depozitojnë në Gjykatë pohimin e fakteve ose konstatime me shkrim".*

ekspertët, ose edhe prova me dëshmitarë, megjithatë, zakonisht, duke qenë se, në këto lloj gjykimesh, kemi të bëjmë me çështje të ligjit dhe jo të faktit, zakonisht, nga ana e Gjykatës, nuk merren prova konkrete, pra, nuk ka hetim gjyqësor.

Pasi nga ana e përfaqësuesve të palëve të pranishme, jepen argumentet e tyre në lidhje me çështjen, e merr fjalën Avokati i Përgjithshëm, nëse, ai merr pjesë në gjykim sipas Statutit, i cili paraqet argumentet e tij, nëse norma juridike ose akti në fjalë është apo jo në përputhje me rendin juridik evropian ose të drejtën e Bashkimit Evropian. Duhet të kemi parasysh faktin se, Mendimi apo opinioni i Avokatit të Përgjithshëm, në çështje të tilla, është shumë i rëndësishëm, sepse, ai përfaqëson një mendim të një personi të specializuar ose të një eksperti të ligjit, megjithatë, ai nuk është detyrues për Gjykatën e Drejtësisë, e cila vendos sipas bindjes së saj të brendshme, në lidhje me zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Rregullat procedurale për marrjen e Vendimit Paraprak nga ana e Gjykatës së Drejtësisë, në rastet e Vendimeve Paragjyqësore, janë të njëjta si kur ajo Gjykatë merr vendimin përfundimtar, në rastet e Padive që paraqiten para saj. *Në Vendimin Paraprak Gjykata vendos, nëse, norma juridike ose akti qoftë ai i Shtetit Anëtar, qoftë ai institucionit ose organit apo zyrës së Bashkimit Evropian, objekt shqyrtimi gjyqësor, është apo jo në përputhje me rendin juridik evropian ose me të drejtën e Bashkimit Evropian.* Vendimi i Paraprak i marrë nga Gjykata e Drejtësisë, i dërgohet gjykatës së Shtetit Anëtar, e cila ka pezulluar gjykimin, për vazhdimin e gjykimit nga ana e saj dhe ky vendim i marrë nga Gjykata e Drejtësisë, në lidhje me çështjen konkrete, është i detyrueshëm për zbatim prej asaj gjykate, si dhe për të gjitha Shtetet Anëtare dhe institucionet, organet, zyrat apo agjensitë e Bashkimit Evropian.

Në procesin gjyqësor të zhvilluar nga ana e Gjykatës së Drejtësisë që ka për objekt Vendimet Paragjyqësore ose Vendimet Paraprake, përveç këtij procesi gjykimi të shpjeguar më lart, i cili përbën procedurën normale të gjykimit, me vendimin 79 të vitit 2008 të Këshillit të Bashkimit Evropian, është përcaktuar se, *Rregullorja e Procedurës, mund të parashikojë një procedurë të përshpejtuar të gjykimit ose procedurë urgjente, e cila nuk ndjek dy pjesët e mësipërme të procesit ose dhe afatet e parashikuara në pjesën me shkrim të procesit, por, vetëm në rastet kur Vendimi Paragjyqësor ka të bëjë zonën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë së Bashkimit Evropian.* Procedura urgjente në Vendimet Paragjyqësore, është një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, dhe zbatohet vetëm kur plotësohen këto dy kushte:

Së pari: Duhet që Rregullorja e Procedurës ta lejojë, në mënyrë të shprehur, zbatimin e kësaj procedure dhe

Së dyti: Duhet që Vendimi Paragjyqësor që do të merret nga Gjykata e Drejtësisë, të ketë të bëjë me çështje që lidhen me zonën e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.

Në procedurën urgjente, Gjykata mund të vendosë që të përjashtohet pjesa me gojë e procesit, duke lejuar që të zhvillohet vetëm pjesa me shkrim e tij. Po ashtu, edhe përsa i përket pjesës me shkrim të procesit, Gjykata, mund të vendosë që afati prej dy muajsh që kanë palët, Shtetet Anëtare dhe institucionet apo organet e Bashkimit Evropian, për të dhënë argumente dhe parashtrime me shkrim në lidhje me çështjen, të jetë më i shkurtër, por, gjithmonë, duhet të jetë i tillë, që në varësi të rrethanave konkrete, të jetë i tillë, që subjektet në gjykim, të kenë mundësi efektive që të bëjnë mbrojtjen e tyre dhe të paraqesin qëndrimet e tyre për çështjen. Në rastet e procedurës urgjente, Gjykata mund të vendosë, po ashtu, që çështja të gjykohet edhe pa marrjen e Mendimit të Avokatit të Përgjithshëm. Madje, sipas procedurës së

mësipërme, kur Gjykata konstaton se, çështja është tepër urgjente, ajo mund të vendosë që të mos kryhen të gjitha hapat e procedurës me shkrim.

Procedura e përshpejtuar si më sipër, mund të zbatohet nga Gjykata e Drejtësisë, jo vetëm në rastet e Vendimeve Paragjyqësore, por edhe në rastet e gjykimit të Padive të paraqitura nga Shtetet Anëtare, institucionet e Bashkimit Evropian, ose personat fizikë apo personat juridikë privatë. Gjykimi i çështjes sipas kësaj procedurë të veçantë, bëhet duke mos zbatuar disa hapa të procedurës me shkrim, si dhe duke caktuar datën e seancës gjyqësore, për pjesën me gojë të procedurës. Organi kompetent që vendos për zbatimin e procedurës së përshpejtuar, është Kryetari i Gjykatës së Drejtësisë, i cili vendos mbi bazën e një kërkesë të veçantë me shkrim të paraqitur nga pala kërkuese, si dhe pasi të ketë dëgjuar Rekomandimin e Gjyqtarit Relator, palën tjetër dhe Avokatin e Përgjithshëm.

KAPITULLI I TRETË

MBROJTJA E TË DREJTAVE TË NJERIUT NGA GJYKATA EVROPIANE E DREJTËSISË

3.1. Paditë e ngritura nga personat fizikë ose juridikë privatë me objekt anulimin e akteve të institucioneve të Bashkimit Evropian.

Institucionet e ndryshme të Bashkimit Evropian, të cilat sipas Traktateve Kushtetuese janë Parlamenti, Këshilli, Komisioni, Banka Qendrore Evropiane, Komiteti i Rajoneve, por, edhe organet, zyrat dhe agjensitë që krijohen nga këto institucione, e ushtrojnë veprimtarinë e tyre me anë të akteve juridike siç janë Rregulloret, Direktivat, Vendimet, Rekomandimet dhe Opinionet. Secila prej këtyre akteve juridike ka veçoritë e veta, trajtimi i të cilëve nuk është objekt i temës sime, por, për të kuptuar paditë që kanë si objekt anulimin e këtyre akteve, është e nevojshme që të jepet kuptimi i tyre, në mënyrë shumë të shkurtër. Përcaktimi i kuptimit të akteve juridike që nxjerrin institucionet e Bashkimit, duhet të bëhet edhe për të përcaktuar se, cilët prej këtyre akteve mund të jenë objekt anulimi para Gjykatës së Drejtësisë, nga ana e personave fizikë dhe juridikë privatë.

Duke iu referuar nenit 288 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, mund të nxjerrim këto përkufizime për aktet juridike të institucioneve të Bashkimit Evropian:⁶⁸

a) Rregullorja është një akt juridik, e cila vendos rregulla të përgjithshme dhe abstrakte sjelljeje, me karakter detyrues, të cilat janë, drejtpërdrejt të zbatueshme për të gjitha Shtetet Anëtare. Duke u nisur nga përkufizimi i mësipërm, rezulton se, Rregullorja si akt juridik i institucioneve të Bashkimit ka këto karakteristika:

i. është një akt juridik me karakter të përgjithshëm, që do të thotë se, i drejtohet jo një personi konkret ose një kategorie të përcaktuar personash, por, një numri të pacaktuar personash;

ii. është një akt juridik abstrakt, që do të thotë se, zbatohet jo për një rast konkret ose disa raste konkrete, por për një numër të pafund rastesh hipotetike;

iii. është një akt juridik me karakter detyrues, që do të thotë se, të gjithë subjektet e së drejtës, duhet të sillen në përputhje me rregullat e vendosura nga ky akt juridik, sepse në të kundërt do të ndëshkohen me anë të sanksionit;

iv. është një akt juridik që zbatohet, drejtpërdrejt, për të gjitha Shtetet Anëtare, që do të thotë se, për zbatimin e saj, Shtetet Anëtare, nuk është e nevojshme që të nxjerrin ndonjë akt ose normë tjetër juridike të veçantë, pasi ky akt bëhet, automatikisht pjesë e sistemit ligjor të çdo Shteti Anëtar.

⁶⁸ Neni 288 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Për të ushtruar kompetencat e Bashkimit, institucionet miratojnë rregulloret, direktiva, vendime, rekomandime dhe opinione.

Rregullorja ka zbatim të përgjithshëm. Ajo ka fuqi detyruese në tërësinë e saj dhe është drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

Direktiva ka fuqi detyruese, në lidhje me rezultatin që duhet arritur për çdo Shtet Anëtar të cilit i drejtohet por, ua lë autoriteteve kombëtare kompetencën e zgjedhjes së formës dhe mënyrave.

Vendimi ka fuqi detyruese në tërësinë e tij. Vendimi që përcakton se kujt i drejtohet ka fuqi detyruese vetëm për këta. Rekomandimet dhe opinionet nuk kanë fuqi detyruese”.

b) Direktiva është një akt juridik, e cila vendos rregulla të përgjithshme dhe abstrakte sjelljeje, me karakter detyrues për të gjitha Shtetet Anëtare, vetëm për rezultatit që duhet arritur, ndërkohë që çdo Shteti Anëtar i takon kompetenca e përzgjedhjes së formës dhe mënyrave të arritjes së këtij rezultati. Duke u nisur nga përkufizimi i mësipërm, rezulton se, Direktiva, si akt juridik i institucioneve të Bashkimit Evropian, ka shumë ngjashmëri me Rregulloren, sepse, edhe ky akt juridik, ashtu si edhe Rregullorja, ka karakter të përgjithshëm, abstrakt dhe detyrues. Dallimi themelor që ekziston ndërmjet Rregullores dhe Direktivës, është fakti se, Direktiva nuk është drejtpërdrejt e zbatueshme në Shtetet Anëtare. Me qëllim që ajo të zbatohet në Shtetet Anëtare dhe të bëhet pjesë e sistemit ligjor të tyre, duhet që secili prej Shteteve të nxjerrë një akt tjetër juridik, i cili, e bën atë të zbatueshme në këtë Shtet.

Tek Direktiva, vetëm arritja e rezultatit është e detyrueshme për çdo Shtet Anëtar, ndërsa, formën dhe mënyrën e arritjes së këtij rezultati, çdo Shtet Anëtar, është i lirë që ta zgjedhë vetë, me anë të nxjerrjes së një akti juridik nga ana e tij, akt i cili e bën të zbatueshëm Direktivën, në secilën prej këtyre Shteteve. Po ashtu, në ndryshim nga Rregullorja, Direktiva, nuk është pjesë e sistemit ligjor të brendshëm të Shteteve Anëtare, pjesë e sistemit ligjor kombëtar, nuk është Direktiva, por, është akti juridik që nxjerr çdo Shtet, me qëllim zbatimin ose vënien në jetë të saj.

c) Vendimi është një akt juridik, me fuqi detyruese dhe që zbatohet drejtpërdrejt, në secilin prej Shteteve Anëtare, i cili ka si veçori se mund të ketë karakter të përgjithshëm duke iu drejtuar të gjitha Shteteve Anëtare, ose karakter të veçantë, duke iu drejtuar një ose disa Shteteve. Në rastet kur Vendimi si akt juridik, iu drejtohet të gjitha Shteteve Anëtare, ai ngjan shumë me Rregulloren, megjithatë ai edhe në këtë rast, nuk është i njëjtë me të, pasi, përgjithsisht pranohet se, Vendimi, në ndryshim nga Rregullorja, edhe kur iu drejtohet të gjithë Shteteve, nuk vendos rregulla abstrakte sjelljeje, por, vendos rregulla konkrete sjelljeje. Kur vendimi i drejtohet një ose disa Shteteve Anëtare, ai është i detyrueshëm për zbatim vetëm nga këto Shtete.

Nga përkufizimi i dhënë më sipër për Vendimin si akt juridik, kuptohen edhe ngjashmëritë dhe dallimet e tij, si me Rregulloren ashtu edhe me Direktivën. Vendimi, sidomos në rastet kur iu drejtohet të gjitha Shteteve Anëtare, ka shumë ngjashmëri me Rregulloren, sepse, ky akt juridik, ashtu si Rregullorja, vendos rregulla të detyrueshme sjelljeje, që zbatohen, në mënyrë të drejtpërdrejtë, nga të gjitha Shtetet Anëtare, por, nga ana tjetër, ndryshon nga Rregullorja, sepse, Vendimi vendos rregulla konkrete sjelljeje dhe jo rregulla abstrakte siç vendos Rregullorja. Nga ana tjetër, Vendimi ka ngjashmëri edhe me Direktivën, sepse ashtu si Direktiva, vendos rregulla sjelljeje të detyrueshme dhe të përgjithshme, por, dallon prej saj, sepse, ndërsa Vendimi është drejtpërdrejt i zbatueshëm për Shtetet Anëtare, duke u bërë pjesë e sistemit ligjor të tyre, Direktiva nuk është, drejtpërdrejt e zbatueshme, pasi që ajo të zbatohet në këto Shtete, secili prej tyre duhet të nxjerrë një akt juridik të veçantë, për arritjen e rezultatit të Direktivës.

ç) Rekomandimet janë akte të nxjerra nga institucionet e Bashkimit Evropian, me anë të të cilave, ftohen ose udhëzohen apo orientohen Shtetet Anëtare, për mënyrën sesi ato duhet të veprojnë në situata të ndryshme hipotetike. Në ndryshim nga Rregulloret, Direktivat dhe Vendimet, Rekomandimet kanë si karakteristikë themelore se, nuk janë të detyrueshme për zbatim nga Shtetet Anëtare, ç'ka përbën edhe dallimin kryesor ndërmjet këtyre akteve juridike. Rekomandimet nxirren nga institucionet e Bashkimit, në rastet kur situata të caktuara juridike janë të paqarta ose kur Shtetet Anëtare, veprojnë në mënyra të ndryshme, për çështje që

lidhen me fusha të ndryshme të Bashkimit Evropian, por, Shtetet Anëtare janë të lira të veprojnë, t'i zbatojnë ose jo këto Rekomandime.

Moszbatimi ose mosrespektimi i Rekomandimeve nga ana e Shteteve Anëtare, nuk sjellë asnjë pasojë juridike për ta, për vetë faktin se, ato nuk janë të detyrueshme për zbatim, por, kjo nuk do të thotë se, moszbatimi i tyre, nuk sjellë pasojë politike për ta. Pikërisht, tek pasojat politike që sjellë moszbatimi i Rekomandimeve nga ana e një ose disa Shteteve Anëtare, duhet parë edhe “fuqia” e tyre, në kuadër të akteve të institucioneve të Bashkimit Evropian. Për shkak të pasojave politike që sjellë moszbatimi i Rekomandimeve, këto akte konsiderohen edhe si “ligj i butë”, term i cili tregon se, Rekomandimet nuk janë akte ligjore me fuqi detyruese, por që edhe pse nuk janë të tilla, këshillohet të zbatohen nga Shtetet Anëtare, për të shmangur pasojat politike negative që kanë këto Shtete, në rast të mos zbatimit të tyre.

d) Opinionet janë akte që nxirren nga institucionet e Bashkimit Evropian në lidhje me çështje të caktuara brenda fushës së veprimtarisë së Bashkimit Evropian. Opinionet, po ashtu si dhe Rekomandimet kanë të përbashkët faktin se, nuk janë akte juridike dhe për pasojë nuk janë të detyrueshme për zbatim për Shtetet Anëtare, çka i dallon ato me aktet juridike siç janë Rregulloret, Direktivat dhe Vendimet. Duke qenë se si Opinionet dhe Rekomandimet, nuk janë të detyrueshme për zbatim për Shtetet Anëtare, në praktikë, është e vështirë që të bëhet dallimi ndërmjet një Opinioni dhe një Rekomandimi.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë që, Rekomandimet dhe Opinione janë akte të njëjta, ata janë akte të ndryshme dhe nxirren nga institucionet e Bashkimit për qëllime të ndryshme. Kështu si dallim të parë ndërmjet Rekomandimit dhe Opinioni, do të përmendja faktin se, Rekomandimi nga natyra e tij është një akt që i udhëzon Shtetet Anëtare, sesi duhet të veprojnë në situata të caktuara hipotetike dhe mund të themi se, ka karakter të përgjithshëm, ndërsa, Opinioni përbën një akt të institucioneve të Bashkimit që nxirret për një ose disa çështje konkrete dhe mund të themi se, ka karakter të veçantë. Një dallim tjetër ndërmjet tyre, qëndron në faktin se, në përgjithësi Rekomandimet nxirren nga institucionet e Bashkimit, si rregull, me nisëm e tyre, ndërsa, Opinione nxirren, si rregull me kërkesë të Shteteve Anëtare ose të një institucioni tjetër të Bashkimit Evropian.

Nga të pesë aktet e mësipërme, Rregulloret, Direktiva, Vendime, Rekomandime dhe Opinione, Gjykata e Drejtësisë ka kompetencë që të shqyrtojë ligjshmërinë e tyre, me pasojë anulimin, vetëm të tre aktëve të para, pra, të Rregulloreve, Direktivave dhe Vendimeve, pasi vetëm këto tre akte, janë akte juridike me fuqi detyruese dhe që mund të sjellin pasojë për palët e treta, ndërsa, Rekomandimet dhe Opinione nuk janë akte juridike dhe nuk janë të detyrueshme dhe as nuk mund të sjellin pasojë ndaj palëve të treta. Një gjë e tillë është e përcaktuar, në mënyrë të shprehur, në nenin 263 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian. Kjo dispozitë i jep të drejtë Gjykatës së Drejtësisë që të shqyrtojë ligjshmërinë e akteve legjislative dhe të akteve të tjera juridike të nxjerra nga Këshilli, Komisioni, Parlamenti Evropian, Këshilli Evropian dhe Banka Qendrore Evropiane, që nuk janë Rekomandime dhe Opinione, të cilat kanë për qëllim që të prodhojnë pasojë juridike ndaj personave të tretë.⁶⁹

⁶⁹ Pargrafi i parë i nenit 263 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian shqyrton ligjshmërinë e akteve legjislative, e akteve të Këshillit, të Komisionit, të Bankës Qendrore Evropiane që nuk janë rekomandime dhe opinione, dhe të akteve të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian, të cilat kanë për qëllim që të prodhojnë pasojë ligjore kundrejt të tretëve. Ajo shqyrton edhe ligjshmërinë e akteve të organeve, zyrave ose agjensive të Bashkimit të cilat kanë për qëllim të prodhojnë pasojë ligjore kundrejt të tretëve”.

Përpara se nga ana ime të trajtohen *kushtet që një person fizik ose juridik duhet që të përmbushë, me qëllim që ai të legjitimohet që të ngrejë padi (locus standi), me objekt anulimin e akteve të institucioneve të Bashkimit Evropian, më duhet të sqaroj paraprakisht se, kompetente për shqyrtimin e padive të tilla, është Gjykata e Përgjithshme. Një gjë e tillë rezulton e parashikuar, shprehimisht, nga paragrafi i parë i nenit 256 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, dispozitë e cila, i ka dhënë një kompetencë të përgjithshme kësaj Gjykate, për të shqyrtuar të gjitha paditë që kanë të bëjnë si me kontrollin e ligshmërisë së akteve të institucioneve të Bashkimit, të quajtura padi të anulimit, ashtu edhe në rastet kur institucionet e Bashkimit nuk veprojnë, të quajtura padi për mosveprim, si dhe të padivë që rrjedhin nga klauzolat e arbitrazhit të lidhura nga Bashkimi Evropian, në rastet kur këto padi ngrihen nga personat fizikë ose juridikë privat, me përjashtim të padive që i janë rezervuar Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatave të Specializuara.⁷⁰*

Nga interpretimi që i bëhet nenit 51 të Statutit të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, rezulton se, Gjykata e Përgjithshme është kompetente për të shqyrtuar dhe vendosur, përveç padive të tilla, kur ngrihen nga personat fizikë ose juridikë privat, pra, padive të anulimit, padive për mosveprim dhe klauzolave të arbitrazhit, *edhe për shqyrtimin e padive që ngrihen nga Shtetet Anëtare, në këtë raste:*

i. paditë e ngritura kundër akteve të Këshillit me anë të të cilëve ky i fundit e ka konsideruar si të papajtueshëm me tregun e brendshëm të Bashkimit Evropian dhe si cënim të konkurrencës, ndihmën që një Shtet Anëtar iu ka dhënë një ose disa ndërmarrjeve të caktuara, padi të ngritura këto në bazë të paragrafit të tretë të pikës 2 të nenit 108 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian;

ii. paditë e ngritura kundër akteve të Këshillit të miratuar prej tij sipas një Rregullorje në lidhje me masat që kanë për qëllim mbrojtjen e tregtisë, padi këto të ngritura në bazë të nenit 207 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian;

iii. paditë e ngritura kundër akteve të Këshillit, akte me të cilat Këshilli ushtron kompetenca zbatuese, padi të cilat ngrihen në bazë të pikës 2 të nenit 291 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian;

Në këto tre raste përjashtimore, si dhe në raste të tjera, kur një gjë e tillë ia njej, në mënyrë të shprehur, Statuti i Gjykatës së Drejtësisë, Gjykata e Përgjithshme, ka si kompetencë për të shqyrtuar dhe vendosur në lidhje me paditë e ngritura nga Shtetet Anëtare, kundër akteve të institucioneve të Bashkimit Evropian. Në të gjitha rastet e tjera, kjo Gjykatë ka për kompetencë që të shqyrtojë, vetëm paditë që personat fizikë ose juridikë privatë, ngrejnë kundër akteve të institucioneve të Bashkimit.

Një problem tjetër me rëndësi që duhet trajtuar përpara se të nis trajtimin e thelbit të çështjes, ka të bëjë me *fushën e akteve juridike të Bashkimit Evropian, të cilat mund të jenë objekt padie nga personat fizikë dhe juridikë. Si rregull, personat fizikë dhe/ose juridikë privat, mund të ngrejnë padi me objekt anulimin e çdo akti juridik të nxjerrë nga institucionet e Bashkimit, që ka fuqi detyruese dhe sjellë pasoja juridike ndaj palëve të treta. Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, personat fizikë dhe juridikë privat, por edhe Shtetet Anëtare, nuk mund të ngrejnë padi ndaj akteve të*

⁷⁰ Paragrafi i parë i nenit 256 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Gjykata e Përgjithshme ka kompetencë të dëgjojë dhe të vendosë mbi çështjet ose procedurat e shkallës së parë të përmendura në nenet 263, 265, 268, 270 dhe 272, me përjashtim të atyre që i takojnë një gjykate të specializuar të krijuar sipas nenit 257 dhe atyre të cilat Statuti ia ka rezervuar Gjykatës së Drejtësisë. Statuti mund të parashikojë që Gjykata e Përgjithshme të ketë kompetencë për kategori të tjera çështjesh dhe procedurash”.

institucioneve të Bashkimit Evropian dhe as ndaj akteve dhe masave që marrin Shtetet Anëtare, që kanë të bëjnë me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë.⁷¹

Për çështjet që kanë të bëjnë me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe Sigurisë, parimi është se, Gjykata e Përgjithshme dhe as Gjykata e Drejtësisë nuk kanë kompetencë për shqyrtimin e tyre. Megjithatë, pavarësisht këtij parimi, një çështje që ka të bëjë me Politikën e Përbashkët dhe Sigurinë, mund të shqyrtohet, respektivisht, nga Gjykata e Përgjithshme ose nga Gjykata e Drejtësisë, në qoftë se, ndodhemi para njërit prej këtyre dy rasteve:

a) Kur ka mosmarrëveshje në lidhje me ushtrimin e kompetencave nga ana e institucioneve të Bashkimit për fushat ku Bashkimi Evropian ka kompetenca ekskluzive dhe kompetenca mbështetëse e bashkërenduese, me ushtrimin e kompetencave në fushën e Politikës së Jashtme dhe të Sigurisë, të parashikuara respektivisht nga Traktati për Bashkimin Evropian dhe Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian. Në këtë rast, Gjykata e Drejtësisë ka të drejtë të monitorojë dhe të vendosë nëse nga institucionet e Bashkimit, janë ushtruar në përputhje me Traktatet Kushtetuese këto kompetenca nga ana e institucioneve të Bashkimit.

b) Në rastet e padive të ngritura nga personat fizikë ose juridikë privat me objekt rishqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve që parashikojnë masa kufizuese kundër personave fizikë ose juridikë.⁷²

Personat fizikë ose juridikë privat në ngritjen e padive me objekt anulimin e akteve të institucioneve të Bashkimit Evropian, janë subjekte jo të privileguar. Kjo do të thotë se, në ndryshim nga Shtetet Anëtare dhe institucionet e Bashkimit, të cilët janë subjekte të privileguara dhe kanë të drejtë që të ngrejë padi, në çdo rast, pa qenë të detyruar që të provojnë cënimin e interesit të tyre nga akti që ata kërkojnë të anulojnë, personat fizikë dhe juridikë privat, për ngritjen e padisë, janë të detyruar që, në çdo rast, të provojnë se akti i institucionit të Bashkimit që ata kërkojnë të anulojnë, prek, në mënyrë individuale dhe të drejtpërdrejtë, interesat e tyre.

Detyrimi që kanë personat fizikë dhe juridikë privatë për të provuar se, akti i institucionit të Bashkimit Evropian, që ata kërkojnë të anulojnë me padi, çënon në mënyrë individuale dhe të drejtpërdrejtë interesat e tyre, përbën edhe legjitimitimin e tyre në këto padi dhe është një nga çështjet më të rëndësishme dhe më të debatueshme në fushën e doktrinës dhe të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Ky detyrim i tyre njihet po ashtu, edhe si e drejta e aksesit për t'iu drejtuar Gjykatës, ose e drejta e palës për të bërë ankim/padi dhe për t'iu drejtuar autoriteve publike për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Duke qenë se, kjo e drejtë përbën edhe një nga të drejtat dhe liritë e njeriut, ajo është zhvilluar dhe trajtuar me hollësi, si nga profesorë të ndryshëm të së drejtës së Bashkimit Evropian, ashtu edhe nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

Në mënyrë që, një person fizik ose juridik privat të ketë legjitimitim aktiv për paraqitjen e padisë, me me objekt anulimin e një akti të institucioneve të Bashkimit Evropian, ai duhet që të plotësojë disa kushte. Kushti i parë i legjitimitimit aktiv që duhet të plotësojë personi fizik ose juridik privat për ngritjen e padisë është që, padia duhet të ngrihet kundër një akti që ekziston, realisht, në momentin e ngritjes së

⁷¹ Paragrafi i parë i nenit 275 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian nuk ka kompetencë lidhur me dispozitat që kanë të bëjnë me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë dhe as në lidhje me aktet e miratuara në mbështetje të këtyre politikave”.

⁷² Shih për më tepër: Craig P; De Burca G; “E drejta e Bashkimit Evropian, Tekste, çështje gjyqësore dhe materiale”, botuar nga Qendra e Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2013, faqe 594.

padisë. Në qoftë se, padia për anulim, ngrihet kundër një akti që nuk ekziston, atëherë, kuptohet se, kjo padi, do të deklarohet e papranueshme për mungesë të ekzistencës së aktit, pasi, perderisa akti nuk ekziston, ai nuk mund të sjellë asnjë efekt juridik dhe për pasojë, nuk mund të ngrihet as padi kundër tij.

Detyrimi që paditësi ka për të ngritur padinë për anulim, kundër një akti që ekziston nënkupton që paditësi, jo vetëm të identifikojë aktin që kundërshton, duke përmendur numrin aktit dhe datën e saktë të tij, por, duhet që të edhe të provojë se, ky akt ekziston edhe fizikisht ose materialisht. Në praktikën e vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, rezulton se, kjo Gjykatë, *me vendimin e saj të datës 10 dhjetor 1957, në çështjen Societe ses usines a tubes de la Sarre*, ka pranuar faktin e mosekzistencës së aktit, duke e zëvendësuar vendimin për mospranim, me një deklaratë mosekzistence të aktit.⁷³

Duhet të kemi parasysh se, *rastet kur Gjykata konstaton mosekzistencën e aktit të institucionit të Bashkimit Evropian, përbëjnë edhe rastet më të rënda të shkeljes së rendit juridik evropian dhe të të drejtave dhe lirive të njeriut*. Për këtë arsye Gjykata, është shumë e rezervuar që të shprehet për mosekzistencën e aktit, sepse, një deklarami i tillë, sjellë si pasojë shuarjen e çdo prezumimi të vlefshmërisë së aktit dhe rrezikon të sjellë efekte shumë të rënda, nëse, akti që juridikisht është jo ekzistues, ka ekzistuar faktikisht për shumë kohë, duke sjellë pasoja, të cilat si akt i paqenë, nuk duhej ti i kishte sjellë.

Në një çështje tjetër, konkretisht në çështjen nr. C-137/92 P, *Commision vs BASF E.A.*, Gjykata e Shkallës së Parë (sot Gjykata e Përgjithshme), konstatoi se, një vendim i Komisionit për procedurën e konkurrencës, kundër kartelit PVC, ishte i paqenë, pasi Komisioni nuk arriti të gjejë një kopje origjinale të vendimit, sipas formës së kërkuar në Rregulloren e Procedurës. Me sa duket, në këtë rast, anëtarët e Komisionit nuk kishin rënë dakort në lidhje me tekstin e saktë të vendimit dhe teksti i vendimit mund të ishte ndryshuar pas miratimit të tij. Gjykata e Shkallës së Parë, u shpreh se, *mosekzistenca e një akti të institucioneve të Bashkimit Evropian, mund të ngrihet nga Gjykata edhe me nisëm e saj, në çdo fazë të procedurës*.⁷⁴

Vendimi i mësipërm të Gjykatës së Shkallës së Parë, u apelua nga Komisioni Evropian në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë, e cila me vendimin e saj të datës 15 qershor të vitit 1994, e ndryshoi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, duke u shprehur se, nuk jemi para një akti që nuk ekziston, akti i Komisionit ekziston, pasi defektet e aktit nuk ishin aq serioze, sa të bënin aktin të paqenë, por, nga ana tjetër, akti kishte parregullësi të tilla që, e bënin atë të anulueshëm. Në vendimin e mësipërm, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, ndër të tjera, arsyeton: “...aktet që përmbajnë parregullësi aq të mëdha saqë nuk mund të tolerohen nga rendi juridik komunitar, duhet të njihen si akte që nuk kanë prodhuar asnjë efekt juridik, madje as përkohësisht, pra, duhet të shihen si inekzistentë juridikisht. Ky përjashtim synon të ruajë ekuilibrin ndërmjet dy kërkesave themelore, por ndonjëherë antoniste, që janë qëndrueshmëria e marrëdhënieve juridike nga njëra anë dhe respektimi i ligjshmërisë nga ana tjetër...”⁷⁵

⁷³ Shih për më tepër: Jacque, J. P; “E drejta institucionale e Bashkimit Evropian”, Shtëpia Botuese “Papyrus”, Tiranë, 2010, faqe 476.

⁷⁴ Shih për më tepër: Craig P; De Burca G; “E drejta e Bashkimit Evropian, Tekste, çështje gjyqësore dhe materiale”, botuar nga Qendra e Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2013, faqe 593.

⁷⁵ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë të datës 15 qershor 1994, në çështjen nr. C-137/92 P, *Commision vs BASF E.A.*

Çështja e ekzistencës ose jo të aktit ndaj të cilit është paraqitur padia për anulim, mund të shtrohet për diskutim edhe në rastet kur insitucioni që ka nxjerrë aktin, duke konstatuar paligjshmërinë e tij, e shfuqizon vetë aktin gjatë kohës që çështja po shqyrtohet në Gjykatë. Në raste të tilla, padia do të deklarohet e papranueshme për mosekzistencë të aktit, megjithatë, Gjykata ka pranuar se, gjykimi ndaj këtij akti mund të vazhdojë, në qoftë se, paditësi provon se ka interes për të marrë një vendim që e anulon atë akt.

Çështja e ekzistencës ose jo të aktit, mund të shtrohet edhe në rastet kur paditësi ka ngritur padi për anulim kundër një “akti të institucionit të Bashkimit Evropian”, për të cilin ai është i bindur se ky akt ka sjellë pasoja juridike ose efekte ligjore, ndërkohë që, në të vertetë, nuk jemi para një akti të tillë, por jemi para një hapi përgatitor, i cili mund të çojë në nxjerrjen e aktit në një fazë të mëvomshme. Në praktikën e vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, është një rast i tillë, kur paditësi, Korporata e Mjeteve të Biznesit Ndërkombëtar, (IBM), ngriti padi kundër një Letre të Komisionit, e cila e njoftonte atë për faktin se, Komisioni kishte nisur procedurat e konkurrencës kundër saj, me qëllim që të përcaktonte nëse ajo kishte shkelur nenin 86 të Traktatit të Komuniteteve Evropiane, sot neni 102 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian. Letra ishte e shoqëruar me një deklaratë kundërshtimesh, si dhe me kërkesën që Kompania të përgjigjej brenda një afati të caktuar. Komisioni gjatë gjykimit pretendoi se, Letra ishte një akt që nuk mund të kundërshtohet, në bazë të nenit 173 të Traktatit të Komunitetit Evropiane.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në vendimin e saj u shpreh ndër të tjera se:

“...9. Me qëllim që të vlerësojmë nëse masat në fjalë janë akte brenda kuptimit të nenit 173, është e nevojshme që të shohim përmbajtjen e tyre. Sipas praktikës gjyqësore të vazhdueshme të Gjykatës së Drejtësisë, çdo masë efektet ligjore të të cilës janë detyruese dhe të afta të prekin interesat ligjore të paditësit, duke shkaktuar një ndryshim të dallueshëm të pozitës së tij ligjore, është një akt apo vendim, i cili mund të jetë subjekt i një padie, sipas nenit 173, për një deklaram se ai është i palefshëm. Megjithatë, forma me të cilën paraqiten akte apo vendime të tilla, në parim është e parëndësishme në lidhje me çështjen, nëse, ato janë të hapura për t’u kundërshtuar sipas atij neni.

10. Në rastin e akteve apo vendimeve të miratuara me një procedurë që ka disa faza, në veçanti kur ato janë kulmi i një veprimtarie të brendshme, nga praktika gjyqësore është e qartë se, në parim një akt është i hapur për rishqyrtim, vetëm në qoftë se është një masë që parashtron përfundimisht qëndrimin e Komisionit apo Këshillit në mbylljen e asaj procedure dhe jo një masë provizore që synon t’i hapë rrugën një vendimi përfundimtar.

11. Do të ishte ndryshe vetëm në qoftë se aktet apo vendimet e miratuara gjatë procedurave përgatitore, nuk do të kishin jo vetëm të gjitha karakteristikat ligjore, të përmendura më sipër, por përveç kësaj ishin në vetvete kulmi i një procedure speciale, që dallonte nga ajo që synonte t’i lejonte Komisionit ose Këshillit të merrte një vendim mbi përmbajtjen e çështjes.

12. Për më tepër duhet theksuar se, ndërsa masat e karakterit thjesht përgatitor mund të mos jenë vetë subjekt i një kërkesë për t’u deklaruar se ato janë të pavlefshme, çdo defekt ligjor aty, mund të shërbejë si bazë për një padi kundër aktit përfundimtar, për të cilin ato përfaqësojnë një hap përgatitor. ...”⁷⁶

⁷⁶ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen gjyqësore nr. 60/81, Korporata e Mjeteve të Biznesit Ndërkombëtar, kundër Komisionit Evropian; (1981) ECR 2639.

Një tjetër kusht që duhet të plotësojë personi fizik ose juridik privat, në kuadër të provimit prej tij të legjitimitetit aktiv, është që padinë duhet ta ngrejë kundër një akti të institucioneve të Bashkimit Evropian. Me këtë rast, nuk ka rëndësi, nëse akti është një akt legjislativ apo akt tjetër juridik, si dhe nuk ka rëndësi nëse akti është një Rregullorë, Direktivë apo Vendim, e rëndësishme është që akti të ketë fuqi juridike detyruese.

Nga ana tjetër, personi fizik ose juridik privat, por as Shtetet Anëtare, nuk mund të ngrejë padi për të anuluar një ose disa dispozita të Traktateve Kushtetuese, që janë Traktati për Bashkimin Evropian, Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian, si dhe Traktati i Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, për faktin e thjeshtë se, ato nuk janë akte juridike të nxjerra nga institucionet e Bashkimit Evropian, por janë akte juridike të krijuara me marrëveshje të Shteteve Anëtare. Po ashtu, nuk mund të ngrihet padi për të anuluar një marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar nga Bashkimi Evropian me Shtetet e tjera, sepse, edhe kjo përbën një akt juridik që ka dy ose ose shumë palë, nga njëra anë, është Bashkimi Evropian dhe nga ana tjetër, janë shtetet e tjera që kanë ratifikuar marrëveshjen.

*Pra, as marrëveshjet ndërkombëtare nuk përfshihen në aket e nxjerra nga institucionet e Bashkimit dhe për pasojë Gjykata Evropiane e Drejtësisë, nuk ka kompetencë për të shqyrtuar dhe vendosur në lidhje me to. Ndërsa, Gjykata nuk ka kompetencë për të anuluar një marrëveshje ndërkombëtare të lidhur ndërmjet Bashkimit Evropian dhe një ose disa shtetve të tjera, ajo ka kompetencë për të shqyrtuar dhe vendosur, në lidhje me vlefshmërinë e aktit të përfundimit ose të nënshkrimit të marrëveshjes nga ana e Bashkimit, para se kjo marrëveshje të nënshkruhet prej tij, nënshkrimi i cili përbën akt të së drejtës së Bashkimit Evropian. Ligjshmëria e nënshkrimit të marrëveshjes ndërkombëtare nga ana e Bashkimit, vlerësohet mbi bazën e përmbajtjes së Marrëveshjes, të cilën Bashkimi do të nënshkruajë. Në rast se, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, pas shqyrtimit të aktit të miratimit të marrëveshjes ndërkombëtare nga Bashkimi Evropian, me një ose disa Shtete të tjera, e anulon atë, pasi e konsideron si të paligjshme dhe të papajtueshme me Traktatet Kushtetuese dhe *acquis communautaire*, atëherë Bashkimi, nuk mund ta ratifikojë këtë marrëveshje, por, duhet që ta rinegociojë atë.*

Në lidhje me kompetencën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë për të shqyrtuar dhe vendosur për ligjshmërinë e akteve të institucioneve të Bashkimit Evropian, neni 263 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian që ia njeh këtë kompetencë Gjykatës, nuk i përmend, në mënyrë specifike aktet e Bashkimit Evropian, të cilat citohen në nenin 288 të këtij Traktati, për pasojë, kompetenca e Gjykatës nuk kufizohet vetëm në shqyrtimin e këtyre akteve, por ajo shtrihet në çdo akt të këtyre institucioneve, pavarësisht nga forma e tyre, mjafton që to të jenë detyruese. Në fillimet e hartimit të tij, Traktati i Komunitetit Evropian, nuk përmendte aktet e Parlamentit Evropian si akte ndaj të cilave mund të ngrihet padi për anulimin e tyre. Kjo për faktin se, hartuesit e Traktateve Kushtetuese kishin menduar se, Parlamenti nuk kishte kompetencë për të nxjerrë akte juridike me fuqi detyruese.

*Megjithatë, pavarësisht nga mungesa e një parashikimi të tillë, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në vendimin e saj të datës 23 prill 1986, në çështjen *Les Verts kundër Parlamentit Evropian*, duke i bërë një interpretim teleologjik dhe logjik të së drejtës komunitare, arriti në konkluzionin se, bazuar në “ekzistencën e Komunitetit të së drejtës”, edhe aktet e Parlamentit Evropian, mund të kontrollohen për ligjshmërinë e tyre, duke u shprehur se, lejohet kontrolli i ligjshmërisë për të gjitha aktet e çdo institucioni që sjellin efekte të së drejtës. Të njëjtin qëndrim mbajti Gjykata edhe në*

çështjen AETR, 22/70, me vendimin e 31 marsit 1971, duke u shprehur se, padia për anulim mund të ngrihet ndaj “të gjitha dispozitave të miratuara nga institucionet, cilado qoftë natyra ose forma e tyre, dhe që kanë si qëllim të prodhojnë efekte ligjore.”⁷⁷

Në rastet kur bëhet fjalë për aktet atipike të një institucioni të Bashkimit Evropian, pavarësisht nga emërtimi i tyre, Gjykata do të analizojë, rast pas rasti, për të verifikuar nëse këto akte sjellin pasoja juridike ose efekte ligjore. Mbi bazën e këtij verifikimi, Gjykata ka konsideruar si të pramueshme paditë për anulim, të drejtuara nga personat fizikë ose juridikë privatë, të cilat drejtoheshin kundër Komunikatave të Komisionit, Letrave, Kodeve të Etikës, si dhe ndaj çdo lloj akti tjetër, pavarësisht nga emërtimi, që ka sjellë efekte ligjore.

Në lidhje me aktet atipike, të cilat mund të goditen me padi për anulim, interesant është një vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen gjyqësore nr. 22/70, të ngritur ndërmjet dy institucioneve të Bashkimit Evropian, Komisioni kundër Këshillit, në të cilën Shtetet Anëtare, duke vepruar me anë të Këshillit, miratuan me datë 20 mars 1970 një Rezolutë, për të koordinuar veprimet e tyre në bisedimet për një Marrëveshje të Transportit Rrugor Evropian (ERTA/AETR). Komisioni nga ana e tij, nuk ishte dakort me procedurën e bisedimeve të zhvilluara ndërmjet Këshillit dhe Shteteve Anëtare dhe ngriti padi me objekt anulimin ose shpalljen të pavlefshme të Rezolutës së miratuar ndërmjet Këshillit dhe Shteteve Anëtare.

Për këtë padi, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në vendimin e saj, ndër të tjera arsyetoi:

“...48. Në lidhje me bisedimet, Këshilli, në përputhje me kursin e veprimit të vendosur në takimet e tij të mëparshme, vendosi që bisedimet të zhvillohen dhe të përmbillen nga të gjashtë Shtetet Anëtare, të cilët do të ishin palë kontraktuese të ERTA-s.

49. Gjatë bisedimeve dhe në përfundimin e marrëveshjes Shtetet do të veprojnë së bashku dhe do të koordinojnë vazhdimisht qëndrimet e tyre sipas procedurës së zakonshme, në lidhje të ngushtë me institucionet e Komunitetit, me delegacionin e Shtetit Anëtar që aktualisht ka Presidencën e Këshillit, i cili vepron si zëdhënës.

50. Nga Protokolli i mbajtur nuk duket që Komisioni ka shfaqur ndonjë kundërshtim lidhur me përcaktimin nga Këshilli të objektivave të bisedimeve.

51. Nga ana tjetër, ai shprehu rezerva të qarta në lidhje me procedurën e bisedimeve, duke deklaruar që ai mendonte se qëndrimi i miratuar nga Këshilli nuk ishte në përputhje me Traktatin dhe në mënyrë të veçantë me nenin 228.

52. Nga çka u tha më sipër, del se procedurat e Këshillit, që merren me çështjen, përfshihen brenda kompetencave të Komunitetit dhe prandaj Shtetet Anëtare nuk mund të vepronin jashtë kuadrit të institucioneve të përbashkëta.

53. Kështu duket se, përderisa flitet për objektivin e bisedimeve, siç ishte përcaktuar nga Këshilli, procedurat e 20 marsit 1970 nuk mund të kishin qenë thjeshtë shprehje apo njohje e një koordinimi vullnetar, por synonin të parashtronin një kurs veprimi detyrues, si për institucionet, ashtu edhe për Shtetet Anëtare dhe do të reflektoheshin përfundimisht në drejtim të Rregullores.

⁷⁷ Shih për më tepër: Jacque, J, P; “E drejta institucionale e Bashkimit Evropian”, Shtëpia Botuese “Papyrus”, Tiranë, 2010, faqe 477-478.

54. Në pjesën e përfundimeve të tij, që lidhet me procedurën e bisedimeve, Këshilli miratoi dispozita, që kishin mundësi që të shmangeshin në rrethana të caktuara nga procedura e parashtruar nga Traktati, në lidhje me bisedimet me Shtetet e Treta dhe përfundimin e marrëveshjeve.

55. Prandaj, procedurat e 20 marsit 1970 kishin efekte të përcaktuara ligjore, si mbi marrëdhëniet midis Komunitetit dhe Shteteve Anëtare, ashtu edhe mbi marrëdhëniet midis institucioneve. ...”⁷⁸

Sic mund të konstatohet nga parashtrimi i bërë, në këtë Vendim, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, vendosi që të anulohet një akt, i cili në rastin konkret është atipik, pasi bëhet fjalë për një Rezolutë të miratuar nga Këshilli, me të cilën nuk ishte dakort Komisioni dhe për këtë arsye, ky i fundit kishte ngritur padi ndaj kësaj Rezolute. Ashtu siç arsyeton Gjykata në pikën 55 të vendimit të sipërcituar, padia e ngritur ishte në kompetencë të saj, pasi akti i miratuar nga Këshilli, kishte “efekte të përcaktuara ligjore, si mbi marrëdhëniet midis Komunitetit dhe Shteteve Anëtare, ashtu edhe mbi marrëdhëniet midis institucioneve”.

Një tjetër kusht që duhet të plotësojë personi fizik ose juridik privat për ngritjen e padisë për anulim, është që padia të ngrihet kundër të një akti i cili prodhon efekte ligjore ndaj të tretëve. Në rastin e personave fizikë dhe juridikë do të konsiderohet se akti prodhon efekte ligjore, në rastet kur, akti e ndryshon dukshëm situatën juridike të paditësit. Për këtë arsye, nuk mund të ngrihet padia për anulim, kundër një rekomandimi ose opinionit që mund të ketë nxjerrë një institucion i Bashkimit Evropian, për faktin se, këto akte nuk mund të sjellin efekte ligjore ndaj të tretëve, duke mos ndryshuar situatën juridike të paditësit. Po ashtu, nuk mund të ngrihet padia për anulim, as ndaj një Rregullorje të Brendshme të institucionit dhe as ndaj një Udhëzimi, për faktin se, si rregull, as këto akte nuk prodhojnë efekte ligjore ndaj të tretëve.

Megjithatë, kur një akt i brendshëm i një institucioni, pavarisht nga forma dhe emërtimi i tij, prodhon efekte ligjore ndaj të tretëve, atëherë, personi fizik ose juridik privat, ka të drejtë që të ngrejë padi për të kërkuar anulimin e këtij akti. Kështu në një rast konkret, Gjykata e Shkallës së Parë, pranoi padinë e bërë nga parlamentarët e Parlamentit Evropian, kundër vendimit që kishte marrë Parlamenti për refuzimin e formimit të një Grupi Parlamentar. Gjykata në vendimin e saj theksoi se, deputetët duhet të konsiderohen si palë e tretë, kundrejt një akti të Parlamentit që lidhet me kushtet e ushtrimit të mandatit të tyre.⁷⁹

Duke u nisur nga fakti se, akti që kundërshtohet duhet të sjellë efekte ligjore ndaj të tretëve, nuk mund të ngrihet padi për anulim, as ndaj një akti që ka natyrë konfirmuese, pra, që konfirmon një akt tjetër të mëparshëm, të nxjerrë nga institucionet e Komunitetit. Gjykata në këtë rast, verifikon nëse, realisht, akti ka natyrë konfirmuese dhe nuk e ndryshon aktin e mëparshëm, me qëllim që ta deklarojë padinë si të papranueshme. Moslejmi i ankimit ndaj akteve konfirmuese, bazohet në faktin se, një zgjidhje e kundërt do çonte në zgjatjen e afateve të paraqitjes së padisë.

Lejimi i kundërshtimit të aktit konfirmues, në kushtet kur afati për kundërshtimin e aktit të mëparshëm ka përfunduar, do të bënte që të mos

⁷⁸ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen gjyqësore nr. 22/70; Komisioni kundër Këshillit (1971) ECR 263.

⁷⁹ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, të datës 2 tetor 2011, në çështjen Martines. De Gaulle, Front National et Bonmino at d’autres kundër Parlamentit Evropian.

respektoheshin rregullat ligjore në lidhje me paraqitjen e padisë, brenda afateve të caktuara ligjore. Problemi i kundërshtimit të një akti konfirmues, nuk shtrohet në rastet kur afati për kundërshtimin e aktit fillestar nuk ka përfunduar. Në një rast të tillë, paditësi mund të ngrejë padi për anulimin ose aktit fillestar ose të aktit konfirmues ose për anulimin e të dy akteve, si aktit fillestar, ashtu edhe aktit konfirmues.

Çështja e dallimit ndërjmet një akti përgatitor, një akti konfirmues dhe një akti përfundimtar që sjellë efekte ligjore ndaj të tretëve, nuk është në çdo rast e thjeshtë, sidomos në rastet kur akti merret mbi bazën e një procedure të ndërlikuar, që kërkon pjesëmarrjen e disa palëve. Kjo vështirësi takohet shpesh në çështjet që kanë të bëjnë me konkurrencën, ndihmat shtetërore ose çështjen që lidhen me dumping-un.⁸⁰ Në këto çështje, me anë të shqyrtimit të një mase përgatitore, mund të verifikohet nëse, akti ka prodhuar efekte ligjore kundrejt të tretëve, si dhe nëse këto efekte mund të riparohen, vetëm me anë të anulimit të masës përgatitore apo mund të riparohen edhe me anë të anulimit të vendimit përfundimtar.

Kështu në fushën e konkurrencës, një masë përkohshme, e vendosur nga Komisioni, e cila pëbën një akt përgatitor, mund të jetë objekt anulimi, për shkak se sjellë efekte ligjore ndaj të tretëve, fakt ky i konfirmuar edhe nga *Gjykata e Drejtësisë, me vendimin e saj të datës 28 shkurt 1984, në çështjen Ford kundër Komisionit* dhe me vendimin e 17 janarit 1980, në çështjen *Camera Care Ltd kundër Komisionit*. Po ashtu, në fushën e ndihmave shtetërore, Njoftimi që u bëhet palëve të intersuara për të paraqitur Vëretjet e tyre, kundër këtij Njoftimi, mund të jetë objekt anulimi në Gjykatë, perderisa ky Njoftim, sjell pezullimin e ndihmës.⁸¹

Nuk mund të përbëjë akt ndaj të cilit mund të paraqitet padi në gjykatë, as vendimi i një institucioni evropian, me të cilin ai i drejtohet një juridiksioni ose një institucioni tjetër ndërkombëtar, me padi ose ankim për një çështje ku ai mendon se, i janë cënuar interesat e tij. Kështu, në një rast konkret të praktikës gjyqësore, Komisioni kishte ngritur padi në gjykatat e Shteteve të Bashkuara, kundër disa prodhuesve amerikan të cigareve, duke i akuzuar për veprimtari kontrabandë të cigareve. Këtë vendim të Komisionit për ngritjen e padisë në gjykatat amerikane, e kundërshtuan prodhuesit e cigareve, duke ngritur padi për anulim në Gjykatën e Shkallës së Parë. Kjo e fundit me vendimin e saj të datës 15 janar 2003, arsyetoi që, vendimi i marrë nga Komisioni për të ngritur padi në gjykatat amerikane, kundër kompanive të cigareve për veprimtari kontrabandë, nuk sjellë ndryshim të situatës në proces, pasi vetëm gjykimi i dhënë mbi bazën e kësaj padie, mund sjellë efekte ligjore. Gjykata e rrezoi padinë e ngritur me arsyetimin se, shoqëritë në fjalë, nuk mund të bënin padi për anulim, kundër gjykimit të dhënë nga një juridiksion i huaj.⁸² Vendimi i dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë, u konfirmuar edhe nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë, me vendimin e saj të datës 19 dhjetor 2006.

Një kusht tjetër i rëndësishëm që duhet të plotësojë personi fizik ose juridik privat, që të ketë legjitimitet aktiv për ngritjen e padisë për anulimin e një akti të institucionit të Bashkimit Evropian, është që akti ndaj të cilit ngrihet padia të ketë lidhje, të drejtpërdrejtë dhe individuale me të drejtat dhe interesat e ligjshme të

⁸⁰ Çështjet dumping, iu referohen rasteve kur tregtarët jashtë Bashkimit Evropian shesin mallra brenda Bashkimit me çmime shumë të ulta, me qëllim për të dëmtuar tregtarët brenda Bashkimit Evropian.

⁸¹ Shih për më tepër: Jacque, J. P; "E drejta institucionale e Bashkimit Evropian", Shtëpia Botuese "Papyrus", Tiranë, 2010, faqe 480-481.

⁸² Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, të datës 15 janar 2003 në çështjen Philip Morris international et autres vs Commission.

paditësit, ose thënë ndryshe, të prekë, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe individuale interesat e paditësit. Do të konsiderohet se akti prek, në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e paditësit, në qoftë se akti prodhon efekte ligjore kundrejt paditësit, në një kohë që autoriteti i ngarkuar me zbatimin e aktit, nuk gëzon asnjë të drejtë për të marrë vendim. Vendosja e një kushti të tillë është bërë me qëllim që paditë e individit për anulim, të kufizohen vetëm për akte që prodhojnë efekte ligjore për paditësin dhe që mund të ndryshojnë, menjëherë, situatën e tij juridike dhe që ngritja e padive të tilla nga individit ose personi juridik privat, të mos lejohet për aktet me karakter të përgjithshëm, të cilat nuk prekin, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe individuale interesat e paditësit.

Do të konsiderohet se akti prek, në mënyrë individuale interesat e paditësit, në rastet kur ky i fundit për shkak të cilësive të tij të veçanta apo të situatës faktike që e karakterizon, në raport me personat e tjerë, duket qartë se akti e individualizon këtë person, duke rezultuar se, akti i drejtohet pikërisht atij dhe jo personave të tjerë. Lidhje individuale e aktit me interesat e paditësit nënkupton që, paditësi i përkët një rrethi të mbyllur personash ndaj të cilëve zbatohet akti. Por, me qëllim që të konsiderohet që akti cënon në mënyrë individuale interesat e paditësit, nuk mjafton të provohet që paditësi i përkët një rrethi të mbyllur personash, por, duhet edhe të provohet që paditësi dallohet nga rrethana të veçanta, në raport me qëllimin e aktit, rrethana të cilat tregojnë se akti i drejtohet atij.

Kriteri i lidhjes së drejtpërdrejtë dhe individuale të aktit, me interesat e paditësit, është një nga kriteret më të rëndësishme që duhet të provojë personi fizik ose juridik privat, në padinë me objekt anulimin e aktit, i cili, duke u nisur nga rëndësia që paraqet, është parashikuar, në mënyrë të shprehur edhe në Traktatet Kushtetuese. Kështu, në paragrafin e katërt të nenit 263 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, përcaktohet se, personat fizikë ose juridikë privat mund të ngrejë padi për anulimin e një akti të institucionit të Bashkimit Evropian, vetëm në qoftë se akti iu drejtohet atyre dhe prek, në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e tyre.

Po ashtu, duke u nisur nga fakti se, në praktikën e vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë, por edhe të Gjykatës së Shkallës së Parë, sot Gjykata e Përgjithshme, pjesa më e madhe e padive të ngritura nga personat fizikë ose juridikë privatë, janë deklaruar të papranueshme, pikërisht për faktin se, paditësi (personi fizik ose juridik privat) nuk ka arritur që të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe individuale me aktin, ky kriter është trajtuar, me shumë thellësi, nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në shumë vendime të dhëna prej saj, disa prej të cilëve, ato më tipiket, do të citohen edhe në këtë punim Doktorature.

Kriteri i lidhjes së drejtpërdrejtë dhe individuale të paditësit me aktin e kundërshtuar, u trajtua në mënyrë të detajuar, për herë të parë nga ana e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen gjyqësore Nr. 25/62 Plaumann & Co kundër Komisionit Evropian dhe njihet që nga ajo kohë nga studuesit e të drejtës së Bashkimit Evropian, si kriteri i çështjes Plaumann. Kjo çështje kishte të bënte me një Kërkesë që Qeveria Gjermane i bëri Komisionit Evropian, me të cilën kërkonte nga Komisioni që të autorizonte Qeverinë Gjermane që të pezullonte mbledhjen e taksave doganore për mandarinat e importuara nga Shtetet jo Anëtare. Kjo Kërkesë e Qeverisë Gjermane u hodh poshtë nga Komisioni, i cili i ktheu edhe përgjigje zyrtare asaj për hedhjen poshtë të kërkesës. Pala paditëse, shoqëria tregtare Plaumann & Co, ishte një importues i mandarinave në tregun e Komunitetit Evropian dhe ngriti padi kundër vendimit të Komisionit me objekt anulimin e tij, me pretendimin se ky Vendim cënon, drejtpërsëdrejti dhe individualisht interesat e saj.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në vendimin e saj, në lidhje me këtë çështje, ndër të tjera arsyeton:

“...Sipas paragrafit të dytë të nenit të Traktatit të KKE-së, çdo person fizik ose juridik mund të nisë procedurat kundër një vendimi, që megjithëse në formën e një vendimi që i drejtohet një personi tjetër, ka lidhje të drejtpërdrejtë dhe individuale me të parin. Pala paditëse pretendon se, fjalët “person tjetër” në këtë paragraf nuk iu referohen Shteteve Anëtare në cilësinë e tyre si autoritete sovraane, ndaj edhe individët mund të ngrejë padi për anulim kundër vendimeve të Komisionit apo Këshillit, të cilat iu drejtohen Shteteve Anëtare.

Megjithatë, paragrafi i dytë i nenit 173, nuk lejon që një individ të ngrejë padi kundër vendimeve që i drejtohen “një personi tjetër”, që kanë lidhje të drejtpërdrejtë dhe individuale me të parin, por ky nen as nuk e përcakton apo kufizon shtrirjen e atyre fjalëve. Fjalët dhe kuptimi i natyrshëm i kësaj dispozite justifikojnë një interpretim shumë të gjerë. Për më tepër, dispozitat e Traktatit lidhur me të drejtën e palëve të interesuara për të ngritur padi, nuk duhen interpretuar në mënyrë të kufizuar. Prandaj, duke qenë se në Traktat nuk flitet për këtë çështje, atëherë në këtë drejtim mund të supozohet edhe ndonjë kufizim.

...Personat e tjerë, përveç atyre që iu është drejtuar vendimi, mund të provojnë se janë të lidhur individualisht, vetëm në qoftë se ai vendim i prek ata për shkak të attributeve të caktuara që janë të veçanta për ta ose për shkak të rrethanave në të cilat ata diferencohen nga të gjithë personat e tjerë dhe në saj të këtyre faktorëve ata dallohen, individualisht ashtu si dhe në rastin e personit të adresuar. Në rastin aktual, aktiviteti tregtar, i cili mund të praktikohet në çdo kohë nga një person dhe prandaj nuk është aq i ndryshëm sa ta dallojë palën kërkuese në lidhje me vendimin e kundërshtuar, si në rastin e atij që i drejtohet vendimi. Për këtë arsye, padia aktuale për anulim duhet shpallur si e papranueshme. ...”⁸³

Kriteri i çështjes Plaumann, është akoma burimi kryesor ku mbështetet praktika gjyqësore për provimin e lidhjes individuale dhe të drejtpërdrejtë të pLaws kërkuese private, me aktin që ajo kërkon që të anulohet. Bazuar në këtë kriter, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, si dhe më vonë edhe Gjykata e Shkallës së Parë, sot Gjykata e Përgjithshme, kanë vendosur pranimin ose jo të padisë të ngritur nga palët private, në varësi të faktit, nëse pala ka arritur që të provojë se, ka patur lidhje të drejtpërdrejtë dhe individuale me aktin objekt kundërshtimi.

Ky kriter përcakton se, pala kërkuese mund të jetë e lidhur individualisht me një akt që i drejtohet një tjetri, vetëm në qoftë se, ajo diferencohet nga të gjithë personat e tjerë dhe për shkak të këtyre tipareve të veçanta, dallohet në të njëjtën mënyrë, si dhe personi të cilit i është adresuar akti. Gjithësesi ndaj një akti, mund të ketë shumë palë kërkuese, të cilat janë lidhur individualisht. Në çështjen e mësipërme, pala kërkuese humbi, pasi ajo, sipas Gjykatës zhvillonte një aktivitet tregtar që mund të zhvillohen nga çdo person, në çdo kohë, pra, nuk arriti të provojë se, është e tillë që diferencohet nga të gjithë personat e tjerë dhe për shkak të këtyre tipareve, dallohet në të njëjtën mënyrë, si dhe personi që i është drejtuar akti.

Arsyetimi i mësipërm i Gjykatës mund të shfaqë probleme, si nga pikëpamja praktike, ashtu edhe nga ana logjike ose konceptuale. Nga ana praktike zbatimi i këtij kriteri, nuk është shumë realist. Në ekonominë e tregut, fakti nëse një numër i kufizuar apo një numër i madh kompanish tregtare zhvillojnë një aktivitet ekonomik

⁸³ Shih për tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1963) ECR 95, në çështjen gjyqësore Plaumann & C0 vs European Commission.

të caktuar, është rezultat i rregullave të kërkesës dhe ofertës. Në qoftë se, një një moment ose periudhë të caktuar, rritet në mënyrë të papritur kërkesa për një produkt ose shërbim, atëherë, do të rritej edhe numri i kompanive tregtare që do të ofronin një produkt/shërbim të tillë. Në këto kushte, në çështjen konkrete, argumenti i Gjykatës se, aktiviteti i importimit të mandarinave, mund të zhvillohej nga çdo person dhe sasia mund të ndryshonte shumë, prandaj edhe palë kërkuuese nuk është e lidhur individualisht, mund të mos jetë bindës.

Arsyetimi i bërë nga Gjykata në lidhje me *kriterin e çështjes Plaumann*, paraqet probleme dhe nga ana logjike ose konceptuale, sepse, ai e bën të pamundur që një palë paditëse të ketë sukses për të provuar legjitimitimin e saj, përveçse për një kategori shumë të kufizuar çështjesh. Arsyetimi i bërë nga Gjykata sipas të cilës, paditësi nuk mund të individualizohet për faktin se, aktiviteti i importimit të mandarinave mund të kryhet nga cilido, në çdo kohë, e bën të vështirë mundësinë e legjitimitimit së palëve private, duke e shndërruar atë, si një mirazh në shkëmbim, që largohet gjithmonë dhe nuk e kap dot kurrë.⁸⁴

Ashtu siç u citua më lart, *kriteri i çështjes Plaumann*, është zbatuar nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në shumë çështje të tjera të gjykuara prej saj më vonë. Duke qenë se, mbi bazën e këtij kriteri kjo Gjykatë, në varësi nga rrethanat e çështjes dhe kushtet ligjore, në disa raste i ka pranuar paditë e paraqitura nga personat privatë dhe në raste të tjera i ka rrëzuar, si dhe duke u nisur nga rëndësia që paraqet ky kriter, në këtë punim do të jepen disa vendime të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në të cilat ajo Gjykatë ka arsyetuar për plotësimin ose jo nga ana e palës së këtij kriteri.

Kushti i lidhjes së drejtpërdrejtë dhe individuale të personit privat me aktin, i njohur edhe si kriteri i çështjes Plaumann, u zbatua nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë edhe në çështjen gjyqësore me nr. 41-44/70, *Kompania Ndërkombëtare e Frutave Nme, kundër Komisionit*. Kjo çështje ka të bëjë me një Rregullore të miratuar nga Komisioni, me anë të të cilës kufizonte importin e mollëve nga Shtetet e Treta, nga 1 prill 1970, deri më 30 qershor 1970. Rregullorja në fjalë parashikonte një sistem licensash importi, të cilat jepeshin në varësi të shkallës që e lejonte tregu i Komunitetit. Sipas këtij sistemi, në fund të çdo jave, një Shtet Anëtar njoftonte Komisionin lidhur me sasinë për të cilat ishin kërkuar licensa importi, gjatë javës pararendëse dhe mbi bazën e këtij informacioni, Komisioni vendoste për dhënien e licensave. Padia e bërë nga Kompania Ndërkombëtare e Frutave Nme, kundër Komisionit, kishte të bënte për një Rregullore, sipas të cilës zbatohet kjo skemë, për një javë të caktuar.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, gjatë shqyrtimit të çështjes, vlerësoi se, paditësi kishte lidhje të drejtpërdrejtë dhe individuale me aktin e kundërshtuar, duke e deklaruar padinë e paraqitur si të pranueshme. Në vendimin e saj, kjo Gjykatë, ndër të tjera arsyeton:

“...23. Për më tepër nga sistemi i futur në Rregulloren Nr. 459/70, sidomos nga neni 2(2) i saj, është e qartë se, vendimi për dhënien e licensave të importit është një çështje që i takon Komisionit.

24. Sipas kësaj dispozite, vetëm Komisioni është kompetent të vlerësojë situatën ekonomike, mbi bazën e të cilës duhet justifikuar dhënia e licensave të importit.

⁸⁴ Shih për më tepër: Shih për më tepër: Craig P; De Burca G; “*E drejta e Bashkimit Evropian, Tekste, çështje gjyqësore dhe materiale*”, botuar nga Qendra e Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2013, faqe 598-599.

25. Neni 1(2) i Rregullores Nr. 459/70, duke parashikuar që Shtetet Anëtare, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 2, duhet t'i japin licensë palës së interesuar që e kërkon atë, e bën të qartë se autoritetet kombëtare nuk gëzojnë ndonjë liri veprimi në çështjen e dhënies së licensave dhe për kushtet në të cilat duhet t'u jepen palëve të interesuara.

26. Detyra e këtyre autoriteteve është vetëm të grumbullojnë të dhënat e nevojshme me qëllim që Komisioni të marrë vendimet e tij në përputhje me nenin 2(2) të asaj Rregullorje dhe më pas të miratojnë masat kombëtare të nevojshme për t'i dhënë fuqi atij vendim.

27. Në këto rrethana, kur bëhet fjalë për palët e interesuara, çështja e dhënies apo refuzimit të lejes së importit duhet të kufizohet sipas atij vendimi.

28. Ndaj masa që vendos Komisioni për dhënien e licensave të importit prek, drejtpërsëdrejti pozitën ligjore të palëve të interesuara.

29. Në këtë mënyrë palët kërkuese, përmbushin kërkesat e paragrafit të dytë të nenit 173 të Traktatit dhe për këtë arsye janë të pranueshme. ...”⁸⁵

Në një çështje tjetër, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, arriti në të konkluzionin e kundërt, sipas të cilit, paditësi nuk preket, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe individuale nga një akt i Komisionit, që kishte të bënte me një Vendim, sipas të cilit Komisioni autorizonte Dukatit e Madh të Luksemburgut, ose shtetin të Luksemburgut, që t'i jepte ndihma financiare firmave të çelikut që ndodheshin në shtetin e Luksemburgut, me kusht që ato të zvogëlonin kapacitetin e prodhimit. Ky akt u kundërshtua nga komuna e Diferdanzhes, e cila kërkoj anulimin e aktit, pasi, sipas saj, akti prekte, drejtpërsëdrejti dhe individualisht interesat e saj.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, duke e konsideruar si të papranueshme padinë e ngritur, në vendimin e saj, ndër të tjera, arsyetoi:

“...10. Në këtë rast, masa e kundërshtuar që i drejtohet Dukatit të Madh të Luksemburgut, e autorizon atë të japë disa ndihma për ndërmarrjet e përmendura me kusht që ata të pakësojnë kapacitetin e prodhimit të tyre, me një sasi të caktuar. Megjithatë, Vendimi nuk cakton as ndërmarrjet ku duhet pakësuar apo mbyllur prodhimi dhe as fabrikat që duhen mbyllur si rezultat i mbarimit të prodhimit. Përveç kësaj në vendim thuhet se Komisioni duhet njoftuar për datat e mbylljes, vetëm nga 31 janari i vitit 1984, ndaj ndërmarrjet e prekura ishin të lira që deri në atë datë dhe nëse ishte e nevojshme, në marrëveshje me Qeverinë e Luksemburgut të caktonin normat e detajuara për ristrukturimin e nevojshëm, për t'u pajtuar me kushtet e përcaktuara në atë vendim.

11. Për më tepër, ai përfundim konfirmohet me nenin 2 të Vendimit, sipas të cilit pakësimi i kapacitetit mund të kryhej edhe nga ndërmarrje të tjera.

12. Nga kjo del se Vendimi i kundërshtuar iu linte autoriteteve kombëtare dhe ndërmarrjeve të interesuara një lloj lirie veprimi në lidhje me mënyrën e zbatimit të tij dhe në veçanti me zgjedhjen e fabrikave që duheshin mbyllur, ndaj vendimi nuk mund të vlerësohet se ka lidhje të drejtpërdrejtë dhe individuale me komunat, me të cilat janë të lidhura ndërmarrjet, që preken për shkak të vendndodhjes së fabrikave të tyre. ...”⁸⁶

⁸⁵ Shih për tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1971) ECR 411, në çështjen gjyqësore Nr. 41-44/70; International Fruit kundër Komisionit.

⁸⁶ Shih për tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1984) ECR 411, në çështjen gjyqësore Nr. 222/83; Komuna e Diferdanzhes kundër Komisionit Evropian.

Kriteri i lidhjes së drejtpërdrejtë dhe individuale të personit privat me aktin e kundërshtuar, i njohur edhe si kriteri i çështjes Plaumann, ka gjetur zbatim në praktikën e vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë edhe për akte juridike detyruese që vendosin rregulla të përgjithshme dhe abstrakte, mjafton që personi privat të provojë se akti prek, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe individuale interesat e ligjshme të tij. Kështu zbatimi i këtij kriteri për aktet juridike të përgjithshme, është bërë nga Gjykata në disa vendime të saj, ku një nga më interesantet e vendimi në lidhje me çështjet gjyqësore 789 dhe 790 Calpak SpA dhe Societa... Fruta SpA, kundër Komisionit. Rrethana e faktit të këtyre çështjeve, të cilat për shkak të objektit të përbashkët të tyre, janë bashkuar nga Gjykata në një gjykim të vetëm, janë si më poshtë:

Paditësit ishin prodhues të dardhave të një marke të përcaktuar saktësisht, dhe paraqitën padi kundër një Rregullorje të Komisionit, duke pretenduar se, llogaritja e ndihmës së prodhimit që iu ishte dhënë atyre, nuk kishte vlerë. Sipas kushteve të Rregullores, ndihma që jepej ndaj prodhimit, duhej llogaritur mbi bazën e prodhimit mesatar të tre viteve të kaluara, me qëllim që të shmangej rreziku i supërprodhimit. Palët paditëse pretendonin se, Komisioni e kishte shkelur këtë dispozitë të Rregullores, pasi e kishte bazuar llogaritjen e ndihmës, vetëm në një vit prodhimi, gjatë të cilit prodhimi ishte mjaft i ulët. Paditësit pretendonin se, ata ishin një grup i mbyllur dhe i përcaktuar, anëtarët e të cilit njiheshin apo kishin mundësi që të identifikoheshin nga Komisioni.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në lidhje me këtë çështje, arriti në përfundimin se paditë e paraqitura ishin të papranueshme, duke arsyetuar në vendimin e saj, ndër të tjera se:

“...7. Paragrafi i dytë i nenit 173 iu jep të drejtë individëve të kontestojnë, inter alia, çdo akt i cili, megjithëse në formën e një Rregullorje, ka lidhje të drejtpërdrejtë dhe individuale me ta. Objektivi i asaj dispozite në veçanti, është të pengojnë institucionet e Komunitetit që vetëm nga zgjedhja e formës së aktit të kenë statusin e përjashtimit të kërkesës së një individi kundër një akti, që lidhet me të, drejtpërdrejt dhe individualisht, prandaj kjo do të thotë që zgjedhja e formës, nuk mund të ndryshojë natyrën e masës.

8. Sipas paragrafit të dytë të nenit 189 të Traktatit, kriteri i dallimit midis një Rregullorje dhe një Vendimi, lidhet me faktin, nëse, masa ka apo nuk ka zbatim të përgjithshëm. ...

9. Një dispozitë, e cila kufizon dhënien e ndihmës së prodhimit për të gjithë prodhuesit në një drejtim prodhimi të caktuar, me një përqindje të njëjtë mbi sasinë e prodhuar prej tyre, gjatë një periudhë të njëjtë, është një masë e cila ka karakter të përgjithshëm, sipas kuptimit të nenit 189 të Traktatit. Në fakt, masa zbatohet për situata të përcaktuara, në mënyrë objektive dhe ka efekte ligjore, në lidhje me kategoritë e personave të përshkruar, me një mënyrë të përgjithësuar dhe abstrakte. Natyra e masës së një Rregulloreje, nuk vihet në diskutim nga fakti i thjeshtë se, është e mundur që të përcaktohet numri e madje edhe identiteti i prodhuesve që do t'u jepet ndihma, e cila, pra, është e kufizuar. ...”⁸⁷

Siç mund të shikohet nga arsyetimi i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në vendimin e mësipërm, në çështjen Calpak, nga ana e kësaj Gjykate, për legjitimitimin e personave privatë në paditë me objekt anulimin e një akti, me karakter të

⁸⁷ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1971) ECR 411, në çështjet gjyqësore Nr. 789 dhe 790; Calpak SpA & Societa Emiliana... SpA kundër Komisionit.

përgjithshëm, zbatohen dy kritere; *kriteri i kategorisë së mbyllur* dhe *kriteri i terminologjisë abstrakte*. Sipas *kriterit të kategorisë së mbyllur*, një palë private *do të mund të legjitimohet* për të ngritur padi për anulimin e një akti, në qoftë se, ajo arrin të provojë se, duke i nisur nga cilësitë e veçanta që ka, si dhe duke iu referuar rrethanave të faktit, rezulton e qartë se, akti i drejtohet pikërisht asaj pale, duke prekur, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe individuale interesat e saj. Sipas *kriterit të terminologjisë abstrakte*, një palë private, *nuk mund të legjitimohet* për të kërkuar anulimin e një akti, në qoftë se akti është me karakter të përgjithshëm dhe iu referohet situatave të përcaktuara në mënyrë objektive dhe që ka efekte ligjore, ndaj kategorive të personave që identifikohen në mënyrë të përgjithshme dhe abstrakte.

Ndërsa, *kriteri i kategorisë së mbyllur* është më i lehtë për t'u kuptuar dhe është trajtuar nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë në shumë vendime të saj, disa prej të cilëve janë paraqitur edhe në këtë punim, *kriteri i terminologjisë abstrakte, paraqitet më problematik*. Ky kriter e bën shumë të vështirë që një palë private, të mund të kundërshtojë një akt që paraqitet në formën e një Rregulloreje. Kjo për faktin se, në raste të tilla, Gjykata, më shumë sesa do të shikonte përmbajtjen e aktit, do t'i referohej formës së tij. Nga ana tjetër, qëllimi i lejimit të personave privatë për kundërshtimin e akteve të tilla, ashtu siç u shpreh edhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë në *çështjen Calpak*, ishte që të pengonte institucionet e Komunitetit, që të mos i imunizonin aktet ndaj të cilëve mund të ngriheshin padi për anulim, për shkak të formës së klasifikimit të tyre ose thjesht për shkak të emërimit të tyre.

Arsyetimi i mësipërm i Gjykatës kishte të bënte me raste kur një Rregullore, në fakt, në të vertetë ishte një Vendim, që kishte lidhje të drejtpërdrejtë dhe individuale me palën kërkuese. Një gjë e tillë, kërkonte që Gjykata të shihte pas formës së aktit, që të përcaktonte që, nëse, akti në përmbajtje ishte apo jo një Rregullore. Ashtu siç theksoi Gjykata në *çështjen Calpak*, një Rregullore do të vlerësohet në të vertetë si e tillë, në qoftë se ajo, zbatohet në situata të përcaktuara, në mënyrë objektive dhe që sjellin efekte ligjore për persona që përcaktohen, në mënyrë të përgjithshme dhe abstrakte. Megjithatë, pavarësisht nga konstatimi i mësipërm, gjithmonë, ekziston mundësia që të hartohen akte me karakter të përgjithshëm, me qëllim për t'i përjashtuar nga goditja për anulim, sidomos pas arsyetimit të bërë nga Gjykata, sipas të cilës, njohja e numrit apo e identitetit të atyre që prekeshin nga akti, nuk do ta pengonte aktin që të vlerësohej si një Rregullore e vertetë.⁸⁸

Duke u bazuar në dy kriteret e mësipërme, kriterin e kategorisë së mbyllur dhe kriterin e terminologjisë abstrakte, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në një *çështje tjetër gjyqësore, konkretisht në çështjen Codorniu SA kundër Këshillit*, vlerësoi se, një akt i miratuar nga Këshilli si Rregullore, në të vertetë nuk ishte i tillë, pasi nuk i referohej situatave të përcaktuara, në mënyrë objektive dhe që sillnin efekte ligjore ndaj personave që identifikoheshin, në mënyrë të përgjithshme dhe abstrakte. Çështja e mësipërme kishte të bënte me një kompani spanjolle që prodhonte verë, konkretisht kompania Codorniu SA, e cila kundërshtoi një Rregullore të Këshillit që përcaktonte se, termi "*cremant*", duhej të përdorej vetëm për verërat e gazuara, të një cilësie të veçantë që prodhoheshin në Francë ose Luskesmburg. Pala paditëse prodhonte verë të gazuar në Spanjë dhe kishte një markë tregtare që përmbante fjalën "*cremant*", si dhe rezultoi që edhe prodhues të tjerë spanjollë të verërave, e përdornin këtë fjalë. Këshilli argumentoi që akti përbënte një Rregullore brenda kriterit të çështjes Calpak dhe se ai

⁸⁸ Shih për më tepër: Craig P; De Burca G; "*E drejta e Bashkimit Evropian, Tekste, çështje gjyqësore dhe materiale*", botuar nga Qendra e Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2013, faqe 601.

nuk mund të kundërshtohet, pavarësisht se ishte i mundur identifikimi i numrit apo i personave që prekeshin nga akti.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë arriti në përfundimin se, akti i kundërshtuar nuk ishte në të vertetë një Rregullore, duke arsyetuar, në vendimin e saj, ndër të tjera, që:

“...18. Siç është shprehur tashmë Gjykata e Drejtësisë, karakteri i përgjithshëm i zbatimit dhe natyra e një mase, nuk vihet në diskutim nga fakti se është e mundur të përcaktosh, pak a shumë me saktësi, numrin apo madje edhe identitetin e personave, për të cilët ajo zbatohet në një kohë të caktuar, për atë kohë sa është e vendosur që ajo zbatohet ndaj tyre, në saj të situatës objektive ligjore apo faktike, të përcaktuara nga masa në fjalë, në lidhje me qëllimin e saj.

19. Megjithatë është e vertetë që sipas kriterit të paragrafit të dytë të nenit 173 të Traktatit, masa e kundërshtuar nga natyra dhe në sajë të sferës së zbatimit të saj, ka karakter legjislativ, për faktin se ajo zbatohet për tregtarët e interesuar në përgjithësi dhe që nuk pengon që të ketë lidhje individuale me disa prej tyre.

20. Personat fizikë apo juridikë mund të pretendojnë që një masë e kundërshtuar ka lidhje individuale me ta, vetëm në qoftë se ajo i prek ata për shkak të disa cilësive që janë të veçanta për ta ose për shkak të rrethanave faktike, ata diferencohen nga personat e tjerë.

21. Codorniu ka regjistruar markën tregtare grafikisht “Grand Cremant de Codorniu”, në Spanjë në vitin 1924. Duke e kufizuar të drejtën për përdorimin e termit “cremant”, vetëm për prodhuesit e verërave në Francë dhe Luksemburg, dispozita e kundërshtuar e pengon Codornium që të përdorë markën e tij tregtare grafike.

22. Nga kjo del se Codorniu ka krijuar ekzistencën e një situate që nga pikëpamja e dispozitës së kundërshtuar, e dallon atë nga të gjithë tregtarët e tjerë.
...⁸⁹

Zbatimi i kriterit të lidhjes së drejtëpërdrejtë dhe individuale të personit fizik ose juridik privat me aktin që kundërshtohet, në rastet e akteve me karakter të përgjithshëm, siç janë Rregulloret dhe Direktivat, u vështirësua akoma më shumë me ndryshimet që iu bënë Traktateve Kushtetuese, pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës. Megjithatë, Gjykatat e Bashkimit Evropian, kanë mbajtur qëndrim, rast pas rasti, nëse, një palë private i përmbush kriteret ligjore për legjitimimin aktiv për kundërshtimin e një akti, pavarësisht nga forma apo emërtimi i aktit, si dhe pavarësisht procedurës së tij, duke mos u kufizuar tek ana formale e aktit, por, tek thelbi ose përmbajtja e tij.

Kështu, duke iu referuar rasteve të praktikës gjyqësore, në lidhje me këtë çështje, do të citoj edhe një tjetër vendim të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, i cili është edhe vendimi i fundit që do të paraqitet në këtë punim, sa i përket të drejtës së personave fizikë dhe juridikë privat për të ngritur padi, me objekt anulimin e një akti të institucioneve të Bashkimit Evropian. Ky vendim gjyqësor i referohet çështjes Nr. C-50/00; *Union de Pequenos Agricultores (UPA) kundër Këshillit* dhe kishte të bënte me padinë e ngritur nga shoqatë fermerësh UPA, për anulimin e Rregullores së Këshillit Nr. 1638/98, e cila ndryshonte organizimin e përbashkët të tregut të vajit të ullirit. Gjykata e Shkallës së Parë vendosi mospranimin e padisë, sepse, sipas saj, anëtarët e shoqatës nuk ishin të lidhur individualisht me Rregulloren. Gjykata

⁸⁹ Shih për tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1994) ECR 1853, në çështjen gjyqësore Nr. C-309/89; Codorniu SA kundër Këshillit Evropian.

Evropiane e Drejtësisë, mbi bazën e ankimit të bërë nga UPA, e ndryshoi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, duke iu referuar parimit të çështjes Codorniu, sipas të cilit një Rregullore mund të kundërshtohet, me kusht që pala kërkuuese, të mund të provonte lidhjen individuale në përputhje me kriterin e çështjes Plaumann. Në vendimin e saj, kjo Gjykatë, ndër të tjera, arsyetoi:

“...37. Në qoftë se, kushti i lidhjes së drejtpërdrejtë dhe individuale të paditësit me aktin nuk është plotësuar, një person fizik ose juridik, në asnjë rrethanë nuk ka status të ngrejë një padi për anulimin e një Rregulloreje.

38. Megjithatë, Komiteti Evropian është një Komitet, i cili bazohet në rendin ligjor, në të cilin institucionet e tij janë subjekt i rishqyrtimit gjyqësor lidhur me pajtueshmërinë e akteve të tyre me Traktatin dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës, që përfshin edhe të drejtat themelore.

39. Prandaj, individët kanë të drejtën e mbrojtjes gjyqësore efektive të të drejtave, që burojnë nga rendi ligjor i Komitetit dhe e drejta për një mbrojtje të tillë është një nga parimet më të rëndësishme të së drejtës që buron nga traditat e përbashkëta kushtetuese të Shteteve Anëtare.

40. Traktati ka krijuar një sistem të plotë kompensimesh dhe procedurash ligjore, që synojnë të garantojnë rishqyrtimin gjyqësor të ligjshmërisë së akteve të institucioneve. Sipas këtij sistemi, kur personat fizikë ose juridikë, për shkak të kushteve për pranueshmëri, të parashikuara në paragrafin e katër të nenit 172 të Traktatit, nuk mund të kundërshtojnë drejtpërsëdrejti masat e Komitetit me zbatim të përgjithshëm, ata janë në gjendje, në varësi të çështjes, të kërkojnë në mënyrë indirekte pavlefshmërinë e akteve të tilla, para gjykatave të Komitetit, sipas nenit 184 të Traktatit ose ta bëjnë një gjë të tillë para gjykatave kombëtare dhe t’u kërkojnë atyre, meqenëse ata vetë nuk kanë juridiksion që t’i shpallin të pavlefshme, të bëjnë një referim në Gjykatën e Drejtësisë, për një vendim paraprak mbi vlefshmërinë.

41. Në këtë mënyrë, iu takon Shteteve Anëtare që të krijojnë një sistem rregullash dhe procedurash ligjore, që të garantojë respektimin e të drejtës për mbrojtje gjyqësore efektive.

42. Në këtë kontekst, në përputhje me nenin 5 të Traktatit, gjykatave kombëtare iu kërkohet, me aq sa është e mundur, të interpretojnë dhe zbatojnë normat procedurale kombëtare, që përcaktojnë ushtrimin e të drejtave të padisë në një mënyrë që iu mundëson personave fizikë ose juridikë, të kundërshtojnë para gjykatave ligjshmërinë e çdo vendimi apo mase tjetër kombëtare, lidhur me zbatimin ndaj tyre të një akti të Komitetit me zbatim të përgjithshëm, duke kërkuar pavlefshmërinë e një akti të tillë.

43. Nuk është e pranueshme të miratosh interpretimin e sistemit të rregullimeve, për faktin se një padi e drejtpërdrejtë për anulim para gjykatave të Komitetit do të ishte në përdorim, në qoftë se, pas shqyrtimit nga ajo Gjykatë e normave të caktuara, procedurale, kombëtare, mund të tregohet se ato norma, nuk i lejojnë individit të nisë procedurat gjyqësore për të kundërshtuar vlefshmërinë e masës së Komitetit në shqyrtim. Një interpretim i tillë do t’i kërkonte gjykatës së Komitetit të shqyrtonte në çdo rast të veçantë dhe të interpretonte të drejtën procedurale kombëtare. Kjo do të shkonte përtej juridiksionit të saj, kur shqyrtohet ligjshmëria e masave të Komitetit.

44. Së fundi, duhet shtuar se sipas sistemit të rishqyrtimit gjyqësor të ligjshmërisë, të caktuar nga Traktati, një person fizik ose juridik mund të ngrejë një padi, që kundërshton një Rregullore, vetëm nëse ajo lidhet me të, drejtpërsëdrejti dhe individualisht. Megjithëse ky kusht i fundit mund të interpretohet nën dritën e parimit

të mbrojtjes gjyqësore efektive, duke marrë parasysh rrethanat e ndryshme që mund të dallojnë palën kërkuese, individualisht, një interpretim i tillë, nuk mund të ketë efektin e lënies mënjane të kushtit në fjalë, që parashikohet shprehimisht në Traktat, pa shkuar përtej juridiksionit që Traktati iu ka dhënë Gjykatave të Komunitetit. ...”⁹⁰ Kushti i fundit që duhet të plotësojë personi fizik ose juridik privat për legjitimimin e tij në ngritjen e padive me objekt anulimin e një akti të institucionit të Bashkimit Evropian, është që, padinë e tij duhet ta ngrejë brenda dy muajve nga botimi i aktit ose masës ose brenda dy muajve nga njoftimi i aktit apo i marrjes dijeni prej tij.⁹¹ Respektimi i këtij afati nga ana e paditësit është shumë i rëndësishëm, sepse, në të kundërt, padia e ngritur jashtë këtij afati, do të rrëzohet nga Gjykata si e papranueshme, duke mos përmbushur në këtë mënyrë paditësi, legjitimimin për shkak të kohës së paraqitjes së padisë (*ratione temporis*).

Më sipër u trajtuan kushtet ose kriteret që duhet të plotësojë personi fizik ose juridik privat për legjitimimin e tij (*locus standi*), për ngritjen e një padie me objekt anulimin e një akti të institucionit të Bashkimit Evropian. Përsa i përket rasteve kur një palë private mund të ngrejë padi me objekt anulimin e aktit, këto raste janë të njëjta me rastet kur kjo padi ngrihet nga Shtetet Anëtare ose institucionet e Bashkimit Evropian dhe duke iu referuar paragrafit të dytë të nenit 263 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, rezulton se këto raste janë:

- kur institucioni ose organi që ka nxjerrë aktin, nuk ka patur kompetencë për të nxjerrë një akt të tillë;
- kur institucioni ose organi e ka nxjerrë aktin, duke mos respektuar, në mënyrë flagrante, procedurën;
- kur akti i nxjerrë, është në kundërshtim me dispozitat e Traktatave Kushtetuese ose me dispozitat e tjera ligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre;
- kur akti i nxjerrë nga institucioni ose organi, është bërë duke shpërdorur kompetencat.

Me ngritjen e padisë për anulim nga ana e personit fizik ose juridik privat dhe me legjitimimin e tij, në rastet kur ai i plotëson të gjitha kushtet ligjore për legjitimim, të cilat janë përmendur më lart në këtë çështje, nga ana e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë zhvillohet procedura e gjykimit, e cila siç është është trajtuar në çështjen II.3 të këtij Punimi, kalon në dy pjesë ose faza, në fazën me shkrim dhe në fazën me gojë dhe në përfundim të gjykimit Gjykata vendos ose pranimin e padisë, duke e anuluar aktin objekt gjykimi ose rrëzimin e padisë, duke mbetur akti në fuqi. Sipas Traktatave Kushtetuese, kur Gjykata e Drejtësisë konkludon se padia është e bazuar, ajo e deklaron të pavlefshëm aktin që kanë qenë objekt i kundërshtimit.⁹² Megjithatë, Gjykata me vendimin e saj, nuk duhet të shkojë përtej anulimit të aktit, dhe nuk mund t’u japë urdhëra institucioneve ose organeve të Bashkimit Evropian që të nxjerrin një ose disa akte konkrete, pasi kjo do të përbënte tejkalim të kompetencave nga ana e Gjykatës dhe shkelje të parimit të pavarësisë dhe ekuilibrit ndërmjet institucioneve

⁹⁰ Shih për tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (2002) ECR I-6677, në çështjen gjyqësore Nr. C-50/00 P Union de Pequeños Agricultores kundër Këshillit Evropian.

⁹¹ Paragrafi i fundit i nenit 263 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon: “Proceset e parashikuara në këtë nen fillojnë brenda dy muajve nga botimi i masës ose nga njoftimi i masës paditësit ose, në mungesë të kësaj, nga dita që ka marrë dijeni për këtë të fundit, sipas rastit”.

⁹² Paragrafi i parë i nenit 231 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon: “Nëse padia është e bazuar, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian e deklaron të pavlefshëm aktin në fjalë”.

(*check and balance*), si një nga parimet themelore mbi bazën e të cilit janë ndërtuar dhe funksionojnë të gjitha institucionet e Bashkimit, përfshirë edhe Gjykatën Evropiane të Drejtësisë.

Pavarsisht nga fakti se, vendimi i Gjykatës ka fuqi dhe është i detyrueshëm, vetëm për palët që kanë marrë pjesë në gjykim (*inter partes*), efektet e anulimit të aktit, kanë karakter të përgjithshëm (*erga omnes*) dhe vendimi i Gjykatës ka efekte prapavepruese (*ex tunc*).⁹³ Fakti që anulimi i aktit ka efekte *erga omnes* ose të përgjithshme, do të thotë se, akti i anuluar nuk mund të sjellë pasoja juridike, as për palët dhe as për ndonjë subjekt tjetër të së drejtës. Efekti *ex tunc* ose prapaveprues i vendimit të Gjykatës do të thotë që ky akt konsiderohet se nuk është nxjerrë ndonjë herë dhe pasojat e pavlefshmërisë së tij, fillojnë jo nga momenti i nxjerrjes së vendimit të Gjykatës, por, që nga data e miratimit të aktit, që është deklaruar i pavlefshëm.

Megjithatë, pavarasht nga efektet prapavepruese të vendimit të Gjykatës, kjo e fundit mundet që në funksion të zbatimit të parimit të sigurisë ligjore, të shprehet se, cila efekte të aktit të anuluar, do të kenë vlerë juridike dhe për pasojë nuk do të anulohen. Një e drejtë e tillë i është njohur Gjykatës, në mënyrë të shprehur, nga paragrafi i dytë i nenit 231 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, i cili parashikon se, kur Gjykata e çmon të nevojshme, ajo në vendimin e saj përcakton se, cilat pasoja të aktit të cilin ajo e ka deklaruar të pavlefshëm, do të konsiderohen përfundimtare, pra, nuk do të anulohen.

Në praktikën e punës së saj, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, kur ka vendosur anulimin e aktit mbi bazën e një padie të ngritur nga personi fizik ose juridik privat, është shprehur për ruajtjen e disa pasojave të aktit edhe pse ky akt është deklaruar i pavlefshëm, në funksion të ruatjes së interesave të ligjshme të personave të tretë dhe të zbatimit të parimit të sigurisë ligjore. Kështu, në çështjen Nr. 92/78, *Cimmenthal kundër Komisionit*, Gjykata në vendimin e saj përcaktoi se, efektet e vendimit të anuluar të Komisionit, ruheshin për çdo person që kishte pasur sukses, bazuar në çmimin e parashikuar në vendimin e Komisionit.⁹⁴

Në qoftë se, pas anulimit të aktit, krijohet një boshllëk ligjor, institucioni ose organi që ka nxjerrë aktin, është i detyruar që të marrë masa për zbatimin e vendimit të Gjykatës, duke nxjerrë një akt të ri, i cili, duhet të jetë në përputhje me rendin juridik evropian dhe sidomos të mos përmbajë ato shkleje që janë konstatuar nga Gjykata dhe të cilat kanë çuar në anulimin e aktit. Ndër masat e tjera të nevojshme për rregullimin e pasojave që vijnë nga anulimi i aktit, përfshihet edhe detyrimi i institucionit për të shfuqizuar të gjitha aktet që kanë të njëjtin efekt, me aktin e deklaruar të pavlefshëm, si dhe detyrimin për të shfuqizuar, të gjitha aktet e mëparshme që burojnë ose rrjedhin prej aktit që është deklaruar i pavlefshëm. Por, duhet të kemi parasysh që, detyrimi që ka institucioni ose organi i Bashkimit Evropian, për të rregulluar pasojat që vijnë nga anulimi i aktit, nuk duhet të prekë, në asnjë rast, përmbushjen e detyrimeve që kanë institucionet dhe organet e Bashkimit, për dëmshpërblimin e dëmeve të shkaktuara personave të tretë, gjatë veprimtarisë së tyre ose të agjenteve të tyre.

⁹³ Shih për më tepër: Jacque, J. P; "E drejta institucionale e Bashkimit Evropian", Shtëpia Botuese "Papyrus", Tiranë, 2010, faqe 495.

⁹⁴ Shih për tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (179) ECR 77/811, në çështjen gjyqësore Nr. 92/78; *Cimmenthal vs Commission*.

3.2. Paditë e ngritura nga personat fizikë ose juridikë privat, me objekt mosveprimin e institucioneve të Bashkimit Evropian.

Personat fizikë ose juridikë privat, në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme, mund të ngrejë padi, jo vetëm me objekt anulimin e një akti të institucionit evropian, por edhe me objekt detyrimin e një institucioni ose organi të Bashkimit që të veprojë, që të nxjerrë një akt ose masë të caktuar që lidhet me interesat e tyre, padi të cilat njihen me emrin padi mosveprimi. Kjo e drejtë e individëve për të ngritur padi mosveprimi është e parashikuar në mënyrë të shprehur në paragrafin e dytë të nenit 265 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, në të cilin thuhet që, *çdo person fizik ose juridik mund të ngrejë padi para Gjykatës së Drejtësisë, në qoftë se, një institucion, organ, zyrë apo agjensi e Bashkimit, nuk ka nxjerrë një akt ose nuk ka marrë një masë, të cilën sipas Traktateve Kushtetuese dhe akteve ligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre, ishte e detyruar që ta merrte.*⁹⁵

Kushtet për ngritjen e padisë së personit fizik ose juridik privat, me objekt detyrimin e institucionit ose organit të Bashkimit Evropian që të veprojë, janë përcaktuar në paragrafin e parë të nenit 265 të këtij Traktati, i cili flet për kushtet që duhet të plotësojnë Shtetet Anëtare ose institucionet e Bashkimit për ngritjen e një padie të tillë. Duke iu referuar përmbajtjes së kësaj dispozite rezulton se, *kushti i parë që duhet të plotësojë një palë private për ngritjen e padisë për mosveprim, është që Traktatet Kushtetuese ose normat e tjera ligjore të nxjerra në bazë dhe në zbatim të tyre, që përbëjnë të drejtën e Bashkimit Evropian ose *acquis communitaire*, të parashikojnë, në mënyrë të shprehur, detyrimin e institucioneve të Bashkimit për të vepruar, për nxjerrjen e një akti ose marrjen e një mase.* Në bazë të këtij kushti, duhet që të ekzistojë një detyrim aktiv që institucionet e Bashkimit Evropian të veprojnë, të nxjerrin një akt, apo masë ose të kryejnë një veprim të caktuar.

Rastet në të cilat institucionet ose organet e Bashkimit Evropian, janë të detyruara që të veprojnë, gjenden në dispozitat konkrete të Traktateve Kushtetuese, si dhe në dispozitat e tjera ligjore që përbëjnë rendin juridik evropian. Përmendja ose trajtimi një nga një i të gjitha këtyre rasteve, nuk është në objektin e këtij Punimi, por, gjithësesi, për shkak të shumëllojshmërisë dhe pafundësisë së situatave faktike, do të ishte e pamundur, objektivisht për t'u trajtuar.

Pavarsisht nga kjo, për të patur një ide më të qartë, në lidhje me plotësimin e këtij kushti nga ana e palëve private në ngritjen e padisë për mosveprim, nga ana ime do të përmenden disa raste konkrete, kur dispozitat e Traktatave Kushtetuese ose të rendit ligjor evropian, në tërësi, i detyrojnë, në mënyrë të shprehur, institucionet e Bashkimit Evropian që të veprojnë. Kështu një nga rastet, sipas të cilëve institucionet dhe organet e Bashkimit janë të detyruara që të veprojnë dhe të nxjerrin akte apo të marrin masa të caktuara, janë rastet që kanë të bëjnë me ndalimin e diskriminimit për shkak të gjinisë, origjinës racore ose etnike, fesë, aftësive të kufizuara, moshësh ose orientimit seksual. Në raste të tilla, në qoftë se, një individ çenohet nga një institucion i Bashkimit Evropian, duke u diskriminuar për shkak të gjinës, origjinës, fesë ose për çdo shkak tjetër jo objektiv, institucionet e Bashkimit Evropian, janë të detyruara që

⁹⁵ Paragrafi i tretë i nenit 265 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Çdo person fizik ose juridik mund të ankojë para Gjykatës sipas kushteve të përcaktuara në paragrafët e mësipërme, se një institucion, organ, zyrë ose agjensi e Bashkimit nuk i është drejtuar personit me asnjë akt, përveç një rekomandimi ose opinioni”.

të marrin masa konkrete, qoftë masa legislative, qoftë edhe çdo masë tjetër të nevojshme, me qëllimin luftimit dhe eliminimit të diskriminimit.⁹⁶

Një tjetër rast kur dispozitat e Traktatave Kushtetuese parashikojnë detyrimin e institucioneve për të vepruar, ka të bëjë me lëvizjen e lirë të personave, shërbimeve dhe kapitaleve. Çështja e lëvizjes së lirë të personave, shërbimeve dhe kapitaleve, është rregulluar në titullin IV, të pjesës së parë të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, nga nenet 45, deri në nenin 66 të tij. Dispozitat e mësipërme ligjore garantojnë lëvizjen e lirë të punonjësve, brenda Bashkimit Evropian, të drejtën e tyre për të kërkuar punë, brenda çdo Shteti Anëtar të Bashkimit, pa asnjë lloj diskriminimi, për shkak të shtetësisë, të drejtën për të përfutur sigurime shëndetësore dhe shoqërore, në rast se, punonjësit në secilin prej Shteteve Anëtare, të drejtën e vendosjes ose vendbanimit në secilin prej Shteteve, të drejtën për të ofruar shërbime në fusha të ndryshme, etj. Po ashtu, dispozitat e mësipërme, parashikojnë edhe detyrimin e institucioneve të Bashkimit Evropian, që në përputhje me kompetencat e tyre, të marrin masat e nevojshme, për sigurimin e lirisë së lëvizjes së punonjësve ose të të drejtës së tyre për të ofruar shërbimet e tyre, në çdo Shtet Anëtar.

Në supozimin që një person fizik ose juridik privat çenohet, në mënyrë të paligjshme për realizimin e lirisë së tij të lëvizjes, ose të të drejtës së ofrimit prej tij të punës ose shërbimeve, Traktatet Kushtetuese parashikojnë që, institucionet evropiane duhet të veprojnë, duke marrë çdo masë të nevojshme me qëllim që individit, të mos pengohet në realizimin e një të drejte të tillë. Aket apo masat konkrete që duhet të marrin institucionet e Bashkimit, janë të ndryshme, në varësi të situatës konkrete që paraqitet, por, këtu e rëndësishme është të kuptohet se, ata kanë një detyrim aktiv për të vepruar, detyrim i cili, parashikohet, shprehimisht, nga normat juridike detyruese të Bashkimit Evropian.

Një rast tjetër i parashikuar nga Traktatet Kushtetuese, në të cilin institucionet dhe organet e Bashkimit Evropian, janë të detyruar që të veprojnë, është njohja dhe garantimi i rregullave që kanë të bëjnë me konkurrencën, ndërmjet operatorëve ekonomike, brenda tregut të përbashkët të Bashkimit. Në dispozitat e Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian janë parashikuar rregulla konkrete që ndalojnë konkurrencën e pandershme, brenda tregut të përbashkët, duke specifikuar edhe rastet më tipike, që përbëjnë konkurrencë të pandershme.

Në qoftë se, një person fizik ose juridik privat që ushtron veprimtari tregtare, brenda tregut të përbashkët të Bashkimit Evropian, konstaton se, një ose disa operatorë ekonomikë privat me veprimtari të tyre po realizojnë konkurrencë të pandershme, atëherë, dispozitat e Traktatit të mësipërm, parashikojnë se, ky person mund t'i drejtohet institucioneve dhe organeve të Bashkimit që të veprojnë, që të marrin masat e nevojshme për të siguruar që veprimtaria ekonomike të zhvillohet, në përputhje me rregullat e konkurrencës. Konkretisht, neni 103 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, parashikon, në mënyrë të shprehur, detyrimin e institucioneve evropiane të Këshillit dhe të Komisionit, që të nxjerrin direktivat e duhura, për të ndaluar konkurrencën e pandershme, si dhe marrjen e sanksioneve

⁹⁶ Pika 1 e nenit 19 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

1. Pa çenuar dispozitat e tjera të Traktateve dhe brenda kufijve të kompetencave që ato i japin Bashkimit, Këshilli, duke vendosur me unanimitet sipas një procedure të posaçme legislative, dhe pasi merr pëlqimin nga Parlamenti Evropian, mund të marrë masat e duhura për të luftuar diskriminimin për shkak të gjinisë, orgjinës racore ose etnike, fësë ose besimit, aftësive të kufizuara, moshës ose orientimit seksual”.

përkatëse, siç janë gjobat periodike, si dhe përcaktimi i rregullave të hollësishme që sigurojnë një mbikqyerje të efektshme të funksionimit të tregut të përbashkët.

Një kusht tjetër që duhet që të plotësojë personi fizik ose juridik privat, që të legjitimohet në ngritjen e padisë për mosveprim është që institucioni, organi, zyra ose agjensia e Bashkimit Evropian edhe pse, kanë patur detyrimin për të vepruar, ato në kundërshtim me këtë detyrim dhe në shkelje të dispozitave të Traktave Kushtetuese dhe të legjislacionit të dalë në zbatim të tyre, nuk kanë vepruar. Ky kusht është i parashikuar, në mënyrë të shprehur në paragrafin e parë të nenit 265 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, i cili përcakton se, padia për mosveprim mund të ngrihet, vetëm në rastet kur insitucionet ose organet e Bashkimit Evropian, kanë patur detyrimin për të vepruar dhe në shkelje të Traktatave dhe dispozitave të tjera ligjore, të dala në bazë të tyre, nuk veprojnë.⁹⁷

Më sipër u përmenden, shkurtimisht, disa raste, kur Traktatet Kushtetuese, parashikojnë që institucionet ose organet e Bashkimit Evropian, me vertetimin e rrethanave respektive, janë të detyruara që të veprojnë dhe të marrin masat e nevojshme, duke nxjerrë aktet ose kryer veprimet që Traktatet Kushtetuese parashikojnë, me qëllim rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë. Pra, siç u citua më lart, kërkohet që, jo vetëm në Traktatet Kushtetuese të parashikohet, detyrimi i institucioneve të Bashkimit Evropian për të vepruar, por kërkohet edhe që këto institucione, në shkelje të dispozitave të këtyre Traktateve, të heshtin, të mosveprojnë.

Për ta kuptuar më lehtë këtë kusht të legjitimitetit të personave fizikë ose juridikë privat, në ngritjen e padisë për mosveprim, mund të japim dy shembuj të thjeshtë hipotetikë, të cilët mund të ketë pak mundësi të ndodhin në praktikë, por që po jepen nga ana ime, për qëllime didaktike. Rasti i parë. Një shtetas i Bashkimit Evropian i cili, është me arsim të mesëm, aplikon për një vend pune pranë një institucioni të Bashkimit Evropian, pozicion pune, i cili sipas përshkrimit të vendit të punës, pranon persona me arsim të mesëm ose të lartë, por që preferohen personat me arsim të lartë.

Në qoftë se, nga ana e institucionit të Bashkimit Evropian, vendi i punës i ofrohet personit me arsim të lartë, duke e punësuar atë, personi që ka arsim të mesëm, nuk mund të pretendojë se është diskriminuar në fushën e mardhënieve të punës dhe t'i drejtohet institucionit të Bashkimit Evropian, me padi mosveprimi, sipas nenit 265 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, që të marrin masa konkrete për eliminimin e diskriminimit, në fushën e mardhënieve të punësimit, në rast se, insitucioni i Bashkimit nuk vepron. Kjo për faktin se, në rastin konkret, në bazë të dispozitave të Traktateve Kushtetuese, mosveprimi i institucionit të Bashkimit Evropian, nuk është bërë në shkelje të Traktatave dhe të legjislacionit të dalë në bazë të tyre. Kjo pasi, është e vertetë se, institucioni nuk ka vepruar, por, mosveprimi i institucionit në këtë rast, është në përputhje me dispozitat e Traktateve, në kushtet kur, duke iu referuar rrethanave të rastit konkret, nuk ka patur diskriminim në fushën e mardhënieve të punësimit, për personin A, me arsim të mesëm, sepse, ai nuk ka qenë në pozita të barabarta me personin tjetër, që ka patur arsim të lartë.

Rasti i dytë hipotetik. Kompania tregtare A, zhvillon aktivitetin e saj në fushën e prodhimit dhe shpërndarjes pajisjeve elektro-shtëpiake, në tregun e përbashkët të

⁹⁷ Paragrafi i parë i nenit 265 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Nëse Parlamenti Evropian, Këshilli Evropian, Këshilli, Komisioni ose Banka Qendrore Evropiane, në shkelje të Traktateve nuk veprojnë, Shtetet Anëtare dhe institucionet e tjera të Bashkimit mund të ngrejë padi para Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian për të konstatuar shkeljen. Ky nen zbatohet në të njëjtat kushte për organet, zyrat dhe agjensitë e Bashkimit të cilat nuk veprojnë”.

Bashkimit Evropian nga janari i vitit 2014. Si pasojë e menaxhimit jo të mirë të saj, por, edhe për shkak se kërkesa për pajisje elektro-shtëpiake, në këtë periudhë, ka rënë shumë prej konsumatorëve, si rrjedhojë e krizës ekonomike, rezulton se kompania A falimenton, në tetor të vitit 2014. Konstatohet se, nga ana e institucioneve të Bashkimit Evropian, nuk është marrë ndonjë masë financiare ose mase tjetër, as në favor dhe as kundër kësaj kompanie dhe as në favor apo kundër kompanive të tjera që, kryejnë të njëjtin aktivitet ose të ngjashëm me të.

Edhe në këtë rast, kompania A, nuk mund të ngrejë padi për mosveprim, ndaj institucioneve të Bashkimit Evropian, në bazë të nenin 265 të Traktatit, duke pretenduar se këto institucione nuk kanë marrë masa për të siguruar konkurrencën e ndershme, masa këto që parashikohen nga neni 103 e vijues i këtij Traktati, pasi duke iu referuar rrethanave të rastit konkret, falimentimi i kompanisë A, nuk ka ardhur si rezultat i konkurrencës së pandershme, por, ka ardhur si rezultat i menaxhimit jo të mirë të saj, si dhe si rezultat i lëvizjes së kërkesë-ofertës, për produktet që ajo prodhonte dhe shpërndante. Në këtë rast, është e vertetë që institucionet e Bashkimit Evropian nuk kanë vepruar, por, ky mosveprim i tyre, nuk është në shkelje të dispozitave të Traktateve Kushtetuese ose të normave ligjore të dala në bazë dhe zbatim të tyre, përkundrazi, ky mosveprim, është në përputhje me Traktatet Themeluese, të cilat parashikojnë se, institucionet e Bashkimit Evropian, si rregull, nuk kanë të drejtë të ndërhyjnë në mënyrën e menaxhimit të brendshëm të kompanive private, si dhe nuk duhet të ndikojnë në ekuilibrin e kërkesës dhe ofertës në treg.

Kushti tjetër që duhet të plotësojë personi fizik ose juridik privat që të ngrejë padinë për mos veprim, ndaj institucioneve të Bashkimit Evropian, është që, ai më parë, duhet që t'i ketë bërë thirrje ose ftesë institucionit, organit, zyrës ose agjensisë së Bashkimit për të vepruar dhe ky institucion edhe pse i është bërë thirrje, në shkelje të Traktatave dhe të normave ligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tyre, përsëri nuk ka vepruar. Thirrja që i bëhet institucionit të Bashkimit për të vepruar nga ana e personit privat, duhet të përmbajë edhe një përshkrim të përmbledhur të situatës faktike dhe ligjore, e cila tregon se, sipas bindjes së personit, institucioni, organi, agjencia ose zyra, duhet të veprojë, *si dhe duhet të tregojë aktin që duhet të nxirret ose veprimin konkret që duhet të kryhet.*

Po ashtu, është e kuptueshme që thirrja për të vepruar që i drejtohet institucioneve të Bashkimit Evropian, nga individit ose pala private, duhet të bëhet me anë të një kërkesë me shkrim, në të cilët, të trajtohen me hollësi situata faktike ose rrethanat e faktit, *si dhe dispozitat e Traktateve Kushtetuese ose të një norme tjetër ligjore që e detyron institucionin që të veprojë.* Kur është e mundur, nga ana e personit privat, kërkesës me shkrim që i drejtohet institucionit, i bashkëngjiten edhe provat konkrete që tregojnë se, situata faktike dhe ligjore, e detyron institucionin që të veprojë, që të nxjerrë aktin ose të marrë masat e nevojshme, me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshme të personit privat.

Në Traktatet Kushtetuese nuk është parashikuar se, sa duhet të jetë afati brenda të cilit personi privat, duhet që t'i bëjë thirrje institucioneve të Bashkimit Evropian që të veprojnë, me qëllim që ai të realizojë mbrojtjen e interesave të tij, *por, praktika gjyqësore ka pranuar se, kjo thirrje duhet të bëhet prej tij, brenda një afati të arsyeshëm*⁹⁸. Se cila është periudha konkrete që do të konsiderohet si “afat i

⁹⁸ Shih për më tepër: Craig P; De Burca G; “E drejta e Bashkimit Evropian, Tekste, çështje gjyqësore dhe materiale”, botuar nga Qendra e Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2013, faqe 616.

arsyeshëm”, kjo është në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, në varësi të masës ose aktit që kërkohet të merret, si dhe në varësi të cilësive dhe aftësive të personale të personit privat.

E rëndësishme është të theksohet se, *nga ana e Traktateve Kushtetuese, si dhe të drejtës së Bashkimit Evropian, në tërësi, nuk justifikohet një qëndrim neglizhent i palës private, kjo në funksion të ruatjes dhe garantimit të parimit të sigurisë juridike.* Kështu për shembull, është e pajustificueshme dhe e papranueshme një thirrje ose ftesë e bërë nga një palë private, qoftë ai person fizik apo juridik, që i drejtohet institucioneve të Bashkimit Evropian për të vepruar dhe për të marrë masa konkrete për një situatë të pretenduar, e cila ka ekzistuar në dëm të personit për një periudhë mbi 10 vjet ose mbi 20 vjet. Një periudhë e tillë kohore kaq e gjatë, nuk mund të konsiderohet se, përbën një “afat të arsyeshëm”, për t’i bërë thirrje institucioneve të Bashkimit për të vepruar dhe mundet që Gjykata të vendosë, mospranimin e padisë së paraqitur, duke u bazuar, qoftë edhe vetëm në faktin që, personi privat nuk i ka bërë thirrje institucionit të Bashkimit për të vepruar, brenda një afati të arsyeshëm.

Por, ndërsa nga ana e Traktateve Kushtetuese nuk është parashikuar ndonjë afat, brenda të cilit palët private duhet t’i bëjnë thirrje institucioneve të Bashkimit Evropian për të vepruar, nga ana tjetër, ato *kanë parashikuar një afat prej dy muajsh, nga data që iu është bërë thirrja, brenda të cilit institucionet e Bashkimit Evropian duhet të veprojnë, duke marra masa konkrete ose duke nxjerrë aktin që pretendohet nga ana e personit privat.*⁹⁹ Afati dy mujor nga data e thirrjes për të vepruar, brenda të cilit institucionet e Bashkimit, duhet të veprojnë, është vendosur nga ana e Traktateve, pikërisht, për t’iu dhënë kohën e arsyeshme këtyre institucioneve, që të vlerësojnë situatën faktike dhe ligjore të pretenduar nga paditësi dhe, brenda këtij afati, *prej dy muajsh*, ato duhet të vendosin të veprojnë ose të mos veprojnë.

Në qoftë se, brenda këtij afati institucionet e Bashkimit Evropian, pasi vlerësojnë situatën e pretenduar nga personi privat, e çmojnë se, duhet të veprojnë duke nxjerrë aktet ose duke kryer veprimet e nevojshme, ato veprojnë dhe i drejtohen paditësit me një akt ose kryejnë veprimin që ata e konsiderojnë të arsyeshëm, për të zgjidhur çështjen e ngritur nga paditësi. Në rast të kundërt, nëse institucionet e Bashkimit, pavarësisht thirrjes së bërë nga personi privat, nuk veprojnë, brenda afatit dy mujor nga data e thirrjes, atëherë, personi privat, duhet të ngrejë padinë për mosveprim, në bazë të paragrafit të tretë të nenit 265 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian.

Thirrja ose ftesa që personi privat i bën institucionit të Bashkimit për të vepruar, e cila, siç u përmend edhe më lart, duhet të tregojë edhe aktin ose veprimin që personi mendon se duhet të nxirret ose të kryhet, *nuk e detyron institucionin që të nxjerrë, pikërisht atë akt ose të kryejë atë veprim që pretendon personi.* E rëndësishme është që, institucioni të veprojë, *të mbajë një qëndrim*, të nxjerrë aktin ose të kryejë veprimin, që ai e çmon të arsyeshëm, për zgjidhjen e çështjes së ngritur nga personi privat. Me nxjerrjen e aktit ose kryerjen e veprimit, nga ana e institucionit, ky i fundit e ka përmbushur detyrimin e tij për mosveprim dhe në këtë rast, nëse, personi nuk është dakort me aktin e nxjerrë ose veprimin e kryer, nuk mund të ngrejë padinë për mosveprim, por, duhet të ngrejë padinë për anulimin e aktit, në

⁹⁹ Paragrafi i dytë i nenit 265 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Padia është e pramueshme vetëm nëse i është bërë me parë thirrje për të vepruar institucionit, organit, zyrës ose agjensisë. Nëse brenda dy muajve pas thirrjes, institucioni, organi, zyra ose agjensia në fjalë nuk ka dalë me një qëndrim, padia mund të ngrihet brenda një periudhe shtesë dy mujore”.

bazë të paragrafit të katërt të nenit 263 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian.

*Kjo për faktin se, padia për mosveprim, është zëvendësuese dhe plotësuese e padisë për anulim dhe si e tillë, nuk mund të ngrihet në rastet kur ngrihet padia për anulim, por, vetëm në rastet kur insitucioni ka dështuar për të vepruar. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në vendimin e saj të datës 18 nëntor 1970, në çështjen 15/70, duke u shprehur se rekursi për anulim dhe rekursi për mosveprim, janë “shpehje e të vetmes dhe të njëjtës rrugë të së drejtës”.*¹⁰⁰

Nga ana tjetër, me paraqitjes e ftesës ose thirrjes së personit privat për të vepruar ndaj institucionit të Bashkimit, nuk lejohet që institucioni të marrë *masa thjesht formale*, të cilat do të shmangnin padinë për mosveprim, por do të ruanin ekzistencën e mosveprimit, nga ana e institucionit. *Garancia kryesore që ka pala private në këtë rast, është se, Gjykata në praktikën e vendimeve të saj, ka përcaktuar se, institucioni të cilit i është bërë ftesa ose thirrja për të vepruar, është i detyruar që “të mbajë një qëndrim”, duke vepruar realisht ose edhe duke mos vepruar dhe Gjykata ka vlerësuar, rast pas rasti, përmbatjen e qëndrimit të mbajtur, nëse ai është real apo thjesht formal. Nëse, qëndrimi i mbajtur nga institucioni ka qenë real, duke nxjerrë aktin ose kryer verpimin e çmuar prej tij, atëherë, pala private nuk mund të ngrejë padinë për mosveprim, por duhet të ngrejë padinë për anulimin e aktit ose veprimit në bazë të nenit 263 të Traktatit. Por, nëse, qëndrimi i mbajtur nga institucioni ka qenë, thjesht formal, atëherë, ky kjo sjellje e institucionit do të vlerësohet sikur të ishte mosveprim i tij dhe në këtë rast personi, duhet të ngrejë padinë për mosveprim, në bazë të nenit 265 të Traktatit.*

Më sipër theksuam se, institucioni, organi, zyra ose agjensia e Bashkimit Evropian, të cilit i është bërë thirrja për të vepruar, duhet të veprojë brenda afatit dy mujor nga data e thirrjes. Thamë po ashtu se, nëse institucioni nuk vepron, personi ka të drejtë që të ngrejë padinë për mosveprim. Mund të ndodhë që, pas ngritjes së padisë për mosveprim nga personi, institucioni të veprojë, me vonesë, jashtë afatit dy mujor, duke nxjerrë aktin ose duke kryer verpimin e kërkuar nga personi. Në këtë rast, shtrohet pyetja: Çfarë do të bëhet me padinë për mosveprim të ngritur, e cila po shqyrtohet nga gjykata?

Në një rast të tillë, Gjykata do të vendosë pushimin e gjykimit, pasi padia e ngritur mbetet pa objekt, në kushtet kur insitucioni ka vepruar edhe pse me vonesë. Përveç pushimit të gjykimit Gjykata, zakonisht me vendimin e saj të pushimit, i ka ngarkuar institucionit që të paguajë shpenzimet gjyqësore, të bëra deri në atë fazë të gjykimit nga personi privat.

Një tjetër kusht që duhet të plotësojë personi fizik ose juridik privat për ngritjen e padisë për mosveprim, është që ai duhet ta ngrejë padinë për nxjerrjen e një akti, i cili, është i detyrueshëm për zbatim dhe jo ndaj akteve të Bashkimit Evropian që nuk ka efekte ligjore të detyrueshme, siç janë Rekomandimet dhe Opinionet. Një kusht i tillë është parashikuar, shprehimisht, në paragrafin e tretë të nenit 265 të Traktatit, i cili përcakton se, personi fizik ose juridik, mund të paraqesë padi kundër një institucioni të Bashkimit, për nxjerrjen e një akti, me përjashtim të akteve që janë Rekomandime dhe Opinione. Se cilët janë aktet me karkater detyrues, këto janë sqaruar më lart, kur është folur nga ana ime për ngritjen e padisë për anulim dhe siç dihet këto akte janë, Rregulloret, Direkivat dhe Vendimet. Për sa më sipër,

¹⁰⁰ Shih për më tepër: Jacque, J, P; “E drejta institucionale e Bashkimit Evropian”, Shtëpia Botuese “Papyrus”, Tiranë, 2010, faqe 496.

mund të konstatohet se, personi privat mund të ngrejë padi vetëm për mos nxjerrjen nga ana e institucioneve të Bashkimit Evropian të një Rregulloreje, Direktive ose Vendimi dhe jo për mosnxjerrjen e një Rekomandimi ose Opinioni, të cilët siç dihet janë akte, që nuk kanë fuqi detyruese.

Ky kusht që personi privat duhet që të ngrejë padinë për nxjerrjen e një akti me karakter detyrues, është një nga kushtet që e dallon atë nga subjektet e tjerë që kanë të drejtë që të ngrejë padi për mosveprim, të cilët janë Shtetet Anëtare dhe institucionet, organet, zyrat ose agjensitë e Bashkimit Evropian. Këta të fundit, kanë të drejtë që të ngrejë padi edhe për nxjerrjen e një akti që nuk ka fuqi detyruese, siç mund të jenë Rekomandimet dhe Opinionet, madje edhe për nxjerrjen e një akti që i përket fazës përgatitore ose paraprake të procedurës së nxjerrjes së aktit.

Një nga kushtet më të rëndësishme që duhet të plotësojë personi fizik ose juridik privat për ngritjen e padisë për mosveprim, është që me padinë e tij të kërkojë nxjerrjen e një akti që prek, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe individuale, të drejtat dhe interesat e tij të ligjshme. Kriteret se kur një akt prek drejtpërdrejt dhe individualisht personin privat, janë sqaruar me hollësi nga ana ime, kur është folur për ngritjen e padisë për anulim dhe për këtë rast, vlejné të njëjtat kritere, si për atë padi dhe për efekte të mospërsëritjes, nuk po trajtohen edhe në këtë çështje. *Ngritjen e padisë për mosveprim nga ana e personit privat, bëhet si në rastin kur akti është me karakter individual, ashtu edhe kur akti është me karakter të përgjithshëm, mjafton që personi të provojë se, akti që ai kërkon që të nxirret është një akt që lidhet, drejtpërdrejt dhe individualisht, me interesat e tij.*

Duhet theksuar se, ky kusht, pra, kushti i lidhjes së drejtpërdrejtë dhe individuale të personit privat me aktin që ai kërkon që të nxirret nga institucionet e Bashkimit Evropian, ashtu si në rastin e padisë së anulimit, është një nga kushtet më të vështira që personi privat duhet të plotësojë dhe një nga kushtet për të cilat Gjykata Evropiane e Drejtësisë, ka vendosur mospranimin e padisë për mosveprim, për shkak se, nuk është arritur të provohet lidhja e drejtpërdrejtë dhe individuale e paditësit me aktin ai që kërkon të nxirret. Kështu në një rast të praktikës gjyqësore, konkretisht në çështjet 10 dhe 18/68 *Societa Eridania kundër Komisionit*, Gjykata vendosi mospranimin e padisë, pikërisht për fakin se, paditësi nuk arriti që të provojë lidhjen, e drejtpërdrejtë dhe individuale, me aktin që kërkonte që të nxirrej nga Komisioni Evropian.

Në këtë çështje, palët paditëse ngriten, fillimisht, padi anulimi dhe kërkonin anulimim e vendimeve të Komisionit që iu jepte ndihmë disa rafinerive të sheqerit në Itali. Paditësit pretendonin se, pozita e tyre konkurrese në tregun e sheqerit do të cënohej rëndë nga dhënia e një ndihme të tillë. Gjykata e Drejtësisë e hodhi poshtë këtë padi, me arsyetimin se, paditësit nuk ishin të lidhur, individualisht me vendimet në fjalë. Pas mospranimit të padisë së anulimit, paditësit ngritën padi mosveprimi, sipas nenit 175 të Traktatit të Komunitetit Evropian, sot, neni 265 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, duke pretenduar se, Komisioni nuk kishte vepruar për të revokuar vendimet përkatëse.

Gjykata e Drejtësisë, duke vendosur mospranimin edhe të padisë për mosveprim, në vendimin e mësipërm, ndër të tjera arsyetonte:

“...15. Kjo kërkesë lidhet me anulimin e vendimit të nënkuptuar për kundërshtimin nga heshtja që mbajti Komisioni në lidhje me kërkesën që i ishte drejtuar atij nga palët kërkuese, të cilat donin anulimin apo revokimin e tre vendimeve të diskutueshme për paligjshmëri, apo ndryshe për shkak se ato ishin të papërshtatshme.

16. Padia që parashikohet në nenin 175 synon të rregullojë një mosveprim të paligjshëm, siç del nga ai nen, i cili i referohet dështimit për të vepruar “për shkelje të këtij Traktati” dhe nga neni 176 që i referohet dështimit për të vepruar, i shpallur si “në kundërshtim me këtë Traktat”.

Pa i deklaruar se, sipas cilës dispozitë të së drejtës së Komunitetit, Komisionit iu kërkua të anulonte ose të revokonte vendimet e përmendura, pasi palët kërkuese janë kufizuar tek pretendimi se, ato vendime janë mirtuar në shkelje të Traktatit, vetëm ky fakt do ta bënte dështimin e Komisionit për të vepruar subjekt të dispozitave të Nenit 175.

17. Gjithsesi, Traktati parashikon, sidomos në nenin 175, metoda të tjera rekursi, me anën e të cilave, një masë e Komunitetit, e konsideruar si e paligjshme mund të diskutohet dhe në rast se është e nevojshme të anulohet, për të mos u zbatuar nga një palë e cilësuar e detyruar.

Të pranosh ashtu siç dëshirojnë palët kërkuese, që palët në fjalë mund t'i kërkojnë institucionit nga ka dalë ajo masë, ta revokojë atë e në rastin e dështimit të Komisionit për të vepruar, t'ia referojë atë Gjykatës së Drejtësisë si një mosveprim i paligjshëm për t'u marrë me çështjen, kjo do të çonte në dhënien e një metode rekursi për ta, paralele me atë të nenit 173, që nuk do të ishte subjekt i kushteve të parashikuara nga Traktati.

18. Prandaj kjo kërkesë nuk i përmbush kërkesat e nenit 175 të Traktatit dhe duhet konsideruar në këtë mënyrë si e papranueshme. ...”¹⁰¹

Kushti i fundit që duhet të plotësojë personi fizik ose juridik privat për ngritjen e padisë për mosveprim, është që padinë ta ngrejë brenda një afati dy mujor, duke filluar ky afat, nga dita që ka kaluar afati tjetër dy mujor, brenda të cilit institucioni i Bashkimit Evropian duhej që të vepronte. Parashikimi i afatit dy mujor brenda të cilit duhet të ngrihet padia për mosveprim nga personi privat, është bërë, në mënyrë të shprehur, në Traktatet Kushtetuese, dhe ky afat duhet të respektohet, detyrimisht nga personi, në të kundërt padia e tij do të deklarohet si e papranueshme, për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit të paraqitjes së padisë. Ky afat dy mujor është vendosur në dispozicion të paditësit, që ai të vlerësojë dhe të vendosë për ngritjen e padisë për mosveprim, i cili përbën një afat të arsyeshëm brenda të cilit personi duhet që të veprojë.

Me ngritjen e padisë për mosveprim dhe me plotësimin e kushteve ligjore që kanë të bëjnë me legjitimitimin e personit fizik ose juridik privat (locus standi), Gjykata Evropiane e Drejtësisë, pasi verifikon kushtet e legjitimitit, e shqyrton çështjen në themel, duke vendosur pranimin ose mospranimin e padisë. Kur Gjykata vendos pranimin e padisë, institucioni i Bashkimit Evropian, është i detyruar që të veprojë, brenda një afati të arsyeshëm, duke nxjerrë aktin e pretenduar nga paditësi në padi. Pavarsisht nga fakti se, vendimi i Gjykatës është me karakter deklarativ ose njohës, ai nuk është pa vlerë juridike. Kjo jo vetëm për faktin se, ky vendim përforcon dhe e bën të taksativ, detyrimin e institucionit për të vepruar, por edhe për faktin tjetër, se, vetëm pas marrjes së këtij vendimi, personi privat ka të drejtë që të ngrejë padi me objekt shpërblim dëmi jashtëkontraktor, në qoftë se, institucioni nuk vepron, brenda një afati të arsyeshëm edhe pas marrjes së vendimit të Gjykatës që e detyron atë që të veprojë.

¹⁰¹ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1969) ECR 459, në çështjen gjyqësore 10 dhe 18/68; Societa Eridania vs Commission.

3.3. Paditë e ngritura nga personat fizikë ose juridikë privat, me objekt paligjshmërinë e akteve të institucioneve të Bashkimit Evropian.

Një tjetër rrugë ose mënyrë që mund të zgjedhin personat fizikë ose/dhe juridikë privat për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre të ligjshme, në kuadër të rendin juridik evropian, është edhe *padia me objekt paligjshmërinë e akteve të institucioneve, organeve, zyrave apo agjensive të Bashkimit Evropian*. Ky mjet mbrojtjeje është parashikuar, në mënyrë të shprehur, në Traktatet Kushtetuese, të cilat i njohin të drejtën personit fizik ose juridik privat, që të kërkojnë me padi para Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, anulimin e një akti të Bashkimit, duke argumentuar se ky akt buron ose është bazuar, në një akt me zbatim të përgjithshëm, i cili, ky i fundit, është nga ana e tij i paligjshëm.¹⁰²

Ky mjet mbrojtjeje, i cili mund të përdoret nga palët private, paraqet disa veçori ose karakteristika që e dallojnë atë nga mjetet e tjera të mbrojtjes, të trajtuara më lart, që janë padia për anulim dhe padia për mosveprim. Për këtë arsye, në këtë çështje, unë do të ndalem, vetëm në trajtimin e veçorive kryesore që paraqet ky mjet mbrojtjeje i palëve private, në krahasim me paditë e tjera që ata mund të ngrejnë, kundër akteve të institucioneve të Bashkimit Evropian dhe duke trajtuar këto veçori, do të dalë dhe kuptimi dhe përmbajtja e padisë me objekt paligjshmërinë e akteve të institucioneve të Bashkimit.

Si veçori të parë të kësaj padie, e cila do të emërtohet shkurt nga ana ime, me emrin “Padi për paligjshmëri”, është fakti se, kjo padi, për nga natyra e saj, nuk është një padi e pavarur, por, është një “padi aksesore”, e cila mund të ngrihet, vetëm në rastet kur, personi juridik privat ka ngritur më parë “padi kryesore”, e cila është, padia e anulimit të një akti të institucioneve të Bashkimit Evropian. Qenia e padisë për paligjshmëri, si padi jo e pavarur ose si padi aksesore, nuk i referohet vlerës ose rëndësisë së saj, por, i referohet anës procedurale të saj, që do të thotë se, kjo padi nuk mund të qëndrojë e vetme, e pavarur në gjykim, por, duhet që të ekzistojë në gjykim, më parë një padi kryesore, që është padia për anulimin e aktit.

Pra, qenia e padisë për paligjshmëri si padi aksesore, nuk do të thotë që ky mjet juridik mbrojtjeje, është më pak e rëndësishëm ose ka më pak vlerë se, mjetet e tjera të mbrojtjes, siç janë padia e anulimit ose padia për mosveprim. Përkundrazi, padia për paligjshmëri, ka të njëjtën vlerë juridike ashtu si dhe paditë e tjera, si dhe sjellë të njëjtat efekte ligjore detyruese për palët, si dhe paditë e tjera, në rastet kur ajo pranohet nga Gjykata. I vetmi dallim i saj me paditë për anulim ose për mosveprim, është fakti se, kjo padi, është parashikuar nga Traktatet Kushtetuese, si një mjet juridik mbrojtjeje shtesë, për personat fizikë ose juridikë private, në rastet kur, ato për shkaqe të ndryshme, të arsyeshme dhe objektive, nuk mund të ngrejnë padinë e anulimit.

Në vijim të asaj që u tha më lart, për veçorinë e parë të kësaj padie, qenia e saj si padi aksesore, nënkupton që, kjo padi mund të ngrihet, vetëm kur një gjykim i mëparshëm me objekt anulimin e aktit, ka filluar tashmë dhe paditësi pretendon se, akti i institucionit duhet të anulohet, pasi ai është i bazuar në një akt tjetër të institucioneve

¹⁰² Neni 277 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Pavarsisht kalimit të afatit të parashikuar në nenin 263, paragrafi i gjashtë, gjatë procesit objekt i të cilit është një akt me zbatim të përgjithshëm i miratuar nga një institucion, organ, zyrë ose agjensi e Bashkimit, çdo palë mund të përdorë arsyetimin e përcaktuar në nenin 263, paragrafi i dytë, për të argumentuar përpara Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian mosbatueshmërinë e aktit në fjalë”.

të Bashkimit, i cili, nga ana e tij, është i paligjshëm.¹⁰³ Mbi bazën e kësaj padie, duke u deklaruar nga Gjykata si i pazbatueshëm akti me karakter të përgjithshëm, për shkak se ai është i paligjshëm, atëherë, në mënyrë automatike, ose të menjëhershme dhe pa kushte, do të anulohet edhe akti konkret, i cili është bazuar në një akt të përgjithshëm, që është deklaruar si i pazbatueshëm nga ana e Gjykatës.

Në lidhje me natyrën juridike të kësaj padie, e është shprehur edhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në vendimin e saj 92/78 *Simmmenthal SpA, kundër Komisionit*. Në këtë çështje pala paditëse kërkonte anulimin e një vendimi të Komisionit, që kishin të bënte me çmimet minimale të shitjes së mishit të ngrirë. Në mbështetje të argumenteve të saj, pala paditëse deklaroi se, do të përdorte nenin 184 të Traktatit të Komuniteteve Evropiane, aktualisht, neni 277 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, për të kundërshtuar ligjshmërinë e disa rregulloreve dhe njoftimeve me karakter të përgjithshëm, të cilat formonin bazën ligjore që kishte shërbyer për nxjerrjen e vendimit, që kundërshtohet nga pala paditëse me padi anulimi.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në vendimin e saj, arriti në konkluzionin se, pala paditëse, lidhje, drejtpërsëdrejti dhe individualisht, me aktin kryesor, pra, me rregulloret dhe vendimet me karakter të përgjithshëm, edhe pse këto akte iu drejtoheshin Shteteve Anëtare dhe jo palës paditëse. Në vendimin e mësipërm, në lidhje me këtë çështje, Gjykata, ndër të tjera, arsyetoi:

“...34. Ndërsa zyrtarisht pala kërkuese kundërshton vendimin e Komisionit Nr 78/258, ajo bazuar në nenin 184 të Traktatit të Komuniteteve Evropiane, ka kundërshtuar, në të njëjtën kohë edhe disa aspekte të sistemit “lidhës”, në formën që ai është zbatuar, sipas nenit të ri, 14 të Rregullores Nr 805/68, me Rregulloren Nr 2900/77, si dhe me njoftimet e Ftesave për tenderin e datës 13 janar 1978.

...36. Nuk ka dyshim se kjo dispozitë (Neni 184) i mundëson palës kërkuese që të kundërshtojë, në mënyrë indirekte gjatë procesit, duke pasur si synim anulimin e vendimit të kundërshtuar, si dhe pavlefshmërinë e masave të parashtruara nga Rregullorja, e cila formon bazën ligjore të këtij të fundit.

37. Nga ana tjetër, ka arsye për të diskutuar nëse neni 184 zbatohet për njoftimet e ftesave për tenderin e 13 janarit 1978, kur sipas formulimit të tij, ai parashikon vetëm vënien në diskutim të “Rregulloreve”.

38. Këto njoftime janë akte të përgjithshme që përcaktojnë paraprakisht dhe objektivisht, të drejtat dhe detyrimet e tregtarëve, që dëshirojnë të marrin pjesë në ftesat për tender, të cilat i bëjnë publike këto njoftime.

39. Siç është shprehur Gjykata e Drejtësisë në vendimin e saj, në çështjen gjyqësore 15/57 *Campagne des Hauts...* dhe në vendimin e saj në çështjen 9/56, *Meroni*, në lidhje me nenin 36 të Traktatit të Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut, neni 184 i Traktatit të Komunitetit Evropian, shpreh një parim të përgjithshëm, i cili i jep çdo pale në proces, të drejtën për të kundërshtuar, me qëllim sigurimin e anulimit të një vendimi, me lidhje të drejtpërdrejtë dhe individuale me atë palë, të vlefshmërisë së akteve të mëparshme të institucioneve, që formojnë bazën ligjore të vendimit, që kundërshtohet, nëse ajo palë nuk ka të drejtë që sipas nenit 173 të Traktatit, të ngrejë një padi të drejtpërdrejtë për të kundërshtuar ato akte, nga të cilat ishte cenuar, pa qenë në një pozitë për të kërkuar që ato të shpallehin të pavlefshme.

¹⁰³ Shih për më tepër: Craig P; De Burca G; “E drejta e Bashkimit Evropian, Tekste, çështje gjyqësore dhe materiale”, botuar nga Qendra e Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2013, faqe 617.

40. Fusha e zbatimit të nenit të sipërpërmendur, duhet të përfshijë akte të institucioneve, të cilat megjithëse nuk janë në formën e një Rregulloreje, gjithsesi shkaktajnë efekte të njëjta dhe mbi atë bazë mund të kundërshtohen sipas nenit 173, nga persona fizikë apo juridikë, përveç institucioneve të Komunitetit dhe Shteteve Anëtare.

41. Interpretimi i gjerë i nenit 184 buron nga nevoja për t'i dhënë atyre personave, që ndalohen nga paragrafi i dytë i nenit 173, të nisin drejpërsëdrejti procedura në lidhje me aktet e përgjithshme, për të pëfituar rishqyrtim gjyqësor për vete, në një kohë kur ato janë cënuar nga zbatimi i vendimeve, të cilat për ta kanë lidhje të drejtpërdrejtë dhe individuale.

42. Njoftimet e ftesave për tenderin e 13 janarit 1978, për të cilat pala kërkuese nuk mund të niste procedurat, janë çështja që po shqyrtojmë, duke parë se vetëm vendimi i marrë për shkak të tenderit, të cilin ajo e kishte paraqitur si një përgjigje ndaj një ftese specifike për tender, mund të ketë më të lidhje të drejtpërdrejtë dhe individuale.

43. Prandaj ka arsye të shëndosha për të deklaruar se, kundërshtimi i palës kërkuese, gjatë procedurave sipas nenit 184, që lidhet jo vetëm me rregulloret e sipërpërmendura, por edhe me njoftimet e ftesave për tenderin e 13 janarit 1978, është i pranushëm, megjithëse këto të fundit, në kuptimin e ngushtë, nuk janë masa të parashtruara nga Rregullorja. ...”¹⁰⁴

Një veçori tjetër e padisë për paligjshmëri është fakti se, kjo padi mund të ngrihet nga personat fizikë dhe juridikë private, vetëm kundër akteve me karakter të përgjithshëm. Kjo veçori e kësaj padie, është parashikuar, në mënyrë të shprehur në nenin 277 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, në të cilin është përcaktuar se, pala private mund të kërkojë paligjshmërinë e një akti me zbatim të përgjithshëm, të miratuar nga një institucion, organ, zyrë ose agjensi e Bashkimit Evropian.

Në këtë rast, shtrohet pyetja: Çfarë kuptojmë me akte me karakter të përgjithshëm? Duke iu referuar dispozitave të Traktateve Kushtetuese, si akte me karakter të përgjithshëm do të konsiderohen, në radhë të parë, Rregulloret, të cilat, siç dihet janë akte që zbatohet për të gjitha Shtetet Anëtare, duke vendosur norma sjellje të detyrueshme, abstrakte dhe që i drejtohen një numri të pacaktuar personash, duke u bërë pjesë të legjislacionit të brendshëm të Shteteve Anëtare. Por, si akte me karakter të përgjithshëm, do të konsiderohen edhe Direktivat dhe Vendimet e përgjithshme, që iu drejtohen të gjitha Shteteve Anëtare, pavarësisht se, këto akte, nuk konsiderohen si pejsë e legjislacionit të brendshëm të Shteteve Anëtare dhe në rastet e Direktivave, Shtetet duhet që të nxjerrin norma të tjera juridike, në mënyrë që ata të zbatohen në këto Shtete. Nga ana e saj, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në praktikën e vendimeve të saj, ka pranuar që kjo padi, mund të ngrihet kundër çdo akti me karakter të përgjithshëm, pavarësisht nga emërtimi dhe forma e tij, duke arsyetuar, se, nuk ka rëndësi emri ose forma e aktit, e rëndësishme është përmbajtja e tij, nëse akti, për nga natyra ose përmbajtja e tij, është me karakter të përgjithshëm, atëherë, pala mund të ngrejë padinë për paligjshmëri, sipas nenit 277 të Traktatit.

Veçoria e mësipërme e padisë për paligjshmëri, është në përputhje të plotë, me natyrën juridike të saj, si një padi e cila ka karakter aksesor, që ngrihet gjatë një gjykimi, i cili është filluar më parë dhe që ka për objekt anulimin e një akti konkret të

¹⁰⁴ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1979) ECR 777, në çështjen gjyqësore 92/78; Societa Simmenthal kundër Komisionit Evropian.

institucionit të Bashkimit. Siç është theksuar më lart, pala private në gjykimin e filluar me objekt anulimin e aktit, si shkak i anulimit paraqet faktin se, akti që kërkohet të anulohet, është bazuar në një akt me zbatim të përgjithshëm, i cili sipas palës paditëse pretendohet se, është i paligjshëm.

Kjo lloj padie, nuk mund të pranohet që të ngrihet ndaj akteve që iu drejtohen personave të caktuar ose akteve individuale, kjo sepse, këta persona për kundërshtimin e akteve individuale, duhet të përdorin padinë për anulim, të parashikuar nga neni 263 i Traktatit. Nëse, padia për paligjshmëri do të pranohej edhe për aktet individuale, kjo do të çonte që afatet e padisë për anulim, sipas nenit 263 të rifillonin, ndërkohë që, personi të cilit akti i drejtohet, ka patur mundësi që të ngrinte, drejtpërdrejt, padi për anulimin e aktit.

*Si veçori tjetër tjetër të kësaj padie, mund të themi se, kjo padi mund të ngrihet vetëm në rastet kur pala private, nuk ka mundësi ose nuk ka patur mundësi objektive për të përdorur ndonjë mjet tjetër mbrojtjeje, pra, kur nuk ka patur mundësi objektive që të ngrejë padinë për anulim. Kjo veçori e padisë për paligjshmëri, është trajtuar, shumë qartë, në vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen *Simmenthal kundër Komisionit Evropian*, ku, kjo Gjykatë, ndër të tjera është shprehur: “...Neni 184 i Traktatit të Komunitetit Evropian, shpreh një parim të përgjithshëm, i cili i jep çdo pale në proces të drejtën për të kundërshtuar, me qëllim sigurimin e anulimit të një vendimi, me lidhje të drejtpërdrejtë dhe individuale me atë palë, të vlefshmërisë së akteve të mëparshme të institucioneve, që formojnë bazën ligjore të vendimit, që kundërshtohet, nëse ajo palë nuk ka të drejtë që sipas nenit 173 të Traktatit, të ngrejë një padi të drejtpërdrejtë për të kundërshtuar ato akte, nga të cilat ishte cenuar, pa qenë në një pozitë për të kërkuar që ato të shpallehin të pavlefshme. ...”*

Që të ngrejë këtë padi, pala private, të drejtën për të kërkuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë, anulimin e aktit, duhet ta ketë humbur për shkaqe objektive, që do të thotë se, pala nuk mund të kërkonte anulimin e aktit sepse, ai ishte akt me karakter të përgjithshëm, si dhe ishte një akt për të cilin pala nuk mund të provonte lidhjen e drejtpërdrejtë dhe individuale me të, si një nga kushtet më themelore për ngritjen e padisë për anulim. Pala private, nuk mund të ngrejë padi për paligjshmëri kundër një akti, për të cilin, për arsye subjektive ose neglizhence, pra, për faj të saj, nuk ka ngritur padinë për anulim. Kërkesa për siguri juridike, si një nga parimet bazë të veprimtarisë së Gjykatës, nuk lejon që të ngrihet padia për paligjshmëri, për një akt që ka marrë formë të prerë, për faktin se, pala nuk ka ngritur padinë e anulimit, kundër këtij akti, brenda afatit ligjor, për shkaqe subjektive ose neglizhence.¹⁰⁵

Si veçori tjetër të padisë për paligjshmëri, mund të përmendim faktin se, me anë të kësaj padie, nuk kërkohet anulimi i aktit me zbatim të përgjithshëm, por kërkohet që akti të deklarohet si i pazbatueshëm. Edhe kjo veçori është parashikuar në nenin 277 të Traktatit, ku përcaktohet se, pala private mund të kërkojë me anë të kësaj padie, mozbatueshmërinë e aktit në fjalë. Kuptohet se, duke u deklaruar akti me karakter të përgjithshëm, si i pazbatueshëm, atëherë, do të pranohet edhe padia e palës për anulimin e aktit e ngritur sipas nenit 263 të Traktatit dhe anulimi i këtij akti nga ana e Gjykatës do të bëhet, pikërisht për faktin se, ai akt është bazuar në një akt tjetër, me karakter të përgjithshëm, i cili, është deklaruar si i pazbatueshëm nga ana e Gjykatës, po me anë të të njëjtit vendim.

¹⁰⁵ Shih për më tepër: Jacque, J, P; “E drejta institucionale e Bashkimit Evropian”, Shtëpia Botuese “Papyrus”, Tiranë, 2010, faqe 500.

Në lidhje me padinë për paligjshmërinë e akteve me karakter të përgjithshëm, e çmoj me vend të sqaroj edhe njëherë se, kjo është një padi, e cila, nuk mund të ngrihet, në mënyrë të veçantë dhe të pavarur përpara Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, nga ana e personave fizikë ose juridikë privatë. Kjo padi, duke qenë një padi aksesore, ngrihet në formë pretendimi ose kërkesë ligjore, pasi është ngritur padia kryesore, që është padia për anulimin e aktit, e ngritur në bazë të nenit 263 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian. Është kjo arsyeja se, pse kjo padi, quhet ndryshe edhe *padia për anulimin e akteve për mungesë të bazës ligjore*, pasi me këtë padi, akti individual i cili, *formalisht është i ligjshëm*, anulohet nga Gjykata, sepse ky akt, është bazuar në një akt tjetër që është nga ana e tij, realisht dhe objektivisht është i paligjshëm, paligjshmëri e cila konstatohet nga Gjykata dhe me këtë rast, ajo e deklaron si të pazbatueshëm, aktin me karakter të përgjithshëm.

Në këto kushte, dobia e padisë së ngritur në bazë të nenit 277 të Traktatit është se, *me anë të kësaj padie, iu jepet mundësia palëve private që të kundërshtojnë një akt me karakter të përgjithshëm*, të cilin, nuk legjitimohen ta kundërshtojnë në bazë të nenit 263 të Traktatit, pasi nuk lidhen drejtpërdrejt dhe individualisht me aktin, *por që kundërshtimin e tij e bëjnë në mënyrë indirekte, duke kundërshtuar aktin individual, i cili ka dalë në bazë dhe për zbatim të aktit të përgjithshëm*. Me anë të kësaj padie, duke u deklaruar i pazbatueshëm akti me karakter të përgjithshëm, atëherë, deklarohet si i pavlefshëm, duke u anuluar akti individual, për faktin se, ky akt individual, ka dalë duke u bazuar mbi një akt tjetër, të përgjithshëm, që është deklaruar nga ana e tij nga Gjykata si i pazbatueshëm.

Si veçori të fundit të kësaj padie, mund të themi se, kjo padi është një padi ose kërkim që mund të ngrihet nga personat fizikë ose juridikë në çdo kohë, pra, është një padi e paparashkrueshme. Fakti i paparashkrueshmërisë së padisë për paligjshmëri, rezulton nga vetë natyra e saj, si një padi ose kërkim aksesor, i cili ngrihet vetëm pasi është ngritur padia kryesore, që është padia për anulimin e aktit në bazë të nenit 263 të Traktatit. Po ashtu, kjo veçori e kësaj padie, është parashikuar, në mënyrë të shprehur, edhe në nenin 277 të Traktatit, i cili jep edhe kuptimin e saj, sipas të cilit, kjo padi mund të ngrihet, pavarësisht nga kalimi i afatit dy mujor të parashikuar nga neni 263 i Traktatit.

Në lidhje me shkaqet e paraqitjes së kësaj padie, duhet thënë se, kjo padi mund të paraqitet për të njëjtat shkaqe, që ngrihet edhe padia për anulim. Si shkaqe për të cilat mund të ngrihet kjo padi, mund të themi se, kjo padi mund të ngrihet për akte që janë nxjerrë për mungesë të kompetencës së institucioneve të Bashkimit Evropian, për akte të cilat kanë cënuar rëndë dispozitat procedurale, në lidhje me formën e nxjerrjes së tyre, për akte në të cilat institucionet e Bashkimit kanë shkelur dispozitat e Traktateve Kushtetuese, ose të normave të tjera ligjore në fuqi, të rendit juridik evropian, si dhe për akte që përbëjnë shpërdorim të kompetencave nga ana e institucioneve të Bashkimit.

Me paraqitjen e kësaj padie, e cila siç u sqarua më lart, nuk ngrihet në formën e një padie të pavarur, por në formën e një kërkitimi aksesor, pasi është ngritur padia kryesore për anulimin e aktit, Gjykata, pasi shqyrton dhe analizon provat, merr vendimin përfundimtar, duke e pranuar ose rrëzuar atë. *Në rastin kur Gjykata vendos pranimin e padisë, ajo nuk e deklaron aktin me karakter të përgjithshëm si të pavlefshëm, si dhe nuk e anulon atë, por, e deklaron këtë akt si të pazbatueshëm*. Vendimi i gjykatës, në këtë rast, është detyrues vetëm për palët në gjykim ose ka efekte ligjore *inter partes* dhe për këtë arsye, vendimi i Gjykatës zbatohet vetëm për personat që janë palë në mosmarrëveshje, ndërsa, për personat e tjerë, akti i

përgjithshëm, i cili është deklaruar i pazbatueshëm, si rregull, ka vlerë ligjore dhe duhet të zbatohet për raste të tjera. Por, në një rast të tillë Bashkimi Evropian, do të vihej para një rreziku që për këtë akt me karakter të përgjithshëm, që është deklaruar si i pazbatueshëm nga Gjykata, për një çështje konkrete, të paraqiteshin nga palët private një numër i pafund padish, me objekt deklarimin si të pazbatueshëm të këtij akti.

Për këtë arsye, *pasoja me logjikshme që do të vinte, pasi Gjykata të kishte deklaruar si të pazbatueshëm një akt të përgjithshëm, është që vetë institucioni i Bashkimit Evropian ta anulonte këtë akt*. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në vendimin e saj të datës 20 mars 1984, në çështjen *Razzouk et Beydoun kundër Këshillit*, duke u shprehur se zgjidhja më e mirë në këtë rast, do të ishte që institucioni që ka nxjerrë aktin e deklaruar nga Gjykata si të pazbatueshëm, në një çështje konkrete, ta anulonte atë akt.¹⁰⁶

Megjithatë, sipas Gjykatës edhe pse institucioni këshillohet që të anulojë aktin, në të kundërt, ai do të përballet me të gjitha pasojat e mundshme negative, anulimi i aktit të përgjithshëm nga institucioni, nuk do të thotë që institucioni është i detyruar që të shfuqizojë me efekt prapaveprues, të gjitha gjitha masat ose aktet individuale të mëparshme, me qëllim riparimin e dëmeve që mund t'u ketë shkaktuar palëve të treta. Ky qëndrim i Gjykatës bazohet në faktin se, siç u tha më lart, vendimi i Gjykatës që e deklaroi si të pazbatueshëm aktin, është i detyrueshëm për zbatim, vetëm ndërmjet palëve ndërgjyqëse (inter partes) dhe nuk është i detyruar që të zbatohet nga të gjitha subjektet e së drejtës, pra, nuk ka efekte *erga omnes*.

3.4. Paditë e ngritura nga personat fizikë ose juridikë privat, ndaj institucioneve të Bashkimit Evropian me objekt dëmshpërblimin kontraktor dhe jashtëkontraktor.

Gjatë veprimtarisë së tij ekonomike Bashkimi Evropian mund të lidhë kontrata të ndryshme, në fushën e të drejtës civile ose tregtare, me Shtete të tjera jo Anëtare, me organizata të ndryshme ndërkombëtare, si dhe me persona të ndryshëm fizikë ose juridikë privatë. Këto kontrata ose marrëveshje, ashtu siç ndodh edhe për subjektet e tjerë të së drejtës civile, zakonisht, përmbushen nga palët, në përputhje me kluazolat e parashikuara në kontratat konkrete dhe me përmbushjen e tyre, mardhënia kontraktore e lidhur ndërmjet Bashkimit Evropian dhe palëve të treta përfundon, normalisht. Por, mund të ndodhë që gjatë fazës së ekzekutimit ose të përmbushjes së mardhënies kontraktore, Bashkimi, si një nga palët në mardhënie, të mos e përmbushë kontratën në afat ose sipas kushteve të parashikuara në kontratë apo të mos e përmbushë, plotësisht kontratën për shkaqe të ndryshme. Në një rast të tillë, *Bashkimi Evropian mban përgjegjësi për shpërblimin e dëmit që rrjedh nga detyrimet kontraktore*, duke iu dhënë mundësinë personave fizikë ose juridikë privat, që të ngrejën *padi për shpërblimin e dëmit kontraktor ndaj tij*.

Bashkimi Evropian dhe institucionet e tij, ashtu si të gjithë subjektet e tjerë të së drejtës civile, mbajnë edhe *përgjegjësi për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, në qoftë se, ato me veprimet e ose mosveprimet e paligjshme, i shkaktajnë dëm palëve të treta*. Në ndryshim nga përgjegjësia kontraktore, e cila ekziston, në rastet kur Bashkimi Evropian dhe/ose institucionet e tij, kanë lidhur një marrëdhënie

¹⁰⁶ Shih për më tepër: Jacque, J, P; “E drejta institucionale e Bashkimit Evropian”, Shtëpia Botuese “Papyrus”, Tiranë, 2010, faqe 502.

kontraktore me subjektet e tjerë dhe i shkaktajnë dëm palës tjetër kontraktore, për shkak të mos përmbushjes së kësaj mardhënie, përgjegjësia jashtëkontraktore, ekziston në rastet kur ndërmjet Bashkimit ose institucioneve të tij, nuk ekziston asnjë mardhënie juridike me palën e dëmtuar, të cilës i është shkaktuar dëmi. Ky përbën edhe dallimin themelor, në fushën e të drejtës civile, ndërmjet përgjegjësisë kontraktore dhe përgjegjësisë jashtëkontraktore, ndërkohë që, ndërmjet këtyre dy llojeve të veçanta të përgjegjësisë, ekzistojnë edhe dallime të tjera, trajtimi i të cilëve, del jashtë objektit të këtij Punimi.

Përveçse në fushën e të drejtës civile të legjislacionit të brendshëm të Shteteve Anëtare, përgjegjësia kontraktore dhe jashtëkontraktore, është e ndryshme edhe për Bashkimin Evropian dhe institucionet e tij dhe për këtë arsye, këto dy lloje përgjegjësisë, do të trajtohen të ndara nga ana ime, duke filluar me përgjegjësinë kontraktore të Bashkimit dhe institucioneve të tij. *Përgjegjësia kontraktore e institucioneve, organeve, zyrave dhe agjensive të Bashkimit Evropian, është parashikuar edhe në Traktatet Kushtetuese, të cilat përcaktojnë se, kjo përgjegjësi rregullohet sipas ligjit që është i zbatueshëm për kontratën konkrete të lidhur.*¹⁰⁷

Në rastin e *përgjegjësisë kontraktore të Bashkimit dhe institucioneve të tij*, zakonisht, kur Bashkimi Evropian lidh kontrata në fushën e së drejtës civile ose tregtare, me subjekte të tjerë, persona fizikë ose juridikë priavat, palë në kontratë, *parashikojnë edhe ligjin e zbatueshëm që të shërbejë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve*. Kështu, për shembull, në një rast hipotetik, nëse Komisioni Evropian lidh një kontratë shërbimi telefonik, me një kompani private që ofron shërbime të tilla, e cila e ka qendrën në Francë, dhe palët parashikojnë që për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet palëve, do të zbatohet ligji francez, atëherë përgjegjësia kontraktore të Bashkimit, në këtë rast, do të rregullohet sipas ligjit francez. E njëjta gjë ndodh në të gjitha kontratat që lidhen nga Bashkimi dhe institucionet e tij, me personat fizikë ose juridikë privat, kur palët në kontratë kanë përcaktuar se, cili është ligji që do të zbatohet për kontratën e lidhur, në të gjitha këto raste, përgjegjësia kontraktore e Bashkimit do të përcaktohet, sipas ligjit që është parashikuar nga palët për rregullimin e kontratës.

Problemi vështirësohet kur Bashkimi Evropian ka lidhur një kontratë me një ose disa persona fizikë ose juridikë dhe palët nuk kanë përcaktuar në kontratë se cili është ligji i zbatueshëm. Në këtë rast, shtrohet pyetje: Mbi bazën e cilit ligj do të rregullohet përgjegjësia kontraktore Bashkimit Evropian dhe institucioneve të tij në këtë rast? Përgjigjen në lidhje me këtë pyetje e jep e *drejta ndërkombëtare private*, e cila përbën një degë të veçantë të së drejtës civile ose private dhe që ka si funksion themelor, *zgjidhjen e konfliktit të ligjeve*, në rastet kur subjektet e mardhënies juridike i përkasin shteteve të ndryshme ose kur objekti i mardhënies apo përmbajtja e saj, shtrihet në dy ose më shumë shtete të ndryshme, të cilat quhen ndryshe edhe *mardhënie juridike, me elementë të huaj*.

Dhënia e një përgjigje të detajuar në lidhje me pyetjen e shtruar më sipër, del jashtë qëllimit të këtij Punimi, por, gjithësesi, për të mos lënë pa përgjigje pyetjen e shtruar më lart, çështja e ligjit të zbatueshëm nga e drejta ndërkombëtare private, zgjidhet në këtë rast, mbi bazën e të quajturit *Kriteri lidhës*. Mbi bazën e këtij *Kriteri, për rregullimin e një mardhënie kontraktore me elementë të huaj, ku përfshihet edhe*

¹⁰⁷ Paragrafi i parë i nenit 340 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon: *“Përgjegjësia kontraktore e Bashkimit rregullohet nga ligji i zbatueshëm për kontratën në fjalë”*.

përgjegjësia kontraktore, do të zbatohet, ligji i atij shteti, i cili është më i afërt për rregullimin e mardhënies, fakt i cili, përcaktohet, rast pas rasti, nga ana e Gjykatës.

Rregulli i mësipërm i *Kriterit lidhës*, do të zbatohet edhe për përgjegjësinë kontraktore të Bashkimit Evropian dhe institucioneve të tij, me subjektet e tjerë, në rastet kur ata kanë krijuar mardhënie kontraktore dhe në kontratë nuk kanë përcaktuar ligjin e zbatueshëm. Kështu, në një shembull hipotetik, në rast se, Parlamenti Evropian ka lidhur një kontratë për sigurimin nga zjarri, të ambienteve dhe të godinës, ku ai ushtron aktivitetin e tij, me një shoqëri sigurimi që e ka selinë në Danimarkë, dhe palët në kontratë nuk kanë përcaktuar se cili do të jetë ligji i zbatueshëm, atëherë për rregullimin e përgjegjësisë kontraktore, në bazë të Kriterit lidhës, *si ligj më i afërt*, do të ishte ose ligji danez, si ligji i shtetit ku ndodhet selia e shoqërisë sigurorese, ose ligji francez, si ligji i shtetit ku ndodhet selia e Parlamentit Evropian. Në një rast të tillë, gjykata, në varësi nga bindja e saj e brendshme, si dhe duke iu referuar provave dhe rrethanave konkrete, do të zgjidhte që të zbatonte njërin prej këtyre dy ligjeve, pra, ose ligjin danez ose ligjin francez, dhe jo një ligj tjetër, për shembull, ligjin italian apo polak, pasi në bazë të Kriterit lidhës, ligji më i afërt në këtë rast për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është ose ligji danez ose ligji francez.

Në lidhje me përgjegjësinë kontraktore të Bashkimit Evropian dhe institucioneve të tij, përballë personave fizikë ose juridikë privatë, me të cilët Bashkimi ka lidhur kontrata me ta, duhet theksuar se, kompetenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, respektivisht, e Gjykatës së Përgjithshme për të zgjidhur mosmarrëveshje të tilla, *është një kompetencë fakultative, mbi bazën e zgjedhjes së palëve, dhe jo një kompetencë e detyrueshme*. Kjo do të thotë që, Gjykata e Drejtësisë mund të vendosë për një çështje që ka të bëjë me përgjegjësinë kontraktore të Bashkimit dhe institucioneve të tij, vetëm në qoftë se, palët në kontratë, pra, Bashkimi Evropian ose institucionet e tij, nga njëra anë dhe personat fizikë ose juridikë privat, nga ana tjetër, në kontratën e lidhur, kanë parashikuar që kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata Evropiane e Drejtësisë, parashikim i cili njihet me emrin *Klauzolë arbitrazhi*. Në të kundërt, në qoftë se, palët në kontratë, që janë Bashkimi ose institucionet e tij, nga njëra anë dhe personat fizikë ose juridikë nga ana tjetër, nuk kanë parashikuar një *Klauzolë arbitrazhi*, në bazë të të cilës kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve për kontratën e lidhur do të jetë Gjykata e Drejtësisë, atëherë, si gjykatë kompetente do të jetë gjykata e shtetit, ligji i të cilit do të zbatohet për rregullimin e kontratës.

Fakti që kompetenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë për gjykimin e mosmarrëveshjeve që kanë të bëjnë me përgjegjësinë kontraktore të Bashkimit Evropian dhe institucioneve të tij, përballë personave fizikë ose juridikë privatë, është një kompetencë fakultative ose opsionale dhe jo e detyrueshme, është përcaktuar, në mënyrë të shprehur edhe në Traktatet Kushtetuese. Kështu, *sipas këtyre Traktateve, Gjykata e Drejtësisë, ka kompetencë për të gjykuar dhe vendosur në lidhje me mosmarrëveshjet që kanë të bëjnë me përgjegjësinë kontraktore të Bashkimit Evropian, vetëm mbi bazën e një Klauzole arbitrazhi, me anë të të cilës, palët në kontratë, ia kanë njohur shprehimisht një të drejtë të tillë kësaj Gjykate*. Nëse palët në kontratën e lidhur, me anë të Klauzolës së arbitrazhi, ia kanë njohur të drejtën Gjykatës së Drejtësisë për të zgjidhur mosmarrëveshjen në lidhje me përgjegjësinë kontraktore, kjo Gjykatë do të jetë kompetente, pavarësisht nga fakti nëse, kontrata i takon të drejtës private apo të drejtës publike.¹⁰⁸

¹⁰⁸ Neni 272 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

Si kontrata të së drejtës private konsiderohen të gjitha kontratat që lidhen nga palët në bazë të vullnetit të lirë të tyre, bazuar në parimin e autonomisë së vullnetit, rregullimi i të cilave, përgjithsisht bëhet nga Kodet Civile ose Tregatë të Shteteve Anëtare. Si shembuj të kontratave të tilla mund të përmendim, duke filluar që nga kontratat më klasike, si kontrata e shitjes, qirasë, sipërmarrjes, agjensisë, sigurimit, deri tek kontratat e reja dhe moderne, si kontrata faktoring, leasing, franchising e të tjera që rregullohen nga e drejta private. Ndërsa, si kontrata të së drejtës publike, do të konsiderohen ato kontrata që njihen edhe me emrin kontrata administrative, në të cilat, zakonisht, njëra palë e kontratës është një organ i administratës publike, dhe që kanë si qëllim lindjen, ndryshimin dhe shuarjen e një marrëdhënie juridike, në fushën e të drejtës publike. Si kontrata të tilla, në varësi të legjislacionit të Shteteve Anëtare të ndryshme, mund të përmendim, kontratat e furnizimit me energji elektrike, kontratat e shërbimit telefonik, prokurimi i punëve ose shërbimeve publike, licencimi i lojrave të fatit, kontraktimi i shërbimeve të subjekteve private, në raste e fatkeqësive natyrore, si dhe në përgjithësi, të gjitha ato kontrata, ku interesi publik është i pranishëm dhe për të cilën, legjislacionet e brendshme të Shteteve parashikojnë edhe Autoritete të Pavarura, që mbikqyrin lidhjen dhe ekzekutimin e këtyre kontratave.

Përsa i përket *përgjegjësisë jashtëkontraktore* të institucioneve, organeve, zyrave dhe agjensive të Bashkimit Evropian, duhet thënë se, në ndryshim nga përgjegjësia kontraktore, *kompetenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë për të shqyrtuar dhe vendosur për këtë lloj përgjegjësie, është e detyrueshme*. Kjo nënkupton që, *Gjykata e Drejtësisë, është e detyruar që të shqyrtojë dhe vendosë për çdo padi që paraqitet nga personat fizikë ose juridikë privatë ose edhe Shtetet Anëtare, me anë të të cilës kërkohet që Bashkimi Evropian dhe institucionet e tij, të përgjigjen civilisht, për dëmin jashtëkontraktor që iu kanë shkaktuar palëve të treta*. Një përgjegjësi e tillë e Bashkimit dhe institucioneve të tij, është parashikuar, shprehimisht në Traktatet Kushtetuese, në të cilat thuhet se, në rastet e përgjegjësisë jashtëkontraktore, Bashkimi Evropian, mund të japë dëmshpërblim për çdo dëm që institucionet ose nëpunësit e tyre, iu shkaktojnë palëve të treta.¹⁰⁹

Në Traktatet Kushtetuese parashikohet se, për përcaktimin e përgjegjësisë jashtëkontraktore të institucioneve, organeve, zyrave ose agjensive të Bashkimit Evropian, Gjykata e Drejtësisë bazohet në *“parimet e përgjithshme që janë të përbashkëta për ligjet e Shteteve Anëtare”*. Se cilët janë *“parimet e përgjithshme që janë të përbashkëta për ligjet e Shteteve Anëtare”*, duke qenë se sistemi ligjor i Shteteve që përbëjnë sot Bashkimin Evropian, është i ndryshëm, është e vështirë që të përcaktohet në mënyrë konkrete dhe shteruese.

Një punë të jashtëzakonshme për përcaktimin e përgjegjësisë jashtëkontraktore të institucioneve të Bashkimit Evropian, përballë palëve të treta, ka bërë Gjykata Evropiane e Drejtësisë, me vendimet e saj dhe për këtë arsye, në këtë çështje, do të citohen nga ana ime, disa vendime të kësaj Gjykate, prej ku kanë dalë edhe edhe rregullat bazë, për përcaktimin e përgjegjësisë jashtëkontraktore të Bashkimit dhe institucioneve të tij.

“Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian ka kompetencë të gjykojë dhe vendosë në mbështetje të klauzolave të arbitrazhit të përfshira nga kontratat e lidhura nga Bashkimi ose për llogari të Bashkimit, pavarësisht nëse këto kontrata i rregullon e drejta publike ose ajo private”.

¹⁰⁹ Paragrafi i dytë i nenit 340 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Në rastin e përgjegjësisë jashtëkontraktore, Bashkimi mund të japë dëmshpërblim, në përputhje me parimet e përgjithshme që janë të përbashkëta për ligjet e Shteteve Anëtare, për çdo dëm që shkaktojnë institucionet ose nëpunësit e tij gjatë kryerjes së detyrave të tyre”.

Duke iu referuar parimeve të përgjithshme, të përbashkëta, të së drejtës së Shteteve Anëtare, si dhe vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë, rezulton se, *kushtet kryesore që duhet të plotësojë një person fizik ose juridik privat, që Bashkimi Evropian të mbajë përgjegjësi jashtëkontraktore janë tre:*

- a) *Veprimi ose mosveprimi i paligjshëm i institucionit të Bashkimit Evropian;*
- b) *Shkaktimi i dëmit ose mundësia reale e shktimit të dëmit;*
- c) *Lidhja shkakësore, e drejtpërdrejtë, ndërmjet veprimit dhe mosveprimit të paligjshëm dhe dëmit të ardhur ose mundësisë reale të ardhjes së tij.*

Kushtet e mësipërme duhet të plotësohen në çdo rast, që ngrihet një padi me objekt dëmshpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, dhe duhet theksuar që, barrën e provës (*onus probandi*) për të provuar ekzistencën, në të njëjtën kohë, të secilit prej këtyre kushteve e ka paditësi pra, në rastin konkret, personi fizik ose juridik privat që ngren padinë. Por, kjo padi, mund të ngrihet, jo vetëm nga personi fizik ose juridik privat kundër Bashkimit Evropian dhe institucioneve të tij, por edhe nga Bashkimi kundër personave privatë dhe në rastet kur padia ngrihet nga institucionet e Bashkimit Evropian, kuptohet se, barrën e provës, për të provuar ekzistencën e këtyre kushteve e kanë këta të fundit.

Në përcaktimin e kushteve që duhet të plotësojë personi fizik ose juridik privat, për ngritjen e padisë me objekt shpërblimi e dëmit jashtëkontraktor, konstatohet se, nuk përmendet *ekzistenca e fajit të institucionit*, si një nga kushtet për shpërblimin e dëmit. Gjykata Evropiane e Drejtësisë, nga ana e saj, në vendimet e saj, është munduar që ta shmangë përdorimin e konceptit “faj”, si një nga kushtet e përgjegjësisë jashtëkontraktore të institucioneve të Bashkimit, sepse, ky koncept ka kuptime të ndryshme, në sistemet ligjore kombëtare të Shteteve Anëtare.¹¹⁰

*Përgjegjësia jashtëkontraktore e Bashkimit Evropian dhe institucioneve të tij, është e ndryshme, në varësi të faktit nëse jemi para një akti ku Bashkimi ka liri veprimi për nxjerrjen e tij, të quajtura edhe si akte vetëgjykimore apo jemi para një akti ku, nuk ekziston liria e veprimit nga Bashkimi për nxjerrjen e tij, të njohura edhe si akte jo vetëgjykimore.*¹¹¹ Në përputhje me këtë ndarje, *përgjegjësia jashtëkontraktore e Bashkimit Evropian dhe institucioneve të tij, është më e vështirë për t’u provuar nga ana e personave fizikë dhe juridikë privatë, në rastet e akteve vetëgjykimore dhe është më e lehtë për t’u provuar në rastet e akteve jo vetëgjykimore.* Duke qenë se, për të konstatuar përgjegjësinë e Bashkimit në rastet e akteve vetëgjykimore, palëve private iu duhet një punë shumë e madhe dhe kjo gjë përbën një çështje të vështirë, edhe vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në përgjithësi, iu referohen këtyrë akteve, të cilat përbëjnë edhe çështjet më të debatueshme, kur trajtohet përgjegjësia jashtëkontraktore e Bashkimit Evropian dhe institucioneve të tij.

Padia e ngritur nga personat fizikë ose juridikë privat kundër Bashkimit Evropian dhe insitucioneve të tij, më objekt shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, është e lidhur me padinë e anulimit ose padinë për mosveprim që mund të ngrejë këta persona kundër institucioneve të Bashkimit. Kjo për faktin se, shumica e padive që ngrihen nga palët private, me objekt shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, bazohen në një veprim ose mosveprim të paligjshëm të institucioneve të Bashkimit Evropian.

¹¹⁰ Shih për më tepër: Jacque, J. P; “*E drejta institucionale e Bashkimit Evropian*”, Shtëpia Botuese “Papyrus”, Tiranë, 2010, faqe 520.

¹¹¹ Shih për më tepër: Craig P; De Burca G; “*E drejta e Bashkimit Evropian, Tekste, çështje gjyqësore dhe materiale*”, botuar nga Qendra e Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2013, faqe 655

Për këtë shkak u konstatua se, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, fillimisht, pranoi se, padia për dëmshpërblimin jashtëkontraktor, ishte një padi që kushtëzohej nga ngritja e padisë për anulim ose për mosveprim dhe vetëm pasi të ishte pranuar me sukses një nga këto padi, mund të ngrihej padia për dëmshpërblimin jashtëkontraktor, duke e orientuar praktikën gjyqësore, drejt faktit që kjo padi (padia për dëmshpërblimin jashtëkontraktor), nuk ishte një padi e pavarur, fakt ky i pranuar nga Gjykata në çështjen Plaumann, çështje e cila, është trajtuar me hollësi nga ana ime në këtë Punim. Megjithatë, pavarësisht nga ky orientim i fillimit të praktikës gjyqësore, Gjykata e Drejtësisë, në vendimet e mëvonshme dhe konkretisht duke filluar nga vendimi i dhënë me datë 2 dhjetor 1971, në çështjen 5/71, *Zuckerfabrik Schoppenstedt*, e ka ndryshuar qëndrimin e saj dhe ka pranuar se, padia për dëmshpërblimin jashtëkontraktor, është një padi e pavarur që mund të ngrihet nga personi, pa qenë e nevojshme që të ngrihet më parë, padia e anulimit ose padia për mosveprim. Duke filluar nga ky vendim, në të gjitha çështjet e tjera, nga ana Gjykatës është pranuar se, padia për dëmshpërblim, është një padi e pavarur dhe autonome, e cila nuk ka lidhje me paditë e tjera që mund të ngrihen ndaj institucioneve të Bashkimit Evropian.

Trajtimi i përgjegjësisë jashtëkontraktore të institucioneve, organeve, zyrave dhe agjensive të Bashkimit Evropian, do të fillojë me përgjegjësinë që ata kanë për nxjerrjen e akteve ku institucionet e Bashkimit kanë një liri të caktuar veprimi, të quajtura si *akte vetëgjykimore*. Çështja e përgjegjësisë jashtëkontraktore të institucioneve të Bashkimit Evropian, për aktet vetëgjykimore është trajtuar nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë në disa vendime të saj, ku, një ndër vendimet e para është vendimi i datës 2 dhjetor 1971, në çështjen gjyqësore 5/71, *Zuckerfabrik Schoppenstedt*, të përmendur më sipër, me anë të të cilit Gjykata vendosi kriteret e përgjithshme për përcaktimin e kësaj përgjegjësie. Kjo çështje i referohej një padie të ngritur kundër nga Zuckerfabrik Schoppenstedt, kundër Këshillit, me anë të të cilës paditësi pretendonte se Rregullorja 769/68 e Këshillit që kishte të bënte me tregun e sheqerit, ishte në kundërshtim me nenin 40 të Traktatit të Komunitetit Evropian, pasi ishte diskriminues me mënyrën me të cilën vendoste politikën e çmimit të produktit. Gjykata duke vendosur mospranimin e padisë, në vendimin e saj, të mësipërm, ndër të tjera, arsyetonte: “...Në çështjen e tanishme, detyrimi jo kontraktor i komunitetit supozon se të paktën karakteri i paligjshëm i aktit të përfolur është shkak i dëmit. Kur flitet për aktin legjislativ, që përfshin masa të politikës ekonomike, Komuniteti nuk përmban përgjegjësi jashtëkontraktore për dëmin që pësojnë individët si pasojë e atij akti, sipas dispozitave që përmban paragrafi i dytë i nenit 215 të Traktatit, po se, nuk ka kryer një shkelje njaft flagrante të një norme ligjore superiore për mbrojtjen e individit. ...”¹¹²

Bazuar në vendimin e mësipërm të Gjykatës, *kriteret e përgjithshme* për pranimin e padisë së personit fizik ose juridik privat me objekt dëmshpërblimin e dëmit jashtëkontraktor të ardhur nga një akt vetëgjykimor i institucioneve të Bashkimit Evropian, rezulton se janë tre:

- i. akti duhet të përbëjë një shkelje flagrante të një norme ligjore;
- ii. akti duhet të ketë shkelur, në mënyrë flagrante, një normë ligjore superiore;
- iii. akti duhet që të ketë shkelur në mënyrë flagrante një normë ligjore superiore, e cila i ka si qëllim mbrojtjen e individit.

¹¹² Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1971) ECR 975, në çështjen gjyqësore 5/71, *Zuckerfabrik Schoppenstedt vs Council*.

Për përcaktimin e përgjegjësisë jashtëkontraktore të institucioneve të Bashkimit Evropian, në rastet e akteve vetëgjykmore, është e nevojshme që të sqarohen tre koncepte të reja dhe konkretisht, duhet të përcaktohet se, çfarë duhet të kuptojmë me *“shkelje flagrante të një norme ligjore”*, çfarë duhet të kuptojmë me *“norme ligjore superiore”*, si dhe çfarë duhet të kuptojmë me *“norme ligjore që ka si qëllim mbrojtjen e individit”*? Sqarimi i secilit prej këtyre koncepteve është një punë e ndërlikuar dhe është bërë nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë me vendimet e saj, në çështje të ndryshme, disa prej të cilëve do të citohen në këtë punim, megjithatë, e çmoj me rëndësi që përkufizimi i secilit prej tyre të bëhet edhe nga ana ime.

Me *“shkelje flagrante të një norme ligjore”*, do të kuptojmë ato raste kur institucioni i Bashkimit Evropian, në nxjerrjen e aktit i kalon hapur kufijtë e lirisë së veprimit të dhëna nga norma ligjore, ose abuzon me lirinë e veprimit të tij. *“Shkelje flagrante”*, e aktit nuk nënkupton çfarëdo lloj mosrespektimi të normave ligjore, por, nënkupton një mosrespektim ose një shkelje të hapur dhe të rëndë të lirisë së veprimit të institucionit në nxjerrjen e aktit. Nga ana tjetër, *“shkelja flagrante e një norme ligjore”*, nuk nënkupton që duhet të jemi para një akti arbitrar, në mënyrë që ajo të konsiderohet si shkelje flagrante, sepse, arbitrariteti, është një nocion i huaj për rendin juridik dhe të drejtën e Bashkimit Evropian dhe askujt nuk mund t’i vihet kushti që të provojë që akti është arbitrar, me qëllim që ai të përfitojë dëmshpërblimin jashtëkontraktor.

Me *“shkelje flagrante të një norme ligjore”*, do të kuptojmë jo vetëm rastet kur akti i institucionit të Bashkimit Evropian, shkel në mënyrë të rëndë dhe të qartë lirinë e tij të veprimit në nxjerrjen e aktit, por edhe rastet kur institucionet e Bashkimit Evropian, nuk veprojnë, në kushtet kur kishin një detyrim ligjor për të vepruar. Edhe mosveprimi i institucioneve të Bashkimit, duhet të jetë i tillë që të përbëjë një shkelje të hapur dhe të rëndë të lirisë së veprimit dhe të detyrimit për të vepruar, ku institucioni, megjithëse e ka patur këtë detyrim, përsëri nuk ka vepruar. Ashtu si edhe në rastin e aktit që përbën shkelje të rëndë, edhe tek mosveprimi, nuk kërkohet që ky mosveprim të barazohet me arbitraritetin, por, që të jetë i i tillë që i afrohet kufijve të arbitraritetit, duke sjellë cënimin e rëndë të interesave të individit.

Me *“norme ligjore superiore”*, do të kuptojmë të gjitha ato norma që shërbejnë si bazë për nxjerrjen e aktit dhe që akti konkret është nxjerrë në bazë dhe për zbatim të tyre. Përcaktimi i faktit nëse jemi para shkeljes së një norme ligjore superiore apo jo, bëhet në bazë të parimit të hierarkisë së normave ligjore, ku, një normë që qëndron më poshtë në sistemin hierarkik, duhet të jetë në përputhje me një normë që qëndron më lart në këtë sistem, në të kundërt është e pavlefshme. Duke iu referuar rendit juridik evropian, mendoj se, normat ligjore renditen sipas këtij rendi hierarkik:

- Traktatet Kushtetuese, të cilat aktualisht janë, Traktati i Bashkimit Evropian, Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe Traktati i Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike;
- Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Bashkimi Evropian me Shtetet e Treta;
- Parimet e përgjithshme të së drejtës, të cilat janë të përbashkëta për ligjet e Shteteve Anëtare;
- Aktet normative të nxjerra nga institucionet kushtetuese të Bashkimit Evropian (Parlamenti, Këhilli, Komisioni) me karakter të përgjithshëm;
- Aktet normative të nxjerra nga organet, zyrat, apo agjensitë e Bashkimit Evropian;

- Aktet e tjera juridike me karakter individual të nxjerra nga institucionet e Bashkimit Evropian ose nga organet, zyrat, apo agjensitë e tij.

Në përputhje me konceptin shkelje e një *“norme ligjore superiore”*, personi fizik ose juridik privat, mund të ngrejë padi për dëmshpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, në qoftë se, për shembull, një akt normativ i nxjerrë nga Këshilli ose Komisioni, vjen në kundërshtim me Traktatet Kushtetuese, ose një vendim individual i nxjerrë nga Komisioni, vjen në kundërshtim me një akt normativ, me karakter të përgjithshëm të nxjerrë nga Këshilli ose edhe nga vetë Komisioni. Nisur nga sa u sqarua më lart, duhet të pranojmë se, *nuk mund të ngrihet padi me objekt shpërblim dëmi jashtëkontraktor, me pretendimin e shkeljes së një “norme ligjore superiore”, në rastet kur akti që pretendohet se ka shkaktuar dëmin, është bazuar në një akt tjetër, të të njëjtit nivel.* Për shembull, nuk mund të kërkohej dëmshpërblim për një rregullore të miratuar nga Këshilli, e cila është bazuar në një Rregullore tjetër po të miratuar më parë, nga Këshilli, me pretendimin se, Rregullorja e miratuar më vonë, ka shkelur Rregulloren e mëparshme të Këshillit, sepse të dy aktet në këtë rast, janë në të njëjtin nivel hierarkie, dhe nuk plotësohet kushti që akti që pretendohet se ka shkaktuar dëmin, të ketë shkelur një *normë ligjore superiore*.

Padia për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor kundër institucioneve të Bashkimit Evropian, nuk mund të ngrihet nga personat fizikë ose juridikë privat, por as edhe nga Shtetet Anëtare, me pretendimin se, nxjerrja ose miratimi një normë ligjore të Traktateve Kushtetuese, iu ka shkaktuar një dëm të caktuar. Kjo për faktin e thjeshtë se, sistemi ligjor që përbën Traktatet Kushtetuese, nuk është i krijuar nga Bashkimi Evropian dhe institucionet e tij, por, është i krijuar nga vetë Shtetet Anëtare. Në kushtet kur, normat ligjore që përbëjnë këto Traktate, nuk janë akte që janë nxjerrë nga Bashkimi Evropian, atëherë, Bashkimi nuk mund të mbajë përgjegjësi për akte që nuk janë nxjerrë prej tij.

Koncepti i tretë që duhet sqaruar për përcaktimin e përgjegjësisë jashtëkontraktore të Bashkimit Evropian, në rastet e akteve vetëgjykimore, të cilat siç e thamë, janë akte, ku Bashkimi ka një liri veprimi, është sqarimi i faktit se, çfarë duhet të kuptojmë me *“norme ligjore që ka si qëllim mbrojtjen individit”*? Në përgjigje të pyetjes së shtruar, do të kemi të bëjmë me një *“norme ligjore që ka si qëllim mbrojtjen individit”, në rastet kur norma ligjore i njeh të drejta të caktuara individit ose mbron një interes të ligjshëm të tij.*

Si norma ligjore që i njohin të drejta individit, mund të përmenden një numër i madh dispozitash të Traktateve Kushtetuese, por, edhe të normave ligjore të përgjithshme të nxjerra nga institucionet e Bashkimit Evropian, në bazë dhe për zbatim të Traktateve Kushtetuese, të cilat parashikojnë lindjen, ndryshimin ose shuarjen e marrëdhënieve juridike, brenda Bashkimit. Nga Traktatet Kushtetuese, si shembull të normave ligjore që parashikojnë të drejta për individët, mund të përmendim nenin 16 të Traktatit për funksionimin e Bashkimit Evropian, i cili, i njeh çdo individ të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale, ose nenet 45, deri në 66 të po këtij Traktati që, njohin të drejtën e lëvizjes së lirë të personave, shërbimeve dhe kapitaleve, si dhe një sërë nenesh të tjera, ku një vend qëndror zënë edhe nenet që përmban Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, e cila, ka të njëjtën vlerë me Traktatet Kushtetuese.

Si dispozita ligjore të cilat mbrojnë një interes të ligjshëm të individit nga Traktatet Kushtetuese, mund të përmendim nenin 19 të Traktatit që ndalon diskriminimin mbi baza racore, feje, gjinie, moshe, aftësie apo orientimi seksual, ose nenet 111-118 të Traktatit që garantojnë konkurrencën e ndershme, brenda tregut të

përbashkët evropian. Përsa i përket normave ligjore të nxjerra nga insitucionet e Bashkimit Evropian, që njohin të drejta për individët ose mbrojnë interesat e tyre, nga ana ime është e vështirë që të përmendet ndonjë shembull konkret, pasi këto norma ose akte ligjore, nxirren nga insitucionet e Bashkimit, rast pas rasti, në varësi të fushës së veprimtarisë së tyre dhe të situatës konkrete që duhet rregulluar.

Duhet theksuar se, secili nga këto kritere të përgjithshme është trajtuar nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në disa vendime të saj, ku nga ana ime, do të zgjidhen për t'u pasqyruar në këtë punim, dy prej këtyre vendimeve. Kështu në lidhje me plotësimin e kriterit të shkeljes së një "norme ligjore superiore", vlen të përmendim vendimin e Gjykatës në çështjen gjyqësore 74/74, *Comptoir National Technique Agricole SA, kundër Komisionit*. Kjo çështje i referohet një padie të ngritur nga shoqëria Agricole SA, kundër Rregullores 189/72 të Komisionit Evropian, e cila hyri në fuqi me 1 shkurt 1972, me anë të të cilës pretendonte se, kishte pësuar humbje nga heqja e shumave të kompensimit monetar, përsa iu përket farërave të kolzës dhe kolzës vajore, heqje që ishte bërë me anë të kësaj Rregulloreje. Heqja e shumave të kompensimit ishte bërë nga Komisioni, pasi ai kishte vlerësuar se, situata e tregut kishte ndryshuar, prandaj edhe dhënia e kompensimit monetar ishte i panevojshëm.

Në çështjen konkrete rezultoi e provuar se, pala paditëse kishte lidhur kontrata që nënkuptonin kompensimin monetar, përpara se të miratohej Rregullorja, kontrata që do të ekzekutoheshin pas përfundimit të skemës së kompensimit. Paditësi argumentonte se, i kishte lidhur kontratat duke supozuar se shuma e kompensimit monetar, do të ishte ende e pagueshme dhe se e kishte vendosur çmimin mbi këtë hipotezë. Mbyllja e papritur e sistemit të kompensimit monetar, në këtë fushë, pa paralajmërim, sipas paditësit i kishte shkaktuar humbje ose dëm jashtëkontraktor.

Gjykata e Drejtësisë, duke u shprehur edhe njëherë për parimin e përgjithshëm të sanksionuar në çështjen Schoppenstedt, sipas të cilit, insitucionet e Bashkimit Evropian mbajnë përgjegjësi jashtëkontraktore, vetëm kur akti ose sjellja e tyre, përbën "një shkelje mjaft flagrante të një norme superiore për mbrojtjen e individit", në vendimin e mësipërm, ndër të tjera, arsyeton:

"...17. Në lidhje me këtë pala kërkuese pretendon së pari, se duke hequr shumat e kompensimit me Rregulloren 189/72, Komisioni ka shkelur Rregulloren bazë të Këshillit me numër 974/71.

18. Rregullorja pretendon ajo, ndërsa i jep Komisionit kompetencë për të vlerësuar plotësimin e kushteve për shumat e kompensimit, nuk e lejon atë të marrë vendim për heqjen e shumave të kompensimit, kur janë caktuar dhe kërkon për çdo rast që vendimi i Komisionit të merret vetëm mbi bazën e vlerësimit të faktorëve monetarë dhe duke përjashtuar faktorët ekonomikë, që janë marrë parasysh nga Komisioni.

19. Nga fjalia e fundit e nenit 1 (2) të Rregullores 974/71 del se Shtetet Anëtare mund të përdorin variantin e shumave të kompensimit, vetëm kur masat monetare në fjalë do të çonin në çrregullime të tregtisë së produkteve bujqësore.

20. Meqënëse përdorimi i shumave kompensuese është një masë me karakter të veçantë, kjo dispozitë duhet kuptuar sikur paraqet një kusht jo vetëm për futjen, por edhe për mbajtjen e shumave të kompensimit për një produkt specifik.

21. Komisioni ka një masë të madhe lirie veprimi për të gjykuar, nëse masa monetare në fjalë, mund të çojë në çrregullime për tregtimin e produkteve në fjalë.

22. Me qëllim që të gjykojë mbi rrezikun e çrregullimeve të tilla, Komisionit i lejohet të marrë parasysh kushtet e tregut, si dhe faktorët monetare.

23. Nuk është vertetuar se Komisioni i kaloi kufijtë e kompetencave të tij, kur ai nga fundi i janarit të vitit 1972, vlerësoi se situata në tregun e kolzës dhe të farërave të kolzës ishte e tillë që, përdorimi i shumave të kompensimit për ato produkte nuk ishte më i nevojshëm.

...41. Sidoqoftë përdorimi i shumave të kompensimit në praktikë, shmang rrezikun e kursit të këmbimit, ndaj një tregtar, qoftë edhe një tregtar i matur, mund të nxitet të lërë pas dorë ruajtjen e vetes nga një rrezik i tillë.

42. Në këto rrethana, një tregtar mund të shpresojë në mënyrë legjitime që, për transaksionet e kryera prej tij në mënyrë të pakthyeshme, pasi ai ka siguruar kundrejt dispozitës përkatëse licensat e eksportit, të cilat caktojnë shumën e paradhënies së kompensimit, të mos ndodhë ndonjë veprim i paparashikuar, i cili mund t'i shkaktojë atij humbje të pashmangshme, duke e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit të monedhës.

43. Prandaj Komuniteti në mungesë të një çështje thelbësore me interes publik, është përgjegjës në qoftë se Komisioni heq me efekt të menjëhershëm dhe pa paralajmërim përdorimin e shumave kompensuese në një sektor të caktuar, pa miratuar masa kalimtare, të cilat do t'i lejonin tregtarit të paktën ose që të shmangte humbjen që do të kishte pësuar me plotësimin e kontratave të eksportit, ekzistenca dhe pakthyeshmëria e të cilave janë vendosur me caktimin që përpara kompensimeve, ose të kompensohej për humbje të tilla.

44. Në mungesë të një çështje thelbësore me interes publik, Komisioni ka shkelur një normë ligjore superiore, duke e bërë kështu Komunitetin përgjegjës, duke mos përfshirë në Rregulloren 189/72 masa kalimtare për mbrojtjen e besimit që një tregtar mund të ketë pasur në normat e Komunitetit. ...”¹¹³

Në një tjetër vendim të saj, konkretisht në çështjen C-352/98 P, *Shoqëria Farmaceutike Bergaderm SA kundër Komisionit*, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, vendosi disa kriteret të përgjithshme, në bazë të të cilave, një shkelje ligjore do të konsiderohej si shkelje serioze ose flagrante. Sipas Gjykatës, përcaktimi i faktit nëse një shkelje ligjore do të konsiderohej si flagrante, varet nga disa faktorë si: qartësia relative e normës së shkelur, masa e lirisë së veprimit që iu jepet institucioneve të Bashkimit Evropian nga norma përkatëse, nëse gabimi me ligjin ishte i arsyeshëm ose jo, si dhe nëse shkelja nga ana e institucionit ishte bërë me dashje apo nga pakujdesia. Mbi bazën e këtyre kriterëve, paditësi nuk është i detyruar që të provojë që akti është arbitrar, që institucioni të mbajë përgjegjësi për dëmin e shkaktuar. Po ashtu, masa e lirisë së veprimit që ka institucioni ndikon, në mënyrë të pashmangshme, në pranimin ose jo të padisë për dëmshpërblim. Sa më e madhe të jetë liria e institucionit për të vepruar, aq më e vështirë është për paditësin që të provojë kriterin e shkeljes flagrante të normës ligjore.¹¹⁴

Në çështjen e mësipërme, vendimi nga ana e Gjykatës së Drejtësisë u mor, pas apelit që u bë kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, sot Gjykata e Përgjithshme, ku në apel pala paditëse kërkonte dëmshpërblime për humbjet e pësuarat nga miratimi prej Komisionit Evropian të një Direktive që ndalonte përdorimin e substancave të caktuara në kozmetikë. Paditësi pretendonte se Direktiva, duhej të vlerësohej si një akt administrativ, meqenëse lidhej vetëm me palën kërkuese dhe për pasojë, paligjshmëria ishte e mjaftueshme për të provuar përgjegjësinë dhe nuk ishte e nevojshme të provohej ekzistenca e një shkelje flagrante e normës ligjore.

Gjykata e Drejtësisë, në vendimin e saj, ndër të tjera, arsyetoi:

“...41. Gjykata është shprehur se kushtet në të cilat shteti ngarkohet me përgjegjësi për dëmet e shkaktuara ndaj individëve me një shkelje të së drejtës së Komunitetit, në mungesë të një justifikimi të caktuar, nuk mund të ndryshojnë nga ato që përcaktojnë përgjegjësinë e Komunitetit në rrethana të ngjashme. Mbrojtja e të drejtave që individëve iu burojnë nga e drejta e Komunitetit, nuk mund të ndryshojë

¹¹³ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1975) ECR 533, në çështjen gjyqësore 74/74, *Comptoir National Technique Agricole SA, vs Commission*.

¹¹⁴ Shih për më tepër: Craig P; De Burca G; “E drejta e Bashkimit Evropian, Tekste, çështje gjyqësore dhe materiale”, botuar nga Qendra e Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2013, faqe 660.

në varësi të faktit, nëse autoriteti kombëtar apo një autoritet i Komunitetit, është përgjegjës për dëmin.

42. Përsa i përket përgjegjësisë së Shteteve Anëtare në lidhje me dëmin e shkaktuar ndaj individëve, Gjykata e Drejtësisë është shprehur se e drejta e Komunitetit, jep të drejtën e dëmshpërblimit kur plotësohen tre kushte: norma ligjore që është shkelur duhet të synonte që t'u jepte të drejta individëve, shkelja duhet të ishte mjaft serioze dhe të kishte një lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore ndërmjet shkeljes së detyrimit nga shteti dhe dëmit të pësuar nga palët e dëmtuara.

43. Përsa i përket kushtit të dytë, në lidhje me përgjegjësinë e Komunitetit, kriteri vendimtar për përcaktimin që shkelja e bërë nga Komuniteti është mjaft serioze, është që institucioni i Komunitetit të ketë shkelur hapur dhe rëndë kufijtë e lirisë së tij të veprimit.

44. Kur Shteti Anëtar ose institucioni evropian ka pak ose aspak liri veprimi, shkelja e dukshme e të drejtës së Komunitetit, mund të jetë e mjaftueshme për të konstatuar ekzistencën e një shkelje mjaft serioze.

45. Prandaj, është e nevojshme të shqyrtojmë nëse Gjykata e Shkallës së Parë ka gabuar ligjërisht, gjatë shqyrtimit të mënyrës me të cilën Komisioni e ushtroi lirinë e tij të veprimit, që gëzon institucioni në fjalë.

46. Në atë drejtim, Gjykata e Drejtësisë konstaton se, karakteri i përgjithshëm apo individual i një mase të marrë nga një institucion, nuk është kriteri vendimtar për identifikimin e kufijve të lirisë së veprimit që gëzon institucioni në fjalë.

47. Nga kjo rrjedh se, arsyeja e parë e apelit, që bazohet vetëm në kategorizimin e Direktivës si një masë individuale, gjithsesi nuk ka ndonjë lidhje me çështjen dhe duhet hedhur poshtë. ...”¹¹⁵

Kriteret e mësipërme të vendosura nga Gjykata e Drejtësisë, në lidhje me verifikimin e kushtit “shkelje flagrante ose mjaft serioze”, janë ndjekur nga kjo Gjykatë, si dhe nga Gjykata e Shkallës së Parë, sot Gjykata e Përgjithshme edhe në çështjet e tjera. Kështu në çështjen *Arcelor*, paditësi kërkonte dëmshpërblim për humbjet e shkaktuara nga një Direktivë që lidhej me çlirimin e gazrave të serave. Në gjykimin e kësaj çështje, Gjykata e Shkallës së Parë përdori kriterin e vendosur në çështjen *Begaderm*, sipas të cilës, i binte barra e provës paditësit që të vertetonte ekzistencën e shkeljes serioze. Një gjë e tillë kërkonte që, paditësi në çështjen konkrete, duhet të provonte që institucioni evropian, konkretisht Parlamenti Evropian, kishte dështuar, në mënyrë të dukshme dhe serioze, në lidhje me kufijtë e lirisë së veprimit të tij, në ushtrimin e kompetencave mjedisore.

Të njëjtën qëndrim mbajti Gjykata e Shkallës së Parë edhe në lidhje me çështjen *My travel* që lidhej me ligjin e Bashkimit Evropian Për konkurrencën. Kjo Gjykatë u shpreh se, koncepti i një shkelje serioze, si kusht për përcaktimin e përgjegjësisë jashtëkontraktore, nuk përfshin çdo lloj gabimi, edhe pse me një farë peshe, në zbatimin e normave në fushën e konkurrencës, të cilat sipas saj ishin “komplekse, delikate dhe subjekt i një shkalle të konsiderueshme të lirisë së veprimit”. Në këtë mënyrë, sipas Gjykatës, fakti që ajo kishte anuluar më parë një vendim të Komisionit që përcaktonte një përqendrim të papajtueshëm me tregun e përbashkët evropian, nuk mund të barazohej me konstatimin e një shkeljeje mjaft serioze. Gabimet e thjeshta të vlerësimit të rrethanave apo të situatave, në kuadrin e një padie anulimi, nuk mund të mjaftonin për të treguar një shkelje, mjaft serioze të

¹¹⁵Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (2000) ECR I-5291, në çështjen gjyqësore Shoqëria Farmaceutike Bergaderm kundër Komisionit Evropian.

kufijve të vendosura mbi lirinë e Komisionit, duke sjellë për pasojë përgjegjësinë jashtëkontraktore të tij, sepse një gjë e tillë do ta frenonte Komisionin që të merrte masa, me qëllim sigurimin e një konkurrence të ndershme, brenda tregut të përbashkët evropian.¹¹⁶

Në lidhje me përgjegjësinë jashtëkontraktore të Bashkimit Evropian për aktet jo vetëgjykimore, të cilat janë akte ku institucionet e Bashkimit kanë pak ose aspak liri veprimi për të vlerësuar për nxjerrjen e aktit, nuk është e nevojshme që të provohet ekzistenca e kushteve që janë specifike për aktet vetëgjykimore që siç thamë ishin: (a) shkelja flagrante e (b) një norme ligjore superiore (c) për mbrojtën e individit. Për përcaktimin e përgjegjësisë për aktet jo vetëgjykimore kërkohet që të plotësohen vetëm tre kushtet e përgjithshme të përgjegjësisë jashtëkontraktore që ishin:

i. paligjshmëria e veprimit;

ii. shkaktimi i dëmit dhe

iii. lidhja shkakësore, e drejtpërdrejtë, ndërmjet paligjshmërisë së veprimit dhe dëmit të pësuar.

Për aktet jo vetëgjykimore, duke qenë se, nuk është e nevojshme që të provohet ekzistenca e kushteve specifike, si për aktet vetëgjykimore, përgjegjësia jashtëkontraktore e Bashkimit Evropian, është më e lehtë për t'u provuar dhe në përgjithësi, personat fizikë ose juridikë privatë, duhet që të provojnë, vetëm një shkelje të thjeshtë të së drejtës me qëllim që të pranohet padia e tyre, kuptohet pasi të kenë provuar edhe dy kushtet e tjera, shkaktimin e dëmit dhe lidhjen shkakësore. Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të institucioneve të Bashkimit, duhet të qartësoj se, në rastet e akteve vetëgjykimore, personi fizik ose juridik privat, duhet të provojë jo vetëm kushtet specifike, por edhe kushtet e përgjithshme të cilat kanë të bëjnë me paligjshmërinë e veprimit, ekzistencën e dëmit dhe lidhjen shkakësore. Në ndryshim nga kjo, për aktet jo vetëgjykimore, personi fizik ose juridik privat, duhet të provojë vetëm ekzistencën e kushteve të përgjithshme dhe jo edhe ekzistencën e kushteve specifike që kanë të bëjnë me ekzistencën e një (a) shkelja flagrante të (b) një norme ligjore superiore (c) për mbrojtën e individit, të cilat ai është i detyruar që t'i provojë për aktet vetëgjykimore.

Për përcaktimin e përgjegjësisë jashtëkontraktore të institucioneve të Bashkimit Evropian për aktet jo vetëgjykimore, një rëndësi të posaçme merr provimi i paligjshmërisë së veprimit ose mosveprimit, si një nga kushtet e përgjegjësisë jashtëkontraktore, krahas dy kushteve të tjera, shkaktimit të dëmit dhe lidhjes shkakësore. Në këto raste, si rregull, me provimin e paligjshmërisë së veprimit, të ekzistencës së dëmit dhe të lidhjes shkakësore, institucioni i Bashkimit Evropian, është përgjegjës për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor.

Megjithatë, edhe në rastet e akteve jo vetëgjykimore, nga ana e Gjykatës së Drejtësisë, provimin e paligjshmërisë së veprimit, nga ana formale, e ka barazuar me provimin e shkeljes mjaft serioze që kërkohet tek aktet vetëgjykimore, pavarësisht nga fakti se, tek këto të fundit, pra, tek aktet vetëgjykimore, kërkohet një shkelje flagrante e ligjit, ndërsa, tek aktet jo vetëgjykimore kërkohet, thjeshtë, shkelja e ligjit ose thjeshtë, vetëm paligjshmëria e veprimit.

Për përcaktimin e përgjegjësisë jashtëkontraktore, në bërjen e dallimit ndërmjet akteve vetëgjykimore dhe jo vetëgjykimore, nuk ka rëndësi lloji i aktit, pra, nuk ka rëndësi nëse akti është një akt me karakter të përgjithshëm, siç janë

¹¹⁶ Shih për më tepër: Craig P; De Burca G; "E drejta e Bashkimit Evropian, Tekste, çështje gjyqësore dhe materiale", botuar nga Qendra e Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2013, faqe 661.

Rregulloret apo Direktivat, apo është një akt i veçantë, siç janë Vendimet, e rëndësishme është liria e veprimit të institucioneve të Bashkimit në nxjerrjen e akteve. Në rastet kur institucionet kanë një liri të caktuar veprimi në nxjerrjen e aktit, të quajtura akte vetëgjykimore, pavarësisht se janë akte më natyrë të përgjithshme apo individuale, paditësi duhet të provojë përveç kushteve të përgjithshme; paligjshmëria e veprimit, ekzistenca e dëmit dhe lidhjen shkakësore mes veprimit dhe dëmit të ardhur, edhe kushtet e posaçme; (a) shkeljen mjaft serioze, (b) të një norme superiore, (c) për mbrojtjen e individit, në përputhje me parimin që, sa më e madhe të jetë liria e institucionit në nxjerrjen e aktit, aq më e vështirë është për paditësin provimi i këtyre kushteve specifike. Kur institucionet nuk kanë liri veprimi në nxjerrjen e aktit, pavarësisht se, akti mund të jetë me natyrë të përgjithshme ose individual, paditësi duhet të provojë vetëm kushtet e përgjithshme të përgjegjësisë jashtëkontraktore; paligjshmërinë e veprimit, ekzistencën e dëmit dhe lidhjen shkakësore mes veprimit dhe dëmit të ardhur dhe jo kushtet specifike.

Por, siç u përmend edhe më lart, tek *aktet jo vetëgjykimore*, nga ana e Gjykatës së Drejtësisë, *paligjshmëria e veprimit*, është konsideruar si një kriter i barabartë me shkeljen mjaft serioze, tek *aktet vetëgjykimore* dhe provimi i vetëm paligjshmërisë së veprimit, i ka mjaftuar Gjykatës që në rastet e akteve jo vetëgjykimore, ta konsiderojë veprimin e institucionit si shkelje mjaft serioze të ligjit. Gjykata po ashtu, ka theksuar në vendimet e saj, se, për të përcaktuar nëse jemi para një akti vetëgjykimor apo para një akti jo vetëgjykimor, nuk ka rëndësi lloji i aktit, pra, nëse jemi para një akti me karakter të përgjithshëm, siç janë Rregulloret apo Direktivat, ose jemi para një akti individual siç janë vendimet, njoftimet apo urdhërat, por, rëndësi ka liria e veprimit të institucionit të Bashkimit Evropian. Kështu, në *çështjen gjyqësore C-390/95 Antilean Rice Mills kundër Komisionit*, palët paditëse kundërshtuan disa nene të vendimit bazë të Këshillit, që përcaktonte mardhëniet ndërmjet vendeve dhe territoreve të huaja me Bashkimin Evropian. Paditësit kundërshtonin edhe një vendim të Komisionit që caktonte masa mbrojtëse për orizin, që e kishte origjinën nga Antilet holandeze, për shkeljen e vendimit bazë të Këshillit.

Gjykata e Shkallës së Parë, sot Gjykata e Përgjithshme, vendosi mospranimin e padisë, për pjesën më të madhe të kërtimeve të paditësit. Në apelin e bërë, para Gjykatës së Drejtësisë, paditësi pretendonte se, vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë ishte i gabuar, pasi ajo, padrejtësisht kishte kërkuar prova që të provonin një shkelje mjaft serioze, në kushtet kur sipas paditësit, këto prova nuk duhej të kërkoreshin, pasi paditësi kundërshtonte një akt individual siç ishte vendimi i Komisionit dhe jo një akt normativ. Gjykata e Drejtësisë, duke konfirmuar ligjshmërinë e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, në vendimin e saj, ndër të tjera, arsyetonte:

“...57. Së pari, duhet theksuar se nga praktika gjyqësore është përcaktuar se në kontekstin legjislativ, që lidhet me ushtrimin e një lirie të madhe veprimi, Komuniteti nuk mund të mbajë përgjegjësi në qoftë se, institucioni në fjalë nuk ka shkelur hapur dhe rëndë kufijtë e ushtrimit të kompetencave të tij ...

58. Së dyti, Gjykata e Shkallës së Parë procedoi mbi bazën e faktit që Komisioni gëzonte një liri të madhe veprimi në fushën e politikës ekonomike, që do të thotë se, duhet zbatuar kriteri më i rreptë i përgjegjësisë, kryesisht kriteret specifike për një shkelje mjaft serioze të një norme ligjore superiore, për mbrojtjen e individit.

59. Nga kjo rrjedh se, Gjykata e Shkallës së Parë zbatoi, me saktësi, kriterin më të rreptë të përgjegjësisë.

60. Fakti që masa e kundërshtuar është në formën e një vendimi dhe për këtë arsye, parimisht ai mund të jetë subjekt i një padie për anulim, nuk është i

mjaftueshëm për ta penguar që ai të mos ketë karakter legjislativ. Në kontekstin e një padie për dëmshpërblime, ai karakter varet nga natyra e masës në shqyrtim dhe jo nga forma e saj. ...

62. *...Duhet theksuar se, fakti që ato lidhen individualisht, nuk ka ndikim mbi karakterin e masës në kontekstin e një padie për dëmshpërblime, meqenëse ajo padi, përbën një kërkim të pavarur. ...”¹¹⁷*

Meqenëse, për aktet jo vetëgjykimore përcaktimi i paligjshmërisë së veprimit, paraqet një rëndësi të veçantë, është e nevojshme që të përcaktohet se, në çfarë rastesh konkrete, veprimi ose mosveprimi i institucioneve të Bashkimit Evropian, do të konsiderohet si i paligjshëm. Si rastet të tilla mund të përmendim; dështimin e institucionit për të mbledhur si duhet faktet e duhura, para se të marrë aktin ose vendimin, marrjen e një vendimi nga institucioni duke u bazuar në faktorë që nuk janë të rëndësishëm për çështjen, mosdhënia e të drejtave procedurale subjekteve të caktuara, para nxjerrjes së aktit, dështimi i institucionit për të mbikëqyrur organin ose agjensinë që i janë deleguar kompetencat, vlerësimi i gabuar i ligjit material, në nxjerrjen e aktit, etj.¹¹⁸

Që një akt ose vendim i institucionit të konsiderohet si i paligjshëm, nuk mjafton çdo lloj gabimi i kryer prej tyre, në vlerësimin e fakteve dhe ligjit në nxjerrjen e akteve, por, duhet që shkleja të jetë e tillë, ku si pasojë e shkeljes, personit fizik ose juridik privat, t'i jenë cënuar të drejtat ose interesat e tij të ligjshme, si dhe veprimi ose mosveprimi i institucionit të mos justifikohet nga ana ligjore. *Rastet kur jemi para një gabimi të zakonshëm, i cili, nuk mund t'i japë të drejtë personit për të kërkuar dëmshpërblimin jashtëkontraktor dhe kur jemi para një veprimi të paligjshëm, që i jep të drejtë personit për të kërkuar shpërblimin e dëmit, përcaktohen nga Gjykata, për çdo çështje, në varësi nga natyra e saj dhe shkalla e shkeljes së kryer, nga ana e institucionit të Bashkimit Evropian. Nga ana e saj, edhe Gjykata e Drejtësisë, në disa vendime ka theksuar se, për ngritjen e padisë për dëmshpërblim, nuk mjafton që të provohet një gabim i zakonshëm i institucionit në nxjerrjen e akteve, por, shkelja duhet të jetë e një shkalla me të madhe, e shoqëruar, në çdo rast, me cënimin e të drejtave të individit.*

Qëndrimi i mësipërm është mbajtur nga Gjykata në disa çështje, ku, vlen të përmenden *çështjet gjyqësore 19, 20, 25, 30/69 Denise Richez-Parise e të tjerë, kundër Komisionit*, ku palët paditëse ishin zyrtarë të Bashkimit Evropian, të cilëve iu ishte dhënë informacion i pasaaktë në lidhje me pensionet e tyre. Informacioni që iu dha paditësve bazohej në interpretimin e Rregullores përkatëse, interpretim i cili, në kohën kur iu dha informacioni mendohej se ishte i saktë. Departamenti që dha informacionin, më pas arriti në përfundimin se interpretimi që i ishte bërë Rregullores, nuk ishte i saktë, por, nga ana e Departamentit, nuk u vijua më tej që të njoftoheshin, menjëherë, kërkuarit për këtë fakt.

Ky njoftim paditësve iu bë më vonë, në kohën kur paditësit kishin përfunduar procedurën për marrjen e pensionit dhe ishin në pritje të miratimit për marrjen e tij. Meqenëse, ndërmjet palëve pati mosmarrëveshje në lidhje me këtë fakt, paditësit ngritën padi, duke kërkuar shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, për humbjet që iu shkaktuan atyre.

¹¹⁷ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1999) ECR I-769, në çështjen gjyqësore *Antilean Rice Mills kundër Komisionit*.

¹¹⁸ Shih për më tepër: Craig P; De Burca G; *“E drejta e Bashkimit Evropian, Tekste, çështje gjyqësore dhe materiale”*, botuar nga Qendra e Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2013, faqe 663.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë, duke pranuar padinë e ngritur, jo për faktin se, interpretimi i gabuar i Rregullores, përbën veprim të paligjshëm, por, për faktin se, mosnjohimi në kohë i paditësve, për ndryshimin e mënyrës së interpretimit të aktit, i bën përgjegjës institucionet, në vendimin e saj, ndër të tjera, arsyeton:

“...36. Përveç ndonjë rasti të veçantë, zbatimi i një interpretimi të pasaktë, nuk përbën në vetvete një akt të paligjshëm.

37. Edhe fakti që autoritetet iu kërkojnë personave të interesuar të sigurojnë informacion nga departamentet kompetente, nuk i ngarkon domosdoshmërisht ato autoritete me detyrimin për të garantuar saktësinë e informacionit të dhënë, ndaj dhe nuk i bën ato përgjegjës për ndonjë dëmtim që mund të jetë i shkaktuar nga informacioni i pasaktë.

38. Megjithatë, ndërkohë që, mund të jetë e mundur të vësh në dyshim ekzistencën e një akti të gabuar, në lidhje me dhënien e një informacioni të pasaktë, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për vonesën e departamentit, në korrigjimin e informacionit.

39. Megjithëse një korrigjim i tillë ishte i mundur që në fillim të prillit 1968, ai u vonua pa ndonjë justifikim deri në fund të vitit 1968. ...

41. Një korrigjim i bërë menjëherë, para ose pas 16 prillit të vitit 1968, pra, para periudhës kur personat e interesuar duhej të merrnin vendimin e tyre, sigurisht do t'i kishte dhënë mundësi palës së paditur, ta shmangte të gjithë përgjegjësinë për pasojat e informacionit të gabuar. Mosbërja e një korrigjimi të tillë, nga ana tjetër, është një çështje me karakter të tillë që i bën përgjegjës Komunitetet. ...”¹¹⁹

Një nga çështjet më të rëndësishme që shtrohet në rastin e përgjegjësisë jashtëkontraktore të institucioneve të Bashkimit Evropian, përballë personave fizikë ose juridikë privat, është çështja nëse institucionet e Bashkimit mbajnë përgjegjësi kur ato shkaktjnë dëm në rastet e nxjerrjes së akteve të ligjshme. Në lidhje me këtë çështje, duhet thënë se, parimisht, institucionet e Bashkimit Evropian, mbajnë përgjegjësi edhe për aktet e tyre ligjshme, në qoftë se, me anë të tyre iu shkaktohet një dëm personave fizikë ose juridikë privat. Por, nga ana tjetër, kushtet e përgjegjësisë së institucioneve të Bashkimit, për shkaktimin e dëmit nga një akt ligjshëm, janë shumë të vështira për t'u përmbushur, nga personat fizikë ose juridikë privat. Që Bashkimi Evropian dhe institucionet e tij, të mbajnë përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga një akt i ligjshëm, duhet që të provohet se ekzistojnë, në të njëjtën kohë, përveç kushteve të përgjithshme për përgjegjësinë për shkaktimin e dëmit, edhe këto kushte specifike:

a) dëmi i shkaktuar cënon një numër të caktuar subjektesh ekonomike, në një mënyrë të pabarabartë, në krahasim me të tjerët, pra të jetë dëm i jashtëzakonshëm;

b) dëmi i shkaktuar i tejkalon rreziqet e zakonshme ekonomike në sektorin ekonomik përkatës, pra, të jetë dëm i veçantë dhe

c) akti legjislativ i miratuar që ka shkatëruar dëmin, të mos ketë ardhur si pasojë e mbrojtjes së një interesi të përgjithshëm ekonomik.

Kushtet e mësipërme specifike, janë argumentuar edhe nga Gjykata e Shkallës së Parë sot, Gjykata e Përgjithshme, në çështjen gjyqësore T- 184/95 *Dorch Consult kundër Këshillit*, e cila ishte një çështje që kishte të bënte me Luftën e Gjirit Persik. Bashkimi Evropian, në zbatim të një Rezolute të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombëve të Bashkuara, miratoi një Rregullore që ndalonte tregtinë me Irakun. Qeveria irakiane u kundërpërgjigj me një ligj, me anë të të cilit ngrinin të gjitha

¹¹⁹ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1970) ECR 325, në çështjet gjyqësore 19, 20, 25, 30/69 *Denise Richez-Parise* e të tjerë, kundër Komisionit.

pasuritë dhe të drejtat e kompanive që bënin biznes në Irak, kur këto kompani e kishin qendrën në vendet që kishin vendosur embargon. Pala paditëse, ishte një nga këto kompani dhe me padinë e saj pretendonte dëshmpërblimin jashtëkontraktor ndaj Bashkimit Evropian edhe pse ky i fundit kishte vepruar mbi bazën e një akti legjislativ.

Gjykata e Shkallës së Parë, duke e rrëzuar padinë e ngritur, në vendimin e saj, ndër të tjera arsyetonte:

“80. Nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë është e qartë se në rastin e parimit të përgjegjësisë së Komunitetit për një akt të ligjshëm, që njihet nga e drejta e Komunitetit, një përgjegjësi e tillë mund të mbahet, vetëm nëse dëmi i pretenduar, që mendohet se përbën një “dëm që ekziston ende”, që çënon numër të caktuar operatorësh ekonomik, në një mënyrë të pabarabartë në krahasim me të tjerët (dëm i jashtëzakonshëm), që i tejkalon rreziqet e zakonshme ekonomike në sektorin në fjalë (dëm i veçantë), pa e justifikuar me një interes të përgjithshëm ekonomik masën legislative, që u bë shkak i dëmit të pretenduar.

81. Në lidhje me karakterin e jashtëzakonshëm të dëmit të pretenduar, nuk janë cënuar vetëm pretendimet e palës kërkuese, por edhe ato të të gjitha sipërmarrjeve të Komunitetit që operojnë në Irak ...

83. ...Dihet se Iraku, vlerësohej prej kohësh si “një vend me rrezik të madh”. Në ato rrethana, rreziqet ekonomike dhe tregtare që buronin nga përfshirja e mundshme e Irakut në konflikte të reja dhe pezullimi i pagesave të borgjeve prej tij, ishin rreziqe të parashikueshme, të natyrshme për çdo furnizim shërbimesh në Irak. ...

86. Nga kjo rrjedh se rreziqet që shoqëronin sigurimin e shërbimeve nga pala kërkuese në Irak, ishin pjesë e rreziqeve të natyrshme në sektorin e përmendur. ...”¹²⁰
Dëmi jashtëkontraktor ndaj personit fizik ose juridik mund të ndodhë që të shkatohet bashkarisht, në të njëjtën kohë, si nga institucionet e Bashkimit Evropian dhe nga autoritetet e kombëtare të Shteteve Anëtare. Në këtë rast lindin pyetjet: A mund të ngrejë padi personi privat për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor të shkaktuar në të njëjtën kohë nga institucionet e Bashkimit Evropian dhe nga Shtetet Anëtare? Nëse personi mund të ngrejë një padi të tillë, në cilin organ gjyqësor do ta paraqesë padinë, para Gjykatave të Bashkimit Evropian, apo para Gjykatave kombëtare të Shteteve Anëtare?

Në lidhje me pyetjen e parë të shtruar mendoj se, personi fizik ose juridik privat mund të ngrejë padi për kërkimin e dëmit jashtëkontraktor, kur ky dëm është shkaktuar bashkarisht si nga Bashkimi Evropian ashtu dhe nga autoritet e brendshme të Shteteve Anëtare. Për ngritjen e padisë në këtë rast, personi duhet të provojë përveç kushteve të përgjithshme të përgjegjësisë për shkaktimin e dëmit, edhe faktin se, *dëmi ka ardhur si pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të përbashkëta të institucioneve të Bashkimit dhe të autoriteteve kombëtare të Shteteve Anëtare*. Shkaqet e ngritjes së padisë nga personi fizik ose juridik privat mund të përmbledhen në dy raste:

Rasti i parë, kur Bashkimi Evropian nuk ka marrë masat e duhura për të penguar shkeljen e të drejtës së Bashkimit nga ana e autoriteteve kombëtare të Shteteve Anëtare. Siç do ta shikojmë në Kreun tjetër, një nga detyrat që ka Bashkimi Evropian është që të mbrojë të drejtën komunitare nga shkeljet që mund t'i bëjnë asaj, autoritetet kombëtare të Shteteve Anëtare. Në një rast të tillë, Bashkimi Evropian ka

¹²⁰ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë (1998) ECR II-667, në çështjet gjyqësore *Dorch Consult kundër Këshillit*.

të drejtë që të ngrejë padi kundër Shtetit Anëtar që ka shkelur të drejtën e Bashkimit, në bazë të nenit 258 të Traktatit të Bashkimit Evropian.

Që të konsiderohet se dëmi ka ardhur si pasojë e veprimit ose mosveprimit të përbashkët të Bashkimit dhe autoriteteve kombëtare të Shteteve Anëtare, zakonisht, nuk mjafton vetëm mosveprimi i institucioneve të Bashkimit, por për ngritjen e padisë kërkohet edhe që institucionet e Bashkimit, të kenë marrë masa që miratojnë ose konfirmojë veprimin e kryera nga autoritetet kombëtare, qofshin këto edhe masa formale.

Një gjë e tillë është konfirmuar edhe nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në *çështjet gjyqësore 5, 7, 13-24/1966 Kampfmejer kundër Komisionit*, çështje e cila lindi për shkak të krijimit të një tregu të përbashkët evropian për drithërat. Me datë 1 tetor 1963, Bordi Gjerman i Ndërhyrjes, nxori një njoftim sipas të cilit taksa për imortin e drithërave, brenda vendeve të Komunitetit Evropian ishte zero. Në të njëjtën ditë, paditësit kërkuan licensa importi për importimin e mistrit nga Franca, me taksën që ishte bërë zero, që nga 1 janari i vitit 1964. Disa nga palët paditëse, faktikisht kishin arritur që të blinin misër nga Franca. Qeveria Gjermane, në të njëjtën datë, pra, me 1 tetor 1963, i pezulloi licensat e importit me tarifën zero për produktet e drithërave. Sipas nenin 22 të Rregullores, Qeveria Gjermane mund t'i refuzonte këto kërkesa, vetëm nëse ekzistonte ndonjë kërcënim me probleme serioze për tregun e brendshëm gjerman. Një vendimi i tillë i qeverisë gjermane, duhej konfirmuar nga Komisioni dhe ky i fundit autorizoi me 3 tetor 1963, që masa e pezullimit të marrë nga Qeveria Gjermane, të mbetej në fuqi, deri më 4 tetor. Vendimi i mësipërm i Komisionit u anulua nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë. Pas këtij vendimi, paditësit ngritën padi me objekt dëmshpërblimin jashtëkontraktor kundër Komisionit. Disa nga palët paditëse kishin paguar taksat e caktuara nga autoritetet gjermane dhe po e importonin misrin me ato kushte. Disa nga palët e tjera, i kishin hequr dorë nga kontratat e tyre për të blerë misër, sepse Qeveria Gjermane kishte refuzuar që të jepte kicensa me tarifën zero.

Në lidhje me këtë çështje, Gjykata e Drejtësisë, në vendimin e saj, ndër të tjera, arsyeton:

“...Megjithatë, përse i përket ndonjë dëmi të pësuar nga palët kërkuese, që u përkasinë kategorisë së parë dhe të dytë, që u përmendën më sipër, palët kërkuese e kanë informuar Gjykatën e Drejtësisë se dëmi i pretenduar është subjekt i dy padive për dëme, një ndaj Republikës Federale të Gjermanisë, para një gjykate gjermane, ndërsa tjetra kundër Komunitetit para Gjykatës së Drejtësisë. Prandaj është e nevojshme të shmanget që palët kërkuese të mos kompensohen në mënyrë të pamjaftueshme apo të tepruar për të njëjtin dëm, nga vlerësimet e ndryshme të dy gjykatave të ndryshme, që zbatojnë norma të ndryshme ligjore.

Përpara caktimit të dëmit, për të cilin Komuniteti duhet të konsiderohet përgjegjës, është e nevojshme që gjykatës kombëtare t'i jepet mundësia për të dhënë gjykimin mbi përgjegjësinë që ka Republika Federale e Gjermanisë. Për këtë shkak, vendimi final nuk mund të jepet para se palët kërkuese të kenë paraqitur vendimin e gjykatës kombëtare për këtë çështje, i cili mund të jetë dhënë, pavarësisht nga provat që iu kërkohen palëve kërkuese në kategorinë e parë, për faktin se ato i kanë shfrytëzuar të gjitha metodat e mundshme të kompesimit me shumat e paguara gabimisht me anë të taksës.

Për më tepër, nëse vendosej një kompensimi i tillë i mundshëm, ky fakt mund të ketë si pasojë llogaritjen e dëmeve që lidhen me kategorinë e dytë. Megjithatë,

*natyra vendimtare e provave të kërkuara nuk i pengon palët kërkuese të sjellin prova të tjera, që ndërkohë i kanë paraqitur më parë. ...”.*¹²¹

Rasti i dytë i paraqitjes së padisë nga personi fizik ose juridik privat për kërkimin e dëmit jashtëkontraktor, kur ky dëm është shkaktuar bashkarisht si nga Bashkimi Evropian ashtu dhe nga autoritet e brendshme të Shteteve Anëtare, është kur dëmi është shkaktuar për shkak se Shteti Anëtar ka zbatuar legjislacionin e paligjshëm të Bashkimit Evropian. Në bazë të Traktateve Kushtetuese, Shtetet Anëtare janë të detyruara që të zbatojnë legjislacionin e Bashkimit, i cili, ka përparësi dhe prevalon (mbizotëron) mbi legjislacionin e brendshëm të Shteteve Anëtare. Po ashtu, një Shtet Anëtar, thjeshtë, është i detyruar që të zbatojë legjislacionin e Bashkimit dhe nuk ka të drejtë që të vlerësojë ose të interpretojë, nëse ky legjislacion është i ligjshëm ose jo. Në qoftë se, si rezultat i zbatimit të legjislacionit të Bashkimit Evropian, i cili, rezulton të jetë u paligjshëm, dhe që u jepet Shteteve Anëtare, zakonisht në formën e Direktivave, i shkaktohet një dëm personit fizik ose juridik privat, nga autoritetet kombëtare, atëherë jemi para rasteve të përgjegjësisë së përbashkët të Bashkimit dhe Shteteve Anëtare.

Rastet më të shpeshta të shkaktimit të dëmit, nga zbatimi prej autoriteve të Shteteve Anëtare të legjislacionin të paligjshëm komunitar, kanë të bëjnë me Politikën e Përbashkët Bujqësore. Në këtë fushë, Direktivat e Bashkimit Evropian, zbatohen me anë të masave të posaçme që marrin autoritetet kombëtare të Shteteve Anëtare. Në rastet të tilla, mund të ndodhë që, si pasojë e një vendimi të marrë nga Bordet e Brendshme Bujqësore të Shteteve Anëtare, në zbatim të një Direktive të Bashkimit Evropian, e cila rezulton e paligjshme, t’i shkaktohet një dëm i caktuar personave fizikë ose juridikë privat.¹²²

*Në lidhje me pyetjen e dytë të shtruar për zgjidhje; para cilës gjykatë duhet të ngrihet padia për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, në rastin e përgjegjësisë së përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Shteteve Anëtare, përgjigja është se, në parim, kjo padia, duhet të ngrihet para Gjykatave të Bashkimit Evropian. Kjo për faktin se, nga pikëpamja procedurale, nuk është e mundur që përgjegjësia jashtëkontraktore e Bashkimit Evropian të vendoset nga gjykatat kombëtare të Shteteve Anëtare. Po ashtu, një fakt i tillë, rezulton edhe nga neni 268 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, i cili i njeh të drejtë Gjykatës së Drejtësisë për të shqyrtuar dhe vendosur, në lidhje me përgjegjësinë jashtëkontraktore të institucioneve të Bashkimit dhe për më tepër një gjë e tillë rezulton edhe nga neni 274 i Traktatit, i cili përcakton se, Gjykata e Drejtësisë ka kompetencë ekskluzive për të vendosur për përgjegjësinë jashtëkontraktore të Bashkimit Evropian dhe institucioneve të tij.*¹²³

Por, pavarësisht nga ky rregull i përgjithshëm, praktika gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë, siç rezulton edhe nga vendimi i kësaj Gjykate, në çështjet gjyqësore 5, 7, 13-24/1966 Kampfnejer kundër Komisionit, ka konfirmuar se, duke qenë se jemi para përgjegjësisë së përbashkët, padia duhet të ngrihet fillimisht në gjykatat kombëtare dhe më pas në Gjykatat e Bashkimit Evropian. Pavarësisht se, një zgjidhje e tillë e

¹²¹ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1967) ECR 245, në çështjet gjyqësore 5, 7, 13-24/1966 Kampfnejer kundër Komisionit.

¹²² Shih për më tepër: Craig P; De Burca G; “E drejta e Bashkimit Evropian, Tekste, çështje gjyqësore dhe materiale”, botuar nga Qendra e Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2013, faqe 672.

¹²³ Neni 274 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Mosmarrëveshjet në të cilat Bashkimi është një prej palëve nuk mund të përjashtohen, për shkak të kësaj, nga juridiksioni i gjykatave të Shteteve Anëtare, me përjashtim të rasteve kur juridiksionin për këto mosmarrëveshje Traktatet ia kanë dhënë Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian”.

praktikës gjyqësore, mund të jetë e kritikueshme, pasi sipas kësaj zgjidhjeje rezulton që Bashkimi Evropian të përgjigjet, vetëm për pjesën e mbetur të përgjegjësisë për të cilën nuk janë përgjigjur Shtetet Anëtare, argumentet e dhëna nga Gjykata e Drejtësisë, sipas të cilëve, kjo procedurë veprimi është më e drejtë, sepse shmang si dëmshpërblimin e pamjaftueshëm të palës private, ashtu edhe dëmshpërblimin e tepërt të saj, janë argumente të sakta dhe që qëndrojnë në këtë rast.

Duke iu referuar paragrafit të dytë të nenit 340 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, rezulton se, Bashkimi Evropian ka përgjegjësi jashtëkontraktore, jo vetëm për dëmet e shkaktuara personave fizikë ose juridikë privatë, nga institucionet, organet, agjensitë dhe zyrat e Bashkimit, por edhe për dëmet e shkaktuara nga nëpunësit e Bashkimit. Që Bashkimi të mbajë përgjegjësi për dëmet e shkaktuara nga nëpunësit e tij, është e domosdoshme që të provohen të gjitha kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë që rrjedh nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor, si dhe të provohet edhe një kusht tjetër specifik, që dëmi të jetë shkaktuar nga nëpunësi civil gjatë kryerjes së detyrës së tij. Në këtë rast shtrohet çështja, se çfarë duhet të kuptojmë me akte që kryen gjatë detyrës dhe për shkak të detyrës?

Për përcaktimin e faktit, nëse, akti është kryer gjatë dhe për shkak të detyrës, Gjykatës i duhet të sqarojë një sërë faktesh si; funksioni ose detyra që kryen nëpunësi, lloji konkret i punës ose të detyrës së nëpunësit, nëse akti është kryer gjatë kohës së punës apo gjatë kohës së pushimit, nëse, nëpunësi ka kryer aktin brenda kompetencave dhe funksioneve të tij, apo ka tejkaluar detyrat e funksionit të tij dhe një sërë faktesh dhe rrethanash, të cilat në varësi të çështjes konkrete, kanë rëndësi për përcaktimin e përgjegjësisë së nëpunësit të Bashkimit Evropian.

Çështja e përgjegjësisë së Bashkimit Evropian për dëmet e shkaktuar personave të tretë nga nëpunësit e tij civil, është trajtuar edhe nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë në disa vendime të saj. Nga këto vendime rezulton se, përgjegjësia e institucioneve të Bashkimit për nëpunësit e tij, është më e vogël se, përgjegjësia kanë Shtetet Anëtare për dëmet që nëpunësit e tyre iu shkaktojnë të tretëve. Në rastet kur, Bashkimi Evropian nuk konsiderohet si përgjegjës, atëherë padia mund të ngrihet kundër nëpunësit si person privat, në gjykatën kombëtare të shtetit të nëpunësit dhe gjykohet sipas të drejtës kombëtare.

Por, një gjë e tillë nuk e zgjidh plotësisht çështjen, sepse, nëpunësit civil, sipas nenit 12 të Protokollit mbi Privilegjet dhe Imunitetin e Komuniteteve Evropiane, t janë të imunizuar nga procedurat ligjore në lidhje me aktet që kryhen prej tyre për shkak të funksionit të tyre. Në këto kushte, çështja e përgjegjësisë së Bashkimit Evropian për aktet e nëpunësve civil të tij, të kryera gjatë dhe për shkak të detyrës së tyre, është një çështje e një e gjetjes së një ekulibri të brishtë, ndërmjet interesave të Bashkimit Evropian dhe interesave të personave fizikë ose juridikë privatë, ku, në këtë konflikt interesash, duhet pranuar se Bashkimi në shumicën e rasteve ka dalë fitues.

Një fakt i tillë konfirmohet edhe nga *çështja gjyqësore 9/69 Sajag kundër Komisionit*, ku Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në vendimin e saj, vendosi mospranimin e padisë së ngritur me arsyetimin se, akti i nëpunësit civil nuk kishte të bënte me detyrën e tij. Kjo çështje i referohet një inxhinieri me mbiemrin Sajag, nga ka marrë edhe emrin çështja, i cili ishte i punësuar në Euroatom. Sajag ishte udhëzuar që të merrte me vete edhe një person tjetër me mbiemrin Leduc, i cili ishte përfaqësues i një firme private për një vizitë, në disa instalime. Sajag e çoi Leduc-in me makinën e vet në ndërmarrje dhe siguroi një urdhër shërbimi që i jepte mundësi që

të kërkonte shpenzimet e udhëtimit nga Bashkimi Evropian. Gjatë udhëtimit ndodh një aksident, si pasojë e të cilit dëmtohet shoqëruesi i Sajag, Leduc-i dhe ky i fundit ngren padi në një gjykatë belge, kunder Sajag për të kërkuar shpërblimin e dëmeve të pësuar. Nga ana e gjykatës belge u argumentua se Sajag po i jepte makinës në zbatim të detyrave të tij dhe për këtë arsye padia duhej ngritur kundër Bashkimit Evropian, në zbatim të nenit 188(2) të Traktatit të Euroatomit, aktualisht, neni 340, paragrafi i dytë i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian.

Në lidhje me këtë çështje, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, ndër të tjera, arsyetoi se:

“...Duke iu referuar njëkohësisht dëmit të shkaktuar nga institucionet dhe atij të shkaktuar nga nëpunësit e Komunitetit, në nenin 188 vihet në dukjes se Komuniteti është përgjegjës, vetëm për ato akte të nëpunësve të tij, që për shkak të një lidhje të brendshme dhe të drejtpërdrejtë, janë një zgjatim i nevojshëm i detyrave që iu besohen institucioneve.

Nën dritën e karakterit special të këtij sistemi ligjor, nuk do të ishte e ligjshme ta shtrije atë në kategori aktesh të tjera, përveç atyre që iu referuam më sipër.

Përdorimi i makinës së tij private nga një nëpunës për transport, gjatë kryerjes së detyrave të tij, nuk i përmbush kushtet e parashtruara më sipër.

Referimi tek makina private e një nëpunësi me një urdhër shërbimi, nuk e çon drejtimin e një mjeti të tillë brenda kryerjes së detyrave të tij, por ajo thjesht synon pagimin e shpezimeve të udhëtimit, që bëhen me këtë mjet transporti, në përputhje me standartet e përcaktuara për këtë qëllim. Vetëm në raste të rralla të një force madhore apo në rrethana të veçanta me rëndësi të madhe, kur pa përdorimin e mjeteve private të nëpunësit për transport, Komuniteti nuk do të ishte në gjendje që të kryente detyrat që i ishin ngarkuar, një përdorim i tillë mund të konsiderohej se ishte pjesë e kryerjes së detyrave të tij, brenda kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 188 të Traktatit të Euroatomit të Komunitetit Evropian. ...”¹²⁴

Personi fizik ose juridik privat, të cilit i është shkaktuar dëmi nga institucionet e Bashkimit Evropian ose nëpunësit e tij, duhet që të tregojë kujdes në kufizimin e sasisë së dëmit, si dhe të marrë masa për pakësimin e tij, kur kjo është e mundur, sepse, në të kundërt, do të jemi para *përgjegjësisë së përzier, ku si përgjegjës për shkaktimin e dëmit konsiderohen si pala që ka shkaktuar dëmin, ashtu edhe pala e dëmtuar*. Asnjë qëndrim neglizhent i palës së dëmtuar në këtë drejtim nuk mund të justifikohet dhe kur vertetohet se pala e dëmtuar ka qenë e pakujdesshme në uljen e sasisë së dëmit të shkaktuar ose në pakësimin e saj, Gjykata do të vendosë shpërndarjen e përgjegjësisë ndërmjet shkaktuesit të dëmit dhe palës së dëmtuar.

Kështu, në një rast të praktikës gjyqësore, që ka të bëjë me çështjen Adamas kundër Komisionit, Gjykata Evropiane e Drejtësisë vlerësoi se, pala e dëmtuar Adams kishte përgjegjësi të barabartë me palën shkaktuese të dëmit, Komisionin, për dëmin që iu shkaktua palës së dëmtuar.¹²⁵ Kjo çështje kishte të bënte me disa dokumente konfidenciale të kompanisë ku ai punonte, që pala e dëmtuar Adams, i kishte dorëzuar Komisionit, me anë të të cilave u zbulua se, kompania kishte shkelur nenin 82 të Traktatit të Komunitetit Evropian, që kishte të bënte me konkurrencën e pandershme. Komisioni nga ana e tij, nuk e respektoi konfidencialitetin e dokumenteve dhe ia

¹²⁴ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1969) ECR 329, në çështjen gjyqësore Sajag kundër Komisionit.

¹²⁵ Shih për më tepër: Celami, E; “Gjykata Evropiane e Drejtësisë. Juridiksioni. Efekti i vendimeve të saj në gjykatat e Shteteve Anëtare. Raporti i saj me Gj.E.D.Nj-në”, punim i dorëzuar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2005-2006, faqe 77.

dorëzoi ato kompanisë që ishte Hoffman la Roche, në Zvicër. Kompania me anë të këtyre dokumenteve e zbuloi se, kush i kishte nxjerrë ato. Pala e dëmtuar Adams, ndërkohë, ishte larguar në Itali dhe kishte hapur biznesin e tij, por, kur u kthye në Zvicër, u arrestua dhe u dënua për spiunazh ekonomik. Si rezultat i dënimit të Adams, gruaja e tij vrau veten dhe ai humbi biznesin në Itali. Gjykata Evropiane e Drejtësisë vlerësoi se Adams kishte përgjegjësi edhe vetë, sepse nuk i kishte treguar Komisionit se, dokumentet mund të zbulonin identitetin e tij, si dhe për faktin se ai u kthye në Zvicër, ndërkohë që mund të qëndronte i sigurtë në Itali.

Afati i ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor nga ana e personave fizikë ose juridikë, është 5 vjet, duke filluar nga data e ngjarjes ose faktit që është bërë si shkak për ngritjen e padisë. Ky afat 5 vjeçar për ngritjen e padisë, është parashikuar në Statutin e Gjykatës së Drejtësisë, sipas të cilit, nuk mund të ngrihet padi kundër Bashkimit Evropian, që kanë të bëjnë me përgjegjësinë jashtëkontraktore të tij, nëse kanë kaluar 5 vjet nga dita e ndodhjes së ngjarjes për të cilën duhet të ngrihet padia. Statuti, po ashtu, ka parashikuar që afati 5 vjeçar i parashkrimit të ngritjes së padië, ndërpritet, nëse pala paditëse ka paraqitur padi para Gjykatës së Drejtësisë, ose para fillimit të procesit, ka paraqitur kërkesë para një institucioni tjetër të Bashkimit Evropian. Pas ndërprerjes së parashkrimit, gjykimi duhet të fillojë brenda dy muajsh, duke filluar nga data e ndërprerjes, në të kundërt, pala paditëse, humbet të drejtën e ngritjes së padisë.¹²⁶

Pavarsisht se, nga ana e Statutit parashikohet që afati 5 vjeçar i ngritjes së padisë me objekt shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor, fillon nga data e ndodhjes së ngjarjes, Gjykata e Drejtësisë, në vendimet e saj, ka interpretuar se, ky afat fillon nga data e marrjes dijeni të personit për ngjarjen ose faktin, ndaj të cilit do të ngrihet padia. Kjo sepse, mund të ndodhë që, ngjarja ose fakti të ketë ndodhur para shumë vitesh, por, personi ta ketë patur të pamundur të vihet në dijeni të tij dhe për këtë shkak, në funksion të mbrojtjes së të drejtave të ligjshme të individit, nga ana e Gjykatës është interpretuar që, ky afat duhet të fillojë nga dita personi ka marrë dijeni ose kishte mundësinë reale që të merrte dijeni. Po ashtu, mund të ndodhë që personi ta humbasë afatin 5 vjeçar, për shkaqe të arsyeshme dhe objektive. Në rastet të tilla, personi ka të drejtë që të rivendoset në afat, me qëllim që të ngrejë padinë me objekt shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor kundër Bashkimit Evropian, të drejtë që ia jep neni 45 i Statutit, sipas të cilit asnjë e drejtë e individit nuk mund të çenohet, me pretendimin e kalimit të afatit, në rast se, pala arrin që të provojë se, e ka humbur afatin për shkaqe objektive ose të forcës madhore.

¹²⁶ Paragrafi i parë i nenit 46 të Statutit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, parashikon: *“Ndalohet procedimi kundër Bashkimit në çështje që lindin nga përgjegjësia jashtëkontraktore pas një periudhë pesë vjeçare që nga ndodhja e ngjarjes që ka çuar drejt saj. Periudha e parashkrimit ndërpritet nëse fillon procesi para Gjykatës së Drejtësisë ose nëse para fillimit të procesit pala e dëmtuar ka paraqitur kërkesë tek institucioni përkatës i Bashkimit. Në rastin e fundit, procesi duhet të fillojë brenda një periudhe dy mujore të parashikuar në nenin 263 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian; dispozitat e nenit 265 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian zbatohen sipas rastit”.*

KAPITULLI I KATËRT

GJYKATA EVROPIANE E DREJTËSISË SI ROJE E TRAKTATEVE

4.1.Procedurat ligjore të ndjekura nga Komisioni Evropian, në rastet e mospërbushjes së detyrimeve nga një Shtet Anëtar.

Traktatet Kushtetuese të Bashkimit Evropian kanë krijuar një organizatë ndërkombëtare të veçantë ose sui generis, e cila përbëhet nga “një numër Shtetesh Anëtare të pavarura”, që veprojnë, në të njëjtën kohë, si subjekte të së drejtës, me një funksion të dyfishtë; edhe brenda Bashkimit Evropian, duke iu nënshtuar normave ligjore të të Drejtës së Bashkimit Evropian, edhe jashtë Bashkimit, duke iu nënshtuar normave të së drejtës ndërkombëtare, në përgjithësi. Shtetet Anëtare të Bashkimit, me krijimin e Bashkimit Evropian si organizatë ndërkombëtare, po ashtu, kanë fituar të drejta dhe kanë marrë përsipër detyrime të caktuara, të cilat janë përcaktuar në Traktatet Kushtetuese, si legjislacion primar, por edhe në aktet dhe normat e nxjerra nga institucionet Bashkimit Evropian, si legjislacion sekondar, si dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës të përbashkëta, në ligjet e të gjitha Shteteve Anëtare. Meqenëse, me krijimin e Bashkimit Evropian, Shtetet Anëtare, me vullnetin e tyre të lirë, kanë marrë përsipër të drejta dhe detyrime të caktuara, ato kanë edhe detyrimin që t’i përmbushin ato.

Në qoftë se, një Shtet Anëtar, nuk përmbush, pa shkak ligjor, një ose disa detyrime që ai ka marrë përsipër, atëherë Traktatet Kushtetuese i kanë dhënë të drejtë Komisionit Evropian që të fillojë procedurat ligjore, me qëllim që të detyrojë këtë Shtet, që ta përshtasë sjelljen e tij me të drejtën e Bashkimit Evropian, duke përmbushur detyrimet, në përputhje me këtë të drejtë.¹²⁷

Pyetja që mund të shtrohet në këtë rast është: *Pse Traktatet Kushtetuese të drejtën për të nisur procedurat ligjore për përmbushjen e detyrimeve nga Shtetet Anëtare ia kanë besuar Komisionit dhe jo një institucioni tjetër të Bashkimit Evropian?* Në lidhje me këtë pyetje, përgjigja është se, Traktatet ia kanë besuar këtë detyrë Komisionit, duke u nisur nga pushtetet dhe kompetencat që ka ky organ në kuadër të institucioneve të Bashkimit. Sipas Traktateve Komisioni është “zemra” e Bashkimit Evropian, ai është institucioni që nxit dhe promovon interesin e përgjithshëm të Bashkimit, duke marrë çdo veprim që është i nevojshëm për këtë qëllim. Komisioni, ka si mision që të sigurojë zbatimin e Traktateve dhe për këtë arsye ka të drejtë që të marrë çdo masë që duhet për të realizuar këtë mision. *Pikërisht, tek kjo kompetencë që ka Komisioni për të siguruar zbatimin e Traktateve dhe të akteve të miratuara nga institucionet e Bashkimit Evropian, janë bazuar*

¹²⁷ Neni 258 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Nëse Komisioni është i mendimit se një Shtet Anëtar, nuk ka përmbushur një detyrim që rrejdhet nga Traktatet, ai nxjerr një opinion të arsyetuar për çështjen në fjalë pasi i ka dhënë Shtetit në fjalë mundësinë të paraqesë komentet e veta.

Nëse Shteti në fjalë nuk e zbaton opinionin brenda periudhës së vendosur nga Komisioni, ky i fundit mund ta ngrejë çështjen para Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian”.

Traktatet Kushtetuese që i kanë njohur të drejtën Komisionit, që të fillojë procedurat ligjore, në rast të mospërbushjes së detyrimeve nga ana e Shteteve Anëtare.

Përveç kompetencës së sigurimit të zbatimit të Traktatave Kushtetuese dhe të akteve të tjera të nxjerra nga institucionet e Bashkimit, Komisioni ka si detyrë mbikqyrë zbatimin e të drejtës së Bashkimit Evropian, nën kontrollin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. *Kompetenca që ka Komisioni që të mbikqyrë zbatimin e së drejtës së Bashkimit, është një tjetër arsye se, pse Traktatet Kushtetuese i kanë njohur Komisionit të drejtën që të fillojë procedurat, në rast të mospërbushjes së detyrimeve nga ana e Shteteve Anëtare,* pasi kjo mospërbushje detyrimeve nga Shtetet përbën, në të njëjtën kohë, edhe cënim të së drejtës së Bashkimit. Komisioni Evropian po ashtu, zbaton buxhetin dhe administron programet e Bashkimit, siguron përfaqësimin e jashtëm të tij, me përjashtim të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, si dhe hap programet vjetore dhe shumëvjeçare të Bashkimit, me qëllim arritjen e marrëveshjeve, ndërmjet institucioneve të Bashkimit Evropian.¹²⁸

Procedura e verifikimit të mospërbushjes së detyrimeve nga ana e Shteteve Anëtare, kalon nëpër katër faza:

a) *faza fillestare, e cila është fazë e parë dhe e vetme informale dhe jo zyrtare, në të cilën bëhen përpjekje që mosmarrëveshja të zgjidhet, ndërmejt Shtetit Anëtar dhe Komisionit në mënyrë diplomatike, pa nisur procedura sipas nenit 258 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian;*

b) *faza e njoftimit zyrtar nga ana e Komisionit, për mosmëmbushjen e detyrimit nga ana e Shtetit Anëtar, me anë të një Letre Zyrtare, ose Njoftimi Zyrtar, në të cilën i njoftohen Shtetit Anëtar shkeljet konkrete që ka bërë, e cila përbën fazën e fillimit të procedurës formale, pasi zgjidhja e çështjes, në mënyrë diplomatike, ndërmjet palëve nuk është arritur.*

c) *faza e Mendimit të Arsytuar, e cila përbën edhe fazën e dytë zyrtare, në të cilën Komisioni nxjerr një Mendim të Arsytuar, ku, pasqyrohen, në mënyrë të qartë se, ku bazohet shkelja e pretenduar dhe i lihet një afat i arsyeshëm Shtetit Anëtar për të ndrequr shkeljen, gjithmonë, pasi t'i jetë lënë mundësia për t'u shprehur në lidhje me Letrën Zyrtare që përmban shkeljen e pretenduar.*

ç) *faza e fundit zyrtare, e cila është faza e ngritjes së padisë nga ana e Komisionit para Gjykatës së Drejtësisë, në rastet kur Shteti Anëtar, nuk ndreq shkeljet e konstatuar nga Komisioni, brenda afatit të caktuar.*¹²⁹

Secila prej këtyre fazave do të trajtohet, në mënyrë të përmbledhur, nga ana ime më poshtë, por, ajo që duhet thënë që në fillim, është fakti që, jo çdo mosmarrëveshje ose mospërbushje e detyrimeve nga një Shtet Anëtar kalon, detyrimisht, nëpër këto katër faza, përkundrazi, e kundërta është e vertetë.

Një pjesë shumë e madhe e mosmarrëveshjeve që kanë të bëjnë me mospërbushjen e detyrimeve, nga ana e Shteteve Anëtare, zgjidhen para se çështja

¹²⁸ Pika 1 e nenit 17 të Traktatit të Bashkimit Evropian parashikon:

“Komisioni promovon interesin e përgjithshëm të Bashkimit dhe, për këtë qëllim, merr nismat e duhura. Ai siguron zbatimin e Traktateve dhe të masave të miratuara nga institucionet në zbatim të tyre. Ai mbikqyr zbatimin e së drejtës së Bashkimit nën kontrollin e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Ai zbaton buxhetin dhe administron programet. Ai ushtron funksione bashkërenduese, ekzekutuese dhe administruuese, që parashikohen në Traktatet. Me përjashtim të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurimit dhe të rasteve të tjera të parashikuara nga Traktatet, ai siguron përfaqësimin e jashtëm të Bashkimit. Ai hap programin vjetor dhe shumëvjeçar të Bashkimit, me qëllim arritjen e marrëveshjeve ndër-institucionale”.

¹²⁹ Shih për më tepër: Craig P; De Burca G; *“E drejta e Bashkimit Evropian, Tekste, çështje gjyqësore dhe materiale”*, botuar nga Qendra e Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2013, faqe 525.

të kalojë në fazën finale, atë të ngritjes së padisë nga Komisioni para Gjykatës së Drejtësisë. Kështu në Raportin e vitit 2012-2015 të Komisionit, rezultonte se, rreth 68 për qind e ankesave ishin mbyllur në fazën informale, para se të fillonte faza e parë zyrtare e dërgimit të Letrës ose Njoftimit Zyrtar nga ana e Komisionit, 84 përqind e procedurave të bazuara në një ankesë, ishin mbyllur para nxjerrjes së Mendimit të Arsytuar nga ana e Komisionit dhe 94 për qind e procedurave ishin mbyllur para se të merrej vendimi përfundimtar nga Gjykata e Drejtësisë, në lidhje me mosmarrëveshjen, ndërmjet Komisionit dhe Shtetit Anëtar.¹³⁰

Përpara se të trajtoj, secilën prej këtyre fazave nëpër të cilat kalon një çështje, kur një Shtet Anëtar nuk përmbush detyrimet e tij, të vendosura nga Traktatet Kushtetuese, e çmoj me vend të trajtoj, *të drejtën ose lirinë që ka Komisioni për të filluar procedurat, si dhe rolin që kanë individët ose qytetarët e Bashkimit Evropian, në nisjen e procedurave ligjore nga ana e Komisionit*, në respektimin e të drejtës së Bashkimit Evropian, në përgjithësi. Në rastet kur, një Shtet Anëtar, nuk përmbush një ose disa detyrime që burojnë nga Traktatet, si dhe rendi ligjor evropian, në përgjithësi, ose thënë ndryshe kur një Shtet Anëtar, shkel një dispozitë ligjore të rendin evropian, Traktatet Kushtetuese, i kanë dhënë të drejtë Komisionit që të nisë procedurat për konstatimin e shkeljes dhe më pas për ndreqjen ose rregullimin e shkeljes nga ana e këtij Shteti.

Kur themi se Traktatet Kushtetuese i kanë njohur të drejtën Komisionit që të fillojë procedurat ligjore, në qoftë se, një Shtet Anëtar nuk përmbush detyrimet e tij sipas të drejtës së Bashkimit Evropian, *duhet të kuptojmë se, Komisioni, ka të drejtë dhe jo detyrim që të fillojë ose jo nisjen e procedurave. Kjo do të thotë se, Komisioni ka, në çdo rast liri të plotë veprimi për të vlerësuar, në varësi të shkeljes konkrete të bërë nga Shteti Anëtar ose në varësi të mos përmbushjes së detyrimit prej tij, të fillojë ose jo procedurat ligjore kundër këtij Shteti. Traktatet Kushtetuese, i kanë njohur Komisionit kompetencën, ekskluzive, për të vlerësuar dhe vendosur, ai dhe vetëm ai, nëse, do të fillojë ose jo procedurat për një shkelje të caktuar të kryer nga një Shtet Anëtar, duke patur liri të plotë veprimi për këtë çështje.*

Megjithëse, sipas Traktateve, Komisioni ka liri të plotë veprimi për të vlerësuar nisjen apo jo të procedurave ligjore, kundër një Shteti Anëtar, që nuk ka përmbushur detyrimet sipas të drejtës së Bashkimit Evropian apo ka kryer një shkeje të kësaj të drejte, kjo liri veprimi e tij, nuk është e pakufizuar dhe për më tepër, ajo ka qenë objekt debatesh dhe kritikash të ndryshme. Duke u nisur nga fakti që, Komisioni, në bazë të Traktateve, mund të fillojë procedurën ligjore për mospërmbushje detyrimi kundër një Shteti Anëtar, qoftë me nisëm e tij, qoftë edhe mbi bazën e akimit të individëve ose qytetarëve, por edhe të personave juridik privat, në këto kushte, është shtruar për diskutim çështja se, cili është roli që kanë individët në fillimin e procedurave kundër një Shteti Anëtar, që ka kryer shkelje dhe cila është liria që ka Komisioni për të vlerësuar ankesat e këtyre individëve, që kërkojnë nisjen e procedurës kundër atij Shteti?

Në lidhje me peshën që kanë individët në fillimin e procedurës ligjore kundër një Shteti Anëtar për mospërmbushje detyrimi prej tij, Komisioni prej kohësh është shprehur se, ankesat e qytetarëve përbëjnë një burim të rëndësishëm për zbulimin e shkeljeve dhe ka sugjeruar se procedura e nenit 258 të Traktatit, kontribuon për të krijuar një Bashkim Evropian me pjesëmarrës, në të cilin qytetarët mund të luajnë

¹³⁰ Shih për më tepër: Raportin Vjetor të vitit 2012, 2015 për diskutimin e statistikave në COM (2012, 2015) 95,84 Commission Communication on Better Monitoring of the Application of Community Law.

*rolin e tyre në zbatimin e ligjit.*¹³¹ Në kuadër të rritjes së peshës së individëve për paraqitjen e ankesave për fillimin e procedurave ligjore, kundër Shtetit që ata mendojnë se ka kryer shkeljen, nga ana e Komisionit në vitin 1999, u hartua një Formular Ankese standart, për përdorim më të lehtë nga individët, si dhe u krijuan një sërë organizmash për t'iu dhënë mundësinë individëve që të sillnin ankesat e tyre, siç janë Europa Direkt, Udhëzues për Qytetarin dhe Qendrat e Biznesit Evropian.

Roli i individëve, ku përfshihen edhe personat juridikë privat, si shoqatat apo organizatat e të drejtës private, është rritur ndjeshëm me krijimin e Ombudsmen-it ose Avokatit të Popullit të Bashkimit Evropian, misioni i të cilit është, jo vetëm që të mbrojë interesat e individëve, në paraqitjen e ankesave të tyre, por edhe të kontrollojë apo të monitorojë Komisionin, nëse i ka trajtuar ankesat, në përputhje me ligjin dhe në mënyrë transparente.

Si pasojë e ndërhyrjes së Avokatit të Popullit, Komisioni ka marrë masa efikase për trajtimin, në mënyrë sa më transparente, të ankesave dhe kërkesave të paraqitura nga individët, duke hequr dorë nga praktika e tij e mëparshme e mosinformimit të ankuesve, kur çështja ishte mbyllur prej tij, si dhe filloi të përdorë më shpesh, njoftime për shtyp dhe informacionet me anë të internetit.

Po ashtu, Komisioni në kuadër të transparencës dhe ligjshmërisë së trajtimit të ankesave të individëve, në vitin 2002, pasi bëri një komunikatë për Parlamentin Evropian, për ankesat e individëve, botoi një variant të konsoliduar të normave të brendshme procedurale që rregullonin mardhëniet e tij me ankuesit. Në këto norma të brendshme procedurale, Komisioni angazhohej se do të merrte për shqyrtim çdo ankesë të paraqitur nga individët dhe se do ta trajtonte ankesën, duke marrë një vendim konkret, brenda një viti nga data e paraqitjes së saj.

Një nga problemet shqetësuese që kanë patur individët me rastin e paraqitjes së ankesave të tyre, para Komisionit për mospërbushjen e detyrimeve nga një Shtet Anëtar, ose për kryerjen e një shkelje ligjore prej tij, ka qenë fakti se, individët e kanë patur të vështirë që të siguronin dokumentet e nevojshme, në lidhje me procedurat e shkeljes të nisura nga Komisioni. Në lidhje me këtë çështje, Komisioni, përgjithësisht, ka arsyetuar që, nuk duhet të njihet e drejta e individëve që kanë paraqitur ankesë, për t'u njohur në lidhje me inspektimet dhe hetimet e bërë nga Komisioni, arsyetim i cili është mbështetur edhe nga Avokati i Popullit. Për kërkesën e individëve për t'u njohur në lidhje me procedurat e kryera nga Komisioni, për verifikimin e shkeljeve, në bazë të ankimit të tyre, është shprehur edhe Gjykata e Shkallës së Parë, sot Gjykata e Përgjithshme, në çështjen *Petrie kundër Komisionit*, ku kjo Gjykatë ka theksuar se, *individët nuk janë palët në këto procedura dhe refuzimi i bërë nga Komisioni për të parë dokumentet, në lidhje me procedurat e shkeljeve, është i bazuar*, pasi natyra e procedurave sipas nenit 258 të Traktatit, ka vetëm dy palë, Komisionin dhe Shtetin Anëtar dhe jo tre palë, ku të përfshihej edhe individ që ka bërë ankesën.¹³²

Qëndrimi i mësipërm i mbajtur nga Gjykata e Shkallës së Parë, përbënte një konfirmim të pikëpamjes që ka patur më parë Komisioni, sipas të cilit, procedura e nisur prej tij për mospërbushje detyrimi nga Shtetet Anëtare, nuk ka si qëllim që t'u japë të drejtë individëve që të nisin procedurën, por është një mjet që tregon se Shteti ndaj të cilit paraqitet ankesa, po vepron në përputhje me të drejtën e Bashkimit

¹³¹ Shih për më tepër Raportet e Monitorimit Vjetor të Komisionit në adresën elektronike: http://ec.europa.eu/community_law/eulaw/index_en.htm

¹³² Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë në çështjen gjyqësore T-191/99 *Petrie kundër Komisionit* (2001).

Evropian. Po ashtu, *Komisioni duke theksuar rolin që kanë individët në këtë proces, ka argumentuar, me forcë se, është në lirinë e tij të veprimt për të vendosur për fillimin ose jo të procedurës ndaj Shtetit*, duke e vënë theksin me shumë tek natyra dypalëshe (Komision dhe Shtet Anëtar), sesa tek natyra trepalëshe e procedurës (Komision, Shtet Anëtar dhe individ që bën ankesën), si dhe *duke përcaktuar si objekt parësor të procedurës, zbatimin e ligjit nga ana e Shteteve Anëtar dhe jo realizimin e interesave të individëve*.

Megjithatë, pavarësisht pikpamjes së Komisionit dhe qëndrimit të mbajtur nga Gjykata e Shkallës së Parë në *çështjen Petrie*, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në *çështjen Suedia dhe API, kundër Komisionit*, afërmoi qëndrimin drejt një hapje më të madhe, në kontekstin e procedurave të shkeljes nga një Shtet Anëtar. Kështu, në këtë çështje, Gjykata arsyetoi se, pala e tretë, nuk ka të drejtë të shikojë kërkesë paditë e paraqitura para Gjykatës për procedura gjyqësore dhe se ekzistonte një prezumim i përgjithshëm që, hapja e kërkesë padive të paraqitura nga një prej institucioneve, do të minonte mbrojtjen e procedurave, ndërkohë që, palët ishin në pritje të vendimit. Sipas Gjykatës, mund të lejohej njohja e një dokumenti, vetëm në qoftë se, pala që e kërkonte, sillte prova që hapja e tij, nuk do të minonte procedurën. Në këtë çështje, Gjykata e Drejtësisë, mbështeti arsyetimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, sipas të cilit dokumentet që lidhen me hetimet që kryhen nga Komisioni, në kontekstin e procedurave të shkeljes, nuk do të mbulohen nga përjashtimi për mbrojtjen e procedurave gjyqësore, pasi Gjykata e Drejtësisë kishte vendosur mbylljen e procedurave.

Gjykata e Drejtësisë, duke kundërshtuar argumentin e Komisionit sipas të cilit, Gjykata e Shkallës së Parë kishte keqinterpretuar lidhjet ndërmjet dy procedurave të parashikuara nga nenet 258 dhe 260 të Traktatit, u shpreh që, këto dy procedura, ishin qartësisht të dallueshme dhe nëse, Gjykata kishte gjetur shkelje të procedurave sipas nenit 258, nuk është e mundur që më pas të pretendohet zgjidhja me pajtim e çështjes. Për pasojë, theksonte Gjykata, nuk mund të pretendohet se, hapja e dokumenteve për akuzat e ngritura për shkelje sipas nenit 258, do të minonte hetimet që mund të çonin në procedura, sipas nenit 260 të Traktatit.¹³³

Faza e parë e procedurave ligjore të ndjekura nga Komisioni, në rast të mospërmbyshjes së një detyrimi nga një Shtet Anëtar, ose kryerjen e një shkeljeje prej tij, është faza informale. Kjo fazë njihet ndryshe edhe faza "diplomatike", ose zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes ndërmjet Komisionit dhe Shtetit Anëtar. Gjatë fazës informale çdo komunikim që zhvillohet ndërmjet palëve, është konfidencial dhe nuk është e hapur për publikun, pavarësisht, nëse procedura ligjore, ka filluar me nisëm e vetë Komisionit, apo ka nisur mbi bazën e ankimit të individëve apo peticioneve të ndryshme, dërguar Komisionit Evropian.

Në këtë fazë, e cila, në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të procedurave, mund të zgjasë, nga disa javë, në disa muaj, por që zakonisht, nuk zgjat më shumë se gjashtë muaj, Komisioni bën konsultime dhe komunikime, me përfaqësuesin e përhershëm të Shtetit Anëtar në Bashkimin Evropian, me qëllim zgjidhjen miqësore ose me pajtim të mosmarrëveshjes. Komisioni i njofton përfaqësuesit të përhershëm të Shtetit Anëtar, mospërmbyshjen konkrete të detyrimit prej tij, ose natyrën dhe llojin konkret të shkeljes dhe kërkon prej tij, që të komunikojë me autoritetet e Shtetit të tij, për përmbushjen e detyrimit ose ndreqjen e shkeljes, në mënyrë vullnetare ose

¹³³ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjet gjyqësore C-514, 528 dhe 532/07, Suedia dhe API, kundër Komisionit Evropian.

miqësore. Duke qenë se, kjo është një fazë informale dhe diplomatike, komunikimi ndërmjet Komisionit dhe Shtetit Anëtar, bëhet në mënyrë verbale ose me shkrim, si dhe me çdo formë tjetër komunikimi, si faks, email, etj.

Duhet të kemi parasysh se, *edhe pse kjo fazë është informale, ajo nuk është më pak e rëndësishme se fazat e tjera, të cilat janë faza formale dhe zyrtare*. Prandaj, si Komisioni ashtu edhe Shteti Anëtar, i kushtojnë një vëmendje të madhe komunikimit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes që në këtë fazë, duke evituar kështu qoftë shpenzimet që nevojiten për fazat formale, por, sidomos duke shmangur kostot politike dhe ekonomike që shoqëron në çdo rast, ngritja e një padie nga Komisioni, në Gjykatën e Drejtësisë, kundër një Shteti Anëtar, për shkak të mospërmbyshjes së detyrimeve prej tij. Rëndësia që ka kjo fazë në procedurat ligjore të filluara nga Komisioni, kundër një Shteti Anëtar, rezulton mjaft e qartë nga pesha ose volumi i çështjes që zgjidhen ndërmjet palëve në këtë fazë, e cila siç u citua më lart, zë një peshë rreth 68 përqind të të gjithë çështjeve, që zgjidhen në këtë fazë, pa kaluar, fare, në fazat zyrtare të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Pavarsisht nga fakti që, kjo fazë është informale, komunikimi ndërmjet Komisionit dhe Shtetit Anëtar, për të cilin ka filluar procedura ligjore e shkëljes, sipas nenit 258 të Traktatit, nuk bëhet vetëm në mënyrë verbale, apo vetëm në diskutime dhe konsultime të drejtëpërdrejta, ndërmjet Komisionit dhe përfaqësuesit të përhershëm të Shtetit Anëtar, por, bëhet, edhe me anë të një *Letre Informale*, që Komisioni i dërgon përfaqësuesit të Shtetit Anëtar. Në këtë Letër Informale, Komisioni paraqet, në terma të përgjithshme, natyrën dhe llojin e mospërmbyshjes së detyrimit nga ana e Shtetit Anëtar, si dhe i lë një afat, zakonisht prej dy muajash, që përfaqësuesi i Shtetit të komunikojë me autoritetet e Shtetit të tij, si dhe nga ky i fundit të merren masa për përmbushjen e detyrimit ose rregullimin e shkëljes. Në qoftë se, negociatat ndërmjet Komisionit dhe Shtetit Anëtar, nuk japin rezultat edhe pas kalimit të afatit të caktuar nga Komisioni për ndreqjen e shkëljes, ose në qoftë se, Shteti Anëtar, nuk pranon që të bëjë negociata dhe komunikime informale me Komisionin, atëherë, Komisioni, në varësi të natyrës dhe rëndësisë së shkëljes ose mospërmbyshjes së detyrimit, vlerëson, nëse, do të kalojë apo jo në fazën e parë formale, që është faza e Njoftimit Zyrtar të Shtetit Anëtar.

Faza e dytë e procedurës ligjore të nisur nga Komisioni kundër një Shteti Anëtar për mospërmbyshje detyrimi ose kryerjen e një shkëljeje prej tij, është edhe faza e parë formale ose zyrtare e kësaj procedure, në të cilën Komisioni i dërgon një Njoftim Zyrtar ose një Letër Zyrtare Shtetit Anëtar, me anë të të cilës e njofton atë, zyrtarisht për natyrën dhe llojit konkret të shkëljes së kryer prej tij, ose për mospërmbyshjen konkrete të detyrimit prej tij. Duhet theksuar se Komisioni, ashtu siç ka liri veprimi për të vlerësuar dhe vendosur vetëm ai, ekskluzivisht, për të filluar apo jo procedurën ligjore kundër një Shteti Anëtar, sipas nenit 258 të Traktatit, po ashtu, Komisioni ka liri për të vlerësuar dhe vendosur, ekskluzivisht, nëse do të kalojë apo jo në fazën zyrtare të procedurës. Për fillimin e kësaj faze zyrtare kundër Shtetit Anëtar, Komisioni vlerëson një sërë faktorësh, ku në radhë të parë janë faktorët që kanë të bëjnë me natyrën dhe rëndësisë së shkëljes, por, nuk përjashtohen edhe faktorët politikë dhe pragmatistë.

Në qëndrimet e tij në lidhje me këtë problem Komisioni është shprehur se, *bërja e Njoftimit Zyrtar ose dërgimi i Letrës Zyrtare Shtetit Anëtar, në lidhje me mospërmbyshjen e detyrimeve prej tij, që burojnë nga Traktatet Kushtetuese ose për kryerjen e shkëljeve nga ky Shtet, nuk mund të bëhet për çdo lloj shkëljeje ose mospërmbyshjeje, por vetëm për ato shkëlje që minojnë themelet e rendit juridik të*

Bashkimit Evropian ose cënojnë funksionimin e rregullt të sistemit ligjor të Bashkimit. Sipas Komisionit, fillimi i procedurave zyrtare kundër një Shteti Anëtar, duhet vlerësuar në mënyrë strategjike dhe planifikuar me kujdes, si një mekanizëm i fundit dhe vetëm pasi strategjitë e tjera për të siguruar pajtimin e Shtetit me normat e Bashkimit, kanë dështuar dhe pasi bisedimet dhe ndërhyrjet konstruktive gjatë fazës së parë informale, nuk kanë patur sukses. Ky qëndrim i Komisionit duket të jetë i drejtë, kjo jo vetëm për faktin se, nisja zyrtare e procedurave ligjore kundër një Shteti Anëtar, për mospërmbyshje të detyrimeve prej tij, sipas nenit 258 të Traktatit, përbën një çështje delikate dhe komplekse, ndërmjet këtij Shteti dhe Bashkimit Evropian, por, edhe për faktin tjetër se, edhe sikur Komisioni të kishte dëshirë që për çdo shkelje ose mospërmbyshje të detyrimeve nga ana e Shteteve Anëtare, të fillonte procedurat ligjore kundër tyre, ai do ta kishte objektivisht të pamundur. Kjo pasi, në një Bashkim Evropian me 28 anëtarë, dhe me një Komision Evropian, të cilit Traktatet Kushtetuese i kanë ngarkuar role të shumëfishta, Komisionit i mungojnë burimet financiare dhe njerëzore për të filluar procedurat për çdo shkelje, përveç faktit tjetër që, nisja dhe përfundimi i të gjithë procedurave ligjore kërkon kohë, që zakonisht shkon deri në dy vjet.¹³⁴

Një tjetër çështje për të cilën ka patur debate është fakti, nëse, sipas nenit 258 të Traktatit, Komisioni, kur konstaton një shkelje ose mospërmbyshje detyrimi, mundet që të fillojë procedurën ligjore zyrtare kundër një Shteti Anëtar, duke i dërguar Letrën Zyrtare të njoftimit, në çdo kohë, apo një gjë të tillë, ai duhet që ta bëjë brenda një afati të arsyeshëm nga konstatimi i shkeljes prej tij. Në lidhje me këtë çështje, duke qenë se, neni 258 i Traktatit nuk e ka rregulluar, në mënyrë të shprehur, Gjykata Evropiane e Drejtësisë është shprehur që, mbi lirinë e veprimit të Komisionit ekzistojnë disa kufizues kohorë, përderisa, bëhet fjalë për periudhën që i duhet atij, për të nisur procedurat zyrtare për një shkelje të caktuar. Kështu, në një çështje konkrete, Mbretëria e Holandës pretendoi se, një periudhë më shumë se pesë vjet për të verifikuar procedurat e shkeljes, që nga koha që asaj i ishte dërguar letra e parë nga Komisioni, ishte tepër e gjatë dhe për pasojë,

Komisioni nuk kishte të drejtë që të vijonte procedurat zyrtare të shkeljes kundër saj. Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në lidhje me këtë pretendim, argumentoi se, pavarisht nga fakti që, neni 258 i Traktatit nuk kishte parashikuar, qëllimisht, afat kohor kohor për zhvillimin e procedurave, vonesa e tepruar e tyre nga Komisionit, ishte e papranueshme. Kështu, Gjykata në vendimin e saj të vitit 1991, në lidhje me këtë çështje, ndër të tjera, arsyetonte:

“...Është e vertetë se, në disa raste zgjatja e tepruar e procedurës gjyqësore të parashikuar nga neni 258 i Traktatit, ka mundësi t’ia bëjë më të vështirë Shtetit Anëtar të interesuar të hedhë poshtë argumentet e Komisionit dhe ato që shkelin të drejtat e mbrojtjes. Qeveria Holandeze nuk ka provuar që zgjatja e pazakontë e procedurës kishte ndonjë efekt mbi mënyrën sesi ajo kreu mbrojtjen e saj. ...”¹³⁵

Në Letrën Formale të njoftimit që Komisioni i dërgon Shtetit Anëtar, duhet që të tregohen, me hollësi dhe konkretisht, të gjitha rrethanat dhe faktet që tregojnë se Shteti në fjalë, ka kryer shkelje të Traktateve Kushtetuese dhe/ose të normave ligjore të së drejtës së Bashkimit Evropian apo nuk ka përmbushur detyrimet që burojnë nga

¹³⁴ Shih për më tepër: Craig P; De Burca G; “E drejta e Bashkimit Evropian, Tekste, çështje gjyqësore dhe materiale”, botuar nga Qendra e Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2013, faqe 526.

¹³⁵ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen gjyqësore C-96/89 Komisioni kundër Mbretërisë së Holandës, ECR 2461.

këto Traktate, duke specifikuar konkretisht edhe llojin dhe numrin konkret të shkeljeve ose të mospërbushjeve të detyrimeve, nga ana e Shtetit Anëtar. *Të dhënat që përmban Letra Formale, janë shumë të rëndësishme, sepse, në zbatim të parimit të kontradiktorialitetit, sipas të cilit Shteti Anëtar ka të drejtën që të paraqesë kundërshtime dhe prova në lidhje me pretendimet e bëra nga Komisioni, Komisioni në fazën e mëtejshme, mund ta vijojë procedurën e tij, vetëm për ato të dhëna të cilat ia ka njoftuar Shtetit Anëtar, në Letrën Zyrtare dhe jo edhe në fakte dhe të dhëna të reja.* Përveç kësaj, Letra Zyrtare që Komisioni i dërgon Shtetit Anëtar, realisht dhe praktikisht, ka një rëndësi të madhe, sepse, përcakton objektin e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve, ku, palët do të parashtrajnë pretendimet dhe prapsimet e tyre, si dhe provat konkrete, vetëm brenda këtij objekti, si edhe e gjithë procedura e mëtejshme ligjore do të vazhdojë, brenda këtij objekti dhe nuk mund t'i kalojë kufijtë e tij.

Për vlerën dhe rëndësinë që ka Letra Zyrtare e Njoftimit është shprehur edhe Gjykata e Drejtësisë në një *çështje konkrete*, që kishte të bënte me një mosmarrëveshje, ndërmjet Komisionit dhe Italisë, për shkelje në bazë të nenit 258 të Traktatit, ku, kjo Gjykatë, ndër të tjera, arsyetonte:

*“...Letra Formale e njoftimit ka për qëllim të përcaktojë objektin e mosmarrëveshjes dhe t'i bëjë të ditur Shtetit Anëtar që të paraqesë vërtetjet dhe faktet, si dhe t'i mundësojë atij që të përgatisë mbrojtjen. ...dhënia e mundësisë Shtetit Anëtar për të paraqitur vërtetjet e tij, përbën një garanci thelbësore të parashikuar nga Traktati, edhe nëse një Shtet Anëtar nuk e konsideron të nevojshme të përfitojë nga kjo, respektimi i kësaj garancie, është kërkesë formale, thelbësore e procedurës, sipas nenit 226 të Traktatit të Komunitetit Evropian. ...”*¹³⁶

Faza e tretë procedurës ligjore të nisur nga Komisioni kundër një Shteti Anëtar, sipas nenit 258 të Traktatit, e cila përbën edhe fazën e dytë zyrtare të procedurës, është nxjerrja nga ana e Komisionit të një Mendimi të Arsyetuar, i cili i njoftohet Shtetit Anëtar. Komisioni nxjerr Mendimin e Arsyetuar, vetëm pasi Shtetit Anëtar, t'i jetë dhënë një afat i arsyeshëm, për t'u përgjigjur dhe për të dhënë argumentet dhe provat e tij, në lidhje me shkeljen e konstatuar/pretenduar nga Komisioni dhe të paraqitura prej tij në Letrën Zyrtare, të drejtuar këtij Shteti. *Dhënia e një afati të arsyeshëm Shtetit Anëtar që të përgjigjet në lidhje me Letrën Zyrtare të dërguar atij nga Komisioni, përbën një pjesë thelbësore të procedurës, pa zbatimin e të cilës, Komisioni nuk mund të nxjerrë Mendimin e tij të Arsyetuar, në lidhje me shkeljen e pretenduar të bërë nga Shteti në fjalë.* Një kërkesë e tillë është e parashikuar, shprehimisht në paragrafin e parë të nenit 258 të Traktatit, në të cilin thuhet se: *“Komisioni nxjerr në Mendim të Arsyetuar për çështjen, pasi i ka dhënë mundësinë Shtetit në fjalë që të paraqesë komentet e veta”*, si dhe është sanksionuar edhe në disa vendime të Gjykatës së Drejtësisë.

Mendimi i Arsyetuar i Komisionit, i cili, faktikisht përbën edhe padinë e ardhshme dhe të mundshme që do të ngrejë ai, nëse Shteti Anëtar nuk e përmbush detyrimin ose nuk e rregullon shkeljen e bërë, duhet të përmbajë të argumentuar, me hollësi, të gjitha rrethanat e shkeljes së bërë nga Shteti Anëtar, si dhe provat përkatëse që provojnë shkeljen nga ana e këtij Shteti, kur kjo është e mundur. Mendimi i Arsyetuar që i drejtohet Shtetit Anëtar, përcakton objektin e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve, si dhe në këtë Mendim, Komisioni duhet të tregojë edhe dispozitat ligjore të Traktateve Kushtetuese ose të të drejtës së Bashkimit Evropian, që janë

¹³⁶ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen gjyqësore 51/83 Komisioni kundër Italisë, ECR 2793.

shkelur nga ana e Shtetit Anëtar. Ky Mendim paraqet rëndësi të madhe, jo vetëm për faktin se, përcakton objektin e mosmarrëveshjes dhe dispozitat ligjore të shkelura, por, edhe për faktin tjetër se, në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, Komisioni, nëse do të ngrejë padi në Gjykatë në të ardhmen, padinë e tij, duhet të mbështesë vetëm në faktet dhe të dhënat që ka përcaktuar në Mendimin e Arsytuar dhe jo edhe në fakte dhe rrethana të reja, që nuk janë qenë pasqyruar më parë në këtë Mendim. Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, Komisionit, sigurisht, i lejohet që ta kufizojë objektin e mosmarrëveshjes në padinë që mund të ngrejë në Gjykatë kundër Shtetit Anëtar, duke hequr ose pakësuar një ose disa kërtime të objektit të padisë, të cilat kanë qenë të pasqyruara në Mendimin e Arsytuar, por, nuk ka të drejtë që të shtojë objektin e kërtimeve të tij në Gjykatë, jashtë atyre fakteve dhe të dhënave që ka paraqitur më parë, në mendimin e tij të arsyetuar.

Ky konstatim është konfirmuar edhe nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në një çështje konkrete me palë Komisionin kundër Mbretërisë së Holandës, ku në vendimin e saj, në lidhje me këtë çështje, kjo gjykatë, ndër të tjera, arsyetonte:

“...Aplikimi në Gjykatë duhet të bazohet në të njëjtat baza dhe argumente, si Mendimi i Arsytuar. Mendimi që i referohet neni 226 i Traktatit të Komuniteteve Evropiane duhet të konsiderohet se përmban paraqitje të mjaftueshme të arsyeve për të kënaqur ligjin, kur ai përmban një paraqitje koherente të arsyeve që e kanë çuar Komisionin të besojë se Shteti në fjalë nuk ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Traktati. ...”¹³⁷

Detyrimi që ka Komisioni që të arsyetojë Mendimin e tij, buron përveçse nga neni 258 i Traktatit, por edhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës së Bashkimit Evropian, si dhe nga parashikimi i nenit 296 të Traktatit, i cili përcakton parimin e përgjithshëm sipas të cilit, *aktet ligjore të nxjerra nga institucionet e Bashkimit, duhet të tregojnë arsyet mbi të cilat bazohen*. Por, nga ana tjetër, edhe pse arsyetimi i Mendimit të tij nga ana e Komisionit, në respektim të nenit 258 të Traktatit, përbën një kërkesë thelbësore procedurale, *ky akt i Komisionit, nuk mund të jetë objekt i një padie për anulim, sipas nenit 263 të Traktatit për faktin e thjeshtë se, ai nuk ka karakter detyrues*. Megjithatë, pavarisht nga fakti se, Mendimi i Arsytuar, nuk mund të jetë objekt i padisë për anulim, Shteti Anëtar që i është drejtuar ky Mendim, mund ta kundërshtojë mungesën e arsyetimit të tij, para Gjykatës së Drejtësisë, në qoftë se çështja paraqitet për gjykim para saj.

Kështu, në një çështje, me palë Komisionin kundër Italisë, Italia kundërshtoi para Gjykatës formën ligjore dhe përmbajtjen e Mendimit të Arsytuar. Në lidhje me këtë pretendim të Italisë, Gjykata, ndër të tjera, u shpreh se:

“...Mendimi që i referohet neni 169 (aktualisht neni 258 i Traktatit) duhet të konsiderohet se përmban një deklaram të mjaftueshëm të arsyeve për të zbatuar ligjin, kur ai ka, si në këtë rast, një paraqitje koherente të arsyeve që e çuan Komisionin të besojë që Shteti në fjalë, nuk ka arritur të përmbushë një detyrim sipas Traktatit. ...”¹³⁸

Duke u bazuar në vendimet e Gjykatës së Drejtësisë, rezulton që, Komisioni nuk është i detyruar që në Mendimin e tij të Arsytuar, t'i përgjigjet çdo argumenti të paraqitur nga Shteti në fazën paragjyqësore, apo t'i tregojë Shtetit se cilët duhet të jenë masat që ai të marrë, me qëllim që të rregullojë shkeljen e pretenduar.

¹³⁷ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen gjyqësore 290/87 Komisioni kundër Mbretërisë së Holandës, ECR 3083.

¹³⁸ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen gjyqësore 7/61 Komisioni kundër Italisë, ECR 317.

Megjithatë, Gjykata ka arsyetuar se, Komisioni duhet t'i përgjigjet, Përgjigjes së Shtetit të dërguar prej tij, kundër Letrës Zyrtare, edhe sikur kjo përgjigje të jetë e vonuar nga ana e Shtetit në fjalë. Po ashtu, siç është theksuar më lart, Komisioni nuk ka të drejtë që të ndryshojë përmbajtjen substanciale të padisë që paraqet në Gjykatë, krahasuar kjo me Mendimin e Arsyetuar, dhe për pasojë padia e ngritur, duhet të jetë, e njëjtë, në thelb, me Mendimin e Arsyetuar, që i është njoftuar Shtetit në fjalë.

Në qoftë se, padia e ngritur nga Komisioni kundër Shtetit Anëtar, është vlerësuar nga Gjykata, si e papranueshme për shkak se ajo është e ndryshme, në thelb dhe në përmbajtje, me Mendimin e Arsyetuar të Komisionit, Komisioni nuk është i detyruar që të rifillojë nga e para, të gjithë procedurën paragjyqësore, por, mund të ngrejë një padi të re, e cila, përmban të njëjtat argumente, ashtu si dhe Mendimi i Arsyetuar, i njoftuar Shtetit Anëtar. Po ashtu, kur legjislacioni i Bashkimit Evropian, mbi bazën e të cilit është mbështetur Mendimi i Arsyetuar, ka ndryshuar, para se çështja të paraqitet në Gjykatë, kjo nuk e detyron Komisionin që të tërheqë padinë apo të japë një Mendim të Arsyetuar të ri, përderisa, detyrimet e Shtetit u përgjigjen normave ligjore të parashikuara nga legjislacioni i mëparshëm.

Siç u tha edhe më lart, në këtë fazë, Komisioni, pas dhënies së Mendimit të Arsyetuar, duhet që t'i caktojë edhe një afat të arsyeshëm Shtetit në fjalë, brenda të cilit ai duhet të reagojë për të përmbushur detyrimin ose për të ndrequr shkeljen e pretenduar. *Çështja se sa duhet të jetë ky afat i arsyeshëm, brenda të cilit Shteti duhet të reagojë, është në varësi të kompleksitetit dhe natyrës së shkeljes së pretenduar, megjithatë, në shumicën e çështjeve, ky afat varion nga dy, deri në gjashtë muaj, me përjashtim të rasteve kur, çështja është urgjente.* Problemi i afatit që Komisioni i cakton Shtetit Anëtar për të reaguar dhe për të ndrequr shkeljen, është marrë për shqyrtim edhe nga Gjykata e Drejtësisë, e cila, në disa vendime të saj, ka arsyetuar se, ky afat, varet nga lloji dhe natyra e çështjes, e rëndësishme është që, Shtetit t'i lihet një kohë e arsyeshme që ai, obkjektivisht të ketë mundësi të reagojë dhe të përmbushë detyrimin ose të rregullojë shkeljen e konstatuar.

Kështu, në një rast të praktikës gjyqësore, *me palë Komisionin kundër Irlandës*, Gjykata e Drejtësisë, shprehu mospajtimin e saj me afatin prej 5 ditësh që Komisioni i kishte lënë Irlandës, brenda të cilit ai duhet që të ndreqte shkeljen e pretenduar. Kështu, në këtë vendim, Gjykata, ndër të tjera, u shpreh:

"...Gjykata është e detyruar të deklarojë mosmiratimin prej saj të sjelljes së Komisionit në këtë drejtim. Ajo është në të vertetë e paarsyeshme, siç e ka theksuar Irlanda, t'i lejonte një Shteti Anëtar pesë ditë për të ndryshuar që ishte zbatuar për më shumë se dyzet vjet e që për më tepër nuk i jepte shkas ndonjë padie nga ana e Komisionit gjatë një periudhe që ka kaluar, që nga pranimi i Shtetit Anëtar në fjalë. Për më tepër, është e qartë se nuk kishte ndonjë urgjencë të veçantë. ...".¹³⁹

Mendimi i Arsyetuar që i drejtohet Shtetit Anëtar edhe pse përbën një dokument zyrtar dhe një akt thelbësor të procedurës ligjore, sipas nenit 258 të Traktatit, përsëri, është vlerësuar nga ana e Komisionit, por edhe e Gjykatës së Drejtësisë, si një dokument konfidencial dhe që nuk mund të jetë i hapur për t'u njohur për publikun para se, Gjykata të ketë dhënë vendimin e saj, në lidhje me çështjen konkrete. Mbajtja sekret e Mendimit të Arsyetuar të Komisionit, para se Gjykata të jepte vendimin e saj, ka sjellë debate, në rastet kur procedura ligjore kundër Shtetit Anëtar është nisur nga Komisioni, mbi bazën e ankimit të individëve

¹³⁹ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen gjyqësore 74/82 Komisioni kundër Irlandës, ECR 317.

dhe kjo procedurë është mbyllur nga Komisioni, pa e dërguar çështjen para Gjykatës së Drejtësisë. Në këtë rast, individët që kanë paraqitur ankimin, mbi bazën e të cilit ka nisur procedura, kanë kërkuar nga Komisioni që të njihen me përmbajtjen, si të Letrës Zyrtare ashtu edhe të Mendimit të Arsytuar të Komisionit, ashtu edhe të përgjigjeve të kthyer nga ana e Shtetit Anëtar.

Në lidhje me këtë kërkesë të individëve, për t'u njohur me këto dokumente, Komisioni është shprehur me refuzim, duke mos i lejuar individët që të njihen me to, me arsyetimin se njohja e tyre, do të minonte procedurat ligjore të parashikuara nga neni 258 i Traktatit. Qëndrimi i mbajtur nga Komisioni, është mbështetur edhe nga Gjykata e Shkallës së Parë, në disa vendime të saj, duke arsyetuar se, është e nevojshme që të ruhet konfidencialiteti i këtyre dokumenteve, derisa sa të jepet vendimi nga ana e Gjykatës së Drejtësisë. Kështu në një *çështje gjyqësore me palë Komisioni kundër Spanjës*, kjo Gjykatë, arsyetonte, ndër të tjera se:

"...Konfidencialiti, të cilin Shtetet Anëtare kanë të drejtë ta presin nga Komisioni në rrethana të tilla, të udhëhequr nga mbrojtja e interesit publik, kërkon refuzimin për t'u njohur me dokumentet, që lidhen me hetimet që mund të çojnë në një procedurë shkeljeje, edhe kur ka kaluar një farë kohe nga mbyllja e hetimit. ...".¹⁴⁰

Të njëjtin qëndrim mbajti Gjykata e Shkallës së Parë edhe në *çështjen Petrie*, të cituar nga ana ime më lart, ku në lidhje me këtë fakt, ndër të tjera, arsyetonte:

"...Kjo kërkesë për konfidencialitetin qëndron edhe pasi çështja është ngritur para Gjykatës së Drejtësisë për faktin se, nuk mund të përjashtohet që gjatë diskutimeve midis Komisionit dhe Shtetit Anëtar në fjalë, lidhur me mospërmbushjen vullnetare nga ky i fundit të kërkesave të Traktatit, bisedimet për zgjidhjen me pajtim të nosmarrëveshjes të mund të vazhdojnë gjatë seancave gjyqësore dhe deri në dhënien e vendimit nga Gjykata e Drejtësisë. Ruajtja e atij objektivi, kryesisht për një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, midis Komisionit dhe Shtetit Anëtar të intersuar, para se Gjykata e Drejtësisë të japë vendim, e justifikon refuzimin e hapjes së letrave me Njoftime Zyrtare dhe të Mendimeve të Arsytuara, të hartuara në lidhje me procedurat e nenit 226 të Traktatit. ...".¹⁴¹

Faza e katërt e procedurës ligjore të ndjekur nga Komisioni, në zbatim të nenit 258 të Traktatit, kundër një Shteti Anëtar, është ngritja e padisë para Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, për përmbushjen prej tij të detyrimeve që burojnë nga Traktatet Kushtetuese, ose për kryerjen prej tij të një shkelje të këtyre Traktateve ose të së drejtës së Bashkimit Evropian. Kjo është faza e fundit e procedurave ligjore sipas nenit 258 të Traktatit dhe me paraqitjen e padisë, çështja gjykohet nga Gjykata e Drejtësisë, sipas procedurës së rregullt, duke kaluar gjykimi në të dy fazat, në *fazën me shkrim* dhe në *fazën me gojë*, duke u respektuar rregullat procedurale, për secilën fazë, dhe në fund të gjykimit, Gjykata vendos, sipas rastit, në bazë të provave dhe akteve të shqyrtuara, pranimin ose rrëzimin e padisë së Komisionit.

Duhet të kemi parasysh se, nga numri total i çështjeve që Komisioni, nis sipas nenit 258 të Traktatit kundër një Shteti Anëtar, një numër shumë i vogël i tyre, rreth 10 përqind, përfundon me ngritjen e padisë nga ana e Komisionit para Gjykatës së Drejtësisë. Një gjë e tillë ndodh për dy arsye:

¹⁴⁰ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës e Shkallës së Parë, në çështjen gjyqësore T-105/95 Komisioni kundër Spanjës.

¹⁴¹ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë në çështjen gjyqësore T-191/99 Petrie kundër Komisionit (2001).

Së pari: Pjesa më e madhe e mosmarrëveshjeve ndërmjet Komisionit dhe Shtetit Anëtar, zgjidhen në mënyrë miqësore, pra, me pajtim, gjatë fazave të mëparshme të procedurës, siç janë faza e parë informale, faza e dytë ajo e Njoftimit Zyrtar dhe faza e tretë, ajo e Mendimit të Arsyetuar të hartuar nga Komisioni;

Së dyti: Në rastet kur mosmarrëveshja nuk zgjidhet, në mënyrë miqësore ose me pajtim ndërmjet Komisionit dhe Shtetit Anëtar, gjatë fazave të mëparshme të procedurës, Komisioni, ka liri veprimi për të vlerësuar dhe vendosur, nëse do të ngrejë apo jo padi në Gjykatë, kundër Shtetit Anëtar, që ka kryer shkeljen ose nuk ka përmbushur detyrimet, sipas Traktatave Kushtetuese ose të drejtës së Bashkimit Evropian.

Edhe liria që ka Komisioni për të vlerësuar nëse do të ngrejë padi para Gjykatës së Drejtësisë, bazuar në nenin 258 të Traktatit, nëse, një Shtet Anëtar nuk ka përmbushur detyrimet e tij, apo ka kryer një shkelje ligjore, është bërë objekt debatesh dhe diskutimesh, pasi Komisioni mund të ketë arsye politike ose edhe pragmatiste për mos ngritjen e padisë kundër Shtetit Anëtar. Por, pavarësisht nga kjo duhet theksuar se, Komisioni, nuk ka një liri të pakufizuar në vlerësimin e fakteve, nëse, do të ngrejë ajo padi kundër Shtetit Anëtar, dhe si rregull, Komisioni në çdo rast, ka ngritur padi, kur shkelja ose mospërmbushja e detyrimit nga ana e Shtetit, ka cënuar rëndë, funksionimin e sistemit ligjor të Bashkimit Evropian, ose ka minuar themelet e rendit ligjor të Bashkimit.

4.2. Rastet tipike kur Komisioni mund të fillojë procedurat ligjore, për mospërmbushje të detyrimeve nga Shtetet Anëtare.

Duke iu referuar përmbajtjes së nenit 258 të Traktatit, në të cilën është parashikuar nisja e procedurave ligjore kundër një Shteti Anëtar, në rast se, ky Shtet “nuk ka përmbushur detyrimet që burojnë nga Traktatet”, rezulton se, kjo dispozitë është shumë e përgjithshme dhe nuk përcakton konkretisht, se për cilat lloje detyrimesh që nuk ka përmbushur Shteti Anëtar, Komisioni ka të drejtë që të fillojë procedurat ligjore, deri në ngritjen e padisë në Gjykatën e Drejtësisë, me qëllim që ta detyrojë Shtetin në fjalë, që të përmbushë detyrimet sipas Traktatave. Për këtë arsye, me qëllim që të bëhet më e lehtë kuptimi i kësaj dispozite, nga ana ime, do të pasqyrohen në këtë çështje, disa raste tipike të detyrimeve, të cilët, nëse, nuk përmbushen nga Shtetet Anëtare, Komisioni ka të drejtë që të fillojë procedurave sipas nenit 258 të Traktatit. Në evidentimin e këtyre rasteve tipike, një rol të madh ka luajtur Gjykata Evropiane e Drejtësisë, me vendimet e saj, prandaj në këtë çështje, gjatë trajtimit të saj, do të citohen edhe disa vendime të kësaj Gjykate, duke u mundur që të citoj, nga një ose dy vendime, për çdo rast. Bazuar në Traktatet Kushtetuese, rastet tipike që përbëjnë mospërmbushje detyrimesh nga Shtetet Anëtare, që i japin të drejtë Komisionit që të fillojë procedurat ligjore sipas nenit 258, mund të përmbledhen si më poshtë:

a) Kur një Shtet Anëtar shkel detyrimin për bashkëpunim të sinqertë me Bashkimin Evropian.

Një nga parimet më të rëndësishme që zbatohet për të gjitha Shtetet Anëtare, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve prej tyre, si pjesë e Bashkimit Evropian, është parimi i bashkëpunimit të sinqertë, midis Shteteve Anëtare dhe Bashkimit Evropian.¹⁴²

¹⁴² Pika 3 e nenit 4 të Traktatit të Bashkimit Evropian parashikon:

Bashkëpunimi i singertë nënkupton detyrimin që kanë Shtetet Anëtare, nga njëra anë dhe Bashkimi Evropian, nga ana tjetër, që të sillen ndaj njëri-tjetrit, në bazë të rregullave të mirëbesimit dhe kërkesave të arsyes. Detyrimi për bashkëpunim të singertë, i vendosur nga Traktatet Kushtetuese, nuk lejon që një Shtet Anëtar të sillet ndaj Bashkimit Evropian dhe institucioneve të tij, në mënyrë arrogante, aq me pak arbitrare, si dhe madje nuk pranon që Shteti Anëtar, të ketë rol pasiv apo të heshtë, në lidhje me detyrimet që ai ka si pjesë e Bashkimit Evropian. Përkundrazi, ky detyrim kërkon që çdo Shtet Anëtar, duhet që të ketë rol aktiv dhe të bashkëpunojnë me Bashkimin Evropian në realizimin e detyrimeve që ai ka, bashkëpunimi, i cili, duhet të jetë i ndershëm dhe sjellja e Shtetit në kuadrin e këtij bashkëpunimi, duhet të jetë brenda kërkesave të arsyes. Po ashtu, detyrimi i bashkëpunimit të singertë kërkon që, secila palë (Shteti Anëtar dhe Bashkimi Evropian), duhet t'i bëjë të njohura palës tjetër, faktet për të cilat ajo ka dijeni dhe që nuk dihen nga pala tjetër, si dhe t'i njoftojë çdo fakt apo rrethanë, e cila lehtëson realizimin e këtij bashkëpunimi.

Parimi i bashkëpunimit të singertë, ndërmjet Shteteve Anëtare dhe Bashkimit Evropian, është një parim që nuk ka karakter thjeshtë ceremonial apo formal, por, është një parim me natyrë thelbësore dhe me pasoja të drejtpërdrejta, në të cilin Gjykata e Evropiane e Drejtësisë është mbështetur për dhënien e disa vendimeve prej saj, kundër Shteteve Anëtare, pikërisht për shkeljen e këtij parimi prej tyre. Por, nga ana tjetër, duke qenë se, detyrimi për bashkëpunim të singertë, është një parim ose detyrim me karakter të përgjithshëm, Gjykata e Drejtësisë, ka theksuar se, moszbatimi i këtij parimi përbën mospërbushje detyrimi nga një Shtet Anëtar, vetëm në rastet kur nuk ekziston një rregull ligjor tjetër specifik dhe i dallueshëm. Kjo për faktin se, në rastet kur ekziston një rregull specifik që përcakton detyrimin e Shtetit Anëtar, atëherë mospërbushja e detyrimit për këtë Shtet, do të përcaktohet për shkeljen e këtij rregulli ligjor të veçantë dhe jo mbi bazën e detyrimit të përgjithshëm të bashkëpunimit të singertë.

Në një çështje të praktikës gjyqësore, konkretisht, në çështjen 96/81, Komisioni kundër Holandës, Komisioni nisi procedurat kundër saj, duke e akuzuar Holandën, për moszbatimin e disa direktivave të Bashkimit Evropian që kishin të bënin me cilësinë e ujit për larje dhe duke pretenduar se Qeveria Holandeze, nuk kishte arritur dot të jepte informacion për përbushjen prej saj të detyrimeve që buronin nga Direktiva. Komisioni argumentonte se, për shkak të dështimit të dhënies së këtij informacioni, ai kishte të drejtë që të prezumonte se shteti i paditur, nuk kishte arritur dot masat e nevojshme kombëtare. Në çështjen e ngritur para saj, Gjykata konstatoi se, shkelje e pretenduar nga Komisioni, nuk kishte të bënte me dështimin e shtetit të paditur për të dhënë informacionin e duhur, por, me mospërbushjen e detyrimit për të zbatuar Direktivën.

Për prezumimin e Komisionit sipas të cilit, mosdhënia e informacionit të nevojshëm nga ana e Shtetit të paditur, nënkuptonte se ai nuk kishte përbushur detyrimet e tij kombëtare për zbatimin e Direktivës, Gjykata e Drejtësisë, në vendimin e saj u shpreh se: “Duhet theksuar se, në procedimet sipas nenit 169 të Traktatit të Komuniteteve Ekonomike Evropian, (aktualisht, neni 258 i Traktatit për Funksimin

3. Në bazë të parimit të bashkëpunimit të singertë, Bashkimi dhe Shtetet Anëtare, bazuar në respektin e ndërsjelltë, e mbështesin njëri-tjetrin në kryerjen e detyrave që rrjedhin nga Traktatet.

Shtetet Anëtare marrin masat e duhura, të përgjithshme dhe të posaçme, për të siguruar plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga Traktatet ose nga aktet e institucioneve të Bashkimit.

Shtetet Anëtare ia lehtësojnë Bashkimit arritjen e detyrave të tij dhe heqin dorë nga çdo masë që do të vinte në rrezik arritjen e objektivave të Bashkimit”.

e Bashkimit Evropian)¹⁴³ *për mospërbushjen e një detyrimi, Komisioni ka për detyrë që të provojë akuzën se detyrimi nuk është përmbushur. Komisioni ka përgjegjësinë që të paraqesë para Gjykatës informacionin e nevojshëm, për t'i mundësuar Gjykatës të vendosë që detyrimi nuk është përmbushur dhe për ta bërë këtë gjë, Komisioni nuk mund të bazohet tek ndonjë prezumim*".¹⁴⁴

Nga ana tjetër, duke iu referuar vendimit të mësipërm, edhe pse Komisioni nuk mund të bazohet në një prezumim të shkeljes në rastet kur, Shteti i paditur nuk jep informacionin e duhur në lidhje me përmbushjen e detyrimeve, Gjykata e Drejtësisë, *në përputhje me rregullat për barrën e provës "onus probandi", ka përcaktuar që, në rastet kur Komisioni ka sjellë prova të mjaftueshme që tregojnë që Shteti i paditur ka shkelur të drejtën e Bashkimit Evropian, ky i fundit ka jo vetëm detyrimin që të mohojë shkeljet e pretenduara, por, edhe duhet të sjellë fakte konkrete që provojnë se, nuk e ka kryer shkeljen*. Duke i bërë një ndarje të drejtë barrës së provës ndërmjet palëve, po ashtu, Gjykata ka vlerësuar se, ndërsa barra e provës bie mbi Komisionin për të provuar që Shteti i paditur e ka kryer shkeljen, dhe kur ankesa lidhet me moszbatimin e duhur të një Direktive, duke mos qenë e nevojshme që të provojë Komisioni efektet e dëmshme të moszbatimit të Direktivës, Shteti i Paditur, duhet që nga ana e tij, të provojë se, nuk e ka kryer shkeljen dhe ka marrë masat konkrete për zbatimin e Direktivës.¹⁴⁵

Në vendimin e cituar më sipër, në çështjen Komisioni kundër Holandës, Gjykata argumentoi se, të gjitha Shtetet Anëtare kishin detyrim, sipas nenit 10 të Traktatit të Komuniteteve Evropiane, sot neni 4, pika 3 e Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, që t'ia lehtësojnë përmbushjen e detyrave Komisionit, përfshirë edhe lejimin që Komisioni të monitorojë faktin, nëse, sjellja e Shteteve Anëtare është në përputhje me Traktatet Kushtetuese. Detyrimi që kanë Shtetet Anëtarë që t'ia lehtësojnë përmbushjen e detyrave Komisionit, në të kundërt, sjellja e tyre do të konsiderohet si shkelje në bazë të pikës 3 të nenit 4 të Traktatit, është përdorur, shumë shpesh nga Komisioni si argument, në paditë e ngritura prej tij ndaj një Shteti Anëtar, për mospërbushje detyrimi prej tij, në bazë të nenit 258 të Traktatit, në rastet kur, autoritetet e Shtetit Anëtar, nuk janë të gatshëm që t'i përgjigjen Komisionit, në lidhje me shkeljet e pretenduar prej tij. Kjo për faktin se, në mungesë të përgjigjes dhe mosdhënies së informacionit nga ana e Shtetit Anëtar, për Komisionit në fazat paragjyqësore të çështjes, Komisioni do ta kishte të pamundur që të vlerësonte nëse sjellja e Shtetit Anëtar përbën apo jo mospërbushje detyrimi. Zgjidhja që ka gjetur, me të drejtë, Komisioni në një rast të tillë, është fillimi i procedurave të veçanta të shkeljes ndaj Shtetit Anëtar, mbi bazën e shkeljes së detyrimit për bashkëpunim të singertë, të parashikuar në pikën 3 të nenit 4 të Traktatit. Qëndrimi i mësipërm i mbajtur nga Komisioni, është përkrahur edhe Gjykata e Drejtësisë në disa vendime të saj, ku vlen të përmendim, *vendimin e datës 20 shtator 1988, në çështjen 272/86, Komisioni kundër Greqisë*, lidhur me refuzimin e Greqisë për t'i dhënë informacione Komisionit për këtë çështje, ku, nga ana e Gjykatës u konsideruar si shkelje Traktateve, dhe konkretisht e detyrimit për bashkëpunim, refuzimi i Greqisë për të mos i dhënë informacionin e nevojshëm Komisionit. Në një

¹⁴³ Shënim i autores së këtij punimi.

¹⁴⁴ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen gjyqësore 96/81, ECR 1791, Komisioni kundër Holandës.

¹⁴⁵ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen gjyqësore C-392/96 ECR I-5091, Komisioni kundër Irlandës.

çështje tjetër, konkretisht, në çështjen C-265/95, *Komisioni kundër Francës*, Gjykata, me vendimin e datës 9 dhjetor 1997, ndëshkoi Francën për shkak të pengesave ndaj qarkullimit të lirë të mallrave që lidheshin me manifestimet e bujqëve francezë.¹⁴⁶

Në këtë çështje, Gjykata argumentoi që, detyrimi për bashkëpunim të sinqertë, përfshin jo vetëm detyrime negative për Shtetet Anëtare, pra, jo vetëm shmangien e shklejes së të drejtës së Bashkimit Evropian prej tyre, por përfshin edhe detyrime pozitive për Shtetet, të cilët kanë detyrimin që, t'i pengojnë personat e tjerë që ndodhen në juridiksionin dhe autoritetin e tyre që të shkelin dispozitat e Traktateve. Në vijim, Gjykata vlerësoi se, Franca duke mos marrë masat e duhura për të penguar protestat e dhunshme dhe shkatërruese të fermerëve francezë, protesta të cilat po pengonin lëvizjen e lirë të mallrave bujqësore, brenda tregut të përbashkët të Bashkimit Evropian, ajo kishte shkelur detyrimet që i ngarkonin Traktatet Kushtetuese. Në përputhje me detyrimin pozitiv të Shtetit Anëtar për të vepruar, detyrimi për bashkëpunim të sinqertë do të shkelet, në rastet kur një Shtet Anëtar, nuk do të ndëshkonte personat që ndodhen në autoritetin e tij, që shkelin të drejtën e Bashkimit Evropian, në të njëjtën mënyrë, siç do t'i ndëshkonte këta persona kur, shkelin të drejtën kombëtare të atij Shteti, ndëshkim i cili duhet të jetë efektiv, proporcional dhe parandalues.

Përveç detyrimit për bashkëpunim të sinqertë me institucionet e Bashkimit Evropian, *Shtetet Anëtare, por edhe Bashkimi, kanë detyrimin që të tregojnë respekt të ndërsjellë ndaj njëri-tjetrit, në përmbushjen e detyrimeve të tyre*. Respekti i ndërsjellë nënkupton faktin që, në përmbushjen e detyrimeve Shtetet Anëtare dhe Bashkimi Evropian, duhet të jenë luajalë ndaj njëri-tjetrit, të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin duke respektuar të drejtat dhe pushtetet që ka secili prej palëve, në funksion të arritjes së një qëllimi të përbashkët, që është plotësimi i objektivave të Bashkimit Evropian, por edhe ruajtja e sovranitetit të Shteteve Anëtare. Kur kanë marrë pjesë si Shtete Anëtare të Bashkimit Evropian, kuptohet se, këto Shtete kanë hequr dorë nga një pjesë e rëndësishme e Sovranitetit të tyre, duke ia deleguar atë Bashkimit Evropian, por, kjo nuk do të thotë që, këto Shtete kanë humbur sovranitetin e tyre dhe nuk janë më shtete të pavarura dhe subjekt i veçantë i të drejtës ndërkombëtare.

Respekti reciprok ndërmjet Shteteve Anëtare dhe Bashkimit Evropian, kërkon që këto Shtete të respektojnë dhe të lejojnë Bashkimin që të veprojë në atë pjesë të Sovranitetit nga i cili ato kanë hequr dorë, në funksion të krijimit të Bashkimit Evropian, por, kërkon nga ana tjetër që edhe Bashkimi të respektojë atë pjesë të Sovranitetit të Shteteve Anëtare, nga i cili ato nuk kanë hequr dorë dhe që bën që ato të jenë akoma Shtete të Pavarura dhe subjekte më vehte, të së drejtës ndërkombëtare. Respekti reciprok arrihet kur, secila nga palët e ka të qartë si objektivin ose qëllimet që kërkohen të arrihen, ashtu edhe të drejtat dhe pushtetet që ka pala tjetër, si dhe kur këto të drejta dhe pushtete të palëve, përdoren, pikërisht për arritjen e qëllimit të përbashkët, funksionimin sa më të mirë dhe të plotë të Bashkimit Evropian.

Një detyrim tjetër i rëndësishëm që kanë Shtetet Anëtare në kuadër të bashkëpunimit me Bashkimit Evropian, *është detyrimi që kanë këto Shtete që të marrin çdo masë të përgjithshme dhe të posaçme me qëllim plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga Traktatet Kushtetuese dhe nga normat e tjera ligjore të Bashkimit Evropian*. Ky parim vendos detyrimin e Shteteve Anëtare për të vepruar dhe për të qenë aktiv në përmbushjen e detyrimeve që kanë ndaj Bashkimit, detyrim i cili

¹⁴⁶ Shih për më tepër: Jacque, J, P; “E drejta institucionale e Bashkimit Evropian”, Shtëpia Botuese “Papyrus”, Tiranë, 2010, faqe 504-505.

përfshin marrjen e masave konkrete, në përputhje me normat që përbëjnë të drejtën e Bashkimit Evropian. Këto masa, të cilat mund të jenë me karakter të përgjithshëm ose të veçantë, mund të përfshijnë masa të natyrave të ndryshme, siç mund të jenë masa me karakter legjislativ, të cilat kanë të bëjnë me përafrimin e legjislacionit të Shtetit Anëtar, me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Por, këto masa mund të jenë dhe me karakter administrativ, strukturor, që kanë të bëjnë me krijimin e organeve ose institucioneve të reja nga ana e Shtetit Anëtar, mund të jenë me karakter financiar ose social, që kanë të bëjnë me mbështetjen e grupeve të ndryshme të ndryshme të popullsisë, të cilat janë të marxhinalizuara dhe pa mbrojtje, ose kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe të ujit, si dhe një sërë masash, të cilat kanë për qëllim arritjen e standardeve të kërkuara nga Bashkimi Evropian, në çdo fushë të jetës për Shtetin Anëtar.

Meqenëse, po flas në lidhje me masat që duhet të marrë secili Shtet Anëtar, me qëllim plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga Traktatet Kushtetuese, si dhe meqenëse, Shqipëria është Shtet Kandidat i Bashkimit Evropian, që nga qershori i vitit 2014, mendoj se, *marrja e masave, me qëllim plotësimin e detyrimeve që burojnë nga Bashkimi Evropian, vlen edhe për Shqipërinë si Shtet Kandidat*. Në këtë drejtim do të thoja se, në Raport Progresin Vjetor të Bashkimit Evropian për Shqipërinë për vitin 2013, Shqipërisë i janë caktuar marrja e masave konkrete të përgjithshme dhe të posaçme, në pesë fusha, të njohura edhe si Pesë Prioritetet Kryesore, që duhet të përmbushë Shqipëria, me qëllim që të hapë Negociatat për t'u anëtarësuar si Shtet Anëtar, në Bashkimin Evropian. Këto Pesë prioritete, siç dihet janë;

- zbatimi i reformave në administratën publike, me qëllim sigurimin e një administrate publike profesionale dhe të pavarur;
- marrjen e reformave në sistemin e drejtësisë, me qëllim forcimin e pavarësisë, efikasitetin dhe përgjegjësinë e institucioneve të drejtësisë;
- lufta kundër korrupsionit, në drejtim të krijimit të të dhënave të pandërprera të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve;
- lufta kundër krimit të organizuar, në drejtim të krijimit të të dhënave të pandërprera të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve;
- mbrojtja e të drejtave të njeriut, ku përfshihen masat për mbrojtjen e romëve, masat kundër diskriminimit, si dhe zbatimin e të drejtës së pronës.

Plotësimi i këtyre pesë detyrimeve është në vullnetin e organeve të brendshme kombëtare të Shqipërisë, të Qeverisë, Parlamentit, por edhe të institucioneve të tjera të vendit, në qoftë se, Shqipëria dëshiron Hapjen e Negociateve për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Sigurisht, që plotësimi i të gjitha detyrimeve të mësipërme, përveçse nga vullnetin e Qeverisë, kërkon edhe një kohë të mjaftueshme, por, kërkon edhe burime njerëzore dhe financiare, si dhe kërkon dhe një bashkëpunim të të gjitha forcave politike, si dhe një bashkim të të gjitha burimeve njerëzore, materiale, financiare, shoqërore dhe ekonomike, në një drejtim të vetëm, integrimin e vendit në Bashkimin Evropian. Një gjë është e sigurtë, sa më shpejt t'i plotësojë Shqipëria këto detyrime, si Shtet Kandidat, aq më shpejt Bashkimi Evropian do t'i ofrojë asaj Hapjen e Negociateve, dhe aq më shpejt Shqipëria do të bëhet Shtet Anëtar i Bashkimit Evropian, duke realizuar kështu edhe ëndërrën e madhe të qytetarëve të saj, për t'u ndjerë të barabartë me të gjithë qytetarët e Shteteve të tjera të Evropës.

Një tjetër detyrim që kanë Shtetet Anëtare në lidhje me bashkëpunimin me Bashkimin Evropian, është fakti se, *këto Shtete duhet që t'ia lehtësojnë arritjen e detyrave Bashkimit Evropian, si dhe të heqin çdo masë e cila do të bëjë pengesë për arritjen e objektivave të Bashkimit*. Si një bashkim shtetesh të pavarura, Bashkimi

Evropian ka përcaktuar një arritjen e disa objektivash, objektiva që janë parashikuara në Traktatet Kushtetuese, të cilat e kanë si detyrim që t'i përmbushin, në të njëjtën kohë, si Bashkimi Evropian edhe Shtetet Anëtare. Me qëllim realizimin e këtyre objektivave, Shtetet Anëtare duhet të marrin çdo masë që e lehtësojnë Bashkimin në realizimin e detyrave të tyre, si dhe duhet të heqin çdo pengesë, e cila rrezikon arritjen e objektivave të Bashkimit.

b) Kur një Shtet Anëtar zbaton, në mënyrë të papërshtatshme, të drejtën e Bashkimit Evropian.

Rasti i dytë kur Komisioni ka të drejtë të fillojë procedurat ligjore kundër një Shteti Anëtar, për mospërmbushje të detyrimeve, është kur ky i fundit zbaton, pjesërisht ose zbaton në mënyrë të gabuar, të drejtën e Bashkimit Evropian. Ky shkak i fillimit të procedurave ligjore nga Bashkimi Evropian, në bazë të nenit 258 të Traktatit, kundër një Shteti Anëtar, i referohet rasteve kur Shteti në fjalë, nuk dështon në mënyrë të plotë, në zbatimin e së drejtës së Bashkimit, por kur e zbaton pjesërisht atë, ose e zbaton në mënyrë të gabuar. *Zbatimi i papërshtatshëm i së drejtës së Bashkimit Evropian, nga ana e Shtetit Anëtar, konstatohet në dy raste:*

i. kur Shteti Anëtar, e zbaton në mënyrë të pjesshme të drejtën e Bashkimit ose

ii. kur Shteti Anëtar e zbaton, në mënyrë të gabuar të drejtën e Bashkimit.

Verifikimi i njërit apo tjetrit rast, kur Shteti Anëtar ka zbatuar në mënyrë të papërshtatshme të drejtën e Bashkimit Evropian, bëhet, rast pas rasti, nga ana e Gjykatës së Drejtësisë, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, prandaj për të sqaruar këtë, do të duhet të citoj disa nga vendimet e kësaj Gjykate. Kështu, në një *çështje gjyqësore të zhvilluar ndërmjet Komisionit dhe Francës*, Gjykata e Drejtësisë konstatoi zbatimin e papërshtatshëm të së drejtës së Bashkimit Evropian nga ana e Francës, pasi kjo e fundit nuk kishte mundur që të harmonizonte ose të përshtaste të drejtën e saj të brendshme, me të drejtën e Bashkimit. Çështja në fjalë kishte të bënte me Kodin Detar francez, i cili kishte një nen që përcaktonte që, një pjesë e ekuipazhit të një anije, duhej të ishte, detyrimisht me shtetësi franceze, nen të cilin shteti Francez nuk e kishte shfuqizuar.

Ky nen i Kodit Detar të Francës, binte në kundërshtim me të drejtën e Bashkimit Evropian, që garanton lirinë e lëvizjes së punonjësve, brenda Shteteve Anëtare dhe për këtë shkak, në vijim të procedurave Komisioni ngriti padi kundër Francës, në bazë të nenit 258 të Traktatit, për zbatim të papërshtatshëm prej saj, të të drejtës së Bashkimit. Shteti Francez nga ana e tij, kundërshtoi padinë e ngritur, duke pretenduar që, ai u kishte dhënë udhëzime, në mënyrë verbale autoriteteve detare, që t'i trajtonin shtetasit e Bashkimit Evropian, si shtetas francez dhe sipas tij, këto udhëzime verbale, ishin të mjaftueshme për zbatimin e të drejtës së Bashkimit.

Në përgjigje të pretendimit të Shtetit Francez, Gjykata e Drejtësisë, në vendimin e saj, ndër të tjera, u shpreh se:

“...40. Duket si nga argumenti i paraqitur para Gjykatës, ashtu edhe nga qëndrimi i mbajtur në seancat parlamentare, gjendja e situatës së tanishme është se, liria e lëvizjes së lirë të punonjësve në sektorin në fjalë, vazhdon të konsiderohet nga autoritetet franceze, jo si një çështje e së drejtës, por sikur varet nga vullneti i tyre i njëanshëm.

41. Si rrjedhim, megjithëse qëndrimi objektiv ligjor është i qartë, do të thotë se, neni 48 i Kodit Detar francez dhe Rregullorja nr. 1612/68 e Komuniteteve Evropiane, jashtë të zbatueshme, drejtpërsëdrejti në territorin e Republikës Franceze, gjithësesi, mbajtja këto rrethana e formulimit të Kodit Detar, çon në një gjendje të paqartë të çështjes dhe kur flitet për ata që janë subjekt i ligjit në fjalë, krijon një

gjendje pasigurie në lidhje me mundësitë që iu jepen atyre për t'u mmbështetur tek e drejta e Komunitetit.

42. Kjo pasiguri vetëm mund të shtohet nga karakteri i brendshëm dhe verbal i udhëzimeve të thjeshta administrative për të mos marrë parasysh zbatimin e së drejtës kombëtare... ”¹⁴⁷

Zbatimi i papërshtatshëm i së drejtës së Bashkimit Evropian ka shërbyer si shkak për nisjen e procedurave nga ana e Komisionit, sidomos në rastet kur, Shtetet Anëtarë janë të detyruar që të zbatojnë një Direktivë të nxjerrë nga institucionet e Bashkimit. Siç është përmendur në këtë punim, në rastin e Direktivave, sipas nenit 288 të Traktatit, Shtetet Anëtare kanë të drejtë që të zgjedhin metodën dhe mjetin e zbatimit të Direktivës, por, kjo nuk i përjashton nga detyrimi që, ata të marrin të gjitha masat për zbatimin e plotë të saj, në legjislacionin kombëtar. Ky fakt është konfirmuar edhe nga Gjykata e Drejtësisë, e cila duke theksuar natyrën e Direktivës, e cila sipas Gjykatës e është një akt juridik i detyrueshëm, vetëm në lidhje me arritjen e rezultatit, duke e lënë në çmim të autoriteteve kombëtare të Shteteve Anëtare, zgjedhjen e mjetit dhe metodës së zbatimit të saj në legjislacionin kombëtar. Megjithatë, kjo nuk i heq të drejtë Gjykatës që të vlerësojë karakterin e përshtatshëm ose jo të metodës së zgjedhur për zbatim, nga Shteti Anëtar.

Në lidhje me këtë fakt, Gjykata e Drejtësisë në çështjen nr. 96/81, Komisioni kundër Holandës, ndër të tjera, është shprehur:

“...Gjithësesi, fakti që në rastin e Direktivës, Shteti ka të drejtë që të zgjedhë vetë mjetin dhe metodën për zbatimin e saj në legjislacionin kombëtar, kjo nuk e çliron atë për t'i dhënë fuqi dispozitive të Direktivës me mjetet e dispozitive kombëtare që kanë karakter detyrues. ... Praktikë e thjeshta administrative, që nga karakteri i tyre mund të ndryshohen sipas dëshirës së administratës, mund të mos konsiderohen sikur përmbajnë përmbushjen e duhur të detyrimit që buron nga Direktiva. ... ”¹⁴⁸

Marrja e masave konkrete legjislative nga ana e Shtetit Anëtar me qëllim transpozimin e një Direktive të Bashkimit Evropian, në legjislacionin kombëtar, nuk është e nevojshme, në qoftë se, në legjislacionin e këtij Shteti, ekzistojnë praktika të konsoliduara dhe objektive ose ekzistojnë parime të përgjithshme të së drejtës në atë Shtet, që e bëjnë nxjerrjen e një akti legjislativ të panevojshëm. Kështu, duke iu referuar një çështjeje konkrete, që kishte të bënte me lirinë e vendosjes së infermiereve në Gjermani, Komisioni ngriti padi kundër Gjermanisë, duke pretenduar se, nuk kishte marrë masat e duhura legjislative, për zbatimin e një Direktive të Bashkimit që garantonte lëvizjen e lirë të punonjësve, në sektorin e infermierisë. Nga ana e tij, Shteti Gjerman, argumentoi para Gjykatës se, marrja e masave të veçanta legjislative, nuk ishte e nevojshme, në këtë rast, pasi në atë Shtet, ekzistonin praktika administrative objektive dhe të njohura, që e garantonin lëvizjen e lirë të infermiereve. Gjykata e Drejtësisë, në vendimin e saj, për këtë çështje, duke e pranuar si të drejtë argumentin e paraqitur nga Gjermania, ndër të tjera, u shpreh se:

“...17. Shteti Gjerman nuk mbron që praktikë e thjeshta administrative, që për shkak të karakterit të tyre mund të ndryshohen, siç i pëlqen apo kur i pëlqen administratës dhe që nuk poullarizohen aq sa duhet, nuk mund të vlerësohen si një

¹⁴⁷ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen gjyqësore 167/73, ECR 359, Komisioni kundër Francës.

¹⁴⁸ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen gjyqësore 96/81, ECR 1791, Komisioni kundër Holandës.

përmbushje e duhur e detyrimit që kanë Shtetet Anëtare, sipas nenit 189 të Traktatit, siç është shprehur vazhdimisht Gjykata. Megjithatë, Shteti në fjalë pretendon se, parimi nuk mund të zbatohet në këtë rast, për shkak se praktika administrative në fjalë, nuk mund të ndryshohet siç i pëlqen apo kur i pëlqen administratës dhe asaj i është dhënë një popullaritet i mjaftueshëm.

...22. Përballë këtyre pikpamjeve të kundërta, Gjykata e rikonsideron të nevojshme të rikujtojë formulimin e paragrafit të tretë të nenit 189 të Traktatit, sipas të cilit një Direktivë është detyruese, përsa i përket rezultatit që duhet të arrihet nga çdo Shtet Anëtar, të cilit ajo i drejtohet, por, zgjedhjen e formave dhe metodave, ua lë autoriteteve kombëtare.

23. Nga kjo dispozitë del se zbatimi i një Direktive nuk kërkon, dosmosdoshmërisht veprim legjislativ në secilin Shtet Anëtar. Në veçanti, ekzistenca e parimeve të përgjithshme të së drejtës kushtetuese apo administrative, mund ta bëjnë nxjerrjen e legjislacionit specifik të panevojshëm, gjithsesi, me kusht që ato parime garantojnë se autoritetet kombëtare do të zbatojnë, në fakt, Direktivën plotësisht dhe se kur Direktiva synon të krijojë të drejta për individët, personat në fjalë do të bëhen plotësisht të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe kur është e përshtatshme, iu jepet mundësia të mbështeten në to, para gjykatave kombëtare. ...”¹⁴⁹

Në vazhdim të studimit të rasteve të praktikës së vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë, që kanë të bëjnë me zbatimin e Direktivave nga ana e Shteteve Anëtare, me interes paraqitet një çështje tjetër, që ka të bëjë me procedurat e nisura nga Komisioni kundër Mbretërisë së Bashkuar, në të cilën Komisioni pretendonte se, Mbretëria e Bashkuar kishte zbatuar, në mënyrë të gabuar, Direktivën e Bashkimit Evropian, që kishte të bënte me Përgjegjësinë ndaj Produkteve. Në këtë çështje, Gjykata, duke pohuar dhe arsyetuar efektin indirekt të Direktivave, argumentoi detyrimin që kanë gjykatat kombëtare, që ta interpretonin ligjin vendas, në përputhje me Direktivat e nxjerra nga Bashkimi Evropian, argument ky që u përdor nga Gjykata për të rrëzuar padinë e ngritur nga Komisioni. Në këtë çështje, Komisioni pretendonte se, Mbretëria e Bashkuar kishte shkelur Direktivën, sepse iu kishte kërkuar gjykatave kombëtare që të interpretonin të drejtën kombëtare, kundër frymës së ligjit vendas, me qëllim që t’i përshtateshin kërkesave të Direktivës. Për këtë pretendim Gjykata u shpreh se, nuk ekzistonte asnjë ndalim ligjor që të parashikonte që gjykatat e Mbretërisë së Bashkuar, nuk duhej ta interpretonin ligjin kombëtar, në përputhje me parashikimet e Direktivës, me qëllim që t’i jepnin fuqi asaj, përkundrazi, gjykatat kombëtare, e kanë detyrim që ta interpretojnë të drejtën e vendit, në përputhje me parashikimet e akteve të Bashkimit Evropian.¹⁵⁰

c) Kur një Shtet Anëtar kryen shkelje që çënon mardhëniet me jashtë të Bashkimit Evropian.

Rasti i tretë kur Komisioni mund të nisë procedurat kundër një Shteti Anëtar për mospërmbushje të detyrimeve, është kur ai Shtet me sjelljen e tij, çënon politikën e jashtme të Bashkimit Evropian. Bashkimi, si një bashkim Shtetesh të Pavarura, si dhe si një organizatë ndërkombëtare “sui generis”, duke iu referuar Traktateve Kushtetuese, mund të konsiderohet edhe subjekt i së drejtës ndërkombëtare, më vehte dhe i pavarur, nga shtetet që bëjnë pjesë në të. Nga ana tjetër edhe Shtetet Anëtare që

¹⁴⁹ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen gjyqësore 29/84, ECR 1661, Komisioni kundër Gjermanisë.

¹⁵⁰ Shih për më tepër: Craig P; De Burca G; “E drejta e Bashkimit Evropian, Tekste, çështje gjyqësore dhe materiale”, botuar nga Qendra e Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2013, faqe 537.

përbëjnë Bashkimin Evropian, janë subjekte më vehte dhe të pavarura të së drejtës ndërkombëtare. Çështja e politikës së jashtme të njësuar dhe të pavarur të Bashkimit Evropian, përballë Shteteve që e përbëjnë atë, si dhe përballë Shteteve të tjera që nuk janë anëtarë të Bashkimit, ka qenë gjithmonë objekt debatesh dhe ndryshimesh ligjore, ndërmjet Shteteve Anëtare. Kjo çështje ka evoluar në kohë, ashtu si edhe vetë Bashkimi, duke shkuar gjithnjë në drejtim të njohjes së një politike të jashtme të pavarur dhe më vehte të Bashkimit, duke përfshirë edhe faktin se, edhe Shtetet Anëtare që përbëjnë Bashkimin, kanë të drejtë që të kenë dhe të bëjnë politikën e tyre të jashtme, po ashtu të pavarur dhe më vehte nga ajo e Bashkimit Evropian.

Por, situata e politikës së sotme të jashtme të Bashkimit Evropian, nuk është ajo që është sot, ajo ka ardhur duke u forcuar, gjithnjë e më shumë, po të kemi parasysh se, në kohën e krijimit të Bashkimit Evropian, i cili, në atë kohë ekzistonte në formën e tre Komuniteteve të ndara, as që bëhej fjalë që të ekzistonte një politikë e jashtme e pavarur dhe më vehte e Bashkimit. Ashtu siç dihet, Traktatet Themeluese kishin si qëllim të tyre fillestar “bashkimin” ekonomik të shteteve të Evropës dhe jo bashkimin politik të saj, ndërsa, sot si pasojë e ndryshimeve, të herëpashershme në këto Traktate, përveç krijimit të një hapësire të vetme ekonomike ndërmjet Shteteve Anëtare, po synohet që t’i jepet Bashkimit, edhe e drejta e përfaqësimit në politikën e jashtme.

Në këto kushte, veprimtaria e Bashkimit Evropian, në fushën e mardhënieve ndërkombëtare po rritet gjithnjë edhe më shumë dhe për këtë arsye edhe Shtetet Anëtare, kanë detyrimin që të respektojnë të drejtat që Traktatet Kushtetuese i kanë dhënë Bashkimit, në këtë fushë. Gjykata Evropiane e Drejtësisë, pikërisht, duke marrë parasysh veprimtarinë në rritje të Bashkimit Evropian, në fushën e mardhënieve ndërkombëtare, është shprehur me disa vendime të saj, mbi bazën e padisë së ngritur nga Komisioni, kundër Shteteve Anëtare, për mospërbushjen e detyrimeve prej tyre, që kanë të bëjnë me politikën e jashtme të Bashkimit. Procedurat ligjore të nisura nga Komisioni në këtë rast, kanë të bëjnë, kryesisht me shkeljen nga ana e Shteteve të detyrimit për bashkëpunim të sinqertë, në fushën e mardhënieve ndërkombëtare, si dhe me shkeljet e bërë nga këto Shtete, me anë të të cilave çënohen objektivat e Bashkimit Evropian, në fushën e politikës së jashtme.

Kështu, në *çështjet gjyqësore Qiejt e Hapur*, Komisioni ngriti padi kundër disa Shteteve Anëtare, pasi ata kishin bërë bisedime dy palëshe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për marrëveshje të transportit arjor ndërkombëtar, pa u konsultuar me parë, me institucionet e Bashkimit Evropian. Në këto padi, Komisioni pretendonte se, Shtetet Anëtare duke u përfshirë në bisedime dy palëshe, për çështje që kishin të bënin me transportin ajror ndërkombëtar, kishin cënuar kompetencat e Bashkimit Evropian që lidhen me politikën e jashtme, pretendim që u vlerësua si i bazuar nga ana e Gjykatës. Në një *tjetër çështje që kishte të bënte me një marrëveshje ndërkombëtare mjedisore, të nënshkruar sipas Konventës së Stokholmit*, Gjykata e Drejtësisë u shpreh se, Suedia kishte shkelur detyrimin për bashkëpunim të sinqertë, pasi ajo kishte bërë një propozim të njëanshëm për të renditur një substancë të caktuar si të rrezikshme për mjedisin, para se Bashkimi Evropian të ishte shprehur në lidhje me këtë çështje. Gjykata në vendimin e saj, duke konstatuar se, kjo çështje përfshihej në fushën e kompetencave të përbashkëta, ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shteteve Anëtare, ndër të tjera, u shpreh se:

*“Një situatë e tillë ka mundësi të dëmtojë parimin e unitetit në përfaqësimin ndërkombëtar të Bashkimit dhe të Shteteve të tij Anëtare, si dhe dobëson fuqinë e tyre për bisedime në lidhje me palët e tjera të interesuar për Konventën”.*¹⁵¹

Në disa çështje të tjera që kanë të bëjnë me disa Shtetet Anëtare, siç janë Holanda, Irlanda, Suedia dhe Austria, nga ana e Gjykatës së Drejtësisë u pranuan paditë e ngritur nga Komisioni, për shkelje që kishin bërë këto Shtete, me anë të të cilave ishte dëmtuar politika e jashtme e Bashkimit. Kështu, konkretisht, Holanda u ndëshkua nga Gjykata për vendosjen e tarifave të larta dhe diskriminuese për lejet e banimit në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Turqinë, ndërsa, Irlanda u ndëshkua pasi ajo nuk pranoi që të aderonte në Konventën e Bernës *“Për të drejtën e autorit”*. Po ashtu, Suedia dhe Austria u ndëshkuan nga Gjykata për shkelje të nenit 351 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, pasi ato nuk kishin përshtatur legjislacionin e tyre të brendshëm, me atë të Bashkimit, për të eliminuar kontraktat që ekzistonin, ndërmjet ligjeve kombëtare dhe dispozitave të Traktatit të Komunitetit Evropian, si dhe ndërmjet ligjeve të brendshme dhe traktatave dy palëshe të investimeve që këto Shtete kishin nënshkruar me Shtetet jo Anëtare, para hyrjes së tyre në Bashkimin Evropian.

ç) Kur një Shtet Anëtar kryen shkelje të lehta, në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme të së drejtës së Bashkimit Evropian apo zbaton praktika të përgjithshme, që vijnë në kundërshtim me këtë të të drejtë.

Rasti i fundit kur Komisioni ka të drejtë që të nisë procedurat për mospërbushje detyrimi, kundër një Shteti Anëtar, është kur ky i fundit, kryen shkelje sistematike dhe të vazhdueshme të së drejtës së Bashkimit Evropian apo zbaton praktika të përgjithshme, që vijnë në kundërshtim me këtë të të drejtë. E drejta e Bashkimit Evropian përbën nga një sistem i gjerë normash ligjore, që fillojnë nga dispozitat që përbëjnë Traktatet Kushtetuese dhe që përbën legjislacioni primar dhe deri të aktet ligjore që nxjerrin institucionet e Bashkimit, siç janë Rregulloret, Direktivat dhe Vendimet, të cilat njihen edhe si legjislacion sekondar, pasi këto akte nxirren në bazë dhe për zbatim të Traktateve Kushtetuese. Fillimi i procedurave të shkeljes nga ana e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, kundër Shteteve Anëtare, sipas kësaj pike bëhet, kryesisht, për shkak se këto Shtete, nuk përmbushin detyrimet e tyre që burojnë nga legjislacioni sekondar, duke kryer shkelje të lehta, por, në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme, të normave që parashikon ky legjislacion.

Po ashtu, fillimi i procedurave sipas kësaj pike nga ana e Komisionit bëhet edhe në rastet kur, Shtetet Anëtare ndjekin praktika të përgjithshme, të cilat bien në kundërshtim me të drejtën e Bashkimit Evropian, pavarësisht nga fakti se, Shteti në fjalë, e ka zbatuar legjislacionin në mënyrën e duhur. Komisioni duke iu referuar shkeljeve të lehta, të kryera në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme të legjislacionin sekondar të Bashkimit, ka ngritur padi kundër Shteteve Anëtare, me qëllim që këto Shtete të ndalojnë kryerjen e shkeljeve të tilla, si dhe të mos i përsërisin më ato në të ardhmen. Gjykata e Drejtësisë nga ana e saj, ka argumentuar se, në rastet e çështjeve të tilla, padia e Komisionit do të pranohet, vetëm në qoftë se, ky i fundit arrin që të sjellë prova të mjaftueshme, të dokumentuara dhe të hollësishme që tregojnë se, Shteti i paditur ka shkelur një ose disa norma të legjislacionit sekondar, ose ka zbatuar praktika të përgjithshme që vijnë në kundërshtim me të drejtën e Bashkimit Evropian. Në një *çështje konkrete kundër*

¹⁵¹ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen gjyqësore C-246/07, ECR 246, Komisioni kundër Suedisë.

Irlandës, të vitit 2005, që ishte çështja e parë që i hapi rrugën Gjykatës për të vendosur në lidhje me çështje të kësaj natyre, Gjykata u shpreh se, një praktikë e përgjithshme administrative, mund të gjykohej se bie në kundërshtim me të drejtën e Bashkimit Evropian, në qoftë se, konstatohet një numër i caktuar shkeljesh të veçanta, gjë që të jep mundësinë që të konkludosh për një shkelje të vazhdueshme dhe të përgjithshme, të kryer nga Shteti i Paditur.

Në këtë çështje, procedimi i Komisionit kundër Irlandës, citonte 12 shkelje të veçanta që lidheshin me hedhjen e mbeturinave, të cilat shkelnin Direktivën e Bashkimit Evropian “Për mbetjet” dhe që sipas Komisionit këto raste të veçanta, tregonin një shkelje të përgjithshme dhe sistematike që Irlanda i bënte kësaj Direktive. Bazuar në këtë argument, Komisioni kërkonte nga Gjykata e Drejtësisë një vendim, jo vetëm për 12 shkeljet e veçanta, por edhe për natyrën e përgjithshme dhe të vazhdueshme të zbatimit jo të plotë të Direktivës nga Irlanda. Kjo e fundit nga ana e saj, kërkoi që Gjykata të shprehej vetëm në lidhje me 12 shkeljet të veçanta dhe të mos arrinte në konkluzione, në lidhje me shkelje të vazhdueshme dhe të përsëritur të Direktivës. Pavarsisht nga pretendimi i Irlandës, Gjykata përkrahu qëndrimin e Komisionit dhe mbi bazën e shqyrtimit të rasteve të veçanta, deklaroi se, Irlanda kishte kryer shkelje sistematike dhe të vazhdueshme të Direktivës së Bashkimit Evropian “Për mbetjet”.¹⁵²

*Për sa i përket barrës së provës, Gjykata u shpreh se, në rastet kur Komisioni kishte sjellë prova të mjaftueshme të rasteve të veçanta për të treguar një praktikë shkeljesh të vazhdueshme dhe sistematike, i binte barra e provës Shtetit të paditur që të vertetonte me prova konkrete, të kundërbën, pra, që sjellja e tij, nuk ishte në kundërshtim me të drejtën e Bashkimit Evropian. Në përputhje me këtë “ndarje” të barrës së provës nga Gjykata, kjo e fundit, në disa raste i ka pranuar paditë e Komisionit kundër Shteteve Anëtare, siç janë çështja gjyqësore C-135/05, Komisioni kundër Italisë, që kishte të bënte me hedhjen e mbeturinave, çështja gjyqësore C-88/07, Komisioni kundër Spanjës, në lidhje me klasifikimin e produkteve mjekësore, çështja gjyqësore C-150/07, Komisioni kundër Portugalisë, në lidhje me pagesën nga burimet e veta nga Bashkimi Evropian, ndërsa, në raste të tjera, Gjykata i ka rrëzuar paditë e Komisionit, siç janë çështja C-335-07, Komisioni kundër Finlandës, në lidhje me trajtimin e ujrave të zeza, çështja nr. C-512/08, Komisioni kundër Francës, në lidhje me rimbursimin e kostove të spitaleve për trajtim mjekësor jashtë shtetit dhe çështja gjyqësore C160/08, Komisioni kundër Gjermanisë, në lidhje me caktimin e praktikës së përgjithshme në një rajon të caktuar.*¹⁵³

Një çështje shumë e diskutueshme ndërmjet studiuesve të së drejtës, është fakti, nëse, Komisioni mund të nisë procedurat kundër një Shteti Anëtar, për mospërmblidhje detyrimi në bërë të nenit 258 të Traktatit për faktin se, gjykatat kombëtare të atij shteti, kanë kryer shkelje të së drejtës së Bashkimit, duke mos zbatuar plotësisht ose duke interpretuar në mënyrë të gabuar, legjislacionin e Bashkimit Evropian. Kjo është një çështje e diskutueshme dhe delikate për faktin se, në sistemet kushtetuese dhe ligjore të Shteteve Anëtare, por, edhe në vetë sistemin kushtetues dhe ligjor të Bashkimit Evropian, është pranuar, në mënyrë solemne, parimi i pavarësisë së sistemit gjyqësor, sipas të cilit, gjykatat janë të pavarur dhe i

¹⁵² Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen gjyqësore C-494/01, ECR 494, Komisioni kundër Irlandës.

¹⁵³ Shih për më tepër: Craig P; De Burca G; “E drejta e Bashkimit Evropian, Tekste, çështje gjyqësore dhe materiale”, botuar nga Qendra e Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2013, faqe 539.

nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjit. Në këto kushte, duke qenë se pushteti gjyqësor i çdo Shteti Anëtar, ka specifika të dallueshme nga pushtetet e tjera, siç është ai legjislativ dhe ekzekutiv, atëherë, është hedhur hije dyshimi në faktin, nëse, Komisioni ka të drejtë që të fillojë procedurat ligjore dhe për pasojë, nëse, Gjykata e Drejtësisë, ka të drejtë që të ndëshkojë Shtetet Anëtare, për një shkelje që ka kryer pushteti gjyqësor i atij Shteti.

Megjithatë, pavarësisht nga këto diskutime, *Gjykata e Drejtësisë është shprehur, në mënyrë të vazhdueshme që, Shtetet Anëtare janë përgjegjës për mospërmbyshjen e detyrimeve edhe në rastet kur, shkeljet kryhen nga ana e gjykatave kombëtare të atyre Shteteve, madje duke i njohur përgjegjësi këto Shtete edhe për dëmet që gjykatat iu kanë shkaktuar individëve, për shkelje të së drejtës së Bashkimit Evropian.* Gjithësesi, duhet pranuar se, edhe pse, nga Gjykata e Drejtësisë, është konkluduar se, Shtetet Anëtare janë përgjegjës për kryerjen e shkeljeve edhe në rastet kur këto shkelje bëhen nga pushteti gjyqësor i tyre, Komisioni, ka hezituuar në shumë raste që, të paraqesë padi kundër Shtetet Anëtare, kur shkeljet pretendohen se janë kryer nga Gjykatat, pikërisht për faktin se, çështja e veprimtarisë së pushtetit gjyqësor të Shteteve Anëtare, është një çështje shumë delikate dhe e diskutueshme.

Nga ana tjetër, edhe pse Komisioni nuk ka preferuar që të ngrejë padi ndaj Shteteve Anëtare, për shkeljet e bëra nga organet gjyqësore të tyre, në një rast konkret, i cili, bëri një zhurmë shumë të madhe mediatike dhe politike në Shtetin Anëtar të paditur, *Komisioni nisi procedurat ligjore kundër Suedisë*, duke dhënë edhe Mendimin e tij të Arsytuar, për faktin se, Gjykata e Lartë e atij Shteti, nuk zbatoi detyrimin për *Referim Paraprak në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë*, konform nenit 267 të Traktatit, pasi mungonin dispozitat ligjore që përcaktonin procedurën e bërjes së Referimeve Paraprake. Edhe pse kjo çështje nuk shkoi në gjyq, pasi Shteti Suedezi, hartoi normat ligjore për zgjidhjen e çështjes, duke miratuar një akt ligjor që përcaktonte procedurën për Referime Paraprake, nga shumica e juristëve të Shtetit Anëtar, nuk u pranua që gjykatat kombëtare suedeze, të kishin shkelur të drejtën e Bashkimit Evropian.¹⁵⁴

Gjatë procesit gjyqësor kundër padive të paraqitura nga Komisioni për mospërmbyshje të detyrimeve, në bazë të nenit 258 të Traktatit, Shtetet e paditura, kanë paraqitur para Gjykatës së Drejtësisë arsye të ndryshme, për të justifikuar mospërmbyshjen nga ana e tyre. Pavarësisht nga arsyet e paraqitura nga Shteti i paditur, në lidhje me shkaqet e mospërmbyshjes së detyrimeve prej tij, Gjykata, në shumicën e rasteve, nuk i ka marrë parasysh ato, pasi sipas saj, *përgjegjësia e Shtetit, në këtë rast, është objektive dhe mjafton që të provohet mospërmbyshja e detyrimit prej tij, dhe nuk kanë rëndësi arsyet apo shkaqet që kanë çuar shtetin në këtë mospërmbyshje.* Një nga arsyet me të shpeshta të përdorura nga Shtetet e paditura për mospërmbyshjen e detyrimeve prej tyre, është, *forca madhore ose "force majeure"*. Ky shkak i mospërmbyshjes së detyrimeve nënkupton që, Shteti i paditur nuk i ka përmbushur detyrimet për fakte dhe rrethana që nuk varen nga vullneti i tij dhe pavarësisht se, ai i ka bërë të gjitha përpjekjet për të përmbushur këto detyrime, ai nuk ka arritur që t'i përmbushë ato, për shkak të këtyre fakteve dhe rrethanave natyrore. Si shembuj të "force majeure", mund të përmendim fenomenet e natyrës si, tërmetet, vullkanet, përmytjet, ngricat, etj.

Arsyeja e mospërmbyshjes së detyrimeve që burojnë nga e drejta e Bashkimit Evropian nga ana e Shtetit të paditur, për shkak të "force majeure", është një nga

¹⁵⁴ U Bernitz; "Controlling Member State Courts under EU Law", 2005.

arsyet e pakta që është marrë parasysh nga Gjykata e Drejtësisë për të përjashtuar nga përgjegjësia Shtetin e paditur, duke rrëzuar padinë e ngritur nga Komisioni.

Por, duhet të kemi parasysh faktin se, jo çdo fakt apo rrethanë që përfshihet brenda konceptit të forcës madhore është pranuar nga Gjykata si arsye e justifikuar për të përjashtuar Shtetin e paditur nga përgjegjësia për mospërmbylljen e detyrimeve. Nga ana e Gjykatës është theksuar se, përveç ekzistencës së rrethanës së forcës madhore, duhet të ekzistojë dhe fakte dhe prova konkrete që tregojnë se, Shteti i paditur i ka bërë të gjitha përpjekjet për përmbylljen e detyrimeve dhe megjithë përpjekjet e tij, ai nuk ka arritur që t'i përmbyllë ato.

Në kuadër të konceptit të forcës madhore nga ana e Gjykatës, në përgjithësi, nuk është pranuar se përfshihen brenda këtij koncepti, fenomenet shoqërore, siç janë trazirat, grevat apo demonstratat që ndodhin brenda një Shteti. Kështu, siç është cituar më lart, Gjykata e gjeti përgjegjës Francën për mospërmbyllje të detyrimeve të saj sipas Traktatit, për lëvizjen e lirë të mallrave bujqësore, duke mos e marrë në konsideratë pretendimin e saj se, ajo nuk e kishte përmbyllur detyrimin e saj për shkak të trazirave të shkaktuara nga fermerët francezë. Ashtu siç theksoi Gjykata, Franca u konsiderua përgjegjëse, për shkak të mos marrjes së masave të përshtatshme për të evituar këto trazira, si dhe për të siguruar lëvizjen e lirë të produkteve bujqësore.

Megjithatë, si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, një fenomen shoqëror, siç ishte sulmi me bombë, i cili kishte krijuar vështirësi të pakapërcyeshme për Shtetin e Paditur, që ai të përmbyllte detyrimet sipas Traktatit, u vlerësua nga Gjykata si forcë madhore, duke e përjashtuar nga përgjegjësia këtë Shtet, pavarësisht se edhe në këtë çështje, Gjykata nuk kishte plotësisht e bindur se sulmi me bombë, përbënte një pengesë të pakapërcyeshme për Shtetin, në kohën e fillimit të procedurave nga Komisioni.¹⁵⁵

Po ashtu, Gjykata nuk ka përfshirë në konceptin e “force majeure”, pretendimet e Shteteve të paditura, sipas të cilëve mospërmbyllja e detyrimeve ka ardhur për shkak të organizimit të saj të brendshëm administrativ, autonomisë që kanë rajonë të ndryshme të shtetit, apo që mospërmbyllja ka ardhur për shkak të veprimtarisë së organeve të pavarura gjyqësore të shtetit. Për të gjitha këto raste, Gjykata është shprehur se, Shteti do të jetë përgjegjës për shkeljen e kryer, nga çdo agjensi e shtetit, veprimi apo mosveprimi i së cilës është shkak për mospërmbylljen e detyrimeve, përfshirë edhe rastet kur shkelja është kryer nga një institucion i pavarur nga pikëpamja kushtetuese, madje edhe kur shkelja është kryer nga persona fizikë privat.

Përveç sa më sipër, nuk janë pranuar si arsye për përjashtimin nga përgjegjësia të Shtetit të paditur, për moszbatimin prej tyre të Direktivave të Bashkimit Evropian edhe pretendimet e tij që mospërmbyllja ka ardhur për shkak të sistemit të brendshëm ligjor të atij Shteti, pasi një nga detyrimet më të rëndësishme dhe të vazhdueshme që ka çdo Shtet Anëtar, është që të përshtasë dhe harmonizojë legjisllacionin e tij të brendshëm, me atë të Bashkimit Evropian. Siç është shprehur edhe Gjykata në disa çështje, “Një Shtet Anëtar nuk mund të përdorë dispozitat, praktikat apo rrethanat ekzistuese të sistemit të tij të brendshëm ligjor, për të

¹⁵⁵ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen gjyqësore 33/69, ECR 93, Komisioni kundër Italisë.

justifikuar mospajtimin me detyrimet dhe afatet kohore që caktohen nga Direktivat e Komunitetit”¹⁵⁶

Një tjetër arsye e përdorur nga Shtetet e paditura para Gjykatës, me qëllim justifikimin e tyre për mospërbushjen e detyrimeve është *mungesa e shkeljes së qëllimshme nga ana e Shtetit*. Në këto raste, Shteti i paditur pranonte para Gjykatës se, nuk kishte përbushur detyrimet ose që kishte bërë shkelje, por, pretendonte se, *shkelja e bërë prej tij nuk ishte e qëllimshme*, dhe për këtë arsye duhet të përjashtohet nga përgjegjësia. Këtë shkak të pretenduar nga Shtetet e paditur për shmangien nga përgjegjësia, Gjykata nuk e ka pranuar, në asnjë rast, duke theksuar, në disa vendime të saj se, pranimi i padisë në bazë të nenit 258 të Traktatit varet nga konstatimi objektiv i mospërbushjes së detyrimeve dhe jo nga fakti i një lloj plogështie apo kundërshtimi nga ana e Shtetit të paditur.¹⁵⁷

Po ashtu, *Gjykata e Drejtësisë nuk ka pranuar si arsye për përjashtimin nga përgjegjësia të Shtetit të paditur pretendimin se, shkelja e kryer është e vogël apo se shkelja e bërë është rezultat i një gabimi të falshëm*. Gjykata i ka hedhur poshtë këto pretendime, pasi sipas saj, në konstatimin e përgjegjësisë së Shtetit për mospërbushjen e detyrimit ose në kryerjen e shkeljes prej tij, rëndësi ka ekzistenca objektive e shkeljes dhe nuk ka rëndësi, nëse, shkelja e kryer është e qëllimshme apo jo apo nëse, ajo ka të bëjë me ndonjë veprim të keq moral nga ana e Shtetit të paditur.

Një arsye tjetër e ngritur nga Shtetet e paditura për të shmangur përgjegjësinë e tyre për mospërbushjen e detyrimeve, është *pretendimi i tyre sipas të cilit akti ose masa e Bashkimit Evropian, ku është bazuar nisja e procedurave nga ana e Komisionit, nuk është e ligjshme*. Ky pretendim i Shteteve të paditura, është hedhur poshtë, me të drejtë, në çdo rast nga ana e Gjykatës, kjo për faktin se, në qoftë se, Shteti i paditur ka pretendime në lidhje me ligjshmërinë e aktit të Bashkimit Evropian, ai duhet të ngrejë padi me objekt anulimin e tij, në bazë të nenit 263 të Traktatit dhe nuk mund të pretendojë paligjshmërinë e tij, në kuadër të padisë së ngritur nga Komisioni kundër këtij Shteti, sipas nenit 258 të këtij Traktati. Pas ngritjes së padisë prej Shtetit të paditur, për anulimin e aktit ose masës ligjore të Bashkimit Evropian, në rast se Gjykata e gjen të bazuar atë, atëherë, padia e ngritur nga Komisioni për mospërbushje detyrimi ndaj këtij Shteti, do të rrëzohej nga Gjykata, për mungesë të bazës ligjore.

Gjykata e Drejtësisë në disa vendime të saj ka hedhur poshtë pretendimet e Shteteve të paditura për paligjshmëri të masës ligjore së Bashkimit Evropian, ku është bazuar procedura nga ana e Komisionit, mbi bazën e të njëjtit arsyetim, sipas të cilit, nëse Shteti i Paditur ka pretendime në lidhje me ligjshmërinë e aktit apo masës ligjore, ai duhet të ngrejë më parë padi me objekt anulimin e aktit, në bazë të nenit 263 të Traktatit. Kështu, në një rast të praktikës gjyqësore që ka të bëjë me *çështjen 226/87, Komisioni kundër Greqisë*, Komisioni kishte konstatuar se, një vit pas miratimit të një Vendimi, në bazë të nenit 90 të Traktatit të Komunitetit Evropian, që deklaronte se legjislacioni grek në fushën e sigurimeve shoqërore të sektorit publik, nuk ishte në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, Greqia pavarësisht marrjes së këtij Vendimi, nuk kishte përshtatur legjislacionin. Në këto kushte, Komisioni nisi procedurat për mospërbushje detyrimesh ndaj Greqisë, në bazë të

¹⁵⁶ Shih për më tepër: Çështjen gjyqësore C-334/08, Komisioni kundër Italisë dhe çështjen gjyqësore C-298/97, Komisioni kundër Spanjës.

¹⁵⁷ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen gjyqësore 301/81, ECR 467, Komisioni kundër Belgjikës.

nenit 169 të Traktatit të Komunitetit Evropian, sot neni 258 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, ndërkohë që Shteti Grek pretendoi që, Vendimi i marrë nga Komisioni dhe që kishte shërbyer si bazë për procedurat e nisura dhe ngritjen e padisë, ishte i paligjshëm. Gjykata e Drejtësisë, duke hedhur poshtë këtë pretendim të Shtetit Grek, në vendimin e saj, ndër të tjera, arsyeton:

“...14. Sisetemi i kompensimeve të caktuar nga Traktati, dallon nga kompensimet që parashikohen në nenet 169 dhe 170, çka e lejon deklarin se një Shtet Anëtar, nuk i ka përmbushur dot detyrimet e tij, si dhe ato që përmbahen në nenet 173 dhe 175, ku lejohet rishqyrtimi gjyqësor i masave të miratuara nga institucionet e Komunitetit apo mosmiratimit të masave të tilla. Ato kompensime kanë objektiva të ndryshme dhe iu nënshtrohen normave të ndryshme. Në mungesë të një dispozite të Traktatit që lejon shprehimisht për të bërë këtë gjë, një Shtet Anëtar nuk mund të kërkojë paligjshmërinë e një Vendimi që i drejtohet atij, si mbrojtje në një padi për një deklarin që ai nuk ka arritur që të përmbushë detyrimet e tij, si rezultat i moszbatimit të atij vendimi. ...”¹⁵⁸

Pavarsisht se, pretendimet e ngritura nga një Shtet i paditur, sipas të cilit masa ligjore ku është bazuar Komisioni, është e paligjshme, në një gjykim me padi mospërmbushje detyrimesh të ngritur nga Komisioni në bazë të nenit 258 të Traktatit, nuk është pranuar nga Gjykata, si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, një pretendimi i tillë mund të pranohet, nëse, masa ligjore ku është bazuar Komisioni për ngritjen e padisë, është me të meta aq të mëdha, sa jo mund të konsiderohet e paqenë ose që nuk ekziston ligjërisht. Po ashtu, pretendimi për paligjshmërinë e masës ligjore, mund të jetë një shkak i arsyeshëm për përjashtimin nga përgjegjësia të Shtetit të paditur edhe në rastet kur, masa ligjore ku është bazuar Komisioni, nuk është një Vendim që i drejtohet Shtetit të paditur, por është një Rregullorë, paligjshmëria e të cilës ishte e pamundur që të konstatohej prej Shtetit të Paditur, para se të ishte ngritur padia nga Komisioni.

Një arsye tjetër e përdorur nga Shteti i paditur para Gjykatës, për të shmangur përgjegjësinë e tij në rast të mospërmbushjes së detyrimeve, është argumenti se, mospërmbushje e tij nuk përbën shkelje, sepse edhe Shtetet e tjera Anëtare kanë kryer të njëjtën shkelje, arsye e cila është e lidhur me parimin e reciprocitetit në të drejtën ndërkombëtare. Ky argument i përdorur nga Shtetet e paditur, nuk është pranuar, në asnjë rast nga Gjykata e Drejtësisë, e cila ka arsyetuar se, *ideja që detyrimi që ka një Shtet Anëtar për të zbatuar të drejtën e Bashkimit Evropian, është një detyrim reciprok, që varet nga fakti nëse kjo e drejtë zbatohet edhe nga Shtetet e tjera Anëtar, është një ide e papramueshme*. Detyrimet që marrin përsipër Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian nga Traktatet Kushtutuese, por edhe nga e drejta e Bashkimit, në tërësi, nuk kushtëzohet nga raporte reciprociteti, as ndërmjet Shteteve Anëtare dhe as ndërmjet tyre dhe Bashkimit, por, këto Shtete janë të detyruar që të përmbushin detyrimet që burojnë nga e drejta e Bashkimit, të cilën ata e kanë pranuar me vullnetin e tyre të lirë, në çdo rast dhe pa asnjë kusht reciprociteti.

Gjykata e Drejtësisë, në lidhje me këtë fakt, që në një çështje të hershme, të vitit 1963, e njohur si *çështja Van Gend en Loos*, e ka dalluar të drejtën e Bashkimit Evropian, si një të drejtë të veçantë, nga format dhe parimet tradicionale të së drejtës ndërkombëtare, në përgjithësi. *Ndërsa, në të drejtën ndërkombëtare, gjejnë zbatim norma dhe parime të tjera, ku, parimi i reciprocitetit, ka një rol qëndror, në të drejtën*

¹⁵⁸ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen gjyqësore 226/87, ECR 3611, Komisioni kundër Greqisë

e Bashkimit Evropian, gjejnë zbatim norma dhe parime të vendosura në Traktatet Kushtetuese, ku, një nga parimet kryesore, është detyrimi i Shteteve Anëtare që të përmbushin detyrimet ligjore që burojnë nga e drejta e Bashkimit dhe ta përshtasin, kurdoherë, sjelljen e tyre, në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian. Për këtë arsye, nga ana e Gjykatës, është hedhur poshtë, në të gjitha rastet, pretendimi i Shtetit të paditur që sjellja e tij, nuk përbën shkelje ligjore, sepse edhe Shtetet e tjera, kanë kryer ose po vazhdojnë të kryejnë të njëjtën shkelje.

4.3. Paditë e ngritura nga një Shtet Anëtar, kundër një Shteti tjetër Anëtar për mospërmbushje të detyrimeve.

Bashkimi Evropian, organizohet dhe funksionon mbi bazën e detyrimeve që kanë Shtetet Anëtare të tij, që të respektojnë normat dhe rregullat ligjore që përbëjnë të drejtën e tij të detyrueshme. Në çështjen “3.1” të Kreut IV të kësaj Teme Doktorature, u trajtua se, në rast se, një ose disa nga Shtetet Anëtare, nuk përmbushin detyrimet që burojnë nga e drejta e Bashkimit Evropian, Komisioni ka të drejtë që të nisë procedurat ligjore me qëllim që ta detyrojë Shtetin në fjalë, që t’i përmbushë këto detyrime. Siç është sqaruar edhe më lart, këto procedura ligjore përfundonin, deri tek padia që kishte të drejtë që të ngrinte Komisioni para Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, kundër Shtetit Anëtar, i cili kryente shkelje ose nuk përmbushte detyrimet që ai kishte marrë përsipër, me vullnetin e tij të lirë, si Shtet Anëtar i Bashkimit Evropian.

Traktatet Kushtetuese, përveç Komisionit, i kanë njohur të drejtën edhe secilit prej Shteteve Anëtare, që të ngrejë padi kundër një Shteti tjetër Anëtar, para Gjykatës së Drejtësisë, kur Shteti paditës, vlerëson se, Shteti i paditur nuk ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga e drejta e Bashkimit Evropian, ose ka kryer një shkelje të kësaj të drejte.¹⁵⁹ Pyetja që shtrohet në këtë rast është: Pse Traktatet Kushtetuese i kanë njohur të drejtën që të ngrejë padi kundër një Shteti Anëtar, për mospërmbushje detyrimesh prej tij, përveç Komisionit edhe secilit prej Shteteve Anëtare? Arsytet pse Traktatet Kushtetuese ia kanë njohur këtë të drejtë edhe Shteteve Anëtare, përveç Komisionit, mendoj se, janë disa, nga të cilat vlerësoj se tre janë më të rëndësishmet. Arsyeja e parë ka të bëjë me faktin se, ashtu siç është trajtuar më lart, Komisioni ka liri të plotë veprimi për të vlerësuar dhe vendosur, nëse, do të nisë procedurat ligjore për mospërmbushje detyrimi, kundër një Shteti Anëtar, në rastet kur ai Shtet ka kryer një shkelje të caktuar. Megjithatë, Komisioni ka liri të plotë për të vlerësuar, nëse do të fillojë procedurat kundër një Shteti Anëtar, kur Shteti në fjalë kryen një shkelje të së drejtës së Bashkimit Evropian, atëherë, Traktatet Kushtetuese kanë parashikuar si një mjet shtesë, të drejtën e çdo Shteti Anëtar, që të ngrejë padi kundër një Shteti tjetër Anëtar, për mospërmbushje të detyrimeve ligjore prej tij, në rastet kur Komisioni edhe pse ka ndodhur shkelja ligjore, ai ka vlerësuar të mos veprojë dhe të mos nisë procedurat ligjore kundër atij Shteti.

Një tjetër arsye se, pse Traktatet Kushtetuese i kanë njohur të drejtën çdo Shteti Anëtar që të ngrejë padi kundër një Shteti tjetër Anëtar, për mospërmbushje të detyrimeve ose për kryerjen e një shkelje ligjore prej tij, është fakti se, mund të ndodhë që shkelja e kryer nga ana e Shtetit Anëtar, përveç cënimit të së drejtës së

¹⁵⁹ Paragrafi i parë i nenit 259 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon: “Një Shtet i cili mendon se një Shtet tjetër Anëtar nuk ka përmbushur një detyrim që rrjedh nga Traktatet mund ta ngrejë çështjen para Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian.”.

Bashkimit Evropian, mund të cënojë edhe interesat e ligjshme të një Shteti ose disa Shteteve Anëtare të Bashkimit. Kur shkelja e kryer nga Shteti Anëtar, prek ose cënon, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, të drejtat dhe/ose interesat e ligjshme të një Shteti tjetër Anëtar, është logjike dhe mëse e arsyeshme që, ky Shtet të kundërveprojë, duke iu drejtuar me padi Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, kundër Shtetit i cili ka cënuar në mënyrë të paligjshme interesat e tij. Në këto raste, interes më të drejtëpërdrejtë për ngritjen e padisë, ka Shteti Anëtar i cënuar, sesa vetë Komisioni, dhe për këtë arsye, Traktatet Kushtetuese i kanë njohur tëdrejtën Shtetit Anëtar, që t'i drejtohet me padi Gjykatës së Drejtësisë, me qëllim që ta detyrojë Shtetin e paditur, të përmbushë detyrimin ose të ndreqë shkeljen e kryer dhe të mos kryejë shkelje të tjera të tilla, në të ardhmen.

Duke iu referuar padive të ngritura nga një Shtet Anëtar, kundër një Shteti tjetër Anëtar, për mospërmbushje detyrimi sipas nenit 259 të Traktatit, konstatohet se, rastet kur është ngritur padi prej tyre, në përgjithësi kanë qenë raste, kur ata kanë vlerësuar se, Shteti i Paditur, me veprimet ose mosveprimet e tij, ka cënuar, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë, të drejtat dhe interesat e tij ose ka dëmtuar interesat e ligjshme të shtetasve të Shteti Paditës. Gjithësesi, duke iu referuar përmbajtjes së kësaj dispozite, nuk është kusht që për ngritjen e kësaj padie, Shteti Paditës, duhet të pretendojë apo të provojë se, mospërmbushja e detyrimit nga ana e Shtetit të Paditur ka, cënuar të drejtat ose interesat e tij, por, kusht është që Shteti Paditës të provojë që, Shteti i Paditur, me veprimet ose mosveprimet e tij, ka cënuar ose ka shkelur një dispozitë ligjore të së drejtës së Bashkimit Evropian.

Një arsye e tretë dhe e fundit, që ka çuar Traktatet Kushtetuese në dhënien e së drejtës Shteteve Anëtare për të ngritur padi kundër një Shteti tjetër Anëtar, për mospërmbushje detyrimesh prej tij, mendoj se, është sigurimi i zbatimit, sa më të plotë dhe efektiv të së drejtës së Bashkimit Evropian. Zbatimi i efektiv i së drejtës së Bashkimit, është një nga misionet bazë të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, e cila sipas nenit 19 të Traktatit të Bashkimit Evropian, ka për detyrë të garantojë “respektimin e ligjit në interpretimin dhe zbatimin e Traktateve”. Por, që Gjykata e Drejtësisë të garantojë zbatimin e plotë dhe efektiv të së drejtës së Bashkimit Evropian, asaj i duhen krijuar kushtet e duhura ligjore dhe praktike, për realizimin e këtij misioni të rëndësishëm kushtetues.

Dhënia e së drejtës çdo Shteti Anëtar për të ngritur padi kundër një Shteti tjetër, në rast se ky i fundit nuk përmbush detyrimet që burojnë nga e drejta e Bashkimit Evropian, duhet parë, pikërisht, si mjet dhe si mundësi, që nga ana e Gjykatës të sigurohet zbatimi i plotë dhe efektiv i kësaj të drejtë. Pavarsisht nga fakti se, një të drejtë të tillë e ka edhe Komisioni, i cili sipas Traktateve Kushtetuese “mbikqyr zbatimin e së drejtës së Bashkimit nën kontrollin e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian”, dhënia e kësaj të drejte edhe secilit prej Shteteve Anëtare, është një garanci më tepër dhe një mundësi e dytë, që nga ana e Gjykatës së Drejtësisë, të garantohet zbatimi i plotë dhe efektiv i së drejtës së Bashkimit Evropian.

Një tjetër çështje që duhet trajtuar me këtë rast, është çështja e interpretimit të saktë dhe të drejtë që duhet t'i bëhet paragrafit të parë të nenit 259 të Traktatit, i cili përcakton se: “Një Shtet Anëtar i cili mendon se një Shtet tjetër Anëtar nuk e ka përmbushur një detyrim që rrjedh nga Traktatet mund ta ngrejë çështjen përpara Gjykatës së Drejtësisë”. Pyetja që shtrohet është: Si duhet interpretuar shprehja “një detyrim që rrjedh nga Traktatet”, në kuptimin e ngushtë të saj, “*stricto sensu*”, apo në kuptimin e gjerë. Domethënë, një Shtet Anëtar, mund t'i drejtohet Gjykatës së Drejtësisë me padi kundër një Shteti tjetër Anëtar, për mospërmbushje të një detyrimi

që rrjedh vetëm nga Traktatet Kushtetuese, apo edhe për mospërbushje të një detyrimi që rrjedh edhe nga legjislacioni sekondar i Bashkimit Evropian, siç janë Rregulloret, Direktivat dhe Vendimet?

Në lidhje me këtë pyetje, përgjigja është se, shprehja “një detyrim që rrjedh nga Traktatet”, duhet kuptuar dhe interpretuar jo në kuptimin e ngushtë të saj, por, në kuptimin e gjerë. Për pasojë *çdo Shtet Anëtar, në bazë të nenit 259 të Traktatit ka të drejtë që të ngrejë padi në Gjykatën e Drejtësisë, kundër një Shteti tjetër Anëtar, për mospërbushje të detyrimeve prej tij, që rrjedhin, jo vetëm nga Traktatet Kushtetuese, por edhe për mospërbushje të detyrimeve, që rrjedhin nga legjislacioni dytësor i Bashkimit Evropian, siç janë Rregulloret, Direktivat dhe Vendimet, si dhe për mospërbushje të detyrimeve që rrjedh nga e gjithë e drejta e Bashkimit Evropian, në tërësi.* Ky interpretim i paragrafit të parë të nenit 259 të Traktatit, është një interpretim që është pranuar, pa asnjë hezitim, nga të gjitha Shtetet Anëtare të Bashkimit, si dhe është një interpretim që është konfirmuar edhe nga Gjykata e Drejtësisë, në të gjitha vendimet e saj që kanë lidhje me këtë çështje.

Ngritja e padisë nga ana e një Shteti Anëtar kundër një Shteti tjetër Anëtar, për mospërbushje prej tij të detyrimeve që burojnë nga e drejta e Bashkimit Evropian, kalon nëpër disa faza, të cilat janë:

a) paraqitja e çështjes nga ana e Shtetit Anëtar në Komisionin Evropian, para se ky Shtet të ngrejë padi në Gjykatën e Drejtësisë kundër Shtetit të Paditur;

b) dhënia mundësi nga ana e Komisionit, secilit prej Shteteve palë në konflikt, si Shtetit Paditës dhe Shtetit të Paditur, që të paraqesin pretendimet dhe prapsimet e tyre, si dhe provat përkatëse, në lidhje me objektin e mosmarrëveshjes;

c) nxjerrja nga ana e Komisionit të një Mendimi të Arsytuar, me anë të të cilit propozon zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve dhe

ç) ngritja e padisë nga ana e Shtetit Paditës, në Gjykatën e Drejtësisë, kundër Shtetit të Paditur.

Një mosmarrëveshje që ka lindur ndërmjet dy Shteteve Anëtare, Paditës dhe të Paditur, nuk kalon, detyrimisht nëpër të gjitha fazat e përmenduar më lart, para se Shteti Paditës të ngrejë padi në Gjykatën e Drejtësisë kundër Shtetit të paditur. Nga fazat e cituara vetëm faza e parë dhe faza e dytë, duhet të kalohen detyrimisht, para se Shteti Paditës t'i drejtohet me padi Gjykatës kundër Shtetit të Paditur, me objekt mospërbushjen e detyrimeve prej tij, në bazë të nenit 259 të Traktatit. Po ashtu, mosmarrëveshjet e lindura ndërmjet dy Shteteve Anëtare, nuk përfundojnë të gjitha me ngritjen e padisë para Gjykatës, pasi një pjesë e mirë e tyre, ka mundësi që të zgjidhen me pajtim ndërmjet palëve, gjatë fazës së dytë dhe fazës së tretë të procedurës, duke mos shkuar deri tek ngritja e padisë në Gjykatë.

Madje, mund të themi se, kjo ka qenë edhe arsyeja bazë, që neni 259 i Traktatit ka parashikuar që, para se Shteti Anëtar të ngrejë padi kundër një Shteti tjetër Anëtar, për mospërbushje të detyrimeve prej tij, Shteti Paditës duhet që t'i drejtohet më parë Komisionit dhe ky i fundit iu jep të drejtë palëve që të paraqesin kundërshtimet dhe prapsimet e tyre, në lidhje me objektin e mosmarrëveshjes. Pas dhënies mundësi për të paraqitur qëndrimet e tyre, për mosmarrëveshjen në fjalë, Komisioni ka të drejtë, por, jo detyrim që të nxjerrë një Mendim të Arsytuar, me anë të të cilit, iu propozon palëve zgjidhjen e çështjes me pajtim. Nëse, edhe pas nxjerrjes së Mendimit të Arsytuar nga Komisioni, palët nuk arrijnë që të zgjidhin mosmarrëveshjen, atëherë, Shteti Paditës ka të drejtë që të ngrejë padi para Gjykatës së Drejtësisë, për mospërbushje të detyrimeve që rrjedhin nga e drejta e Bashkimit Evropian.

Më sipër përmenda fazat nëpër të cilat, zakonisht, kalon procedura e ngritjes së padisë së një Shteti Anëtar, kundër një Shteti tjetër Anëtar, për mospërmbyshje të detyrimeve prej tij. Duke i krahasuar këto faza të procedurës së ngritjes së padisë nga një Shtet Anëtar, në bazë të nenit 259 të Traktatit, me fazat e procedurës ligjore të ndjekur nga Komisioni, kundër një Shteti Anëtar për mospërmbyshje të detyrimeve, në bazë të nenit 259 të Traktatit, konstatojmë se ka ndryshime, ndërmjet këtyre fazave të procedurave. *Ndryshimi i parë ka të bëjë me faktin se, tek procedura e ngritjes së padisë nga një Shtet Anëtar, kundër një Shteti tjetër Anëtar, mungon faza informale, e cila është faza e parë e procedurës së ndjekur nga Komisioni, kundër një Shteti Anëtar, fazë që është shumë e rëndësishme dhe që praktika ka treguar se, rreth 68 për qind e çështjeve të ngritura nga Komisioni kundër një Shteti Anëtar, është mbyllur në këtë fazë. Një ndryshim tjetër është se, fazat e parashikuara në procedurën e ndjekur nga Komisioni, kundër një Shteti Anëtar, janë të detyrueshme që të kalohen të gjitha nga palët në mosmarrëveshje dhe mosrespektimi i një faze, bën që të mos kalohet në fazën tjetër, si dhe pengon ngritjen e padisë nga ana e Komisionit kundër Shtetit të Paditur. Në ndryshim nga kjo, fazat e procedurës së padisë së ngritur nga një Shtet Anëtar, kundër një Shteti tjetër Anëtar, nuk është e detyrueshme që të kalohen të gjitha, duhet që të kalohet detyrimisht faza e parë dhe fazë e dytë, ndërsa faza e tretë, nuk është e detyrueshme që të kalohet dhe padia nga një Shtet Anëtar kundër një Shteti tjetër Anëtar, mund të ngrihet edhe pa nxjerrejen e Mendimit të Arsytuar nga ana e Komisionit.*

*Faza e parë nëpër të cilën duhet të kalojë procedura e ngritjes së padisë së një Shteti Anëtar kundër një Shteti tjetër Anëtar, për mospërmbyshje të detyrimeve prej tij, është ngritja e çështjes nga ana e këtij Shteti para Komisionit.*¹⁶⁰ Kjo fazë duhet detyrimisht të kalohet nga ana e Shtetit Anëtar, para se ai të ngrejë padi në Gjykatën e Drejtësisë, kundër Shtetit tjetër Anëtar dhe mosrespektimi i kësaj faze, bën që padia e ngritur nga Shteti Anëtar, të deklarohet e papranueshme nga Gjykata, për mosrespektim të procedurave ligjore.

Në Traktatet Kushtetuese, nuk është parashikuar as procedura dhe as forma apo mënyra, sesi Shteti Anëtar duhet që ta paraqesë çështjen në Komision, për mospërmbyshjen e detyrimeve nga një Shtet Anëtar, para se ai t'i drejtohet me padi Gjykatës së Drejtësisë. Në lidhje me këtë çështje, praktika ka treguar se, Shteti Anëtar për ngritjen e çështjes para Komisionit, i është drejtuar me një *Letër Zyrtare* ose me një *Njoftim Zyrtar* Komisionit, në të cilën Shteti në fjalë, ka pasqyruar, me hollësi, shkeljen ligjore ose mospërmbyshjen e detyrimit nga Shteti tjetër Anëtar, duke treguar edhe dispozitat konkrete ligjore të shkelura nga Shteti i Paditur, si dhe duke paraqitur edhe provat përkatëse, kur një gjë e tillë është e mundur.

Letra Zyrtare apo Njoftimi Zyrtar që Shteti Anëtar i dërgon Komisionit, për shkeljen ligjore të kryer nga një Shtet tjetër Anëtar, është e njëjtë, në formë dhe përmbajtje me Letrën Zyrtare apo Njoftimin Zyrtar, që Komisioni i dërgon Shtetit Anëtar, në rastet kur Komisioni ka filluar procedurën ligjore për mospërmbyshje të detyrimeve nga ai Shtet, në bazë të nenit 258 të Traktatit. Për këtë arsye, ajo çfarë është thënë për kërkesat që duhet të plotësojë Letra Zyrtare e Komisionit, kur ajo i drejtohet një Shteti Anëtar, vlen edhe për Letrën Zyrtare që Shteti Anëtar i dërgon Komisionit për mospërmbyshje të detyrimeve nga një Shtet tjetër Anëtar dhe që të

¹⁶⁰ Paragrafi i dytë i nenit 259 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian parashikon: “Përpara se Shteti Anëtar të ngrejë padi kundër një Shteti tjetër Anëtar për një shkelje të dyshur detyrimi që rreth nga Traktatet, ai e ngre këtë çështje para Komisionit”.

mos bie në përsëritje, nuk do të trajtohen, me hollësi edhe në këtë çështje. Ajo që ka rëndësi të theksohet është fakti se, Letra Zyrtare që Shteti Anëtar i dërgon Komisionit, për mospërmbyllje të detyrimeve nga një Shtet tjetër Anëtar, duhet të përmbajë të njëjtat elementë dhe të përmbushë të njëjtat kërkesa, si Letra Zyrtare që Komisioni i dërgon një Shteti Anëtar, për mospërmbylljen e detyrimeve prej tij.

Pavarsisht se, në këtë çështje, siç u tha më lart, për shkak të mos rënies në përsëritje, nuk do të trajtohen, me hollësi të gjitha kërkesat që duhet të plotësojë Letra Zyrtare ose Njoftimi Zyrtar, që Shteti Anëtar i drejton Komisionit për mospërmbyllje të detyrimeve nga një Shtet tjetër Anëtar, edhe në këtë çështje, e çmoj me vend të theksoj që, *në këtë Letër Zyrtare, nga ana e Shtetit Anëtar, duhet të tregohen të gjitha faktet, rrethanat dhe shkeljet që ai mendon se, ka kryer Shteti tjetër Anëtar. Kjo paraqet një rëndësi të madhe, sepse, në vijim të procedurës së mëtejshme, deri tek ngritja e padisë, nga ana e Shtetit Akuzues, nuk mund të ngrihen apo të pretendohen fakte apo shkelje të reja, të cilat nuk janë saktësuar dhe argumentuar që në Letrën Zyrtare.* Në përputhje me parimin e kontradiktoritetit, Shteti i Paditur, ka të drejtë që të mbrohet dhe të paraqesë prapsimet dhe kundërshtimet e tij, vetëm për ato fakte dhe rrethana që janë pretenduar nga Shteti Paditës në Letrën Zyrtare, që ky i fundit i ka dërguar Komisionit dhe jo edhe për fakte dhe rrethana të reja, që mund të pretendohen nga Shteti Paditës, pas dërgimit të Letrës Zyrtare. Po ashtu, në përputhje me parimin e disponibilitetit, Shteti Paditës, mund t'i pakësojë kërkimet dhe pretendimet e tij dhe t'i vijojë procedurat apo të ngrejë padi në Gjykatë, për fakte dhe shkelje që janë më të vogla në numër apo në rëndësi se, faktet e pretenduara në Letrën Zyrtare, por, nuk mund t'i shtojë kërkimet e tij, pas dërgimit të Letrës Zyrtare.

Faza e dytë e procedurës së ngritjes së padisë së një Shteti Anëtar kundër një Shteti tjetër Anëtar, për mospërmbyllje të detyrimeve nga këtij të fundit, është Njoftimi që iu bën Komisioni, si Shtetit Paditës, ashtu edhe Shtetit të Paditur që ata të paraqesin pretendimet, prapsimet, argumentet dhe kundërshtimet e tyre në lidhje me Letrën Zyrtare, si dhe në lidhje me argumentet që paraqet secila prej palëve në mosmarrëveshje. Njoftimi që Komisioni i bën Shtetit Paditës dhe Shtetit të Paditur, për Letrën Zyrtare dhe mosmarrëveshjen e lindur ndërmjet dy Shteteve Anëtare, është një akt zyrtar, në të cilin Komisioni duhet të pasqyrojë të gjitha faktet dhe rrethanat, si dhe provat e paraqitura të pretenduara nga Shteti Paditës. Ky Njoftim Zyrtar, është veçanërisht i rëndësishëm për Shtetin e Paditur, pasi ky Shtet, nuk është, fare në dijeni të objektit të mosmarrëveshjes dhe vihet në dijeni për pretendimet dhe argumentet e Shtetit Paditës, që kanë të bëjnë me mospërmbylljen e detyrimeve prej tij, vetëm me anë të Njoftimit Zyrtar që Komisioni i dërgon Shtetit të Paditur. Në Njoftimin e tij Zyrtar, Komisioni i dërgon Shtetit të Paditur, përveç një përmbledhje të fakteve dhe shkeljeve që pretendohen nga Shteti Paditës, edhe një kopje të Letrës Zyrtare që Shteti Paditës i ka dërguar Komisionit, në të cilën janë të pasqyruara, me hollësi, të gjitha argumentet, faktet dhe provat që tregojnë mospërmbylljen e detyrimit nga ana e Shtetit të Paditur, duke treguar edhe dispozitat konkrete të ligjit të shkelur prej tij.

Me marrjen prej Komisionit të Njoftimit Zyrtar nga Shteti i Paditur, ky i fundit ka të drejtë që të ketë një afat të caktuar që të përgatisë mbrojtjen e tij, si dhe të paraqesë prapsimet, kundërshtimet dhe argumentet e tij, për shkeljen e pretenduar se ai ka kryer. Se sa do të jetë ky afat që Shteti i Paditur duhet të ketë, me qëllim që të përgatisë mbrojtjen e tij, si dhe të paraqesë prapsimet dhe kundërshtimet e tij, kjo nuk është përcaktuar në Traktatet Kushtetuese dhe as në ndonjë normë tjetër ligjore të së drejtës së Bashkimit Evropian dhe për këtë arsye, kjo varet, rast pas rasti, në varësi nga rrethanat e çështjes, nga vështirësia e çështjes dhe nga lloji i shkeljes. E

rëndësishme është që, Shtetit të Paditur t'i lihet një afat i arsyeshëm që të përgatisë mbrojtjen e tij dhe të paraqesë argumentet e tij, kundër shkeljes së pretenduar se ai ka kryer, në të kundërt, nuk mund të vijojë më tej procedura dhe Shteti Paditës, nuk mund të ngrejë padi në Gjykatë kundër Shtetit të Paditur, pasi kjo padi do të vlerësohej si e papranueshme nga Gjykata, për mosrespektim të procedurave.

Njoftimi Zyrtar që dërgon Komisioni për palët në mosmarrëveshje, ka rëndësi edhe për Shtetin Paditës, dhe për këtë fakt i dërgohet edhe këtij të fundit, sepse edhe pse ky i fundit e di objektin e mosmarrëveshjes, në kushtet kur procedura është filluar prej tij dhe është ai që më mirë se kushdo tjetër, i di rrethanat dhe faktet e çështjes, ky Njoftim i tregon këtij Shteti që, Komisioni ka filluar procedurën ligjore sipas nenit 259 të Traktatit, si dhe e fton atë që të bëhet gati që të paraqesë argumentet e veta, kundër prapsimeve dhe kundërshtimeve që mund të bëjë Shteti i Paditur për shkeljet e pretenduara. Në vijim të procedurës ligjore, që paraprin mundësinë e ngritjes së padisë nga ana e Shtetit Paditës, ky i fundit, përveç Letrës Zyrtare të dërguar Komisionit, për shkeljet e pretenduara të kryera nga Shteti i Paditur, ka të drejtë që t'i përgjigjet Shtetit të Paditur për prapsimet dhe kundërshtimet e paraqitura prej tij, por, nuk është i detyruar që ta bëjë një gjë të tillë, ashtu si edhe Shteti i Paditur ka të drejtë që të paraqesë prapasimet dhe kundërshtimet e tij, në lidhje me Letrën Zyrtare të Shtetit Paditës, por, nuk është i detyruar që përgjigjet, me çdo kusht, kësaj Letre.

Shteti i Paditur me marrjen e Letrës Zyrtare nga ana e Komisionit, nëse dëshiron, paraqet kundërshtimet, argumentet dhe provat përkatëse, që tregojnë se, sipas tij, nuk ka kryer shkelje dhe se, pretendimet e Shtetit Paditës, janë të pabazuara. Kundërshtimet dhe argumentet e veta Shteti i Paditur, sipas Traktateve Kushtetuese, mund t'i paraqesë me shkrim ose me gojë, megjithëse, fillimisht preferohet që argumentet nga palët të paraqiten me shkrim dhe më pas të bëhet sqarime të mundshme, me gojë nga secila prej tyre. Në respektim të parimeve të disponibilitetit dhe të kontradiktoritetit, Shteti i Paditur, mund të paraqesë argumentet dhe kundërshtimet e tij, vetëm brenda kufijëve të objektit të mosmarrëveshjes dhe vetëm për ato fakte dhe shkelje që pretendohen nga Shteti Paditës dhe jo edhe për fakte dhe rrethana, që nuk janë pretenduar nga ky i fundit në Letrën Zyrtare që ai i ka dërguar Komisionit.

Pavarsisht se, nga përmbajtja e nenit 259 të Traktatit, nuk rezulton e shprehur në mënyrë të qartë, mendoj që, pretendimet dhe kundërshtimet e tyre, me shkrim dhe/ose me gojë që palët kanë në lidhje me objektin e mosmarrëveshjes, nuk duhet t'ia drejtojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë njëra-tjetrës, por, duhet që t'ia drejtojnë Komisionit dhe ky i fundit t'ia njoftojë më pas secilës palë. *Komisioni luan në këtë rast rolin e një Ndërmjetësi dhe duhet të ketë të gjitha cilësitë për të qenë i tillë, duke u treguar i paanshëm dhe asnjans ndërmjet palëve, por, edhe duke ofruar shërbimet e tij, me qëllimin e mirë, që palët ta zgjidhin me pajtim mosmarrëveshjen ndërmjet tyre.* Roli i Komisionit si “ndërmjetës”, në mosmarrëveshjen e lindur ndërmjet Shteteve Anëtare, rezulton, në mënyrë të tërthortë, nga paragrafi i tretë i nenit 259 të Traktatit, që i ka dhënë të drejtë Komisionit, që të nxjerrë një Mendim të Arsyetuar, në të cilin, pasqyrohet objekti i mosmarrëveshjes, pretendimet dhe prapsimet e palëve, si dhe jepen sugjerime konkrete për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjes.

Nëse gjatë fazës së “ndërmjetësimit” të realizuar nga Komisioni, Shteti i Paditur shfrytëzon të drejtën duke paraqitur para Komisionit, me shkrim dhe/ose me gojë, prapsimet dhe argumentet e tij, në lidhje me shkeljet e pretenduara nga Shteti Paditës, edhe ky i fundit ka të drejtë që të paraqesë argumentet e tij, në lidhje me prapsimet dhe kundërshtimet e Shtetit të Paditur. Kuptohet se, në këtë rast, edhe

Shtetit Paditës duhet që t'i lihet një afat i arsyeshëm, në varësi nga rëndësia dhe rrethanat e çështjes, brenda të cilit ai të njihet me prapsimet dhe kundërshtimet e Shtetit të Paditur dhe më pas, të paraqesë edhe ai argumentet e tij. Shteti Paditës, po ashtu si Shteti i Paditur, duhet që argumentet e tij për prapsimet dhe kundërshtimet e Shtetit të Paditur, duhet t'i paraqesë brenda çështjeve dhe fakteve që janë ngritur prej këtij të fundit dhe nuk mund të japë argumente që tejkalojnë prapsimet e Shtetit të Paditur dhe as nuk mund të shtojë apo të ngrejë pretendime të reja, të cilat nuk kanë qenë ngritur në Letrën Zyrtare që ai i ka drejtuar Komisionit.

Një tjetër çështje që shtrohet, përsa i përket fazës së procedurës që ka të bëjë me dhënien e mundësisë palëve që të paraqesë, secila prej tyre para Komisionit, me shkrim dhe me gojë, argumentet dhe pretendimet e tyre për objektin e mosmarrëveshjes, është fakti sesa, duhet të zgjasë në kohë, kjo fazë e procedurës. Në lidhje me këtë çështje, në Traktatet Kushtetuese apo në ndonjë normë tjetër të së drejtës së Bashkimit nuk është parashikuar ndonjë afat i caktuar, brenda të cilës palët duhet që të japin argumentet dhe pretendimet e tyre për mosmarrëveshjen e lindur ndërmjet tyre, kjo sepse, një gjë e tillë varet nga një sërë faktorësh, siç janë rëndësia e shkeljes së pretenduar, numri i fakteve dhe rrehanave të çështjes, natyra e mosmarrëveshjes, koha që është e nevojshme që Shteti i Paditur të ndreqë shkeljen e pretenduar etj.

Megjithatë, pavarësisht nga fakti se, në Traktatet Kushtetuese nuk është parashikuar, në mënyrë të shprehur, ndonjë afat konkret për realizimin e fazës së paraqitjes së pretendimeve dhe prapsimeve të palëve, nga interpretimi që i bëhet paragrafit të katërt të nenit 259 të Traktatit, mund të konstatohet, në mënyrë të tërthortë se, afati për realizimin e kësaj faze të komunikimit të ndërsjellë ndërmjet palëve, është deri në tre muaj. Paragrafi i katërt i kësaj dispozite i ka njohur të drejtën Komisionit, që të nxjerrë një Mendim të Arsyetuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet Shteteve Anëtare, duke përcaktuar se, nëse, Komisioni nuk e nxjerr këtë Mendim brenda një periudhe prej 3 muajash, Shteti Paditës ka të drejtë që të ngejë padia në Gjykatën e Drejtësisë, kundër Shtetit të Paditur për mospërmbushje të detyrimeve prej tij. Duke u nisur nga ky parashikim ligjor mund të interpretojmë se, përderisa Traktatet Kushtetuese i kanë njohur të drejtën Komisionit që të nxjerrë një Mendim të Arsyetuar, brenda 3 muajve nga paraqitja e çështjes para, tij, atëherë edhe faza e paraqitjes së pretendimeve, prapsimeve dhe argumenteve ndërmjet Shteteve në mosmarrëveshje, duhet që të jetë deri në 3 muaj. Gjithësesi, ky është një interpretimi i zgjeruar që i bëhet paragrafe tre dhe katër të nenit 259 të Traktatit dhe përderisa nga kjo dispozitë nuk është parashikuar, në mënyrë të shprehur, afati brenda të cilit palët duhet të përfundojnë paraqitjen e pretendimeve dhe prapsimeve për çështjen objekt mosmarrëveshje, duhet të pranohet që, ky afat është me natyrë këshilluese dhe jo detyruese, si dhe ai mund të jetë edhe më i gjatë se 3 muaj, në varësi të rrethanave, natyrës dhe vështirësisë së mosmarrëveshjes, por që në çdo rast, duhet të jetë një afat i arsyeshëm.

Nëse mosmarrëveshja e lindur ndërmjet Shtetit Paditës dhe të Paditur nuk zgjidhet me pajtim, gjatë fazës së paraqitjes së pretendimeve dhe prapsimeve të tyre, atëherë procedura mund të kalojë në fazën e tretë, e cila është faza e nxjerrjes së një Mendimi të Arsyetuar nga ana e Komisionit.¹⁶¹ Themi se, procedura mund të kalojë

¹⁶¹ Paragrafi i tretë i nenit 259 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

në fazën e tretë, atë të xjerrjes së Mendimit të Arsyetuar dhe jo që *procedura kalon* në fazën e tretë, *pasi neni 259 i Traktatit i ka njohur si të drejtë dhe jo si detyrim Komisionit, që të nxjerrë një Mendim të Arsyetuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve*. Nxjerrja e Mendimit të Arsyetuar nga Komisioni, në këtë rast, është një kompetencë ekskluzive e tij, është në vlerësimin e lirë dhe të plotë dhe në vullnetin e tij, që të nxjerrë apo jo këtë Mendim dhe as Shtetet palë në mosmarrëveshje dhe as ndonjë institucion i Bashkimit Evropian, nuk mund ta detyrojë Komisionin që të nxjerrë Mendimin e Arsyetuar, jashtë vullnetit të tij.

Nisur nga fakti që, Komisioni është i lirë që, sipas vullnetit të tij, të nxjerrë apo jo Mendimin e Arsyetuar për zgjidhjen e çështjes ndërmjet palëve, konstatohet se, kjo fazë e procedurës është fakultative dhe jo e detyrueshme për Shtetin Anëtar. Kjo nënkupton se, Shteti Anëtar mund të ngrejë padinë në Gjykatën e Drejtësisë, kundër një Shteti tjetër Anëtar, për mospërmbushje të detyrimeve prej tij edhe pa e kaluar këtë fazë, pra, edhe pa nxjerrjen e Mendimit të Arsyetuar nga ana e Komisionit. Kuptohet se, nëse Komisioni e nxjerr Mendimin e Arsyetuar, Shteti Paditës duhet ta kalojë detyrimisht këtë fazë, me të gjitha rregullat dhe afatet që përmban ajo dhe më pas të ngrejë padinë, kundër Shtetit të Paditur, nëse, ai e vlerëson për ta bërë një gjë të tillë. Por, nga ana tjetër, mosnxjerrja e Mendimit të Arsyetuar nga ana e Komisionit, nuk e pengon Shtetit Paditës, që të ngrejë padi për mospërmbushje të detyrimeve nga Shteti i Paditur dhe për këtë shkak themi se, kjo fazë e procedurës, nuk është e detyrueshme, por është fakultative, në varësi të faktit, nëse, Komisioni vlerëson që ta nxjerrë ose jo, Mendimin e Arsyetuar për zgjidhjen e çështjes.

Kur Komisioni vlerëson të nxjerrë një Mendim të Arsyetuar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, ndërmjet Shteteve Anëtare dhe e nxjerr atë, ky Mendim përbën një akt të rëndësishëm zyrtar të Komisionit, i cili, i drejtohet si Shtetit Paditës, ashtu edhe Shtetit të Paditur. Mendimi i Arsyetuar i Komisionit, duhet të përmbajë objektin e mosmarrëveshjes ndërmjet palëve, faktet dhe rrethanat që përbëjnë shkeljen e pretenduar, si dhe aragumentet e secilës palë në mosmarrëveshje. *Në këtë Mendim, Komisioni duhet që të pasqyrojë edhe propozimet konkrete që ai mendon për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me pajtim ndërmjet palëve, para se çështja të shkojë në Gjykatën e Drejtësisë.*

Pas njohjes me Mendimin e Arsyetuar të Komisionit, secila nga palët, Shteti Paditës dhe ai i Paditur, por sidomos ky i fundit, sepse, këtij Shteti mund t'i kërkohen ndërmarrja e veprimeve të caktuara për ndreqjen e shkeljes, duhet t'u lihet një periudhë e arsyeshme që të vlerësojnë, nëse, janë dakort me propozimet e bëra nga Komisioni për zgjidhjen me pajtim të çështjes, si dhe nëse Shteti i Paditur, përveç kësaj, nëse, ai është dakort që të kryejë veprimet që i kërkohen për ndreqjen e shkeljes së pretenduar. Për Shtetin e Paditur, periudha pas vënies në dijeni për Mendimin e Arsyetuar të Komisionit, i shërben atij, për të vlerësuar, nëse, është apo dakort apo jo me këtë Mendim, si dhe nëse, ai do të kryejë veprimet që mund t'i jenë propozuar nga Komisioni në këtë Mendim, për ndreqjen e shkeljes dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me pajtim, pa qenë nevoja për t'iu drejtuar me padi Gjykatës së Drejtësisë. Por, kjo periudhë i shërben edhe Shtetit Paditës, për të vlerësuar edhe ai, nëse, është dakort që me kryerjen e veprimeve nga Shteti i Paditur të propozuara nga Komisioni, në Mendimin e Arsyetuar, ai e konsideron të zgjidhur mosmarrëveshjen

"Komisioni nxjerr një Mendim të Arsyetuar pasi i ka dhënë secilit prej Shteteve në fjalë mundësinë që të paraqesin argumentet e tyre dhe komentet e tyre për argumentet e palës tjetër, me gojë dhe me shkrim".

me pajtim, apo ai nuk është dakort me propozimet e paraqitura nga Komisioni dhe për këtë shkak, zgjidhja me pajtim e mosmarrëveshjes nuk do të ndodhë, edhe sikur Shteti i Paditur, t'i kryejë veprimet e propozuara nga Komisioni, në Mendimin e tij të Arsytuar.

Në Traktatet Kushtetuese nuk është përcaktuar, sesa është periudha brenda të cilës Shtetet palët në mosmarrëveshje, duhet që të njihen me Mendimin e Arsytuar të Komisionit dhe më pas, ata të veprojnë në përputhje me propozimet e paraqitura në këtë Mendim. Kjo është një çështje më rëndësi dhe mendoj se duhej të ishte parashikuar në Traktatet Kushtetuese, pasi duke qenë se jemi në një procedurë që duhet të zbatohet nga Shteti Anëtar, para se ai të paraqesë padi në Gjykatën e Drejtësisë, kjo periudhë duhet të ishte përcaktuar me një afat maksimal, pasi nuk mundet që Shteti Paditës, të presë për një kohë të gjatë apo për një afat të pacaktuar, nëse, Shteti i Paditur do të reagojë dhe do të jetë dakort me propozimet e paraqitura nga Komisioni në Mendimin e tij të Arsytuar.

Por, nga ana tjetër, *edhe pse në Traktatet Kushtetuese nuk është përcaktuar një kufij kohor, brenda të cilës palët në mosmarrëveshje, duhet të shprehen, nëse, janë dakort me zgjidhjen e çështjes sipas propozimeve të bërë nga Komisioni në Mendimin e tij të Arsytuar, është e kuptueshme që, kjo periudhë nuk mund të zgjasë pa fund, por, duhet të pranohet se, palët kanë detyrimin për t'u shprehur, nëse, janë dakort me Mendimin e Arsytuar dhe se do të kryejnë veprimet ose mosveprimet e propozuara nga ky akt, brenda një afati të arsyeshëm.* Se sa do të jetë, konkretisht ky afat, varet nga një sërë faktorësh, si natyra e mosmarrëveshjes, rëndësia e saj, koha që është e nevojshme që Shteti i Paditur të kryejë veprimet ose mosveprimet për ndreqjen e shkëljes, koha e nevojshme për shmangien e pasojave të dëmshme të ardhura, si dhe nga rrethanat, në tërësi, të çështjes. Me rëndësi është fakti, që edhe pse ky afat, nuk është përcaktuar konkretisht, ai duhet të jetë një afat i arsyeshëm dhe për pasojë, nuk mund të jetë as shumë i shkurtër, duke dëmtuar kështu interesat e Shtetit të Paditur, por as shumë i gjatë dhe për më tepër nuk mund të zgjasë pa fund, sepse, në këtë mënyrë, dëmtohen interesat e Shtetit Paditës, por edhe interesat e përgjithshme publike të së drejtës së Bashkimit Evropian.

Kur Komisioni nxjerr një Mendim të Arsytuar, me anë të të cilit u ofron palëve zgjidhjen e mosmarrëveshjes me pajtim dhe palët, qoftë Shteti Paditës, qoftë Shteti i Paditur ose dhe të dy në të njëjtën kohë, nuk janë dakort me këtë Mendim, atëherë, procedura kalon në fazën e fundit që është ngritja e padisë nga Shteti Paditës, kundër Shtetit të Paditur në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë, me qëllim që të detyrohet Shteti i Paditur që të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga e drejta e Bashkimit Evropian. Çështja, nëse, Shteti Paditës do të ngrejë apo jo padi kundër Shtetit të Paditur, me objekt detyrimin e këtij të fundit që të përmbushë detyrimet e parashikuara nga ligji, është një çështje që është në vlerësimin e lirë dhe të plotë të këtij Shteti dhe asnjë Shtet tjetër dhe as Komisioni apo ndonjë institucion tjetër i Bashkimit, nuk mund të ndërhyjnë në vullnetin e Shtetit, për ngritjen ose jo të padisë prej tij. Në vlerësimin e çështjes së ngritjes së padisë kundër Shtetit të Paditur, Shteti Paditës vlerëson një numër rrethanash dhe faktorësh, siç janë rëndësia e shkëljes, kohëzgjatja e saj, dëmtimi apo jo i të drejtave dhe interesave të shtetasve të Shtetit Paditës, cënimi apo jo i rëndë i të drejtës së Bashkimit Evropian, por edhe faktorët pragmatistë dhe politikë.

Duke marrë parasysh këto rrethana dhe faktorë, por sidomos dy faktorët e fundit, ato pragmatikë dhe politikë, mund të konstatojmë se, rastet e ngritjes së padisë së një Shteti Anëtar kundër një Shteti tjetër Anëtar, janë të rralla. Kjo për faktin se, nuk

mund të mohohet fakti që, ngritja e padisë nga një Shtet Anëtar kundër një Shteti tjetër Anëtar, të sjellë ndikime negative në mardhëniet diplomatike, por, edhe politike, ekonomike dhe shoqërore, ndërmjet këtyre dy Shteteve.¹⁶² Një nga arsytet e tjera se pse një Shtet Anëtar, nuk ngre padi kundër një Shteti tjetër Anëtar, është fakti se, ai mendon që zgjidhjen e mosmarrëveshjes ta bëjë me anë të mjeteve politike, pra, me anë të bisedimeve dypalëshe, ndërmjet dy Shteteve Anëtare.

Gjithësesi, pavarësisht se, paditë e ngritura në Gjykatën e Drejtësisë nga një Shtet Anëtar kundër një Shteti tjetër Anëtar, janë të rralla, në këtë pumim, mund të përmend disa nga paditë që këto Shtete, kanë ngritur kundër njëra-tjetrës, padi për të cilat është shprehur edhe Gjykata me vendim përfundimtar, duke e pranuar ose rrëzuar padinë, në varësi të rrethanave dhe kushteve ligjore të provuara për secilin rast. Kështu, konkretisht, në vitin 2000, Spanja ngriti padi kundër Mbretërisë së Bashkuar, për një mosmarrëveshje që kishte të bënte me të drejtat e votimit për në Parlamentin Evropian për banorët e Gjilbraltarit, i cili, siç dihet është një zonë neutrale, por nën ndikimin britanik. Komisioni i nxiti palët që ta zgjidhin mosmarrëveshjen me pajtim me njëra-tjetrën dhe nuk pranoi që të nxjerrë një Mendim të Arsyetuar, duke u nisur nga natyra shumë e ndjeshme dhe e rëndësishme, që kishte kjo çështje për të dy palët. Në mungesë të nxjerrjes së Mendimit të Arsyetuar, Mbretëria e Bashkuar ngriti padi para Gjykatës, e cila në vendimin e saj vendosi pranimin e padisë, duke i dhënë të drejtë pretendimeve të ngritura nga Mbretëria e Bashkuar. Një tjetër padi është ajo e ngritur në vitin 1979, nga Franca kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe kishte të bënte me një mosmarrëveshje ndërmjet palëve, në lidhje me të drejtat e peshkimit. Një padi tjetër është ajo e ngritur nga Spanja kundër Mbretërisë së Bashkuar në vitin 2006, ku veprimi i Mbretërisë së Bashkuar kishte ardhur si përgjigje për vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në çështjen Mateus kundër Mbretërisë së Bashkuar.

Nga paditë e ngritura nga një Shtet Anëtar kundër një Shteti tjetër Anëtar, për mospërmbyshje detyrimi në bazë të nenit 259 të Traktatit, disa prej të cilëve u përmenden më lart, konstatohet që, ngritja e këtyre padive nga Shtetet Anëtare, ka qenë mjeti i fundit, pasi kanë dështuar të gjitha mjetet e tjera për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në shumë raste, Shtetet Anëtare, kanë preferuar që nisjen e procedurave për mospërmbyshje detyrimi nga një Shtet tjetër Anëtar, t'ia lënë Komisionit, i cili edhe ka vepruar, duke filluar procedurat dhe deri tek ngritja e padisë prej tij, në bazë të nenit 258 të Traktatit. Veprimi nga ana e Komisionit, mbi bazën e kërkesës së bërë nga një Shtet Anëtar, tregon se, mjeti juridik i parashikuar nga neni 259 i Traktatit, është një mjet juridik shitesë dhe plotësues, që përdoret nga Shtetet Anëtare, vetëm si mjet i fundit, kur Komisioni nuk ka vepruar dhe kur zgjidhja e mosmarrëveshjes me mjete të tjera, ndërmjet Shteteve Anëtare, nuk ka qenë e mundur.

4.4. Rregullat ligjore për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, për mospërmbyshje të detyrimeve nga ana e Shteteve Anëtare.

Qëllimi i gjykimit të realizuar nga ana e Gjykatës së Drejtësisë, në bazë të një padie të ngritur nga Komisioni ose një Shtet Anëtar kundër një Shteti tjetër Anëtar,

¹⁶² Shih për më tepër: Craig P; De Burca G; "E drejta e Bashkimit Evropian, Tekste, çështje gjyqësore dhe materiale", botuar nga Qendra e Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2013, faqe 543.

për mospërmbushje të detyrimeve prej tij, nuk ndryshon shumë, në thelb, me qëllimin që ka çdo gjykim i zakonshëm, në një proces civil. Ky qëllim është marrja e vendimit përfundimtar nga ana e Gjykatës, me anë të të cilit zgjidhet çështja në themel, duke u vendosur pranimi i padisë ose rrëzimi i saj, si dhe ekzekutimi më pas i vendimit të gjykatës, në përputhje me urdhërimet e përcaktuara në dispozitivin e tij, në rastet kur Gjykata ka vendosur pranimin e padisë.

Në një kuptim të gjerë, i gjithë procesi civil, ku përfshihet edhe procesi civil i zhvilluar nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë, kalon në dy faza; faza e gjykimit, në përfundim të të cilës Gjykata merr vendimin përfundimtar, duke e zgjidhur çështjen në themel dhe faza e ekzekutimit të vendimit, gjatë të cilës bëhet ekzekutimi, në praktikë ose fizikisht i vendimit përfundimtar të gjykatës. Ashtu siç është pranuar nga të gjithë studiuesit e së drejtës, por edhe nga praktika gjyqësore e të gjitha Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, *procesi civil, i cili do të ngelte vetëm në fazën e gjykimit, pa kaluar në fazën e ekzekutimit të vendimit, realisht, nuk do të kishte asnjë vlerë dhe ky proces nuk do të realizonte dot qëllimin e tij përfundimtar që është dhënia e drejtësisë dhe sigurimi i zbatimit të ligjit, në të drejtën e Bashkimit Evropian, i cili përbën edhe misionin dhe funksionin qendror të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.*

Çështja e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë, në rastet kur kjo e fundit ka konstatuar me vendim përfundimtar, mospërmbushjen e detyrimeve që burojnë nga e drejta e Bashkimit Evropian, nga një Shtet Anëtar, është një nga çështjet më të debatuar dhe delikate, si për Shtetet Anëtare, ashtu edhe për institucionet e Bashkimit Evropian. Kjo për faktin se, ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës prek, në mënyrë të drejtpërdrejtë, interesat dhe Sovranitetin e Shteteve Anëtare, nga i cili, ato e kanë të vështirë që të heqin dorë. Për më tepër, kjo çështje cënon edhe nga ana financiare buxhetet e këtyre Shteteve, sepse, në fund të fundit, siç do ta shohim më poshtë, ekzekutimi i vendimit përfundon me një shumë të hollash, në disa raste edhe në vlera të konsiderueshme, që Shteti Anëtar i paditur do të paguajë, derisa ai të marrë masat e duhura për të ekzekutuar, plotësisht, vendimin e Gjykatës.

Duke u nisur nga natyra delikate dhe e debatueshme që ka kjo çështje, ajo i është nënshtruar edhe evoluimit të saj, apo ndryshimeve të herë pas hershme, nga Traktatet Kushtetuese, të cilat duhet thënë se, që në fillimet e tyre, kanë parashikuar dispozita ligjore në lidhje me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë, për secilin nga Komunitetet. Por, ndryshimet më të mëdha çështjes së ekzekutimit të vendimeve, iu bënë me anë të Traktatit të Lisbonës, duke e bërë me efektive dhe më të shpejtë, ekzekutimin e vendimeve, si rezultat final të të gjithë procesit civil. Përpara se të trajtoj ekzekutimin e vendimeve sipas rregullimit aktual, pas ndryshimeve të bëra me Traktatin e Lisbonës, mendoj se, është e nevojshme që të trajtohet, në mënyrë të përmbledhur, procedura e ekzekutimit të vendimeve, para ndryshimeve të bëra në vitin 2009, sepse, në këtë mënyrë, kuptohen më mirë jo vetëm ndryshimet e bëra, por, e gjithë procedura e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

Në të njëjtën kohë, për të kuptuar saktë dhe drejt ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë, duhet të kemi parasysh, natyrën që kanë këto vendime sipas Traktateve Kushtetuese. *Duke iu referuar dispozitave ligjore të Traktateve, rezulton se, vendimet që merr Gjykata e Drejtësisë, në bazë të nenet 258 dhe 259 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, janë vendime me karakter deklarativ ose me natyrë gracioze dhe jo vendime me karakter detyrues. Një vendim është me natyrë deklarative ose gracioze, në rastet kur, ky vendim nuk përmban detyrime, të cilat mund të ekzekutohen, forcërisht nga ana e përmbartuesit gjyqësor. Ndërsa, një*

vendim është me natyrë detyruese, në qoftë se, urdhërimet që përcaktohen në dispozitivin e vendimit, ekzekutohen forcërisht nga ana e përmbaryesit gjyqësor.

Në përputhje me natyrën që kanë vendimet e Gjykatës së Drejtësisë, të cilat siç u tha më sipër, janë vendime deklarative, megjithëse, këto vendime janë detyruese për Shtetet Anëtare, Gjykata nuk ka fuqi ligjore që të urdhërojë marrjen e masave për ekzekutimin e këtyre vendimeve dhe as të anulojë legjislacionin e brendshëm të Shteteve Anëtare. Me këtë rast, duhet të bëjmë dallimin ndërmjet natyrës deklarative të vendimeve të Gjykatës, të lidhur këtë me natyrën detyruese të tyre. *Fakti që vendimet e Gjykatës janë me natyrë deklarative, nuk do të thotë që ato nuk janë të detyrueshme për Shtetet Anëtare, kundër të cilëve ato janë dhënë.* Përkundrazi, këto vendime janë detyruese për Shtetet Anëtare, por, Gjykata nuk ka fuqi të marrë masa, të drejtpërdrejta për ekzekutimin e tyre, si dhe këto vendime, nuk mund të ekzekutohen, forcërisht me anë të përmbaryesit gjyqësor, ashtu siç ndodh zakonisht me vendimet civile të gjykatave të brendshme të Shteteve Anëtare.

Në kushtet kur, vendimet e Gjykatës së Drejtësisë janë me natyrë deklarative, që në fillim Traktatet Kushtetuese, kanë parashikuar rregulla ligjore për ekzekutimin e tyre, pasi këto vendime edhe pse janë me natyrë deklarative, ata janë të detyrueshme për zbatim për Shtetet Anëtare. Përpara ndryshimeve të bëra me Traktatin e Lisbonës në vitin 2009, ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës, ishte më i ndërlikuar dhe zgjaste më shumë në kohë. Kështu neni 228 i Traktatit të Komunitetit Evropian parashikonte që, nëse Gjykata e Drejtësisë në vendimin e saj konstatonte se, një Shtet Anëtar nuk kishte përmbushur detyrimet që rridhnin nga Traktatet, këtij Shteti i kërkohej që të merrte masat e duhura për zbatimin e vendimit të Gjykatës.

Në qoftë se, nga ana e Komisionit vlerësohej se, Shteti Anëtar nuk kishte marra masat e duhura për zbatimin e vendimit, Komisioni i caktonte një afat Shtetit në fjalë, që të shprehte mendimin e tij, në lidhje me zbatimin e vendimit të Gjykatës. Pas lënies së këtij afati, Komisioni kishte të drejtë që të nxirrte një *Mendim të Arsytuar*, në të cilin përcaktoheshin pikat konkrete, të cilat Shteti Anëtar nuk i kishte përmbushur, në ekzekutim të vendimit të Gjykatës.

Në qoftë se, edhe pas nxjerrjes së Mendimit të Arsytuar, si edhe pas lënies së një afati të arsyeshëm Shtetit Anëtar që të ekzekutonte vendimin e Gjykatës, Shteti Anëtar, përsëri nuk e ekzekutonte atë, Komisioni kishte të drejtë që t'i drejtohej Gjykatës me padi, me qëllim që ta detyronte Shtetin Anëtar që të ekzekutonte vendimin e Gjykatës. Në padinë përkatëse, Komisioni kishte të drejtë që të propozonte edhe shumën totale të gjobës që duhet të caktonte Gjykata ndaj Shtetit të Paditur, shumë e cila do të paguhej nga ky Shtet, deri në ekzekutimin e plotë të vendimit prej tij. Pas zhvillimit të gjykimit, procedurë e cila kalon në dy fazat e saj, me shkrim dhe me gojë, Gjykata në përfundim të tij, nëse, e gjente padinë të bazuar, duke konstatuar se Shteti i Paditur nuk e kishte ekzekutuar vendimin e tij, Gjykata kishte të drejtë që të caktonte një gjobë periodike ose një shumë totale, me të cilën ngarkohej Shteti i Paditur që të paguante, duke filluar nga momenti i marrjes së vendimit, deri në ekzekutimin e plotë të tij.

Rregullat aktuale për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë, të vendosura në vitin 2009, me Traktatin e Lisbonës, janë të ngjashme me ato që parashikoheshin nga neni 228 i Traktatit të Komunitetit Evropian, megjithëse, ndërmjet tyre ka edhe ndryshime, të cilat do të trajtohen nga ana ime më poshtë. Në Traktatet Kushtetuese, është parashikuar që Shteti i Paditur, ndaj të cilit është marrë një vendim nga ana e Gjykatës për mospërmbushje të detyrimeve prej tij, është i detyruar që të marrë të gjitha masat për ekzekutimin e këtij vendimi. Masat që duhet

të marrë Shteti i Paditur për ekzekutimin e vendimit, mund të jenë të ndryshme, në varësi të shkëlqes së kryer prej tij ose në varësi të veprimeve ose mosveprimeve të kryera prej tij dhe që përbëjnë mospërbushje detyrimi, masa të cilat janë të përcaktuara, në çdo rast, në dispozitivin ose në pjesën urdhëruese të vendimit të Gjykatës.

Për shembull, nëse nga ana e Gjykatës është konstatuar me vendimin e saj se, Shteti i Paditur nuk ka përbushur detyrimin e tij për të zbatuar një Direktivë të Bashkimit Evropian, duke mos e përshtatur legjislacionin e brendshëm me normat ligjore të parashikuara në Direktivë, atëherë, masat që duhet të marrë ky Shtet për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës, kanë të bëjnë me miratimin e legjislacionit të brendshëm që është i nevojshëm, me qëllim që e drejta e brendshme e këtij Shteti, të jetë në përputhje me Direktivën e miratuar, në veçanti dhe me të drejtën e Bashkimit Evropian, në përgjithësi. Në një shembull tjetër, në qoftë se, me vendimin e saj Gjykata ka konstatuar se, në legjislacionin e Shtetit të Paditur, ekzistojnë dispozita që pengojnë lëvizjen e lirë të punonjësve, brenda tregut të përbashkët të Bashkimit Evropian, ose ekzistojnë dispozita ligjore sipas të cilave diskriminohen, në pagë, punonjësit për shkak të gjinisë, masat që duhet të marrë Shteti i Paditur për ekzekutimin e vendimit, janë që të shfuqizojë këto dispozita ligjore, që ndalojnë apo kufizojnë qarkullimin e lirë të punonjësve, apo që lejojnë diskriminimin, në pagë, për shkak të gjinisë.

Në qoftë se, pas marrjes së vendimit prej Gjykatës së Drejtësisë, me të cilin është konstatuar mospërbushje e detyrimeve nga ana e Shtetit të Paditur, ky i fundit nuk e ekzekuton, në mënyrë vullnetare këtë vendim, Traktatet Kushtetuese kanë parashikuar që, Shtetit të Paditur i kërkohet që të marra masat e duhura për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës.¹⁶³ Duke u nisur nga përmbajtja e dispozitës së nenit 260 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, që rregullon procedurën e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës, mendoj se, kjo procedurë mund të ndahet në dy faza:

a) faza e parë, e cila mund të quhet edhe faza e procedurës së ekzekutimit vullnetar, ku, Shtetit të Paditur i kërkohet që të ekzekutojë në mënyrë vullnetare vendimin e Gjykatës, fazë e cila është e parashikuar në pikën 1 të kësaj dispozite dhe,

b) faza e dytë, e cila është faza e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit nga ana e Shtetit të Paditur, e cila është parashikuar në pikën 2 të dispozitës.

Rregullat ligjore për ekzekutimin e vendimit gjatë fazës së parë ose gjatë fazës vullnetare, janë më të thjeshta dhe si rregull, kjo fazë është edhe më shkurtër në kohë, sesa faza e ekzekutimit të detyrueshëm. Në këtë fazë, nga ana e Gjykatës së Drejtësisë, konstatohet që Shteti i Paditur nuk ka ekzekutuar vendimin e saj, si dhe ftohet ai që të marrë masat e duhura për ekzekutimin e vendimit. Çështja se, nga cili subjekt apo organ Gjykata i merr të dhënat për të bërë konstatimin që Shteti i Paditur, nuk ka ekzekutuar vendimin e saj, nuk ka rëndësi. Gjykata mund të vihet në dijeni të faktit se, Shteti i Paditur nuk ka ekzekutuar vendimin, kryesisht ose me nismën e saj, por, mund të vihet në dijeni edhe nga Komisioni, nga çdo Shtet Anëtar, nga institucionet e tjera të Bashkimit Evropian, por edhe nga personat fizikë ose personat juridikë privat. E rëndësishme është që Gjykata, në mënyrë të saktë dhe të

¹⁶³ Pika 1 e nenit 260 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Nesë Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian konstaton se një Shtet Anëtar nuk ka përbushur detyrimin që rrjedh nga Traktatet, Shtetit i kërkohet që të marrë masat e nevojshme për të respektuar vendimin e Gjykatës”.

padyshtimtë, të konstatojë që Shteti i Paditur nuk ka marrë masat e duhura, ose nuk ka kryer veprimet e nevojshme, të cilat janë urdhëruar në vendimin e Gjykatës.

Pasi nga ana e Gjykatës së Drejtësisë, konstatohet se, Shteti i Paditur nuk ka ekzekutuar vendimin e saj, Gjykata i kërkon atij që të veprojë dhe të marrë masat e nevojshme për ekzekutimin e këtij vendimi. Në Traktatet Kushtetuese, nuk është përcaktuar mënyra konkrete, sesi nga ana e Gjykatës i kërkohet Shtetit të Paditur ekzekutimi i vendimit, por kjo gjë i është lënë praktikës ose rregullave formale të korespondencës që zbatohen ndërmjet institucioneve të Bashkimit Evropian dhe Shteteve Anëtare. Në këto kushte, *kërkimi që Gjykata i bën Shtetit të Paditur për ekzekutimin e vendimit të saj, bëhet me anë të një Njoftimi Zyrtar që Gjykata i dërgon Shtetit të Paditur*. Në këtë Njoftim Zyrtar, Gjykata i tregon Shtetit të Paditur, numrin dhe datën e vendimit për të cilën ajo ka konstatuar se nuk është ekzekutuar prej tij, si dhe i kërkon që të marrë masat e duhura për ekzekutimin vullnetar të vendimit, duke e paralajmëruar se, në rast të kundërt, nga ana e Komisionit Evropian, mund të fillojë procedura e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit.

Në Njoftimin Zyrtar që Gjykata i bën Shtetit të Paditur, i cili duhet të ekzekutojë vendimin e saj, i tregon edhe se cilat janë masat konkrete që duhet të marrë ky Shtet, me qëllim që vendimi i Gjykatës të konsiderohet i ekzekutuar. Po ashtu, pavarësisht se, një gjë e tillë nuk është parashikuar, në mënyrë të shprehur, në Traktatet Kushtetuese, së bashku me Njoftimin, nga ana e Gjykatës i lihet Shteti i Paditur, edhe një afat i arsyeshëm që të ekzekutojë, në mënyrë vullnetare, vendimin e Gjykatës.

Në lidhje me periudhën konkrete se sa duhet të jetë ky afat që duhet t'i lihet Shtetit të Paditur, për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, kjo është e vështirë që të përcaktohet. Kjo sepse, periudha e cila duhet t'i lihet Shtetit Anëtar për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, varet nga një numër faktorësh, siç janë, lloji i shkeljes së kryer, natyra e shkeljes, rëndësia e saj, koha që është e nevojshme që Shtetit Anëtar i duhet për ekzekutimin e detyrimit, sistemi ligjor i Shtetit Anëtar, gjendja e tij financiare, niveli i zhvillimit ekonomik dhe social etj. E rëndësishme është që, Shtetit Anëtar, në varësi nga natyra, rëndësia dhe lloji i çështjes, t'i lihet një afat i arsyeshëm për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, si dhe t'i bëhet e qartë se, nëse ai nuk e ekzekuton detyrimin, në mënyrë vullnetare, ndaj tij do të fillojnë procedurat për ekzekutimin e detyrueshëm.

*Në qoftë se, Shteti i Paditur nuk e ekzekuton vendimin, në mënyrë vullnetare edhe pas Njoftimit Zyrtar të bërë nga Gjykata dhe pas afatit të arsyeshëm të lënë nga Gjykata për këtë qëllim, atëherë Komisioni ka të drejtë që të ngrejë padi në Gjykatën e Drejtësisë, me qëllim që të detyrohet Shteti i Paditur që të bëjë ekzekutimin e vendimit, duke kaluar kështu fazën e dytë të ekzekutimit të vendimit, në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm.*¹⁶⁴ Faza e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit, kalon nga ana e saj në disa nënfaza ose hapa proceduralë. *Hapi i parë procedural ka të bëjë me vlerësimin që bën Komisioni, nëse, Shteti i Paditur e ka ekzekutuar, në mënyrë vullnetare vendimin e Gjykatës. Ky vlerësim i bërë nga Komisioni nuk mund të jetë, kurrësesi, subjektiv apo abuziv, por ai bazohet në gjendjen konkrete të*

¹⁶⁴ Pika 2 e nenit 260 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian parashikon: *Nëse Komisioni është i mendimit se Shteti Anëtar në fjalë nuk i ka marrë masat e nevojshme për të respektuar vendimin e Gjykatës, ai mund ta ngrejë çështjen përpara Gjykatës pasi i ka dhënë mundësi Shtetit që të paraqesë komentet e veta. Ai përcakton vlerën e shumës apo të gjobës që duhet të paguajë Shteti Anëtar në fjalë, siç e gjykon sipas rrethanave. Nëse Gjykata konstaton se Shteti Anëtar në fjalë nuk e ka respektuar vendimin e saj, ajo mund të vendosë një shumë ose gjobë për t'u paguar nga ky Shtet Anëtar*".

vendimit të Gjykatës dhe në qëndrimin që ka mbajtur Shteti i Paditur për këtë vendim. Për të vlerësuar faktin nëse, Shteti i Paditur e ka ekzekutuar apo jo, në mënyrë vullnetare vendimin, Komisioni mund t'i mbledhë vetë të dhënat dhe informacionet, por këto të dhëna mund t'i marrë edhe nga Gjykata e Drejtësisë, nga insitucionet e tjera të Bashkimit Evropian, nga Shtetet Anëtare, si dhe nga personat fizikë dhe personat juridikë privatë.

Kur Komisioni, pas mbledhjes së të dhënave dhe informacioneve të nevojshme, është i bindur se, Shteti i Paditur nuk e ka ekzekutuar, në mënyrë vullnetare, vendimin e Gjykatës, ai (Komisioni) i drejtohet me një Letër Zyrtare Shtetit të Paditur, me anë të të cilës e njofton atë për këtë konstatim të tij, si dhe e fton atë që të paraqesë pretendimet dhe kundërshtimet që ai i çmon të arsyeshme. Ky veprim përbën edhe hapin e dytë procedural, nëpër të cilën kalon procedura e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit të Gjykatës. Në Letrën Zyrtare ose Njoftimin Zyrtar, që Komisioni i dërgon Shtetit të Paditur, duhet të parashtrohen të gjitha faktet dhe provat që tregojnë se ky i fundit nuk e ka ekzekutuar vendimin e Gjykatës, si dhe duhet që të ftohet Shteti i Paditur, që të paraqesë kundërshtimet e tij, nëse, ai dëshiron në lidhje me këtë konstatim të Komisionit.

Në respektim të parimit të kontradiktoritetit, Shtetit të Paditur, duhet t'i lihet një kohë e arsyeshme, në varësi nga natyra dhe rëndësia si dhe kompleksiteti i çështjes, që të përgatisë mbrojtjen e tij, si dhe që të paraqesë kundërshtimet dhe prapsimet e tij, për çështjen në fjalë.

Po ashtu, pavarësisht se, në Traktatet Kushtetuese nuk rezulton e parashikuar në mënyrë të shprehur, mendoj se, një kohë e arsyeshme mund t'i lihet Shtetit të Paditur që, ai edhe në këtë fazë, të ekzekutojë, në mënyrë vullnetare detyrimin, para se Komisioni të ngrejë padi në Gjykatë kundër tij. Një gjë e tillë do të shërbente për zgjidhjen më të shpejtë dhe efektive të çështjes, në kushtet kur, dihet që procedurat gjyqësore para Gjykatës së Drejtësisë zgjasin, por edhe për faktin tjetër që, ngritja e padisë kundër Shtetit të Paditur nga Komisioni, nuk mund të mohohet se, sjellë probleme më mardhëniet e këtij Shteti me Komisionin Evropian, në veçanti dhe me institucionet e Bashkimit Evropian, në përgjithësi. Për këtë arsye, jam e mendimit se, Shtetit të Paditur, përveç kohës së nevojshme për të përgatitur mbrojtjen e tij, me qëllim që të paraqesë kundërshtimet e veta për konstatimin e bërë nga Komisioni, në lidhje me mosekzekutimin vullnetar të vendimit prej tij, mund t'i lihet nga Komisioni edhe një kohë e arsyeshme, që ai ta ekzekutojë vullnetarisht detyrimin, sigurisht, kur Shteti i Paditur reagon në mënyrë pozitive, duke pranuar mosekzekutimin e vendimit prej tij, si dhe duke u shprehur i gatshëm se do ta ekzekutojë atë. Në rast të kundërt, në qoftë se, Shteti i Paditur, nuk i përgjigjet Letrës Zyrtare të Komisionit ose kundërshton përmbajtjen e saj dhe deklaron se, nuk do ta ekzekutojë vendimin, dhënia e kësaj kohe të arsyeshme nga Komisioni, do të ishte e pavlerë dhe do të bënte efektin e kundërt, atë të zvarritjes së ekzekutimit të vendimit të gjykatës.

Në qoftë se Shteti i Paditur, megjithë Njoftimin Zyrtar të bërë nga Komisioni, me të cilin e njofton për mosekzekutimin e vendimit prej tij, si dhe megjithë kohën e dhënë që ai të parashtrojë pretendimet e veta, nuk reagon dhe nuk e ekzekuton, përsëri, vendimin e Gjykatës, Komisioni mund të ngrejë padi në Gjykatën e Drejtësisë, me qëllim për ta detyruar Shtetin e Paditur që ta ekzekutojë, forcërisht, vendimin, veprim i cili përbën dhe hapin e tretë procedural të fazës së ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë. Ashtu siç është përcaktuar edhe në pikën e 2 të nenit 260 të Traktatit, rezulton se, Komisioni mund të ngrejë padi kundër Shtetit të Paditur për ta detyruar forcërisht për ekzekutimin e vendimit, por, nuk është i

detyruar që të ngrejë padi, edhe pse ai konstaton që Shteti i Paditur nuk e ka ekzekutuar vendimin e Gjykatës. Kjo do të thotë që, është në vlerësimin ekskluziv të Komisionit, nëse ai do të ngrejë apo jo padi kundër Shtetit të Paditur, me qëllim që ta detyrojë atë që të bëjë ekzekutimin e vendimit të Gjykatës dhe nëse Komisioni vlerëson që, edhe pse Shteti i Paditur nuk e ka ekzekutuar vendimin, ai nuk do të ngrejë padi, ky vlerësim është e drejta e tij e ligjshme dhe ekskluzive dhe asnjë institucion tjetër i Bashkimit dhe asnjë Shtet Anëtar apo ndonjë subjekt tjetër, nuk mund ta detyrojë Komisionin që të ngrejë padi, jashtë vullnetit të tij.

Në vlerësimin e faktit për ngritjen ose jo të padisë ndaj Shtetit të Paditur, me qëllim detyrimin e tij që të ekzekutojë vendimin e Gjykatës, Komisioni merr në konsideratë një sërë faktorësh, siç janë pasojat që kanë ardhur nga mosekzekutimi i vendimit, faktin, nëse, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit janë cënuar apo jo të drejtat dhe liritë themelore të shtetasve, faktin, nëse, mosekzekutimi i vendimit çënon ose rrezikon rëndë sistemin ligjor të Bashkimit Evropian, por, edhe faktorët politikë dhe pragmatistë. Në këtë moment, vlen të konstatohet që, *edhe pse Komisioni është institucioni i vetëm që ka të drejtën ekskluzive dhe liri të plotë për të vendosur, nëse, do të ngrejë padi kundër Shtetit të Paditur, kjo liri nuk është e pakufizuar dhe si rregull, Komisioni duhet të ngrejë padi, në çdo rast, kur mosekzekutimi i vendimit çënon të drejtat dhe liritë e qytetarëve të Bashkimit Evropian ose vë në rrezik rendin ligjor evropian.* Kjo liri e Komisionit, ashtu si e gjithë veprimtaria e tij, vlerësohet në përputhje me parimin “*check and balance*”, sipas të cilit asnjë institucion i Bashkimit Evropian, nuk është i pakontrolluar dhe i palimituar, në ushtrimin e pushteteve të tij, por, përkundrazi, ai duhet t’i ushtrojë funksionet e tij, në bazë të parashikimeve ligjore, si dhe duhet të japë llogari dhe të përgjigjet, për mënyrën e ushtrimit të pushteteve prej tij.

Kur Komisioni vlerëson që do të ngrejë padi, kundër Shtetit të Paditur për detyrimin e tij që të ekzekutojë vendimin e Gjykatës, pas ndryshimeve që iu bënë Traktateve Kushtetuese, me Traktatin e Lisbonës, Komisioni nuk duhet të nxjerr më një Mendim të Arsytuar që t’ia njoftojë atë Shtetit të Paditur, duke i treguar edhe pikat se ku nuk është ekzekutuar vendimi, si dhe duke i lënë edhe kohë për ekzekutimin e vendimit. Ky ndryshim i rëndësishëm i bërë në pikën 2 të nenit 260 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, është bërë me qëllim që, procedura e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit të Gjykatës, të jetë më e shpejtë dhe më efikase. Nxjerrja e *Mendimit të Arsytuar* nga ana e Komisionit dhe lënia kohë Shtetit të Paditur që të ekzekutojë detyrimin vullnetarisht, në kushtet kur kjo kohë i ishte lënë më parë, sipas pikës 1 të nenit 260 të Traktatit, tregoi se, nuk jepte rezultate konkrete dhe sillte zvarritje të procedurave për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit. Për këto arsye, me Traktatin e Lisbonës, të hyrë në fuqi, me 1 janar 2009, u hoq nga pika 2 e nenit 260 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, detyrimi që Komisioni, më parë, duhet të nxirrte një Mendim të Arsytuar dhe t’i linte kohë Shtetit të Paditur për të ekzekutuar, vullnetarisht, vendimin e Gjykatës dhe vetëm më pas, Komisioni të kishte të drejtë që të ngrinte padi në Gjykatë, me qëllim detyrimin e Shtetit të Paditur që të ekzekutojë vendimin. Bërja e këtij ndryshimi ligjor, mendoj se, është në drejtimin e duhur dhe është një ndryshim pozitiv, që duhet vlerësuar dhe që më siguri, do të sjellë efektet e tij në drejtim të ekzekutimit, sa më të shpejtë dhe efektiv të vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë. Me ngritjen e padisë nga ana e Komisionit kundër Shtetit të Paditur, Komisioni përvëç argumenteve dhe provave konkrete që tregojnë që Shteti i Paditur, nuk e ka ekzekutuar vendimin e Gjykatës, duhet t’i propozojë kësaj të fundit edhe shumën e përgjithshme ose gjobën

që duhet të paguajë Shteti i Paditur, deri sa ai ta ekzekutojë vendimin. Nga përcaktimi që ka bërë ligji, konstatohet se, Komisioni i propozon Gjykatës që Shteti i Paditur të paguajë një “shumë të përgjithshme” ose një “gjobë” të caktuar, terma të cilat nuk janë e njëjta gjë, por nënkuptojnë koncepte të ndryshme. Kështu, termi “shumë e përgjithshme”, nënkupton detyrimin e Shtetit të Paditur që të paguajë një shumë fikse parash, në njëherë të vetme, ndërsa termi “gjobë”, nënkupton pagimin e një shume të hollash, në mënyrë periodike nga Shteti i Paditur, nga momenti që është dhënë vendimi i Gjykatës, deri në momentin që ai të ekzekutojë vendimin.

Në Traktatet Kushtetuese është përcaktuar që, vlera e shumës së përgjithshme ose të gjobës që duhet të paguajë Shteti i Paditur, Komisioni ia propozon Gjykatës ashtu siç ai e gjykon të arsyeshme, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes. Në këto kushte, *sa më e rëndë të jetë shkelja e kryer nga Shteti i Paditur, sa më neglizhent të jetë treguar ai në mosekzekutimin e vendimit dhe sa më të rënda të jenë pasojat e mosekzekutimit të vendimit, për të drejtat e qytetarëve dhe të sistemit ligjor të Bashkimit Evropian, aq më e madhe duhet të jetë vlera e shumës së përgjithshme ose e gjobës, që Komisioni do t’i propozojë Gjykatës.* Por, me qëllim që shuma e përgjithshme ose e gjobës të realizojë qëllimin e saj dhe të mos jetë jo proporcionale, në përcaktimin e vlerës së tyre, Komisioni ka marrë parasysh edhe faktorë të tjerë, siç janë madhësia e popullsisë dhe sipërfaqes së Shtetit të Paditur, gjendja e tij financiare, si dhe numri i votave që ai ka në Këshill, në rastet kur vendimet merren me shumicë të cilësuar. Po ashtu, *nga ana e Komisionit mund t’i propozohet Gjykatës, në varësi nga rëndësia e shkeljes dhe sjellja e Shtetit të Paditur, por, sidomos në varësi të pasojave që ka sjellë mosekzekutimi i vendimit të Gjykatës, jo vetëm pagimi i një gjobe periodike, por edhe pagimi, në të njëjtën kohë si i gjobës periodike edhe i një shume të përgjithshme të hollash.*

Për përcaktimin e kriterëve në lidhje me vlerën e gjobës dhe/ose shumës së përgjithshme që mund të propozojë Komisioni, ky i fundit në vitet 1996 dhe 1997, ka nxjerrë dy Komunikata, e para është “*Memorandumi për gjobat*”, ndërsa e dyta është, “*Njoftimi i Koeficientit*”, në të cilat janë përcaktuar rregullat për mënyrën e llogaritjes së gjobave që ai, do t’i propozojë Gjykatës së Drejtësisë. Në këto dy dokumente, Komisioni argumentonte që shuma që duhet të paguajë Shteti i Paditur, duhet të paqyrojë qëllimin e sanksionit, domethënë, të sigurojë përputhjen efektive të Shtetit të Paditur, me të drejtën e Bashkimit Evropian, sa më shpejt që të jetë e mundur. Komisioni sqaron më tej se, mjetet më të përshtatshme për arritjen e këtij qëllimi, do të ishte që të detyrohej Shteti i Paditur që të paguante një gjobë periodike, e cila do të fillonte të pagahej prej tij, nga data e dhënies së vendimit të Gjykatës, deri në datën e ekzekutimit të dënimit prej tij.

Sipas dokumentit “*Memorandumi për gjobat*”, *gjoba duhet të llogaritet në bazë të tre kriterëve:*

a) *serioziteti i shkeljes*, ku, në këtë rast, duhet të mbahet parasysh jo vetëm mosmarrjen e masave nga Shteti i Paditur për ekzekutimin e vendimit, por edhe serioziteti i shkeljes fillestare të bërë nga Shteti i Paditur;

b) *kohëzgjatja e shkeljes*, e cila nënkupton periudhën kohore që ka patur në dispozicion Shteti i Paditur, për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës dhe

c) *nevojën për të garantuar se gjoba ka si qëllim jo vetëm ndëshkimin e Shtetit të Paditur, por edhe parandalimin në të ardhmen të kryerjes së shkeljeve të tilla dhe*

për këtë arsye, gjoba duhet të ishte me karakter frenues dhe jo vetëm thjesht simbolike.¹⁶⁵

Duhet theksuar se, ky Dokument i Komisionit mbi kriteret për përcaktimin e gjobave ndaj Shteteve të Paditur, është një akt me natyrë këshilluese ose udhëzuese dhe jo një akt detyrues. Ky fakt është pranuar edhe nga Gjykata e Drejtësisë, në disa vendime saj, me anë të të cilëve ka vendosur gjoba periodike për Shtetet e Paditura, ku, Gjykata është shprehur se, edhe pse ajo është dakort me pjesën më të madhe të udhëzimeve të Komisionit, mbi kriteret e përcaktimit të vlerës së gjobës, këto udhëzime të Komisionit, nuk janë detyruese për Gjykatën. Kështu, në një çështje konkrete të përmendur nga ana ime më lart, si çështje themeli, konkretisht, *në çështjen Komisioni kundër Spanjës, e cila kishte të bënte me shkeljen nga ana e Spanjës të dispozitave të një Direktive të Bashkimit për “ujin për larje”*, ku, Gjykata vendosi të pranojë padinë e ngritur nga Komisioni, por që ka vazhduar më pas edhe me një vendim tjetër të Gjykatës, *në fazën e ekzekutimit të vendimit, për detyrimin forcërisht të Spanjës për të ekzekutuar vendimin*, Gjykata nuk pranoi propozimin e Komisionit për t'i vendosur Spanjës një gjobë ditore, por vendosi ndaj saj një gjobë vjetore. Arsyeja e vendosjes së kësaj gjobë vjetore, sipas Gjykatës kishte të bënte me natyrën e shkeljes dhe vështirësitë që ekzistonin për të parë se, pasi kishte kaluar një periudhë e konsiderueshme kohe, cilësia e ujit për larje, përputhej apo jo me kufirin e vlerave të caktuara, nga e drejta e Bashkimit Evropian.¹⁶⁶

Në dokumentin tjetër të nxjerrë nga Komisioni, i quajtur *“Njoftimi i Koeficientit”*, Komisioni përcaktoi vlerën, tavan prej 500 eurosh në ditë, si bazë për të llogaritur shumën e gjobës. Kjo bazë prej 500 eurosh shumëzohet me dy koeficientë; koeficienti i parë pasqyron seriozitetin e shkeljes dhe varion nga 1 deri në 20 shkallë dhe i dyti pasqyron kohëzgjatjen e shkeljes dhe varion nga shkalla 1 deri në 3 shkallë. Kjo shumë e gjobës e formuar ndërmjet koeficienteve të seriozitetit të shkeljes dhe kohëzgjatjes së shkeljes sipas shkallëve përkatës, shumëzohet me një faktor tjetër, që përcaktohet nga aftësia paguese e Shtetit të Paditur, të bazuar në Produktin e Përgjithshme Bruto të Shtetit, si dhe votat që ky Shtet ka në Këshill. Ky faktor varion nga shkalla 1 për Luksemburgun dhe shkon deri në 26.4 për Gjermaninë. Këto dy dokumente u përmirësuan dhe u përditësuan më tej nga ana e Komisionit, në vitet 2005 dhe 2010, me qëllim shuma e gjobës të pasqyronte të dhënat e sotme të zhvillimit makroekonomik të Shteteve Anëtare. Përveç kësaj, Komisioni ka nxjerrë edhe një Komunikatë tjetër, sipas të cilës, ai mund t'i propozojë Gjykatës, në të njëjtën kohë, të dy sanksionet, si pagimin e një shume të përgjithshme ashtu dhe pagimin e një gjobë periodike, kërkesë e cila mund të pranohet nga Gjykata, nëse ajo do ta vlerësojë të arsyeshme. Po ashtu, *me Traktatin e Lisbonës, në vitin 2009, u bë edhe një ndryshim i fundit në nenin 260 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, ku është përcaktuar se, shuma e gjobës që mund të vendosë Gjykata, nuk mund ta kalojë vlerën që ka propozuar Komisioni, pra, Gjykata mund të caktojë një vlerë të barabartë ose me të vogël të gjobës, se ajo e kërkuar nga Komisioni, por, nuk mund të vendosë një vlerë më të madhe.*

Në përcaktimin e shumës së gjobës periodike ose të shumës totale, që duhet të paguajë Shteti i Paditur për mosekzekutimin e vendimit, Gjykata, në disa vendime të

¹⁶⁵ Craig P; De Burca G; *“E drejta e Bashkimit Evropian, Tekste, çështje gjyqësore dhe materiale”*, botuar nga Qendra e Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2013, faqe 545.

¹⁶⁶ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen gjyqësore C-278/01, ECR I-14141, Komisioni kundër Spanjës.

saj edhe pse është pajtuar, në përgjithësi, me udhëzimet e Komisionit për kriteret e koeficenteve, ajo në disa raste, ka vendosur në kundërshtim me atë çfarë i ka propozuar Komisioni, në lidhje me llojin e masës ndëshkuese, që duhet të jepet ndaj Shtetit të Paditur. Një nga vendimet e Gjyktaës, ku ajo ka vendosur në kundërshtim me atë që i ka propozuar Komisioni, është çështja e vitit 2004, që ka të bëjë me një mosmarrëveshje ndërmjet Komisionit dhe Francës, në lidhje me zbatimin prej saj të normave të Bashkimit Evropian, për konservimin e peshkut. Në këtë çështje, Gjykata vendosi që Franca të paguante një gjobë të përgjithshme për një shkelje afatgjatë edhe pse një gjë e tillë nuk ishte propozuar nga Komisioni. Në këtë çështje, e cila pati edhe efekte mediatike, pasi në të ndërhyjnë edhe 16 Shtete Anëtare, ku 4 prej të cilëve kërkuan që Franca të detyrohej që të paguante, përveç gjobës periodike dhe një shumë te vetme, si masë plotësuese. Nga ana tjetër, 12 Shtete të tjera Anëtare, pretendonin se, Traktatet Kushtetuese, nuk e lejonin që kundër një Shteti të vendoseshin, në të njëjtën kohë, dy sanksione edhe pagimi i një shume të përgjithshme edhe pagimi i një gjobe periodike.

Gjykata e Drejtësisë, në vendimin e saj, duke hedhur poshtë pretendimet e 12 Shteteve Anëtare, në vendimin e saj, ndër të tjera, arsyetonte:

“...80. Procedura e parashikuar në nenin 228(2) të Traktatit të Komunitetit Evropian, ka si objektiv të detyrojë Shtetin Anëtar kundërvajtës, të pajtohet me një vendim gjyqësor të marrë për një shkelje të detyrimeve dhe në këtë mënyrë, garanton që e drejta e Komunitetit, në fakt zbatohet. Masa e parashikuar nga ajo dispozitë, kryesisht një shumë e përgjithshme dhe një pagesë gjobe, të dyja synojnë të arrijnë këtë objektiv.

81. Përdorimi i secilës prej këtyre masave varet nga cilësia e tyre përkatëse për të arritur objektivin që ndiqet, sipas rrethanave të çështjes. Ndërkohë që, vendosja e një pagese gjobe periodike, i përshtatet mjaft mirë detyrimit të Shtetit Anëtar për t'i dhënë fund sa më shpejt një shkelje të detyrimeve, që në mungesë të një mase të tillë do të kishte prirje që të përsëriteshin në të ardhmen, vendosja e një shume të përgjithshme bazohet, më shumë në vlerësimin e efekteve të interesave publike dhe private për shkak të dështimit të Shtetit Anëtar në fjalë, për të përmbushur detyrimet e tij, e në mënyrë të veçantë kur shkelja ka vazhduar për një kohë të gjatë, që nga vendimi gjyqësor që është marrë për të.

82. Në këtë situatë, padia që mund të ngrihet për të dy llojet e gjobave, të parashikuar në nenin 228 të Traktatit të Komunitetit Evropian, nuk mund të parandalohet dhe sidomos kur shkelja e detyrimeve ka vazhduar për një kohë të gjatë dhe ka tendencë për të vazhduar në të ardhmen. ...”¹⁶⁷

Në vendimin e mësipërm Gjykata argumentonte më tej se, mungesa e ndonjë Direktive të Komisionit për vendosjen e një shume të përgjithshme, nuk çënon parimin e sigurisë ligjore dhe as mungesa e propozimit të Komisionit për vendosjen e një shume të përgjithshme, nuk e pengonte Gjykatën që ajo vetë, me nismën e saj, ta vendoste një shumë të tillë. Gjykata po ashtu, kundërshtoi edhe argumentin se, asaj i nevojitej legjitimitet politik për të vendosur një gjobë që nuk ishte propozuar nga Komisioni, duke arsyetuar se, gjobat financiare duhet të vendosen sipas shkallës së bindjes që nevojitet, me qëllim që Shteti në fjalë, të ndryshojë qëndrimin e tij dhe të fillojë të zbatojë vendimin e Gjykatës. Më tej, Gjykata duke hedhur poshtë pretendimet e Shteteve Anëtare se, ajo nuk ishte kompetente për të vendosur një

¹⁶⁷ Shih për më tepër: Vendimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen gjyqësore C-304/02, ECR I-9091, Komisioni kundër Francës.

gjobë, e cila nuk ishte propozuar nga Komisioni, në mënyrë lakonike u shpreh se: “Në një situatë të tillë që është subjekt i vendimit të tanishëm, në dritën e fakteve që shkelja e detyrimeve ka vazhduar për një periudhë të gjatë, që nga koha kur vendimi u mor fillimisht, si dhe nën dritën e interesave publike dhe private në fjalë, ka rëndësi të madhe të vendoset pagesa e një shume të përgjithshme”.

Duke iu referuar vendimit të mësipërm të Gjykatës, rezulton se, vendosja ndaj Shtetit të Paditur, në të njëjtën kohë edhe e një gjobë periodike edhe të një shume të përgjithshme, është e justifikuar për shkak të qëllimeve të ndryshme që ato kanë. Kështu, vendosja e gjobës periodike ka si qëllim që, Shteti i Paditur të marrë masa për ekzekutimin, sa më shpejt të vendimit të Gjykatës, vendosja e shumës së përgjithshme merr në konsideratë, cënimin e interesave publike dhe private që ka ardhur si pasojë e mosekzekutimit të vendimit. Kuptohet se, jo në çdo rast, mund të justifikohet vendosja e të dy sanksioneve edhe e gjobës periodike edhe e shumës së përgjithshme, kjo varet nga natyra e shkeljes, nga rëndësia e saj, si dhe sidomos nga periudha që Shteti i Paditur nuk ka ekzekutuar vendimin. Kështu, në përgjithësi, kur vertetohet se shkelja është serioze, si dhe Shteti i Paditur nuk e ka ekzekutuar vendimin për një kohë të gjatë, për shkaqe të papërligjura, vendosja edhe e gjobës periodike edhe e shumës së përgjithshme, ndaj këtij Shteti, është e justifikuar.

Mbi bazën e këtij vendimi të Gjykatës, Komisioni ka përmirësuar udhëzimet e tij, duke propozuar pagimin e një shume të përgjithshme, krahas gjobës periodike, kur Shtetet Anëtare, kanë vonuar shumë ekzekutimin e vendimeve, shumë e cila është propozuar duke mbajtur parasysh edhe parimin e proporcionalitetit dhe të trajtimit të barabartë të Shteteve Anëtare. Këto përmirësime janë bërë nga Komisioni, në respektim të vendimeve të Gjykatës edhe për çështje të tjera, në të cilat ajo ka theksuar se, në zbatim të parimit të Shtetit të së Drejtës, është e nevojshme që sanksionet të parashikohen. Po ashtu, Komisioni në *Qarkoren e vitit 2005*, ka bërë disa rekomandime të reja, siç është propozimi që brenda një çështje të vetme, të mund të vihen sanksione të veçanta për shkelje të veçanta, rregullimin e sanksioneve me qëllim që, të përputhen në mënyrë graduale ose të pjesshme, për periudha gjashtë mujore ose një vjeçare, mundësia e pezullimit të pagimit të gjobave, në rastet kur Shteti i Paditur ka marrë masa, të menjëhershme dhe efektive për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës etj. Të gjitha këto përmirësime kanë një qëllim të vetëm, detyrimin e Shtetit të Paditur, që me sa më pak kosto, të ekzekutojë, sa më shpejt dhe në mënyrë të plotë, vendimin e Gjykatës.

Një nga ndryshimet më të rëndësishme të bëra me Traktatin e Lisbonës që ka të bëjë me procedurat për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Drejtësisë, në rastet kur ajo ka marrë një vendim kundër Shteteve Anëtare për mospërbushje të detyrimeve prej tyre, është fakti që, kur Komisioni ngren padi kundër një Shteti Anëtar, për mospërbushje të detyrimeve për të zbatuar ose transpozuar një Direktivë të Bashkimit Evropian në të drejtën e tij të brendshme, Komisioni ka të drejtë që t'i propozojë gjykatës, drejtpërdrejt, pagimin e një shume të menjëhershme dhe/ose të një gjobe periodike, në rast se gjykata konkludon se, Shteti i Paditur nuk e ka përmbushur këtë detyrim.¹⁶⁸ Ky ndryshim i bërë me Traktatin e Lisbonës, përbën një

¹⁶⁸ Pika 3 e nenit 260 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Kur Komisioni e ngre çështjen përpara Gjykatës, sipas nenit 258, me arsyen se Shteti Anëtar në fjalë nuk e ka përmbushur detyrimin për të njoftuar masat që transpozojnë një Direktivë të miratuar sipas një procedure legislative, kur e gjykon të arsyeshme ai mund të propozojë vlerën e shumës së menjëhershme ose gjobës që duhet të paguajë Shteti Anëtar në fjalë, siç e gjykon të arsyeshme sipas rrethanave. Nëse Gjykata konstaton se ka shkelje, ajo mund të vendosë shumën ose gjobën për Shtetin

ndryshim të rëndësishëm përsa i përket ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, sepse, *në bazë të këtij ndryshimi për detyrimet që kanë Shtetet Anëtare për të zbatuar ose transpozuar një Direktivë të Bashkimit Evropian, nuk zbatohen fare pikat 1 dhe 2 të nenit 260 i Traktatit, të cilat rregullojnë procedurën e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës, procedurë e cila, siç është trajtuar më lart, zgjat në kohë, por ka edhe shpenzime dhe kosto jo të vogëla, si për Shtetet Anëtare edhe për Bashkimin Evropian.*

Sipas këtij ndryshimi, vetëm për moszbatimin e Direktivave të Bashkimit, që kanë të bëjnë me përjasjen ose përputhjen e legjislacionit të brendshëm të Shteteve Anëtare, me atë të së drejtës së Bashkimit Evropian, vendimi i Gjykatës së Drejtësisë është i njëjtë në thelb, me vendimin e çdo gjykate të Shtetit Anëtar, pasi ai ka mundësi që të ekzekutohet direkt, pa ndjekur fare procedurat për ekzekutimin e vendimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 260, të cilat, siç u sqarua më lart, nënkuptojnë në vetvete, zhvillimin e një gjykimi tjetër nga ana e Gjykatës së Drejtësisë, me të cilin ajo konstaton mosekzekutimin e vendimit nga Shteti i Paditur dhe më pas, vendos detyrimin e tij për pagimin e një gjobe periodike dhe/ose të një shume të përgjithshme të hollash. *Sipas këtij ndryshimi, dhe vetëm për Direktivat që ngarkojnë përshtatjen e legjislacionit të brendshëm të Shteteve Anëtare, me atë të Bashkimit Evropian, nuk është e nevojshme që Komisioni të ngrejë një padi të re, sipas pikës 2 të nenit 260 të Traktatit dhe më pas të zhvillohet një gjykim i ri nga Gjykata, ku ajo të konstatojë mosekzekutimin e vendimit dhe më pas, të vendosë sanksione ndaj Shtetit të Paditur.*

Ndryshimi i mësipërm, e kapërcen, e kalon procedurën për ekzekutimin e vendimeve të parashikuara nga pikat 1 dhe 2 të nenit 260 të Traktatit, duke i dhënë mundësi Gjykatës, që mbi padinë së ngritur nga Komisioni, sipas nenit 258 të Traktatit, për moszbatim të Direktivave të Bashkimit Evropian, për përshtatjen dhe përputhjen e legjislacionit të brendshëm të Shteteve Anëtare, me të drejtën e Bashkimit Evropian, Gjykata, kur konstaton se Shteti Anëtar ka kryer një shkelje të tillë, vendos edhe sanksione ndaj tij, duke e detyruar që të paguajë një gjobë periodike dhe/ose një shumë të përgjithshme të hollash. Me anë të këtij ndryshimi dhe vetëm për moszbatimin e Direktivave me karakter legjislativ, vendimi i Gjykatës së Drejtësisë, nuk është vendim deklarativ ose gracioz, por, është vendim detyrues pasi e detyron Shtetin e Paditur që të paguajë një gjobë periodike dhe/ose një shumë të përgjithshme të hollash, derisa ai të ekzekutojë vendimin e Gjykatës.

Anëtar në fjalë, e cila nuk mund të jetë më e madhe se vlera e përcaktuar nga Komisioni. Detyrimi për të paguar fillon në datën e përcaktuar nga Gjykata në vendimin e saj”.

Konkluzione

Pas trajtimit që u bë nga ana ime në lidhje me rolin që ka Gjykata Evropiane e Drejtësisë në të drejtën e Bashkimit Evropian, në këtë pjesë të Punimit, do të paraqes Konkluzionet e tij, si dhe disa Rekomandime, për ndryshimin dhe përmirësimin e disa dispozitave ligjore që rregullojnë organizimin, funksionimin dhe veprimtarinë e kësaj Gjykate. Si konkluzione të Punimit, që mund të nxjerr duke u bazuar në trajtimet e mësimeve teorike si dhe referencat praktike që ky institucion ka servitur ndërsa vite, mund të them se:

1. *Gjykata Evropiane e Drejtësisë është një nga institucionet më të rëndësishme të Bashkimit Evropian, misioni dhe funksioni qëndror i së cilës është: “garantimi i zbatimit të ligjit në interpretimin dhe zbatimin e Traktateve”.* Ky mision i Gjykatës së Drejtësisë, është parashikuar, në mënyrë të shprehur, në pikën 1 të nenit 19 të Traktatit të Bashkimit Evropian, nga i cili rezulton se, misioni i saj është sigurimi i zbatimit, uniform, të së drejtës së Bashkimit Evropian.

Arsyeja kryesore e krijimit të kësaj Gjykate buron nga fakti se, *çdo sistem ligjor mund të jetë i vazhdueshëm vetëm në qoftë se, rregullat e tij kontrollohen nga një Autoritet i Pavarur.* Duke qenë se, Bashkimi Evropian i krijuar Traktatet Themeluese, përbënte një bashkim Shtetesh të Pavarura, rregullat e përbashkta të Bashkimit, nëse do t'i nënshtroheshin kontrollit të gjykatave të Shteteve Anëtare, kjo do të çonte në një interpretim dhe zbatim të ndryshëm të këtyre rregullave, nga Shtete të ndryshme Anëtare. Pikërisht, *sigurimi i zbatimit uniform të së drejtës së Bashkimit Evropian, si dhe sigurimi i vazhdimësisë së vetë kësaj organizate,* përbën edhe arsyen kryesore të lindjes së Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

2. Gjykata Evropiane e Drejtësisë, përveç misionit të saj kryesor që është garantimi i interpretimit uniform të së drejtës së Bashkimit Evropian, ushtron edhe funksione të tjera, një nga më të rëndësishmet është, *ushtrimi i funksioneve të balancës dhe kontrollit, ndërmjet institucioneve të Bashkimit Evropian.* Aspekti kontrollues i kësaj Gjykate, duket në disa drejtime, të cilat përbëjnë edhe pjesë të rëndësishme të juridiksionit të saj. Kështu, në rastet kur, kjo Gjykatë, merr për shqyrtim dhe vendos për paditë që kanë të bëjnë me vlefshmërinë ligjore të akteve që nxjerrin institucionet e ndryshme të Bashkimit Evropian, si Komisioni Evropian, Këshilli, apo Parlamenti Evropian, sigurisht, në këto raste, ajo ushtron kompetenca të rëndësishme kontrolli dhe balance, ndërmjet institucioneve. Po ashtu, në rastet kur, kjo Gjykatë, shqyrton padi me objekt mosveprimin e institucioneve të ndryshme të Bashkimit, edhe në këto raste, ajo ushtron kompetenca kontrolli, mbi mënyrën, sesi duhet të veprojnë institucionet e ndryshme të Bashkimit Evropian.

Si datë e krijimit të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, konsiderohet *data 18 prill 1951*, e cila, është data e nënshkrimit të Traktatit të Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut nga gjashtë Shtete, Franca, Gjermania, Italia, Holanda, Belgjika dhe Luksemburgu, Traktat, i cili, ishte i hapur për nënshkrim, për të gjitha shtetet e tjera të Evropës, Traktat që hyri në fuqi, *me datë 25 korrik 1952.* Ky Traktat, i cili kishte si qëllim krijimin e një Tregu të Përbashkët Evropian të Qymyrit dhe Çelikut si dhe krijimin e institucioneve të përbashkëta me qëllim garantimin e zbatimit të detyrimeve që buronin nga Traktati, krahas organeve të tjera, krijoi edhe Gjykatën e Drejtësisë. Që nga koha e krijimit të saj, e deri më sot Gjykata Evropiane e Drejtësisë, i është nënshtuar një procesi të evoluimit të vazhdueshëm historik, ashtu si dhe vetë

Bashkimi Evropian dhe sot, nga një Gjykatë e ndarë për çdo Komunitet, që krijuan Traktatet Themeluese, paraqitet si një insitucion, i cili përbëhet nga tre organe gjyqësore të pavarura:

- a) Gjykata e Drejtësisë;
- b) Gjykata e Përgjithshme (ish Gjykata e Shkallës së Parë) dhe
- c) Gjykatat e specializuara.

1. Përsa i përket natyrës së kësaj Gjykate, mund të konkludojmë se, *Gjykata Evropiane e Drejtësisë, është një gjykatë e një lloji të veçantë "siu generis", duke përbërë organin gjyqësor të Bashkimit Evropian, juridiksioni i së cilës është, të garantojë respektimin e ligjit me anë të interpretimit të Traktatave dhe të të interpretojë të drejtën evropiane. Një tjetër veçori që ka të bëjë me natyrën e kësaj Gjykate, është fakti se, në Traktatet Kushtetuese dhe në normat e tjera juridike që përbëjnë rendin juridik evropian, nuk janë parashikuar organe të posaçme, brenda Bashkimit Evropian, që të bëjnë ekzekutimin e vendimeve që ajo jep. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës, i është lënë kompetencë organeve të brendshme të Shteteve Anëtare, të cilat duhet të marrin masa konkrete për ekzekutimin e tyre.*

2. Gjatë veprimtarisë së saj, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, ka shpallur dhe zhvilluar disa parime të rëndësishme, një nga më kryesoret është *parimi i ligjshmërisë. Sipas këtij parimi, çdo institucion i Bashkimit Evropian, përfshirë edhe vetë Gjykatën, çdo qytetar i Bashkimit, si dhe çdo person fizik ose juridik privat apo publik që ndodhet nën juridiksionin e Bashkimit, është i detyruar që të zbatojë ligjin dhe askush nuk mund të qëndrojë mbi ligjin. Parimi i ligjshmërisë është parë nga Gjykata i lidhur ngushtë me parimin e përgjegjësisë dhe të llogaridhënies, sipas të cilit, të gjitha institucionet e Bashkimit Evropian, mbajnë përgjegjësi për shkeljet e mundshme të ligjit, si dhe duhet të japin llogari për mënyrën e ushtrimit të pushtetit të tyre.*

Një nga parimet bazë të veprimtarisë së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, është *parimi i delegimit të kompetencave. Ky parim është parashikuar, në mënyrë të shprehur, në Traktatet Kushtetuese dhe është një nga parimet më të rëndësishme, sepse, Gjykata, ashtu si dhe çdo insitucion tjetër i Bashkimit, mund të veprojë vetëm brenda fushës ose sferës së kompetencave që Traktatet Kushtetuese i kanë deleguar Bashkimit Evropian, dhe nuk mund të veprojë në rrethin e çështjeve, të cilat janë lënë në kompetencë të Shteteve Anëtare. Bazuar në parimin e delegimit të kompetencave, kompetencat për institucionet e Bashkimit Evropian, ndahen në tre lloje:*

- a) Kompetenca ekskluzive;
- b) Kompetenca të përbashkëta dhe
- c) Kompetenca të ndara.

Me kompetenca ekskluzive kuptojmë ato fusha apo çështje, në të cilat vetëm Bashkimi Evropian ka të drejtë që të nxjerrë akte juridike me fuqi detyruese të përgjithshme, ndërsa, Shtetet Anëtare mund ta bëjnë një gjë të tillë, vetëm nëse një të drejtë të tillë ua jep Bashkimi.

Me kompetenca të përbashkëta kuptojmë ato fusha apo çështje, për të cilat akte juridike me fuqi detyruese, kanë të drejtë që të nxjerrin si Bashkimi Evropian ashtu edhe Shtetet Anëtare, por, që aktet juridike nxirren nga Shtetet Anëtare, vetëm në masën që Bashkimi nuk i ka nxjerrë këto akte ose në rastet kur ai nuk i ushtron kompetencat e tij. Si kompetenca të përbashkëta, mund të konsiderohen edhe ato

fusha, ku Bashkimi Evropian ka kompetencë për të kryer veprime të caktuara, me qëllim mbështetjen, bashkërendimin dhe plotësimin e veprimeve të Shteteve Anëtare. *Me kompetenca të ndara, kuptojmë atë fusha apo çështje, ku, akte juridike me fuqi detyruese, mund të nxjerrin si Shtetet Anëtare, ashtu edhe Bashkimi Evropian, por, nxjerrja e tyre bëhet e ndarë, në përputhje me të drejtën që i është dhënë secilit prej tyre, në Traktatet Kushtetuese dhe në rendin juridik të brendshëm të secilit Shtet Anëtar, për Shtetet Anëtare.*

Bazuar në parimin e delegimit të kompetencave Gjykata Evropiane e Drejtësisë, ka juridiksion dhe mund të vendosë si për çështje, të cilat përfshijnë kompetencat ekskluzive të Bashkimit Evropian, ashtu edhe për çështje që përfshihen në kompetencat e përbashkëta dhe kompetencat e ndara, por, në rastin e kompetencave të ndara, Gjykata ka kompetencë vetëm për ato fusha, ku Traktatet Themeluese i njohin të drejtë Bashkimit që të nxjerrë norma juridike me fuqi detyruese. Ndërsa, për kompetencat e ndara, të cilat sipas Traktateve Themeluese dhe të drejtës së brendshme të Shteteve Anëtare, të drejtën për të nxjerrë norma juridike detyruese, e kanë vetëm Shtetet Anëtare, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, nuk ka juridiksion dhe kompetencë për të vendosur në lidhje me këto fusha, por, një të drejtë të tillë, e kanë gjykatat e brendshme të Shteteve Anëtare.

Një tjetër parim i rëndësishëm mbi bazën e të cilit Gjykata Evropiane e Drejtësisë e bazon veprimtarinë e saj, është parimi i proporcionalitetit. Duke u nisur nga rëndësia që paraqet për të drejtën e Bashkimit Evropian, ky parim, së bashku me parimin e subisdaritetit, janë parashikuar në një Protokoll të veçantë, që është Protokollin nr. 2, i quajtur: *“Protokolli për zbatimin e parimeve të subisdaritetit dhe proporcionalitetit”*, i cili është pjesë përbërëse dhe ka të njëjtën vlerë si dhe vetë Traktatet Kushtetuese. Sipas parimit të proporcionalitetit *çdo akt dhe veprim i Bashkimit Evropian dhe institucioneve të tij, nuk duhet të tejkalojë kufijtë që janë të nevojshëm për arritjen e objektivave të Bashkimit.* Pra, në bazë të këtij parimi duhet të ketë një përputhje, ndërmjet mjeteve që përdoren për arritjen e qëllimeve të caktuara dhe vetë këtyre qëllimeve që duhet të arrihen. *Parimi i proporcionalitetit nënkupton se, çdo veprim i vetë Bashkimit Evropian, si dhe i institucioneve të tij, si përsa i përket formës ose përmbajtjes, duhet të merret brenda kufijve që janë të nevojshëm për arritjen e objektivave, për të cilat ndërmerret ai veprim.* Në këtë rast, paraqet rëndësi, jo vetëm përmbajtja e veprimit, me anë të të cilit mund të cënohen të drejtat e subjekteve të caktuar, por edhe forma e tij, sepse, në disa raste, të drejtat mund të cënohen, jo vetëm nga përmbajtja e veprimit por, edhe nga forma e tij.

Një tjetër parim i cili është sanksionuar nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë me veprimtarinë e saj, është edhe parimi i mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të njeriut. Në shpalljen dhe zhvillimin e këtij parimi, duhet thënë se, kjo Gjykatë ka luajtur një rol krijues, pasi në Traktatet e para Themeluese, nuk kishte ndonjë dispozitë të shprehur, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ndërkohë që, *Gjykata Evropiane duke i interpretuar këto Traktate, jo në mënyrë mekanike, por në mënyrë krijuese, që në vendimet e saj të para, ka sanksionuar se, parimi i mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të njeriut, përbën një nga shtyllat kryesore të rendit juridik evropian.*

Aktualisht, ky parim përbën një nga parimet kushtetuese më të rëndësishme, sepse nga ana e Bashkimit Evropian, është nënshkruar *Karta Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në vitin 2000, përfshirë edhe ndryshimet e bërë asaj në vitin 2009, Kartë e cila është pjesë përbërëse e Traktateve Kushtetuese dhe ka të njëjtën vlerë me ta.*

Një parim tjetër i cili është parashikuar në Traktatet Kushtetuese, por që është zhvilluar edhe nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë është *parimi i barazisë para ligjit dhe ai i mosdiskriminimit*. Në bazë të këtij parimi të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe që kanë të bëjnë me ngjyrën, racën, fenë, origjinën shoqërore, gjininë, bindjet politike, orientimin seksual, si dhe për asnjë shkak tjetër që nuk është objektiv dhe i arsyeshëm. Në Traktatet Kushtetuese janë parashikuar disa dispozita, të cilat kanë për qëllim që të ndalojnë diskriminimin e personave, në të gjitha fushat, si dhe është parashikuar edhe detyrimi për Shtetet Anëtare që të marrin masa konkrete, me qëllim ndëshkimin e personave që kryejnë veprime ose mosveprime diskriminuese, gjë që tregon se, parimi i barazisë para ligjit dhe ai i mosdiskriminimit, përbën një nga parimet më të rëndësishme ku është e bazuar e drejta e Bashkimit Evropian.

Një tjetër parim që është zhvilluar dhe sanksionuar nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë është *parimi i sigurisë juridike*. Ky parim përbëhet nga disa elementë kryesore, të cilët janë:

- *normat juridike me fuqi detyruese të përgjithshme, duhet që të nxirren vetëm nga një organ i përcaktuar, që zakonisht është organi legjislativ;*
- *normat juridike funksionojnë mbi bazën e parimit të hierarkisë, ku normat e nivelet më të ulët, duhet të jenë në përputhje me përmbajtjen dhe qëllimin e normave të nivelit më të lartë, në të kundërt, ato janë të pavlefshme;*
- *normat juridike duhet të jenë të qarta dhe të sakta;*
- *normat juridike me fuqi detyruese të përgjithshme, nuk duhet të ndryshojnë në mënyrë të shpeshtë dhe pa arsye, pra, duhet të krijojnë parashikueshmëri dhe siguri tek qytetarët;*
- *normat juridike nuk duhet të kenë fuqi prapavepruese, me përjashtim të rasteve kur ato parashikojnë të drejta për qytetarët ose nxirret për interpretimin e normave ekzistuese.*

1. Në lidhje me përbërjen e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, Traktatet Kushtetuese, kanë përcaktuar se, ajo përbëhet nga një Gjyqtar për çdo Shtet Anëtar. Edhe çështja e përbërjes së Gjykatës, i është nënshtruar një procesi të vazhdueshëm historik, ku, pas ndryshimeve të herë pas herëshme, u mendua që numri i Gjyqtarëve të ishte fiks, 15 gjyqtarë, pavarësisht sa ishte numri i Shteteve Anëtare. Por, një gjë e tillë nuk u pranua dhe përfundimisht me Traktatin e Nisës, u vendos që, Gjykata Evropiane e Drejtësisë do të përbëhet nga një Gjyqtar për çdo Shtet Anëtar.

Një çështje e rëndësishme që ka të bëjë me organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, është çështja e Statusit të Gjyqtarëve të kësaj Gjykate. Statusi i Gjyqtarëve të kësaj Gjykate, përbëhet nga disa elementë që janë; emërimi i Gjyqtarëve, garancitë që Gjyqtarët kanë gjatë ushtrimit të detyrës, imuniteti nga procesi penal, patundshmëria nga lëvizja prej funksionit të gjyqtarit, rastet dhe procedura e shkarkimit të Gjyqtarëve, paga dhe përfitimet e tjera që Gjyqtarët gëzojnë për shkak të ushtrimit të funksionit të tyre.

Për emërimin e Gjyqtarëve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, Traktatet Kushtetuese parashikojnë se, ata emërohen me marrëveshje të përbashkët të Shteteve Anëtare, ku, çdo Shtet ka të drejtë që të emërojë një Gjyqtar. Kjo mënyrë e emërimit të Gjyqtarëve, është parashikuar, sepse Shtetet Anëtare, nuk kanë pranuar që të heqin dorë nga Sovraniteti i tyre dhe t'ia bësojnë emërimin e Gjyqtarëve, një institucioni të Bashkimit Evropian, siç mund të jetë Këshilli i Bashkimit Evropian, ose Parlamenti Evropian ose edhe dy institucione të Bashkimit, në bashkëpunim me njëri-tjetrin.

Mospranimi nga Shtetet Anëtare që Gjyqtarët e Gjykatës së Drejtësisë, të emërohen nga institucionet e Bashkimit, është një element që tregon që, Bashkimi Evropian, ngjan më shumë me organizatat ndërkombëtare, sesa, me një Shtet, qoftë ai në formën e Federatës apo Konfederatës. Pavarisht nga fakti që, Traktatet Kushtetuese kanë parashikuar edhe një Panel prej Shtatë Anëtarësh, i cili ka për detyrë që të japë mendimin e tij, në lidhje me përshtatshmërinë e kandidatëve për kryerjen e detyrave të Gjyqtarit, fakti që, Gjyqtarët emërohen, jo nga një institucion i Bashkimit Evropian, por, me marrëveshje të përbashkët, ndërmjet Shteteve Anëtare, është një tregues domethënës, që flet se Shtetet Anëtare nuk janë të gatshme që të heqin dorë nga ajo pjesë e Sovranitetit, që prek, në mënyrë të drejtpërdrejtë, interesat e tyre.

Për cilësitë që duhet të gëzojë një person që të emërohet Gjyqtar i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, Traktatet Kushtetuese parashikojnë që si të tillë mund të emërohen vetëm personat, për pavarësinë e të cilëve nuk duhet të ketë dyshime, si dhe që plotësojnë kushtet e nevojshme për të mbajtur postet, më të larta gjyqësore, në Shtetet përkatëse të tyre ose që janë juristë me aftësi profesionale të shquara. Gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, Gjyqtarët kanë imunitet nga ndjekja penale, që do të thotë që ndaj tyre, nuk mund të ngrihet një akuzë penale, nga asnjë autoritet kombëtar ose ai i Bashkimit Evropian. Nëse, organi përkatës vlerëson se, një Gjyqtar ka kryer një vepër penale, ai duhet të paraqesë kërkesë me shkrim, për heqjen e imunitetit të Gjyqtarit, në të cilën duhet të tregohen edhe arsyet dhe provat konkrete ku bazohet kjo kërkesë. Kompetente për të shqyrtuar dhe vendosur për heqjen e imunitetit të Gjyqtarit është Gjykata Evropiane e Drejtësisë, e cila, duhet të marrë vendimin për heqjen e imunitetit, me pjesëmarrjen e të gjithë Gjyqtarëve dhe me votë unanime të të gjithë Gjyqtarëve. Vetëm pas heqjes së imunitetit të Gjyqtarit, ndaj tij mund të fillojë procesi penal dhe mund të vihet nën akuzë dhe t'i nënshtrohet gjyqimit, ashtu si të gjithë qytetarët e tjerë.

Traktatet Kushtetuese kanë parashikuar si një nga elementët më të rëndësishëm të Statusit të Gjyqtarëve, patundshmërinë e lëvizjes së tyre nga funksioni. Një Gjyqtar i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, mund të largohet nga funksioni i tij, vetëm kur i mbaron mandati ose jep dorëheqjen, si dhe në rastet kur ai shkarkohet nga vetë Gjykata e Drejtësisë dhe për asnjë arsye tjetër. Një Gjyqtar mund të shkarkohet nga funksioni i tij, vetëm në rastet kur me sjelljen e tij tregon se, i ka humbur cilësitë për të qenë Gjyqtar i kësaj Gjykate. *Vendimi për shkarkimin e Gjyqtarit merret nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë, me pjesëmarrjen e të gjithë Gjyqtarëve dhe me votë unanime të të gjithë gjyqtarëve, çka tregon për rëndësinë që i kanë kushtuar Traktatet Kushtetuese, çështjes së shkarkimit të Gjyqtarëve, si një nga elementët më të rëndësishëm të Statusit të tyre.*

Mandati i Gjyqtarëve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë është 3 vjet, me të drejtë riemërimi të menjëhershme. Për mandatin e Gjyqtarëve mendoj se, zgjedhja që kanë bërë Traktatet Kushtetuese, nuk është zgjedhja më e mirë e mundshme, pasi, ekziston mundësia që Gjyqtarët, në përfundim të madatit të mos jenë plotësisht të pavarur, duke u vënë në shërbim të Qeverive të tyre që i kanë zgjedhur, me qëllim që të përfitojnë edhe një riemërim tjetër, nga Qeveria përkatëse. Për këtë arsye, mendoj që mandati i Gjyqtarëve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë të jetë më i gjatë, konkretisht 9 vjet, pa të drejtë riemërimi, të menjëhershme, sepse, në këtë mënyrë do të garantohej, në mënyrë të plotë, pavarësia e tyre nga Qeveritë e Shteteve Anëtare që i zgjedhin ato.

Gjyqtarët e Gjykatës së Drejtësisë, përveç garancive që kanë për ushtrimin e funksionit të tyre, gëzojnë edhe përfitime të tjera, siç janë paga, si lehtësirat e

nevojshme që gëzojnë edhe funksionarët më të lartë të institucioneve të tjera të Bashkimit Evropian, çka tregon që për nga statusi i tyre ata barazohen me funksionarët më të lartë të Bashkimit, duke treguar për pozitën e rëndësishme që ato kanë në të gjithë strukturën organizative të institucioneve të Bashkimit.

2.Një organ i veçantë dhe original, të cilën nuk e gjejmë në gjykatat e ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, që funksionin pranë Gjykatës së Drejtësisë, janë Avokatët e Përgjithshëm. Traktatet Kushtetuese kanë parashikuar të njëjtin status, mënyrë emërimi dhe privilegje për Avokatët e Përgjithshëm, si edhe për Gjyqtarët e kësaj Gjykate, çka tregon për rolin dhe rëndësinë që ato kanë, në kuadrin e organeve gjyqësore të Bashkimit Evropian. Modeli nga janë marrë Avokatët e Përgjithshëm, ngjan me sistemin ligjor francez, në të cilin parashikohen Komisarët e Qeverisë, të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e tyre pranë gjykatave administrative dhe Këshillit Kushtetues francez, por, ekzistojnë dallime, jo të vogla, ndërmjet Avokatëve të Përgjithshëm dhe Komisarëve të Qeverisë në Francë, ku, duhet thënë se, pushteti i këtyre të fundit është më i madh se ai i Avokatëve të Përgjithshëm, që funksionojnë pranë Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

Arsyeja e parashikimit të Avokatëve të Përgjithshëm, ka të bëjë me sistemin me një nivel gjykimi që parashikonin Traktatet Themeluese, ku Gjykata Evropiane e Drejtësisë, ishte gjykata e vetme që shqyrtonye paditë që paraqiteshin, vendimet e të cilës ishin të formës së prerë dhe ndaj tyre nuk kishte drejtë ankimi. Pikërisht për të shmangur këtë mangësi, u parashikua një organ i veçantë, siç ishin Avokatët e Përgjithshëm, të cilët kishin si detyrë, që të ngrinin para Gjykatës çështje që kishin të bënin me të drejtën evropiane, në përgjithësi, si dhe çështje që lidheshin me procesin e rregullt ligjor, kur këto çështje, nuk ishin ngritur nga palët.

Në sistemin ligjor të sotëm, pushteti gjyqësor i Bashkimit Evropian, mund të thuhet se, është i organizuar dhe funksionon, si pushteti gjyqësor i autoriteteve kombëtare të Shteteve Anëtare, pra, është një sistem me tre nivele gjykimi, ku, kemi Gjykatën e Shërbimit Civil, Gjykatën e Përgjithshme dhe Gjykatën e Drejtësisë, si shkallën më të lartë të pushtetit gjyqësor, por, përsëri, nga Traktatet Kushtetuese, është parë e arsyeshme që, Avokatët e Përgjithshëm të vazhdojnë të ekzistojnë si organe që funksionojnë pranë Gjykatës së Drejtësisë dhe aktualisht, numri i tyre është tetë. *Funksioni i Avokatëve të Përgjithshëm, në bazë të paragrafit të dytë të nenit 252 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, është që, me paanëshmëri dhe pavarësi të plotë, të bëjnë parashtrime të tyre me shkrim, për çështjet ku ato sipas Statutit duhet të marrin pjesë.* Duhet theksuar se, sipas Statutit, Avokatët e Përgjithshëm, marrin pjesë në çështjet më të rëndësishme, si dhe Mendimet e tyre me shkrim, janë të detyruar që të botohen, së bashku me vendimet përfundimtare të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Praktika ka treguar se, vlera e Mendimeve të Avokatëve të Përgjithshëm është e madhe, kjo jo vetëm duke u nisur nga profesionalizmi dhe paanëshmëria e Mendimeve të dhëna prej tyre, por edhe nga fakti se, rreth 60 përqind e Mendimeve të Avokatëve të Përgjithshëm, janë marrë në konsideratë dhe janë vlerësuar si të drejta, nga ana e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në vendimet që ajo ka marrë në të ardhmen.

3.Përveç Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, si organi më i lartë gjyqësor i Bashkimit Evropian, një organ tjetër i rëndësishëm i pushtetit gjyqësor të Bashkimit, është edhe Gjykata e Përgjithshme, ish Gjykata e Shkallës së Parë. Si datë e krijimit të Gjykatës së Përgjithshme konsiderohet data 31 tetor 1989, e cila është edhe data e

fillimit të veprimtarisë së saj. Krijimi i Gjykatës së Përgjithshme, çoi në një ndryshim rrënjësor, në sitemin e drejtësisë së Bashkimit Evropian. Kjo sepse, pas krijimit të kësaj Gjykate, sistemi gjyqësor i Bashkimit, nga një sistem me një nivel gjykimi, e cila ishte Gjykata e Drejtësisë, vendimet e të cilës ishin të formës së prerë dhe palët nuk kishin të drejtë ankimi, u shndërrua në një sistem me dy nivele gjykimi; Gjykata e Përgjithshme, ose siç njihet në aktë kohë, Gjykata e Shkallës së parë dhe Gjykata e Drejtësisë, si gjykatë e shkallës së dytë, tek e cila mund të paraqiteshin ankimet, për çështje ligjore, kundër vendimeve të Gjykatës së Përgjithshme.

Fillimisht, kjo Gjykatë, u krijua si një trupë gjyqësore, që i bashkëngjitej Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, por, me Traktatin e Nisës, ajo u parashikua si një institucion më vete, i pavarur nga Gjykata e Drejtësisë, si dhe me kompetenca dhe juridiksion të përcaktuar qartë. Aktualisht, Gjykata e Përgjithshme, është një institucion i pavarur i drejtësisë, në kuadër të sistemit gjyqësor të Bashkimit Evropian dhe organizimi dhe mënyra e funksionimit të saj, janë parashikuar, si në Traktatet Themeluese, ashtu edhe në dispozitat e Statutit të Gjykatës së Drejtësisë.

Në lidhje me emërimin dhe statusin e Gjyqtarëve të Gjykatës së Përgjithshme, në Traktatet Kushtetuese, është përcaktuar se, mënyra e emërimit dhe statusi i këtyre Gjyqtarëve është e njëjtë me emërimin dhe statusin e Gjyqtarëve të Gjykatës së Drejtësisë, çka tregon për rëndësinë shumë të madhe që ka kjo Gjykatë, në kuadër të sistemit të drejtësisë së Bashkimit Evropian. Përsa i përket juridiksionit që ka Gjykata e Përgjithshme, ose rrethit të çështjeve që ajo ka të drejtë për të shqyrtuar dhe vendosur, konstojmë se, kjo Gjykatë ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Juridiksioni më i rëndësishëm i Gjykatës së Përgjithshme, është juridiksioni fillestar i saj, i cili përbën edhe volumnin më të madh të punës të kësaj gjykate dhe rastet e shqyrtuara sipas këtij funksioni, përbëjnë edhe çështjet më të rëndësishme të gjykuara prej saj.

Në lidhje me juridiksionin fillestar të Gjykatës së Përgjithshme, konstojmë se, ky juridiksion është parashikuar, në mënyrë të përgjithshme, nga paragrafi i parë i nenit 256 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, si dhe nga neni 51 i Statutit të Gjykatës së Drejtësisë, nga i cili rezulton se, Gjykata e Përgjithshme, ka, në përgjithësi të njëjtin juridiksion me Gjykatën e Drejtësisë, me të vetmin dallim që ajo shqyrton në shkallë të parë, të gjitha llojet e padive që ngrihen nga personat fizikë ose juridikë privat, ndërsa, kur këto padi ngrihen nga Shtetet Anëtare ose institucionet e Bashkimit Evropian, kompetente për shqyrtimin e tyre është Gjykata e Drejtësisë.

Për juridiksionin rishikues të Gjykatës së Përgjithshme, mund të themi se, ajo ka të drejtë që të shqyrtojë dhe vendosë, për ankimet që bëhen kundër vendimeve të gjykatave të specializuara, siç është Gjykata e Shërbimit Civil e Bashkimit Evropian. Sipas Traktateve Themeluese dhe Statutit të Gjykatës së Drejtësisë, kundër vendimit përfundimtar të marrë nga Gjykata e Shërbimit Civil, palët kanë të drejtë që të bëjnë ankim në Gjykatën e Përgjithshme. Ankimi kundër vendimit të Gjykatës së Shërbimit Civil, mund të bëhet nga palët, si rregull, për çështje të zbatimit të ligjit, pra, për mos zbatim ose zbatim të gabuar të ligjit, nga ana e Gjykatës dhe jo edhe për çështje të vlerësimit të fakteve. Megjithatë, në rastet kur Rregullorja e Brendshme e Gjykatës e parashikon dhe e lejon, ankimi nga palët mund të bëhet edhe për çështje që kanë të bëjnë me vlerësimin e fakteve.

4.Një organ i veçantë i pushtetit gjyqësor të Bashkimit Evropian është edhe Gjykata e Shërbimit Civil, e cila është krijuar me datë 22 korrik 2005, që është edhe data e fillimit të veprimtarisë së saj. Gjykata e Shërbimit Civil, është një gjykatë e

specializuar, e cila, ka për kompetencë për të shqyrtuar dhe vendosur për mosmarrëveshjet që lindin nga mardhëniet e punës, ndërmjet nëpunësve të Bashkimit Evropian dhe institucioneve, organeve, agjensive dhe zyra të Bashkimit. Kundër vendimeve të Gjykatës së Shërbimit Civil, palët kanë të drejtë që të bëjnë ankim, për çështje ligjore në Gjykatën e Përgjithshme dhe në raste të jashtëzakonshme, kur vihet në rrezik uniformiteti i së drejtës së Bashkimit Evropian, palët mund të paraqesin ankim edhe kundër vendimit të Gjykatës së Përgjithshme, në Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Emërimi i Gjyqtarëve të Gjykatës së Shërbimit Civil, në ndryshim nga Gjyqtarët e Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme, të cilët emërohen me marrëveshje të përbashkët të Shteteve Anëtare, bëhet institucionet e Bashkimit Evropian, konkretisht nga Këshilli, pasi ky i fundit të ketë marrë mendimin e Komitetit për emërimin të përbërë nga 7 anëtarë. Si Gjyqtarë të Gjykatës së Shërbimit Civil, mund të emërohen, vetëm personat që plotësojnë kriterët ligjore për t'u emëruar si gjyqtar në Shtetet Anëtare dhe për pavarësinë e të cilëve nuk mund të ketë dyshime.

5. Gjykimi i çështjeve nga ana e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë bëhet sipas një procedure të caktuar, rregullat e së cilës janë parashikuar në Statutin e Gjykatës dhe në Rregulloren e Procedurës. Procedura e gjykimit kalon në dy fazë ose pjesë; në pjesën me shkrim dhe në pjesën me gojë ose në senacë gjyqësore publike. Gjatë pjesës me shkrim, secilës prej palëve ndërgjyqëse, i jepet mundësia që të paraqesë me shkrim, të gjitha pretendimet dhe aragumentet e saj, si dhe provat konkrete, që ajo mendon për të provuar faktet e pretenduara.

Me përfundimin e pjesës me shkrim të procedurës, çështja kalon në pjesën me gojë ose në seancë gjyqësore, por, përpara se palët të paraqiten në pjesën me gojë ose verbale të procedurës, sipas nenit 44 të Rregullores së Procedurës, Kryetari i Gjykatës së Drejtësisë, cakton një Gjyqtar Relator, i cili, ka për detyrë që të përgatisë një Raport Paraprak. Ky Raport duhet të përmbajë:

- rekomandime për marrjen e masave paraprake nga Gjykata, nëse, një gjë e tillë është e nevojshme;*
- propozimin, nëse, çështja do të gjykohej me trup gjykues të përbërë nga tre apo pesë gjyqtarë ose nga Dhoma e Madhe;*
- propozimin, nëse, është e nevojshme që të mos zhvillohet pjesa me gojë ose orale e procedurës;*
- propozimin nëse për çështjen konkrete, duhet marrë apo jo mendimi i Avokatit të Përgjithshëm.*

Raporti Paraprak i Gjyqtarit Relator i paraqitet Mbledhjes së Përgjithshme të Gjykatës së Drejtësisë, e cila vendos në lidhje me veprimet konkrete që do të ndërmerren për zgjidhjen e çështjes konkrete. Mbledhja e Përgjithshme për veprimet që do të ndërmerren, vendos pasi të ketë dëgjuar Avokatin e Përgjithshëm. Në Rregulloren e Procedurës përcaktohet se, caktimi i Gjyqtarit Relator për hartimin e Raportit Paraprak, bëhet nga ana e Kryetarit të Gjykatës, vetëm pasi të ketë kaluar afati i vendosur për palët për depozitimin e kundërpërgjigjeve me shkrim. Kryetari i Gjykatës cakton Gjyqtarin Relator edhe në rastet kur, palët deklarojnë me shkrim se heqin dorë nga depozitimi i kundërpërgjigjeve me shkrim, si dhe kur është kërkuar procedura e përshpejtuar, ku, në këtë rast Kryetari i Gjykatës, përveç caktimit të Gjyqtarit Relator, cakton edhe datën për zhvillimin e pjesës me gojë të procedurës.

Masat Paraprake, të cilat njihen edhe me emrin Hetimet Paraprake të Gjykatës, përfshijnë në vetvete, një ose disa nga veprimet e mëposhtme:

- i. paraqitjen personale të palëve;
- ii. kërkesë për informacion;
- iii. kërkesë për paraqitjen e dokumenteve;
- iv. dëshmitë gojore para Gjykatës;
- v. kryerjen e një akti ekspertimi;
- vi. kqyerjen e vendeve apo sendeve.

Pas marrjes së një ose disa prej këtyrë Masave Parprake, çështja, kalon në pjesën me gojë të procedurës, ku Shtetet Anëtare dhe institucionet e Bashkimit Evropian përfaqësohen nga një agjent të emëruar për çdo çështje, i cili mund të mbështetet nga një këshilltar ose avokat, ndërsa personat fizikë dhe/ose juridikë privat përfaqësohen me nga një avokat. Gjatë pjesës me gojë të procedurës së gjykimit para Gjykatës së Drejtësisë, seanca gjyqësore, si rregull, zhvillohet me dyer të hapura ose në mënyrë publike. Megjithatë, si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, seanca gjyqësore mund të zhvillohet edhe me dyer të mbyllura, kur për arsye serioze, Gjykata vendos, kryesisht me nisëm e saj ose me kërkesë të palëve, që gjykimi do të jetë me dyer të mbyllura, por vendimi jepet, në çdo rast publikisht.

Seanca gjyqësore fillon me leximin e Raportit Paraprak të hartuar nga Gjyqtari Relator. Më pas dëgjohen agjentët, këshilltarët dhe avokatët, sipas radhës së tyre, ku në fillim e merr fjalën përfaqësuesi i paditësit, më pas i të paditurit dhe më pas bën parashtrimet e tij, përfaqësuesi i personit të tretë ose i palëve të tjera pjesëmarrëse, nëse ka të tilla. Në çështjet kur sipas Statutit të Gjykatës së Drejtësisë dhe Rregullores së Procedurës, është e domosdoshme prania e Avokatit të Përgjithshëm, ky i fundit e marr fjalën për të paraqitur Mendimin e tij, në përfundim të pjesës me gojë të procesit ose në përfundim të gjykimit, pra, para se Gjykata të tërhiqet për të marrë vendimin përfundimtar.

Në pjesën me gojë të procesit, mund të shqyrtohen prova të ndryshme, si provat me dëshmitarë, ekspertë, dokumentet shkresore, kqyerja në vend e personave dhe sendeve, rregullat për marrjen e të cilave janë trajtuar më lart. Për çdo seancë gjyqësore të zhvilluar, mbahet procesverbal nga ana e sekretarit gjyqësor, i cili, nënshkruhet në përfundim të seancës, nga personi që e ka hartuar, nga Krytari i Gjykatës së Drejtësisë dhe Kancelari.

Pas marrjes së provave dhe paraqitjes së diskutimit përfundimtar nga palët, si dhe dëgjimit të Mendimit të Avokatit të Përgjithshëm, në rastet kur ai merr pjesë në gjykim sipas Statutit, pjesa me gojë ose faza me gojë e procesit përfundon dhe Gjykata e Drejtësisë deklaron të mbyllur shqyrtimin gjyqësor dhe tërhiqet në Dhomën e Këshillimit për të marrë vendimin përfundimtar që e zgjidh çështjen në themel. Në Dhomën e Këshillimit, ku diskutohet dhe vendoset për zgjidhjen përfundimtare të çështjes, marrin pjesë vetëm Gjyqtarët që kanë gjykuar çështjen dhe asnjë person tjetër. Nuk lejohet që të marrë pjesë në Dhomën e Këshillimit, as Kryetari i Gjykatës së Drejtësisë, as Avokati i Përgjithshëm, as sekretari gjyqësor, dhe asnjë person tjetër, përveç Gjyqtarëve të çështjes.

Në Dhomën e Këshillimit paraqesin mendimet e tyre për zgjidhjen e çështjes, secili nga Gjyqtarët që ka marrë pjesë në fazën me gojë të gjykimit, duke filluar nga Gjyqtari më i ri në profesion, ndërsa i fundit voton Kryetari i trupit gjykues. *Gjyqtarët diskutojnë në lidhje me marrjen e vendimit përfundimtar, mbi bazën e një Proket-vendimi të paraqitur nga Gjyqtari Relator, megjithatë, secili nga Gjyqtarët ka të drejtë që të paraqesë propozime për ndryshime për vendimin përfundimtar. Gjykata e Drejtësisë i merr vendimet në mënyrë unanime ose me shumicë votash, megjithatë,*

vendimi i marrë prej saj konsiderohet se, është marrë, në çdo rast, në mënyrë unanime dhe nuk lejohet Mendimi i Pakicës.

Vendimi i përfundimtar i marrë nga ana e Gjykatës së Drejtësisë është i formës së prerë, domethënë, ai mund të vihet në ekzekutim, në rast se, pala që ka humbur gjyqin, nuk e zbaton atë në mënyrë vullnetare. Duke qenë se, Gjykata e Drejtësisë, është organi më i lartë gjyqësor i Bashkimit Evropian, kundër vendimeve të marra prej saj, nuk lejohet ankim dhe për pasojë, ky vendim është i detyrueshëm për palët që nga data që ai është marrë. Sipas nenit 280 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian vendimet e Gjykatës së Drejtësisë janë të ekzekutueshme, sipas procedurës së përcaktuar nga neni 299 i këtij Traktati. Nga ana e saj kjo dispozitë parashikon që, ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë bëhet sipas normave të procedurës civile në fuqi, në territorin e Shtetit Anëtar të cilit do të kryhet ky ekzekutim. Kështu, në qoftë se, vendimi i Gjykatës do të ekzekutohet në Holandë, atëherë, procedura e ekzekutimit të këtij vendimi do të bëhet, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile të Shtetit holandez.

Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Drejtësisë lëshohet urdhëri i ekzekutimit, i cili, i bashkëlidhet vendimit përfundimtar, pa asnjë lloj formaliteti tjetër, përveç verifikimit të vertetësisë së vendimit të bërë nga autoriteti kombëtar, të cilin Qeveria e çdo Shteti Anëtar e ka caktuar për këtë qëllim dhe i njoftohet Gjykatës së Drejtësisë dhe Komisionit Evropian. Në funksion të realizimit të një ekzekutimi sa më të shpejtë të vendimit të Gjykatës, është parashikuar që, në qoftë se, formalitetet e lëshimit të urdhërit të ekzekutimit dhe të dorëzimit të vendimit, janë përfunduar me kërkesë të palës gjyqësuese, ajo ka të drejtë që të paraqesë kërkesë, drejtpërdrejt, përpara autoritetit kompetent, me qëllim që të realizojë ekzekutimin e vendimit në përputhje me legjislacionin e tij kombëtar.

1. Një nga paditë më të rëndësishme që paraqiten para Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, janë *paditë e ngritura nga personat fizikë ose juridikë privat, me objekt paligjshmërinë e akteve të institucioneve të Bashkimit Evropian, padi që janë parashikuar në nenin 263 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian*. Nga përmbajtja e kësaj dispozite, si dhe duke iu referuar vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, për ngritjen e kësaj padie, personi fizik ose juridik privat, duhet të plotësojë disa kushte, që janë:

- a) Padia duhet të ngrihet ndaj një akti që, realisht ekziston;
- b) padia duhet të ngrihet ndaj një akti të nxjerrë nga institucionet e Bashkimit Evropian;
- c) Padia duhet të ngrihet ndaj një akti që prodhon efekte ligjore ndaj të tretëve;
- ç) Padia duhet të ngrihet ndaj një akti dhe në rastet kur ai është një akt i përgjithshëm dhe abstrakt, në qoftë se ai, prek, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe individuale, interesat e paditësit;
- d) Padia brenda dy muajve nga data e nxjerrjes së aktit ose nga data e njoftimit të tij, kur palët janë në mungesë.

Nga të pesë kushtet e mësipërme, kushti ose kriteri, i cili është më i vështirë për t'u provuar nga paditësi dhe ka ngjallur më shumë debate në praktikën e vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, është kriteri i katërt, i përmendur në germën "ç", më sipër, sipas të cilit, paditësi duhet të provojë se akti prek, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe individuale interesat e tij. Në lidhje me plotësimin e këtij kriteri Gjykata ka nxjerrë disa vendime të saj, ku, vendimi i parë kishte të bënte me çështjen gjyqësore Plaumann kundër Komisionit Evropian dhe për këtë arsye, ky kriter njihet

edhe si *kriteri Plaumann*. Kjo çështje gjyqësore është trajtuar nga ana ime në Punim dhe kishte të bënte me një Kërkesë që Qeveria Gjermane i bëri Komisionit Evropian, me të cilën kërkonte nga Komisioni që të autorizonte Qeverinë Gjermane që të pezullonte mbledhjen e taksave doganore për mandarinat e importuara nga Shtetet jo Anëtare. Kjo Kërkesë e Qeverisë Gjermane u hodh poshtë nga Komisioni, i cili i ktheu edhe përgjigje zyrtare asaj për hedhjen poshtë të kërkesës. Pala paditëse, shoqëria tregtare Plaumann & Co, ishte një importues i mandarinave në tregun e Komunitetit Evropian dhe ngriti padi kundër vendimit të Komisionit me objekt anulimin e tij, me pretendimin se ky Vendim cenon, drejtpërdrejt dhe individualisht interesat e saj.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë e rrëzoi padinë e ngritur shoqëria Plaumann & Co, pasi sipas Gjykatës ajo nuk arriti të provojë që akti i nxjerrë, prek, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe individuale, interesat e saj. Sipas këtij vendimi të Gjykatës, i cili duhet thënë se, është trajtuar më tej prej saj edhe në disa vendime të tjera, *do të konsiderohet se akti prek, në mënyrë individuale interesat e paditësit, në rastet kur ky i fundit për shkak të cilësive të tij të veçanta apo të situatës faktike që e karakterizon, në raport me personat e tjerë, duket qartë se akti e individualizon këtë person, duke rezultuar se, akti i drejtohet pikërisht atij dhe jo personave të tjerë. Lidhje individuale e aktit me interesat e paditësit nënkupton që, paditësi i përket një rrethi të mbyllur personash, ndaj të cilëve zbatohet akti. Por, me qëllim që të konsiderohet që akti cenon në mënyrë individuale interesat e paditësit, nuk mjafton të provohet që paditësi i përket një rrethi të mbyllur personash, por, duhet edhe të provohet që, paditësi dallohet nga rrethana të veçanta, në raport me qëllimin e aktit, rrethana të cilat tregojnë se akti i drejtohet atij.*

Një nga paditë të tjera të rëndësishme, që paraqesin personat fizikë ose juridikë privat në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë, janë *paditë me objekt mosveprimin e institucioneve të Bashkimit Evropian, padi që parashikohen në nenin 265 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian*. Edhe për ngritjen e kësaj padie, paditësi duhet të plotësojë disa kushte ose kriterë, të cilat janë:

a) Duhet që Traktatet Kushtetuese ose normat e tjera ligjore me fuqi detyruese, të parashikojnë, në mënyrë të shprehur, detyrimin e institucionit, organit, zyrës ose agjensisë së Bashkimit Evropian që të veprojnë ose të marrë një masë të caktuar në favor të paditësit;

b) Duhet që institucioni i Bashkimit Evropian, megjithëse ka detyrimin ligjor për të vepruar, në kundërshtim me parashikimet e Traktateve Kushtetuese dhe/ose të normave të tjera ligjore, nuk ka vepruar;

c) Duhet që personi fizik ose juridik privat, t'i ketë bërë thirrje më parë institucionit për të vepruar dhe ai, përsëri, nuk ka vepruar;

ç) Duhet që personi fizik ose juridik privat, të pretendojë nxjerrjen e një akti me fuqi detyruese dhe jo të një akti me karakter këshillues ose udhëzues;

d) Duhet që personi fizik ose juridik privat, të kërkojë nxjerrjen e një akti, i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë dhe individuale me interesat e tij;

dh) Duhet që personi fizik ose juridik privat, të paraqesë padinë para Gjykatës brenda dy muajve, nga dita që i është bërë thirrje institucionit të Bashkimit Evropian për të vepruar.

Një padi tjetër që mund të ngrihet nga personat fizikë privat janë *paditë me objekt paligjshmërinë e akteve të institucioneve të Bashkimit Evropian, padi e cila parashikohet nga neni 277 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian*. Kjo padi nga ana e saj, ka disa veçori, ku si veçori e parë është fakti se, *kjo padi është një*

padi aksesore, e cila mund të ngrihet vetëm pasi është ngritur edhe është akoma duke u gjykuar, padia kryesore, që është ajo e anulimit të aktit, në bazë të nenit 263 të Traktatit. Si veçori tjetër e kësaj padie mund të përmendet se, kjo padi mund të ngrihet vetëm ndaj akteve me karakter të përgjithshëm, fakt i cili është parashikuar, në mënyrë të shprehur, në nenin 277 të Traktatit dhe që rezulton edhe nga vetë natyra e saj.

Po ashtu, vlen të theksohet se, *padia me objekt paligjshmërinë e akteve të institucioneve të Bashkimit Evropian, mund të ngrihet nga personat fizikë ose juridikë privat, vetëm kur ato nuk mund të ngrejnë asnjë padi tjetër, siç është padia e anulimit apo ajo për mosveprimin e institucioneve të Bashkimit*. Një tjetër veçori e kësaj padie është fakti që, kjo padi mund të ngrihet në çdo kohë, pra, është një padi e paparashkrueshme. Mosparashkrimi i kësaj padie, rezulton nga vetë natyra e saj, si padi aksesore. Duke qenë se, me anë të kësaj padie, pala ngren një pretendim për paligjshmërinë e një akti, me karakter të përgjithshëm, por, është një pretendim që ngrihet në një gjykim tjetër, që është ai me objekt anulimin e aktit, si dhe duke qenë se, ky pretendim është me natyrë aksesore, pra, është i varur nga koha kur do të ngrihet padia kryesore e anulimit të aktit, padia me objekt paligjshmërinë e aktit, për nga vetë natyra e saj, mund të ngrihet në çdo kohë.

2.Një nga paditë më të shpeshta që paraqiten nga personat fizikë ose juridikë privatë, kundër institucioneve të Bashkimit Evropian, janë *paditë me objekt shpërblimin e dëmit kontraktor dhe jashtëkontraktor*. Për përgjegjësinë kontraktore të institucioneve të Bashkimit Evropian, Traktatet Kushtetuese parashikojnë që, *kjo përgjegjësi rregullohet sipas ligjit që është i zbatueshëm për kontratën konkrete të lidhur*. Kështu, nëse një institucion i Bashkimit Evropian, lidh një kontratë furnizimi me një shoqëri tregtare dhe palët në kontratë parashikojnë që për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve, ligji i zbatueshëm do të jetë ligji gjerman, atëherë, përgjegjësia kontraktore e këtij institucioni do të rregullohet sipas ligjit të Shtetit Gjerman.

Për përgjegjësinë kontraktore problemi paraqitet më i vështirë, kur palët në kontratë nuk kanë parashikuar ligjin e zbatueshëm. Në raset e tilla, çështja sesi do të rregullohet përgjegjësia kontraktore e institucioneve të Bashkimit Evropian, zgjidhet nga e Drejta Ndërkombëtare Private, e cila këto mardhënie kontraktore i quan si *Mardhënie Juridike me Elementë të Huaj*. Përcaktimi i përgjegjësisë kontraktore në këtë rast, bëhet në bazë të Kriterit Lidhës, sipas të cilit, për rregullimin e mardhënieve kontraktore do të zbatohet, ai ligj, i cili është më i afërt me mardhënien kontraktore të lidhur, fakt i cili, përcaktohet, rast pas rasti, nga ana e Gjykatës.

Në lidhje me përgjegjësinë kontraktore të institucioneve të Bashkimit Evropian, duhet theksuar se, kompetenca e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë është një kompetencë fakultative, mbi bazën e zgjedhjes së palëve, fakt ky që është parashikuar, në mënyrë të shprehur në nenin 272 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian. Në bazë të kësaj dispozite, që Gjykata të ketë kompetencë për të vendosur për përgjegjësinë kontraktore të institucioneve të Bashkimit, duhet që palët në kontratën e lidhur, me marrëveshje ndërmjet tyre, të parashikojnë një *Klauzolë Arbitrazhi*, në të cilën të përcaktohet, në mënyrë të shprehur që, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve, do të jetë Gjykata Evropiane e Drejtësisë.

Në ndryshim nga përgjegjësia kontraktore, *tek përgjegjësia jashtëkontraktore e institucioneve të Bashkimit Evropian, kompetenca e Gjykatës Evropiane e*

Drejtësisë, është e detyrueshme, që do të thotë, se, kompetente për gjykimin dhe përcaktimin e përgjegjësisë jashtëkontraktore që insitucionet e Bashkimit Evropian, mund të kenë ndaj palëve të treta, është, në çdo rast, Gjykata Evropiane e Drejtësisë. Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të institucioneve të Bashkimit Evropian, Traktatet Kushtetuese kanë parashikuar që, kjo përgjegjësi rregullohet nga parimet e përgjithshme që janë të përbashkëta për ligjet e Shteteve Anëtare. Duke qenë se, sistemi ligjor i Shteteve Anëtare të Bashkimit është i ndryshëm, është e vështirë të përcaktohen se cilat janë parimet e përbashkëta të ligjeve të këtyre Shteteve, që rregullojnë përgjegjësinë jashtëkontraktore, por, duhet thënë se, një kontribut të madh në përcaktimin e rregullave për përvaktimin e kësaj përgjegjësie, ka dhënë Gjykata Evropiane e Drejtësisë me disa vendime të saj.

Duke iu referuar parimeve të përgjithshme që janë të përbashkëta për ligjet e Shteteve Anëtare, si dhe vendimeve të Gjykatës Evropiane, rezulton se, kushtet që duhet të ekzistojnë për përgjegjësinë jashtëkontraktore të institucioneve të Bashkimit Evropian, janë tre:

- a) veprimi ose mosveprimi i paligjshëm;*
- b) shkaktimi i dëmit;*
- c) lidhja shkakësore, e drejtpërdrejtë, ndërmjet veprimit ose mosveprimit dhe shkakimit të dëmit.*

Për kushtet e përgjegjësisë jashtëkontraktore të institucioneve të Bashkimit Evropian, konstatohet se, nuk përmendet si një nga kushtet *faji i institucionit*. Elementi i fajit është shmangur, jo pa qëllim nga ana e Gjykatës, si një nga kushtet e përgjegjësisë jashtëkontraktore, sepse, ky koncept është shumë i diskutueshëm, si dhe për më tepër, legjislacione të ndryshme kombëtare, i japin kuptime të ndryshme.

Përgjegjësia jashtëkontraktore e institucioneve të Bashkimit Evropian, është e ndryshme, në varësi të faktit nëse, jemi para akteve për të cilat institucionet e Bashkimit kanë një liri veprimi në nxjerrjen e tyre, të quajtura edhe Akte Vetëgjykimore, apo jemi para akteve ku insitucionet e Bashkimit, nuk kanë liri veprimi, të quajtura si Akte Jo Vetëgjykimore. Si rregull, i përgjithshëm, personat fizikë ose juridikë privatë e kanë më të vështirë që të provojnë përgjegjësinë e institucioneve të Bashkimit Evropian, në rastin e Akteve Vetëgjykimore, sesa, në rasin e Akteve Jo Vetëgjykimore, pasi në rastin e parë, përveç kushteve të përgjithshme të përgjegjësisë jashtëkontraktore duhet të provojnë edhe ekzistencën e disa kushteve të veçanta, të cilat do të përmenden më poshtë.

Konkretisht, në raste e Akteve Vetëgjykimore, për të provuar përgjegjësinë jashtëkontraktore të institucioneve të Bashkimit Evropian, paditësi përveç kushteve të përgjithshme të përgjegjësisë jashtëkontraktore, duhet të provojë edhe këto kushte:

i. duhet që akti të përbëjë një shkelje flagrante të ligjit, ku, si të tilla konsiderohen rastet kur institucioni i Bashkimit ka kaluar, hapur, lirinë e tij të veprimit të dhënë nga norma ligjore ose ka abuzuar me këtë liri;

ii. duhet që akti të ketë shkelur një normë ligjore superiore;

iii. duhet që akti i shkelur të jetë miratuar me qëllimin e posaçëm për mbrojtjen e individit.

Për Aktet Jo Vetëgjykimore për provimin e përgjegjësisë jashtëkontraktore të institucioneve të Bashkimit Evropian, personi fizik ose juridik privat, mjafton të provojë kushtet e përgjithshme të përgjegjësisë. Për këto Akte, një rëndësi të madhe paraqet provimi i kushtit të parë, që ka të bëjë me paligjshmërinë e veprimit ose mosveprimit të institucioneve të Bashkimit, pasi Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në

disa vendime të saj e ka barazuar këtë kusht me kushtin e parë të veçantë që ka të bëjë me përgjegjësinë jashtëkontraktore për Aktet Vetëgjykimore, pra, kërkohet që shkelja e bërë nga institucioni të jetë një shkelje flagrante e ligjit.

Përveç përgjegjësisë jashtëkontraktore që kanë institucionet e Bashkimit Evropian për aktet e paligjshme të tyre, ato, si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, mbajnë përgjegjësi jashtëkontraktore edhe në rastet e akteve të tyre të ligjshme, në rastet kur këto akte u kanë shkatuar dëme personave fizikë ose juridikë privat. Por, që institucionet e Bashkimit të mbajnë përgjegjësi jashtëkontraktore për aktet e tyre të ligjshme, duhet që të plotësohen, në të njëjtën kohë tre kushte:

- *duhet që dëmi të jetë i jashtëzakonshëm, domethënë, të cenojë një numër të caktuar subjektesh, në mënyrë jo të barabartë me subjektet e tjerë;*

- *duhet që dëmi të jetë i veçantë, domethënë, t'i tejkalojë rreziqet e zakonshme ekonomike;*

- *duhet që akti i ligjshëm që ka shkaktuar dëmin, të mos jetë marrë për mbrojtjen e një interesi të përgjithshëm ekonomik.*

Dëmi jashtëkontraktor mund t'i shkatohet personit fizik ose juridik privat edhe nga veprimet ose mosveprimet e përbashkëta të Shteteve Anëtare dhe institucioneve të Bashkimit Evropian. Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka përcaktuar se, personi fizik ose juridik privat mund të ngrejë për dëmin e përbashkët, në qoftë se, ekziston një nga këto raste:

a) Kur Bashkimi Evropian nuk ka marrë masat e duhura për shkeljen e së drejtës së Bashkimit nga ana e Shteteve Anëtare. Për të vendosur përgjegjësinë jashtëkontraktore të institucioneve të Bashkimit, në këtë rast, kërkohet, kërkohet jo vetëm mosmarrja e masave, por edhe ndërmarrja e veprimeve që konfirmojnë ose miratojnë veprimin e kryer, nga autoritetet kombëtare.

b) Kur Shteti Anëtar ka zbatuar legjislacionin e paligjshëm të Bashkimit Evropian.

Në rastet kur dëmi jashtëkontraktor është shkaktuar si pasojë e veprimeve të përbashkëta të institucioneve të Bashkimit Evropian dhe Shteteve Anëtare, Gjykata e Drejtësisë ka përcaktuar që, fillimisht padia duhet të ngrihet në gjykatat kombëtare dhe më pas në organet gjyqësore të Bashkimit. Arsyetimi që ka dhënë Gjykata në këtë rast, është se, sipas saj, në këtë mënyrë, shmanget shpërblimi i dyfishtë ose i mangët që mund të marrin personat e dëmtuar, si dhe ka vlerësuar që përgjegjësia e institucioneve të Bashkimit, në këtë rast, të jetë plotësuese, vetëm për pjesën që personi i dëmtuar, nuk është shpërblyer nga autoritetet kombëtare të Shtetit të tij.

Personat fizikë ose juridikë privat mund të pësojnë dëme jashtëkontraktore edhe nga nëpunësit e Bashkimit Evropian. Për dëmet jashtëkontraktore të shkaktuara nga nëpunësit e tij, përballë personave të tretë, përgjigjet Bashkimi Evropian, por, që ai të mbajë një përgjegjësi të tillë, duhet që përveç kushteve të përgjithshme, të provohet edhe kushti i veçantë që dëmi i shkaktuar nga nëpunësi personit privat, të jetë shkaktuar gjatë punës ose për shkak të punës.

Personi fizik ose juridik privat duhet që ta ngrejë padinë me objekt shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor ndaj institucioneve të Bashkimit Evropian, brenda 5 viteve, nga data e shkaktimit të dëmit ose nga data e vënies në dijeni të tij për dëmin e pësuar. Në qoftë se, pala e dëmtuar e ka humbur afatin 5 vjeçar, për shkaqe të arsyeshme, ai kë të drejtë që të rivendoset në afat, me qëllim që të paraqesë padinë me këtë objekt.

3. Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian, në bazë të Traktateve Kushtetuese të Bashkimit, marrin përsipër të drejta dhe detyrime të caktuara, ku, një nga detyrimet kryesore të tyre është që të zbatojnë të drejtën e Bashkimit. *Në qoftë se, një Shtet Anëtar kryen një veprim ose mosveprim, apo kryen një shkelje që cenon të drejtën e Bashkimit Evropian, Komisioni Evropian, ka të drejtë që të nisë procedurat ligjore, me qëllim që ta detyrojë Shtetin Anëtar që të ndreqë shkeljen e bërë.* Traktatet Kushtetuese kanë parashikuar që është Komisioni ai që nis procedurat ligjore kundër Shtetit që ka kryer shkeljen, sepse, Komisioni është institucioni i Bashkimit që siguron zbatimin e Traktateve, si dhe nxit dhe promovon interesat e përgjithshme të Bashkimit Evropian.

Procedurat ligjore të Komisionit kundër Shtetit të Paditur që ka kryer shkeljen e së drejtës së Bashkimit Evropian, kalojnë nëpër katër faza:

- a) faza fillestare ose informale;*
- b) faza e Njoftimit Zyrtar nga ana e Komisionit;*
- c) faza e Mendimit të Arsytuar;*
- ç) faza e ngritjes së padisë para Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.*

Faza fillestare e procedurave ligjore, është *një fazë informale dhe diplomatike*, e cila synon zgjidhjen miqësore të mosmarrëveshjes, para se ajo të kalojë në fazat zyrtare të procedurave. Gjatë kësaj faze, Komisioni komunikon, në mënyrë informale, me përfaqësuesin e Shtetit të Anëtar, në Bashkimin Evropian, të cilit i shtron për diskutim objektin e mosmarrëveshjes, si dhe masat që duhet të marrë Shteti Anëtar, për të ndrequr shkeljen e kryer dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me pajtim. Komunikimi ndërmjet palëve, në këtë fazë, mund të bëhet me gojë ose me anë të një Letre Informale, që Komisioni i dërgon Shtetit Anëtar, në të cilën i propozon alternativat për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjes. Çdo komunikim që zhvillohet ndërmjet palëve në këtë fazë, është konfidencial dhe qëllimi final i kësaj faze, është zgjidhja me pajtim e mosmarrëveshjes së lindur. Edhe pse kjo është një fazë informale, kjo është një fazë e rëndësishme e të gjithë procedurave ligjore, gjë që tregohet nga fakti që, rreth 68 përqind e mosmarrëveshjeve të lindura, ndërmjet Komisionit dhe Shteteve Anëtare, janë zgjidhur me pajtim gjatë kësaj faze.

Në qoftë se, mosmarrëveshja e lindur ndërmjet Komisionit dhe Shtetit Anëtar nuk zgjidhet gjatë fazës së parë informale, procedurat ligjore kalojnë në fazën e parë zyrtare, që është ajo e Njoftimit Zyrtar që Komisioni i bën Shtetit Anëtar, për shkeljen e bërë prej tij ose për mospërmblidhjen e detyrimeve ligjore prej tij. Komisioni e njofton Shtetin Anëtar për mospërmblidhjen e detyrimeve ligjore prej tij, me anë të një Letre Zyrtare, në të cilën përcaktohen shkeljet konkrete, që ka kryer Shteti në fjalë, si dhe e fton atë që të paraqesë kundërshtimet e tij, nëse ai dëshiron, për shkeljet e konstatuara nga Komisioni. Dërgimin e Letrës Zyrtare Shtetit Anëtar, Komisioni duhet ta bëjë brenda një afati të arsyeshëm, nga konstatimi i shkeljes dhe duhet të kemi parasysh faktin Komisioni ka liri të plotë, për të vlerësuar, nëse, do të fillojë procedurat zyrtare, kundër Shteteve Anëtare për shkeljet e bëra prej tyre.

Komisioni nuk fillon procedurat zyrtare kundër Shteteve Anëtare, për çdo lloj shkeljeje ligjore që ata mund të kryejnë, por, vetëm për ato shkelje minojnë themelet e rendit juridik Evropian, ose që çenojnë funksionimin e rregullt të sistemit ligjor të Bashkimit Evropian. Një rol të rëndësishëm në fillimin e procedurave zyrtare nga ana e Komisionit luajnë qytetarët e Bashkimit Evropian, me anë të letrave, peticioneve dhe ankesave që i dërgojnë Komisionit, në të cilat parashtrohen shkeljet e mundshëm ligjore që kanë kryer Shtetet Anëtare dhe i kërkohet Komisionit që të fillojë procedurat zyrtare, me qëllim që të detyrohen këto Shtete, që të ndreqin këto shkelje.

Vetë Komisioni në disa Komunikata ka deklaruar se, roli i qytetarëve të Bashkimit Evropian, është shumë i rëndësishëm për të siguruar që ligj zbatohet nga të gjithë dhe se Bashkimi është një organizatë, ku, sundon ligji dhe drejtësia. *Roli i individëve në fillimin e procedurave zyrtare kundër Shteteve Anëtare është rritur akoma më shumë, me krijimin e Avokatit të Popullit të Bashkimit Evropian ose të Ombudsmen-it të Bashkimit, i cili, jo vetëm ka ndihmuar individët në hartimin e kërkesave dhe peticioneve, por edhe ka kontrolluar, nëse, nga ana e Komisionit këto kërkesa janë trajtuar në kohë, në mënyrë të barabartë dhe në përputhje me procedurat ligjore.*

Faza e tretë e procedurave ligjore të ndjekura nga Komisioni, e cila është edhe faza e dytë zyrtare, është faza e nxjerrjes së Mendimit të Arsyetuar nga Komisioni. Mendimi i Arsyetuar në lidhje me mosmarrëveshjen e lindur, ndërmjet Komisionit dhe Shtetit Anëtar, nxirret nga Komisioni, vetëm pasi ky i fundit t'i ketë lënë një afat të arsyeshëm Shtetit në fjalë, që të parashtrojë pretendimet dhe kundërshtimet e tij të mundshme. Mendimi i Arsyetuar është një akt shumë i rëndësishëm zyrtar, sepse, në këtë dokument përcaktohet objekti i mosmarrëveshjes ndërmjet palëve, si dhe tregohen shkeljet konkrete që ka kryer Shteti Anëtar. Ky Mendim përbën padinë e ardhshme që Komisioni mund të ngrejë në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë kundër Shtetit Anëtar dhe për pasojë duhet të pasqyrojë me hollësi të gjitha shkeljet ligjore që ka kryer Shteti i Paditur, si dhe provat ku bazohet Komisioni për provimin e këtyre shkeljeve. Nëse, Komisioni vendos që të ngrejë padi në Gjykatë, ai është i detyruar që t'i përmbahet shkeljeve që ka prezantuar në Mendimin e Arsyetuar dhe nuk mund të paraqesë në padi edhe shkelje të tjera, të cilat nuk kanë qenë pasqyruar në Mendimin e Arsyetuar.

Faza e katërt e procedurave ligjore të nisura nga Komisioni kundër Shteteve Anëtare për mospërmblidhjen e detyrimeve prej tyre, është ngritja e padisë në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë nga ana e Komisionit. Duhet të kemi parasysh se, edhe në këtë fazë, Komisioni ka liri të plotë veprimi për të vlerësuar dhe vendosur nëse do të ngrejë padi në Gjykatë kundër Shtetit Anëtar, pavarësisht se Shteti në fjalë mund të ketë kryer një shkelje ligjore të caktuar. Në vlerësimin e faktit për ngritjen e padisë, Komisioni vlerëson një sërë faktorësh, siç janë natyra e shkeljes, rëndësia e saj, pasojat e dëmshme që ka shkaktuar, sjelljet e Shtetit Anëtar, gjatë fazave të mëparshme të procedurës, por edhe faktorë politikë dhe pragmatistë. Pavarësisht se, Komisioni ka liri të plotë veprimi për të vlerësuar, nëse, do të ngrejë padi ndaj një Shteti Anëtar, për një ose disa shkelje ligjore të kryera prej tij, duhet thënë se, kjo liri nuk është e pakufizuar dhe për pasojë, Komisioni duhet që të ngrejë një padi të tillë, në rastet kur, shkelja e kryer, ka cënuar rëndë sistemin ligjor të Bashkimit Evropian, apo ka minuar funksionimin e të drejtës së Bashkimit, në tërësi.

Kur Shtetet Anëtare nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore që burojnë nga e drejta e Bashkimit Evropian, si dhe kur kjo mospërmblidhje ose shkelje e kryer prej tyre, ka qenë e rëndë, duke vënë në dyshim sistemin ligjor të Bashkimit, Komisioni nuk ka hezituar që të ngrejë padi në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë kundër tyre, ku, duhet thënë se, një pjesë të madhe të padive të ngritura, janë fituar tij. Një nga rastet tipike të ngritjes së padive nga Komisioni, është kur Shtetet Anëtare kanë shkelur detyrimin për bashkëpunim të singertë me Bashkimin Evropian, detyrim i cili buron nga pika 4 e nenit 3 të Traktatit të Bashkimit Evropian, ku parashikohet se, në bazë të parimit të bashkëpunimit të singertë, Bashkimi dhe Shtetet Anëtare e mbështesin njëri-tjetrin, në kryerjen e detyrave që rrjedhin nga Traktatet.

Duhet të kemi parasysh se, detyrimi që kanë Shtetet Anëtare për bashkëpunim të singertë me Bashkimin Evropian, nuk është një detyrim, thjesht formal, por, është

një detyrim thelbësor, që duhet të zbatohet, në çdo rast nga Shtetet Anëtare. Një gjë e tillë rezulton edhe nga fakti se, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, shumë vendime të saj, kundër Shteteve Anëtare, i ka bazuar, pikërisht, në mos zbatimin nga ana e tyre të detyrimit për bashkëpunim të sinqertë me Bashkimin Evropian, disa prej këtyre vendimeve janë cituar edhe në këtë Punim. Detyrimi për bashkëpunim të sinqertë, është një parim i përgjithshëm dhe për pasojë i ka shërbyer Gjykatës për të bazuar vendimet e saj, vetëm në rastet kur, Shtetet Anëtare nuk kanë shkelur një dispozitë tjetër ligjore konkrete, pasi kur ka rezultuar se, ata kanë shkelur një ose disa dispozita konkrete, Gjykata e ka bazuar vendimin e saj, në shkeljen e këtyre dispozitave nga Shtetet Anëtare dhe jo në parimin e përgjithshëm të bashkëpunimit të sinqertë.

Parimi i bashkëpunimit të sinqertë përbëhet nga disa elementë, siç janë respekti reciprok, ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Shteteve Anëtare, marrja e çdo mase të përgjithshme dhe të posaçme nga Shtetet Anëtare për plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga e drejta e Bashkimit Evropian, marrja e masave nga Shtetet Anëtare për lehtësimin e arritjes së objektivave nga ana e Bashkimit, si dhe heqja e çdo mase ose pengesë, që pengon Bashkimin Evropian në arritjen e objektivave të tij.

Rast të tjetër tipik kur Komisioni ka ngritur padi ndaj Shteteve Anëtare, janë rastet kur Shtetet Anëtare kanë respektuar, në mënyrë të papërshtatshme të drejtën e Bashkimit Evropian. Ky rast mund të haset në dy situata, e para, kur Shtetet Anëtare zbatojnë, në mënyrë të gabuar të drejtën e Bashkimit Evropian dhe e dyta, kur Shtetet Anëtare, zbatojnë, pjesërisht, jo në mënyrë të plotë, të drejtën e Bashkimit.

Një rast tjetër tipik që e ka detyruar Komisionin që të ngrejë padi kundër Shteteve Anëtare, është rasti kur ata, me veprimet e tyre, kanë cenuar Politikën e Përbashkët të Jashtme të Bashkimit Evropian. Bashkimi Evropian si organizatë ndërkombëtare, është subjekt i së drejtës ndërkombëtare, më vehte dhe i pavarur, krahas Shteteve Anëtare, që e përbëjnë atë. Duke qenë subjekt më vehte i së drejtës ndërkombëtare, Bashkimi Evropian, ka edhe politikën e tij të jashtme, të pavarur nga Shtetet Anëtare. Nëse, një ose disa Shtete Anëtare, me veprimet e tyre, çenojnë politikën e jashtme të Bashkimit Evropian, atëherë, Komisioni Evropian, ka të drejtë që të ngrejë padi kundër tyre, me qëllim që politika e jashtme e këtyre Shteteve, të jetë në përputhje me politikën e jashtme të Bashkimit Evropian.

Rasti i fundit tipik kur Komisioni Evropian mund të ngrejë padi kundër Shteteve Anëtare, iu referohet situatave kur Shtetet Anëtare kryejnë shkelje të lehta, por të përsëritura, të së drejtës së Bashkimit Evropian, ose zbatojnë praktika të përgjithshme, që vijnë në kundërshtim me të drejtën e Bashkimit. Shkeljet e lehta, por të përsëritura e të drejtës së Bashkimit, nga ana e Shteteve Anëtare, tregojnë një mospërfillje që këto Shtete kanë për rendin juridik të Bashkimit, dhe për këtë arsye, është e drejta e Komisionit që të ngrejë padi, që t'i detyrojnë këto Shtete që t'i ndërpresin këto shkelje dhe të mos i përsërisin ato në të ardhmen. Po ashtu, zbatimi i praktikave të përgjithshme nga ana e Shteteve Anëtare, të cilat vijnë në kundërshtim me të drejtën e Bashkimit, sjellë pasoja për qytetarët e Bashkimit Evropian, duke dëmtuar, në mënyrë të padrejtë interesat e tyre, dhe në këto kushte, është e drejtë dhe detyrim i Komisionit, që të ngrejë padi kundër këtyre Shteteve, me qëllim që të ndalohen këto praktika të paligjshme dhe që e gjithë sjellja dhe veprimtaria e autoriteteve kombëtare të Shteteve Anëtare, të jetë në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian.

Kur një Shtet Anëtar kryen një shkelje të së drejtës së Bashkimit Evropian, ose nuk përmbush një detyrim që buron nga e drejta e Bashkimit, Traktatet Kushtetuese, i kanë njohur të drejtën edhe Shteteve të tjera Anëtare, përveç Komisionit Evropian, që

të fillojnë procedurat ligjore, kundër këtij Shteti Anëtar, me qëllim që ta detyrojë atë që të ndreqë shkeljen e kryer ose të përmbushë detyrimin, në përputhje me të drejtën e Bashkimit. Arsyet se pse Traktatet Kushtetuese, ia kanë njohur këtë të drejtë edhe secilit prej Shteteve Anëtare, përveç Komisionit, mund të përmbledhen në tre: e para, sepse, Komisioni ka liri të plotë për të vlerësuar dhe vendosur për fillimin e procedurave kundër një Shteti Anëtar edhe kur ai ka kryer shkelje, dhe në këto kushte njohja e kësaj të drejte Shteteve Anëtare, është një mjet juridik shitesë, që zbatohet kur Komisioni nuk dëshiron të veprojë, e dyta, shkelja e kryer nga një Shtet Anëtar, mund të cenojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, interesat e Shtetit tjetër Anëtar dhe për këtë shkak, ky i fundit është shumë më i interesuar edhe se Komisioni, për fillimin e procedurave dhe për ndreqjen e shkeljes së kryer, pasi ai është pala e dëmtuar dhe e treta, dhënia e kësaj të drejte Shteteve Anëtare, siguron zbatimin sa më të plotë dhe efektiv të së drejtës së Bashkimit Evropian.

Procedurat ligjore të nisura nga një Shtet Anëtar, kundër një Shteti tjetër Anëtar për mospërmbushjen e detyrimeve prej tij, kalojnë, po ashtu në disa faza, që janë:

a) ngritja nga ana e Shtetit Anëtar e çështjes së mospërmbushjes së detyrimeve ligjore, nga ana e Shtetit tjetër Anëtar, para Komisionit Evropian;

b) dhënia kohë dhe mundësi nga ana e Komisionit, Shteteve të përfshira në mosmarrëveshje, që të paraqesin pretendimet dhe kundërshtimet e tyre;

c) Nxjerrja nga ana e Komisionit e një Mendimi të Arsytuar, nëse ai e vlerëson të arsyeshme për ta nxjerrë atë;

ç) Ngritja e padisë nga ana e Shtetit Anëtar, kundër Shtetit tjetër Anëtar, në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë.

Për procedurat ligjore të nisura nga një Shtet Anëtar, kundër një Shteti tjetër Anëtar, për mospërmbushjen e detyrimeve prej tij, në krahasim me procedurat e nisura nga Komisioni, konstatojmë se, mungon faza informale ose e zgjidhjes diplomatike dhe me pajtim e mosmarrëveshjes, ndërmjet palëve. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që, gjatë procedurave ligjore të zhvilluara nga një Shtet Anëtar, kundër një Shteti tjetër Anëtar, mungojnë ose nuk zbatohen përpjekjet për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjes, ndërmjet palëve. Përkundrazi, parashikimi i zbatimit dhe ndjekjes së gjithë procedurës ligjore, që duhet të ndjekë Shteti Anëtar, para se të ngrejë padi kundër Shtetit tjetër Anëtar, është bërë pikërisht për faktin, për t'u dhënë mundësi palëve që ta zgjidhin mosmarrëveshjen me pajtim.

Kështu, gjatë fazës së parë të procedurës, Shteti Anëtar, duhet që t'i drejtojë një Letër Zyrtare Komisionit, me anë të të cilës e njofton, se, sipas tij, Shteti tjetër Anëtar, nuk ka përmbushur një ose disa detyrime që burojnë nga e drejta e Bashkimit Evropian. Në këtë Letër Zyrtare ose Njoftim Zyrtar, Shteti që nis procedurat ligjore, duhet të tregojë, me hollësi dhe konkretisht se cilat janë shkeljet ligjore që ka kryer Shteti tjetër Anëtar, duke cituar edhe dispozitat ligjore të shkeluara, si dhe duhet të paraqesë edhe prova konkrete që tregojnë se Shteti tjetër Anëtar i ka kryer shkeljet e pretenduara. Përmbajtja e Letrës Zyrtare të dërguar nga Shteti Anëtar, është shumë e rëndësishme, sepse, në të përcaktohet objekti i mosmarrëveshjes dhe kjo Letër përbën padinë e ardhshme të Shtetit Anëtar, për pasojë, ai në padinë që mund të ngrejë, nuk mund të shtojë çështje të tjera, ose shkelje të tjera, që nuk janë pasqyruar më parë në Letrën Zyrtare.

Pas marrjes së Letrës Zyrtare nga Shteti Anëtar, Komisioni i dërgon një Njoftim Zyrtar Shtetit tjetër Anëtar, me anë të të cilës e njofton për pretendimet që ka Shteti Anëtar për shkeljet ligjore të kryera prej tij. Komisioni së bashku me Njoftimin

Zyrtar, si rregull i dërgon Shtetit tjetër Anëtar edhe një kopje të Letrës Zyrtare, si dhe i fton të dy palët në mosmarrëveshje që të paraqesin pretendimet dhe aragumentet e tyre, duke iu lënë edhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Duhet të kemi parasysh që, gjatë kësaj faze, nga ana e Komisionit, por edhe palëve, bëhen përpjekje që mosmarrëveshja të zgjidhet me pajtim, pasi i gjithë qëllimi i procedurës ligjore, është që të pengohet, sa më shumë, paraqitja e padive, e cila, në çdo rast, sjellë ndërlikime politike dhe diplomatike, ndërmjet Shteteve Anëtare në konflikt.

Traktatat Kushtetuese i kanë dhënë të drejtë Komisionit që të nxjerrë edhe një Mendim të Arsytuar, në konfliktin që zhvillohet ndërmjet Shteteve Anëtare, me anë të të cilit të propozojë alternativat e zgjidhjes me pajtim të mosmarrëveshjes, por, që nxjerrja e këtij Mendimi, nuk është e detyrueshme për Komisionin, ai mund ta nxjerrë atë, vetëm nëse ai e çmon të arsyeshme. Praktika ka treguar se, Komisioni nuk ka nxjerrë një Mendim të Arsytuar, në rastet kur, ai ka qenë i bindur se, mosmarrëveshja ndërmjet palëve, ka qenë e pamundur ose ka patur pa mundësi që të zgjidhet me pajtim, dhe për këtë arsye, nxjerrja e këtij Mendimi, nuk do të kishte rezultat.

Në qoftë se, pas ndjekjes së procedurës ligjore si më sipër, Komisioni nuk e nxjerr Mendimin e Arsytuar, brenda 3 muajve nga fillimi i procedurave ligjore prej Shtetit Anëtar, atëherë, ky i fundit ka të drejtë që të ngrejë padi në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë, kundër Shtetit tjetër Anëtar, i cili nuk ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga e drejta e Bashkimit Evropian. Në vlerësimin e çështjes së ngritjes ose jo të padisë, Shteti Anëtar, duhet të marrë parasysh një sërë faktorësh, si rëndësia e shkeljes, kohëzgjatja e saj, pasojat që ajo ka sjellë, por edhe faktorët politikë, dhe sidomos pasojat që mund të sjellë, në mardhëniet ndërmjet Shteteve në konflikt, ngritja e padisë. Duke marrë parasysh këto faktorë, por sidomos faktorët politikë dhe pasojat që mund të sjellë ngritja e padisë në mardhëniet ndërmjet Shteteve, palë në konflikt, praktika ka treguar se paditë e ngritura nga një Shtet Anëtar kundër një Shteti tjetër Anëtar, për mospërmbushje të detyrimeve, janë shumë të rralla dhe Shtetet Anëtare, kanë preferuar që këtë mjet t'i lënë Komisionit Evropian, si dhe të përdorin Komisionin Evropian, për ngritjen e padive të tilla edhe në rastet kur, ato kanë patur të drejtë dhe kanë vlerësuar se duhet të ngrihet padia.

4.Çështja e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, është një nga çështjet më të rëndësishme, pasi kjo është faza e fundit dhe përfundimtare e të gjithë gjykimit të zhvilluar nga ana e Gjykatës. Nëse, vendimet e Gjykatës nuk do të ekzekutoheshin, atëherë, vendimi përfundimtar i dhënë prej saj, do të mbetej një letër, pa vlerë dhe pa efekte ligjore, sepse, në fund të fundit, qëllimi i dhënies së vendimit është që me anë të tij, të ndreqet shkelja ligjore ose të vihet në vend drejtësia, e konstatuar me këtë vendim. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, vështirësohet jo vetëm nga fakti se, ajo nuk është një gjykatë kombëtare, për të cilën ekziston shërbimi përbarimor përkatës, por edhe për faktin tjetër se, vendimet e dhënë nga kjo Gjykatë, janë vendime me karakter deklarativ ose garcioz dhe nuk janë vendime që përbajnë ekzekutimin e një detyrimi të caktuar dhe për pasojë, nuk mund të ekzekutohen, drejtpërdrejt nga ana e përmbaruesit gjyqësor.

Në Traktatat Kushtetuese, janë parashikuar rregulla konkrete për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, rregulla këtë të përcaktuara në nenin 260 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian. Rregullat për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës mund të ndahen në rregulla për ekzekutimin vullnetar të vendimit dhe rregulla për ekzekutimin e detyrueshëm të tij. Rregullat për ekzekutimin

vullnetar janë parashikuar në pikën 1 të nenit 260 të Traktatit, sipas të cilave, nëse konstatohet që Shteti Anëtar nuk ka ekzekutuar vendimin e Gjykatës, atij i kërkohet që të marrë masat e nevojshme për ekzekutimin e këtij vendimi. Gjatë kësaj faze, e cila, zakonisht është e shkurtër në kohë, Shtetit Anëtar i lihet një afat i arsyeshëm që të paraqesë pretendimet dhe kundërshtimet e tij, por, sidomos, ky afat i lihet me qëllim që, ai të fillojë, menjëherë, ekzekutimin e vendimit të Gjykatës.

Nëse, Shteti Anëtar edhe pas njoftimit që i bëhet për ekzekutimin në mënyrë vullnetare të vendimit, duke iu lënë edhe një afat i arsyeshëm për këtë qëllim, nuk e ekzekuton vullnetarisht atë, atëherë, kalohet në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimit të Gjykatës. *Faza e ekzekutimit të detyrueshëm, nënkupton ngritjen e padisë nga ana e Komisionit, në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë, kundër Shtetit Anëtar, me anë të të cilës, kërkohet që të detyrohet ky i fundit që të ekzekutojë vendimin e Gjykatës. Përpara se Komisioni të ngrejë padi në Gjykatë, duhet që të respektojë një procedurë ligjore të caktuar që kalon në tre faza:*

a) konstatimi nga Komisioni që Shteti Anëtar nuk e ka ekzekutuar, pa shkaqe të arsyeshme, vendimin e Gjykatës;

b) Dërgimin nga ana e Komisionit e një Letre Zyrtare Shtetit Anëtar, në të cilën e njofton për konstatimin që ai ka bërë, si dhe e fton atë që të paraqesë kundërshtimet dhe argumentet e tij;

c) ngritja e padisë nga ana e Komisionit.

Me Traktatin e Lisbonës, të hyrë në fuqi, më 1 janar 2009, është hequr një fazë e rëndësishme që lidhje me ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, pasi para këtij Traktati, Komisioni ishte i detyruar që të nxirrte një Mendim të Arsyetuar, dhe t'i linte mundësi Shtetit Anëtar që, brenda një afati të arsyeshëm të paraqiste pretendimet dhe prapsimet e tij për këtë Mendim. Ndryshimi i bërë me Traktatin e Lisbonës, është një ndryshim që duhet përshendetur, pasi në këtë mënyrë, të shkurtohet procedura e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe ekzekutimi i tyre do të bëhet, më shpejt dhe brenda afateve të arsyeshme.

Me ngritjen e padisë kundër Shtetit Anëtar për mosekzekutimin e vendimit, Komisioni i propozon Gjykatës edhe shumën e menjëhershme të parave dhe/ose shumën e gjobës, që Shteti Anëtar do të paguajë, derisa, ai të ekzekutojë plotësisht vendimin. Duhet të kemi parasysh se, Komisioni ka të drejtë të propozojë dhe Gjykata mund të vendosë, si pagimin e një shume të menjëhershme, e cila vendoset për ndreqjen e pasojave të dëmshme që ka shkaktuar mosekzekutimi i vendimit, ashtu edhe pagimin e një gjobe periodike, nga Shteti Anëtar, e cila do të paguhet nga Shteti Anëtar, në mënyrë periodike, deri në ditën që ai do të ekzekutojë, plotësisht, vendimin e Gjykatës.

Komisioni e propozon vlerën e shumës së menjëhershme dhe/ose të gjobës periodike, në varësi të rëndësisë së shkeljes, në varësi të sjelljes së Shtetit Anëtar për ekzekutimin e vendimit, por duke u nisur edhe nga madhësia dhe popullsia e Shtetit Anëtar, si dhe nga gjendja financiare e tij dhe votat që ai ka në Këshill, në rastet kur duhet të merren vendime të cilësuar. Për përcaktimin e vlerës së shumës së përgjithshme dhe/ose të gjobës periodike, Komisioni në vitet 1996, 1997, ka nxjerrë dy Komunikata, “Memorandumi për gjobat” dhe “Njoftimi i Koeficientit”, mbi bazën e të cilave bëhet llogaritja prej tij e gjobave të propozuara, ku, Komisioni për vlerën e tyre, disa herë ka theksuar se ato nuk duhet të jenë simbolike, por, duhet që të kenë si qëllim që të detyrojnë Shtetin Anëtar që sa më shpejt të ekzekutojë vendimin e Gjykatës. *Duhet theksuar se, pavarësisht propozimeve të bëra nga Komisioni dhe kritereve të vendosura prej tij për llogaritjen e gjobave, Gjykata Evropiane e*

Drejtësisë, në disa vendime të saj, ka theksuar se, kriteret e vendosura nga Komisioni, janë me natyrë udhëzuese dhe nuk janë detyruese për Gjykatën. Me Traktatin e Lisbonës, si për t'i dhënë të drejtë Komisionit Evropian, në lidhje me kriteret e vendosjes së gjobave, Traktatet Kushtetuese përcaktuan se, shumica e gjobës së vendosur nga Gjykata, nuk mund ta kalojë vlerën e shumës së propozuar nga Komisioni.

Një ndryshim tjetër shumë pozitiv i bërë me Traktatin e Lisbonës, është ndryshimi i pikës 3 në nenin 260 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, në bazë të të cilit, në rastet e mospërbushjes së detyrimeve prej Shteteve Anëtare që lidhen me zbatimin e Direktivave të Bashkimit Evropian, me objekt përshtatjen e legjislacioneve kombëtare me atë të Bashkimit Evropian, Komisioni ka të drejtë që t'i propozojë, në mënyrë të drejtpërdrejtë Gjykatës, pagimin shumës së menjëhershme ose të gjobës periodike për Shtetin Anëtar, pa qenë nevoja për zhvillimin e një gjykimi tjetër të ri, me objekt ekzekutimin e vendimit të Gjykatës, sipas procedurës së parashikuar nga pikat 1 dhe 2 të këtij neni. Ndryshimi i mësipërm është një ndryshim pozitiv dhe me vlera praktika, pasi sipas këtij ndryshimi, nëse një Shtet Anëtar, nuk zbaton një Direktivë të Bashkimit që ka për objekt përafrimim të legjislacionit të tij, me atë të Bashkimit Evropian, Gjykata e Drejtësisë, kur konstaton se, Shteti në fjalë nuk ka përmbushur këtë detyrim, mbi bazën e propozimit të Komisionit, ajo ka të drejtë që të vendosë me vendimin e saj përfundimtar, pagimin e një shume të menjëhershme dhe/ose pagimin e një gjobë periodike, derisa, Shteti Anëtar të ekzekutojë vendimin e Gjykatës. Me anë të këtij ndryshimi dhe vetëm për për Direktivat me karakter legjislativ, shmanget procedura e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, të parashikuara nga neni 260 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe vendimi i Gjykatës, nuk është më me karakter njohës, por, është një vendim që përcakton detyrime konkrete për Shtetin Anëtar, vendim i cili është i ekzekutueshëm, në mënyrë të ngjashme, me vendimet e gjykatave të Shteteve Anëtare.

Pas paraqitjes së Konkluzioneve të këtij punimi, mendoj që të jap disa Rekomandime, që kanë të bëjnë me përmirësimin e dispozitave ligjore që rregullojnë Statusin dhe veprimtarinë e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë edhe pse jam e vetëdijshme se, dhënia e tyre, është një punë e vështirë, duke u nisur nga rëndësia e madhe që ka tema objekt trajtimi.

i.Rekomandimi i parë i referohet mënyrës së emërimit të Gjyqtarëve të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe Avokatëve të Përgjithshëm, si dhe të Gjyqtarëve të Gjykatës së Përgjithshme. Siç është trajtuar më lart, Gjyqtarët e Gjykatës së Drejtësisë si dhe Avokatët e Përgjithshëm, emërohen me miratimin e përbashkët të Qeverive të Shteteve Anëtare, për një mandat gjashtëvjeçar, me të drejtë riemërimi. Për të siguruar një pavarësi sa më të plotë të Gjyqtarëve të Gjykatës së Drejtësisë dhe të Gjyqtarëve të Gjykatës së Përgjithshme, si dhe për të shmangur çdo lloj ndikimi të mundshëm, që ata mund të kenë nga Qeveritë e Shteteve Anëtarë që i zgjedhin, do të rekomandoja që, Gjyqtarët e Gjykatës së Drejtësisë dhe të Gjykatës së Përgjithshme, të emëroheshin nga institucionet e Bashkimit Evropian, siç mund të ishte Këshili ose Parlamenti Evropian, ose të dy këto institucione, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, ashtu, siç emërohen sot, Gjyqtarët e Gjykatës së Shërbimit Civil.

Ndryshimi i mënyrës së emërimit të Gjyqtarëve të Gjykatës së Drejtësisë dhe të Gjykatës së Përgjithshme, në këtë mënyrë, përveçse do të përjashtonte çdo ndikim

të mundshëm të Shteteve Anëtare mbi këta Gjyqtarë dhe do të siguronte një pavarësi më të plotë të tyre, do të shënonte edhe një hap përpara në drejtim të konsolidimit të Bashkimit Evropian si një Bashkim Shtetesh të Pavrura në formën e një Konfederate ose Federate, duke e kaluar nga një organizatë ndërkombëtare e një lloji të veçantë ose “sui generis”, siç është sot, në një Evropë të Bashkuar, e cila ka qenë edhe ëndërra e themeluesve të Bashkimit. Në përputhje me këtë rekomandim, mbi mënyrën e zgjedhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës së Drejtësisë dhe të Gjykatës së Përgjithshme, fjalë e fundit e paragrafit të parë, të nenit 253 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, propozoj që të ndryshohet në këtë mënyrë:

“Ata emërohen nga Parlamenti Evropian, mbi bazën e propozimit të bërë nga Shtetet Anëtare për një mandat nëntëvjeçar, pasi konsultohet me panelin e parashikuar në nenin 255”.

Duke qenë e vetëdijshme që ndryshimi i mënyrës së emërimit të Gjyqtarëve të Gjykatës së Drejtësisë dhe të Gjykatës së Përgjithshme, nga emërimi i tyre me marrëveshje të përbashkët të Shteteve Anëtare, në emërimin e tyre nga institucionet e Bashkimit Evropian, do të ishte një rekomandim ose propozim që vështirë se do të pranohej nga Shtetet Anëtare, për shkak të mos pranimit prej tyre që të heqin dorë nga ajo pjesë e Sovranitetit që lejon gjykimin e sjelljes së tyre nga persona që ata nuk i kanë zgjedhur ose që kanë votuar, për zgjedhjen e tyre, unë do të bëja një rekomandim tjetër që ka të bëjë me mandatin ose kohëzgjatjen e funksionit të këtyre Gjyqtarëve. Gjithmonë, në drejtim të sigurimit të një pavarësie sa më të plotë dhe të shmangies së çfarëdo lloji ndikimi nga Qeveritë e Shteteve Anëtarë, *do të propozoja që, Gjyqtarët e Gjykatës së Drejtësisë dhe të Gjykatës së Përgjithshme të vazhdonin të emëroheshin me marrëveshje të përbashkët të Qeverive të Shteteve Anëtare, por mandati ose kohëzgjatja e tyre në detyrë të ishte nëntë vjet, pa të drejtë rimemërimi të menjëhershme*. Mendoj se, zgjatja e mandatit të Gjyqtarëve nga gjashtë vjet, në nëntë vjet dhe sidomos mos emërimi i tyre, i menjëhershëm në përfundim të mandatit, është një garanci shtesë, për të siguruar një pavarësi sa më të plotë dhe efektive në ushtrimin prej tyre të funksionit funksionit të vështirë të dhënies së drejtësisë. Në përputhje me këtë propozim, mendoj që paragrafi i katër i nenit 253 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, të ndryshohet në këtë mënyrë:

“Gjyqtarët dhe Avokatët e Përgjithshëm, të cilëve u ka mbaruar mandati, nuk mund të rimërohen, në mënyrë të menjëhershme”.

ii. Një tjetër rekomandim për ndryshime ligjore do të propozoja në nenin 258 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian, i cili flet për procedurat e ndjekura nga Komisioni Evropian kundër Shteteve Anëtare, për mospërbushje të detyrimeve prej tyre ose për kryerjen e shkeljeve ligjore prej tyre. Në paragrafin e parë të kësaj dispozite parashikohet që, nëse, Komisioni mendon se, një Shtet Anëtar, nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga Traktatet Kushtetuese, Komisioni, ka të drejtë që të nisë procedurat ligjore, që ta detyrojë Shtetin në fjalë, që të përmbushë këto detyrime ligjore. Mendoj se, termi *“një detyrim që rrjedh nga Traktatet”*, është një term i kufizuar dhe jo plotësisht i saktë, duke mos shprehur, në mënyrë të qartë, qëllimin që ka patur kjo Dispozitë Kushtetuese. Mendoj se, qëllimi i saj ka qenë që, Komisioni ka të drejtë që të fillojë procedurat ligjore, kundër një Shteti Anëtar, jo vetëm kur ai nuk përmbush detyrimet që burojnë nga Traktatet Kushtetuese, por, edhe kur ai nuk përmbush detyrimet që burojnë nga i gjithë sistemi ligjor i Bashkimit Evropian, ku përfshihen përveç Traktateve Kushtetuese, edhe aktet ligjore të nxjerra nga institucionet e Bashkimit, siç janë Rregulloret, Direktivat dhe Vendimet, fakt ky

që është konfirmuar edhe nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në disa vendimet të saj. Për këtë arsye, *mendoj që, në paragrafin e parë të nenit 258 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, fjalët “një detyrim që rrjedh nga Traktatet”, të zëvendësohet me fjalët: “një detyrim që rrjedh nga sistemi ligjor i Bashkimit Evropian”, dhe pas këtij ndryshim, i gjithë paragrafi i parë i kësaj dispozite, mendoj të ndryshohet në këtë mënyrë:*

“Nëse Komisioni është i mendimit që një Shtet Anëtar nuk ka përmbushur një detyrim që rrjedh nga sistemi ligjor i Bashkimit Evropian, ai nxjerr një Mendim të Arsytuar për çështjen në fjalë, pasi i ka dhënë Shtetit në fjalë mundësinë që të paraqesë shpjegimet e veta”.

iii. Një tjetër ndryshim që mendoj se duhet të bëhet në nenin 258 të Traktatit të mësipërm, ka të bëjë me shtimin e një paragrafi të veçantë në këtë nen, para paragrafit të dytë, paragraf i cili të flasë, në mënyrë shumë të përmbledhur, për *përmbajtjen e Mendimit të Arsytuar që nxjerr Komisioni, në këtë rast*. Shtimi i këtij paragrafi mendoj se duhet bërë për faktin se, Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në shumë vendime të saj, ka theksuar rëndësinë e jashtëzakonshme që ka Mendimi i Arsytuar, duke përcaktuar edhe kriterët dhe kufijtë e përmbajtjes së tij. Pavarsisht se, Gjykata në disa vendime të saj, është shprehur për rëndësinë dhe elementet që duhet të përmbajë Mendimi i Arsytuar, e çmoj me vend se, një përshtatje e përgjithshme të përmbajtjes së këtij akti në Traktatet Kushtetuese, do të shërbente në funksion të rregullimit sa më të plotë dhe të qartë të të gjithë procedurave që ndjek Komisioni, nëse, një Shtet Anëtar, nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga e drejta e Bashkimit Evropian. Nisur sa më lart, mendoj që, pas paragrafit të parë të nenit 258 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, të shtohet një paragraf tjetër me këtë përmbajtje:

“Komisioni në Mendimin e Arsytuar që nxjerr, tregon objektin e mosmarrëveshjes dhe shkeljet konkrete që ka kryer Shteti Anëtar, së bashku me provat përkatëse, kur është e mundur, duke i lënë edhe një afat të arsyeshëm për ndreqjen e shkeljeve të pretenduara”

iv. Një plotësim tjetër që mendoj se duhet të bëhet në nenin 258 të Traktatit, është shtimi i dy paragrafeve të tjerë, pas paragrafit të dytë ekzistues të këtij neni, shtim i cili, ka të bëjë me natyrën e vendimeve që jep Gjykata e Drejtësisë, si dhe me ekzekutimin e tyre, dhe ndryshim që aktualisht është bërë me Traktatin e Lisbonës, në nenin 260 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, në pikën 3 të tij dhe që parashikohet vetëm për detyrimet që kanë Shtetet Anëtare për të zbatuar Direktivat me karakter legjislativ të Bashkimit, pra, për të përshtatur legjislacionin e tyre të brendshëm me atë të Bashkimit Evropian. Siç është theksuar më lart, në rastet kur, një Shtet Anëtar nuk zbaton një direktivë me karakter legjislativ, sipas Traktatit të Lisbonës, Komisioni ka të drejtë që në ngritjen e padisë të propozojë edhe shumën e menjëhershme ose shumën e gjatë që detyrohet që të paguajë Shteti Anëtar, derisa ai të zbatojë detyrimin për zbatimin e Direktivës së Bashkimit Evropian, kërkesë e cila duhet të pranohet nga Gjykata, nëse ajo e vlerëson padinë e ngritur si të bazuar.

Mendoj se, ka ardhur koha që, Komisionit t'i jepet e drejta që kur ngren padinë kundër një Shteti Anëtar, për mospërmbushje të detyrimeve prej tij, ai t'i propozojë Gjykatës edhe pagimin e një shumë të menjëhershme dhe/ose gjatë periodike, për çdo mospërmbushje të detyrimeve nga Shtetet Anëtare, dhe jo vetëm për mospërmbushjen e detyrimeve që burojnë nga Direktivat me karakter legjislativ. Një parashikim i tillë kushtetues, do të ishte një hap i madh cilësor, që do të

garantonte një ekzekutim të shpejtë dhe efektiv të vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, pasi do të shmangte të gjithë procedurën për ekzekutimin e vendimeve, të parashikuar nga neni 260 i Traktatit dhe do të shmangte zhvillimin e një gjykimi të ri nga ana e Gjykatës, sipas këtij neni, në të cilën ajo konstaton mosekzekutimin e vendimit të saj, si dhe ndëshkimin e Shtetit në fjalë, me pagimin e një shume të menjëhershme dhe/ose të një gjobe peridodike, deri në ekzekutimin e plotë të vendimit nga ana e këtij Shteti.

Në lidhje me këtë ndryshim kushtetues, dua të shtoj se, unë jam e vetëdijshme që ky ndryshim do të kërkonte një vullnet të fortë politik nga Shtetet Anëtare të Bashkimit, të cilët mund të mos jenë të gatshëm për ta përqafuar, pasi ky ndryshim përbën një zhvillim shumë të madh përpara drejt krijimit të një forme të Shteteve të Bashkuara të Evropës ose të një Evrope të Bashkuar, sepse, në këtë rast, vendimet e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, do të ishin vendime të njëjta, në thelb, me vendimet e gjykatave të brendshme të Shteteve Anëtare dhe do të shndërroheshin nga vendime me natyrë njohëse, në vendime me natyrë detyruese. Për të arritur një rezultat të tillë, në nenin 258 të Traktatit, mendoj se, duhet të shtohen dy paragrafe të rinj, me këtë përmbajtje:

“Kur Komisioni ngren padi para Gjykatës, sipas këtij neni, me arsyen se Shteti Anëtar në fjalë nuk ka përmbushur detyrimet që burojnë nga sistemi ligjor i Bashkimit Evropian, kur e gjykon të arsyeshme, ai mund të propozojë vlerën e shumës së menjëhershme dhe/ose të gjobës që duhet të paguajë Shteti Anëtar në fjalë, siç e gjykon të arsyeshme sipas rrethanave. Nëse Gjykata konstaton se ka shkelje, ajo mund të vendosë shumën ose/dhe gjobën për Shtetin Anëtar në fjalë, siç ajo e gjykon të arsyeshme sipas rrethanave”.

Ndryshimi i propozuar që të bëhet në nenin 258 të Traktatit me shtimin e dy paragrafeve të rinj, do të bënte që kjo dispozitë kushtetuese, nga një nen me dy paragrafe, të shndërrohen në një nen me pesë paragrafe, nen i cili, duke përfshirë të gjitha shtesat dhe ndryshimet e propozuara, do të kishte këtë përmbajtje:

“Nëse Komisioni është i mendimit që një Shtet Anëtar nuk ka përmbushur një detyrim që rrjedh nga sistemi ligjor i Bashkimit Evropian, ai nxjerr një Mendim të Arsyetuar për çështjen në fjalë, pasi i ka dhënë Shtetit në fjalë mundësinë që të paraqesë shpjegimet e veta.

Komisioni në Mendimin e Arsyetuar që nxjerr, tregon objektin e mosmarrëveshjes dhe shkeljet konkrete që ka kryer Shteti Anëtar, së bashku me provat përkatëse, kur është e mundur, duke i lënë edhe një afat të arsyeshëm për ndreqjen e shkeljeve të pretenduara.

Nëse Shteti Anëtar nuk e zbaton Mendimin brenda periudhës së vendosur nga Komisioni, ky i fundit mund ta ngrejë çështjen përpara Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Kur Komisioni ngren padi para Gjykatës, sipas këtij neni, me arsyen se Shteti Anëtar në fjalë nuk ka përmbushur detyrimet që burojnë nga sistemi ligjor i Bashkimit Evropian, kur e gjykon të arsyeshme, ai mund të propozojë vlerën e shumës së menjëhershme dhe/ose të gjobës që duhet të paguajë Shteti Anëtar në fjalë, siç e gjykon të arsyeshme sipas rrethanave.

Nëse Gjykata konstaton se ka shkelje, ajo mund të vendosë detyrimin e Shtetit Anëtar që të paguajë shumën ose/dhe gjobën në vlerën që ajo e çmon të arsyeshme sipas rrethanave konkrete të çështjes. Detyrimi për të paguar fillon në datën e vendosur nga gjykata dhe vazhdon, deri kur Shteti Anëtar e ekzekuton plotësisht vendimin e Gjykatës”.

Nga ana tjetër propozimet për shtesa në nenin 258 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, më konkretisht, propozimi për të shtuar dy paragrafet e fundit në këtë dispozitë, e bëjnë të panevojshëm të gjithë nenin 260 të këtij Traktati dhe për pasojë, nëse këto ndryshime dhe shtesa do të miratoheshin, kjo dispozitë ligjore (neni 260) do të duhej të shfuqizohej.

Ndryshimi i fundit ligjor që mendoj të propozoj, në funksion të përmirësimit dhe qartësimit të dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, lidhet me nenin 259 të Traktatit që flet për procedurat që ka të drejtë që të ndjekë një Shtet Anëtar, kundër një Shteti tjetër Anëtar, në rast se ky i fundit nuk ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga sistemi ligjor i Bashkimit Evropian. Në paragrafin e e tretë të këtij neni, në fillim të tij, pas fjalës “Komisioni”, mendoj që të shtohen fjalët: “*brenda tre muajve*”, pasi duke vendosur afatin brenda të cilit Komisioni ka të drejtë dhe jo detyrim që të nxjerrë Mendimin e Arsytuar, kjo dispozitë ligjore bëhet më e qartë dhe është në harmoni dhe me paragrafin e katërt të saj. Si përfundim, nëse, do të pranohej propozimi për rregullimin e këtij paragrafi, ky paragraf, do të kishte këtë përmbajtje:

“Komisioni, brenda tre muajve, nxjerr një Mendim të Arsytuar pasi i ka dhënë secilit prej Shteteve në fjalë mundësinë që të paraqesin argumentet e tyre dhe komentet e tyre për argumentet e palës tjetër, me gojë dhe me shkrim”.

Këto ishin disa nga rekomandimet që unë propozoj, me qëllim përmirësimin dhe qartësimin e dispozitave Kushtetuese që rregullojnë statusin dhe veprimtarinë e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë. Natyrisht që pranimi i këtyre rekomandimeve dhe ndryshimeve kushtetuese, është në vullnetin politik të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, por, unë jam e mendimit që pranimi i tyre, jo vetëm që do ta bënte më të qartë dhe të plotë kuadrin kushtetues në lidhje me organizimin dhe veprimtarinë e Gjykatës, por, edhe do të çonte në drejtim të forcimit dhe konsolidimit të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në veçanti dhe Bashkimit Evropian, në përgjithësi.

Bibliografia

I. Literatura bazë

1. Anastasi; Aurela, *"E drejta kushtetuese e krahastuar"*, Tiranë 2009.
2. Borchardt, K, D, *"ABC-ja e së drejtës së Bashkimit Evropian"*, botim i Ministrisë së Integrimit Evropian, Tiranë 2011.
3. Bernitz U & Nergelius J; *"General Principle of Community Law"*, Kluwer 2000.
4. Bell, M; *"Anti-Discrimination Law and European Union"*, Oxford University Press, 2002.
5. Craig P; De Burca G; *"E drejta e Bashkimit Evropian, tekste, çeshtje gjyqësore dhe materiale"*, botuar nga Qendra e Studimeve Ndërkombëtare, Tiranë 2013.
6. Celami, E; *"Gjykata Evropiane e Drejtësisë. Juridiksioni. Efekti i vendimeve të saj në gjykatat e shteteve anëtare. Raporti i saj me GJEDNJ"*, shkolla e Magjistraturës, viti 2006.
7. Heukels, T & McDonnell, A, *"The action for damages in Community Law"*, Kluwer, 1997.
8. Jacque, J, P; *"E drejta institucionale e Bashkimit Evropian"*, shtëpia botuese "Papyrus", Tiranë, 2010.
9. L. Neville Brown & Tom Kennedy; *"The European Court of Justice of European Communities"*.
10. Lasole & Bridge; *"Law and Institutions of European Union"*.
11. Nuni; Ardian, *"E drejta Civile, pjesa e përgjithshme"*, Tiranë 2012.
12. Pocar; Fausto; *"E Drejta e Komuniteteve Evropiane"*, Shtëpia botuese "Logoreci", Tiranë 1995.
13. Sadushi, Sokol, *"Gjykata administrative dhe kontrolli ligjor mbi administratën"*, Tiranë 2014.
14. Stephen Weatherill; Paul Beaumont; *"EU Law"*;
15. Schermers, HG, Heukel T, & Mead, P; *"The non-Contractual Liability of the European Communities"*, Nijhof 1998;
16. Tridimas T; *"The General Principles of EU Law"*, Office of Official Publication of the European Communities, 2006.
17. U Bernitz; *"Controlling Member State Courts under EU Law"*, 2005.
18. Zajmi; Iva, *"E drejta evropiane"*, Tiranë, 2006;

II. Traktetet themeluese të Bashkimit Evropian.

1. Traktatit Themelues i Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut, nënshkruar me datë 18 prill 1951 dhe hyrë në fuqi me datë 25 korrik 1952.
2. Akti Unik Evropian, nënshkruar në Luksemburg me datë 17 shkurt 1986 dhe në Hagë me 28 shkurt 1986 dhe hyrë në fuqi me datë 1 korrik 1987.
3. Traktati i Komunitetit Ekonomik Evropian.
4. Traktati i Amsterdimit.
5. Traktati i Nisës.
6. Traktati i Lisbonës, hyrë në fuqi me 1 janar 2009.

7. Traktati i Bashkimit Evropian.
8. Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian, version i konsoliduar.
9. Protokolli(nr.2) *“Për zbatimin e parimeve të subsidiaritetit dhe të proporcionalitetit”*.
10. Statuti i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.
11. Shtojca Nr (1) e Statutit të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.
12. Rregullorja e Procedurës së Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

III. Vendime dhe Jurisprudencë e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

1. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen çështjen nr. 114/76 Bela-Muhle kundër Grous Farm (1997) ECR 1211.
2. Vendim nr. 26/69, (1960), ECR 423, i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen Stauder kundër Ulm.
3. Vendim nr. 4/73, (1974), ECR 491, i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen Nold kundër Komisionit Evropian.
4. Vendim nr. 145/77, (1978) ECR 2027, i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen Royal Scholten-Honing kundër IBAP.
5. Vendim nr. 37/89, (1990) ECR 2395, i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen Ueiser kundër Caisse Nationale des Barreaux Français.
6. Vendim nr. 30/89, (1990) ECR 691 i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen Komisioni Evropian kundër Francës.
7. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, i datës 15 qershor 1994, në çështjen nr. C-137/92 P, Commission vs BASF E.A.
8. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen gjyqësore nr. 60/81, Korporata e Mjeteve të Biznesit Ndërkombëtar, kundër Komisionit Evropian; (1981) ECR 2639.
9. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen gjyqësore nr. 22/70; Komisioni kundër Këshillit (1971) ECR 263.
10. Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë, i datës 2 tetor 2011, në çështjen Martines. De Gaulle, Front National et Bonmino at d’autres kundër Parlamentit Evropian.
11. Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë, i datës 15 janar 2003 në çështjen Philip Morris international et autres kundër Komisionit.
12. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1963) ECR 95, në çështjen gjyqësore Plaumann & C0 kundër Komisionit.
13. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1971) ECR 411, në çështjen gjyqësore Nr. 41-44/70; International Fruit kundër Komisionit.
14. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1984) ECR 411, në çështjen gjyqësore Nr. 222/83; Komuna e Diferdanzhes kundër Komisionit Evropian.
15. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1971) ECR 411, në çështjet gjyqësore Nr. 789 dhe 790; Calpak SpA & Societa Emiliana... SPA kundër Komisionit.
16. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1994) ECR 1853, në çështjen gjyqësore Nr. C-309/89; Codorniu SA kundër Këshillit Evropian.
17. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (2002) ECR I-6677, në çështjen gjyqësore Nr. C-50/00 P Union de Pequenos Agricultores kundër Këshillit Evropian.

18. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (179) ECR 77/811, në çështjen gjyqësore Nr. 92/78; Cimmenthal kundër Komisionit.
19. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1969) ECR 459, në çështjen gjyqësore 10 dhe 18/68; Societa Eridania kundër Komisionit.
20. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1971) ECR 975, në çështjen gjyqësore 5/71, Zuckerfabrik Schoppenstedt kundër Këshillit.
21. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1975) ECR 533, në çështjen gjyqësore 74/74, Comptoir National Technique Agricole SA, kundër Komisionit.
22. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (2000) ECR I-5291, në çështjen gjyqësore Shoqëria Farmaceutike Bergaderm kundër Komisionit Evropian.
23. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1999) ECR I-769, në çështjen gjyqësore Antillean Rice Mills kundër Komisionit.
24. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1970) ECR 325, në çështjet gjyqësore 19, 20, 25, 30/69 Denise Richez-Parise e të tjerë, kundër Komisionit.
25. Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë (1998) ECR II-667, në çështjet gjyqësore Dorch Consult kundër Këshillit.
26. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1967) ECR 245, në çështjet gjyqësore 5, 7, 13-24/1966 Kampfmejer kundër Komisionit.
27. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë (1969) ECR 329, në çështjen gjyqësore Sajag kundër Komisionit.
28. Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë, në çështjen gjyqësore T-191/99, Petrie kundër Komisionit (2001).
29. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjet gjyqësore C-514, 528 dhe 532/07, Suedia dhe API, kundër Komisionit.
30. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen gjyqësore C-96/89, Komisioni kundër Mbretërisë së Holandës, ECR 2461.
31. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen gjyqësore 51/83, Komisioni kundër Italisë, ECR 2793.
32. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen gjyqësore 290/87, Komisioni kundër Mbretërisë së Holandës, ECR 3083.
33. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen gjyqësore 7/61, Komisioni kundër Italisë, ECR 317.
34. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen gjyqësore 74/82, Komisioni kundër Irlandës, ECR 317.
35. Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë, në çështjen gjyqësore T-105/95, Komisioni kundër Spanjës.
36. Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë, në çështjen gjyqësore T-191/99 Petrie kundër Komisionit (2001).
37. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen gjyqësore 96/81, ECR 1791, Komisioni kundër Holandës.
38. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen gjyqësore C-392/96 ECR I-5091, Komisioni kundër Irlandës.
39. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen gjyqësore 167/73, ECR 359, Komisioni kundër Francës.
40. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen gjyqësore 29/84, ECR 1661, Komisioni kundër Gjermanisë.

41. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen gjyqësore 33/69, ECR 93, Komisioni kundër Italisë.
42. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen gjyqësore C-334/08, Komisioni kundër Italisë dhe çështjen gjyqësore C-298/97, Komisioni kundër Spanjës.
43. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen gjyqësore 301/81, ECR 467, Komisioni kundër Belgjikës.
44. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në çështjen gjyqësore 226/87, ECR 3611, Komisioni kundër Greqisë.
45. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen gjyqësore C-278/01, ECR I-14141, Komisioni kundër Spanjës.
46. Vendim i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, në çështjen gjyqësore C-304/02, ECR I-9091, Komisioni kundër Francës.
47. Raport Vjetor i vitit 2009 për diskutimin e statistikave në COM (2009) 675, Commission Communication on Better Monitoring of the Application of Community Law.

Website

1. Website zyrtar i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë www.curia.eu.int dhe www.europe.eu.int
2. Raportet e Monitorimit Vjetor të Komisionit në adresën elektronike: http://ec.europa.eu/community_law/eulaw/index_en.htm.

